

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
BOTIME TË VEÇANTA CLII
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
LIBRI 55

REXHEP ISMAJLI

STUDIME PËR HISTORINË E SHQIPES NË KONTEKST BALLKANIK

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SPECIAL EDITIONS CLII
SECTION OF LINGUISTICS AND LITERATURE
BOOK 55

REXHEP ISMAJLI

STUDIES ON THE HISTORY OF ALBANIAN IN THE BALKAN CONTEXT

Approved for publication at the meeting of
the Section of Linguistics and Literature,
held on 1st October, 2015, after review by
academician Idriz Ajeti and prof. dr. Bardh Rugova.

Editor: Academician Eqrem Basha,
Secretary of the Section of Linguistics and Literature.



PRISHTINA
2015

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
BOTIME TË VEÇANTA CLII
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
LIBRI 55

REXHEP ISMAJLI

STUDIME PËR HISTORINË E SHQIPES NË KONTEKST BALLKANIK

U miratua për botim në mbledhjen e
Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë,
mbajtur më 1 tetor 2015, në bazë të recensioneve të
akademik Idriz Ajetit dhe prof. dr. Bardh Rugovës.

Redaktor: Akademik Eqrem Basha,
Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.



Copyright © ASHAK

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	7
SHQIPJA DHE GJUHËT E BALLKANIT	11
DISKUTIME TË VONA PËR RAPORTET E SHQIPES ME GJUHËT LASHTOBALLKANIKE DHE INDOEUROPIANE	27
PREJARDHJA E GJUHËS SHQIPE – DISKUTIME.....	135
BALLKANISTIKA DHE PREJARDHJA E SHQIPES.....	171
PREJARDHJA E GJUHËS DHE E POPULLIT SHQIPTAR – REFLEKSE PËR DISA IDE TË SHFAQURA NË STUDIMET HISTORIKE....	205
PËR RAPORTET E SHQIPES ME RUMANISHTEN.....	271
RRETH SLLAVIZMAVE TË SHQIPES.....	469
BIBLIOGRAFI E PËRBASHKËT	513
INDEKSI I EMRAVE.....	539

PARATHËNIE

Në këtë vëllim janë bërë bashkë disa studime që janë rezultat i interesimeve për çështjet që na kanë preokupuar pët një kohë, qoftë gjatë procesit mësimor në Departamentin e Gjuhës Shqipe të UP-së, apo në kuadër të Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të ASHAK-ut. Ato nuk janë kapituj të një studimi të vetëm, as përnnga koha e hartimit, as përnnga përmasat. I bashkon preokupimi me çështje të historisë së hershme të gjuhës shqipe, të prejardhjes së saj, të para në raportet me gjuhët e Ballkanit, të lashta apo të sotme. Synimi im nuk ka qenë të bëja një vepër sintetizuese në këtë fushë, po më parë të përmblihdhja diskutimet në dy boshtet themelore: për vendin e shqipes në kuadër të gjuhëve indoeuropiane të parë në raport me gjuhët e Ballkanit të lashtë, dhe të raporteve të historisë së saj me disa prej gjuhëve të Ballkanit që fliten edhe sot (rumanishtja, gjuhët sllave).

Për tematikat e përfshira në këtë vëllim kam pasur mundësinë të kumtoja në konferenca të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, por në forma më të reduktuara. Studimi Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit, që mund të shërbejë si një parathënie e vërtetë e këtij libri, është rimarrë nga botimi i materialeve të Konferencës me të njëjtin titull të mbajtur në Prishtinë më 2011, ashtu si studimi Rreth sllavizmave të shipes, që u lexua në Konferencën shkencore të organizuar nga Qendra e Studimeve albanologjike e Mynihut, në Pogradec më 2014. Studimi Ballkanistika dhe prejardhja e shqipes është botuar te Studime më 1996, ndërsa të tjerat janë versione të reja dhe të zgjeruara të diskutimeve të zhvilluara në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare apo me raste të tjera.

Tematizimi i raporteve të shqipes me gjuhët e Ballkanit në albanistikë nuk është i ri as i panjohur. Qysh në sh. XIX ishin hetuar aspekte të ndryshme që e lidhin këtë gjuhë me gjuhët e tjera të Ballkanit. Studimet historike e krahasimtare sa vinin e shtoheshin, sillnin gjithnjë elemente shtesë për të diskutuar pikërisht në saje të implikimit të këtyre aspekteve. Në fakt, e tërë historia e gjuhës shqipe shfaqet gjithnjë e ndërlidhur me gjuhët e tjera të Ballkanit, të reja apo të lashta, të gjalla apo të zhdukura. Për një pjesë ato studime kanë ndodhur në vazhden e ballkanistikës tashmë të përvijuar si disiplinë në areale, tipologjike, disiplinë që në themelet e saj ka konceptin e unionit (të lidhjes gjuhësore, të Sprachbundit) me të gjitha nuancimet, në një anë, dhe të trashëgimisë gjuhësore ballkanike nga shtresat gjuhësore që janë folur dikur në këtë hapësirë, e për të cilat ndonjë dëshmi e kemi nga autorët e lashtë, ndërsa shqipja është vetë vazhdim i një gjuhe të tillë të lashtë nëpër të gjitha transformimet e mundshme të kontaktit me gjuhët e tjera. Aspekti krahasimtar indo-europian ka qenë gjithashtu vazhdimisht i pranishëm. Qysh herët kisha vërejtur se as mund të bëhej histori e pastër e gjuhës shqipe pa u ngatërruar në një mënyrë a në një tjetër me gjuhët e tjera të Ballkanit, as mund të bëhej ballkanistikë e mirëfilltë pa mësimet thelbësore të shqipes, të gjendjes së sotme dhe të historisë së saj.

Në vitet e vona '80 të sh. XX rrethanat ndikuan që të shtrija interesimet në fushën e sociolinguistikës të ndërlidhur me gjendjen e përdorimeve të shqipes. Kjo më duket se ndihmoi edhe në studimet e tjera historike-gjuhësore që vazhdova në punën universitare pas Luftë në Prishtinë. Në vitet '80-'90 të sh. XX jo një herë kisha qenë dëshmitar i situatave në të cilat studimi lidhur me vendin ku do të jetë folur shqipja në faza më të hershme, apo çështje të ngjashme, sidomos lidhur me prejardhjen e shqipes, ishte kontekstualizuar në shqyrtimet e natyrës përtëjgjuhësore dhe politike.

Ndërkohë, çështjet e tilla (vendi ku do të jetë folur shqipja në lashtësi, raportet e saj me gjuhët e panjohura ose krejt pak të njohura të lash-

tësisë) vazhdojnë të jenë objekt diskutimesh dhe në qarqe shumë serioze të gjuhësisë me kërkimin e përgjigjeve sa më të afërta përmes konceptimeve shkencorisht sa më të pranueshme. Në kulturën tonë tashmë ka në qarkullim vepra bazë me të dhënat e nevojshme për të krijuar një pasqyrë për mendimin themelor në këto fusha. Problematizimet kishin bërë që të kërkohesh të shfaqeshin mendimet për to dhe në kuadër të Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare dhe kjo që shkasi i drejtpërdrejtë për hartimin e një pjese të teksteve të përmbledhura këtu, natyrisht, gjithnjë të rishikuara dhe të zgjeruara dukshëm. Në këtë frymë jam përpjekur të shihja se ç'mendojnë të tjerët, pa iluzionin se do të gjeja të vërtetën përfundimtare (kush e ka?) dhe ato diskutime jam përpjekur t'i paraqisja sa më gjerësisht në tekstet që vijojnë. Raportimet e punës së të tjerëve dhe të diskutimeve komplekse lidhur me çështje të tilla, sidomos nga ato që janë më pak në qarkullim te ne, edhe pse jo shterruese, më janë dukur të nevojshme, qoftë dhe për të treguar se çështjet e tilla kanë preokupuar dhe vazhdojnë të nxisin studiuesit gjithandej, ndërkohë që një pjesë e mirë e atyre që qarkullojnë në literaturën e gjuhësisë historiko-krahasuese nuk janë bërë shumë të njohura te ne. Një pjesë tjetër e studimeve, ato për raportet e shqipes me rumanishten, edhe pse kanë qenë në fokus të interesimeve të mia qysh në vitet '80, ashtu si ato për raportet me gjuhët sllave pak më vonë, në versionet e këtushme janë të një kohe krejt të re.

Pavarësisht se libri është përmbledhje studimesh të veçanta, të bëra dhe të botuara ose jo në rrethana të ndryshme, bibliografinë e përgjithshme parapëlqeva ta jepja në mënyrë kumulative në fund për shkak se indikacionet konkrete janë dhënë brenda teksteve dhe për të evituar përsëritjet.

Duhet të them me këtë rast se në këtë punë studiuesi në Kosovë ndesh vështirësi që nuk ndeshen në mjedise të tjera. Mungesa e fondeve bibliotekare dhe e infrastrukturës për studime të tilla, po edhe pashitja e interesit për të tilla çështje, ta vështirësojnë punën në çdo hap. Prandaj e ndjej të nevojshme të falënderoj të gjithë ata

që më përkrahën dhe që qenë të gatshëm të dëgjonin apo të bisedonin me mua për këto çështje, ata që më lehtësuan punën duke më ndihmur për të siguruar materialet e nevojshme. Ndhimë jo të vogël në këtë drejtim kam pasur në qëndrimet e shkurta në Akademinë Sllovene (Instituti i Gjuhës Sllovene) në Lubjanë, në Institutin e Gjuhësisë të Universitetit të Vjenës, në Universitetin e Kalabrisë në Rende, në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë, në Akademinë Bullgare në Sofje, etj. Matrerialet që kam marrë në ato qëndrime më kanë shërbyer jo vetëm për punimet që botohen këtu, po edhe për punë të mëtejme. Të gjithëve u shpreh falënderimet më të përzemërta. Dua të falënderoj po ashtu miqtë dhe kolegët këtu në Prishtinë, sidomos të ndjerin akademik Besim Bokshi, me të cilin kemi diskutuar për këtë çështje vazhdimisht, pastaj profesor Bardh Rugovën dhe akademik Eqrem Bashën, të cilët e lexuan dorëshkrimin në tërësi dhe bënë vërejtjet e tyre. Natyrisht, të gjitha mungesat e gabimet janë vetëm të miat. Në fund dua të falënderoj dhe time shoqe Hakiden dhe familjen që gjatë gjithë kësaj kohe patën durimin dhe më mbështetën.

Prishtinë, tetor 2015

Autori

SHQIPJA DHE GJUHËT E BALLKANIT

“Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit” për shumë arsye është një tematikë me rëndësi. Së pari, shqipja si degë më vete e grupit indoeuropian krahasohet me gjuhët e tjera të tij për qëllime rindërtimi të fazave më të hershme dhe të raporteve midis tyre. Këto interesime shtyhen në kohë qysh në shekullin XIX. Këtu në Ballkan shqipja shpesh është krahasuar me greqishten, me gjuhët e tjera të Ballkanit të lashtë, me sllavishten e përbashkët.

Studimet për shqipen si degë më vete të grupit të gjuhëve indoeuropiane, natyrisht pas ngjitjes në kohë më të hershme të saj vetëm tërthorazi përmes kontakteve pjesërisht të dokumentuara, kanë interesa krahasimi me gjuhët IE të pranishme në Ballkan, konkretisht me greqishten, me latinishten dhe romanitetin ballkanik dhe me kompleksin e gjuhëve sllave. Krahasimet e tilla më së shpeshti janë të natyrës gjenetike dhe ndërlidhen me sfondin më të gjerë IE (indoeuropiane). Në këtë sfond hyjnë dhe krahasimet me gjuhët e lashta joklasike të Ballkanit – kompleksi ilir përfshirë mesapishten, kompleksi trako-dako-mez, frigjishtja, makedonishtja, etj. Gjithsesi afritë gjenetike të shqipes me gjuhët e tjera IE janë më të largëta në kohë, prandaj shpesh më vështirë të identifikueshme për shkak të shkrimit të saj të vonë. Dokumentimi më i hershëm i gjuhëve të tjera IE potencialisht të afra me shqipen, si gjuhët sllave, greqishtja, latinishtja, armenishtja, gjuhët gjermanike, gjuhët keltike dhe krahasimi me gjuhët baltike, të dëshmuara po ashtu vonë, por mbase me afri me shqipen në një fazë shumë të hershme, kanë bërë të mundur emetimin e një numri hipotezash për lidhjet e saj të lashta me ato gjuhë dhe për vendin e saj në kuadër të gjuhëve IE. Në atë kontekst janë diskutuar edhe çështje të raporteve të saj me gjuhët joklasike të Ballkanit të lashtë, doku-

mentimi i të cilave është krejtësisht i pamjaftueshëm. Sado që mbi bazë evidencash të reduktuara, diskutimet lidhur me këto aspekte të krahasimit kanë qenë pasionante. Kanë mbisunduar çështje leksikore, gjithsesi jo gjithnjë shumë diskriminuese për aspektet gjenetike të studimit. Hipotezat e emetuara për lidhjet e supozuara të shqipes me ndonjërin prej atyre gjuhëve shpesh janë mbështetur në argumentime të natyrës historiko-kulturore, gjeografike, sepse cilësia, sasia dhe autenticiteti i elementeve të krahasueshme lënë për të dëshiruar. Ilirishtja dokumentohet: me pak glosa, me më shumë material onomastik (emra njerëzish, emra vendesh, fisesh e popujsh) në Ballkan; mesapishtja me pak mbishkrime të fragmentuara dhe ende jo krejt të interpretuara në Itali të Jugut, për të cilën mendohet të ketë qenë e afërt me ilirishten (Katičić, Çabej, Cimochowski, Hamp, Matzinger, Rădulescu). Trakishtja, për të cilën ka pasur shumë shqyrtime në këtë gjysmë shekulli, është dokumentuar po ashtu me pak glosa, më shumë materiale onomastike (emra njerëzish, vendesh, perëndish, fisesh e popujsh), emra bimësh dhe, çka është shumë e rëndësishme, me disa mbishkrime vërtet jo shumë të gjata, por që ende presin interpretimin e pranueshëm. Studimet trakologjike kanë përjetuar një gjallëri të shënueshme në Bullgari dhe Rumani (Dechev, Georgiev, Duridanov, Poghirc, Vraciu, Brixhe-Panayotou, Neroznak). Dakishtja, dako-mezishtja, getishtja, dako-geto-mezishtja me emërtime të ndryshme dhe të ndryshueshme ka qenë objekt diskutimesh të shumta pas publikimit të idesë së Georgiev-it për konceptimin e saj si gjuhë më vete; diskutimet janë shtuar shumë në Rumani. Frigjishtja është dokumentuar dhe interpretuar më mirë për fazën e saj anatolike. Ka pasur diskutime jo të pakta për makedonishten, e cila tash njihet edhe nga ndonjë mbishkrim dhe më shpesh shihet më afër me greqishten (Katičić, Kalleris), ndërsa nuk ka mbetur pa u diskutuar edhe për dardanishten (nga hapësira dardane njohim materiale onomastike, emra njerëzish), për peonishten. Diskutime të vazhdueshme ka pasur dhe vazhdon të ketë edhe për gjuhën që Georgiev-i e disa të tjerë e quajnë parahelenishte, ndërsa V. Vindekens-i pellazgishte, për të cilën dimë po ashtu shumë pak.

Do thënë qysh në fillim se kjo gjendje dhe këto raporte kanë implikuar një lloj tjetër krahasimi për shqipen dhe tërë këtë 'monadë' ballkanike, atë që njihet si studim areal i gjuhëve me tërë nënkuptimet e kontakteve, të huazimeve e të ndërndikimeve, të lidhjeve e shprahbundeve (gjermanisht Sprachbund = union, lidhje gjuhësore) gjuhësore, të situatave sociolinguistike të kryqëzimit, e të proceseve të ndryshme të identifikuar nga studimet areale e sociolinguistike të kohës sonë, por për periudha e faza më të hershme. Jo një herë është folur për mundësinë e vështrimeve të pozitës së parashqipes në suaza areale në periudha të lashtësisë, qoftë në Ballkan me gjuhët që u përmendën, qoftë dhe në faza më të hershme si ajo që ka supozuar komparatisti Eric P. Hamp me *North-West-European-Indo-European* në një përbashkësi me grupet e paragjuhëve balto-sllave, gjermanike, tokare e keltike (Hamp).

Vështrimet e shqipes në suaza të teorive për prejardhjen e saj nga ilirishtja apo nga kompleksi lashtoballkanik ndonjëherë i quajtur iliro-trak, janë shoqëruar me shqyrtime serioze të raporteve të kontaktit të shqipes së hershme me gjuhët klasike – greqisht e latinisht dhe me më të vonat pastaj – sllave, romane e turke (Thumb, Ölberg, Çabej, Mihăescu, Jokl, Svane, Ylli, Boretzky). Në aspektin ballkanistik, sado që për nga orientimi i studimit ballkanistik përqendrimi bie mbi vështrimet tipologjike detyrimit sinkronike, nevojat për shpjegime të ngjashmërive midis shqipes e rumanishtes, në mungesë evidencash dokumentare për faza të caktuara zhvillimesh historike, kanë kredituar hipoteza të substratit lashtoballkanik për rumanishten, ndërsa shpjegimet për sa u përket raporteve të saj me shqipen më tej kanë prodhuar hipoteza për lidhjet e afrisë së para-shqipes me atë substrat të supozuar (Poghirc, Vraciu, Russu, Hamp). Kështu janë forcuar argumentet për filiacionin e shqipes me kompleksin trako-dakas, paqëndrueshmërinë e të cilit Hamp-i provonte ta tejkalonte përmes hipotezës për fashën e gjerë të gjuhëve proto-albanoide, ku do të përfshihej edhe substrati i supozuar i rumanishtes. Në fakt, Hamp-i mendonte se shqipja nuk do të ketë lidhje bijërie me trakishten (shih raportet *zjarm/ghermi, Biso/ besë*, etj.), por në suazat e fashës së dialekteve IE protoalbanoide, prej së cilës ka mbijetuar shqipja dhe një pjesë e elementeve të

përbashkëta të saj me rumanishten, ai e shihte dhe dakishten (dako-me-zishten) të ndryshme nga trakishtja. Sipas tij, leksiku i përbashkët i shqipes dhe rumanishtes do parë jo si *Lehnwörter*, po si *Restwörter*. Në këtë sfond fjalët e jetës baritore si *shtrungë*, *vatër* apo *urdhë*, që dëshmohen në një areal të gjerë deri në Karpate, duhet të jenë më të vjetra, ndërsa fjalë si *moş* mund të jenë huazime nga shqipja ose e kundërta më vonë gjatë mesjetes. Dhe ndër argumentimet këtu përfshihet edhe mundësia e interpretimit të një emri si *Drobeta* si një sintagmë nominale me emrin *dru*, të huazuar në rumanishten jugore shumë si *druți*, pra **dru-të*, me nyjën shquese të prapavendosur qysh në periudhën para Krishtit, çka vështirë se mund të përfillet nga perspektiva e rindërtimeve të brendshme historike të shqipes. Në këtë vazhdë shqyrtimeve do të çonte edhe ridiskutimi nga ana e S. Schumacher-it për idenë e mbrojtur qysh nga H. Pedersen-i të lashtësisë së prapavendosjes së nyjës shquese në saje të rindërimit të formantit të kallëzores *-në* nga IE **om-tom*. Pavarësisht nga vështirësitë kronologjike, diskutimet e tilla me prapavijë historike-gjenetike implikojnë ndriçime në raportet midis shqipes e rumanishtes në fushën e nyjave dhe në fushat e tjera të përbashkësive specifike midis tyre, që më vonë do të shihen si thjesht ballkanistike. S. Schumacher-i bënte dhe hapin tjetër, për mendimin tim shumë të drejtë, të kërkimit dhe të gjetjes së rrugëve për të dëshmuar prejardhjen nga shqipja të një pjese të leksikut të përbashkët midis dy gjuhëve. Dhe kjo rrugë është rindërtimi fonetik. Natyrisht, ai e shihte si ideologemë qëndrimin e A. Graur-it të mbështetur nga shumë të tjerë për pamundësinë e ndikimit të shqipes në para-rumanishten a rumanishten edhe për shkak të faktit se ajo nuk paska gëzuar ndonjëherë prestigj që do të imponuaka huazimin. Këtu ai sillte në kujtesë faktin se, ta zëmë, megjithë dallimet në çështje statusi midis anglishtes e gjuhëve të aborixhinëve australianë, në anglishten janë shënuar ndikime të atyre gjuhëve. Por, sipas tij, huazimi mund të ndodhte edhe në rast se vendësit do të nxinin romanishten. Nga të gjitha diskutimet mbetet përfundimi se në shqipen krijimi i nyjës shquese dhe prapavendosja e saj do të jenë gjithsesi më të hershme se në rumanishten, përgjithësisht se te krijimi i nyjës kemi të bëjmë me një proces më të afërt me të greqishtes, prandaj

edhe me një mundësi të pranueshme të ndikimit të shqipes së hershme mbi rumanishten në një kohë të përshtatshme për induktime zhvillimesh në bazë ndikimi. E tërë kjo vjen e pajtohet tani me diskutimet e Rizës për afritë me greqishten e të Bokshit për ndikimin e sistemit nyjor të shqipes në proceset e prapavendosjes në rumanishten.

Pa e zgjatur me ekzgjeteza të tilla lashtoballkanike, dua të theksoj faktin se kur shtrohet çështja e shqipes në kuadër të studimeve ballkanistike gjithsesi tipologjikisht të orientuara, pra me vështrime sinkronike, duhet të krijohet një hapësirë e domosdoshme për vështrime diakronike, brenda së cilës ndriçohen procese që kanë lënë pasojë në Sprachbundin e diskutuar kaq shumë sot. Të tilla hapësira kombinimi midis vështrimeve metodikisht të ndryshme, sinkronike – diakronike, ka provuar të shohë dhe I. Hajnal. Diskutimi i tij, si përpjekje teorike për pajtimin e dy vështrimeve të ndryshme dhe për kapërcimin e hendekut midis disiplinës gjenetike dhe disiplinës areale-tipologjike ka rezultuar dhe me një hipotezë me interes për situatën gjuhësore ballkanike në lashtësi të vështruar si të Sprachbundit midis grupimeve IE greke, frigase, armene, por edhe made-done, trakase, ilire apo të kompleksit të ‘gjuhëve adriatike’, si mesapishtja e venetishtja. Diskutimet e tij për izoglosat lashtoballkanike IE në fushën e laringaleve, të varieteteve **-si/*-su* të lokativit që vazhdon të *-sh* e rrjedhore së shqipes, po të kombinohen edhe me të dhënat leksikostatistike që para-shqipen e vendosin më në perëndim të asaj ‘monade’ lashtoballkanike, mbase mund të kenë vlerë edhe për argumentimet e vendit të hershëm të shqipes në Ballkan dhe për filiacionin e saj. Kështu, kërkimet drejt transgresionit metodik të ballkanistikës tipologjike drejt gjuhësisë gjenetike IE vijnë e bëhen me fuqi ndriçuese për faza më të hershme të njërit prej strumbullarëve më të lashtë të unionit gjithsesi më të vonë.

Siç e pat thënë E. P. Hamp-i (1977:27),

“metoda krahasuese dhe gjuhësia areale janë disiplina historike – faqe binjake të gjuhësisë diakronike”,

të dyja janë të domosdoshme nëse duam të japim përgjigje për çfarë mund të ketë ndodhur, gjë që shtrohet vazhdimisht nga gjuhësia his-

torike. Nëse synimi ynë është shpjegimi se çfarë ka ndodhur, pavarësisht se si do të arrijmë ta shpjegojmë, me mjete të gjuhësisë gjenetike, të përhapjes apo me kombinimin e tyre (Campbell). Nga ana tjetër, tashmë është e qartë se rrethana si ato që na kanë bërë që për kohë më të vona të flasim për Sprachbund kanë qenë dhe janë të mundshme edhe në kohë e hapësira të tjera.

Kështu fare natyrshëm po vijmë te mundësia dhe nevoja e krahasimit të natyrës gjeografike me synim që të vendoset shqipja brenda kontekstit të fqinjve të saj. Shqipja bashkë me greqishten flitet më së gjati në Ballkan dhe si e tillë ajo në mënyra të ndryshme ka qenë pjesë e zhvillimeve në tërë këtë kohë, duke u bërë njëherësh një nga miset dendësisht të pranishme në atë që N. S. Trubeckoi e pati quajtur *Balkan Sprachbund*. Studimet e këtij lloji të saj mund të ndihmojnë për të ndriçuar raportet brenda arealit gjuhësor ballkanik dhe zhvillimet e ngjashmërive të shumta strukturore me bazë areale midis këtyre gjuhëve, të krijuara në saje të kontakteve të gjata dhe të drejtpërdrejta. Qysh J. Thunmann-i, pastaj J. Kopitar-i, A. Schleicher-i, F. Miklosich-i, në shekullin XIX kishin hetuar se gjuhët e Ballkanit, bashkë me to shumë manifestime të jetës së shoqërive përkatëse, shfaqnin ngjashmëri midis tyre. Kopitar-i madje i kishte parë si gjuhë me leksik të ndryshëm, por me gramatikë të njëjtë (cf. Friedman, *Studies.*, etj.). Në vijën e Thunmann-it ishte menduar se këto ngjashmëri midis shqipes në mes dhe latinitetit ballkanik nga perëndimi e sllavishtes bullgare nga lindja i detyroheshin bazës ilire, apo iliro-trakase. Schleicher-i, ndërkaq, këto zhvillime i shpjegonte në kaudër të ideologjisë për korruptimin e gjuhëve popullore në raport me klasiket burimore. Në pjesën e parë të shekullit XX doli dhe botimi i rëndësishëm i studiuesit danez K. Sandfeld me titull "*Linguistique balkanique*", studimet e G. Weigand-it, etj. Si të rëndësishme për njohjen e realiteteve të Europës Juglindore u theksuan studimet gjuhësore, por paralelisht me to edhe gjurmimet e folklorit, të etnologjisë, të kulturave dhe të çdo gjëje që mund të bënte pjesë në "*botëkuptimin ballkanik*". U teoretizua koncepti i Lidhjes gjuhësore, që theksonte arsyeshmërinë e studimit të afrive areale dhe jo vetëm gjenetike midis gjuhëve. U bënë studime konkrete dhe botime me vlerë, u ndër-

morën nisma për botime të përkohshme (Asenova, Schaller, Demiraj, Solta, Banfi), etj.

Ideja shoqërohej me supozimin se ngjashmëritë midis gjuhëve, po edhe të kulturave ballkanike i detyroheshin trashëgimisë nga lashtësia dhe jetës së përbashkët në rrethana të ngjashme dhe në fqinjësi shekullore të gjuhëve dhe të popujve të Ballkanit. U theksua sidomos çështja e substratit lashtoballkanik (trako-ilir), ndërsa më vonë u vunë në pah aportet me peshë në këto hapësira të trashëgimisë romane dhe bizantine. Roli ndriçues i të dhënave të saktësuara të shqipes në këtë lloj tematizimesh ka qenë gjithnjë i dorës së parë.

Në pjesën e dytë të sh. XX këto studime morën hov të ri. Paralelisht me zhvillimet teorike në fushën e kontakteve të gjuhëve, u thellua dimension i zhvillimeve të ngjashme në gjuhët e kësaj hapësire për pasojë të jetës së përbashkët dhe të kontakteve midis gjuhëve. U diskutuan aspekte themelore të ngjashmërive midis këtyre gjuhëve, që përbëjnë veçanti në raport me hapësirat e tjera, u përdegëzuan diskutimet për implikimet teorike të gjetjeve eventuale të këtyre studimeve dhe u intensifikuan hulumtimet në terren. Kështu ballkanologjia në kuptimin e gjerë dhe ballkanistika në një kuptim më të ngushtë të fjalës vijuan debatin e tyre multidisiplinor. Diskutimet u zhvilluan deri në shkallën që të flitej edhe për një koncept ballkanik mbi botën. Në konceptin e Sprachbundit, pra, të unionit gjuhësor ballkanik, u bë një dallim i qartë midis gjuhëve ballkanike me tipare të këtij Sprachbundi dhe gjuhëve të Ballkanit me tërë kontradiktën, për kapërcimin e së cilës implikohen shpesh argumentime jashtëgjuhësore: në krahasimet me konvergjenca masive strukturore përfshihen shqipja, bullgarishtja, maqedonishtja, torllakishtja, disa segmente dialektore të hapësirës së Malit të Zi e të Serbisë jugore, i tërë romaniteti ballkanik pa dalmatishten e judezmon, ndërsa brenda Ballkanit janë dhe këto të fundit, tërë kompleksi tjetër serbisht, kroatisht, bosnisht, malazesisht, turqishtja, romishtja, hungarishtja, çerkezishtja, gjermanishtja. Jashtë Ballkanit mbeten rumanishtja veridanubiane dhe disa gjuhë sllave. Ngushtësisht ballkanike në të dy kuptimet mbesin shqipja, greqishtja, maqedo-

nishtja, bullgarishtja, arumanishtja, meglenorumanishtja, rumanishtja jugdanubiane, torllakishtja, turqishtja europiane (shih Friedman në *Elsevir*; Friedman 2004; Asenova 2002).

Në këto lloje studimesh areale çështjet e kontakteve të shqipes me gjuhë të veçanta të Ballkanit nuk mund të mos e kenë peshën e tyre edhe për ndriçimin e konvergencave më të gjera.

Në të gjitha vështrimet e deritashme ballkanistike/ ballkanologjike është vënë në pah shumë qartë se gjuha shqipe dhe *“bota shqiptare”* përbëjnë një nga segmentet më të rëndësishme të këtyre studimeve. Duajeni i studimeve krahasimtare, por edhe ballkanike, Eric. P. Hamp, në një intervistë për gazetën *“Rilindja”* të Prishtinës më 1978 pati thënë: *“gjuha shqipe është thelbi i studimeve ballkanistike”*. Studiues të mëhershëm, themeles të ballkanistikës, si G. Weigand, e vendosnin shqipen po ashtu në zemër të ballkanistikës. Dhe vërtet, vetëm një vështrim sipërfaqësor i gjendjes në dy shekujt e fundit do të tregonte qartë se shqipja, të folme të ndryshme të saj, ndodhen në kontakte intensive me gjuhë e dialekte të ndryshme ballkanike – sllave jugore ijekave, ekave, torllake, maqedonase, greke brenda arealit kryesor të shqipes dhe brenda hapësirës greke, arumune në situata të ndryshme – shqip-arumanisht, por dhe shqip-arumanisht-maqedonisht/ greqisht, turke, rome, etj. Studimet si ai i Juoko Lindstedt e kanë treguar shqipen praktikisht pjesëmarrëse në një mënyrë a në një tjetër në të gjitha tiparet karakteristike për Sprachbundin ballkanik: nyja e prapavendosur, dyfishimi i objektit, përdorimi i parafjalëve në vend të rasave, shkrirja dativ/ gjenitiv, shkrirja qëllim/ lokacion, relativum generale, pastaj folje ndihmëse + folje e mbaruar, futuri volo, futuri i shkuar si kush-tore, perfekti habere, evidencialët, krahasimi analitik, etj. Sipas këtyre tipareve, indeksimi i gjuhëve të Ballkanit jepte këtë pasqyrë: printe sllavishtja ballkanike me indeksin 11.5 (brenda saj maqedonishtja me 12.0), shqipja me 10.5, rumanishtja e Ballkanit dhe greqishtja me 9.5, romishtja me 7.5, çka vetëm pjesërisht pajtohet me përndarjet më fine që në qendër shohin shqipen, bullgarishten-maqedonishten, arumanishten, torllakishten, ndërsa në një radhë të dytë greqishten, rumanishten e të tjerat.

Por shqipja ka një pozitë të veçantë ndaj ballkanizmave, qoftë të konceptuar si të trashëguar, apo si *contact induced*. Nëse marrim strukturën fonetike, shqipja në gjendjen aktuale, ndryshe nga gjuhët ballkanike, ka zanore hundore në njërin prej kryedialekteve të saj, ka gjatësi zanoresh me vlerë funksionale po në atë dialekt (këtë e ka pasur më herët në tërësi), e ka në përdorim paskajoren, pos futurit me *do* ka edhe futur me *kam*, e ka të zhvilluar sistemin e habitores. Ka gjithandej ndërlidhje areale me gjuhët e tjera ballkanike, por edhe diferencime brenda saj, një situatë vërtet dinamike të përfshirjes në/ apo të daljes nga Sprachbundi gjithë duke qenë në qendrën e tij gjeografike.

Në tërë këtë gamë interesimesh, disiplina e ballkanistikës, për arsyt e përmendura metodike dhe për arsye të pamjaftueshmërisë së shpjegimit të fenomeneve, ka lëvizur kohët e vona ndjeshëm në konceptimet e saj, qoftë drejt kontestimeve rezolute, si mohimi i mundësisë së ekzistencës së një disipline të veçantë gjuhësore mbi këto baza qysh nga fillimi i sh. 20, qoftë si rezultat i kontestimit të një Sprachbundi për shkak të shtrirjes më tej drejt hapësirave eurolinguistike, apo edhe për shkak të vështrimeve të reja në fushën e kontakteve të gjuhëve në rrafshin e gjuhëve gojore, me ç'rast përvoja e studimeve të kreolëve dhe të kontakteve të gjuhëve në tërësi kanë sjellë ndriçime të reja.

Në pjesën e dytë të shekullit XX u themeluan revista të ndryshme për studimet ballkanike, gjuhësore, kulturore, historike, etnologjike si *Zeitschrift für Balkanologie*, *Linguistique balkanique*, *Süd-ost Forschungen*, *Revue des études sud-est-européennes*, etj., u zhvilluan qendra hulumtimi dhe bërthama studimi në vende të ndryshme, si p. sh. në München, në Berlin, në Vjenë, në Napoli, në Amsterdam, në Chicago, në Varshavë, në Poznanj, në Sankt Peterburg, në Bukuresht, në Sofje, në Beograd, në Selanik, etj. U themelua Asociacioni i Studimeve të Europës Juglindore, që u bë bartës i organizimit të kongreseve ndërkombëtare përkrye 4 vjetësh duke filluar nga viti 1966, u ndërmorën projekte të ndryshme gjithandej.

Studimet ballkanistike ndër ne janë zhvilluar në kuadër dhe paralelisht me studimet historike për shqipen, ku shpesh më të rëndësishëm ka-

në qenë aspektet e rindërtimit të brendshëm dhe krahasues-historik, por qysh herët janë hetuar dhe aspekte areale dhe të mirëfillta ballkanike. Qysh nga A. Xhuvani, e sidomos te E. Çabej, M. Domi, I. Ajeti, S. Floqi, Sh. Demiraj, B. Bokshi, në brezat që tashmë kanë krijuar një rrumbullakim të dijes së tyre, studiuesit tanë kanë problematizuar aspekte me rëndësi ballkanistike në vështrimet e çështjeve albanistike, shpesh edhe për vetë pozitën e shqipes në atë kuadër. Studimet për nyjat, për futurin, për zanoren ë apo për paskajoren, për dyfishimin e objektit apo për raportet gjinore/ dhanore të shqipes i kanë vendosur ata automatikisht në qendër të interesimeve ballkanistike.

Qysh herët Eqrem Çabej kishte shprehur një opinion mjaft relativ lidhur me tiparet e përbashkëta ballkanike. Sipas tij, ekzistojnë zhvillime të përbashkëta të natyrës fonetike, por shqyrtimi i tyre mund të shihet më parë midis dy-tri gjuhëve, si për shembull, midis shqipes e rumanishtes apo midis rumanishtes, greqishtes moderne dhe shqipes.

Dhe tiparet e përbashkëta ballkanike për Çabejnë ishin: prapavendosja e nyjës, zhdukja e infinitivit, e ardhmja e tipit me *do*, jo me *kam*, parataksa dhe frazeologjia e përbashkët. Në këtë të fundit ai ngulte këmbë posaçërisht. Sh. Demiraj e kishte zgjeruar inventarin e ballkanizmave, kryesisht në suaza të ballkanistikës tradicionale duke përfshirë zanoren ë, prapavendosjen e nyjës, formimin e së ardhmes me *do*, dyfishimin e kundrines përmes trajtës së shkurtë të përemrit vetor, eliminimin e pjesërishtëm të paskajores, ndërsa B. Beci këtë inventar e zgjeronte më tej në suaza të elementeve paradigmatiche duke përfshirë ë-në e theksuar, 6 seritë e bashkëtingëlloreve, çiftin fishkëlluese/ shushuritëse të bashkëtingëlloreve, kundërvënien qiellzore/ velare, prapavendosjen e nyjës, të ardhmen me *do*, zëvendësimin e paskajores, raportet gjinore/ dhanore, dyfishimin e objektit, përemrat e theksuar/ të patheksuar, numërimin 11-19 dhe krahasimin analitik. Është e qartë që këto konceptime të zgjeruara apo të ngushtuara janë në ndërlidhje dhe me konceptime të tjera për shqipen, historike e krahasimtare, në një anë, dialektore/ areale, në anën tjetër (Beci, B. Demiraj). Kështu studimet ballkanistike shqiptare po hyjnë

tani më pa nxitim drejt problematizimeve më të gjera të kohës sonë, modeleve shpjeguese sociolinguistike, të kontaktit të gjuhëve, të pragmatikës, etj.

Po ta shohim më hollë shqipen në raport me gjuhët ballkanike dhe të Sprachbundit mund të nxjerrim vija me interes për historinë e zhvillimit të saj: disa ballkanizma nuk shtrihen në tërë shqipen, në disa aspekte ajo manifeston ndryshime në raport me gjuhët e Ballkanit, ndonjëherë zona të saj të veçanta përfshihen në areale të ndryshme, pikërisht ashtu siç kishte sugjeruar Hamp me idenë e tij për Ballkanin si *“udhëkryq të Sprachbundeve”*, të nuancuar më tej nga I. Sawicka me hapësirat mesdhetare, qendrore ballkanike dhe lindore ballkanike.

Në një studim të tij të viteve të vona ‘70 të shekullit të kaluar, studiuesi i shqipes dhe njohësi i shquar edhe i rrjedhave në studimet ballkanike, i njohur për të gjithë ne, por sikur nga pak i lënë në harresë, Mahir Domi, gjithë duke theksuar se gjuha shqipe cilësohej si me karakter eminentisht ballkanik (nyja e prapavendosur, zhdukja e infinitivit, futuri me do), vërente se shpesh nëpër vepra e studime të kësaj fushe shqipja nuk paraqitej drejt, gjykohej edhe mbi materiale të paverifikuara deri në fund, të pjesërishtme, apo të gabuara, sidomos në raportet me dialektet e saj:

“Mjaft të dhëna të shqipes mjaft shpesh janë paraqitur në mënyrë të pamjaftueshme, të përgjithshme, ndonjëherë madje skematike, pa të gjitha të dhënat e domosdoshme. Jo gjithnjë është dhënë një vlerësim dhe interpretim i drejtë. Janë ngatërruar më shumë se një herë duke i vënë në të njëjtin rrafsh pa asnjë dallim, fenomenet e gjuhës së përbashkët dhe veçantitë e një të folmeje të izoluar apo të një gjinie folklorike”. “...Më shumë se një herë është e domosdoshme të ndreqen pohimet e pasakta apo të gabuara që, për mungesë informimi, vazhdojnë të qarkullojnë nganjëherë edhe në ditët tona, megjithë vrojtimet e bëra lidhur me to kohët e fundit”¹.

¹ Domi, Mahir: *Considérations sur les traits communs ou parallèles de l'albanais avec les*

Një përshtypje e tillë, mbase edhe negative, të krijohet edhe sot kur në botime monografike me qarkullim ndërkombëtar sheh formulime si këta më poshtë:

*“Shqipja toske flitet si gjuhë amtare nga shumica e popullatës së Shqipërisë (2,900.000 folës, sipas SIL), ashtu si në Greqi... dhe Turqi... Flitet po ashtu si gjuhë e dytë (as a second language) nga folësit nativë të shqipes gege në Shqipërinë veriore dhe në krahinën Serbe të Kosovës e Metohisë, ashtu si nga folësit nativë të greqishtes, të maqedonishtes, të serbo-kroatishes, të arumanishtes dhe të romëve që jetojnë në Shqipëri”.*²

Shfletimi i cilitdo manual elementar për gjuhën shqipe na mëson se dialekti i jugut apo toskërishtja shtrihet brenda Shqipërisë vetëm në jug të lumit Shkumbin, pra, afërsisht në gjysmën e territorit të Republikës dhe në rajonin e Prespës, të Ohrit e të Strugës në Republikën e Maqedonisë, në tërë hapësirën ku flitet në Greqi, në Itali të Jugut. Është më shumë se injorancë linguistike e kulturore të konsiderosh se shqipen standarde, që për bazë të saj e ka sistemin e variantit letrar të toskërishtes, shqiptarët e Kosovës (jo të Kosovës e Metohisë!, jo të ‘provincës serbe’!), apo të tjerë e flitkan si gjuhë të dytë, madje njësoj si folësit nativë të greqishtes, të maqedonishtes apo të serbishtes!

autres langues balkaniques et sur leur étude, në Studia albanica XII, 1, 1975, Tirana, 81-91. Këtu f. 83-84. [Biens des faits de l’albanais ont été assez souvent présentés d’une manière insuffisante, sommaire, parfois même schématique, sans toutes les données nécessaires. On n’en a pas donné toujours une juste appréciation et interprétation. On a confondu plus d’une fois en les mettant sur le même plan sans aucun discernement des phénomènes de la langue commune et des particularités d’un parler isolé ou d’un genre folklorique.], f. 83;

Plus d’une fois il est nécessaire de réctifier des affirmations inexactes ou erronées qui, faute d’information, continuent de circuler parfois même de nos jours, malgré les observations faites à leurs sujet ces derniers temps], f. 84.

² “Tosk Albanian is spoken as a mother tongue by the majorit of the population of Albania (2,900,000 speakers, according to SIL), as well as in Greece (no data abort number of speakers) and Turkey (15, 000 native speakers, according to SIL); no data on the number of speakers in Balkan Turkey, however). It is also spoken as a second language by the native speakers of Geg Albanian in North Albania and the Serbian province of Kosovo and Metohia, as well as by native speakers of Greek, macedonian, Serbo-Croatian, Arumanian and Romani living in Albania”, Olga Mišeska-Tomić, f. 704.

Më tej autorja e vëllimeve 7-8 qindfaqëshe O. Mišeska-Tomić³ nga një vend fqinj vijon me margaritarë si ky:

“Shqipja gege është në mënyrë inherente e pakuptueshme për folësit e shqipes toske”!

Dhe pak më poshtë, megjithëse referonte të kishte lexuar artikullin e A. Kovačec-it, pohonte katërçipërisht se arbënishtja (e Zarës)

“është reciprokisht e kuptueshme me toskërishten”,⁴

çka është e vërtetë, por po ashtu është e vërtetë se arbënishtja e Zarës është gegnishte e shpërngulur atje në sh. XVIII nga zonat e Krajës, sot në Mal të Zi, dhe gjithë kjo ka pasur mundësi të mësohej atje. Kjo nuk është dëgjuar ndonjëherë: shqipja, gege apo toske, nuk kuptohet në mënyrë inherente nga folësit e hungarishtes, të frëngjishtes, apo të kinezishtes, le të themi të maqedonishtes, por si mund të thuhet kjo për një shqipe nga shqipja tjetër, madje gegnishte e sotme e pakuptueshme me toskërishten e sotme, ndërsa gegnishtja e sh. XVIII e tëra e mbytur në rrethimin sllav e italian dhe e izoluar nga trangu e kuptueshme me toskërishten?!

Në paraqitjen e saj të *core vocabulary* për shqipen jepen shembuj për gegnishten e për toskërishten me forma edhe si këto: geg. *gjë* - tosk. *kafshë*, geg. *dora* - tosk. *krah*, geg. *hej* – tosk. *hi*, geg. *goditje* - tosk. *fryn* (për blow), geg. *marr frymë* - tosk. *merr frymë* (për breathe), geg. *kafshan* - tosk. *kafshon*, geg. *luin* - tosk. *kërcen* (për dance), geg. *papastër* - tosk. *ndyrë*, geg. *drejt* - tosk. *pluhur* (për dust), geg. *tlynë* - tosk. *majmë*, e kështu me radhë në vetëm në një faqe.

³ Një recension kritik për këtë libër ka bërë ballkanologu i njohur Brian Joseph në *Acta Slavica Iaponica XXIX* (2011), pp. 123-131. Në atë recension janë vënë në pah shumë vërejtje dhe sidomos për çështje më të përgjithshme, por edhe gabime. Përfundimi i B. Joseph-it: “The total effect of these errors is most unfortunate, as they diminish the book’s utility considerably and put it at a serious disadvantage against other compendium-like Works on Balkan languages, therefore, is a book with great potential for lasting value, but despite the welcome features and despite the good intent that went into the book, in the final analysis, the execution does not rise to the challenge that the topic posed”, vetëm sa mund të përshëndetet. Të shihet dhe recensionin i Sims, Andrea D. në *Journal of Slavic linguistics* 16(2), pp. 331-347.

⁴ “Arbanassian is mutually intelligible with Tosk”, f. 704.

Geg. *gjâ* i përgjigjet gjithandej tosk. *gjë*, ndërsa *kafshë* del në të dy dialektet; *dorë* dhe *krah* janë të të dy dialekteve, por me kuptimet: “hand” dhe “arm”; geg. *heij*, mbase *hei*, del vetëm në të folmet ku zan. *i* diftongohet, ndërsa geg. tjetër ka *hi/ hî*; goditje është më tepër e shqipes letrare; *fryn* është e gjuhës standarde, por edhe e geg. e tosk., ashtu siç del në geg. edhe *frÿn, froin*, tosk. e geg. *frin*, varësisht nga varieteti dialektor; shprehja *marr frymë* (ka dhe *marr frimë*) është shprehje foljore e pranishme njësoj në të gjithë shqipen me të njëjtin kuptim; forma *kafshan* mund të dëgjohet disi vetëm në të folmet e Ulqinit e të Shkodrës, ku zanorja *o* e patheksuar delabializohet, çka nuk ngjet në geg. tjetër; *luej* dhe *kërcej* (*luen, kërcen, kcen*) janë pjesërisht sinonime, por në tërë shqipen, ndërsa *luin* mund të ndeshet në ndonjë varietet krejt lokal; geg. thuhet edhe *ndy-të* për të *ndyrë*, ndërsa *papastër* është e tërë shqipes, por më parë letrare; ku e gjeti geg. *drejt* për *pluhur*, që geg. mund të jetë vetëm *pluhun*? Geg. *tlyn, tlÿn* mund t’i përgjigjet vetëm t. *tlirë, tëlier*, por *i majmë* është e të gjithë shqipes me kuptim krejt tjetër.

Me mosnjohje të këtilla të materialeve të shqipes nuk është e mundur të nxirren përfundime të mbështetura për çfarëdo krahasimi ballkanik apo tjetër. Serbezlëku me të cilin i jepte të drejtë vetes autorja me mungesa kështu elementare në njohjen e gjuhës për të gjykuar nuk arsyetohet, aq më tepër që në Republikat ku ajo mund të ketë jetuar (gjykuar sipas emrave - Mišeska në Maqedoni, Tomić në Serbi) realitetet shqipe janë të prekshme. Kjo mungesë elementare njohjesh, apo edhe anim i motivuar politikisht deri në keqdashje në një seri të botimeve Springer, me bord serioz botues ndërkombëtar, gjithsesi të revoltton edhe pas kaq vitesh. Prandaj, prania më substanciale e ballkanologëve albanistë në studimet dhe në tribunat ballkanistike, por edhe kujdesi i botuesve, ashtu si kritika profesionale, mund të ndihmonin për të evituar pasaktësi të tilla jo të sh. XVIII, as të vitit 1975, kur ankohej Domi, po të vitit 2006.⁵

Justifikime për mangësi të tilla nuk mund të ketë as për faktin se gji-

⁵ Olga Mišeska-Tomić: *Balkan Sprachbund Morpho-syntactic Features*, Studies in Natural Language & Linguistic Theory, Springer 2006, pp. 749.

thandej në qendrat e studimeve ballkanistike nëpër botë bëhen përpjekje shumë serioze për studimet e shqipes. Në hapësirat studimore shqiptare deri tani ballkanistika si disiplinë e veçantë ka zënë vetëm një vend dytësor, kryesisht në ndërlidhje me/ dhe në kuadër të studimeve albanistike. Vështrimi ballkanistik nga brenda shqipes ka nevojë të plotësohet me vështrimin edhe nga jashtë saj, nga perspektivat e përgjithshme dhe të veçanta ballkanike.

Me trashëgiminë e njohjes së një pjese të mirë të rrethanave ballkanike (duke qenë në qendër), të mundësive për studime serioze për shqipen dhe gjuhët sllave të jugut, për turqishten, për greqishten e arumanishten, hapësira shqiptare është shumë e përshtatshme për zhvillimin e këtyre studimeve në tërësinë e tyre dhe me thellësinë e nevojshme. Përfitimet nga hulumtimet e tilla mund të jenë të rëndësishme jo vetëm për shkencën ballkanologjike, po edhe për vetë shoqërinë tonë.

DISKUTIME TË VONA PËR RAPORTET E SHQIPES ME GJUHËT LASHTOBALLKANIKE DHE INDOEUROPIANE

Do të flasim këtu për disa diskutime lidhur me raportet e shqipes me gjuhët lashtoballkanike dhe indoeuropiane (IE), që interpretimin e këtyre çështjeve e shohin nga aspekti i risimeve në zhvillimet e studimeve të krahasuara IE sa i përket hapësirës së hershme ku do të jetë folur për shqipja. Nëse duam të mos mbetemi vetëm te shqyrtimet supozitive, këto çështje përdegezohen në shumë drejtime dhe të çojnë te detajet e zhvillimit fonetik, më rrallë morfologjik e morfosintaksor. Ato detaje mund të na shpinin në shqyrtime tepër të stërholluara për një rast si ky.

Në studimet albanistike këto çështje kanë qenë objekt shqyrtimesh në shumë raste. Do të përmend këtë herë ato që janë thënë te Çabej, më tej te Domi (1982), Mansaku (1982), Ismajli (1987), sidomos së fundit dhe gjerësisht Demiraj (1999, 2006), Arapi (2010) në albanistikën vendëse. Ndërkohë në gjuhën shqipe janë botuar dhe veprat ku këto çështje janë diskutuar më herët (Cimochowski,¹ Pedersen,² Miklošič,³ Jokl,⁴ Hamp⁵).

¹ Cimochowski (2004), Waclaw: *Për gjuhën shqipe*, Parathënia R. Ismajli, red. I Ajeti, B. Bokshi, R. Ismajli, ASHAK, Prishtinë, ff. 470.

² Pedersen (2003), Holger: *Studime për gjuhën shqipe*, parathënie R. Ismajli, red. I. Ajeti, B. Bokshi, R. Ismajli, ASHAK, Prishtinë, ff. 495.

³ Miklošič (2006), Franc: *Gjurmime shqiptare/ Albanesische Forschungen*, Parathënie R. Ismajli e M. Snoj, përgatitur nga R. Ismajli & M. Snoj, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës & Slovenska akademija znanosti in umetnosti, Prishtinë-Lubjanë, ff. 504.

⁴ Jokl (2011), Norbert: *Studime për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip/ Studien zur albanesischen Etymologie und Wortbildung*, Parathënia R. Ismajli, përkthimi E. Çabej, përgatitur nga R. Ismajli, ASHAK, Prishtinë, ff. 434.

⁵ Hamp (2007), Eric P.: *Studime krahasuese për shqipen*, Zgjedhja e Parath. R. Ismajli, përk. B. Rugova, Rr. Paçarizi, Sh. Munishi, G. Bërlajolli, B. Pllana, R. Ismajli, ASHAK, Prishtinë, ff. 440.

Më herët ishte botuar Barić.⁶ Këto çështje vazhdojnë të jenë objekt diskutimesh. Shohim se Çabej nuk i ka lënë pa theksuar lidhjet e parashqipes me gjuhët IE veriore ashtu si me gjuhët IE jugore dhe perëndimore,⁷ madje duke theksuar se konceptimi i tij anonte më tepër drejt interpretimit pas traditës së teorisë së valëve të J. Schmidt-it, sesa vetëm pas teorisë së drurit gjenealogjik, sepse kështu mund të përfitonte nga të dy konceptimet lidhur me specifikimin e atyre raporteve.

Sipas autoritetit të gjuhësisë së krahasuar të mesit të sh. XIX – A. Schleicher, për ta treguar tipin indoeuropian, mund të jepen shembuj koniugacioni me ortografinë e përdorur te *Testamenti* i Korfuzit 1827. Në një prej veprave të tij, Schleicher-i shënonte se shqiptarët mbahen kryesisht si pasardhës të ilirëve të lashtë, ndërsa gjuha e tyre, për bindjen e autorit, është indoeuropiane dhe këtë e dëshmojnë përemrat, numërorët, dhe mbaresat e fleksionit. Ndërkohë Schleicher kishte përdorur termin ‘*çifti i familjes pellazgjike*’, ku shihte çiftin gjuhësor greqisht-latinisht, çka domethënë se në bazë të të dy gjuhëve ka një trashëgimi gjuhësore të stërlashtë. *Pelasgisch* për të do të thoshte arkaike. Më tej shënonte se shqipja s’kishte letërsi, se shtrihej nga bregu i Patras e deri te Drini më tej drejt Bullgarisë. Te Danubi i Poshtëm e drejt jugperëndimit ka një grup gjuhësh që kufizojnë me njëra tjetrën, të cilat, me prejardhje të ndryshme, pajtohen vetëm në faktin se janë “*më të rrëgjuarat e familjes*”;


*“Këta bij plangprishës janë vllahishtja në familjen romane, bullgarishtja në sllaven dhe shqipja në familjen greke. Rrëgjimi shfaqet në gjuhën më veriore, ..., edhe më në një shkallë, më shumë tashmë në të mesmen, bullgarishten, dhe në jugoren, shqipen, ka arritur një shkallë errësimi të plotë të prejardhjes së saj. Që të trija pajtohen sidomos në faktin që e bashkojnë njëën në fund të emrave”.*⁸

⁶ Barić (1955), H.: *Hÿmje në historin e gjuhës shqipe*, përkth. H. Kaleshi&H. Thaçi, Prishtinë.

⁷ Shih Çabej, (1970), E.: *Hyrje në historinë e gjuhës me fonetikë historike*, Prishtinë. Çabej (1976), E.: *Studime gjuhësore I-VI*, Prishtinë; Demiraj (1988), Sh.: *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, ribotim 2013.

⁸ “Diese missrathenen Söhne sind das Wallachische in der romanischen, das Bulgarische in der slawischen und das Albanesische in der Griechischen Familie. Das Verderbniss zeigt sich in

Nga skica e drurit gjenealogjik të Schleicher-it shihet se ai shqipen e vendoste afër greqishtes, madje me sugjerimin që ajo të ketë qenë një me të në faza të hershme. Sipas Pedersen-it, Schleicher-i e kishte parë shqipen në detaje me material të freskët dhe kishte dalë te përfundimi se ajo është gjuhë indoeuropiane. Por Rask-u e Schleicher-i gabonin derisa i caktonin shqipes një vend afër me latinishten e greqishten. Ishte F. Bopp-i ai që më 1854 pohoi me të drejtë se shqipja nuk qëndron në raporte të ngushta afrie me asnjë gjuhë tjetër indoeuropiane, as me greqishten e latinishten.⁹



August Schleicher: *Linguistische Untersuchungen II*, Bonn, 1850 e *Compendium der Vergleichenden Grammatik*, 1861.

Tezën e Schleicher-it e pranuan Stier e Camarda. Pas Fiedler-it,¹⁰ Camarda u përpoq të dëshmonte një “*bashkëpërkim gjenetik të greqishtes e të shqipes*”. Me etimologji të gabuara, ai si fjalë të trashëguara shqipe trajtonte huazime nga greqishtja. Këtë vlerësim Fiedler-i e mbështeste në

der nördlichsten Sprache, der zuerst gennanten, noch in einem geringeren Grade, mehr schon in der mittleren, dem Bulgarischen, und hat in der südlichen, der albanesischen einen ihre Herkunft fast völlig verkundelnden Grad erreicht. Alle drei stimmen besonders darin überein, dass sie den Artikel an das Ende der Nomina anhängen”, f. 143.

⁹ H. Pedersen: *The Discovery of Language. Linguistic Science in the 19th Century*, Indiana University Press, Bloomington & London, 1931, fifth printing 1972, f. 71

¹⁰ Fiedler (2006), Wilfried: *Einführung in die Albanologie*.

faktin se Camarda nuk i njihte gjuhët orientale: p.sh. *bejtar* e lidhte me gr. e vj. *ποιητής*. Pas Fiedler-it, në shqyrtimin e Schleicher-it mbetej e pahulumtuar pikëpamja se shqipja ishte bijë e ilirishtes e shprehur më herët me argumente vetëm historike nga Leibniz, Thunmann, Malte-Brun. Hahn-i që i pari që u përpoq të sillte argumente gjuhësore, duke shpjeguar emra të lashtësisë me mjete të shqipes. Kjo nuk e pengoi që me përfytyrime të mjegulluara për ‘pellazgët’ *“ta vendoste ilirishten bashkë me pellazgjishten”* (Fiedler 2006: 18).

Fazë e re për studimet IE u shënua pas vitit 1872 me *“Die Verwandtschaftsverhältnisse der Indogermanischen Sprachen”* të J. Schmidt-it për trajtimin më kompleks dhe përmes shtresave të shumta. Fiedler-i referonte lidhur me Schmidt-in vlerësimin e historianit të gjuhësisë H. Ahrens. Sipas Ahrens-it, teoria e Schmidt-it ka rëndësi së paku për vlerësimet vijuese: 1. Paragjuhën (Ursprache) si tërësi e shihte si fikSION shkencor; 2. Format e vendosura (erschlossenen) IE (Sternchen-Wörter – fjalë yje) i shihte vetëm si rezultat përfundimtar të hulumtimit; 3. Thyente besimin në njësinë e *“paragjuhës indoeuropiane - Idg. Ursprache”* dhe në vend të saj vendoste shumëllojshmërinë dialektore. Fiedler-i mendonte se përkitazi me albanologjinë ka rëndësi qëndrimi i Schmidt-it për sllavoletonishten e gjermanishten - të parën e vendoste afër me të dytën, por të parës nuk ia mohonte afrinë me degën ariane. Ai kështu po thyente skemën rigjide të Zeuss-it, Grimm-it e të tjerëve lidhur me këto raporte (Fiedler 2006: 19-20).


Në sytë e Fiedler-it kjo kishte rëndësi për teorinë e G. Meyer-it,¹¹ që, sipas Jokl-it, përmes këtij punimi kishte bërë hapin vendimtar për t’u larguar nga mendimi deri atëherë sundues i Schleicher-it, Stir-it, Camarda-s, për përkatësinë e shqipes me greqishten e latinishten. Dobia për shkencën nga ky studim i Meyer-it është e madhe. Trajtimi i radhëve të guturaleve është vendosur drejt, mendonte Jokl-i, e me këtë dhe kriteri për ta vendosur shqipen ndër gjuhët indoeuropiane lindore (satəm). Me

¹¹ Meyer 1884, G.: *Die Stellung des Alban. im Kreise der Idg. Sprachen*, BB 8, 185-195.

këtë dhe me caktimin e reflekseve të *media aspirata* e momente të tjera Meyer-i fitoi bazën e saktë për ta ndarë shqipen nga greqishtja dhe për ta afruar më shumë me gjuhët verieuropiane (lit., gjerm. a = shqip a nga IE o).¹²

Duke u marrë me trashëgiminë junggramatikane e me krahasimet në gjuhë, A. Meillet solli interpretime të reja nga aspekti i gjeografisë gjuhësore, me mbështetje te teoria e valëve e Schmidt-it,¹³ pas së cilës gjuhët IE përndaheshin si në skicën anash. Pasi kishte miratuar ndarjen *centum/satəm* ndër gjuhët IE, Meillet kishte konstatuar se

*“dialektet lindore përbëjnë një grup të natyrshëm” të gjuhëve IE.¹⁴ “Këto tipare të ndryshme dalin gati me siguri si risime dhe dëshmojnë një bashkësi të shënueshme. Kjo nuk do të thotë se ky grup dialektor ishte një, as se këto fenomene janë përhapur përmes imitimit; fjala është për risime të realizuara në mënyrë të pavarur”.*¹⁵



Skicë e dialekteve IE sipas emrave të gjuhëve të dëshmuara historikisht e që janë vazhdim i të vjetrave, përshtatur sipas A. Meillet: *Les dialectes indo-européens*, Paris 1922, bot. 1950, f. 134.

Shqipen ai shpesh e *shih*te bashkë me gjuhët sllave, balte, armene,

¹² Jokl 139, Fiedler 20.

¹³ Për modelin vijues shih C. Renfrew, *L'énigme indoeuropéenne*, Paris, 1990, 132.

¹⁴ A. Meillet (1908): *Les dialectes indoeuropéens*, Paris, 131: *“Les dialectes orientaux constituent donc un groupe naturel”*. Për skicat shih Ismajli 1987.

¹⁵ Po aty, f. 131: *“Ces divers traits résultent presque certainement d’innovations et attestent par suite une communauté notable. Ceci ne veut pas dire que ce groupe dialectal était un, ni que ces phénomènes se sont propagés par imitation; il s’agit d’innovations réalisées d’une manière indépendante...”*

indoiraniane; shihte tipare të përbashkëta të saj me gjuhët gjermanike, të cilat e ndajnë atë nga armenishtja. Vendi i shqipes i dilte disi qendror.

Zbulimi i hetishtes e tokarishtes, të gjetura në Lindje, solli dyshime në konceptimin e ndarjes *centum/satəm* korresponduese me ndarjen *lindje/perëndim*. Më vonë ndryshime do të nxisë teoria e laringaleve, që për shqipen ishte studiuar fillimisht nga Hamp-i.¹⁶ Risime solli neolingvistika italiane me supozimet se risimet ndodhnin në qendra dhe rrezatoheshin drejt skajeve, që d.m.th. se në skaje mund të ruheshin arkaizma.

Me kohë ndodhën riinterpretime të teorive të traditës Meillet-Pedersen lidhur me grupimin e gjuhëve IE, pra edhe lidhur me shqipen dhe vendin e saj. U veçua një grup qendror me gjuhët baltike, sllave, gjermanike e greke; shqipes i lihej një vend disi më qendror. Natyrisht, këtu mungon nominalisht shqipja, por aty është kompleksi ilir e trakas. Në këtë kohë afërsisht nis të diskutohet më gjerësisht karakteri *centum* apo *satəm* i ilirishtes. H. Krahe e shihte gjuhë *centum*, ndërsa A. Mayer *satəm*.¹⁷

Vittore Pisani ishte marrë disa herë me çështjen e nyjëtimit dialektor të indoeuropianishtes dhe me përcaktimet e shtrirjes dhe të përndarjes së hapësirës gjuhësore. Qysh më 1933 ai hapësirën e stërlashtë indoeuropiane e kishte përcaktuar përmes linjës Deti i Veriut–Rajna–Danubi–Karpitet-Deti i Zi–Dnjepri–Gryka e Rigas–Deti Lindor-verior. Ai kishte dhënë dhe një raport relativ midis dialekteve IE.¹⁸

¹⁶ E. P. Hamp, *Evidence in Albanian*, in *Evidence for Laryngeals*, The Hague, 1965, 123-141.

¹⁷ Hans Krahe ka shfaqur mendime të ndryshme lidhur me ilirishten në aspekte të shumta qysh nga vepra e tij e parë *Die alten balkanillyrischen geographischen Namen*, Heidelberg, 1925, *Lexikon altillyrischer Personennamen*, Heidelberg, 1929 në studimin e tij në *Sonderbericht der Heidelberger Akademie der Wissenschaften, philologische-historische Klasse*, 3, 1950. Antun Mayer mendimet e veta i ka shprehur në *Glotta* 24, Goettingen, f. 161, por edhe në *Die Sprache der Alten Illyrier I-II*, Wien, 1957, 1959.

¹⁸ V. Pisani 1933, *Preistoria delle lingue indeuropee*, in *Atti del Reale Accademia dei Lincei. Memorie. Ser. VI, vol. IV, fasc. VI*, 545. W. Porzig 1974: 48-49. Skica e riprodhuar këtu sipas Porzig 1974, Walter: *Die Gliederung des indogermanischen Sprachgebietes*, Heidelberg, f. 49.

irish, britisht, galisht	gjermanikisht		balto-sllavisht		arianisht
	latinisht, sikulisht	ilirisht	trakofrigisht		
		oskisht, umbrisht	greqisht		
			hetitisht		

Është e njohur se për shqipen dhe vendin e saj në kuadër të gjuhëve IE deri tash janë emetuar hipoteza e gjykime që, përtej detajeve diferencuese, të shpien te konstatimi i përgjithshëm: shqipja është gjuhë indo-europiane e tipit *satəm*. Në linjën Meyer-Jokl-Çabej janë theksuar lidhjet e saj me grupin e gjuhëve IE veriore (në kuptimin e A. Meillet-së).¹⁹

Martin Huld u përpoq të sugjeronte një vendosje më specifike për shqipen në rrafshin IE. Si gjuhë *satəm* me ruajtjen e gjurmëve të tri radhëve të tektaleve, në vështrimet e tij ajo dilte gjuhë joperiferike, gjuhë e një transicioni qendror. Në këtë transicion shihej në lidhjet e saj me balto-sllavishten në veri e me greqishten-armenishten në jug. Pozita e shqipes sipas tij i përgjigjej pozitës së “qendrës së periferisë”.²⁰

Ideja e vjetër për prejardhjen e gjuhës shqipe nga ilirishtja, pas sprovave për të përcaktuar ilirishten si *centum* e trakishten si *satəm* në dekadat e para të sh. XX, ishte vënë në dyshim duke theksuar njëherësh idenë për prejardhjen nga trakishtja *satəm*. Pas H. Hirt-it, tezën për prejardhjen trakase të shqipes e çoi më tej G. Weigand-i.²¹ H. Barić-i e mbështeti atë gjithë duke i vënë në pah afritë e trakishtes me frigjishten nga ana e saj dhe më tej lidhjet e frigjishtes me armenishten.²² Në pjesën II

¹⁹ Meyer (1893), G.: *Essays und Studien zur Sprachgeschichte und Volkskunde I*, Berlin. Jokl, (1924), N.: *Albaner*, in *Reallexikon der Vorgeschichte I*, Hrsg. von Ebert. Jokl, (1929), N.: *Zur Vorgeschichte des Albanischen und der Albaner*, in *Wörter und Sachen*, Bd. XII. Për një pasqyrë shumë të mirë të historisë së këtyre mendimeve shih Demiraj 1999; Pellegrini 1998; Demiraj 1988, më herët Ismajli 1987, etj.

²⁰ Huld 1984, M.: *Basic Albanian Etymologies*, Los Angeles.

²¹ Weigand, 1927, G.: *Sind die Albaner die Nachkommen der Illyrier oder der Thraker?*, in *Balkan-Archiv 3*, Leipzig, 227-251.

²² Barić 1955, H.: *Hÿmje në historinë e gjuhës shqipe*, Prishtinë. Barić 1959, H.: *Istorijska arbanašskog jezika*, Sarajevo. Barić 1954, H.: *Lingvističke studije*, Sarajevo.

të sh. XX ka pasur rimarrje të hipotezave për prejardhjen trakase të shqipës në diskutimet e V. Georgiev-it lidhur me prejardhjen dako-meze të shqipës,²³ apo lidhur me prejardhjen e shqipës nga gjuha e besëve të K. T. Witczak²⁴ e më gjerësisht të G. Schramm.²⁵

Vështrimi sistematik kritik i E. Çabejtë dhe atyre që janë pajtuar me të ose e kanë ndjekur jo vetëm që do t'i refuzojë bazat e supozimeve të Weigand-it të rimarra nga V. Georgiev-i gjatë formulimit të hipotezës për prejardhjen dako-meze të shqipës, por njëherësh do të sillte argumentim për të treguar se mjaft emra të vendeve të lashtësisë në këto hapësira në gjendjen e sotme kanë arritur përmes shqipës, se nuk është krejtësisht e vërtetë që shqipja s'paska fare terminologji detare, se nga ato pak elemente që mund të njihen nga ilirishtja e mbishkrimet mesape ka mjaft që lidhen me shqipën, se historia nuk ka shënuar shpërngulje popullatash si ato për të cilat supozohet në bazë të ideve të Weigand-it, Barić-it, Georgiev-it (cf. Ismajli 1987). Ndërkohë, W. Cimochowski ngulte këmbë në karakterin *satam* të ilirishtes dhe në interpretimin përmes shqipës të elementeve të ruajtura nga kjo gjuhë.²⁶ Në vijat që ilirishten e shohin si paraardhëse të shqipës shkuan dhe argumentimet albanistike të Desnickaja-s,²⁷ Domit,²⁸ Ajetit,²⁹ sidomos

²³ Георгиев 1957, В.: *Тракийският език*, София; Георгиев 1977, В.: *Траките и техният език*, София. Georgiev 1960, VI.: *Albanisch, Dakisch-Mysisch und Rumänisch*, in *Balkansko ezikoznanie 2*, 1960, Sofija. V. Georgiev, *Thrace et illyrien*, in *Balkansko ezikoznanie, 6*, 1963, Sofija.

²⁴ Witczak 1994, K. T.: *Proto-Albanian and the Problem of the Ethnogenesis of the Albanian Nation*, in *Biuletin polskiego towarzystwa językoznawczego L*, ff. 21-26; Witczak 1995, K. T.: *Were the Bessans Ancestors of the Albanians? A new opinion on the ethnogenesis of the Albanian nation*. in *Thraco-Dacica XVI (1-2)*, ff. 309-312.

²⁵ Schramm 1981, G.: *Eroberer und Eingesessene*, Stuttgart; Schramm 1994, G.: *Anfänge des albanischen Christentums. Die frühe Bekehrung der Bessen und ihre langen Folgen*, Freiburg/ Br.

²⁶ Cimochowski 1958, W.: *Prejardhja e gjuhës shqipe*, in *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkenca Shqetërore 2*, Tiranë. Cimochowski 1973, W.: *Pozicioni gjuhësor i ilirishtes ballkanike në rrethin e gjuhëve indoeuropiane*, in *Studime filologjike 2*. Shih në Cimovhowski 2004, W.: *Për gjuhën shqipe*, ASHAK, Prishtinë 2004.

²⁷ Десницкая 1984, А. В.: *Сравнительное языкознание и история языков*, Ле-

Sh. Demiraj me argumentimet e tij të gjera në kohët e fundit,³⁰ deri tek disa prej pjesëmarrësve në këtë diskutim sot, por dhe te studiues me synime përmbledhëse për gjuhët e Ballkanit të lashtë si Katičić,³¹ Neroznak,³² Pellegrini,³³ deri te brezi tjetër, si Mansaku,³⁴ Ismajli,³⁵ etj.

Përtej zhvillimeve të tektaleve IE të para në kuadër të satemite-tit janë shqyrtuar sidomos lidhjet specifike me gjuhët IE veriore baltike, sllave, gjermanike. Janë theksuar afritë me baltiket e sllavet. Tash vonë në këtë pikë kanë ngulur këmbë sidomos Hamp (shih më poshtë), Desnickaja, Liukonnen³⁶, H. Mayer (shih më poshtë). B. Sergent³⁷ ka provuar të bëjë dhe një interpretim të përgjithshëm.

нинград. Shih dhe Ismajli 1987, R.: *Artikuj për gjuhën shqipe*, Prishtinë, f. 38-41.

²⁸ Domi 1974, M.: *Prapashtesa ilire dhe shqipe, përkime dhe paralelizma*, in *Studime filologjike 4*, Tiranë. Domi 1982: *Probleme të historisë së formimit të gjuhës shqipe, arritje dhe detyra*, in *Studime filologjike, 3-4*, Tiranë, anglisht te Domi 1984, M.: *Problems of the Formation of the Albanian People, their Language and Culture*, Tirana, pp. 35-64.

²⁹ Tek Ajeti 1961, I.: *Istrojski razvitak gegijskog govora Arbanasa kod Zadra*, Sarajevo, në të vërtetë kemi anim nga teoria e Barić-it, pra për prejardhjen trakase të shqipes, por më vonë në studime të ndryshme ai kishte lëvizur qartë prej afritë me mendimet e H. Barić-it drejt pikëpamjeve të mbrojtura nga E. Çabej, W. Cimochoowski, etj.

³⁰ Demiraj 1989, Sh.: *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Prishtinë. Demiraj 1999, Sh.: *Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmive të gjuhës shqipe*, Tiranë, 284 ff. Demiraj 1006, Sh.: *The Origin of the Albanians (linguistically investigated)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tirana. Demiraj 2008, Sh.: *Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët*, Akadmeia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.

³¹ Katičić 1976, R.: *Ancient Languages of the Balkans I-II*, The Hague. Katičić 1985, R.: *Sur la langue illyrienne*, in *Recherches albanologiques, 1*, Prishtinë, 23-34 (cf. Ismajli 1987).

³² Нерознак 1978, В. П.: *Палеобалканские языки*, Москва.

³³ Pellegrini 1998, G. B.: *Avviamento alla linguistica albanese*, Rende.

³⁴ Mansaku 1982, Seit: *Autoktonia e shqiptarëve në dritën e të dhënave të toponimisë së lashtë*, in *Studime filologjike 3*, Tiranë.

³⁵ Ismajli 1987, R.: *Prejardhja e gjuhës shqipe*, in *Artikuj për gjuhën shqipe*, Prishtinë, studim i lexuar në konferencën e vitit 1984, por i botuar më vonë. Ismajli 1987b, R.: *Origine de la langue albanaise*, in *Recherches albanologiques, 4*, pp. 7-22; Ismajli 1994, R.: *Prejardhja e gjuhës shqipe*, in *Kosova, 1*, ff. 9-14.

³⁶ Liukkonen, K.: *Albano-balto-slavjanskije etimologji*, in *Scando-slavica, 35*, 197-202.

³⁷ Sergent 1995, B.: *Les Indo-européens: histoire, langues, mythes*, Paris, Payot-Rivages.

Eric P. Hamp çështjen e shihte pak më komplekse. Pajtohej me interpretimin e shqipes si *satəm*, por i theksonte më shumë lidhjet e shqipes me balto-sllavishten, ashtu si Desnickaja më vonë. Hamp-i madje parapëlqente të fliste jo për lidhjen e shqipes me ilirishten apo trakishten, edhe pse dikur kishte sjellë ndihmesa për lidhjet mesapo-shqipe, po në fakt për një grup dialektesh IE *proto-albanoid*. Duke diskutuar për leksikun e shqipes që afrohet me të rumanishtes dhe të gjuhëve të *arealit karpato-ballkanik*, ai nxirrte përfundimin se grupi i fjalëve si *vatra* e (*h*)*urda* indikonte një zonë dialektore të cilën ai e quante *protoalbanoide*. Një zonë e tillë do të shtrihej në hapësirat që më vonë zënë ukrainishtja perëndimore, polonishtja jugore, sllovakishtja, pjesërisht çekishtja, rumanishtja bashkë me dialektet jugdanubiane të saj, bullgarishtja perëndimore e maqedonishtja bashkë me hapësirat e Banatit, serbishtja e shqipja. Pra kemi të bëjmë me një fashë të tërë nga Karpatet e deri në Shqipërinë Veriore. Në këto hapësira, mendonte ai, gjejmë, edhe pas tre mileniumesh, gjurmë të një vazhdimësie dikur kompakte.³⁸

Drejtimi i hulumtimeve të tij ka qenë ai i studimit të elementeve të përbashkëta të shqipes me rumanishten. Lidhur me këtë, disa studiues kanë ngulur këmbë në hetimin e leksikut baritor të përbashkët për këto dy gjuhë, duke e lidhur atë me hapësirën karpato-ballkanike. Për Hamp-in shtrohet çështja e statusit të elementeve të përbashkëta të shqipes me të rumanishtes. Një pjesë prej atyre fjalëve të përbashkëta i konsideronte jo

³⁸Hamp 1981, E. P.: *On the distribution and Origin of (h)urda*, in *Linguistique balkanique* XXIV, 3, 47-50; Hamp 1957, E. P.: *Albanian and Messapic*, *Studies presented to Joshua Whatmough*, f. 73-89; Hamp 1981b, E. P.: *Autochthonous vatra*, in *Revue roumaine de linguistique* 24, 24, f. 315; Hamp 1976, E. P.: *On the distribution and origin of Vatra*, in *Opuscula slavica et linguistica*, Klagenfurt, f. 201-210; Hamp 1978, E. P.: *Strunga*, in *Balkansko ezikoznanie* 20, f. 115-119; Hamp 1979, E. P.: *The oldest Albanian Syntagma*, in *Balkansko ezikoznanie* XXV, f.77-79; Hamp 1966, E. P.: *The position of Albanian*, in *Ancient Indo-European Dialects*, Berkeley, f. 97-122; Hamp 1980, E. P.: *Thracian, Dacian and Albanian-Romanian correspondences*, in *Actes du Ile congrès international de thracologie*, f. 575-60; Hamp 1960, E. P.: *Palatal before resonant in Albanian*, in *KZ* 76, f. 257-280; Shih shqip: Hamp 2007, E. P.: *Studime krahasuese për shqipen*, ASHAK, Prishtinë, dhe Parathënien tonë po aty, 5-14 dhe Ismajli 1996, R.: *Ballkanistika dhe prejardhja e shqipes*, in *Studime* 3, ASHAK, Prishtinë, ff. 255-274.

huazime, po fjalë mbetje (*Restwörter*). Kjo kërkon një shpjegim që do të vendoste para-shqipen dhe para-rumanishten (dakishten?) në një hapësi-rë të përbashkët. Këtu ndërthuret hipoteza për elementin karpato-ballkanik. Ana tjetër e studimit të këtyre aspekteve tek E. Hamp-i ka të bëjë me interpretimin e glosave a të emrave të vendeve/ njerëzve të lashtësisë përmes shqipes. Vija më e rëndësishme e studimeve të Hamp-it lidhur me këto çështje ka të bëjë me raportet midis dialekteve indoeuropiane në lashtësi dhe të gjuhëve para-shqipe, para-sllave, para-baltike, etj. me to.³⁹

Në studimin e gjatë “*Të kujt ishin Tokarët? Nëngrupimi gjuhësor dhe idiosinkrezia diagnostike*”,⁴⁰ E. Hamp-i shtronte çështje me rëndësi në aspektin që na intereson këtu. Përveç shumë shënimeve të tjera në raportet e shqipes me tokarishten dhe me gjuhët e tjera IE, ai këtu i trajtonte në mënyrë të veçantë raportet e shqipes me balto-sllavishten (f. 321-322), fliste për një grupim të ri të gjuhëve IE, që ai e quante NWIEE (*North-West-Indo-European European*), e të cilit i atribuonte natyrën e Sprachbund-it, e cilësonte hapur si areal, difuzional, që mund të jetë mbase 4 mijëvjeçarë i largët prej nesh, por që mund të hetohet si një substrat përmes tipareve që kanë dalë nga kontakti shoqëror me të. Tipare të tilla karakterizojnë degë gjuhësh IE si gjermanikishtja, balto-sllavishtja, shqipja, parahelenishtja (pellazgjishtja), më pak keltishtja, marginalisht italikishtja. Në kuptimin indoeuropian “*Europa veriore*” është koncept i përdorshëm, mendonte ai. Këtë territor ai e vendoste në veri të Alpeve.

Koncepti i Hamp-it për NWIEE zërthehet më tej në grupin e gjuhëve albanoidë me shtrirje deri te Shkumbini e në veri deri në Ukrainë e Banat. Prej atij grupi të madh ka mbijetuar para-shqipja në shqipen e sotme dhe elementet e substratit rumun të përbashkët me shqipen, terminologjia baritore karpato-ballkanike. Në këtë grupim të Hamp-it veçohet

³⁹ Duke lënë anash detajet e pafund, po rikujtojmë studimin e Hamp 1982-3, E. P.: *Indo-European *laugh- in the Ponto-Baltic Region*, in *Ponto-baltica 2-3*, Academia Toscana di Scienze e Lettere “*La Colombaria*”, ff. 7-8, për lidhjet ma baltiket.

⁴⁰ Hamp 1998, E. P.: *Whose were the Tocharians?*, in *The Bronze Age and Early Iron Age Peoples of Eastern Central Asia*.

një realitet gjuhësor *proto-albanoid* përbri ose duke shpërfillur atë që është quajtur *ilirishte*. Faktin se shqipja në konceptimet e tij nuk mund të dilte e lidhur me kuptim filiacioni me trakishten (*Biso* dhe zhvillimet e *guerm - zjarr*), se zhvillimet fonetike që i atribuoheshin dako-mezishtes (Georgiev), sikur bëjnë që Hamp-i ta linte të hapur shtegun për një realitet dialektor IE mbase të ndryshëm nga ai që mund të supozohet si ilir, të ndryshëm nga trakishtja, por të afërt me mesapishten. Hamp-i ngulte këmbë sërish tek afritë e shqipes me mesapishten, çka i jepte peshë grupimit mesap-ilir-pa-ra-alban, pikë në të cilën puqej me idetë e I. M. Rădulescu-t.

Tani, këmbëngulja e Hamp-it te raportet e shqipes me balto-sllavishten e thekson hipotezën për qenien e proto-shqipes diku në veri, atje ku ai e kishte identifikuar mundësinë e formimit të grupimit NWIEE si Sprachbund, kronologjikisht më i vonë se ndarjet e mëhershme IE (në atë grupim bënin pjesë balto-sllavishtja, shqipja, gjermanishtja, gjuhët keltike, tokarishtja – gjuhë *satəm* e *centum*). Në diskutimet e detajuara në vazhdim, në konferencën e Tiranës, 2008, Hamp-i hodhi dhe një zhvillim të mundshëm të mëtejme të idesë së tij drejt lidhjeve të shqipes me ilirishten-mesapishten, e madje edhe për lidhjet e ilirishtes me latinishten.

Por cila është mbështetja për supozimin se para-albanishtja do të jetë folur në veri? Për Hamp-in në këtë pikë rëndësi kanë raportet leksikore e të tjera me baltishten, raportet gramatikore specifike me sllavishten (te foljet), izoglosat fonetike, gjurmët leksiko-semantike në terminologjinë baritore, po edhe gjurmët toponimike si *Karpate* a *Beskide*, të pranuar dhe nga Çabej. Ai aty e ka futur dhe toponimin *Drobeta* te Turnu Severin, të interpretuar si të dalë nga *dru-të*, gjithsesi, për ne, e diskutueshme. Për argumentimet shkencore, supozimi për mbaresën *-m* IE te mbiemrat, diskutimet për foljet, etj. janë elemente që çojnë peshë.

Po elementet e përbashkëta me rumanishten? Ato përforcohen dhe me aspektet karpto-ballkanike.

Desnickaja për afritë me gjuhët IE veriore

Agnja V. Desnickaja (1912-1992), anëtare korrespondente e Akademisë së Shkencave të BRSS-së, profesoreshë e njohur e Universitetit të Leningradit,⁴¹ me siguri më e merituar për zhvillimin e studimeve albanistike në BRSS, por me ndikim të madh edhe në tërë botën e lindjes, i bëri objekt studimesh të veçanta raportet e shqipes me baltishten. Fillimisht e specializuar për gjuhësi krahasuese me vështrime për gjuhët gjermanike, me ndihmesa të shënuara në këtë fushë, më vonë iu kushtua tërësisht studimeve të shqipes dhe të kulturës shqiptare, ngulte këmbë edhe në hulumtimin e raporteve ilire-baltike dhe shqipe-baltike. Lidhjet e indikuara nga ajo me gjermanishten, qoftë për ilirishten, qoftë për shqipen, marrin kuptim të veçantë: të tilla lidhje në studimet trako-dake nuk janë vënë re dhe kjo flet vetiu dhe për prejardhjen e shqipes në raport me gjuhët paleoballkanike, mendonte ajo. Nevojën e hulumtimit të lidhjeve të gjuhëve paleoballkanike me gjuhët baltike, sipas saj, e arsyetonte dhe fakti se gjuhët paleoballkanike dalin nga një kohë e përbashkësisë së vonë indo-europiane dhe se, meqenëse ato janë bartur në Siujdhesën Ballkanike pas shpërnguljeve të fiseve trako-dakase dhe ilire, ruajnë një shkallë të rëndësishme afrie midis tyre. Në këtë kuptim ajo shihte mundësi studimi në fushën e leksikut, po edhe në fushën e fonetikës dhe të segmenteve të tjera strukturore. Të dhënat e rendit të brendshëm historik dhe ato pak të dhëna gjuhësore (mesape e ilire), pas saj, flasin se paraardhësit e shqiptarëve në periudhën antike kanë jetuar në pjesën perëndimore të Ballkanit, afërsisht aty ku jetojnë në kohë të reja, prandaj shqipja është pasardhëse e ilirishtes. Në këtë punë ajo nisej nga rindërtimi i formave të proto-shqipes dhe të shqipes së hershme (në periudhën nga 500 para deri në 500 pas Krishtit).

Për një përfytyrim më të përafërt të mënyrës se si e shihte ajo këtë lidhje midis shqipes dhe gjuhëve baltike po sjellim këtu shembullin e ri-

⁴¹ Shih S. Kuçi: *Studimet mbi strukturën e shqipes në BRSS*, Prishtinë, 2013, ff. 266.

ndërtimit nga ajo të çerdheve derivative me shembullin

**lug*:

<i>*lugas</i> m. –	<i>lug</i> ;	Ndërsa më tej vijonte:
<i>*luga</i> f. (< <i>*lugā</i>) –	<i>lugë</i> ;	<i>*anna</i> – <i>anë</i> ,
<i>*lugiā</i> f. (< <i>*lugiā</i>) –	<i>lugje</i> ;	<i>*ahas</i> – <i>ah</i> ,
<i>*lugariā</i> f. (< <i>lugariā</i> , <i>lugoria</i>) –	<i>lugare</i> ;	<i>*balga</i> – <i>balgë</i> ,
<i>*luganiā</i> f. (<i>*luganiā</i> , <i>lugonia</i>) –	<i>lugajë</i> ;	<i>*balta</i> – <i>baltë</i> ,
<i>*luguras</i> –	<i>lugur</i> ;	<i>*bala</i> – <i>ballë</i> ,
<i>*lugatas</i> –	<i>i lugët</i> ;	<i>*bieska</i> – <i>bjeshkë</i> , etj.
<i>*lugetias</i> –	<i>lugës</i> ;	(Desnickaja 1984: 195).
<i>*lugoniā</i> (< <i>*lugoniō</i>) –	<i>lugonj</i> .	

Posaçërisht me peshë i dilnin rindërtimet e formanteve fjalëformuese, ndërsa këto pastaj mund të krahasoheshin me përkatëset baltike. Në fushën e leksikut ajo, në vijën e G. Meyer-it, theksonte lidhjet e veçanta të shqipes me gjuhët e Europës veriore në fushën e veprimtarisë së hershme bujqësore e blegtorale, të drurit, dhe këto flasin për lidhjet e para-shqiptarëve me para-baltikët, para-sllavët e para-gjermanikët. Shembuj:

**liga*, – *ligë*;

**ligas* – *i lig*; *ligustas*, *i ligstë* – lit. *ligà*, *ligustas*;

**metas mot*, – lit. *mētas*, pl. *mētai*;

**sirmas* *i thjermë*, lit. *širmas*, *širvas*;

**delas*, **dela>djalë* let. *mēls*, lat. *milius*;

**malas (molo) mal*, let. *mala* ‘kraj, bereg’;

**megla, mjegull*, lit. *migl*, let. *migla*, sl. *mēgla*;

**landā, landë* – lit. *lenta* ‘dërrasë’;

**lāpā, lopë* let. *luops*, *lopi*;

**lāmā, lamë* lit. *moma* ‘log, nizina’;

**skalā, halë* lit. *lkala*;

**gardas, gardh* lit. *gardas*.

(Desnickaja 1984: 203)

Në fushë fjalëformimi ajo shënonte: sufiksin IE **-i-mo-*: *vrapim* – lit. *begimas* – ‘beg’, nga *begti*; ndoshta tipar i veçantë i lidhjeve me baltiket. Edhe shuarja e asnjansit në shqipen e lashtë i delte me përkime me gjuhët baltike.

Në këtë grup çështjesh Desnickaja i fuste dhe raportet me gjërma-

nikishten. Në një studim të vonë për elementin latin të shqipes, gjithë duke vijuar me mbështetjen e prejardhjes ilire të shqipes, propozonte një raport të ri midis elementit të romanizuar në shkallë të ndryshme dhe atij relativisht të paromanizuar të ilirëve e me këtë lindjen e shqipes si rezultat i shkrirjes së re të njatyre shtresave ilire nga fillimi i epokës së vjetër.⁴⁷

Në vështrimin për raportet e shqipes me gjuhët gjermanike, A. V. Desnickaja sillte pikëpamjet e saj të formuara deri në vitet '80 të sh. XX.⁴⁸ Nisej nga supozimi se Ballkani dhe Europa jugore nuk kanë bërë pjesë në arealin e pammë të shtrirjes së paragjuhës IE. Banimi i Ballkanit nga fise indoeuropiane që lëvizën drejt jugut nga vise më veriore ka ndodhur në milen. III-II para e.r. Në proceset e shpërnguljeve të atilla në Ballkan u shfaqën paraardhësit e shqiptarëve të sotmë, që deri atëherë kishin jetuar në Europën Qendrore bashkë me fise të tjera IE, (Desnickaja 1984: 210).

Duke qenë, përveç greqishtes e armenishtes, e vetmja gjuhë e gjallë që përfaqëson të folurit e fiseve IE të Ballkanit të lashtë, shqipja paraqet interes për studimet e raporteve midis gjuhëve IE në periudhën parabolkanike. Sido që të zgjidhet çështja e prejardhjes së saj – ilire, trakase, dako-meze – në më të paktën shqipja paraqet

“vijën e pandërprerë të zhvillimit të ndonjërës gjuhë të lashtë, që i përkiste njëjës prej pjesëve qendrore të arealit gjuhësor indoeuropian” (Десницкая 1984: 211).⁴⁹

Përkatësia e shqipes në grupin IE ishte përcaktuar më 1835 nga R. J. von Xylander-i: *Die Sprache der Albanesen oder Skipetaren*, Frankfurt am Main. A. Schleicher-i e vendoste shqipen

“në familjen greke të farës pellazgjike” (greçeskujy semьjy pelasgijskoi vetvi)

⁴⁷ Desnickaja 2001, A. V.: *Mbi prejardhjen e gjuhës shqipe*, in *Studime* 5, 6, 7, 1998/ 1999/ 2000, ASHAK, Prishtinë, ff. 181-191, botuar së pari në *Bulletin de liaison*, No. 11, Centre d'études balkaniques, INALCO, Paris, décembre 1993.

⁴⁸ Десницкая 1984, А. В.: *Древние германо-албанские языковые связи в свете проблем индоевропейской ареальной лингвистики*, in *Сравнительное языкознание и история языков*, Ленинград, Наука, 210-239. Сë pari në *Voprosy jazykoznanija* 6, 1965.

⁴⁹ “v ljubom slučae albanskij prodolžaet neprerivnuju liniju razvitja nekoego drevnego jazyka, pronadležavšego k odnoj iz centralnyh častei indoeuropejskogo lingvističeskogo areala”.

dhe pa në të një rezultat ndryshimi apo zbërthimi të organizmit të gjuhës së lashtë greke. Më 1854 F. Bopp-i dëshmoi se shqipja u përkiste gjuhëve IE pa lidhje specifike me asnjërën prej degëve të saj. Në mënyrë të veçantë ai nënvizoi mospajtimin e plotë me mendimin për afrinë e shqipes me greqishten.⁵⁰ Në gjysmën e dytë të sh. XX hulumtimet shkuan në drejtim të kërkimit të lidhjeve të shqipes me gjuhët e lashta indoeuropiane ballkanike. Meqë shqipja flitet në hapësirën ku jetonin ilirët, u pa e arsyeshme të mendohej se ajo kishte lidhje bijërie me gjuhën e tyre. Ky mendim u shpreh nga J. Thunmann-i,⁵¹ por u argumentua nga Gustav Meyer-i,⁵² ndërsa u pranua nga S. Bugge, K. Brugmann, P. Kretschmer, H. Pedersen. Në vitet '20-'30 të sh. XX këtë ide e mbështeti N. Jokl-i,⁵³ i cili nuk e mohoi mundësinë që në formimin e gjuhës dhe të popullit shqiptar të kishte edhe elemente trakase (Desnickaja 1984: 212; shih Ismajli 1987).

Kundër hipotezës për prearjdhjen ilire të shqipes në fund të sh. XIX doli H. Hirt.⁵⁴ Duke u mbështetur në ndarjen e gjuhëve IE në grupet *centum* e *satəm*, ai e mohonte tërësisht çdo mundësi të afrimit të shqipes me ilirishten, të cilën ai e shihte si gjuhë *centum*, ndërsa shqipen si *satəm* (Десницкая 1984: 213).

Pikëpamja e tij qëndroi gjatë në shkencë, sidomos falë punimit polemizues të G. Weigand-it.⁵⁵ Ai solli një numër argumentesh kundër hipotezës për prearjdhjen ilire të shqipes dhe në favor të prearjdhjes trakase. Argumentimi i Weigand-it u bë i përhapur ndër gjuhëtarë që nuk merreshin në mënyrë të veçantë me shqipen. Argumenti më i rëndësishëm i Weigand-it, pas saj, ka të bëjë me mungesën e pretenduar të terminolo-

⁵⁰ Bopp (1855), F.: *Über das Albanesische in seine nverwandtschaftlichen Beziehungen*. Abhandl. Der Kön. Akad. D. Wiss., Berlin, s. 459. Cf. Десницкая 1984: 212.

⁵¹ Thunmann (1774), J.: *Untersuchungen über die Geschichte der östlichen europäischen Völker*, Leipzig.

⁵² Meyer (1883), G.: *Essays und Studien zur Sprachgeschichte und Volkskunde I*, Berlin, 53.

⁵³ Jokl (1924), N.: *Albaner – Reallexikon der Vorgeschichte*, Hrgs. Ebert I.

⁵⁴ Hirt (1940), H.: *Indogermanica. Forschungen über Sprache und Geschichte Alteuropas*, Halle.

⁵⁵ Weigand (1927), G.: *Sind die Albaner die Nachkommen der Illyrier oder der Thraker?*, *Balkan-Archiv III*.

gjisë detare në shqipen, edhe pse ilirët njiheshin si detarë. Artificialitetin e këtij argumenti e sheh secili që njih pak gjeografinë e Shqipërisë dhe mënyrat e jetesës atje, vërente Desnickaja. Terminologjia e tillë është e huazuar, italiane, greke, turke, çka duket normale, ndërsa banorët e qyteteve e të fshatrave larg detit nuk e njihnin atë. Diçka e ngjashme do të ketë ndodhur dhe në botën e lashtë. Jo të gjithë detarët ishin ilirë, vetëm një pjesë e tyre jetonte në bregdet. Pjesa më e madhe e fiseve ilire merrej me bujqësi e blegtori, madje pak ishte e lidhur me detin, si sot. Mungesa e terminologjisë së lundrimit e të peshkimit nuk mund të mjaftojë si argument kundër prejardhjes ilire të shqipes (Десницкая 1984: 213-14; shih Çabej, pastaj Pellegrini 1995, Demiraj 1999, komentin te Ismajli 1987, etj.).

Pohimin e Weigand-it se në hapësirën ilire nuk ka emra vendesh që na kanë arritur përmes shqipes e hodhi poshtë në hulumtimet e tij N. Jokl, (Desnickaja 1984: 214).⁵⁶ Tezën për prejardhjen trakase të shqipes Weigand e mbështeste në mendimin se lidhjet e vjetra gjuhësore shqiptarumune kanë mundur të ndodhnin vetëm në hapësirën trakase.⁵⁷ Por, vetë argumentimi albanologjik i Weigand-it, sipas saj, ishte “*mjaft sipërfaqësor dhe në një rradhë momentesh subjektiv*”. Vrojtime kritike të shihen te recensionin i Jokl, *Indogermanisches Jahrbuch XIII*, f. 188. Teorinë trakase e përkrahën H. Barić⁵⁸ e D. Dechev.⁵⁹ Georgiev-i doli me hipotezën se shqipja është pasardhëse e dako-mezishtes, me tipare të ndryshme fonetike nga trakishtja (Десницкая 1984, A. В.: 214).⁶⁰

⁵⁶ Jokl (1932), N.: *Zur Geschichte des albanesischen Diphthongs ue-, ua-*, in *Indogermanische Forschungen*, bd. 50, f. 33-34; Jokl (1928), N.: *Balkan lateinische Studien*, *Balkan-Archiv*, IV, Leipzig; Jokl (1936), N.: *Zu den lateinischen Elementen des albanischen Wortschatzes*, *Glotta* 1936, bd. XXV; të dhëna të reja përmbajnë studimet e Çabejtë: *Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve*, *Bul. i Univ. Të Tiranës* 1958, nr. 2, f. 2; *Einige Grundprobleme der älteren albanischen Sprachgeschichte*, in *Studia albanica* 1964, 1.

⁵⁷ Weigand, *Vorwort, zugleich Programm des Balkanarchivs*, *Balkan-Archiv I*, Leipzig 1925; po ashtu *Ethnographie von Makedonien*, Leipzig, 1924, f. 11.

⁵⁸ Rec. për Jokl, *Albaner*, në *Arhiv II*, Beograd 1924, dhe në Barić (1959), H.: *Istorija arbanaskog jezika*, Sarajevo, *Нѹмје нѹ историнѹ е гjuhѹс шqipe*, Prishtinë, 1955.

⁵⁹ Dechev (1952), D.: *Harakterisitka na trakijskija ezik*, Sofija 1952.

⁶⁰ Георгиев 1957, В.: *Тракијскиа език*, Софија; Georgiev 1960, V.: *Albnaisch, Dakisch-*

Në konceptin e Georgiev-it mbetet pa përgjigje raporti midis dakomezishtes e ilirishtes. Sipas saj, pjesa më e madhe e veçorive fonetike që Georgiev-i rindërtonte për dakomezishten në fakt përputhet me veçoritë që shihen si të tipit ballkano-ilirik, po me ngjashmëri edhe me mesapishten.⁶¹ Prandaj mund të mendohet se disa prej tipareve fonetike që dallojnë, pas Georgiev-it, dakomezishten nga trakishtja në një hapësirë mjaft të gjerë të Ballkanit të lashtë përfshijnë jo vetëm dakomezishten e parashqipen, po edhe tipin e gjuhës IE që kushtimisht mund ta quajmë ilirishte. Nga ana tjetër, vetë gjerësia e shtrirjes së tipareve të përmendura e bën atë të duket jo mjaft specifike sa u përket lidhjeve të parashqipes me dakomezishten. Në fushën e leksikut hipoteza e Georgiev-it nuk mbështetet me etimologji të mjaftueshme shqipe (Десницкая 1984: 215).

Hipoteza ilire në vijim gjeti shumë përkrahës.⁶² Për shkak të të dhënave të pakta për ilirishten, trakishten e dakomezishten del e vështirë vendosja e plotë e lidhjes gjenetike të shqipes me këtë apo atë gjuhë të lashtë të Ballkanit. Në këtë pasqyrë të zhvillimit të këtyre studimeve ajo përmendte dhe diskutimin për vetë konceptin e ilirëve.⁶³ Vijonte me vrotimet për raportet fonetike me ilirishten ballkanike dhe më gjerësisht për konceptin e H. Krahe-s lidhur me ilirishten e vjetër dhe me atë që ai quante *Alteuropäisch*. Lidhjet leksikore i ka shqyrtuar Jokl (*Albaner*, 85). Raportet me mesapishten ajo i shihte po ashtu me vlerë.⁶⁴ Citonte Hamp-in li-

Mysisch und Rumänisch. Die Herkunft der Albaner, in *Balkansko ezikoznanie II*, Sofia; Георгиев 1960, В.: Българска етимология и ономастика, София. Kjo do të thotë se ai po ashtu mendonte që raporti i shqipes me trakishten nuk kishte mundësi të konceptohej si raport prejardhjeje apo afrie në një shkallë më të madhe.

⁶¹ Këtu referonte Hass 1962, Oto: *Messapische Studien*, Heidelberg, f. 166.

⁶² V. Pisani: *Les origins de la langue albanaise*, in *Studia albanica* 1 1964, f. 63, W. Cimo-chowski: *Prejardhja e gjuhës shqipe*, in *Bul. li Univ. të Tiranës, Ser SSH* 1958, 2; E. Hamp: *Albanian and Messapic, Studies presented to J. Whatmough*, S-Grevenhage 1957; E Çabej: *Disa probleme themelore të historisë së vjetër të gjuhës shqipe*, *Bul i Univ të Tiranës, SSSH* 1962, 4.

⁶³ Referonte për këtë Kronasser 1962, H.: *Zum Stand der Illyristik, Balkansko ezikoznanie IV*, Sofia. Referonte Neroznak 1978, V. P.: *Paleobalkanskije jazyki*, Moskva 1978; Katičić 1976, R.: *Ancient languages of the Balkans*, I-II, Hague.

⁶⁴ Referonte Krahe 1955, H.: *Die Sprache der Illyrier I. Die Quellen*. Wiesbaden, f. 9; në vë-

dhur me raportet e rëndësishme specifike midis iliro-mesapishtes e shqipes (Hamp: *Alb. and Messapic*, f. 217). Referonte Neroznak-un për idenë që mesapishtja, ilirishtja e protoshqipja të përfshihen në *'obščeilirijski'* (ilirishte e përgjithshme) ose *'zapadnopaleobalkanski'* (paleoballkanishte përrëndimore) (Нерознак 1978: 161; Десницкая 1984: 218).

Studimet e raporteve të shqipes me gjuhët e tjera IE merren me elementet e trashëguar të ruajtur në shqipen me peshë për familjen IE e me tiparet e veçanta të krijuara në bazë kontakti para ndarjes së përbashkësisë IE. Le ta shohim pak më afër idenë e saj bashkë me referimet që ajo vlerësonte. Meyer-i e kishte caktuar vendin e shqipes duke theksuar sidomos lidhjet e saj me arealin verieuropian – baltishte, sllavishte e gjermanikishte. H. Pedersen-i solli disa përkime me armenishten. N. Jokl-i e pohoi qëndrimin e Meyer-it. Pas Jokl-it përkimet speciale leksikore midis shqipes e gjuhëve IE veriore flasin për raporte të lashta të paraardhësve të shqiptarëve me paraardhësit e baltëve, të sllavëve e të gjermanikëve diku në verilindje të Europës. Për mbështetje të kësaj ai solli dhe disa lidhje të lashta leksikore shqiptaro-fino-ugre (Десницкая 1984: 218-19).⁶⁵

Ka pasur vrojtime të tjera sa i përket përcaktimit të vendit të parashqipes, si ato të H. Barić-it, që supozonte njësi të veçantë dialektore shqiptaro-trako-frigo-armene, në të cilën trakishtja e frigjishtja do të kenë pasur një pozitë të ndërmjetme midis shqipes e armenishtes (Barić 1959: 28; Barić 1955). Ashtu si Katičić më herët, ne ishim pajtuar me këtë vlerësim:

“Hipotezë kjo pak e lidhur me karakterin real të të dhënave gjuhësore”
(Десницкая 1984: 219).⁶⁶

Trakishtja e frigjishtja nuk njihen, ndërsa lidhjet e veçanta të shqipes me armenishten duhen dëshmuar me argumente më të rëndësishme se disa leksema që kishte vënë në pah Pedersen-i. Për Desnickaja-n hulu-

Ilimin II 1964 botonte studimet e de Simone 1964, C.: *Die messapische Inschriften* dhe Untermann 1964, J.: *Die messapischen Personennamen*; O. Haas: *Messapische Studien*.

⁶⁵ Referonte Jokl 1929, N.: *Zur Vorgeschichte des Albanischen und der Albaner*, in *Wörter und Sachen* 1929, bd. XII, f. 63.

⁶⁶ “Gipoteza eta malo svjazana s realnym harakterom jazykovyh faktov”. Cf. Ismajli 1987.

mtimet e Barić-it nuk duken bindëse. Ajo kishte vërejtje me rëndësi edhe për vizionin e Georgiev-it në këtë segment. Në paraqitjen e Georgiev-it të skemës dialektore të botës IE në periudhën e neolitit të hershëm (Georgiev 1958: 276) nuk sillen të dhëna lidhur me lidhjet e shqipes me baltishten, sllavishten e gjermanikishten. Këto gjuhë ai i shihte në grupin e veçantë ‘*veriindoeuropian*’, ndërsa për shqipen kishte caktuar vend bashkë me greqishten, makedonishten, indo-iranishten, frigo-armenishten, trakishten, pellazgishten e karishten brenda grupit ‘*qendror indoeuropian*’. Komentet e Desnickajas vijonin kështu: trakishtja, frigjishtja, pellazgishtja, karishtja janë madhësi të panjohura; lidhje speciale të shqipes me indo-iranishten nuk janë dëshmuar; çështja e raporteve armeno-shqiptare do hulumtim më të thelluar, ndërsa lidhjet leksikore shqiptaro-greke në shumicën e rasteve kanë të bëjnë me periudha më të vona të kontakteve historike të shqipes me greqishten, në Ballkan (Десницкая 1984: 220).⁶⁷ Në përgjithësi ajo nuk i tumirte idetë e Georgiev-it lidhur me raportet e shqipes me gjuhët IE.

Skemë më të përshtatshme të lidhjeve të shqipes me gjuhët e tjera IE jepte, pas saj, V. Pisani: ndër elementet indoeuropiane të shqipes mund të dallojmë të atillë që shfaqen në shumicën e gjuhëve IE, të tjerë që e lidhin me qendrën veriore të Europës, me gjermanikishten, me baltishten e sllavishten; një shtresë më e vonë tregon lidhje të saj me trakishten e nëpërmjet saj me frigjishten e armenishten, pastaj me greqishten, më mirë disa dialekte të saj, e me dialektet osko-umbre (Pisani, 1953: 538; Десницкая 1984: 220). Pisani shqipen e konsideronte vazhduese të ilirishtes.

Raportet e shqipes me gjuhët verieuropiane – baltishte, sllavishte, gjermanikishte shtrojnë nevojën për ta kërkuar atdheun parabalkanik të atij grupi të gjuhëve IE, ku përkiste paraardhësja e shqipes. Ato tregojnë për kontakte me fiset e përmendura (Десницкая 1984: 220). Në aspektin leksikor, në tiparet që e bashkojnë shqipen me grupin indoeuropian verior marrin pjesë edhe keltishtja e italikishtja, çka flet për shtrirjen territoriale

⁶⁷ Referonte Pisani 1959, V.: *Lexikalische Beziehungen des Albanesischen zu den anderen indogermanischen Sprachen, Saggi di linguistica storica*, Torino, f. 134.

të hapësirës së fiseve IE drejt jugperëndimit. Kjo vazhdimësi do të ketë ekzistuar edhe në lindje.

Ndër tiparet që flasin për vendosjen e shqipes në kuadër indoeuropian Desnickaja rendiste: IE **o* e shkurtë dha *a* dhe u shkri me refleksin e **a* të shkurtë; shembuj: IE **nok^u-t-*: *natë*, lat. *nox*, *noctis*, irl. vj. *i-ⁿnocht*, sll. e vj. *ношть*, lit. *nak-tis*, gjerm. e lartë-e vjetër *Naht*, ind. e vj. *nakt-*; IE **ost(h)-*: *asht*, lat. *os*, *ossis*, gr. *οστέον*, het. *haštai-*, ind. e vj. *asth-*, *asthi*; IE **kap-*: *kap*, lat. *capīō*, got. *haffja*. Këtë tipar e gjejmë te gjermanishtja, baltishtja, sllavishtja, mesapishtja, ilirishtja ballkanike, iranishtja, indishtja, hetitishtja si shkrirje të **o*-së dhe **a*-së. Shqipja shfaqet më afër me balt., sllav., gjerm., ilir. e mesap., ndërsa në gjuhët iran. përfshihet edhe **e* e shkurtë. Hapësira IE ku hyjnë shqipja e ilirishtja me mesapishten sipas tiparit të shkrirjes së tri zanoreve **e*, **a*, **o* në dy – *e*, *a*, kontraston me hapësirën jugore e perëndimore të arealit IE (kelt., ital., gr., frig., arm.), ku ruhet grupi treanëtarësh, dhe me hapësirën indoiraniane, ku kemi hapje të *ə*-së në zanore (Десницкая 1984: 221).

Tingujt IE mbylltorë të zëshëm të aspiruar në shqipen dalin si mbylltorë të thjeshtë: IE **bher-*: *bie* (**bherō*), got. *baira*, sll. e vj. *беръ*, irl. e vj. *biru*, arm. *berem*, avest. *baraiti*, ind. e vj. *bharāmi*, gr. *φέρο*, lat. *ferō*; IE **dheu-b-*: *det*, (nga **dheubeto-*), got. *diubs*, *daupjan*, lit. *dubùs*, let. *duobs*, *duobe*, *dubuo*, sll. e vj. *дъно* (nga **дъбно*); IE **steigh-*: *shteg* (nga **stoi-gho-*), got. *steigan*, *staiga*, lit. *stiga*, sll. e vj. *стугнъ*, por gr. *στοῖχος* 'radhë, linjë'. Në këtë segment shqipja bashkohet me shumicën e gjuhëve IE – baltisht, sllavisht, gjermanisht, keltisht, ilirisht, trakisht, e iranisht; ajo i ruante tri radhët e mbylltoreve IE duke lënë anash radhën e të zëshmeve të aspiruara (Десницкая 1984: 222). Risim i rëndësishëm i këtij areali të gjerë dilte shkrirja në një e dy radhëve të mbylltoreve – të zëshme të thjeshta dhe të zëshme të aspiruara. Në qendër të këtij areali vetëm hapësira gjuhësore gjermanike nuk e zbatoi këtë risim duke iu shtruar *Lautverschiebung* (mutacion konsonantik) për të ruajtur kështu distancën burimore midis tri radhëve të mbylltoreve IE (Десницкая 1984: 223).

Shqipja hynte te gjuhët IE satëm që ruajnë tiparin e radhës palatale

të guturaleve IE duke i ndryshuar ato përmes asibilimit. Shembuj: IE **ǵens*: *thom* (nga **ǵēnsmi-*), ind. e vj. *çarīsáyati*, avest. *sah-*, lat. *cēnsēō*, sll. e vj. *самъ*. IE **ǵombho-*: *dhâmb*, ind. e vj. *jambhah*, sll. e vj. *зѣбъ*, let. *zûobs*, gjerm. e m. e lartë *kamb*, gr. *γόμφος* (Десницкая 1984: 223).

Në shqipen si në baltishten, në masë më të vogël në sllavishten, sipas Desnickaja-s, kemi 'satemitet jo të plotë'.⁶⁸ Kjo shihet në rastet e ruajtjes së mbylltores atje ku pritej asibilimi, çka ka të bëjë me depalatalizimin e dikurshëm të palataleve IE në disa pozita fonetike (pjesërisht në fqinjësi me sonantet *r*, *l*). Kështu **ǵleu-* *kluhet*, lit. e vj. *klausýti*, prus. e vj. *klausīton*, let. *klausīt*, por sll. e vj. *слоуту*, mesap. *klaohi*, lat. *clueō*, gjer. e lartë e vjetër *hlosēn*. Shqip *mjekër*, lit. *smākras*, *smakrà*, het. *zama(n)kur*, ind. e vj. *çmaçru-* (nga *smaçru-*). Desnickaja mendonte se, siç ka dëshmuar Jokl-i, në shqipen asibilimi i palataleve IE ka ndodhur mjaft vonë. Zhvillimi i IE **ǵ*dhe **k* para *t* dëshmon se në epokën e zhvillimit të veçantë shqipja e lashtë vazhdonte ende të ruante shqiptimin mbylltor (velar) të qiellzoreve IE (ref. Jokl, *Albaner*, f. 90; Desnickaja 1984: 223). Satemiteti i papërfunduar (jo i plotë) mund të konsiderohet tipar mjaft i përhapur në pjesën qendrore të arealit dialektor IE, ku, pos baltishtes, sllavishtes e shqipes, e shohim edhe ilirishten e mesapishten (zakonisht karakteri *centum* i ilir. dëshmohet përmes shembujve si mesap. *klaohi*, e ilir. *Vescleves*) e trakishten (Десницкая 1984: 224). Tendenca drejt asibilimit të qiellzoreve, risim i fuqishëm që vinte nga lindja, në këtë hapësirë dobësohej ndjeshëm në kushte të ndeshjes me tendencën që vinte nga perëndimi për neutralizimin e kundërvënies së qiellzoreve e të velareve. Dhe gjendja e papërfunduar në realizimin e të dy tendencave përcaktonte situatën e përzierjes së tipareve *centum* e *satəm* të gjuhëve dikur në qendër të arealit IE.

Të tri tiparet e shënuara kanë rëndësi për vendosjen e hartës dialektologjike të arealit IE, shfaqen në shqipen e në baltishten. Me sllavishten e gjermanikishten përbashkësia e shqipes dhe baltishtes del vetëm e pjesësisht (Десницкая 1984: 224).

Sipas saj, me gjermanikishten shqipja ka të përbashkët kalimin **o* >

⁶⁸ Këtë e kishte vënë në pah qysh Hamp në vitet '60.

a, por dallon prej saj te bashkëtingëlloret qiellzore. Sllavishtja dallon nga baltishtja, gjermanikishtja e shqipja sa i përket shkrirjes së IE **o*, **a*, rezultat i së cilës në sllavishten është zanorja *o*. Prandaj nxirrte përfundimin:

*“Idioma ilire, në mënyrë të veçantë gjuha mesape, sipas të gjitha tipareve të shqyrtuara – kalimi i IE *o > a, i të aspiruarave të zëshme në mbylltore të zëshme dhe ‘satemiteti i papërfunduar’ – afrohet me gjuhët shqipe dhe baltike”* (Desnickaja 1984: 224).⁶⁹

Sa i përket leksikut, ajo mendonte se kemi shqyrtime mjaft të gjera etimologjike për lidhjet e shqipes me gjuhët baltike, sllave e gjermanike, sidomos te Jokl-i.⁷⁰ Madje mendonte se lidhjet shqipe-baltike janë edhe më të mëdha se ç’është dëshmuar, e

“kjo jep bazë për të menduar se parashqipja ka pasur dikur kontakte mjaft të ngushta me dialektet parabaltike” (Desnickaja 1984: 225).⁷¹

Pamja e lidhjeve të lashta leksikore të shqipes me grupin e gjuhëve IE veriore bëhet edhe më e qartë kur të mblidhen shqyrtimet e veçanta dialektore te Meyer, Jokl, Çabej, mendonte ajo (Десницкая 1984: 225).

Desnickaja i shqyrtonte në mënyrë të veçantë raportet leksikore të shqipes me gjermanikishten, çështje për të cilat kanë folur dhe Pokorny, *Indogermanisches Etymologisches Wörterbuch*, 1, 1959 e të tjerë. Në vijim po japim vështrimin e saj pak të përmbledhur:

barrë (IE **bhornā*), got., gjerm. e vjetër e lartë, island. e vj. *barn*; rrënja IE **bher-* (*bie*), vetëm gjerm. e shq. me sufiks -*no/-nā*, me vokalizëm **o* (Desnickaja 1984: 226). *brî*, -*ni* (nga IE **bhr̥-no-*), sued. dial. *brined* (**brento-*), norv. *bringe*, *brund* (**bhr̥to-*). lit. *briëdis*, lit *briedis*, prus. e vj. *braydis*. mesap. *βρένδος* (nga **βρεντος*) te Heziku, top. *Brundisium*, *Βρεντέσιον*, etnonim ilir *Βρέντοι*.

⁶⁹ “Illirijskaja reč, v osobenosti messapskij jazyk, po vsem otmečennym priznakam – perehod i.e. **o* > *a*, zvonkih aspirirovannyh v prostye zvonkie smyčnie i ‘neposledovateljnaja satemnost’ – primykaet k albanskomu i baltijskim jazykam”.

⁷⁰ Jokl: *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen; Zur Vorgeschichte des Albanischen und der Albaner*, in *Wörter und Sachen* 1912, Bd XII; *Die Verwandtschaftsverhältnisse des Albanischen zu den übrigen indogermanischen Sprachen*, in *Die Sprache* Bd. IX, 2, Wien, 1963.

⁷¹ “Eto daet osnovanija predpolagaty, čto praalbanskij imel nekogda osobo tesnye kontakty imenno s prabaltijskimi dialektami”.

bun, -i, *buj*, *bunj* nga **bheu-*, **bhū-*, e afër me got. *bauan*, isl. e vj. *bū*, ang. e vj. *bū*; mund të krahasohet toponimi ilir Βοῦνος, etnonim *Buni*; me sufiks tjetër mesap. Βύριον, Βαυρία..

dhi, -a, parash. **digā*, gjerm. e vj. e lashtë *ziga*, gr. e trak. (Λάκωνες) διζα. αἰξ (Heziku) 'dhi', IE **digh-*.

gjalm, -i, *gjalmë*, -a, gjerm. e lartë e vjetër *seil*, IE **sē(i)-*, **sai-*: *sī-*; **sei-*, (Desnickaja 1984: 226).

halë, -a IE **skel-* 'rezatë', got. *skalja*, isl. e vj. *skal*, gjerm. e lashtë e vj. *scāla*.

helm, -i, helm < **halmi* < **skolmi*, gjerm. e vj. e lartë *scalmo* 'sëmundje', skelmo. Nga IE *(s)kel- 'me pre', trak. σκάλη (**skolmā*) 'shpatë, thikë', (Desnickaja 1984: 227).

hedh, saks. e lashtë *skiotan*, gjerm. e lartë e vj. *skiozan*, angl. e vj. scēotan 'brosatë, strelljatë'. Lit. skudrūs, skaudrūs, let. *skaudrs*.

lā, *lē*, *lanē* **lādnō*; i *lodhēt* (**lēd-*), got. angl. e vj. *lētan*, saks. e vj. *lātan*, gjerm. e lartë e vj. *lāzgan*, isl. e vj. *lāta*, got. *lats*, is. e vj. *latr*, gjerm. e lartë e vj. *la_z*. Nga kjo rrënjë ka formime dhe në gjuhë të tjera IE: gr. ληδεῖν (**lēd-*), *lassus* (**lādto-*). Kuptimisht diferencohen gjerman. e shq., si dhe nga forma: **ə/ē* (*lats*: *lētan*) – *a/o* (*la-*: *lodh-*, Desnickaja 1984: 227).

lehtë, i (**leug^h-*, *leng^h-*), got. *leihts*, etj.; lit. *leñgvas*, *lengvūs*, sllav. e vj. *льзькъ*. Pas saj vetëm në gjerm. e në shq. baza e mbiemrit ka sufiks -t. Referonte Meyer, Et. W. 239 (Desnickaja 1984: 228).

lesh, -i, holand. *vlies*, gjerm. e lartë e mesme *vlius*, ang. e vj. *flēos* 'kripi i deles, lesh'. IE **pleus-* 'ščipatë šerstv', holand. *plūskos* 'kosmy, flokë', lat. *plūma* 'puh'. Sipas saj, kuptimi i specializuar 'lesh i deles' del vetëm në gjerm. e shq. Referonte Meyer, Et. Wtb. 241. Për shqipen ka dhe etimologji të tjera, shih Çabej, *Studime gjuhësore* 315-316.

miell, gjerm. e vj. e lartë *melo*, *melawes*, angl. e vj. *melu*, isl. e vj. *mjöl*, nga IE **mel-*. Gjerm. e shqipja afrohen me formimin e veçantë të bazës emërore me kuptimin 'miell' me sufiks **_u-* **mel_u-*, 228.

mund; gjerm. e vj. e lartë *muntar*, *munt(a)rī*, got. *mundrei*, IE **mendh-* 'npravljat mysli, bytë oživlennim' (referonte Meyer, 291 dhe Pokorny 730), me to lidhen lit. *mañdras*, *mandrū* 'dobryj, zadornyj', sll. e vj. *м.ѣдръ*, gr. *μανθάνω*, ind. e vj. *mēdhā* 'mudrost', IE **men-dh-* nga rrënja **men-*, 229.

rā, *rāni*, *rëndës*, gjerm. e mesme e lartë *renne*, Jokl: *Zur Vorgeschichte* 15.

rē, -ja, gjerm. e vj. e lartë *rouh*, saks. e vj. *rōk*, isl. e vj. *reykr* 'dym', paragjerm. e lashtë **rauki-* < **rougi-*. Por shqipja e veriut ka rē, Bogdani <ren>.

shparr (**sparno-*), gjerm. e vj. e lartë, saks. e vj. *sparro*, gjerm. e mesme e lartë *sparre*, isl. e vj. *spari*, *sparri*, gjerm. e përgj. **spar(r)an-*, gjerm. e vj. e lartë *sper*, angl. e vj. *spere*, isl. e vj. *sparr* (**sper(r)u-*, **sparru-*), Jokl: *Linguistisch*. 187, lat. *sparus*, *sparum*, gr. Σπάρος.

shpreh (**spreg-sk-*), gjerm. e lartë e mesme *sprehhan*, saks. e vj. angl. e vj. *sprēcan*, 'govoritë'. Kelt. kymr. *ffraeth* (**spraktos*), *ffregod*. 230

lapë, *lapër*, gjerm. e vj. e lartë *lappo*, m., *lappa*, f. 'svisajušči kusok koži, materii', saks. e vj. *lappo* m., gjerm. e sotme *Lappen* 'loskut', 230. lidhet me **iabba*, gr. *λοβός* 'pjesa e poshtme e veshit', irl. e vj. *labor*, lat. *labāre* 'šatatsja', 230. **iappa* gjithëgjerm. hyn te leksiku IE ekspresiv me dyfishim bashkët. f. 230-1. Për shq. mund të vendoset rrënja IE **lap-* me variantin **lab-*, e shpjegueshme përmes karakterit ekspresiv. 231.

Përmes karakterit ekspresiv kërkonte shpjegime edhe në rastet vijuese:

flakë, *flakëroj*, *flakoj*, folja *flak*; gjerm. e lartë e mesme *vlackern*, gjerm. e sotme *flackern*;

angl. e vj. *flacor* 'letučij', angl e mesme *flakeren*, isl. e vj. *flakra* 'porhaty'. 231; Çabej, *Bul.* 1962 1, 99 hedh poshtë shpjegimin e Meyer-it për huazim: *flakë* nga lat. *flacula*, lat. vulg *facla* me metatezë **flaca*. Ka analogji ekspresive në fushë të fjalëve me afri elementare. Mbase për pasojë kontaktesh territoriale paragjermanike e parashqipe. Kjo vlen edhe për grupin e fjalëve: *flatër, fletë, flatroj, flutur, fluturoj, fluroj*, gjerm. mod. *flattern*, gjerm. e hershme e re *flutteren, flotteren*, ang. *flutter, flitter*, por edhe gjerm. e hershme e lartë me variantin *vladern, Fledermaus* (pas ang. *flittermouse*). Me karakter ekspresiv. 232.

Në fushën e gramatikës raportet e shqipes me gjermanikishten i shihte në ruajtjen e tipareve specifike të fleksionit të lashtë IE dhe në rrjedhën tipologjike të proceseve, në fushën e foljeve (Десницкая 1984: 232).

Në sistemin e formave të aoritit historikisht sipas sistemit heterogjen ruhen formime që të çojnë tek format e perfektit IE me *ē* në rrënjë, lat. *lēgi* (perf. veta 1 njëjës e *legō, vēni* nga *venio*), got. *qēmum* v. 1 sh. e preteritit të *qiman* 'me arritë, me ardhë', *sēhwum* nga *saihwān* 'me vësh-true, me shikue'. Meqë në shqipen kemi kalimin **ē* > *o*, historikisht format e perfektit me **ē* në rrënjë kanë *o*. Në prezent këto folje kanë *e* (*ie*) në pjesën rrënjore të temës: *mbledh – mblodha, bredh – brodha, dredh – drodha, siell – solla* (dhe Meyer, *Zum indogermanischen ē-Perfectum*, in *Indogermanische Forschungen* 1895, 5, f. 480, Десницкая 1984: 232).

Kështu dallimi IE i kuantitetit *e*: *ē* në shqipen u transformua në cilësi: *e* (*ie*): *o*. Forma *lodh-te mb-lodh-a* (*mb-ledh*) i përgjigjet formës latine *lēg-* te *lēg-i* (rrënjja te shq. *lodh-* e lat *lēg-* është një - **lēǵ-*). Këtu kemi të bëjmë me një raport specifik lidhur me ruajtjen e një prej formave të fleksionit IE që përfshin një areal të caktuar brenda përbashkësisë IE – italik, gjermanik e shqip. Nëse e shohim shqipen vazhdim të ilirishtes, kemi një argument plotësues për raportet e veçanta midis gjermanikishtes, italikishtes e ilirishtes (Десницкая 1984: 233). Këtu referonte H. Krahe (*Sprache und Vortzeit*, f. 71, 98).

Po të shkojmë pak te Krahe, do të shohim se, sipas tij, emrat e ujërave me prejardhje IE të fazës që ai e përkufizonte si *Alteuropäisch* në vendet jugore duhet të trajtohen si joautoktone, të importuara, të sjella nga popuj/ gjuhë që, si përkatës të familjes IE, i morën këto vende: këto janë në radhë të parë grupi italik dhe grupi ilir. Dhe këto duhet të kenë

ardhur nga veriu – në veri të Alpeve: paraardhësit e ilirëve e të italikëve, në kohën kur lindi hidronimia e lashtë europiane, ishin popuj të veriut, ngjashëm me keltët, germanët, baltët. Krahe përfundonte:

“Kjo prejardhje veriore e italikëve dhe e ilirëve është një nga të dhënat më të rëndësishme, që mund të nxirren për parahistorinë e Europës me mjete linguistike” (Krahe: 71).⁷²

Sipas Desnickaja-s më tej, areali gjuhësor i gjermanikishtes, shqipes e italikishtes

“përfshin dhe izoglosën tipologjike të transformimit të formave indoeuropiane të perfektit e të aoristit në një paradigmë të vetme të preteritit. Fjala është për preteritin e fortë të gjuhëve gjermanike, për aoristin e shqipes dhe për perfektin e gjuhëve italike”.⁷³

Në të tre tipat e gjuhëve kemi sistem historikisht heterogjen të formave të preteritit si konglomerat elementesh të formave më të vjetra të formimit. Në shqipen, si në perfektin e latinishtes, shfaqen format sigmatike: *ap – dhashë, bie – rashë, lë – lashë*, por edhe forma që vazhdojnë formimet e perfektit indioeuropian me zanoren *ē* në pjesën rrënjore të temës. Në preteritin e fortë gjermanik, përveç formave të vjetra të perfektit me zanoren *ē*, në disa tipa foljorë ruhen, si në perfektin e latinishtes, si mbetje formash me dyfishim të rrënjës. Kjo njësi tipologjike e skemës arkaike të preteritit me përfshirje në të të elementeve heterogjene morfologjike që shprehin dallimin e dikurshëm aspektor, në shqipen, gjermanikishten e gjuhët italike nuk vihet në dyshim. Këtu kemi një nga izoglosat shumë të rëndësishme për gjuhësinë areale indoeuropiane, që ishte hetuar për gjuhët italike e gjermanike, e tani shihet se përfshin edhe shqipen. Analogjia në zhvillimin e dy modeleve të zgjedhimit foljor që quhen *,i fortë’* dhe *,i butë’* është veçori e përgjithshme e arealit gjuhësor në të cilin afrohen his-

⁷² „Diese nördliche Herkunft der Italiker und Illyrier ist eines der bedeutsamsten Fakten, welche mit sprachwissenschaftlichen Mitteln für die Vorgeschichte Europas erschlossen werden können“.

⁷³ “...ohvatyvaetsja tipologičeskoj izoglossoj preobrazovanija indoeuropejskih perfektnyh i aoristnyh form v edinuju paradigmatu preterita. Reč’ idet o sil’nom preterite german-skih jazykov, o albanskom aoriste i o perfekte italjskih jazykov”, f. 233.

torikisht strukturat e gjuhëve gjermanike, italice dhe shqipe (Десницкая 1984: 234).

Desnickaja mendonte se ka ngjashmëri në tipat e strukturave morfologjike të gjermanikishtes dhe të shqipes. Në zhvillimet fonetike të shqipes si në gjuhët gjermanike, rol me rëndësi kanë luajtur proceset e variacioneve asimiluese brenda vokalizmit të rrokjes së theksuar. Kjo ka luajtur një rol me rëndësi në morfologjinë e shqipes, në të cilën fleksioni i brendshëm është me peshë. Gjuhët gjermanike e shqipja kanë ngjashmëri në zhvillimet dhe funksionet e tyre morfologjike. Kjo nuk kufizohet vetëm te mbetjet e apofonisë kuantitative IE në disa paradigma foljore. Gjurmë të apofonisë kuantitative IE kemi te rastet e veçanta të izoluar si *bie – barrë*, por kjo nuk luan rol në strukturën morfologjike të shqipes. Ky tipar shfaqet më fuqishëm në ndryshimet tingullore asimilative kronologjikisht më të vona në shqipen që paraqesin analogji të plotë me përkatëset gjermanike (Десницкая 1984: 235).

Krahasimi i strukturave morfologjike të gjuhëve moderne shqipe e gjermanike përtregon analogji të afërta në përndarjen dhe funksionimin e fleksionit të brendshëm në cilësinë e bartësit të kuptimeve gramatikore. Në sistemin emëror metafohia shfaqet në të dy tipat gjuhësorë në formimin e shumësit: *dash – deshë, natë – net : Gast – Gäste, Nacht – Nächste* (gjerm. e vj. e lartë *nahti*) (Десницкая 1984: 235). Edhe te foljet ndryshimet tingullore luajnë rol në dallimin e vetës dhe të numrit, por dhe të temës së kohëve (Desnickaja 1984: 236). Posaçërisht me rëndësi është metafohia. Kështu ka ndodhur edhe në paradigmat foljore: në shqipen e lashtë veta I njëjës e së tashmes **flatīō*, v. 2 **flatīs*, v e 3 **flatīt*, në shq. e re *flas, flet, flet*. Në gjerm. e lartë të epër v. 1 *faru*, v. 2 *feris*, v. 3 *ferit*.⁷⁴

Raporti midis zanores *a* të rrokjes së theksuar që iu shtrua procesit asimilues nën ndikimin e zanores *i(i)* të rrokjes vijuese të patheksuar ka qenë analogjik me raportin përkatës të metafonisë gjermanike. Struktura

⁷⁴ Десницкая 1974, *О категории числа в албанском языке*, in *Проблемы Сравнительной филологии*, Москва-Ленинград 1974, 172; Jokl: *Griechisch-albanische Studien*, in *Festschrift für Paul Kretschmer*, Wien, Leipzig, New York, 1926, 92-93, 236.

theksore e leksikut shqip kryesisht IE dhe e huazimeve të hershme latine, ku u zhvillua procesi i metafonisë me *i*, në thelb ka qenë e ngjashme me të gjermanikishteve të lashta (Десницкая 1984: 236). Karakteristike për të ka qenë se theksi ishte fiksuar në rrokjen e prafundit, të rrënjës. Kjo ka ndikuar në procesin e dobësimit të rrokjeve të patheksuara dhe të reduktimit të zanoreve të patheksuara në historinë e shqipes; pasojat e këtij ndryshimi studiuesit i kanë parë të rëndësishme për zhvillimet e përgjithshme të strukturës gramatikore të shqipes (shih për këtë edhe Demiraj 1988; Bokshi 1980; Topalli 2007; Topalli 1995; Topalli 2011).

Në raport me tipin e përmendur do parë edhe lloji me fjalë trirrokëshe, në të cilat rrokja e theksuar e rrënjës ishte e treta prej fundi, por dhe fjalë me theks fundor, në elementet sufiksore (mjete kryesor për prodhimin e fjalëve). Ky fakt e bën më të ndërliqshëm përshkrimin e sistemit theksor të shqipes e të ndryshimt historik të tij.

Ndryshimi *e-i* gjerësisht i pranishëm në foljet e gjuhës shqipe na e kujton qartë ndryshimin *e-i* që shfaqet në gjuhët e lashta gjermanike me karakter asimilimesh variacioniste (Десницкая 1984: 237). Në fusnotë lidhur me këtë vrojtim Desnickaja shënonte se ky mekanizëm funksionon edhe te shumësi i emrave: *peshk – pishq, peshq, shteg – shtigje*, por në këtë funksion është më pak i përhapur se metafohia *a-e*. Në rrafshin gjermanik secili prej varianteve lidhet me kushte të caktuara. Në gjuhën shqipe kushtet e ndryshimit *e-i* nuk janë sqaruar saktësisht. Është thënë që e në rrokje të theksuar u ndryshua në *i* para disa bashkët., p.sh.: *mblidhni – mbledh, mbledhim; shisni – shesim; prift (presbyter), qind (centum)* etj.

Prej këndeje ajo nxirrte përfundimin se ka ngjashmëri me metafohinë gjermanike. Kronologjikisht ndryshimi *e > i* është më i vonë se ndryshimi *a > e* për pasojë kemi metafohinë: *dilni e delni nga dal, del, dalim, flitni, flas, flet*. Mendonte se, sadoqë kushtet konkrete të ndryshimit *e – i* në gjuhën shqipe mund të mos përputhen me kushtet përkatëse të shfaqjes analogjike në gjuhët e lashta gjermanike, karakteri i përgjithshëm i shfaqjes na lejon të flasim për paralelizëm tipologjik (Десницкая 1984: 238).

Ndryshimet historike tingullore të shqipes që kanë lënë gjurmë në

formimin e paradigmës foljore (*ō – ua, ue*) nuk kanë analogji të pandërmjetme me ligjësitë e ndryshimeve të zanoreve në gjuhët gjermanike; por, parimi i shkrirjes së ndryshimeve të zanoreve me prejardhje të ndryshme në një sistem më të lartë të kundërvënieve morfologjike, bashkë me afiksitet për krijimin e raporteve gramatikore paraqet zhvillim të përgjithshëm në gjermanishten dhe në shqipen. Ajo sqaronte po ashtu se fenomene të përdorimit të tipareve fonetike për arsye morfologjike ndeshen edhe në gjuhë të tjera IE, por me këtë sasi dhe sistematicitet ato janë bërë karakteristike për gjuhët gjermanike dhe për shqipen (Desnickaja 1984: 238). Kemi të bëjmë jo me mbetje të strukturave të trashëguara IE, as me zhvillime në saje të kontakteve të pandërmjetme historike, po me paralelizëm tipologjik të zhvillimit të strukturave gjuhësore në periudha më të vona (në mijëvjeçarin I të erës së re). Meqë kemi të bëjmë me gjuhë gjenetike të afra, sidomos kur ngjashmëritë kanë karakter specifik, nuk do të thotë të jenë të rastit (Десницкая 1984: 239).⁷⁵

Dhe më pastaj ajo vinte me vrojtimin e përgjithshëm: për gjuhësinë areale IE izoglosat tipologjike shfaqen me shkallë jo më të ulët të besueshmërisë se izoglosat leksikore.

Kështu dalim te përfundimi i rëndësishëm për prejardhjen e shqipes:

*“Lidhjet e lashta areale të gjuhës shqipe me hapësirën gjuhësore verieuro-piane përkojnë me lidhje areale, të rindërtueshme për ilirishten. Në pajtim me konceptin e zhvilluar në kohën e tij nga H. Krahe, idioma ilire e kohëve parahistorike (deri tek shpërngulja e një pjese të fiseve ilire në Ballkan) kontaktonte më afër me idiomat gjermanike, sllave dhe në mënyrë të veçantë me baltiken”.*⁷⁶

⁷⁵ Parimisht, ne nuk na duket krejt e pranueshme ideja e trashëgimit të tendencave të zhvillimit specifik midis gjuhëve të ndryshme edhe në kohë kur ato më nuk janë në kontakt midis tyre.

⁷⁶ “Drevnie arealnie svjazi albanskogo jazyka s severnoeuropskoj jazykovoj oblastju sootvetsvujut arealnym svjazam, rekonstruiuemym dlja ilirijaskogo. Soglasno koncepsii, razvivavšejsja v svoe vremja G. Krae, ilirijaskaja reč doistoričeskoj pory (do pereselenija časti ilirijaskih plemen na Balkany) bližajšim obrazom kontaktirovala s germanskoj, slavjanskoj i v osobenosti s baltijskoj”, Десницкая 1984: 239.

Për mendimin tim, vrojtimit e këtilla të Desnickaja-s sikur na thonë se konceptimet si ato të H. Krahe-s, sidomos në shqyrtimet pas viteve '50, ndryshe nga ç'mund të përfundohet në refuzimet *en bloc* të ideve të tij për këto çështje si pasojë e refuzimit të panilirizmit, mund të kenë një bërthamë me vlerë për shqyrtimet e raporteve midis atyre gjuhëve në lash-tësi. Prandaj le të shohim se ç'thoshte H. Krahe në veprën e tij *Sprache und Vortzeit*, që indikonte Desnickaja:

*“Po i morëm bashkë të dhënat e shpërndara në këtë pjesë, do të arrijmë në përfundimin se kontaktet e ilirishtes me baltishten (dhe pjesërisht me sllavishten) – pasi ta kemi marrë para sysh një herë mirë mangësinë e materialeve burimore ilire – kanë qenë mjaft të ngushta, dhe më të ngushta se ato që u përshkruan më parë të relacioneve midis ilirishtes e gjermanikishtes. Prej këndeje duhej të rridhte se paraardhësit e ilirëve dhe ata të fiseve balte për kohë më të gjatë do të kenë jetuar në fqinjësi në kufi të patrazuar dhe me komunikim reciprok dhe shkëmbim midis tyre”, Krahe 1955: 114.*⁷⁷

Krahe na kishte lënë dhe këtë përfundim të përgjithshëm lidhur me raportet midis ilirishtes e gjermanikishtes:

*“Përmes emrit Venedi/ Venethi u tregua se fiset ilire do të kenë qenë të njohura për germanët më së voni në kohën e Lautverschiebung të gjermanikishtes. Jo pak të dhëna të tjera gjuhësore shtohen këtu dhe ndihmojnë ta plotësojmë pasqyrën e raporteve të hershme iliro-germane” (Krahe 1955: 104).*⁷⁸

⁷⁷ „Nimmt man die in diesem Abschnitt ausgebreiteten Tatsachen zusammen, so wird man zu dem Schluß geführt, daß die Berührungen des Illyrischen mit dem Baltischen (und teilweise auch mit dem Slawischen) – zumal wenn man die Lückenhaftigkeit des illyrischen Quellenmaterials gebührend in Rechnung stellt – ziemlich eng gewesen sein müssen, engere noch als die zuvor beschriebenen Beziehungen des Illyrischen zum Germanischen. Daraus dürfte dann weiter zu folgern sein, daß die Vorfahren der Illyrier und die der baltischen Stämme lange Zeit hindurch in ungestörter Grenznachbarschaft und auch in gegenseitigem Verkehr und Austausch miteinander gelebt haben müssen“.

⁷⁸ „Am Namen der Venedi/ Venethi konnte bereits gezeigt werden, daß illyrische Stämme den Germanen spätestens zur Zeit germanischen Lautverschiebung bekannt waren. Nicht wenige andere sprachliche Tatsachen kommen hinzu und helfen das Bild früher illyrisch-germanischer Beziehungen zu vervollständigen“.

Kjo, nga ana tjetër, Desnickaja-s i dukej me interes për analogjitë, e pak më shumë lidhur me raportet e shqipes me gjuhët gjermanike, me supozimin e shumëgjashëm se shqipja është pasardhëse e ilirishtes.

Nxënësit e Desnickaja-s: Neroznak dhe Orel

Vladimir P. Neroznak më 1978 botoi veprën me vlerë për *gjuhët paleoballkanike*, të cilat (ndryshe nga termi konkurrues *ballkanistika antike* i përdorur në Rusi) i përkufizonte si gjuhë të botës së lashtë në Ballkan, të ndryshme nga greqishtja e latinishtja, për të cilat ishte rezervuar cilësimi *klasike*. Ndërkaq, gjuhët e arealit të Ballkanit të lashtë, përveç klasikeve – greqisht e latinisht, kanë qenë po ashtu indoeuropiane, ndërsa raportet midis tyre kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë objekt diskutimesh të shumta, pikërisht për shkak të kompleksitetit dhe informatave shumë të reduktuara për to. Një vend të veçantë në atë grup, qoftë gjuhësh të reja, qoftë të lashta, zënë gjuha shqipe, greqishtja dhe armenishtja. Për shqipen mendohet se ajo është vazhdim i njëres prej gjuhëve të lashta ballkanike, mbi të gjitha ilirishtes, greqishtja është vazhdim i greqishtes së lashtë që njihet mjaft mirë, ndërsa për protoarmenishten mbisundon gjykimi që do të ketë qenë e afërt me frigjishten, siç thoshte dhe tradita lashtogreke (Herodot-i, Strabon-i). Por përmenden në Ballkanin e lashtë një radhë të ashtuquajturash ‘*gjuhë të vogla*’, ‘*gjuhë onomastike*’ etj., gjuhë të izoluara IE me material të paktë të ruajtur: frigjishtja, mezishtja, dakishtja, trakishtja, paragreqishtja (pellazgjishtja), makedonishtja e lashtë, ilirishtja, mesapishtja, venetishtja. Nga fundi i mijëvjeçarit II nga Europa Qendrore, në veri të Danubit, por pa qenë në gjendje të saktësohet më shumë, në Ballkan, në hapësirat e sotme shqiptare kishin depërtuar paraardhësit e mesapëve, si valë e dytë e fiseve ilire, që ishin vendosur dhe më herët aty – *Illyrii proprie dicti*. Hapësira ilire, pas tij dhe pas studimeve të Alföldy-t, Kronasser-it e Katičić-it, në aspektin gjuhësor do të ketë qenë e përthyer në zona dialektore – ilirishte e mirëfilltë, dalmate, liburne e panone. Në fillim të mijëvjeçarit të parë para K. në Italinë e Juglindjes nga hapësira ilire u shpërngulën fiset mesape; gjuha e tyre mund të trajtohet si e afërt me

ilirishten ballkanike dhe shqipen (Нерознак 1978: 7-10).

Meqenëse më duket mjaft realist, konceptimi i tij për gjuhët e Ballkanit të lashtë e meriton të paraqitet më tej. Nga mesi i mijëvjeçarit II para K., në veri dhe lindje të Siujdhesës Ballkanike banonin fiset trakase dhe dakase, në Makedoni (koncept pak më i gjerë se Maqedonia e sotme) banonin makedonasit, frigasit dhe protoarmenët, në jug me kohë ishin banorët paragrekë (pellazgë), ndërsa në perëndim dhe në veriperëndim, së pari në hapësirat e sotme të Shqipërisë dhe të Epirit banonin ilirët dhe mesapët dhe në jug të makedonasve, përfshirë dhe Peloponezin e ujëdhelat qysh nga fundi i mijëvjeçarit III ishin fiset greke. Në bazë edhe të informatave që vinin nga Egjipti, mund të thuhet po ashtu se këto fise, kultura e gjuhë mund të kenë pasur kontakte me pjesët e Azisë së Vogël – hetitet sidomos rreth Trojës, ku do të ketë pasur shpërngulje të hershme frigasish, dardanësh e trakasish dhe ekspansion grekësh – jonikë e eolianë. Kështu, sipas Neroznak-ut, në hinterlandin e Azisë së Vogël rreth sh. XII-X para K. u formua një zonë e arealit gjuhësor paleoballkanik, ku përfshiheshin grupet protoarmene, frigase, trakase (bitino-meze) dhe dardane. Vetëm frigasit nuk kanë lënë pjesëtarë fisesh të tyre në Ballkan. Mendohet se fiset që në burimet antike njihen si *Βριγες* kanë qenë të afërta me frigasit, por ka studiues që i marrin për ilirë (Нерознак 1978: 10-11).

Situata gjuhësore e fiseve paleoballkanike nuk është krejt e qartë. Për dardanët, peonët e migdonët, që përmenden qysh te Homeri, ka ndërdymje: sa i përket gjuhës, disa i marrin për ilirë, të tjerë për trakas. Përmendte dhe mendimin e Georgiev-it, pas të cilit peonët shprehnin më shumë shtresa etnike paleoballkanike: me prejardhje frigase, me një superstrat të vonë ilir, me substrat mez e trakas, po me ndikim të fuqishëm makedon.⁷⁹ Sipas tij, gjuhët e tilla paleoballkanike kanë për gjuhët e Ballkanit të lashtë dokumentim epigrafik: frigjishtja (mbi 100 mbishkrime të vo-

⁷⁹ Në kohë të vona, pas botimit të këtij libri, gjithnjë e më shumë ka studiues që me këto etiketa shënojnë gjuhë të veçanta. Shih Koedderitzsch, Sergent, Duridanov, etj. Sido që të jetë, materialet gjuhësore janë të reduktuara, pos atyre onomastike – prandaj dhe janë quajtur ‘gjuhë onomastike’.

na dhe 89 mbishkrime frigase të lashta), mesapishtja (mbi 300 tekste), trakishtja (rreth 10 mbishkrime), mezishtja (një mbishkrim); të tjerat janë gjuhë pa traditë epigrafike, me një korpus onomastik dhe disa elemente të leksikut apelativ, glosa – makedonishtja e lashtë, ilirishtja, dakishtja, paragreqishtja (pellazgjishtja) dhe gjuhët onomastike – dardanishtja, peonishtja e migdonishtja. Pra, në pjesën jugore të hapësirës qendrore gjuhësore indoeuropiane mund të mendohet për një zonë të veçantë dialektore ‘paleoballkanike’. Mund të thuhet se, lidhur me ndarjen e gjuhëve IE në *centum/ satəm*, apo *perëndimore/ lindore*, ato paraqisnin një hapësirë të veçantë, ku mbisundonte tendenca e asibilimit të qiellzoreve prapagjuhore IE, pos në pozitë para sonanteve. Por skema *centum/ satəm* mund të duket e diskutueshme lidhur me këto gjuhë, siç shihet tek ilirishtja: Jokl, A. Mayer, Hamp, Russu (do të shtonim Cimochofski) e mbajnë për *satəm*, ndërsa Hirt, Krahe, Pokorny e mbajnë për *centum*, *Нерознак* 1978:11-13.

Studimet e vona janë marrë dhe me raportet e gjuhëve paleoballkanike – të trakishtes, mesapishtes, ilirishtes, frigjishtes. Janë diskutuar problemet që lidhen me substratin paleoballkanik në gjuhët ballkanike e posaçërisht me prejardhjen e gjuhës shqipe, si të vetmit vazhdues të gjuhëve paleoballkanike. I dukej i dyshimtë supozimi për një lidhje gjuhësore lashtoballkanike si ‘*zonë kalimtare indoeuropiane*’. Por të dhënat që disponojmë lejojnë të supozohet një zonë e tillë. Pikërisht venerimet lidhur me reflekset e palataleve dhe në pozita të veçanta fonetike, lidhur me labiovelaret apo dezaspirimin, i japin atij të drejtë të nxjerrë përfundimin se kemi të bëjmë me një zonë kalimtare indoeuropiane paleoballkanike midis gjuhëve lindore e perëndimore. Lidhur me reflekset e palataleve në shqipen ruhen shembuj depalatalizimi para sonanteve (*kluhem, mjekër, vjehër*), ashtu si dhe lidhjet e veçanta me gjuhët baltike e sllave në këtë aspekt, që flasin vetë. Ndërkaq, sa i përket tiparit të dezaspirimit, trakishtja, frigjishtja, protoarmenishtja e paragreqishtja e kanë ruajtur atë tipar. Diskutimi i mëtejshëm për labiovelaret dhe elementet e tjera të veçanta, i jepte të drejtë të veçonte një zonë gjuhësore indoeuropiane të quajtur “*gjuhë paleoballkanike*” (*Нерознак* 1978: 18-20).

Sipas Neroznak-ut, dëshmitë kulturo-historike dhe gjuhësore flasin se ilirët dhe mesapët qysh në pjesën e parë të mijëvjeçarit I para K. kanë jetuar në Ballkan në hapësirat e Shqipërisë dhe të Jugosllavisë së viteve '70 (1978). Megjithë mungesën e të dhënave gjuhësore, mesapishtja e ilirishtja paraqesin izoglosa në rrafshet fonologjike, morfologjike e leksikore midis tyre dhe me shqipen. Izoglosat e tilla

*“na lejojnë të shfaqim mendimin se, mesapishtja, ilirishtja e protoshqipja janë zhvilluar nga e njëjta përbërje gjuhësore, të cilën ne kushtimisht e quajmë gjithilirishte”.*⁸⁰

Këtë entitet ai do ta quante po ashtu *paleoballkanishte perëndimore* në raport me *paleoballkanishten lindore* (trakaishte, frigishte, makedonishte e lashtë). Midis tyre po ashtu ka pasur një hapësirë kalimtare: dardanishtja, peonishtja, liburnishtja, migdonishtja, që njihen vetëm nga onomastika (Нерознак 1978: 160-161).

Cilat janë tiparet, izoglosat që i bashkojnë këto gjuhë? Neroznak-u numëronte vijueset:

1. Këtu hyn para së gjithash asibilimi i qiellzoreve prapagjuhore. Në pozitë para sonanteve qiellzoret velarizohen, ashtu si në frigishten, me analogji edhe në baltishten e sllavishten, më tej në tokarishten. Shembuj për kontekstin para sonanteve: *mjekrë, ka < *karŷ-*, lit. *kárvė* 'lopë', prus. e vj. *sirwis* 'dre'; *gardh; quaj, quej < *klu-*; *qull < *klu-lo*, gr. *κλύζω; qumësht, klumësht*, f. 161.
2. Zhvillimi i **bh, *dh, *gh* IE > *b, d, g* dhe shkrirja e tyre me mbylltoret e zëshme, si izoglosë paleoballkanike përfshin edhe baltishtet, sllavishtet, gjuhët keltike, gjuhët gjermanike dhe iranike;
3. Sistemi treanëtarësh i zanoreve IE **e, *a, *o* u zhvillua në dyanëtarësh: **e, *a*;
4. *tj, dj* dhanë *s, z*;
5. në mesapishten, ilirishten e shqipen u ruajt refleksi i labiovelareve;
6. në ilirishten e mesapishten dhe në protoshqipen theksi ishte proparoksiton, prandaj në shqipen kemi theksim paroksiton: *DYRRACHIUM > Durrës*, mesap. *Brundisium*, it. *Brindisi*. (Нерознак 1978: 161-162).

Megjithë ndryshimet e mëdha morfologjike që ka pësuar shqipja, ashtu si studiues të tjerë, ai mendonte se mund të vërehen ngjashmëri

⁸⁰ “... pozvoljaet nam vyskazat'ь mnenie, čto mesapskij, iliriskij i protoalbanskij razvilis'ь iz ednogo jazykogogo sostojanija, kotoroe my uslovno nazovem obščeiliriskim”.

midis ilirishtes, mesapishtes e shqipes në fjalëformim: prapashtesa *-ini-um* te *Ulcinium*: shq. *-inj*: *kërminj*, *thelpinj*; *-este*, *-esta*, *-iste*: shq. *-(e)shte*; prapashtesa etnonimike *-at*: *Labeates*, *Autariate*, shq. *Demat*. Vërente po ashtu ngjashmëritë e mesap. *venian* akuz. ‘i tij’ < **swei-no*, shq. *ve-të*, etj. Këtu ai nuk mund të mos hetonte idetë e shprehura edhe te Hamp, Çabej, Domi, etj. Nga të gjitha këto ai nxirrte përfundimet:

“1. *Shqipja, ilirishtja e mesapishtja shfaqin raporte të ngushta gjenetike që të çojnë te njësia gjuhësore gjithilire; 2. Ato i përkisnin zonës paleobalkanike të hapësirës gjuhësore indoeuropiane; 3. Më të ngushta dalin lidhjet e tyre areale me gjuhët indoeuropiane veriore, baltishten, sllavishten, gjermanikishten dhe keltishten*” (Hерознак 1978: 162).⁸¹

Ndër burimet ilire ai përmendte glosat: *Devadaj*, teonim, nga IE **dheua-* ‘nositsja, kruzhitsja vihrem’, gr. *θύω* ‘prinostitë v zërtvut’, khs. Me *Διάλος* ‘Dionisi te peonët’ sipas Hezikut; sipas Krahe, Spr. I11, 38; *rinos* ‘oblaka’: *Οί λέγουσιν Ἰλλυριοὺς ῥινον λέγειν τὴν ἀχλὺν* ‘thuhet se tek ilirët fjala ῥινον është errësi’, ndërsa jepet krahasimi me ῥινον që tek enetët do të thotë ‘re’ dhe kjo krahasohet me shqipen *rê*, *ren*; Sabaia, *sabaium* ‘pije, **sab-* ‘lëng’, ind. e vj. *sabar*, gjerman. *Sapa-*, tek trakasit *Σαβά-ζιος* për Dionisin, zot i verës; *sybina* ‘ohotniçje κορβέ’, krahasohet me armenishten *suin*, e huazuar dhe në greqishten, pastaj *dranis* – *drê*, etj. f. 162-3. Ndërkaq te mesapishtja shënonte elementet vijuese:

balakraihiaih, gjin. njëjës nga **Balakros*, mak. *Βάλακρος*, gr. *Φάλακρος*; *bal-* < IE **bhel-* dhe *akros* < IE **ak’r-*, gr. *ἄκρος* ‘i ashpër’, *ἄκρον*. *k’* ruhet si velare në pozitë para sonantes.

βαρδῆν, *βάρ(υ)κα*, krahasohet me shq. *bark*, *bars*, *mbars* < **bher-* ‘bie’, mbase edhe me lat. (ilirishte) *equae bardiae*, sipas Çabej, BUSHT 4, 1958: 45.

berain < **bheroint* ‘të bie’, *φεροίντο*; *beran* < *IE **bherant*, lat. *ferant* nga IE **bher-* ‘bie’, frig. *Abberet*, shq. *bërë* (sic!) nga *bie*, mbase *bjerë*.

bilja, *biliva*, shq. *bije* (Sic! *bijë*), dial. *bile* (*bilë*), *bir*.

βίσθην – nga IE **bhei-* *bhī-*.

βρένδον. *ἐλαφον*, Hesiku ‘dre’: “...τῆ Μεσσαπία γλώττη βρέντιον ἢ κεφαλὴ τοῦ ἐλάφου

⁸¹ “1. Albanskij, iliriskij i mesapskij javljajut tesnejšie genetičeskie otnošenija, voshodjaščie k obščeilirjskomu jazykovomu sostojaniju; 2. Oni vohodili v paleobalkanskuju zonu indoeuropejskoj jazykovoju oblasti; 3. Najboljee tesnymi javljajutsja ih arealjnje svjazi s severnymi indoeuropejskimi jazykami, baltijskimi, slavjanskimi, germanskimi i keljtskimi”.

καλεῖται” – Straboni “në gjuhën mesape *βρέντιον* quhet koka e drenit”, mbase etnonim me prejardhje totemike, e krahasonte me *Dauni* ‘ujqit’; G. Meyer-i e krahasonte me shq. *brini, briri*, ashtu si dhe emrin e lashtë *Brindisi, Brundisium, Βρεντέσιον*, mesap. *brent/d-* < IE **bhren-t-*. *Klaohi, klohi*, urdhërore ‘dëgjo’ < IE **k’leu-sīt*, lit. *klausýti*, prus. e vj. *klausiton*, shq. *kluhem, quhem*, sll. e vj. *слышаму*.

tabara, thabara ‘жреу’, si *ta-*, *-bara-* < **bher-* ‘bie’.⁸²

Fjalët e tjera ose s’kanë etimologji shpresëdhënëse, ose lidhen me onomastikë, por ka një numër përkimesh me fjalët që gjenden te fjalori i Hezikut, f. 166-167.

Në përgjithësi, Neroznak mendonte se elementet leksikore paleo-ballkanike në gjuhën shqipe ishin trajtuar më së miri te Çabej. Në atë vazhdë ai jepte elementet jo të numërta të leksikut apelativ dhe shtresën e rëndësishme të onomastikës ilire: *Tergeste, Tergolape, Opitergium*, por edhe fjalën *tergitio* nga mbishkrimi latin *Tergitio Negotiator*, ku, pra, *negotiator* = “tregtar”; *Tragurion, Tragurium* – qytet në Dalmaci, f. 191; *Δέλμιον.πδίων μελόβοτον, Delminium, Dalmatia* – shq. *dele, delme*, baza *dal-, dalm-* (referonte Katičić); toponimi *Dardania* (*Dardi* në Apuli), etnonimi *Dardani* – shqip *dardhë* (referonte Çabejnë); përkimet në emërtimin e popullit të Ptolomeu *Ἄλβανοί* me *Arbën, Arbër*; fjala *πελίας, πελίους* për shënimin e pleqve – shqip *plak; μανυμικρόν* te Heziku ‘i vogël’ e krahason me shqipen e vjetër *mangu i sutese* te Buzuku, *Нерознак* 1978: 192.

Do të shohim më poshtë se afërsisht ky fond të dhënash njihet dhe pranohet edhe ndër ata që kanë mendim tjetër lidhur me raportet e mundshme shqipe/ ilirishte.

Vladimir Orel, pas një numri studimesh të veçanta, në vitin 2000 botoi veprën sintetizuese *A Concise historical Grammar of the Albanian Language. Reconstruction of Proto-Albanian*, Brill, Leiden. Boston. Köln, ff. 332, ku synonte të bënte një përshkrim të detajuar të zhvillimit gjuhësor nga proto-indo-europianishtja te proto-shqipja e te shqipja moderne. I interesonin sidomos kalimi nga indo-europianishtja te proto-shqipja dhe korrespondencat midis proto-shqipes dhe shqipes moderne. Dy nocione qendrore të veprës së tij janë: *proto-indoeuropianishtja* dhe *proto-shqipja*. Proto-indoeuropianishtja që përdorte ai është gjendja e fundit në zhvi-

⁸² Gati të gjitha këto njihen në albanistikë dhe më herët.

llimin e gjuhës, gjendje në të cilën tashmë kishin ndodhur ndryshime si bjerrja e laringaleve IE. Ndërkaq proto-shqipen e shihte si gjuhë që tashmë kishte marrë disa tipare tipike për tipin gjuhësor shqip, f. XII. Dhe rindërtimi që do të bënte ai ka dy forma: proto-shqipja e hershme menjëherë para fillimit të kontakteve gjuhësore me folësit e latinishtes/ proto-romanishtes (sh. I pas K.) dhe proto-shqipja e vonë, pas kontakteve me proto-romanishten dhe dialektet e vjetra sllave ende të afërta me proto-sllavishten (sh. 6-7 pas K.). Të gjitha këto do t'i bënte duke u mbështetur në hulumtimet vetanake dhe te Meyer, Pedersen, Jokl, Çabej e Hamp. Sa i përket proto-indoeuropianishtes, ai saktësonte se do të operonte me atë që shënohet si *'indoeuropianishte e vonë'* apo *'brugmaniane'*, çka do të thotë se nuk do të merrej parasysh rindërtimi që del nga krahasimi me hetitishten e tokarishten.

"Shqipja është prodhim i kësaj 'indoeuropianishteje të vonë' dhe dukej kundërproduktive që rindërtimin tonë ta bënim më thellë se ç'është realisht e domosdoshme", f. XIII.⁸³

Edhe pse thoshte që pozita e shqipes midis gjuhëve të tjera indoeuropiane nuk do të diskutohej, në pjesën e leksikut ai përvijonte izoglosat në këtë kuadër. Kështu, grupi i izoglosave me gjuhët indoeuropiane veri-lindore, sipas tij, kishte rëndësi të skajshme për vendosjen e shqipes, ato izoglosa janë më të numrëtat në raport me çdo grup tjetër, me përjashtim të greqishtes. Këto izoglosa pasqyrojnë, mendonte ai, dy tipare themelore të leksikut të shqipes: shkalla e madhe e afrisë me baltishten dhe një periudhë e gjatë e ekzistencës së përbashkët me balto-sllavishten diku në Europë (Qendrore apo Juglindore?). Izoglosa të përbashkëta të shqipes me grupin gjermanik-balto-sllav i dalin po ashtu të numërta. Pak prej tyre lidhen me drurin apo objekte prej druri.

Mendoj se në përgjithësi nuk kemi ndonjë risi të madhe në këtë fushë, meqë izoglosat leksikore ishin konstatuar dhe më herët, ndërsa një pjesë e etimologjive të sjella si argument mund të lërë për të dëshiruar.

⁸³ "Albanian is a product of this 'late Indo-European' and it seemed counterproductive to make our reconstruction deeper than really necessary".

Raportet mesapo-shqipe të para nga Matzinger

Tash vonë për çështje të mesapishtes në raport me ilirishten ballkanike dhe me shqipen ka pasur sprovë studimi nga M.-M. Rădulescu dhe nga J. Matzinger.⁸⁴ Meqenëse ky i fundit i ka pasur parasysh dhe diskutimet e mëparme, do të mjaftohemi vetëm me evidencimin e disa vërejtjeve të tij. Mendoj se në tërësi në këtë gjendje kjo çështje vështirë se mund të çohet më larg se diskutimet që tashmë janë bërë, sa kohë që nuk kemi interpretime më të kënaqshme të mbishkrimeve ekzistuese apo mbishkrime të reja, ose ndonjë dokumentim tjetër për ilirishten apo gjuhët e tjera paleobalkanike në të dy anët e Adriatikut. Siç mund të shihej në dy interpretimet tashmë të përmendura, apo dhe në ato që janë nisur nga një këndvështrim më specifik albano-ballkanologjik (Çabej, Hamp, Rădulescu, Pellegrini, etj.), pa dashur të merremi me komentimet e specialistëve të mëdhenj të çështjes mesapike dhe të mbishkrimeve të kësaj gjuhe, si Parlangeli, Santoro, Pallotino, Haas, De Simone, Lazzeroni, Lombardo, Prodocoimi, etj. Në gjuhën shqipe tashmë janë të njohura pikëpamjet e E. Çabejtë, më tej të E. Hamp-it të përkthyer tash vonë e ndonjë informacion tjetër në këtë drejtim. Sh. Demiraj ka dhënë një pasqyrë mjaft të qartë të gjendjes së studimeve në raport me shqipen, po ashtu.

Studimi i J. Matzinger-it është provë e re kritike për të paraqitur gjendjen e studimeve në fushën e hulumtimit të raporteve midis mesapishtes dhe shqipes, jo për mesapishten në tërësi. Për ta bërë këtë punë ai qysh në fillim jepte njoftime për gjendjen e dokumentimit të mesapishtes, për hipotezat për lidhjet e saj me ilirishten që nuk është dokumentuar me asnjë mbishkrim (pos me disa glosa dhe shumë emra njerëzish, vendesh, etj.), ashtu si dhe për hipotezat për lidhjet e mundshme të asaj gjuhe me shqipen të dokumentuar vetëm pas sh. XV, e kjo do të thotë edhe për hipotezat për lidhjet e mundshme të shqipes me ilirishten dhe për autoktoninë e saj relative aty ku flitet sot. I njohur si mbështetës i tezës për grupin

⁸⁴ Matzinger (2005), Joachim: *Messapisch und Albanisch*, in *International Journal of Diachronic Linguistics and Linguistic Reconstruction* 2, 2005, pp. 29-54:.

e veçantë të gjuhëve të lashtësisë të quajtur *Balkanindogermanisch*, ku përfshihen greqishtja, armenishtja, frigjishtja dhe shqipja, Matzinger bën fjalë edhe për mundësinë që aty të përfshiheshin edhe gjuhët epihorike si trakishtja, dakishtja, e pse jo edhe ilirishtja, ashtu që të shihet mundësia e lidhjes midis shqipes e ilirishtes, e me këtë edhe mesapishtes, si një gjendje më e hershme kohore. Për të parë se çfarë lidhjesh mund të hetohen midis mesapishtes dhe shqipes, ai, duke u mbështetur në materialin leksikor apelativ që mund të veçohet, përpiket të japë një pasqyrë të përmbledhur. Së pari përmbledh të dhënat specifike për mesapishten: gjuhë e dëshmuar me mbishkrime dhe pak glosa antike (nga sh. VI-I para K.), ku mbisundon materiali onomastik dhe shumë pak forma foljore. Kuptohet, jo çdo herë interpretimi i mbishkrimeve mund të merret si i sigurt. Shqipja, nga ana tjetër, është gjuhë e *Kohës së re* (term i tij), me dëshmi të shkruar nga sh. XV pas K., kështu shkallët e parahistorisë së saj mund të arrihen vetëm me rrugë të rindërtimit krahasimtar dhe të rindërtimit të brendshëm. Shqipja ka pasur një ndikim të fuqishëm latin, kështu që shumë fjalë të trashëguara IE të saj nuk hetohen mirë. Bën vërejtjen se kapërcimi i këtyre vështirësive për shkak të distancës kohore dhe të tjera do të ishte më i lehtë sikur të kishim më shumë material të krahasueshëm nga fushat gramatikore, sepse leksiku në këtë fushë nuk është gjithnjë stabil.

Sa i përket kuptimit, vetëm pak nga të dhënat leksikore të mesapishtes shihen si të përcaktuara. Matzinger-i bën një përzgjedhje subjektive midis barazimeve ekskluzive mesapo-shqipe, po edhe ndër të tjerat që mund të afrohen me shqipen, por që nuk merren si ekskluzive, po mund të shihen në një kuadër më të gjerë indoeuropian.

Ndër barazimet ekskluzive ai numëronte:

ara- (në *...datoria marta pido vastei basta venian aran...* “datoria Marta i kaloi (dha) qytetit Basta arën e saj”): krahasohet me shq. arë (<uralb. **arā-*); përmes detajeve të diskutuara gjerësisht lidhur me rindërtimin IE atij i dilte se mesap. *ara* dhe shqipja *arë* pa probleme tingullore apo formale mund të shpihen te një paraformë e përbashkët dhe kështu të japin një ndërtim të përbashkët vetëm për këto dy gjuhë.

bilja ‘bijë’ (në *...plastas moldatðehiai bilia etðeta hipades aprod|j|ta* “Etðeta, e bija e Plazet Moldatðes, ka dëshmuar për Aphroditën”), një nga barazimet më frapante, sipas tij, midis mesapishtes dhe shqipes, vetëm midis këtyre dy gjuhëve.

βρέndon “dre”, *βρέντιον* “koka e drerit”, *Brundisium* (emër vendi), fjalë që sipas autorëve antikë në mesapishten përdoren për të shënuar “drerin” dhe “koka e drerit”, krahasohen me shqipen *bri*, *brî*. Më tej jepte rindërtimet dhe detajet lidhur me to.

**Menzanas*: (në Sallentini, pud qos *Menzanae* lovi dicatus vijos [sc. equos] conicitur in ignem, ku, në përshkrimin e flijimit të kalit, lupiteri shoqërohet me epitetin *Menzana*, e krahasueshme vetëm me shqipen *mëz*, *mâz* < **mend-jo*, por krahasime, pas tij, mbi bazën **mend-* mund të ndeshen edhe në gjuhë të tjera IE.

ῥῥός, glosë ilire për “mjegull, re”, e përhapur përmes mesapishtes, krahasohet me shqipen *re*, *rê*, megjithë diskutimet e gjera të detajeve, mendonte se mbetet të bëhen hulumtime të mëtejme.

Këto pak barazime ekskluzive do të duhej që në fushën e leksikut të jepnin një indicie për një lidhje midis mesapishtes e shqipes, mendonte Matzinger (2005: 38). Bie në sy se të gjitha këto barazime janë shënuar me kohë në tërë literaturën albanistike, shih dhe *Neroznak* më sipër.

Si barazime joekskluzive, me shtrirje dhe në gjuhë të tjera IE jepte:

ana “nënë” (fjalë fëmijësh, *âmë*, *ëmë* < **amma*); *anda* “në” (*ëndë* < **en-do*); *apa* “prej” (*për-apë* < **apo*); *d(e)iva-*, atribut i emrave të perëndive; *in* “në” < **en*; *ma* “mos” – shq. *mos*; *veina* “i veti” (... *veinan aran*); *zis* “Iuppiter” < **djēs*, Matzinger 2005: 38-39.

Nga elementet morfologjike, kryesisht nominale, sepse në materialet mesape mungojnë elementet verbale, mundësitë për krahasim të mesapishtes me shqipen, sipas Matzinger-i janë:

- gjinorja me (a)*ihi*, IE **-osjo* > **-ahja* > **-ahje* > **-aihije* > **-aihe* > *-aihi*; edhe gjinorja e shqipes me *-i* (e shq. *-it*) mund të çohet te kjo mbaresë nga fusha përemërore;
- shumësi dhanore (-rrjedhore) i mesapishtes me *-bas* < **b^has* dhe më tej rasa mjetore *-bas*, *-bis*; në shqipen nuk ka gjurmë të rasave IE me *b^h*. Por shumësi i rrjedhores *-sh* del nga vendorja shumës **-si*, ndërsa kjo pas ‘prepozicionalit’ të shqipes së lashtë del në vend të shumësit e njëjësit të mjetores IE **-oh₁*, **-o₁s* (në mesap. kjo del si *-ais*);
- në mesapishten, pos përemrit të pakufishëm *kos*, ndeshen gjurmë të përemrave dëftorë **so/to*, dhanore, njëjës, mashkullore *toj*, fem *tai* dhe kallëzore njëjës femërore *tan*; **so/to-* në shqipen përbën bazën e njëjës së prapavendosur emërore, njëjës, mashkullore *-i*, *-u* (< **-sa*), gjinore njëjës mashk. *-t* (< **-tosjo*); Matzinger 2005: 40-41.

Përfundimi i tij në këtë pjesë është: morfologjia emërore nuk jep mbështetje për të vendosur shqyrtimin e raporteve midis mesapishtes dhe shqipes. Në të dyja gjuhët ndeshen morfema që ndeshen në të gjitha gjuhët e tjera IE. S’ka diçka ekskluzive për mesapishten e shqipen.

Në fushën e foljeve në mbishkrimet e mesapishtes ka vetëm pak material të krahasueshëm me të shqipes:

dëshirorja: në korpusin mbishkrimor gjenden dy forma – *berain* (v. 3sh.) “i sjellshin” < **bher-o-ih₁-nt* dhe *kl(a)ohi* (v. 3 nj. aor.) < **kle_u.s.i-t*; dëshirorja e shqipes po ashtu me një mbaresë *-(f)sha, -(f)she, -(f)të*, që, sipas tij, të çon te **s-ī* < **s-ih₁*;

aoristi: *hipades* (v. 3 nj. ind.) “dëshmoi”, që zëvendëson një aorist *s-* **supo dheh₁-s-t*, pastaj *stahan* “vendoj” **stah₂-s-nt*, etj; shqipja ka aorist IE që u zhvillua në mënyrë sinkretike me perfektin IE, si te **doh₃ – dha*, Matzinger 2005: 42-3;

perfekti: mesapishtja, sipas tij, shfaq shenja të një ndërtimi preterital me *-u-* (tek *dupave, eipeigrave, ipigrave, eipigravan*, pastaj *hadive, (ni)ligaves*. Por shqipja nuk shfaq shenja të ndërtimeve preteritale *-u-*, sepse, sipas tij, te ndërtimet e aoristit *°o-va, °e-va* të foljeve vokalike me *°on, °en*, qëndron një *-u-* që shfaqet pas rënies së **-h-* ndërzanore (< IE **-s-*), kështu që format e aoristit me *°o-va, °e-va* janë vazhdim i ndërtimeve më të vjetra aoristore me *s-*, Matzinger 2005: 44.

Në fushën e foljeve mesapishtja e shqipja ndërlidhen përmes optativit, por kjo nuk përbën ndonjë raport ekskluziv. Përveç përkimeve lidhur me ndërtimin e aoristit me *-s-*, që del dhe në shumë gjuhë IE, mesapishtja ruan ndërtime preteritale të tipit *u-*. Në morfologjinsë e foljes ngjashmëritë midis mesapishtes e shqipes mund të shihen si dëshmi kumulative përbri përkimeve leksikore, ndërsa më vete s’kanë peshë, mendonte ai.

Ndër të dhënat tingullore, Matzinger-i shënonte që lidhur me ndarjen tashmë tradicionale *centum/satem* në mesapishten ka pasiguri. Si elemente që flasin për karakterin satem përmendte:

emri *Barzida*-l nëse do të lidhej me **b^hrh₁ĝ-id₁o*, nga rrënja IE **b^hreh₁ĝ*, e kjo me ilirish-ten *Bardus, Bardyl(l)is*; po ashtu leksema *delaran^ooa*, nëse nga **ĝer(h₂)ont₁°* (khs. gr. *γερυσία*). Se edhe në mesapishten do të jenë ruajtur të veçuara të tri radhët e tektaleve mund të tregojnë shembujt si përemri i pakufishëm *kos*<**k^wo-*, apo lidhëza *-ŋi*, nëse merret se del nga *k^we*; një element të posaçëm paraqet në këtë fushë trajtimi paralel i tektaleve në kontakt me sonantet **l, r/*, ku del një trajtim në të dy gjuhët centum: *klaohi*< **kle_u-s-ī-t*, apo emri pers. *balakrahiu-*, mbase nga **ḷro-*. Khs. shqip *quan*, geg. e vj. *kluon*<**kl_u-eh₁*, ose *gju*, geg. *gjû* <**ĝluno*-<**ĝnuno-*, Matzinger 2005: 46.

Sipas tij dhe të tjerëve, ruajtja e mundshme e tri radhëve të tektaleve ashtu si depalatalizimi para sonanteve e lidh mesapishten me shqipen. Derisa ruajtja e radhëve të tektaleve ndeshet dhe në gjuhë të tjera IE, zhvillimi **kr* në **kr* del vetëm në mesapishten e në shqipen, kështu që kjo paraqet një veçori ekskluzive, Matzinger 2005: 47.

Afritë e shënuara midis mesapishtes dhe shqipes së regjistruar vonë, sipas Matzinger-it, mund të interpretohen në dy mënyrë: në njërën anë, mund të quhen bashkarisht si ‘ilirishte’, pra mesapishtja si e shkëputur nga ilirishtja dhe shqipja si e folur më vonë në hapësirë ilire. Nëse ilirishtja mund të merret në konsideratë si paraardhëse apo si gjuhë e kon-

taktit me shqipen, mbetet e paqartë. Një shpjegim tjetër, sipas tij, për lidhjet midis mesapishtes e shqipes do të mund të kërkohej dhe në kuadër të *Balkanindogermanisch*, meqë gjuhët e hapësirës ballkanike kanë qenë të lidhura ngusht midis tyre brenda grupit të quajtur ashtu dhe në suaza të Sprachbundit ballkanik, ku përfshihej dhe ilirishtja, raportet midis mesapishtes e shqipes në atë rast duan parë në një rrafsh kronologjikisht më të hershëm. Edhe pse ndarja e hershme, dokumentimi i vonë i shqipes etj. krijojnë vështirësi të mëdha për dëshmime, cilësia e përkimeve në fushën e leksikut flet për të mirë të supozimit të raporteve midis mesapishtes e shqipes, përfundonte Matzinger-i. Ai nuk arrinte të pëfundimi për rindërtimin e një grupi *gjithilir*, ku do të kenë përkatur mesapishtja, ilirishtja e jugut dhe shqipja, si bënte Neroznak në vitet '80 të sh. XX.

Vrojtimet e Harvey Mayer-it për raportet e shqipes me baltishten

Veçimi i grupit të gjuhëve indoeuropiane verieuropiane NWEIE nga ana e Hamp-it në vitet '90 sikur që një shtysë për vështrime të tjera. Harvey Mayer, indoeuropianist-lituanist në një sërë artikujsh në revistën *Lituanus* ka kërkuar të shpjegonte raportet e mundshme midis shqipes, gjuhëve baltike dhe gjuhëve sllave. Interpretimet e tij mbështeteshin në dy baza: në një anë i elaboronte raportet midis trakishtes-dakishtes e gjuhëve baltike e sllave, duke u mbështetur te Duridanov,⁸⁵ ndërsa në anën tjetër i hulumtonte raportet e mundshme strukturore midis para-shqipes dhe para-sllavishtes e para-baltishtes (studimet e tij përqendroheshin te reflekset e mundshme të segmenteve tingullore IE *sk-*, *ks-*, pastaj të sonanteve, etj. në shqipen, në një anë, dhe në baltishten e sllavishten, në anën tjetër. H. Mayer supozonte dhe argumentonte se trakishtja do të ketë qenë më e afërt me baltishten, duke e quajtur këtë grup hipotetik "*baltoid*", ndërsa para-shqipja (në këtë rast, sipas tij, ilirishtja e mesapishtja) më e afërt me sllavishten, duke e quajtur atë grup hipotetik "*albanoid*". Në këto interpretime ka shumëçka të pasaktësuar dhe të supozuar, por

⁸⁵ Shih Дуриданов 1976, Иван: *Езикът на Траките*, София.

është me interes të shihet se deri ku mund të shkojë diskutimi i raporteve të hershme të shqipes me baltishten e me sllavishten.

H. Mayer diskutonte një çështje të fonetikës historike: rikthimin e aspirimit dhe në këtë pikë e shihte dallimin midis baltishtes, në një anë, dhe sllavishtes e shqipes, në anën tjetër. Fjala është për supozimin se, sipas tij, para-sllavishtja e hershme dhe para-shqipja e hershme kishin ruajtur grupet *sk-* dhe *ks-* nistore, ndërsa para-baltishtja e hershëm kishte ruajtur vetëm grupin *sk-*; kjo do të ketë ndodhur pas dezaspirimit të supozuar si shkallë e glotalizimit; supozohet se para-baltishtja ishte më shumë kundër aspirimit dhe më glotalizuese; atje ku kishte tendencë të kthimit të *s-së* në *h*, para-baltikët, përmes metatezës së *ks-* në *sk-* e parandaluan di-si; kjo lidhet dhe me zhvillimet e palataleve IE drejt prepalataleve e më në fund te *ts*, *dz* e *s*, *z* e *th*, *dh*, me ç'rast, supozonte ai, baltishtet mbetën konservative, ndërsa sllavishtet e shqipja u bënë inovative.⁸⁶ Më vonë do të kthehej te dallimet e para-shqipes e para-sllavishtes nga dialektet e tjera IE lidhur me një risim morfologjik: shënimin e foljeve inaktive me formantin *-ks-*, që është përmbysja e *-sk-*, e që më vonë u bë *-h*: shih sll. *exati*, shq. *dihet*.

Tipar tjetër me rëndësi specifike për përkatësinë e përbashkët gjetetike të shqipes e sllavishtes ai e shihte refleksin e shumëfishtë të nazaleve silabike IE *ŋ*, *ŋ̥*, të gjata e të shkurta. Dhe këtu ai nxirrte përfundime pak më largvajtëse. Në fusnotë shënonte:

*“Besoj se Karpatet ishin territori i funtmë i përbashkët i para-sllavëve – para-albanëve. Prej andej para-sllavët emigruan drejt veriut në territoret që banoreshin nga para-baltikët, ndërsa para-albanët mërguan në jug dhe u vendosën pastaj në Ballkan”.*⁸⁷

⁸⁶ Mayer 1991, H.: *Tokharian and Baltic versus Slavic and Albanian*, in *Lituanus* 37, 1.

⁸⁷ “I believe the Carpathians were the final home territory common to Pre-Slavs-Albanians. From there Pre-slavs migrated north to territory occupied by the Pre-Balts while Pre-Albanians migrated south and eventually reached the Balkans”. Mayer (1991b), H.: *Reflexes of Indo-European Syllabic Resonants in Baltic, Slavic and Albanian*, in *Lituanus* 37, 4. Shih dhe Bednarczuk 1986: 77-83; Çabej 1976: 145; Demiraj 1997: 155-179, 223-225; Pellegrini 1998: 89-91; Topalli 2001: 43-190, 203-289.

Në kohën kur sllavët erdhën në Baltik, qenë të ndikuar nga baltikët që të largonin shumë nga reflekset e shumëfishta të nazaleve silabike IE .

*“Duke pasë dhënë i ose u plus hundore përbri i ose u plus lëngëzore reflekse pak a shumë të rregullta të sonanteve rrokjesore IE, sllavishtja, për pa-sojë, u bë një lloj i shqipes së baltëzuar (balticized Albanian). Të gjitha bashkë, gjurmët e reflekseve të shumëfishta të hundoreve rrokjesore plus ti-pare të tjera, leksikore, fonologjike dhe morfologjike (x, pra, h nga -ks- në elati, dihet), tregojnë një lidhje origjinale të afërt të sllavishtes me paraardhësin e shqipes më parë se me të baltishtes”.*⁸⁸

K. Topalli në *Fonetikën historike të shqipes*, pas referimit të ideve të shfaqura më herët, përfshirë Bednarcsuk, e ripohonte mendimin se

“sonantet e trashëguara kanë dhënë disa reflekse në gjuhën shqipe” dhe se *“me këto reflekse, ..., shqipja afrohet me gjuhët balto-sllave dhe kelte”* (Topalli 1007: 238).

Pas vrojtimit të Hamp-it në formën që

“mund të thuhet se shqipja është më afër me baltishten dhe sllavishten se me çdo gjë tjetër, dhe me siguri jo e afërt me trakishten”,⁸⁹

H. Mayer theksonte idenë se në këtë konstelacion shqipja ishte më e afërt me sllavishten: në fonologji: *th, dh - t, d; s* alternoi me *h*; refleksi i *k', g'h; ks-* dha *h-*; *k', g'h* më shpesh *k, g* se në gjuhë të tjera; në leksik: korrespondencat sllavo-shqipe në numër janë 3 herë më të shumta se balto-shqipet.⁹⁰ Prandaj:

“mundësia e lidhjeve më të afërta speciale aborigjene dialektore (para)-sllave-(para)-albane indikon Karpitet si shtëpi të përbashkët të lashtë për (para)-sllavët dhe (para)-albanët, ku ata realizonin ekzistencën e tyre pas-

⁸⁸ “Having made *i* or *u* plus nasal along with *i* or *u* plus liquid its more or less regular reflexes of Indo-European syllabic resonant, Slavic, in effect, became a sort of Balticized Albanian. All the same, traces of multiple reflexes of syllabic nasals plus other features, lexical, phonological, and morphological (the *x*, that is, *h* from *-ks-* in *exati* ‘to ride’), show an original close Slavic tie with the ancestor of Albanian rather than with Baltic”.

⁸⁹ “It can be said to be related more closely to Baltic and Slavic than to anything else, and certainly not to be close to Thracian”, in Hamp, Eric P. 1980: *Thracian, Dacian and Albanian-Romanian Correspondences*, in *Actes du Ile Congrès international de thracologie*, vol. 3, pp. 57-60, București.

⁹⁰ Më 1993 H. Mayer botoi artikullin *Slavic, a Balticized Albanian?*, in *Lituanus* 39, 2, 1993.

*torale, migratore.*⁹¹

Vlerësimet e tij përgjithësuese për vendin dhe afritë midis idiomave të ndryshme janë: para-sllavët, të parë në thelb si para-albanë veriorë që zbrisnin drejt veriut nga Karpatet në rajonet e baltëve sedentarë, të cilët me gjasë ishin teknikisht superiorë, kështu është për të pritur që dialekti i tyre të ketë qenë fort i ndikuar nga baltishtja. Shenjë tjetër për këtë gjendje të lashtë është shkalla shumë më e madhe e homogjenitetit të sllavishtes sesa të baltishtes, ku dialekte më lashtësisht sedentare anojnë të tregojnë shumë më pak homogjenitet se mërgimtarët.

*“Shqipja, me më shumë homogjenitet se sllavishtja, tregon madje një vendosje edhe më të vonë të shprehive sedentare të folësve, që, duke pasë lëvizur në jug, në mënyrë të veçantë, duket se do të kenë zëvendësuar një rajon malor (Karpatet) me një tjetër (Ballkanin) për të vazhduar tipin më të hershëm, disi migrator, të jetës para se të bëheshin përfundimisht sedentarë”.*⁹²

Më duket sikur do bërë vërejtja vijuese: në raport me hapësirën ku shtrihet shqipja e re, përthyerja e saj dialektore është shumë më e madhe, çka flet për kohën e gjatë të ekzistencës së saj aty. Nga ana tjetër, ne nuk i dimë diferencimet e tjera dialektore të protoshqipes për shkak të proceseve intensive të greqizimit, romanizimit, sllavizimit. Kështu nuk jemi në gjendje të themi gjë për diferencimet brenda fazës ilire, por kjo nuk e legjitimon pohimin e mësipër.

“Në një mënyrë, sllavishtja i ngjet anglishtes, gjuhë gjermanike e romanizuar fuqishëm. Por atje ku situata me anglishten ka qenë relati-

⁹¹ “The possibility of special, close aboriginal (Pre-)Slavic-(Pre-)Albanian dialectal ties indicates the Carpathians as a common ancestral home for (Pre-)Slavs and (Pre-)Albanians where they led a pastoral, migratory existence. This location surely originally put them out of contact with Pre-Baltic”, H. Mayer: *Slavic, a balticized Albanian?*, in *Lithuanus* vol. 39, no. 2 1993.

⁹² “Albanian, with more homogeneity than Slavic, shows an even later offset of sedentare habits of its speaker who, having moved south, characteristically, seem to have replaced one mountanaious region (the Carpathians) with another (the Balkans) to continue an earlier, somewhat migratory, nomadic type of living before finally becoming sedentare”, H. Mayer, *Slavic, a balticized Albanian?*, in *Lithuanus* vol. 39, no. 2 1993.

visht lehtë e identifikueshme, situata analogjike me sllavishten ka qenë shumë eluzive. Kjo nuk të habit. Ndikimi i baltishtes konservative i dha sllavishtes dukjen konservative. Ndikimi i dialekteve dhe gjuhëve fqinje inovative (keltisht, p.sh.) mbi shqipen i dha asaj një dukje shumë të ndryshuar. Reagimi i menjëhershëm ka qenë: shqipja dhe sllavishtja duken aq të ndryshme, ndërsa baltishtja e sllavishtja aq të ngjashme”.⁹³

Dhe më tej ai vijonte me supozimet për ndikime kelte në parashqipen, për çka deri sot nuk kemi pasur dëshmi, çka nuk do të thotë se të tilla s’ka pasur. Por supozimi pas të cilit ato paskan qenë aq të gjera dhe intensive sa ia paskan ndryshuar dukjen nuk duket i pranueshëm në gjendjen e dijes që kemi.

Sipas H. Mayer-it,⁹⁴ kishte dy dialekte të ndryshme proto-IE, baltik dhe karpatian.⁹⁵ Baltishtja rinovoi së pari në fonologji: *-ks- < -sk-* dhe, si gjermanikishtja, reflekset e sonanteve silabike në kohën e satemizimit. Këto grupe i diferenconte uniformiteti i refleksëve *! r m n* përballë reflektimeve jouniforme *ur, ul, un, ën, u*+likuide, *shwa*+nazal drejt të gjithave në *ul, ur, urn, un, i, ir, im, in*, që u lidh me satemitetin. Kishte konservativizëm

⁹³ “In a way, Slavic resembles a powerfully Romanized Germanic language. But where the situation with English has been relatively easily identifiable, the analogous situation with Slavic has been very elusive. This is not surprising. The influence of conservative Baltic gave Slavic a conservative appearance. The influence of innovative neighboring dialects and languages (Celtic, for example) on Albanian gave it a much changed appearance. The immediate reaction has been: Albanian and Slavic look so different while Baltic and Slavic seem so much alike”. Mayer (1997), Harvey: *Balts and Carpathians*, in *Lituanus* 43, no. 2

⁹⁴ Mayer (1997), Harvey: *Balts and Carpathians*, in *Lituanus* 43, no. 2 është një tjetër artikull i H. Mayer, ku diskutohen këto probleme. Karpatianët, në kuptimin e tij, përfshijnë jo vetëm albanoidikët, që diku mund t’i ketë interpretuar madje edhe si sllavoidikë, pra shqiptarët, ilirët, mesapët dhe sllavët, por edhe rumunët. Besonte se baltët në një kohë të hershme patën një dominim mbi karpatianët dhe kjo shpjegoka pse paraardhësit e rumunëve kaq shpejt e rrënjësisht u romanizuan. Ishte çështje politike, të fitohej mbrojtja romake kundër ish-zotërve baltë. Të pyesim vetëm pak: Pse rumanishtja ka shumë më tepër afërsi me shqipen se me baltiket?

⁹⁵ Dialekt apo gjuhë ‘karpatische’, diçka e tillë deri sot nuk është përligjur në gjuhësinë krahasimtare. Mbase në një kuptim konvencional.

në fonologji, ndërsa risim në morfologji. Karpatishtja rinovoi në morfologji me sufiksin *-sk-* nga folje aktive në inaktive si te *elati* dhe *dihet*, pastaj shkoi drejt fonologjisë. Kur interpretimi karpatian i *-sk-* në *-ks-* u përqendrua në aspektin fonologjik, u shtri pastaj te ndryshimet në zanore. I fundit nga ajo periudhë duket ndryshimi i zanoreve në *shwa*, që nuk doli në baltishten. Në shqipen e rumanishten e gjejmë këtë ndryshim, sidomos në leksikun e përbashkët që disa e kujtojnë dakas ose trakas: *buzë/ buză, këpushë/ căpușă*. Kur janë morfologjikisht të markuara këto zanore rimarrin shprehjen e tyre të plotë si *buza*. Këtë lloj ndryshimi të zanores jo shumë të markuar në *shwa* nuk e gjejmë në gjuhët baltike dhe kjo do ta tregonte zhvillimin e veçantë nga proto-IE për baltishten e karpatishten.⁹⁶

Na duket se kjo tregon po ashtu se sa të rrezikshme mund të jenë sprovat për të nxjerrë përfundime të këtij lloji pa i pasë hetuar mirë relacionet kronologjike në gjuhët përkatëse. Ndryshimi *buzë/ buza* në shqipen shpjegohet përmes shkrirjes së fundjes së temës *-ë* me nyjën *-e*: *buzë+e – buza* dhe duhet të jetë mjaft i vonë, madje, në saje të rindërtimeve të brendshme, nuk duket se shkon në fillim të mijëvjeçarit I. Besoj se kështu do parë çështja dhe në rumanishten. Shkrirja *-ë + e = a* është e vonë.

Mund të gjykojmë ngjashëm për supozime si vijuesi. Neutri anon të zhduket në shqip e rumanisht. Sipas tij, neutrin e ruan vetëm sllavishtja, sepse është shumë e baltëzuar, aq shumë sa

“breza specialistësh kanë këmbëngulur që sllavishtja me siguri është një lloj baltishte, madje, ndoshta një lloj i degjeneruar duke pasë ndryshuar kaq shumë përmes inovimit”, thoshte ai.⁹⁷

H. Mayer nisej nga kundërshtimi i parë i bashkësisë së supozuar gjuhësore midis sllavishtes e baltishtes, duke e quajtur atë mit apo edhe më keq, prodhim të ideologjisë sunduese mbi lituanishten për dekada e më shumë. Ai diskutonte një çështje të fonetikës historike: rikthimin e aspirimit, siç e quante ai dhe në këtë pikë e shihte dallimin midis baltishtes, në

⁹⁶ Kjo zanore në këto gjuhë në fakt nuk do të jetë aq e vjetër. Në atë kohë në proto-shqipen do të kemi pasur ende *a*. Zhvillimi në ë duhet të jetë më i vonë.

⁹⁷ Mayer (1982), Harvey: *Dacian, Thracian as Southern Baltoic*, in *Lituanus* 38, n. 2

një anë, dhe sllavishtes e shqipes, në anën tjetër. Fjala është për faktin e supozuar se para-sllavishtja e hershme dhe parashqipja e hershme kishin ruajtur grupet nistore *sk-* dhe *ks-*, ndërsa para-baltikët e hershëm kishin ruajtur vetëm segmentin *sk-*; kjo ka ndodhur, mendonte ai, pas dezaspirimit të supozuar si shkallë e glotalizimit; para-baltishtja ishte më shumë kundër aspirimit dhe më glotalizuese; atje ku kishte tendencë të kthimit të *s-së* në *h*, parabaltikët, përmes metatezës së *ks-* në *sk-*, e parandaluan di-si; kjo lidhet dhe me zhvillimet e qiellzoreve IE drejt paraqiellzoreve e më në fund *ts*, *dz* e *s*, *z* e *th*, *dh*, me ç'rast, supozonte ai, baltishtet mbetën konservative, ndërsa sllavishtet dhe shqipja u bënë inovative. Në një tjetër artikull, ai së pari nisej nga dallimet e para-shqipes dhe para-sllavishtes nga dialektet e tjera IE lidhur me risimin e përmendur morfologjik të shënimi i foljeve inaktive me formantin *-ks-*, si përmbysje e *-sk-*, që më vonë u bë *-h*: sll. *elati*, shq. *dihet* (Mayer 1991). Në fusnotë shënonte se besonte që Karpatet duhej të ishin territori ku së funtmi bashkëqëndruan parasllavët-para-shqiptarët. Prej Karpateve parasllavët emigruan drejt viseve që banoreshin nga para-baltikët, ndërsa parashqiptarët drejt jugut, për t'u vendosur në Ballkan. Kur të mblidhen të gjitha, si gjurmët e reflekseve të shumëfishta të hundoreve rrokjesore, tiparet leksikore, fonologjike e morfologjike (ku ai shihte të kishte rezultuar *h*, nga *ks-* të shembujt *elati* dhe *dihet*) flasin për lidhje origjinale më të afërt midis sllavishtes e paraardhësit të shqipes sesa paraardhësit të baltishtes.⁹⁸

H. Mayer-i kërkonte të shpjegonte në dritë të re nocionet e tij për baltishten e hershme. Mendonte se baltët dhe gjuhët baltike do të jenë shtrirë në hapësirë më të gjerë. Kështu para-trakishten e para-dakishten i quante *baltoidishte jugore*, duke sugjeruar faktin se ato qenkan folur në jug të baltishteve dhe faktin se paskan qenë, nëse jo dialekte saktësisht baltike, një klasë *si-baltike* (Mayer 1982).

Mirëpo, Duridanov-i ka dhënë vetëm paralele leksikore, pa su-

⁹⁸ Ndërkohë që në gjuhësinë e krahasuar kemi një teori të përhapur, që flet për përbashkësinë balto-sllave si për një grupim të hershëm gjuhësor, ndërsa për përkimet e parashqipe me sllavishtet si të mëvona, mbase vetëm të një afrie jo krejt të afërt.

pozuar më tej afri me gjuhët baltike. Mayer-i nisej nga kriteret fonologjike dhe vijonte me hipotezën e tij, sipas së cilës si *baltoidikë* kuptoheshin para-trakasit dhe para-dakasit; këta ai i cilësonte intruzivë, sepse ndodheshin në kufi me para-grekët - në jug, ndërsa para-iliro-mesapikët shqiptarë në perëndim, para-frigasit në lindje dhe sllavët albanoidikë në veri. Këto dialekte ishin, sipas tij, më pak të glotalizuara, prandaj edhe lejonin grupin bashkëtingëllor *ks-* në fillim.

Por hipotezat vijnë e marrin veshje disi tjetër dhe këtu dua të citoj fjalëpërfjalë edhe për rrëfimin piktoresk:

“Për të arritur në Ballkanin Lindor, para-trakasit dhe para-dakasit baltoidikë duhej të kalonin nëpër territorin albanoidik në Karpate. Besoj se ata morën disa albanoidikë dhe i sollën me vete në Ballkanin lindor si sklevër. Disa nga këta albanoidikë ikën drejt perëndimit në male për t’u fshehur. Nga këto zona më pak mikpritëse të Ballkanit Perëndimor të varfër disa nga këta albanoidikë të ikur kaluan Adriatikun drejt Italisë dhe u bënë të njohur si mesapë. Pjesa tjetër mbeti në Ballkanin Perëndimor dhe u bë e njohur si ilirë, pasardhës të të cilëve, besoj, janë shqiptarët, të cilët, incidentalisht e kanë ruajtur traditën e tyre të lashtë të ikjes në Itali. Ky skenar i shpjegon disa nga korrespondencat leksikore joromane, autoktone midis rumanishtes dhe shqipes. Disa nga këto njësi janë fjalë trakase dhe dakase, të cilat paraardhësit e shqiptarëve i mësuuan nga zotërit e tyre baltoidikë trakas e dakas”.⁹⁹

Për të mbetur tek ana anekdotike e kësaj këmbënguljeje në shpjegimin specifik të parahistorisë, le të shohim më në fund se si e interpretohte pjesën tjetër.

⁹⁹ “To reach the Eastern Balkans, Baltoidic Pre-Thracians and Pre-Dacians had to pass through Albanoidic territory in the Carpathians. I believe they captured some Albanoidics and brought them to the Eastern Balkans as slaves. Some of these Albanoidics escaped westward into the mountains to hide. From these less hospitable, poorer West Balkan areas some of these escaped Albanoidiscs crossed the Adriatic to Italy and became known as Messapians. The rest remained in the Western Balkans and became known as Illyrians whose direkt descendants, I believe, are the Albanians who, incidentally, have kept up their old tradition of wandering on to Italy. This scenario explains some of the Non-Romance, “native” lexical correspondences between Rumanian and Albanian. Some of these items are Thracian and Dacian words which the ancestors of the Albanians learned from their Baltoidic Thracian and Dacian master”.

*“Dakasit që lëvizën në veri [sepse ata qysh atëherë të lëvizshëm paskan qenë, r.i.], duke kaluar nëpër territorin albanoidik në Karpate me siguri morën me vete disa albanoidikë si skllevër. Këta u bënë të njohur më vonë si sllavë. Natyra e emaskuluar e sllavishtes nga aspekti i fjalorit IE, pra, mungesa e fjalëve sllave për vyras, aner dhe smakras, fjalë e vjetër mashkullore për mjekër, dëshmon për statusin shërbëtor të paraardhësve të tyre, para-sllavëve albanoidikë”.*¹⁰⁰

Natyrisht, dhe për t’i ekzemplifikuar mundësitë e përdorimit të ‘argumenteve’ të leksikore për nevoja konstruksionesh nga më të ndryshmet.

Nisur nga pohime si këto, përhapja e emrave të lashtë albanoidikë të vendeve, qofshin ata ilirisht, shqip, a sllavisht, nuk të befason.

Duke u mbështetur tek analizat e studiuesit rumun A. Balotă të vitit 1927, H. Mayer¹⁰¹ i hynte interpretimit të formave të shqipes dhe lidhjeve përkatëse me baltishten duke mbindërtuar studimet morfologjike të Orel-it, por duke mos i parë vrojtimit e Klingenschmitt-it pikërisht për të tillë shembuj dhe vërejtjet për kronologji.

Çka thonë botimet standarde

Botimet standarde të indoeuropeanistikës sa i përket vendit të shqipes në kuadër të gjuhëve indoeuropiane i mbahen zakonisht rrugës së rrahur më herët, ndërsa në atë kuadër, megjithë kujdesin e dukshëm, më shpesh përparësi i japin lidhjes së shqipes me ilirishten. Shumë syresh kënaqen me ndonjë shënim të vogël dhe me më shumë rezerva.

¹⁰⁰ “Dacians moving north on passing through intervening Albanoidic territory in the Carpathians surely picked up some Albanoidics to bring along as slaves. These became later known as Slavs. The emasculated nature of Slavic from the view point of old Indo-European vocabulary, that is the lack in Slavic of words like *vyras*, *aner* ‘man’ and *smakras*, the old masculine word for ‘beard’, attests to the servile status of their ancestors, the Albanoidic Pre-Slavs”.

¹⁰¹ Mayer (2003), H.: *Shifts in early albano-slavic syllable boundaries*, in *Lituanus* 49, 3, Balotă 1927, A.: *L’ouverture des syllabes et l’origine de la nasalisation en Albanais*, București.

1. Porzig

W. Porzig-u në veprën për nyjetimin e hapësirës gjuhësore indoeuropiane, gjithsesi e shënuar si vepër me rëndësi,¹⁰² lidhur me vendin e shqipes në kuadër të gjuhëve IE ndiqte albanistikën tradicionale,

“por që të marrim një pasqyrë të plotë për hapësirën gjuhësore IE, duhet të provohet të vendosen gjuhët që deri tash qenë lënë anash, shqipja, toka-rishtja dhe hetishtja. Po të lëmë mënjanë raportin e shqipes me ilirishten, nuk mbesin raporte të veçanta midis saj dhe gjuhëve perëndimore”, Porzig 1974: 174.¹⁰³

Pas kësaj vendosjeje të qartë në pjesën joperëndimore IE, ai shquante në radhë të parë përkitjet e shqipes me hapësirën gjuhësore balto-sllave veri-lindore, sidomos balten, dhe me greqishten në jug.

Pas shqyrtimit të raporteve me gjuhët baltike e sllave, ashtu si me greqishten, ai nxirrte përfundimin se nuk vërehen lidhje të veçanta të shqipes me gjuhët e tjera lindore IE, me arishten jo se jo, po as me armenishten konkretisht, apo me të dyja bashkë. Ai nuk e linte pa shënuar se Pedersen-i mendonte ndryshe. Sipas Porzig-ut, shqipja shfaq përkime me armenishten apo me arishten vetëm në rastet kur përfshihen edhe greqishtja, baltishtja apo sllavishtja, pra jo si specifike për të me arishten (Porzig 1974:179). Është e pritshme që armenishtja, si fq i lashtë i greqishtes, të marrë pjesë në përkimet shqiptaro-greke, si: *ὄναρ* ‘ëndërr’ - *ὄνειρος*, arm. *anurj* nga **anōri-*, shq. *âdërrë*, *ëndërrë* nga **onrijo-*. Formanti që paraqet një risi armeno-shqipe del nga një fjalë e përhapur për ëndërr - **suepnos* – *gjumë* (Porzig 1974: 179-180).

Ndër përkimet shqip.-sll.-arm., nga ana tjetër, Porzig-u shënonte:

¹⁰² Porzig 1974, W.: *Die Gliederung des indogermanischen Sprachgebietes*, Heidelberg.

¹⁰³ *“Um aber ein vollständiges Bild vom idg. Sprachraum zu bekommen, muß noch versucht werden, die bisher beiseite gelassenen Sprachen, das Albanische, das Tocharische und das Hethitische, gleichfalls einzuordnen. Wenn man von Verhältnis des Albanischen zum Illyrischen absieht, so bestehen kaum ausschließliche Beziehungen zwischen ihm und den westlichen Sprachen”.* Dhe ai shqipen e vendoste duke iu referuar Pedersen KZ 36, 340; Thumb IF 36 1; Jokl: *Albanisch in Steitberg, Geschichte d. Idg. Sprachw. II*, 3, 80; *Reallexicon* 1, 84; *WuS* 12, 67.

**smuono-*, **ghuono-*: sll. e vj. kisht. *zvonъ*, zë, zâ nga **ghuoni-*, por **smuono-* jep ind. e vj. *svaná-*, lat. *sonus*, gjerm. an. *svanr*, ang. e vj., gjerm. e lartë e vj. *swan* (Porzig 1974: 180). Ndërsa ndër përkimet shq.-gr.-balt.-sll.-arm. jepete këto: grupi shq.-gr.-balt.-sll. lidhet me arm. me të tashmen në *-iō-*: **g^hhen-* ‘me goditë, me rrahë’, gr. *θείνω*, arm. *ǰnjem*, shq. *gjanj*, lit. *geniù*, sll. e vj. kisht. *žnjq*. Në grupimin shqipe-arishte-baltishte-sllavishte Porzig-u numëronte këto përbashkësi: kallëzorja njëjës e përemrave të vetës së parë ishte e përbashkët IE në një formë pa eptim *(e)mě, ind. e vj. *mā*, gr. (έ)με, po edhe në ir. e vj. *-m-*. Kështu edhe venetishtja *mexo* got. *mik*, hetitishtja *ammuk*. Arishtja, balt., sll. e shq. kanë *-m* në eptimin emëror: ind. e vj. *mām*, persishte e vj. *mien*, sll. e vj. kisht *mę*, shq. *mua mue* nga **mēm*. Shqipja ka të përbashkët me balt., sllav. e arishten një nga emrat për ‘dhi’: ind. e vj. *ajā-* m. ‘cjav’, *ajā* f. ‘Ziege’, *ajikā* ‘edh’, pers. e mesme *azak* ‘dhi’, lit. *ožys* ‘cjav’ nga **āgjos*, *ožkà* ‘dhi’, let. *āzis* ‘cjav’ prus. e vj. *wossux* ‘cjav’, *wosee* ‘dhi’, shq. *dhī*, nga **aḡt̪*. Për *djathë*, shq. e Greqisë *dithë* bashkohet vetëm me balt., me ind. e vj. *dadhi*, gjin. *dadhnás*, prus. e vj. *dadan* (Porzig 1974: 181).¹⁰⁴

Ndër përkimet shqip-arisht-baltisht-sllavisht-armenisht, Porzig-u numëronte: *mjekër*, *mjekrë*, ind. e vj. *śmaśru*, arm. *mauruk* ‘moruk’ nga **smokru-*, shq. nga **smekrā*, lit. *smākras*. Shqipja dhe baltishtja e kanë ruajtur bashkëtingëlloren mbylltore (Porzig 1974: 181).

Për të vënë në pah raportet e shqipes me baltishtjen-sllavishten Porzig-u shënonte përkimet: **g_uen-*: *gjanj*, sll. e vj. kisht. *žnjq* ‘korr’, lit *geniù* ‘gjuaj’; sll. e v. kisht. *časъ* nga **qēso-*, *kohë* nga **qēsā*, prus. e vj. kallëzore njëjës *kīsmān* nga **qēsmo-*. Lit. *bredù*, lit. perënd. *brendù*, let. *brīenu*, dial. *briedu*, rus.-sll. kisht. *bredu*, shq. *breth* ‘huepfe’. Për ilirishten te *Bradanus* në Apuli dhe te *Βροδεντία*. Më tej *liūgas*, let. *ludza* rus. *lúža*, *lëgatë*. Këtu, sipas tij, përket *ἔλος Λούγεον καλούμενον* e shënuar te Strabon-i. Më tej *blato* e sll. së vj. kisht., rus. *bolóto*, çek. *bláto*, nga **bolto-* shq. *baltë* dhe ilir. **balta*, dalm. e vj. *balta*, it. e veriut *palta*. **bholto-*, **bholtā* – këtu hyn dhe *balt* nga *bhel-* ‘bardh’; *mētas*, let. *mets*, prus. e vj.

¹⁰⁴ H. Mayer e mohonte ekzistencën e kësaj fjale në sllav., prandaj nxirrte supozime largvajtëse për raportet midis atyre gjuhëve.

mettan, shq. *mōt* (jo *mōt!*) nga **mēto-*, këtu dhe shq. *masë* nga **matjā*. Prus e vj. *laydis* 'Lehm', shq. *leth* (*ledh*). *lajthi*, lit. *lazdà* let. *lazda*, *lagzda*, prus. e vj. *laxde*; *shkozë* – nga **sqrēbhr-* dhe *-dīā*, lit. *skruóblas skroblùs* nga **sqrōbhru-*, let. *skābarde* nga **sqrābhar-*.

Pra, kryesisht përkime leksikore e më së shpeshti me përfshirjen e gjuhëve baltike e sllave, në një anë, greke, armene etj., në anën tjetër.

2. Fortson

Benjamin W. Fortson IV në tekstin e tij të autoritetshëm për gjuhësinë e krahasuar IE¹⁰⁵ jepte një pasqyrë, ku thuhet se shqipja përbënte degë të veçantë të indoeuropianishtes, se lidhur me prejardhjen e saj ka kontraverza, se supozimi për prejardhjen e shqipes nga ilirishtja ka kuptim gjeografikisht, por është i patestueshëm, ndërsa supozimi për prejardhjen nga trakishtja është po ashtu i patestueshëm.

Ai vërente se rajoni i Shqipërisë së sotme u bë territor roman në sh. II para K., kështu që ndikimi i latinishtes në leksik është i madh. Përgjithësisht huazimet e shumta e vështirësojnë historinë fonologjike e morfologjike të gjuhës. Duke folur për ilirishten e për gjuhët fragmentare të lashedisë shënonte ato që afërsisht dihen: ilirët apo paraardhësit e tyre u vendosën në Ballkan me gjasë në periudhën e hershme të Bronzit në pjesën I të mijëvjeçarit II para K. Më vonë u përhapën dhe formuan mbretëri, ranë nën ndikimin e kulturës greke midis sh. VIII dhe VI para K., kur grekët vendosën koloni në atë hapësirë (Epidamnus). Pas konflikteve me Romën ilirët u bënë të varur prej saj më 165 para K. dhe krijuan Provincën *Illyricum*. Edhe pse luajtën një rol me rëndësi në ushtrinë romake, konstatonte me të drejtë ai, ilirët nuk u asimiluan tërësisht në romanë dhe e ruajtën gjuhën e tyre (Fortson 2004: 405). Por është e pasigurt se çka ishte ajo gjuhë, sepse termi '*ilirishte*' u është referuar shumë gjërave të ndryshme, madje deri vonë çdo gjuhë jo-kelte në hapësirën në perëndim të Trakisë e në veri të Greqisë e Makedonisë dhe në lindje të venetëve. Studimet që

¹⁰⁵ Fortson IV 2004, B. W.: *Indo-European Language and Culture. An Introduction*, f. 390.

janë kryer pas viteve '60 të sh. XX kanë treguar se ky rajon nuk ishte uniform në aspektin arkeologjik si në aspektin e onomastikës, e cila ndahej në tri zona dhe vetëm njëra syresh cilësohej ilire e mirëfilltë. Fjala është për mbetje emrash të njerëzve e të vendeve dhe pak glosa. Mbishkrime nuk ka.

Në këtë raportim të shkurtë, për kaq sa është të plotë e të saktë, lidhur me ilirishten dhe lidhjet e saj të mundshme janë ngritur dy hipoteza të rëndësishme:

1. Ilirishtja është e njëjtë apo e lidhur ngushtë me mesapishten dhe
2. Ilirishtja është paraardhësja e shqipes. E para mbështetet në lidhjet, ngjashmëritë kulturore midis ilirëve dhe mesapëve dhe me disa ngjashmëri midis elementeve gjuhësore.

Por, sipas tij, hipoteza e dytë ka shumë pak mbështetje gjuhësore, por ka shumë kuptim gjeografik. Përmendet gjithashtu dhe fakti se fjala *Albanoí* ndeshet te Ptolomeu si emër për një fis ilir. Si glosë përmendet *rinos* (geg. e vj. *ren*, moderne *rê*), por vetëm kjo nuk mjafton për ta provuar hipotezën, thoshte ai. Relacionet e mundshme me mesapishten nuk ndihmojnë, sepse mbishkrimet mesapike nuk sjellin ngjashmëri të padyshimta me shqipen (Fortson 2004: 405-406). Më tej ai raportonte se ka studiues që ilirishten e trakishten i shohin të afra midis tyre dhe kanë propozuar madje një degë të veçantë trako-ilire. Të tjerë kanë propozuar njëfarë kombinimi të trakishtes, ilirishtes e të gjuhës së provincës së Dakisë.

"Të gjitha këto propozime japin shumë pak për të shkuar më tej dhe janë të parakohëshme" (Fortson 2004: 406).¹⁰⁶

Në këtë paraqitje të thuktë, ai shënonte dhe fjalët e propozuara si ilire që paraqesin interes për indoeuropianishten: *Deipaturos*, emri ilir i *Jupiterit* apo *Zeusit*, nga proto-IE 'baba qiell', **djēus ph₂tēr*, lat. *Iūpiter*; *teuta*- 'popull', pjesë e emrave të njerëzve nga rrënja **teutā-*, që ndeshet edhe në Europën Perëndimore; *Vescleves* 'që ka emër të mirë', si sanskritishtja *vasu-śravas*; *sabaia* a *sabaium* – pije nga rrënja **sab-* që ka dhënë fjalën për lëng *Saft*, ang. *sap*, etj. (Fortson 2004: 406). Afërsisht të gjitha këto shënime gjenden nëpër shkrimet e autorëve shqiptarë dhe të

¹⁰⁶ "All such proposals have very little to go on and are premature".

tjerë lidhur me këto çështje.

Lidhur me mesapishten shtonte se njihet nga afër 300 mbishkrime të vogla nga Italia (Kalabri e Apuli) nga shekulli 6 para K. e më vonë. Mesapishtja ishte gjuha e popujve të njohur me dy emra: mesapë e japigë. Historianët e lashtësisë i lidhin me ilirët në bazë arkeologjike përmes ngjashmërive në mjete të kulturës materiale metalike dhe të qeramikës dhe përmes emrave të përveçëm, prandaj edhe gjuha lidhet me ilirishten, por këtë pohim nuk jemi në gjendje ta testojmë për shkak të mangësive të njohjes. Shkrimet mesapike janë me alfabet grek jonik që ishte përhapur në Itali të Jugut. Shpesh ato janë vetëm emra të personave dhe nuk ndahen në fjalë, prandaj interpretimi është i vështirë. Mendohet se **o* e shkurtë u bë *a*, si tek gjinorja atematike *damatras* “i Demetrit” (me gjinore njëjës *-as* nga **-os*); si keltishtja, italik., e venet., kishte mbaresë të gjinore njëjës *-ī* (në shkrim *-ihī*), por ndryshe prej tyre, kjo mbaresë i shtohet **-o-* të temës me *o-* të emrave dhe jo ta zëvendësonte atë: *dazimaihi malohiaihī* “i Dazimas Malohias”. Në format *logetibas* “për logetit” nga **-ibhos*, shihet si formë e dativit shumës. Është provuar të identifikohen forma foljore si *hipakaθi* ‘vë, vendos’?, veta e tretë njëjës e tashme *hipadews* ‘vë, vendos’, ndoshta aorist me *s-*.

Për Fortson-in pjesa më e vlefshme dhe më e interpretueshme e mesapishtes është *kl(a)ohi zis* e gjetur në fillim të disa mbishkrimeve, që përkthehet si ‘dëgjo, Zis (=Zeus)! (Fortson 2004: 407-408).¹⁰⁷

¹⁰⁷ Mbishkrimet e gjetura në Basta, Apuli te Otranto, të kopjuara në sh. 16, origjinali ka humbur, pa ndarje fjalësh, nuk mund të përkthehet; duke ndjekur Hans Krahe, *Die Sprache der Illyrier*, vol. I 1964, pp. 27-8, me modifikime, Fortson e jepte si vijon:

Klohizisθotoriamartapidovasteibasta
 Veinanaranindaranθoavastistaboos
 Šonedonasdaštassivaanetosinθitrigonošo
 Astaboosšonetθihidazimaihibeileihī
 Inθireššorišoakazareihīšonetθihiotθeihīθi
 Dazohonnihiinθivastima
 Daštaskraθeheihiinθardannoapoššonnihia
 Imarnaihi

Pra, kemi shkrim pa ndarje fjalësh.

J. P. Mallory 1989: 91 si ilustrim veçonte segmentin:

Klohizisθotoriamartapidovasteibasta

3. Mallory

Autori i veprave me qarkullim të gjerë për gjuhët dhe kulturat indo-europiane, ndër to i *In Search of the Indo-Europeans: Language, Archaeology and Myth*, London 1989 dhe bashkë me Douglas Adams si editorë i *Encyclopedia of Indo-European Culture*, London 1997, James P. Mallory, duke bërë fjalë për gjuhët e Ballkanit të lashtë nga perspektiva IE, derisa në pjesën për trakishten nuk linte asnjë dyshim për ta lidhur atë apo dakishten në punë filiacioni me shqipen, duke konstatuar dallim të rëndësishëm midis ilirëve dhe trakasve, për ilirishten shprehej si vijon:

“është së paku e mundshme që pasardhësi modern i njëjës apo më shumë gjuhëve ilire të flitet ende. Shqipja... është e vendosur në territor që më herët u është atribuar ilirëve. Kjo u lejon shumë gjuhëtarëve të supozojnë se ajo është mbase pasardhëse e gjuhës së hershme ilire, edhe pse shumë e prekur nga latinishtja, greqishtja, sllavishtja dhe turqishtja”, Mallory (1989: 73).¹⁰⁸

Në vijim theksonte se shqipja është shkruar vonë, ndërsa dëshmitë gjuhësore për ilirishten, përveç emrave të njerëzve dhe të vendeve, janë krejtësisht të pakta (*sabaia* ‘emërtim i një pije’, *rinos* = *rê*). Prandaj,

“pa tekste reale ilire, duhet të kënaqemi me konsiderimin e shqipes si gjuhë ilire si kryesisht supozim i mundshëm”, Mallory 1989: 74.¹⁰⁹

Veinananandinandanθoavasti,

për të cilin sillte tri përkthime të ndryshme:

- “Hear, Jupiter! Thotoria Marta gave to the city of Basta her land in [the locality] of Darantua...” (E quante consensus’ translacion);
- “Hear, Jupiter! Under the *teutor-ship of Amartapidius, for the inhabitants of basta this law. They passed it (the law) in the Council of Elders in Basta... (O. Haas);
- “Onme should heed these things! I, Teutoria Marta, purchase in the city of basta the wine fields in Darantua...” (Martin E. Huld). Megjithë interpretimet me interes të segmenteve apo fjalëve të veçanta, nuk ka një interpretim të sigurt dhe të plotë të teksteve.

¹⁰⁸ “...it is at least possible that a modern descendant of one or more of the Illyrian languages is still spoken. Albanian, ..., is situate in territory earlier attributed to the Illyrians. This permits many linguists to surmise that it is probably a descendant of the earlier Illyriana language although much affected by Latin, Greek, Slavic and Turkish”.

¹⁰⁹ “Without actual Illyrian texts, we must content ourselves with regarding Albanian as an Illyrian language as merely a probable assumption”.

Pellazgjishtja, Demiraj

Shaban Demiraj në veprën *Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët*, Tiranë, 2008, mesapët i shihte si fis ilir që ka emigruar nga Ballkani në Itali të Jugut nga fillimi i mijëvjeçarit I para K. Referimet kryesore të tij këtu janë Haas 1982, Parlange 1980, De Simone 1964, Santoro 1982, 1983, 1984, Hamp 1957, Hammond 1967 dhe Pellegrini 1995. Referonte idetë e Hamp-it 1957 dhe të Pellegrini-it 1995 për afritë e saj me ilirishten ballkanike. Duke sjellë në mendje diskutimin për karakterin e pretenduar *centum* të ilirishtes, ai rikujtonte rregullin e satemitetit të papërfunduar në kontekst të qiellzoreve IE **ḱ*, **ǵ* të ndjekura nga sonantet, që u depalatalizuan në mesapishten, ilirishten, shqipen, gjuhët baltike e sllave, prandaj mendimi se ilirishtja ishte *centum* del i pasaktë. Te mesapishtja duan veçuar këto cilësi:

**o* e shkurtë IE u bë *a*: dëftori njëjës asnjës *ta*, *ta noman*, *ta dentan*: shqip *a-ta* (djathë), gr. *tò: to sykon*, *to alfa*, *to delta*, IE **to*d, Demiraj 2008: 187;

ka ndodhur dezspirimi i mbylltoreve IE: *bili/ bilio* e *bilja*: bir, bijë; *Aprodita*; në shq. dhe huazimet gr. *mokënë* nga *māxanā*, *lakënë*: *laxanon*, *shkarpë*: *skarip^hos*; në fund ka ndodhur zhvillimi i *-m* në *-n*: *Ana-n*, *Aprodita-n*, *veinan-n ara-n*, *ola-n*, *agoria-n*, edhe te dëftorja kallëzore njëjës *ta-n* (shih dhe Hamp 1957);

ka theks nistor: këtu Demiraj ngulte këmbë për të vënë relacion midis mesapishtes, ilirishtes e shqipes, në fakt ashtu siç kishte theksuar dhe Çabej. Ritheksonte rastet si Brúndisium – Bríndisi, Tárentum – Táranto, Ódryntum/ Hýdruntum – Otranto dhe Dýrrhachion/ Dýrrhachium – Durrës, Drívastum – Drisht, Pólatum – Pult (cf. Çabej 1972, Demiraj 1999: 207 e vijim, Demiraj 2008: 183-189).

Sipas Demirajt përfundimisht, edhe pse me zhvillime të pavarura, përkimet që vërehen midis mesapishtes e shqipes

“dëshmojnë se mesapët e lashtë dhe stërgjyshërit e shqiptarëve duhet të kenë pasur një origjinë të përbashkët etniko-gjuhësore”, Demiraj 2008:189).

Demiraj këtu megjithatë relativizonte, duke thënë se ‘*ky problem mbetet i hapur*’. Ai kishte referuar fjalët e Hamp-it për lidhjet midis mesapishtes e ilirishtes:

“Nuk mund të ketë asnjë dyshim që mesapishtja dhe ilirishtja janë gjuhë motra, megjithëse të ndara ndoshta nga një gjysmë mijëvjeçari ndryshimi, dhe që në vija të përgjithshme çfarë themi për mesapisht-

ten ndoshta vlen barabar edhe për ilirishten. Për ta bërë më të qartë pohimin tonë, duhet të kuptojmë me 'ilirishte' vetëm gjuhën që flitej në Adriatikun Lindor dhe në Dardani ndoshta aq larg në veri sa të shumtën deri në Danub, dhe jo në kuptimin e gjerë të adoptuar nga dijetarë të tillë si Pokorny dhe të kritikuar me të drejtë nga Whatmough-i" (Word 6. 242-1950).¹¹⁰

Balkanindogermansich

Relacioni shqipe-armenishte u vështrua nga G. Klingenschmitt-i, indoeuropianist, armenist i shquar dhe njohës i zhvillimeve të shqipës. Pikënisja e tij ishin zhvillimet në fushën e foljeve, konkretisht të aoristit të shqipes me *-sh-*: *pashë, thashë, qeshë*. Duke u mbështetur në dëshmitë e autorëve të vjetër dhe të të folmeve që ai i konsideronte arkaike, aoristi i shqipës, pas tij, ishte me formën *pae, thae*, etj. dhe pikërisht kjo bazë e lidhte atë me armenishten e greqishten dhe gjuhët e jugut kryesisht. Këndej ai shihte dhe aspekte të tjera në fushë të emrave. Ai në fakt vinte ta theksonte disi grupimin IE ballkanik (*Balkanindogermansich*), ku do të hynin shqipja, greqishtja, armenishtja, frigjishtja, pra një dispozicion tjetër të gjuhëve IE, që mund të supozojë edhe konceptime të ndryshme nga ato që njohim e që flasin për shtrirjen e hershme të gjuhëve IE në Europën Verilindore. Pas zbërthimit të njësisë IE, sipas tij, ky grup ballkanik i gjuhëve qëndroi një kohë si bashkësi komunikimi në kontakt dhe krijoi risime.

Në këtë grupim ai vendoste afritë në pikat vijuese:

ruajtjen e tri radhëve të tektaleve (ka gjurmë të labiovelareve edhe në armenishten); segmentet para-IE zanore *+laringal h₁* dhe laringal *h₂* jepnin gjysmëzanore+shwa₂ apo *shwa₁* (**-ih₂, *-ih₁ > *-i₂, *-i₁* – gr. *ῶσσε*, arm. *ačk* < **áčha+kh*, khs. *zonjë* < **djàh-ptn₂* < **desjás + potnájə*); lok. shumë **-si* (gr., shq., arm.) - (**-su*); mbaresat e parme njëjës veta 1 mes. **-maj* (riformim nga IE e lashtë);

¹¹⁰ Demiraj 2008: 185, përkthimi Demiraj. Shih përkthimin e plotë të studimit të Eric P. Hamp: *Studime krahasuese për shqipen*, zgjodhi e përgatiti R. Ismajli, ASHAK, Prishtinë, 2007: *Shqipja dhe mesapishtja*, ff. 147-170, përktheu Rrahman Paçarizi; citati përkatës në f. 148.

*h₂q̥i pas *-mi: gr. -μα, arm. -m, shq. -m (*digjem* < *d̥ieg'em < *degamaī);
përkime në leksik, psh. mohimi *h₂oju ± kwid, gr. οὐ, οὐκί, arm. oçç, çç, alb. as, s).¹¹¹

Shumë vjet para se të botonte studimin të cilit do t'i referohemi tani dhe pa ndonjë referim te koncepti *Balkanindogermanisch*, për të cilin folëm, Fr. Kortlandt kishte mbrojtur tezën se gjuhët shqipe dhe armenishte ishin zhvilluar nga dialekte IE në vazhdimësi, të cilat do të kenë krijuar një lidhje midis balto-sllavishtes, në njërën anë, dhe greqishtes në anën tjetër, ndërsa në studimin e tij *Armenian and Albanian*¹¹² merrej me leksikun që mund të flasë për lidhjet e shqipes me armenishten dhe këtë ai e kishte bërë duke u mbështetur te Fjalori etimologjik i M. Huld-it (1984), sipas të cilit korrespondencat e shqipes, greqishtes e armenishtes janë: *ëndërr*, arm. *anurj*, gr. *óneiros*; *edh*, arm. *ayc*, gr. *aíks*; *ënde*, arm. *ánthos* 'lule', arm. *and* 'fushë'; *thellë*, arm. *soyl* 'shpellë', gr. *κοίλος* 'gropë'; *vjehërr*, arm. *skesur*, gr. *hekurá* 'nëna e burrit'; *im*, arm. *im*, gr. *emós* 'imi'; *njeri*, arm. *ayr*, gr. *anér*; *thëri*, arm. *anic*, gr. *konís*, sl. *gnjida*; *punë*, arm. *póyt* 'zell', gr. *spoudé*; *qaj*, arm. *lam*, gr. *kla(w)íō*; *zjarm*, arm. *ǰerm*, gr. *thermós*; *dorë*, arm. *je in*, gr. *kheír*; *një*, arm. *mi*, gr. *mía*. Pedersen-i (1900), Jokl-i 1963 dhe Solta 1960¹¹³ kishin shtuar edhe: *ardhi*, arm. *ort* 'verë' – e dyshimtë; *zog*, arm. *jag*; *butë*, arm. *but* 'a', arm. *č*, gr. *oukí*; *qe* < *kle*, arm. *linim* 'bëhet', gr. *κλίνω* 'prirem'; *ha*, *hëngra*, arm. *utem*, *keray* 'ha, hëngër';

¹¹¹ Shih Gert Klingenschmitt, *Albanisch und Urindogermanisch*, in *MSS* 40 1981; *Das Albanische als Glied der indogermanischen Sprachfamilie*, in J. E. Rasmussen (Hrsg.), *In Honorem Holger Pedersen*, Wiesbaden, 1994, ff. 221-233; *Die Verwandtschaftsverhältnisse der indogermanischen Sprachen*, in J. E. Rasmussen (Hrsg.), *In Honorem Holger Pedersen*, Wiesbaden, 1994, ff. 235-251. Shih për këto edhe J. Matzinger, *Der Altalbansiche Text Mbsuame e Krështerë (Dottrina cristiana) des Lekë Matrënga von 1592*, Dettelbach, 2006.

¹¹² Kortland, Fr. 1986: *Armenian and Albanian*, in M. Leroy et F. Mawet (Eds) (1986): *La place de l'arménien dans les langues indo-eropéennes*, Lovanii Aedibus Peeters, 38-47.

¹¹³ Pedersen, H. (1900): *Albanesisch und Armenisch*, in *Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung* 36: 340-341, shqip te Pedersen, H. (2003): *Studime për gjuhën shqipe*, AShAK, Prishtinë, ff. 115-116; Jokl, N. (1963): *Die Verwandtschaftsverhältnisse des Albanischen zu den übrigen indogermanischen Sprachen*, in *Die Sprache* 9: 113-156; Solta, R. (1960): *Die Stellung des Armenischen im Kreise der indogermanischen Sprachen*, Wien.

herdhe, arm. *orjik* 'testis', gr. *órkhis*; *dhjamë*, arm. *tamuk* 'lagështirë', gr. *dēmós*; e dyshimtë; *glisht*, arm. *čiwł* 'degë, gisht'; *dredh*, *drodha*, arm. *dařnam*, *darjay* 'kthej, kthyer'; *vëth*, arm. *gind* 'unazë'; e dyshimtë; *trim*, arm. *t'arm* 'freskët';¹¹⁴ *dhallë*, arm. *dal*, *dayl* 'kullloshtër'.

Tash Kortland mendonte se depalatalizimi i qiellzoreve IE para sonanteve në armenishten kishte vepruar njësoj si në shqipen, f. 41.

Gjuhët satem veçohen po ashtu sipas tiparit që PIE *s e bën *sh* pas *i*, *u*, *r*, *k* (risim i balto-sl., indo-ir., arm. dhe mbase shqipes). Në shqipen *sh* është refleksi i zakonshëm i PIE *s në shumë rrethana: *shoh*, *shtatë*, *shtërpinj*, *mish* (arm. *mis*), *dhashë*, *shsosh*, *shteg*, *asht*, *është*, *jashtë*; në fillim të fjalës në rrokje të theksuar PIE *s u bë qiellzore e zëshme: *gjarpër*, *gjash-të*, *gjalpë*, *gjumë*; në pozitë ndërzanore refleksi ishte zero: *ajo* > *-sā, *u* < *su; PIE *sk dha *h*: *hie* < gr. *skiā*, *hedh* < *skeudō, *ah* < *osko-, te foljet me -h < *-skō; para hundoreve, si në armenishten, u bor: *jam*, *mjekër*, f. 42.

Armenishtja e shqipja kanë refleksi të veçantë të PIE *sw (arm. *k'ún* 'fle', shq. *gjumë*; arm. *k'irtn* 'sweat', shq. *dirsë*; do komentuar *djersë*; shq. *diell*, gr. *hélē*). Sipas tij, zhvillimi i shënueshëm i PIE *sw- në armenishten e në shqipen bëhet i kuptueshëm nëse supozojmë që grupi u bë monofonematik në një fazë të hershme të këtyre gjuhëve, f. 43. Refleksi i përbashkët i PIE *k'w dhe *ghw (arm. *šun* 'qen', arm. *eš* 'gomar', shq. *sorrë* < *kwērnā, arm. *jayn*, shq. *zë*, *zâ*).

Mendonte se një përndarje në fushën e laringaleve si PIE *H₂e- (arm. *han* 'gjyshe', *hatanem* 'pres', *how* 'gjysh', *hagacim* 'become addicted', *harawunk* 'fushë', *haw* 'zog'); *H₃e- (*hoviw* 'bari', *hac* 'bung', *hot* 'erë'); PIE *Ho- dhe e vokalizuar *H₃- (*or* 'rump', *orb* 'jetim', *rojik* 'herdhe', *oror* 'seagull', *ost* 'degë', *oskr* 'asht', *ut* 'tetë') dhe PIE *H₂- (*ayr* 'shpellë', *arj'ari*, *arcat* 'argjend', *argel* 'pengesë', *arwar* 'plough', *acem* 'sjell'), mund të jetë ruajtur dhe në shqipen dhe për këtë sillte shembujt: *hap* < *H₂ep-, *hinj* < *H₂eu-, *hut* < *H₂eut-, *hipënj* < *Heup-, *herdhe* < *H₃ergh-, *ha* < *H₂eu-, *halë* < *H₂elsno, *ardhur* < *H₁orgh-un-, *athët* < *H₂ok-, *amë* < *H₃odmā-, *ah* - *H₃os-

¹¹⁴ Është supozuar se fjala shqipe do të ketë qenë *t+rim*, pra të lidhet me *ri*.

ko-, asht<*H₃ost-, α<*H₂ou, enj *Hoid-n-, edh<*aiǵ-, ari *H₂rtko-, arë<*H₂rH₃-, elb<*H₂lbhi-, ende<*H₂ndh-, ëndërr<*H₃nr-, emër<*H₃nH₃men-, ënj<*H₂nH₁em-, mbi<*H₂mbhi, në<*H₁ndh-, im<arm. im, gr. eimós,, f. 44-5.

Çështja e laringaleve, e shtruar kështu te Hamp, vjen e diskutuar dhe ndryshe në albanistikë nga Ölberg¹¹⁵ e të tjerë më vonë. Por përfundimi i Kortland-it është ky:

*“Armenishtja dhe shqipja kanë të përbashkët jo vetëm një numër njësisish leksikore, që i kanë të përbashkëta me greqishten, por gjithashtu dhe një numër zhvillimesh fonetike: depalatalizimi i velareve qiellzore para sonanteve, që gjendet po ashtu në balto-sllavishten, monofonematizimi i PIE *sw, *k^w dhe *ǵhw, që mund të ketë qenë zhvillim paralel i dy gjuhëve, dhe ndoshta refleksin e dyfishtë jozero të PIE *H₂- e *H₃-, që u vokalizuan para një sonanteje tautosilabike, si në greqishten, aspirim i para PIE *e”.*¹¹⁶

këtu vinte me përfundimin e përgjithshëm:

*“Këto ngjashmëri midis dy gjuhëve e mbështesin idenë se ato burojnë nga dialekte indoeuropiane në vazhdimësi, të vendosura midis greqishtes në jug dhe balto-sllavishtes në veri”.*¹¹⁷

Të gjitha këto mund të kërkonin rishqyrtimin serioz të raporteve të shqipes me gjuhët IE të veriut dhe sqarime shtesë për kohën dhe natyrën e atyre kontakteve nëse nuk do të kishin ndodhur në Europën Qendrore apo Veriore. Do të kërkonin dëshmi më substanciale për lidhjet që mund të quhen me peshë midis shqipes, greqishtes e armenishtes.

¹¹⁵ Ölberg, H. M.: *Einige Überlegungen zur Laryngaltheorie (An Hand des Albanischen)*, in *Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung* 86: 121-136.

¹¹⁶ “Armenian and Albanian share not only a number of lexical items, which they have in common with Greek, but also a number of phonetic developments: the depalatalization of palatovelars before resonants, which is also found in Balto-Slavic, the monophonemicization of PIE *sw, *k^w, *ǵhw, which may have been a parallel development of the two languages, and perhaps the twofold nonzero reflex of PIE *H₂- and *H₃-, which were vocalized before a tautosyllabic resonant, as in Greek, yielded aspiration before PIE *e”. Kortlandt 1986: 45.

¹¹⁷ “The similarities between the two languages support the idea that they originated from contiguous Indo-European dialects, situated between Greek in the south and Balto-Slavic in the north”.

Digresioni trako-armenas i Barić-it

Henrik Barić-i në librin e tij *Hýmje ne historín e gjuhes shqipe*, Mustafa Bakija, Prishtinë, 1955, në pjesën për vendin që zë shqipja në rrethin e gjuhëve të afërta (f. 31-), nisët nga mendimi ekzistues për prejardhjen e shqiptarëve nga ilirët. Kjo hipotezë, sipas tij, ka lindur nga lidhja e emrit të hershëm *Albanoi* me albanët e mesjetës, çka mund të ketë ndodhur për arsye të ndryshme; shqiptarët mund të kenë jetuar në Ballkan. As fjalët ilire në shqipen nuk kanë fuqi argumentuese, pohonte ai, sepse ka të tilla dhe nga trakishtja. Karakterin trakas të shqipes e kanë theksuar në fund të sh. 19 C. Paul, H. Hirt, ndërsa Jokl-i ka mbajtur qëndrim të mesëm, sepse karakteristikat e saj ilire përputhen me të njëjtat trakase (Referonte *Reallexicon der Vorgeschichte I*, 24 e vazhdim). Këto raporte janë parë kryesisht në bazë të refleksit të qiellzoreve IE, në bazë të të cilave shqipja shihet *satəm*, ndërsa ilirishtja *centum*, prandaj ajo nuk mund të jetë pasardhëse e ilirishtes. Lidhur me zëvendësimin e velareve të thjeshta *k, g, gh* dhe të buzorevelareve *q^h, g^h, g^hh*, sillte teorinë e Pedersen-it për refleksin e labiovelareve në shqipen si njësim me velaret e thjeshta, pos para zanoreve të përparme, ku kanë dhënë *s, z*.

*“Në këte të ndamë refleksesh të rradhëve jopallatale indoev., gjuha shqipe nuk është e vetmueme, por lidhet me grupin tharako-frigjiko-armen të gjuhëve sateme. Kështu n’armenishten labjovelaret indoev. nuk pallatalizohen para vokalevet pallatale (krahasò arm. kin ‘grueja’: indoev. *g^henā, kurse pallatalizimi është bā nëse para e-s dhe i-s kanë qëndrue velaret e thjeshta indoev. (krahasò çim ‘frêni’, greq. gémos). Por, përkueshmënia midis refleksëve të thrakishtes dhe refleksëve të shqipes në rradhët e jopallatalevet indoev. nuk shihet vetëm në të ndamit e tyne, por edhe n’identitetin e refleksëve të velareve dhe labjovelareve indoev”, Barić 1955: 33.*

Barić-i krahasonte glosën trakase *árgilos* ‘mîni’, velarja para i është ruajtur (gr. *órkhilos* nga **orgh-*), ‘ndërsa labjovelaret në këte pozitë janë pallatalizue njilloj si në gjuhën shqipe’, khs. thrak. *dzerm-* ‘i ngrohtë’ te *Dzermi-zirga* në Daki, ie. **g^hhermos*, *zjerm*, *zjarm*, Barić 1955: 33. Kjo do të thotë se dallimi i tri radhëve të guturaleve ie. është veçori konservative e shqipes, armenishtes e thrakishtes, çka do të thotë se ky grup kishte po-

zitë qendrore, ndërsa palatalizimi është inovacion i përbashkët shqiptaro-trak, Barić: 34. Për ruajtjen e tri radhëve të guturaleve referonte veprën e tij *Lingvističke studije*, Sarajevo 1954, f. 38, po edhe të V. Pisani-t.

Si izoglosë thrako-shqiptare i dukej asimilimi i *s*-së në grupet *s+hundore*, *s+l*: *jam*, ind. e vj. *asmi* (ie. **ésmi*), trak. *níba* 'bora' (ie. **snig^h-n*); *kollë*, sll. e vj. *kašlī* prej IE **koslo*. Ndërsa izoglosë shq.-arm. i dukej zëvendësimi i *rn* në shq. *rr* (*barrë* – gr. *phérnē*, fazë e ndërmjetme midis *rn* e *rr* ruhet në arm., ku *r* para *n* kalon në *r* (*darnam* 'kthehem' – aor. *darjay*. Fa-za *rr* e shqipes e *ĕ* IE, ind. e vj. *šardula*, ndërsa *sk* mbetet e pandryshueshme: *bashkë*, irl. e vj. *bask*; *mushk*, ind. e vj. *muškah*; *shkon* got. *skewjan*; *shkas* – lat. *scateo*, lit. *su-skote*; *shkop*, lat. *scāpus*. arm. *c* zëvendëson *sk* IE: *hurcanem* 'lutem': lat. *posco* prej *porc-sco*, IE **prĕk-sĕko*, ndërsa *sk* IE mbetet – *skund* 'këlysh', pami. *skön*, sll. e vj. *štenič*, Barić 1955: 34.

Shembull të sigurt për refleksin trakas të *sĕk* IE nuk ka; *sĕk* IE mbetet e pandryshueshme si në shqipen: trak. *skalmē* 'shpata', nord. e vj. *skalm*, dak. *skiarē*, shq. *shqer* (rranja *sker-*). Në shq. e arm. nuk janë njësuar *tenues* dhe *tenues aspiratae* IE (shq. *fal* prej IE **phalnō*: gr. *sphállō*, arm. *pul*, shq. *rreth* ind. e vj. *rāthah*. Lidhja midis shqipes e trakishtes shihet te refleksi i sonanteve IE, refleksi identik i shqipes e trak. te sonantet hundore IE është *a*-ja: *shtatë* prej IE **septn̥ti*; gjatë: IE **dl̥gh-to*, trak. emri i lumit te Bizanti *A-thýras* (prej **ndhu-r*, ind. e vj. *dhāvāte* 'rrjedh', si në lit. *nevadas*, emri i kështjellës *Bastera*, nga **nh̥d-teria*, lit. *bandà*. Trakishtja, pra, qëndron ndërmjet shqipes e armenishtes, ku kemi refleksi *a* për *n̥* IE, kemi dhe refleksin *an* në armeno-trak.: glosa *génton* 'mish' nga **gánton*, IE **g^hh̥n̥-t*, me *e* prej *a*, si te trak. *-deva*, *-dava*, Barić 1955: 35-36.

Shq.-trak. për *r*: *ri* – *krimb*; ind. e vj. *kṛmi-h*, emri *Trib-all-oi*, got. *þaurp* prej **t₁b-*. Shqip pos *ri* kemi edhe *ur* – *burmë* prej IE **bh₁rmo-*, kurse *ur* për *r* del dhe në trak. – *Burdipta*: lit. *bredù*, sll. *bredō*. Refleksi armen. i *r* IE është *ar* – *arj* 'ari', ind. e vj. *r̥kṣa-ḥ*, po edhe në trak. *Dársioi*, gr. *thárses* 'guxim', ind. e vj. *dh₁śnōti* 'guxon', IE **dh₁s-*, f. 36. Ka lidhje me grupin trako-frig te zanoret: *ū* > *ü* (*dyll*, gr. *khỹlos*, IE **ghũlo-*; *o* > *ö* > *e* – shq. *ne*, IE **nōs*; *a* > *e* *rreth*, gjerm. e vj. *rad*, lat. *rota*; *ü* do të ketë ekzistuar edhe

në arm. e lashtë, Barić 1955: 37.

Lzofonë shqip-arm. është kalimi *en+s* në *i*: *mish*, arm *mis*, prus. e vj. *mansa*, sl. *męso*, Barić 1955: 39.

Sipas Jokl-it nyja në shqipen ka ekzistuar qysh në kohën kur kanë nisur të hyjnë elementet më të vjetra lat., sepse marrëdhënia midis *ftua*, *ftue* dhe *fton-i* lat. *cotoneum* shpjegohet me lëvizjen e kufirit të rrokjes (*fto-ni*).

“Por s’ka dyshim se artikulli postpozitiv ka ekzistue shumë më përpara, dmth se ai rrjedh nga epoka e stërlashtë e bashkësis gjuhësore shqiptaro-trako-armene”, Barić 1955: 39.

Prova nuk ka, por për këtë na flet gjuha armene, ku si nyja të prapavendosura përdoren partikulat *-s*, *-d*, *-n*, sipas rastit se kush flet, kujt i flitet ose për kë flitet: *mard-s* – ‘njeri ky këtu’, *mard-d* – ‘njeri ai aty’, *mard-n* – ‘njeri ai atje’, si në maqed. *-ot*, *-ov*, *-on*. f. 39. Një fazë e atillë do të ketë ekzistuar dhe në shqipen, mendonte ai. Pajtohej me Meyer-in e Brugmann-in që *-i-në* e prapavendosur të shqipes e nxirrnin nga IE **is* (lat *is-dem*), ose **ei* (lat. *ae* nga *eia*), ndërsa Skok-u nyjën *-u* e nxirrte nga *-(o)-vo(s)* (por mendonte se Skok-u gabonte kur *-në* të kallëzores mashk. e fem. e nxirrte nga *(o)nom*, *(o)nam*, sll. *onŭ*, *ona*, sepse në tosk. pritej *-r* për *-n*), Barić 1955: 40.

Karakteristikë e përbashkët shqipe-armene në lakim, sipas tij, është edhe prapashtesa e vendores, të njëjësit dhe të shumësit të gjinisë mashkullore e femërore *-t*, që është prapashtesa e vjetër ndajfoljore që mund të lidhet me **dhi* IE (khs. gr. *-thi*), prej së cilës, pas humbjes së *-i* të fundit, *d-ja* bëhet *-t*. Me këtë lidhet sufiksi i vendores së armenishtes *-j* = *dh* IE (khs. arm. *telvoj* prej *teli*, *teleac*, së cilës i përgjigjet sufiksi i shqipes *-zi*, tosk. prapa-*zi*), Barić 1955: 41.

Sipas Pisani-t, *-ve* e shqipes duhet të jetë identike me arm. *bk̄*; karakteristikë shqipe-armene është dhe prapashtesa e gjinore-dhanores njëjës e pashquar femërore, prej *-iās*,

“kurse *-iās* në vend të *-ās* është një veti edhe e gjuhës armene (krahasò arm. *ami*, *trajta* gjenitive prej *am*, *ama-v-* prej IE **samiās*)...”,

është inovacion, Barić 1955: 42.

Prapashtesa *-š* e shqipes në rrjedhore shumë, por gegnisht edhe

në gjinore shumë të pashquar, i përgjigjet rrjedhore shumë IE *‑*su* (khs. vendoren e sllavishtes *těhŭ* = ind. e vj. *teṣu*, ndërsa *‑sh* e geg. gjinore përkon me *‑*sōm* të gjinores shumë IE). Kjo lidhet me gr. *‑asom*, lat. *‑ā* (*rosārum*), por edhe me *‑o* (*dominōrum*), e armen. ku *‑ç* përfshin të gjitha lakimet dhe zëvendëson *‑s* të vjetër, siç tregon aoristi i dobët i vjetër sigmatik (khs. *ama‑ç* ‘annorum’, *mardo‑ç* ‘hominum’) prej IE *‑*som* dhe *‑ç* prej *‑s*-te aoristi *mna‑ç* ‘ai u ndal’ në krahasim me pers. *mna‑m*.

Për raportet armeno-shqipe ka rëndësi përkimi i *nomina agentis* të shqipes me *‑es* dhe të armenishtes me *‑ič* dhe *nomina actionis* me *‑le*, siç kishte konstatuar Pedersen 1900: 341 e vijim. Pedersen-i kishte dhënë dhe paralelet leksikore:

Shqip	armenisht
s ‘nuk’	č, oč
ardh‑i	ort ^c
ha, hângra, hêngra	utem, aor. e‑ker
zog	jak f. 43

Barić-i shënonte se zakonisht theksohen izoglosat e shqipes me grupin e gjuhëve IE veriore dhe me gjermanikishten e balto-sllavishten. Nga ato mbeten vetëm dy: 1. Ndërtimi i numërorëve me *‑t* në shq. prej 6-10: *gjashtë* – ind. e vj. *ṣat*, lat. *sex*, gr. *héks*; *shtatë* – IE **septm‑ti* (ind. e vj. *sa-ptá*, lat. *septem*, gr. *heptá*; *tetë* – IE **oktō‑ti*, ind. e vj. *aṣtau*, lat. *octo*, gr. *oktō*; *nândë nëntë* – IE **neun‑ti*, ind. e vj. *nava*, lat. *novem*, gr. *ennéa*; në gjerm *niun* e *taihun* me *‑nt*, balto-sll.: lit. *devīnt*, *dešmt*, sll. *devětī*, *desětī*, po edhe *peťī*, *šestī*; 2. Ndërtimi i dhjetësheve: *tridhjetë*, Barić 1955: 43-4. Pas tij, veçori të vetëm shqipes e gjuhëve balto-sllave nuk ka, Barić 1955: 44. Përmendte megjithatë hundorëzimin e zanores para segmentit hundore + bashkëtingëllore si pasojë e tendencës drejt rrokjes së hapur. Po ashtu, shënonte imperfektin geg. me *‑sh*, aoristi sigmatik (*isha*) si në sll. *delaxŭ*, *delaše* *‑aše*, *‑axomŭ*, *‑ašete*, *‑axo*. Aoristi sigmatik gjendet dhe në armenishten e gjuhë të tjera, prandaj kjo do të thotë se kjo veçori vjen nga periudha e përbashkët.

Për atdheun verior, sipas tij, flasin përkimet leksikore:

Shqip	gjermanik e gjuhë veriore
rrâni	gjerm. e vj. <i>renne</i>

shtalb	gjerm. e vj. <i>stallra</i> , holand. <i>stollen</i>
lândë	lit. <i>lenta</i>
lthí, lajthi, lejthi	lit. <i>lazda</i>
vesh	lit. <i>vāisius</i>
vjel	lit. <i>valýti</i>
vidh	sll. <i>vežǎ</i> , Barić 1955: 44-5.

“Gjithë kjo, në të vërtetë, na tregon fqinjësinë parahistorike, mirëpo, thelbi i çeshtjes s’afinitetit gjenetik qëndron nën tjetër, domethënë ai ka të bājë me gjuhën armene, për të cilën gjā na ka udhëzue, me dorën e sigur-të, Pedersen-i n’artikullin e përmendun. Kur të hjekim isoglosat shqiptaro-armene, të cilat janë edhe të greqishtes edhe të gjuhëve baltiko-sllave, si kemi pá, mbetet një varg i tñë karakteristikash shumë të rëndësishme, të cilat përkufizohen me shqipen dhe armenishten. Ky është, në të vërtetë, edhe koncepti i Pedersen-it mbi pozitën e gjuhës shqipe në rrethin e gjuhëve tjera indoeuropjane. Ndryshimi midis pikëpamjes sime dhe pikëpamjes së Pedersen-it është se ai mohon grupin shqiptaro-thrako-frigjiko-armen, kurse unë mendoj ... se vendin ndërmjetës midis shqipes dhe armenishtes e zën thrakishtja, sepse gjuha shqipe përputhet me thrakishten në të gjitha ato vetina, të cilat e ndajnë prej frigjiko-armenishtes”, Barić 1955: 45.

Më herët (Ismajli 1987: 11) kishim shprehur përfundimin që s’ka arsye ta ndryshojmë as sot:

“... Argumenti i afërive me armenishten ishte tepër i hollë për ta mbështetur gjithë këtë konstrukcion”.

Di Giovine për raportet e shqipes me trakishten

Këtu më duket kishte arritur me argumentimin e tij të hollësishëm në fushën e analizave fonologjike Paolo di Giovine lidhur me afrinë e supozuara të shqipes me trakishten, dakishten.¹¹⁸ Fillimisht ai raportonte në mënyrë të përmbledhur historikun e idesë për prejardhjen trakase të shqipes, duke filluar nga H. Hirt-i,¹¹⁹ i cili shënoi elemente në favor të prej-

¹¹⁸ di Giovine 1979, Paolo: *Tracio, dacio ed Albanese nella prospettiva genealogica*, në *Rendiconti della Classe di scienze morali, storiche e filologiche dell’Accademia nazionale dei Lincei*, serie VIII, vol. XXXIV, fasc. 7-12, Luglio-dicembre, ff. 397-412.

¹¹⁹ Hirt 1898, H.: *Die sprachliche Stellung des Illyrischen*, në *Beiträge zur alten Geschichte und Geographie*, në *Festschrift für H. Kiepert*, Berlin, f. 181 e vijim; Hirt 1905, H.: *Die*

ardhjes trakase të shqipes: karakteri *centum* i ilirishtes, konkordancat që ai i konsideronte si të substratit trakas midis rumanishtes, bullgarishtes e shqipes dhe korrespondencat leksikore midis shqipes e armenishtes të ndërmjetuara përmes trakishtes,¹²⁰ di Giovine 1979: 397. Më tej ai raportonte për hipotezën e Jokl-it për prejardhjen e shqipes, si më të artikuluar, për aq për sa ai lejonte në formimin e kësaj gjuhe konvergjencën e elementeve ilirë dhe trakas (prejardhje iliro-trakase) ndër afinitetet e shumta midis këtyre dy gjuhëve të lashta ballkanike;¹²¹ tiparet fonologjike që shënojnë korrespondencë sinjifikative midis shqipes e trakishtes, sipas Jokl-it, janë: rezultati i diftongut me **w* dhe i sonanteve silabike, dezspirimi i sonoreve spirante, trajtimi i palataleve (si afrikate), ruajtja e labiovelareve si të ndara nga palatalet (vetëm para **e*, **i* në shqipen), zhvillimi i një okluziveje dentale brenda grupit **sr*.¹²² Për Di Giovine-n ndër mbështetësit më vendimtarë të prejardhjes trakase të shqipes e të shqiptarëve qe G. Weigand-i, i cili mbështetej në indicie të rendit etnografik e gjuhësor, ndër të cilat përkimet rumune-shqiptare të termave latinë e fjalëve paralatine të rumanishtes, analizueshmëria e disa toponimeve e antroponimeve trakase përmes leksikut të shqipes dhe e kundërta.¹²³ Ai merrej me diskutimin në detaje të shqyrtimeve të natyrës fonetike të Barić-it, të D. Dechev-

Ingogermanen, Strassburg, I, f. 140 e vijim, me shënime f. 600 e vijim.

¹²⁰ Përmendte rezervat që mund të nxisë argumenti i tipit që vetëm trakishtja e ilirishtja mund të jenë paraardhës të drejtpërdrejtë të shqipes; theksonte se karakteri *centum* i ilirishtes është krejtësisht i pasigurt, shënimi 2; konkordancat midis shqipes, bullgarishtes e rumanishtes, reduktimi i zanoreve të patheksuara, prapavendosja e nyjës, Hirt 1898, f. 187, sa i përket shqipes, janë dytësore, shënimi 3; korrespondencat leksikore midis shqipes e armenishtes, Hirt 1905, f. 142.

¹²¹ Jokl, N.: *Albaner*, B. *Sprache*, në Ebert: *Reallexikon der Vorgeschichte* I, f. 84 e vijim; ngjashëm S. Mladenov 1938, S.: *Albanisch und Thrako-Illyrisch*, në *Balkan-Archiv* 4, f. 181; Ribezzo 1940, F.: *Premesse storico-linguistiche sull'autoctonia illirica degli Albanesi*, *Rivista d'Albania* 1, f. 114 e vijim. Aktualisht teza e një prejardhjeje ngusht ilire e trakase nuk gëzon përkrahje, shih Georgiev 1963, V.: *Thrace et Illyrien*, në *Balkansko ezikoznanie* 6, 1963 f. 71 e vijim; shënimi 5 f. 398.

¹²² Jokl, *Albaner*, 89 e v.; *Thraker*, B, *Sprache*, në Ebert: *Reallexicon* XIII, 278 e v., sh. 6, 398.

¹²³ Weigand 1927, G.: *Sind die Albaner Nachkommen der Illyrier oder der Thraker?*, *Balkan-Archiv* 3, 1927, f. 227 e v., shën. 7, 398.

it,¹²⁴ të V. Georgiev-it,¹²⁵ të C. Poghirc-ut,¹²⁶ të I. Russu-it,¹²⁷ etj.

Para se të argumentonte për paqëndrueshmërinë e tezës trakase-dakase, di Giovine e shihte të nevojshme ta pohonte argumentimin e pamjaftueshëm të tezës ilire, pa implikuar se mohimi i lidhjeve me trakishten, dakishten, nuk do të thotë gjë për prejardhjen ilire, f. 400. Mendonte se kishte arritur të shihte se teza për prejardhjen ilire të shqipes mbështetej në argumente mjaft fragjile: nuk ka pajtim në refleksin e *s; ka mospërkim në vazhdimësinë e sonanteve (hundore, anësore e dridhëse me funksion zanor) dhe të dorsaleve origjinare, etj.

“Më duket se këto divergjenca jo vetëm që nuk e justifikojnë hipotezën që ilirishtja të ketë qenë paraardhësja e shqipes, por e vënë në dyshim dhe mundësinë që midis dy gjuhëve të kishte një ‘afri’ më të ngushtë se ajo midis shqipes e balto-sllavishtes, për të dhënë një shembull”, di Giovine 1979: sh. 15, f. 400.¹²⁸

Dechev,¹²⁹ Georgiev,¹³⁰ Duridanov¹³¹ pranojnë për trakishten kalimin e *o-së origjinare në *a*, aty ku del *o* do të kemi të bëjmë me forma të

¹²⁴ Dechev 1952, D.: *Karakteristika na trakijskia ezik*, Sofija, posthume dhe te *Balkansko ezikoznanie* 2, 1960, f. 147 e vijim, ftn. 10, f. 399.

¹²⁵ Georgiev 1957, V.: *Trakijiskijat ezik*, Sofija 1957, f. 70 e vijim; teza për prejardhjen dakomize të shqipes e shfaqur në këtë vepër, rimerret te Georgiev 1960, V.: *Albanisch-Dakisch-Mysisch und Rumänisch – Die Herkunft der Albaner*, në *Balkansko ezikoznanie*, 2, f. 1 e vijim, fusnt. 12, f. 399. Ai mendonte se shqipja është vijuese e dakomizishtes të ndryshme nga trakishtja, çka del nga analogji të rëndësishme fonologjike, si për shembull mungesa e ‘Lautverschiebung’ tipike për trakishten, rezultati *ri* i dakomezishtes *r (përballë *ur, ir* të trakishtes), kalimi i *ē në *ā e pastaj në *o* në dakomizishten, jo në trakishten dhe dalja e *e* nga *ō, Di Giovine 1980, f. 399, shih dhe Ismajli 1987.

¹²⁶ Poghirc 1963, C.: *L’alternance m/mb/b en thrace et en albanais*, në *Balkansko ezikoznanie* 6, 1963, f. 97 e vijim., fusnota 13, f. 399.

¹²⁷ Russu 1950, I. I.: *Limba traco-dacilor*, București, 1959, f. 113 e vijim.

¹²⁸ “Mi pare che queste divergenze non solo non giustificano l’ipotesi che l’illirico sia stato il progenitore dell’albanese, ma revochino in dubbio anche la possibilità che fra le due lingue vi sia una ‘parentela’ più stretta che non quella tra l’albanese ed il balto-slavo, per fare un esempio”.

¹²⁹ Dechev 1952, f. 92 e vijim

¹³⁰ Georgiev 1957, V.: *Trakijiskija ezik*, f. 64 e 81.

¹³¹ Duridanov 1976, I.: *Ezikat na trakite*, Sofija, f. 94.

helenizuara ose të gjuhëve të tjera, si ilirishtja, peonishtja, etj; Barić-i¹³² e Jokl-i shihnin alternancë *a/o*, ndërsa Russu-i¹³³ ishte në favor të ruajtjes së timbrit origjinar të **ǫ* në trako-dakishten (*a* do të ishte sporadike).

“Sigurisht, nuk mund të thuhet se sundon pajtim midis studiuesve të trakishtes dhe të dakishtes lidhur me refleksin në këto gjuhë të zanores **ǫ*; do të doja të vërej sesi një korrespondencë e përsosur me shqipen në këtë pikë do të implikonte më së shumti përkatësinë e gjuhëve të tilla në sektorin qendro-oriental të indoeuropianishtes...”, di Giovine 1979: 401.¹³⁴

Georgiev-i,¹³⁵ si Jokl-i,¹³⁶ ka shënuar afinitetin e trajtimit të **ǣ* në shqipen e dako-mezishten (diftongim në *je*, disa herë në *ja*); vrojtime për cilësinë e fenomenit në shqipen bëjnë di Giovine-n ta ridimensionojë këtë konkordancë. Po pranuar që diftongimi që ndeshet në dako-mezishten është i identifikueshëm me atë të shqipes, duhet të supozojmë se fenomeni shqip del në kohë më parë antike, jo më vonë se shekujt e parë të epokës sonë, f. 401. Analiza e shqipes bën të mundur të konstatojmë diftongim të kufizuar të kësaj në shqipen në pozitë të theksuar¹³⁷ (shih *pjek* ndaj ind. së vj. *pácati*, gr. *πέσσω*, lat. *coquō*, sl. e vj. *pekǫ*), apo fenomen sekondar që në disa zona dialektore ishte ende prodhues pas simplifikimit të **ew* në *e* (shih *hedh* geg. edhe si *hedh* khs. ags. *scēōtan*, an. *Skjota*). Diftongimin e **ǣ* në shqipen e në dako-mezishten i shihte zhvillime paralele të pavarura, mbase si efekt të një substrati të përbashkët ballkanik,

¹³² Barić 1955: 37.

¹³³ Russu 1959: 94.

¹³⁴ “non si puo certo dire che regni la concordia fra gli studiosi del tracio e del dacio riguardo all’esito in queste lingue della vocale **ǫ*; vorrei osservare come anche una perfetta corrispondenza con l’albanese su questo punto implicherebbe al piu l’appartenenza di tali lingue al settore centro-orientale dell’ indoeuropeo...”

¹³⁵ *Albanisch*, 2 e tutje.

¹³⁶ Thraker, 285 e vijim.

¹³⁷ Georgiev: 1960: *Albanisch*, f. 3, ndër shembuj diftongimi jep: **pǣ* në *je*, e riabsorbuar pas palatales, *pesë* nga **penǣje*, e kjo nga **penkwe*. Di Giovine shënon faktin se nuk mund të mos vihet re pasaktësia e **pǣ* në *je*, ku supozohet diftongim i e të patheksuar dhe mosdiftongim të e të theksuar, khs. me *pánĉa*, *πέντε*. Por pyet pse jo **pjesë* në vend të *pesë*, por këtë e shpjegon me rënien e hundores, madje Bogdani ka *pensë*.

pra nuk kishte presupozime për të vendosur kështu një indicie në favor të prejardhjes dako-meze të shqipes, di Giovine 1979: 402.

Duan marrë në vështrim dhe zhvillimet e fonemave të gjata **ē*, **ā* dhe **ō*. Dy të parat u bashkëshkrinë në një stad në **ā* që si rezultat final dha *o* ('shih për **ē* i *plotë*, analoge me ind e vj *prātá-* e lat *im plētus*); për **ā* *motër*, gr *μητήρ*, lat *māter*, aat. *muotar*; kalimi nga **ē* në **ā* vendoset në periudhën që ndërfitet midis palatalizimit të labiovelareve (**ē* duhej të ishte ende e dalluar nëse shq. *zorrë* del nga **g^wēr-nā*, ku shihet grada e zgjatur e **g^wer-*) dhe palatalizimit të velareve (**ē* nuk ishte më zanore palatale: *kohë* – jo *qohë* nga **kēs(k)*-, siç tregon krahasimi me sll. e vj. *časъ*); stadi final *o* duhej të kishte arritur para epokës së huazimeve nga lat. (ku **ā* dhe **ē* nuk alternojnë), por pas kontakteve të para me gr. e lashtë¹³⁸ (*mokërë* del nga *μῶχανά*¹³⁹), di Giovine 1979: 402.

Vështirësitë që nxjerr krahasimi me trakishten e dako-mezishten janë të dy radhëve: nuk është e sigurt as për njërën as për gjuhën tjetër se **ē* origjinare do t'i ketë lënë vend *a*-së, ndërsa fonema e fundit do të duhej të ishte dhe rezultat i një shkalle të reduktuar **ə* (kjo është pasiguria më e madhe për atë që do të shohë **ē* origjinare në sufiksin *-deva/ -dava*;¹⁴⁰ së dyti, rezultati *o* i **ā*, **ē*, që Georgiev-i hipotetifikisht e vendoste tek dako-mezishtja,¹⁴¹ nuk dëshmohet në të dhëna para sh. II-III, pra është i mëvonë, ndërsa në shqipen fenomeni do të ketë qenë i epokës që përfshin huazimet e para latine, di Giovine 1979: 403.

**ō* ka dhënë *e* në shqipen, një nga alternimet vokalike më të vona të shqipes, ka përfshirë të gjitha huazimet latine: *pōmum*: *pemë*, *hōra*: *herë*, si *tetë* nga **ōktō(w)-ti*; trakishtja nuk ofron elemente për gjykim, sepse ruan timbrin origjinar si *w*: *Στρυμών*, *Μυγδών*; Georgiev-i thotë se në

¹³⁸ Shih *qepë* nga *cēpa*, *paq(ë)* nga *pāce(m)*, *rapë* nga *rāpa*, etj.

¹³⁹ Referonte Thumb: 1909, A.: *Altgriechische Elemente des Albanischen*, in *Indogermanische Forschungen* 26, f. 16.

¹⁴⁰ Referon Jokl, *Thraker* 287; Russu 1959: 94; Dechev 1960: 164; Georgiev 1957: 56.

¹⁴¹ Georgiev, *Albanisch*, 5 e tutje; për **ē* > *o* citon emrat e qyteteve me *-dova*; për **ā* > *o* vetëm *Δοκί-δαυα*, pra **ā* e *Δᾶκ* u modifikua në *o*.

dakishten nëpër fazën **oi* (**ö*) iu afrua një përfundimtareje e. Vërente vë-shtirësi të natyrës kronologjike, di Giovine 1979: 403.¹⁴²

Sa për **ū* si paragon për shqipen e trakishten¹⁴³ a dakomezishten¹⁴⁴ përmes palatalizimit nuk e vlen të flitet si për fenomen të veçantë; diç e tillë ka ndodhur në gjuhë të ndryshme të Europës, Di Giovine 1979: 403.

Zhvillimi i diftongjeve origjinare me element të dytë **y* (**ey* **oy* **ay*), sipas di Giovine, përbën shembull relevant të mospërkimit midis situatës së shqipes dhe të dako-mezishtes. Midis shqipes e trakishtes Jokl-i kishte parë analogji të zhvillimi i diftongjeve me **w*, për aq përse në të dy gjuhët u zhduk elementi sonantik (**ow* e dalluar nga **ew*, do të jepte *a* si **aw*, ndërsa rezultati i **ew* do të ishte *e*). Shqip për **ew* shih *hedh*, *desha* ndaj gr. *ἄγευσα*; për **ow* e **aw* monoftongimi në *a* te *kapë* 'mucchio' nga **kowp-*, shih *kaofa-*, lit *kaũpas*; *lag*, rus. *луža*, lit. *liũgas*, *qaj* gr. *ἔκλαυσα*. Sipas Russu-it, mendohet se në trakishten **ew* pati zhvillim në *e* në epokën historike (top. *Πεόκη, ζέτραια* nga **ghew-*), f. 405. Nuk ka pajtim sa i përket **ow* e **aw*. Georgiev¹⁴⁵ ka veçuar një monoftongim analog në *e* nga **ew* dhe një reduktim të **aw* në *a*. Në çdo rast, afria në rezultatet e diftongjeve në **w*, shpesh u konsiderua një nga argumentet kryesore në favor të prejardhjes trakase të shqipes, në fakt ka një vlerë mjaft të kufizuar, nëse merret parasysh se konfluencia e **ew* me **ow* paraqet një inovacion sporadik për pak zona gjuhësore (baltike, armene, italice, pjesërisht keltike), sepse diftongimi i konservuar, i dëshmuar dhe në zonën ballkanike, nuk është tipar ekskluzivisht nga trakishtja (apo dakishtja) e shqipja; monoftongimi suksesiv me humbje të elementit sonantik, as ky nuk është ekskluzivisht i atyre gjuhëve, po del edhe në ilirishten.¹⁴⁶

Në refleksin e hundoreve rrokjeformuese shqipja dallohet qartë nga

¹⁴² Referonte Reichenkron 1966, G.: *Das Dakische*, 180 për interpretim të ndryshëm.

¹⁴³ Barić 1955: 36; Dechev 1952: 96.

¹⁴⁴ Georgiev 1960: 9.

¹⁴⁵ *Albanisch*, 11.

¹⁴⁶ Krahe 1940, H.: *Beiträge zur illyrischen Wort- und Namenforschung*, in *Indogermanische Forschungen* 57, 116; Mayer 1959, A: *Die Sprache der alten Illyrier*, II, Wien 1959, f. 144 e vijim.

gjuhët e tjera: në trakishten zgjidhja e **η*, **η* origjinare kalon përmes zhvillimit të një vokali mbështetës *i* apo *u* (fjala është për **e*m, **o*m origjinare); pos Jokli-t,¹⁴⁷ vetë Dechev-i¹⁴⁸ dhe Georgiev-i¹⁴⁹ kanë vërejtur se *a(n)* mund të jetë vazhdim trakas i **η*; kjo e fundit nga Georgiev-i i referohet dhe dakishtes. Edhe këtu di Giovine ka shumë diskutime detajesh për zhvillimet në shqipen (Di Giovine 1979: 406).

Në fushën e konsonantizmit Poghirc-u¹⁵⁰ mendonte se alternimi *m/mb/ b* është fenomen tipik i dakishtes e shqipes, prandaj fliste në favor të prejardhjes dakase të shqipes. Di Giovine theksonte se faktet nuk tregojnë një fenomen unitar alternimi, po janë rezultat i transformimeve fonetike me shkaqe të ndryshme (di Giovine 1979: 407).

Në konsonantizëm do shqyrtuar nëse ka korrespondenca midis shqipes e trako-dakishtes në dy pika: prania ose jo e 'Lautverschiebung' (mutacionit bashkëtingëllor) dhe ruajtja ose jo e tri radhëve të dorsaleve IE (tektaleve). Shqipja i ka ruajtur të zëshmet e të shurdhëtat, por nuk i ka ruajtur të aspiruarat; i ka shkrirë me të zëshmet e thjeshta: *dhëmb*: ind. e vj. *jámbha-*, gr. *γόμφο*s 'chiodo', sll. e vj. *zobъ*; *djeg*, nga **dheg^whō*, ind. e vj. *dáhati*, gr. *τέφρα* 'cenere', *θεπτανός* 'acceso', lit. *Degù*; pra, mendonte di Giovine, nuk ka bazë hipoteza e Jokli-it¹⁵¹ që lejonte njëlloj 'Lautverschiebung' për shqipen në bazë të tendencës së shurdhimit, që ndodh në fund dhe vetëm në një dialekt. Nëse është e vërtetë se në trakishten kemi mutacion konsonantik, siç kanë menduar Jokli-i,¹⁵² Dechev-i,¹⁵³ Georgiev-i¹⁵⁴ e Duridanov-i,¹⁵⁵ kjo përbën një divergjencë të pakapërcyeshme midis shqipes e trakishtes (di Giovine 1979: 408).

¹⁴⁷ Jokl, *Thraker*, f. 288.

¹⁴⁸ Dechev 1952: 101.

¹⁴⁹ Georgiev 1957: 64.

¹⁵⁰ Op. cit 97 e vijim.

¹⁵¹ Jokl, *Thraker*, 289 e vijim.

¹⁵² *Thraker*, 289 e vijim.

¹⁵³ Dechev 1952: 65 e vijim.

¹⁵⁴ Georgiev 1957: 72 e vijim.

¹⁵⁵ Duridanov 1976: 100 e vijim.

Ndryshe nga Hermann, Çabej, e Georgiev, Di Giovine mendonte se dallimi në shqipe i labiovelareve para zanoreve të përparme garantohet nga shembuj të mirë: velaret e ndjekura nga **ǣ* **ǣ̃* japin *q*, *gj*: *qeth* nga **ker-t-* (arm. *k'ërem* 'scortito, desto' gr. *κείρω* 'io toso', lit. *kertù* 'colpisco, taglio'; *qoj* me palatalizim jo të ri, ind. e vj. *cyavate* 'si muove', gr. *σεύω* 'spingo, desto', lat. *cieō*; *gjalmë* nga **gel-m-*, edhe te lat. *glomus* e lit. *gle-ñžti* 'raccoliere'; *gjizë* khs lit. *gįžti* 'inacidire del latte', oset. *ənyist* 'fermentato', irl. e vj. *gér* 'aspro', arm. *kic* 'puntura', *kc-ow* 'aspro, rancido', *z-kc-ank* 'amarezza, dolore', sufiks me nazal mund të supozohet edhe për shqipen nëse *gjizë* nuk është sekondare, di Giovine 1979: 409, jep edhe bibliografinë përkatëse. Rerfleksi sibilant i labiovelareve të ndjekura nga zan. palatale është dëshmuar nga Pedersen-i: *pesë* nga **penkwe*, ind. e vj. *pāñča*, gr. *πέντε*, *zjarm* nga **gwherm-*, ind. e vj. *gharmá-* 'calore', arm. *ǰerm*, gr. *θερμός* dëshmojnë se labiovelaret në shqipen kanë pasur zhvillim të ndryshëm nga velaret në prani të një zanoreje të përparme, f. 409. Ka rëndësi të shihet nëse labiovelaret dallohen nga velaret edhe në trakishten e dakishten. Për trakishten duket krejt e pabesueshme. Hipoteza e Jokl-it¹⁵⁶ pas të cilit në trakishten ruhej labiovelarja me kalim të **gw* në *b* e me delabializim të *g^wh* pas aspirimit, mbështetet në argumente vështirë të pranueshme. Shumica e studuesve mendon se në këtë gjuhë labiovelaret origjinare janë delabializuar plotësisht.

Për dakishten Georgiev-i mendonte se labiovelaret kanë marrë koeficient labial, kështu që këto velare sekondare të ndjekura nga **i*, **e* do të jenë transformuar në **k`*, **g`*, **t`*, **d`* dhe më në fund në afrikate, si te shembujt e mundshëm *Tierna*, *Dierna*, *Tsierna*, *Zierna*; në këtë aspekt ai ravizonte zhvillimin e shqipes në *s*, *z*. Di Giovine shihte aty një motiv themelor për refuzim të këtij afrimi midis shqipes e dakishtes: edhe po të lejojmë në dakishten një konfluencë të përgjithshme midis labiovelareve e velareve origjinare, po të lejojmë po ashtu që velaret të kenë pësuar palatalizim para se të jenë delabializuar, duket prapë se shqipja largohet qartë. Në rastin e parë për shkak se dakishtja do të ketë reduktuar dorsalet

¹⁵⁶ Jokl, *Thraker*, 293.

në dy tipa; në rastin e dytë sepse palatalizimi (asibilimi) i labiovelareve në shqipen ka ndodhur para dhe jo pas atij të velareve (*k e *g(h) nuk kanë kaluar në q, gj para *ē origjinare, si te kohë nga *kēsĕ-, sll. *časъ* (referonte Hamp, *On some Etymologies of Albanian*, in *Studia albanica* 2, 1973, 83-88; di Giovine 1979: 410). Kjo do të thotë se palatalizimi, ndryshe nga ai që ka ndodhur për labiovelaret, ka ndodhur pas ndryshimit të timbrit të *ē-së. Palatalizimi ka ndodhur edhe më vonë si te *digjem* nga *djeg, qiell* nga *kēlu (di Giovine 1979: 411).

Sa i përket vazhdimit të dorsaleve IE trakishtja dhe dakishtja divergojnë ndjeshëm nga shqipja; ky është një argument që nuk shkon në favor të prejardhjes trakase a dako-meze të shqipes (di Giovine 1979: 411).

Nga të dhënat e sipërme, mendonte ai përfundimisht, është e vështirë të nxirret përfundimi për një raport gjenetik midis trakishtes (a dakishtes) dhe shqipes. Mendonte po ashtu se në këto shqyrtime duan marrë në konsideratë edhe raportet midis kulturave të ndryshme. Një prej elementeve me rëndësi i dukej konfrontimi midis sistemeve fonologjike. Prandaj i dukej se hipoteza e Hirt-it, e rimarrë nga Jokl-i e Weigand-i e të tjerë, e shfaq dobësinë e saj pikërisht në fushën e fonologjisë së krahasuar, që nga momenti që konkordancat janë pak sinjifikative, ndërsa mospërkimet shfaqen në pika me rëndësi për sistemin fonologjik, si refleksi i nazaleve silabike, i diftongjeve me *y, i sibilanteve origjinare dhe i trajtimit të mënyrës së nyjetimit të bashkëtingëlloreve e të dorsaleve IE.

Ridiskutimet nga Matzinger-i

Krejt vonë tani kemi një ridiskutim të çështjeve nga Joachim Matzinger.¹⁵⁷ Ai e niste raportin e tij për dy hipotezat e fillme – ilire e trakase, pastaj për hipotezën iliro-trakase të Jokl-it, me theksimin e mbështetjes për hipotezën ilire për shkak të autoktonisë dhe me raportimin për përsë-

¹⁵⁷ Matzinger 2012, Joachim: *Zur Herkunft des Albanischen: Argumente gegen die thrakische Hypothese*, në Bardh Rugova (red.): *Studime për nder të Rexhep Ismajlit*, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë dhe Koha, Prishtinë, ff. 463-477.

ritjen e hipotezës trakase nga G. Schramm-i. Bënte dallimin midis etnogjenezës dhe glotogjenezës. Sa i përket glotogjenezës së shqipes, ajo shkon thellë në errësi kohe dhe s'ka metodë për ta hetuar. Por shqipja është gjuhë IE që u soll në hapësirën e Europës Juglindore diku në kohët parahistorike. f. 464. Por sa u përket karakteristikave fonologjike e morfologjike, mendonte se në krahasim me gjuhët e tjera IE, ajo mund të vendoset diku në gjysmën e dytë të mijëvjeçarit të dytë para K. (referonte Schumacher, Hajnal). Tiparet e hershme gjuhësore në fonologji i shihte kështu:

- a. zhbuzorëzim dhe hapje e IE */o/ drejt Frühalt. (shqipe e hershme) */a/ dhe bashkimin me refleksin e IE */a/ në Fruhalb */a/;
 - b. hapje dhe ngritje e IE */ē/ drejt Frühalt */ā/ dhe bashkim kështu me refleksin e IE */ā/ në të trashëguarën */ā/;
 - c. afrikatizim i tektaleve palatale IE */k̄/, */ḡ/ e */ḡ^h/ në Frühalt */ć/ e */j̄/;
 - d. palatalizim i labiovelareve të trashëguara IE */k^w/, */g^w/, */g^{wh}/ në Frühaltbanisch */č/ e */j̄/ në pozitë para */e/, */i/ dhe para gjysmëzanores */ī/. f. f. 465-6.
1. Të rëndësishme në historinë e shqipes kanë qenë kontaktet me greqishten e vjetër, me latinishten e me sllavishten. Më të rëndësishme janë huazimet latine, si më të numërtat.
 2. Historia gjuhësore e lashtë e shqipes në bazë të latinizmave mund të ndahet në dy periudha (Referonte Schumacher 2007: 211):
 - a. *Frühuralbanisch*: nga ndarja nga gjuha bazë IE deri në fillim të depërtimit të huazimeve latine;
 - b. *Uralbanisch* (shqipe e lashtë, stërsHQipe): nga fillimi i depërtimit të huazimeve lat. deri te fillimi i ndarjes së tipareve dalluese geqe e toske.

Në bazë të huazimeve latine që merren si pikë prej nga nisej për ndryshimet fonologjike, i dukej e mundshme të rindërtohej sistemi fonologjik i *Frühuralbanisch*, pra i periudhës para huazimeve latine:

zanore të shkurtra: */a/, */e/, */i/, */u/
 zanore të gjata: */ā/, */ō/, */ī/, */ū/
 obstruentë: */b/, */d/, */g/, */p/, */t/, */k/,
 rezonantë: */l/, */ll/, */m/, */n/, */nn/, */r/, */rr/
 aproksimantë: */j̄/, */j̄/
 sibilantë: */ś/ (<*/s/), */ž/
 spirante: */f/ (< */sp/), */x/ (< */sk/)
 afrikatë: */ć/, */j̄/, */č/, */j̄/

Ky sistem i *Frühuralbanisch* (shqipes së hershme) duhet të krahasohet me sistemet e gjuhëve të njohura lashtoballkanike si ilirishtja, dakishtja,

trakishtja, Matzinger 2012: 467. Problemi më i madh, sipas tij, qëndron në njohjen marginale të atyre gjuhëve. Ilirishtja njihet vetëm sipas materialeve onomastike. Dakishtja mund të rindërtohet pjesërisht nga materiali onomastik, glosat dhe një numër emrash të bimëve. Material i shkruar epihorik gjendet vetëm për trakishten nga Samotraka dhe nga Duvanli, ashtu si dhe nga unaza e Ezerovos dhe nga guri në Qolman. Ato nuk janë interpretuar. Prandaj krahasimi do bërë në saje të rindërtimeve nga glosat e nga materiali onomastik. Ka shumë diskutime e kontraverza. Prandaj ka pak mundësi të rindërtimit të sistemit fonologjik të trakishtes, kjo domethënë dhe të krahasimit me gjuhët e tjera të lashta dhe me shqipen. Materiali trakas është shkruar me alfabet grek apo latin, kjo sjell vështirësi shtesë, Matzinger 2012: 468-9.

Bazat e sistemit fonologjik të trakishtes i shihte kështu:

a. Ndryshimi i palataleve IE në fonema që tek autorët grekë shënohen me <σ>, <ζ> ndërsa tek autorët latinë me <s>, <z>. Kështu një nga njohjet më të sigurta të sistemit fonologjik të trakishtes është se palatalet IE në trakishten patën një zhvillim 'satəm'. Shembull: 'Εσβ-/Esb- (< IE *h₁eḱlo-) dhe -ζενης/-zenus (<IE *ĝenh₁-; khs. gr. – γενης).

b. Refleksi i tiparit [+aspirim] i *mediave aspirate* IE dhe me këtë bashkëshkrirja me zëvendësuesin e mediave të thjeshta. Shembuj: emër vendi Δάτων (<IE *d^heh₁-) apo glosa βρῦτος (< IE *b^here!H-) (Referonte Velkova 1986: 53.)

c. Refleksi i elementit labial i labiovelares IE (referonte Katičić, te Neumann 1979: 783, Brixhe & Panayotou 1999: 179, Hajnal 2004: 141), shembuj: Γερμ-, në Γερμανία (< IE *g^{uh}er-, ov ('Fleisch', referon Velkova 53) (< IE *g^{uh}en-), Matzinger 2012: 470.

d. Ndryshe nga ç'kanë thënë studiues të tjerë, te mbylltoret e trakishtes nuk ka ndodhur asfarë *Lautverschibung* dhe mënyrat e nyjëtimit të bashkëtingëlloreve *tenues* dhe *mediae* në thelb janë ruajtur, Matzinger 2012: 470.

e. Lidhur me diskutimet e zanoreve, konkretisht lidhur me trajtimin e IE */o/, për çka në literaturë kryesisht mendohet se në trakishten është zhvilluar drejt /a/, mendonte se ende nuk kemi një përgjigje përfundim-

tare, sepse materiali është kundërthënës, Matzinger 2012: 471.

Po të merren parasysh këto veçori fonologjike të trakishtes dhe po të krahasohen ato me të sistemit fonologjik të *Frühuralbanisch*, i dilnin dy tipare që shënojnë një diskrepancë: derisa në zhvillimet trakase *satem* të palataleve IE do të kenë arritur herët në sibilante (për këtë shih dhe Hamp më sipër), në *Frühuralbanisch* kemi, sipas rindërtimit të tij afrikate të qarta */ć/, përkt. më vonë *t^s dhe */j/ përkt. më vonë */dʔ/ (referonte Schumacher 2009:42 lidhur me rum. *țarc* që supozonte se dilte nga shq. */thark-/). Edhe më interesante i dilte çështja e refleksit të labiovelareve, që në trakishten shfaqin bjerrje të elementit buzor, ndërsa në *Frühuralbanisch* para zanoreve të përparme kemi zhvillimin drejt */j/, më vonë /z/ dhe ky trajtim i ndryshëm tregon jo më dallime dialektore, po në fakt gjuhësh të ndryshme dhe kjo izoglosë tregon se midis trakishtes dhe shqipes nuk ka afri të ngushtë, sidomos jo rrethana prejardhjeje.

*“Me këtë, porse, teoria, pas së cilës shqiptarët gjuhësisht duhet të jenë pasardhës të besëve trakas, kundërprovohet”.*¹⁵⁸

Pasi bënte vërejtje lidhur me saktësinë e interpretimit të materialeve të disponueshme, rikujtonte përfundimin që sistemet fonematike të trakishtes dhe të *Frühuralbanisch* në një pikë vendimtare janë shumë divergjente dhe kjo nuk shpjegohet me zhvillime dialektore apo me kronologji. Prandaj

*“... rrjedh përfundimi këlthitës se midis trakishtes dhe shqipes nuk mund të ketë asfarë relacioni prejardhjeje dhe prandaj shqipja nuk duhet të shihet si pasardhëse e trakishtes, ku do të përkiste dhe gjuha e besëve”.*¹⁵⁹

Në fund fare Matzinger-i, duke ripohuar se shqipja nuk mund të jetë pasardhëse e asnjërës prej gjuhëve të lashta ballkanike (as e ili-

¹⁵⁸ “Damit aber wird die Theorie, nach welcher die Albaner sprachlich die Nachkommen der thrakischen Bessen sein sollen, widerlegt”, f. 473. Të shihet diskutimi i Hamp-it lidhur me emrin *Biso* i raportuar më sipër.

¹⁵⁹ ... folgt der zwingende Schluss, dass zwischen dem Thrakischen und dem Albanischen kein Abstammungsverhältniss bestehen kann und so das Albanische daher auch nicht als Fortsetzer des Thrakischen, was auch die Sprache der Bessen gewesen sein dürfte, aufgefasst werden darf”, f. 474.

rishtes as e trakishtes), prandaj mbetet vetëm një përfundim se

*“shqipja duhet të jetë pasardhëse e një gjuhe lashtoballkanike të pavarur prej tyre, të veçantë”.*¹⁶⁰

Në studimin e tij të botuar me 2009¹⁶¹ Joachim Matzinger me-
rrej drejtpërsëdrejti me çështjen e raportit të shqipes me ilirishten.
Në fillim rikujtonte idenë e panilirizmit tashmë të kritikuar gjerësisht,
e shpesh të përhapur në mënyrë jokritike në albanologji. Në pjesën e
hyrjes ai nxirrte këtë përfundim:

*“Sidomos për përfytyrimin e vetë shqiptarëve prejardhja e gjuhës së
tyre nga ilirishtja është me rëndësi, e me këtë bashkë shkon dhe su-
pozimi (së paku nga kohët antike) i vazhdimësisë së pandërprerë i po-
pullsisë së hapësirave shqipfolëse (hipoteza e autoktonisë), supozim
që, qysh nga fillimi u përdor për qëllime politike, madje edhe doktri-
narisht u shpërdor”, Matzinger 2009: 98.*¹⁶²

Në fusnotë shënonte se hipoteza për prejardhjen ilire të shqip-
tarëve ka qenë ndërtuar posaçërisht në diasporën italo-shqiptare dhe
prej andej është propaguar më tej. Këtu referonte Bartl 2000. Ndërsa
për shpërdorimin në fjalë referonte Kostallari 1971.

Lidhur me këto duhet të shënoj po ashtu se pajtohem plotë-
sisht që të gjitha aspektet që janë cilësuar si *paniliriste* meritojnë dhe
tashmë kanë marrë kritika të gjithanshme. Shumë prej atyre aspekte-
ve në albanologjinë serioze të pjesës II të sh. XX nuk kanë zënë rrë-
një, ose nuk janë marrë parasysh fare. Natyrisht, kjo nuk ka të bëjë
me hipotezën që parashikon mundësinë e prejardhjes ilire të shqipes

¹⁶⁰ “... das Albanische der Fortsetzer einer davon unabhängigen, eigenständigen alt-
balkanischen Sprache sein muss”, f. 474.

¹⁶¹ Matzinger 2009, Joachim: *Illyrisch und Albanisch – Erkenntnisse und Desiderata*, in
Die Sprache 48, *h2nr. Festschrift für Heiner Eichner, Wiener Sprachgesell-
schaft/ Harrasowitz Verlag, Wiesbaden, pp. 98-106.

¹⁶² “Besonders für das Selbstbild der Albaner ist die Herleitung ihrer Sprache aus dem
Illyrischen von Bedeutung, geht doch damit die Annahme einer (mindestens seit an-
tiken Zeiten) ununterbrochenen Bevölkerungskontinuität albanischsprachiger Gebiete
einher (Autochtoniehypothese), eine Annahme, die bereits seit Anbeginn für poli-
tische Zwecke gebraucht, ja auch durchaus doktrinär misbraucht wurde”.

dhe të shqiptarëve. Duke lundruar në valët e *anti-panilirizmit* si ideologji dhe të *antiliromanisë*, madje, ka rrezik të biem në *ilirofobi*, çka po ashtu meriton vëmendje.

Hipoteza për prejardhjen ilirie të shqiptarëve, në të vërtetë, bu-
rimin e ka qysh te letrat e Leibnitz-it dhe është formuluar tek autorë
si J. Thunmann e të tjerë më vonë, para se të shfaqej tek autorët
arbëreshë. Madje, në albanologjinë shqiptare ajo ka ardhur përmes
albanologjisë serioze të së kaluarës, nga G. Meyer, H. Pedersen e të
tjerë dhe jo nga arbëreshët.

Nëse supozimi për kontinuitetin e popullsisë shqiptare në hapësirat
shqipfolëse, hipoteza e autoktonisë, paska qenë shpërdorur qysh nga fi-
llimi për qëllime doktrinare dhe për qëllime politike, pse nuk paska qenë e
mundshme që një shpërdorim i tillë të ndodhte dhe me hipotezat e kun-
dërta, të admigracionit dhe të prejardhjes trakase të shqipes e shqipta-
rëve? Kështu mund të shkualifikojmë çdo lloj hipoteze.

Mungesat në studimet iliristike Matzinger-i i shihte edhe si pasojë
të panilirizmit dhe të shpërdorimit politik të teorive të kontinuitetit.

*“Një gjendje kaq dëshpëruese sa i përket fuqisë dëshmuese të ilirishtes –
një rrethanë e pakëndshme, që i përket edhe gjuhët e tjera lashtobalka-
nike si trakishtja e dakishtja – në sytë e shumicës së gjuhëtarëve historistë
nuk hodhi as hedh asfarë fuqie të veçantë tërheqëse për qëllime studimi”,
Matzinger 2009: 99.¹⁶³*

Referonte për trakishten Brixhe & Panayotou 1997.

Do thënë gjithashtu se gjendje e ngjashme sundon dhe lidhur me
trako-dako-geto-frigjishten e gjuhët e tjera të Ballkanit të lashtë, por atje
nuk kemi etiketime si *panilirizëm* – pra *pantrakizëm*, as lidhur me inter-
pretimet po kaq doktrinarë të substratit trako-dako-get apo të pellazgjish-

¹⁶³ “Die so desparate Bezeugungslage des Illyrischen – ein ungünstiger Umstand, der
auch auf andere bekannte altbalkanische Sprachen wie Thrakisch und Dakisch zutrifft
– verlieh und verleiht in den Augen der meisten historischen Sprachwissenschaftler
dem Illyrischen keine besondere Anziehungskraft für Forschungszwecke”.

tes si paraardhëse e trakishtes, që në traditën pas-georgieviane shkon deri te dogma.

Preokupimi me ilirishten mund të japë vetëm rezultate sipërfaqëso-re, për shkak se ka mungesë tekstesh, mendonte Matzinger-i dhe për gjendjen e njohjeve për ilirishten referonte shqyrtimin e Eichner-it 2004. Fillimisht shënonte se kemi të bëjmë me përcaktim të konceptit të *Illyrii proprie dicti*, që ishte sugjeruar nga koha e Pedersen-it dhe bërë traditë nga Katičić e këtej, e i cili, ç'është e vërteta, në albanologji qarkullon gjerësisht, pra më herët se të botohej artikulli i Eichner-it. Për diçka kishte lënë të kuptohet edhe Pedersen-i. Ai po ashtu lë të kuptohet se nga onomastika në këtë drejtim nuk mund të nxirret shumëçka.

Raportonte se është menduar që një përgjigje nëse shqipja, që sot flitet në territorin antik të ilirishtes, është pasardhëse e ilirishtes mund të japë vetëm toponomastika. Aty duhet të hetohen rregullat e zhvillimit fonetik të shqipes, sipas përfaqësuesit më të shquar të kësaj rryme të menduari - Çabejtë. Këtë e shihte korrekte, por vetëm si gjysmën e së vërtetës. Këtu sillte vërejtjen se

“në historinë e shqipes dy faza të ligjeve fonetike kronologjikisht të dallueshme duan mbajtur saktësisht veçan nga njëra tjetra”, Matzinger 2009: 101.¹⁶⁴ Referonte: Matzinger 2009a, 21; 2009b, 88; Schumacher 2007: 211.

Lidhur me periodizimet e zhvillimeve të shqipes mendoj se duan parë vërejtjet e Demirajt (shqipja si bijë e ilirishtes u formua më vonë); të Bokshit, 2012, ku jepen dhe idetë e Desnickaja-s, të Rizës, të Çabejtë, të Mansakut, etj.

Matzinger-i vërente, pas Mihăescu-t 1985 (!), ndryshime midis reflekseve dhe zhvillimeve nga pushtimi romak 167 para Krishtit, pas-taj gjatë sundimit romak dhe pas v. 600. Për këto faza referonte: Matzinger 2006 23; Hock 2005; Schumacher 2007: 2011.

¹⁶⁴ “In der Sprachgeschichte des Albanischen zwei chronologisch differenzierte Phasen von Lautwandeln abgelaufen sind, die strikt auseinanderzuhalten sind”.

Shqyrtimin e toponimeve ai e ka bërë gjetiu (Matzinger 2009a: 22; 2009b). Këtu rimerrte parimin me shembullin e emrit *Shkodër*. Lidhur me kontinuitetin gjuhësor iliro-shqiptar, këtu sillte në kujtesë dy ligje fonetike të shqipes: zhvillimin e /sk/ > /h/ (për shkallë të ndër-mjetme shih Schumacher 2007: 228; Matzinger 2009a 23; 2009b: 92)¹⁶⁵ dhe /ó/>/á/ (Matzinger 2009a: 23; Matzinger 2009b: 92), f. 102. Zhvillimi *ó > á dhe shkrirja me *á > á ngjet në kuadër ndryshimeve fonologjike të sistemit (Schumacher 2007: 211).

Emri *Scodra* drejt *Shkodër* ofron dy zëvendësime: /sk/: *shk* dhe /ó/ : ó “që kanë ndodhur pas huazimeve greke dhe latine”, 102¹⁶⁶ (zhvillimet *ó > á ashtu si *sk > *hk dhe shkallë të ndërmjetme të ngjashme janë procese shumë të hershme

“që kanë ndodhur qysh kur hynë huazimet e lashta greke në shqipen, për çka së paku si terminus post quem mund të merret gjysma e dytë e sh. 7 para K.” (Matzinger 2009v: 92). 102.¹⁶⁷

Prej kohës kur shënohej *Scodra*,

“nuk e njihje sistemi fonematik i shqipes së hershme as zanoren e plotë të theksuar /ó/ as kombinimin e fonemave /sk/. Prej këndeje del një diskrepancë e pakapërcyeshme midis sistemit fonematik të ilirishtes dhe të shqipes, çka të çon te përfundimi i detyrueshëm që (a) emërvendi nuk mund të jetë formuar në parashkallën e gjuhës që u zhvillua në shqipen dhe se (b) zhvillimi i emrit ka ndodhur nga koha e dëshimit antik deri në shqipen moderne. Por të dyja janë udhëzime vendimtare kundër një vazhdimësie lineare iliro-shqiptare dhe kundër postulatit të një autoktonie”, Matzinger 2009: 103.¹⁶⁸

¹⁶⁵ Mendoj se do parë si me vlerë studimi i Rusakov-it.

¹⁶⁶ “Erst nach der Aufnahme des griechischen und lateinischen Lehnguts eingetreten sind”.

¹⁶⁷ “Die schon eingetreten waren, ehe die altgriechischen Lehnwörter ins Albanische eingedragen, für die zumindest als terminus post quem die zweite Hälfte des 7. Jahrhunderts v Chr. angesetzt werden kann.”

¹⁶⁸ “Wies das früh-albanische Phonemsystem weder den betonten Vollvokal /ó/ noch die Phonemkombination /sk/ auf. Dadurch ergibt sich eine unüberbrückbare Diskrepanz zwischen dem illyrischen und dem albanischen Phonemsystem,

Po kjo vlen, sipas tij, edhe për emërvendet e tjera antike (për *Ulqin* e *Durrës*, shih Matzinger 2009a: 22; 2009b: 90; as hidronimet e hapësirës shqiptare nuk zëvendësojnë në mënyrë lineare format e emrave antikë, po kemi ndërmjetësimin sllav (Matzinger 2009a: 28). Për të gjitha këto duan parë dhe këndvështrime të tjera, sidomos ato të Sh. Demirajt (Demiraj 1999; 2006), i cili i ka zhvilluar më tej idetë e Çabejtë. As sa i përket saktësisë, as peshës së një argumenti të këtillë nuk mund të jemi kaq të prerë, si te ky përfundim:

“Toponimet nga ky aspekt i vështrimit na shpjen tek njohja e detyrueshme se shqipja nuk duhet të trajtohet si gjuhë pandërmjetshëm vijuese e ilirishtes antike. Toponomastika e vërteton postulatit e vjetër që te shqiptarët nuk sheh një popullatë autoktone në kuptimin e zhvillimit të vazhdueshëm nga popullata antike deri te shqiptarët e sotëm në këto hapësira. Shumë më tepër paraardhësit e shqiptarëve të sotëm në këto hapësira duhet të shihen si të ardhur” (Për Admigration cf. Matzinger 2009a: 28). Matzinger 2009: 103.¹⁶⁹

Por çështja se prej nga kanë ardhur dhe cilat janë raportet e shqipes me gjuhët dhe etnitë e tjera të Ballkanit të lashtë është komplekse (teza e Weigand-it 1927 për prejardhjen trakase u rimor te Schramm 1999; shih Matzinger 2009a: 29). Te Matzinger-i 2009a: 34 shqipja shihet si zëvendësues i një idiome lashtoballkanike që nuk ka raport bijërie as me ilirishten, as me trakishten. Matzinger 2009: 103.

die zu den zwingenden Schlüssen führt, dass (a) der Ortsname nicht in der Vorstufe jener Sprache gebildet sein kann, die sich zum Albanischen entwickelte und dass (b) die Entwicklung des Namens vom antiken Beleg zum modernen Albanischen verlaufen ist. Beides aber sind entscheidene Hinweise gegen eine lineare illyrisch-albanische Kontinuität und gegen das Postulat einer Autochtonie”.

¹⁶⁹ “Die Aussagen der Toponymie führen unter diesem Gesichtspunkt zur zwingenden Erkenntnis, dass das Albanische nicht als die unmittelbare Folgesprache des antiken Illyrischen betrachtet werden darf. Die Toponomastik bestätigt so das schon ebenfalls alte Postulat, dass es sich bei den Albanern nicht um Autochtonen im Sinne einer kontinuierlichen Entwicklung antiker Bevölkerungsteile zu den heute im albanischen Raum Ansässigen handeln kann. Vielmehr müssen die Vorfahren der heutigen Albaner in diese Räume erst zugewandert sein”.

Një ide të tillë që shqipen e sheh të një bijërie të ndryshme nga ilirishtja e nga trakishtja parimisht nuk mund ta mohojmë. Një ide të tillë e kishin nënkuptuar dhe studiues të mëhershëm, qoftë dhe vetëm implicite (shih për këtë Benveniste në klasifikimin e tij të gjuhëve, po edhe të tjerë, shih Ismajli 1987). Edhe përfundimet e di Giovine në artikullin e përmendur më sipër drejt një vështrimi të këtillë të shpien. Por kjo ende nuk do të thotë se shqipja nuk ishte në këto hapësira. Në kompleksin e shqyrtimeve të prejardhjes së shqipes dhe të shqiptarëve ka dhe shumë aspekte të tjera, sidomos kulturore, etnologjike, që çojnë peshë. Më në fund, nëse identifikimi i hapësirës ku paskan qenë paraardhësit e shqiptarëve u dashka dëshmuar përmes emërvendeve, ku janë ato gjurmë ku paskan qenë ata dikur? Mundësia që emrat *Naissus: Nish, e Astibos – Shtip* të kenë arritur në gjendjen e sotme përmes zhvillimeve të shqipes nuk do të thotë ende shumë, sepse në lashtësi ato vende mund të kenë qenë fare mirë në skajet e hapësirës së shqipes që njohim. Nuk kemi pasur asnjë shpjegim se përse Nish dhe Shtip dalin të vetmet gjurmë në hapësirat rreth tyre, pse s'ka atje gjurmë të tjera shqipe? Për më tepër, çfarë ndërmjetësimi mund të supozojmë për zhvillimet *Drilon – Dri, Matis – Mat, Scupi – Shkup, Drivastos – Drisht*, etj.?

Me këto ide dhe me idetë e ndërlydhura me qarkun e studimeve indoeuropiane ballkanike mund të shihet diçka dhe nga studimi i Wojciech Sowa-s.¹⁷⁰

*“Në indoeuropeistikën e sotme nuk ka asfarë dyshimi për të dhënë se në historinë e stërlashtë të greqishtes, armënishtes, shqipes dhe edhe të gjuhëve të tjera mund të qëndronte një parashkallë e përbashkët”, 2005: 611.*¹⁷¹

¹⁷⁰ Sowa 2005, Wojciech: *Anmerkungen zum Balkanindogermanischen*, in *Indogermanica*, Festschrift Gert Klingenschmitt, herausgegeben von Günter Schweiger, Tübingen, Schweiger VWT-Verlag, ff. 611-628.

¹⁷¹ “In der heutigen Indogermanistik besteht kein Zweifel darüber, daß in der Urgeschichte des Griechischen, Armenischen, Albanischen und auch anderer Sprachen eine gemeinsame Vorstufe vorliegen könnte”.

Sowa referonte Meier-Brügger 1992: 65 për kohën para 2000 para K., kur do të jenë krijuar përbashkësi në leksik dhe në morfologji, dhe kur popullatat e veçanta duhej të trajtoheshin si fise të dalluara. Ky areal, sipas Klingenschmitt-it, ishte quajtur ‘*Balkanindogermanisch*’ dhe përfshinte greqishten, frigjishten, armenishten, shqipen dhe për disa përbashkësi mbase edhe tokarishten (Klingenschmitt 1994: 244). Ky grup ballkanik shpreh disa përbashkësi, si

“Ruajtjen e tri radhëve të tektaleve (gjurmë të labiovelareve në armenishten), zhvillimet e veçanta të laringaleve pas /i/, khs. $*ih_2$, $*ih_1 > *i\text{-}\partial_2$, $-i\partial_1$ ”,¹⁷²

sipas Klingenschmitt-it aty përkon dhe shqipja $zonj\acute{e} < *d\acute{i}\acute{a}h\text{-}ptn\acute{i}\partial_2 < *desi\acute{a}s + potn\acute{i}\partial_2$, format e lokativit shumësi nga $*\text{-}si$, mbaresat e parme të përbashkëta të vetës 1 mesore $*\text{-}mai$, gr. *ἄραρε/ο*, arm. *arar*- si risim pas rënies së $*h_2$ dhe mbi të gjitha përkimet e numërta në leksik, që nuk janë krijuar përmes kontakteve të mëvona në periudhën historike: mohimi $*(ne)h_2oiu$ $k^u\acute{i}d$ (Klingenschmitt aty, f. 611-12).

Matzinger-i 2000: 75-87 shënonte 16 kritere, ku hynin edhe këto që u përmendën, po edhe të tjera: $*g\acute{u}nh_2\text{-}ai\text{-}$; aoristi $*e\text{-}k\acute{u}l\text{-}e\text{-}to$; $*smi\acute{i}o\text{-}$; semantika tek $*m\acute{r}\text{-}t\acute{o}\text{-}$, $*s\acute{m}e\acute{k}ureh_2\text{-}$, $*g^u\acute{h}er\text{-}mo\text{-}$; format përemërore me $au\text{-}$, zanorja protetike nga laringalja, e tashmja $*g^u\acute{i}oh_3\text{-}$ (referonte gr. *Γυναι-κ*, arm. *kanay*, frig. *κναικο, κναικαν*, shq. *grā* < $*g^u\acute{h}nh_2\text{-}ai\text{-}es$; gr. *ἔπλετο*, arm. *elew*, shq. e lashtë *cleh*, shq. veriore *qe*; arm. *mi*, shq. *një* < $*smi\acute{i}os$; gr. *ἔκυρά*, arm. *skeswor*, shq. *vjehërrë*; gr. *ἑρμός*, arm. *jerm*, shq. *zjarm*, frig. *Γερμη*, tok. *sărme*; gr. *αὐτός*, altfr. *avto-/* nfr. *avto*; gr. *πᾶς, παντ-*, altfr. *panta*, etj (Matzinger FT, 3), Sowa 2005: 612.

Dëshmitë për këtë vijnë kryesisht nga gr., armen. e shq., ndërsa për frig. ka pak probleme edhe për shkak të dokumentimit. (psh në frig. $*\text{-}si$ *ζεμελωσι* ‘den Menschen’ < $*oi\acute{s}i$, si dhe *τευτωσι* ‘den Gemeinden’ (Hajnal 2003: 129), Sowa 2005: 612.

Shikohen dhe materiale nga trakishtja, ilirishtja, makedonishtja e

¹⁷² “Bewahrung der drei Tektalreihen (Spuren der Labiovelare im Armenischen), die spezielle Entwicklung des Laryngals nach /i/, vgl. $*ih_2$, $*ih_1 > *i\text{-}\partial_2$, $-i\partial_1$ ”.

mesapishtja, ndërsa makedonishtja shpesh shihet si dialekt i greqishtes. Trakishten e njohim nga mbishkrime të pakuptuara, ndërsa ilirishten vetëm nga emra (për ilirishten shënonte glosën *rhinon*, ndërsa emrat *Gen-tius* e *Teuta* i dukeshin kelte, cf. Eichner 2004: 93, 114), Sowa 2005: 614.

Mesapishtja mund të merret parasysh, por, megjithë materialet jo të pakta dhe megjithë mundësinë e krahasimit me shqipen, ajo mbetet në skaje të hapësirës ballkanike, Sowa 2005: 614.

“Përbashkësitë e indoeuropeishtes ballkanike dalin nga rrafshet fonologjike, morfologjike ashtu si leksikore. Mendohet se ato janë krijuar si rezultat i kontakteve gjuhësore, se indoeuropianishtja ballkanike në atë rast mund të kuptohet si një lloj Shprahbundi i kohës së bronzit (Hajnal 2003, 142). Por duket se së paku greqishtja, makedonishtja, armenishtja dhe friggjishtja do të kenë dalë nga një parashkallë e përbashkët (Hajnal 2003: 135), çka mund të na udhëzojë tek një kontinuum dialektor i vonë indoeuropian parahistorik” (ref. Ritter-Sowa 2004: 646), Sowa 2005: 614.¹⁷³

E vërteta, lidhjet e shqipes me gjuhët IE të jugut i ka pasë theksuar dhe Çabej (*Hyrje.*). Qysh më 1966 S. Riza në vijën e diskutimeve të Kamardës, por jo me lashtësinë dhe gjerësinë që supozonte ai, kishte diskutuar konkretisht për lidhjet midis shqipes e greqishtes në raport me supozimin e tij për afrinë midis dy gjuhëve në kapërcimin nga dëftori te nyja (*hi he to – i e të*), por gjithnjë me një kronologji të mëvonë.¹⁷⁴ Një afri më të hershme të shqipes me greqishten, madje

¹⁷³ “Die Gemeinsamkeiten des Balkanindogermanischen beziehen sich auf die phonologische, morphologische sowie lexikalische Ebene. Man nimmt an, daß sie als Resultat von Sprachkontakten entstanden sind, - das Balkanindogermanische kann dann als eine Art Sprachbund der Bronzezeit verstanden werden (Hajnal 2003, 142). Es scheint aber, daß zumindest das Griechische, Makedonische, Armenische und Phrygische von einer gemeinsamen Vorstufe abstammen (Hajnal 2003: 135), was auf ein prähistorisches Dialektkontinuum im Spätindogermanischen weisen könnte”. Shqipen e vendoste duke iu referuar Pedersen KZ 36, 340; Thumb IF 36 1; Jokl *Albnaisch* in Streitberg, *Geschichte d. Idg. Sprachw.* II, 3, 80; *Reallexicon* 1, 84; *WuS* 12, 67.

¹⁷⁴ S. Riza, *Mbi një bashkëpërkim gramatikor të posaçëm të gjuhës shqipe me greqishten*, in Riza 2009, S.: *Veptra* 5, ASHAK, Prishtinë, 2009, ff. 564-569, për herë të parë nga dorëshkrimi i vitit 1966, botimi i të cilit ishte pamundësuar deri te *Studime* 10, 2004.

më të hershme se ç' supozohet për afrinë midis shqipes e balto-sllavishtes, e theksonte dhe W. Porzig.¹⁷⁵ Natyrisht, kjo ide ngre shumë çështje dhe lë pezull aspekte të ndryshme në këtë drejtim.

Në njëfarë mënyre ideja e afrisë me këtë bllok gjuhësh ishte vënë në pah edhe nga V. P. Нерознак (*Paleobalaknskie jazyki*), por vetëm për kohët paleobalkanike dhe edhe atëherë ai paraardhësen e shqipes e shihte në anën perëndimore, ndërsa ashtu e përgjithshme dhe me sprovë konkretizimi del edhe tek studimi i W. Fiedler-it: ky i fundit ndalonte sidomos në tri pika kryesore: te çështja e nyjës, te çështja e mohimit dhe te çështja e diatezës.

Në konceptimin e përgjithshëm, sipas idesë së parë, supozohet një lëvizje e para-IE që do të bëhej para-albanishte nga veriu drejt jugut, diku në mijëvjeçarin II para Krishtit, hapësirë dhe kohë në të cilat ajo do të ketë qenë e afërt me gjuhët IE veriore, qoftë në një grup dialektor, qoftë brenda asaj që Hamp e quante NWIEE Sprachbund, ndërsa afritë me greqishten, nëse janë risime të përbashkëta, sikur shpjegohen me kontaktet e gjata në Ballkan. Sipas idesë së dytë, pra të *Balkanindogermanisch*, do të mund të nxirreshin përfundime të tjera lidhur me vendin e hershëm, jo më vetëm të para-albanishtes, po të para-IE. Orientimi sipas këtyre qëndrimeve mund ta ndryshonte rrjedhën e diskutimeve, po edhe të përmbyshte tërësisht rezultatet. Pavarësisht nga kjo, theksimi i nevojës për të bërë studime më të thelluara në zhvillimet e strukturave morfosintaksore, siç bën Klingenschmitt, nuk mund veçse të përshëndetet. Rezultatet e hulumtimeve të tilla do t'i shpien më tej studimet për vendosjen e shqipes në rrethin e gjuhëve IE dhe në raport me gjuhët lashtobalkanike.

¹⁷⁵ "Der Zeit nach sind die albanisch-griechischen Berührungen zweifellos älter als die albanisch-baltisch-slavischen... Man muß danach die Beziehungen noch in die nördliche Heimat des Griechischen verlegen, das heißt sie um die Wende des dritten zum zweiten Jahrtausend ansetzen." Porzig 1954, W.: *Die Gliederung des indogermanischen Sprachgebietes*, Heidelberg, f. 179. [Sa i përket kohës kontaktet shqiptaro-greke janë pa dyshim më të vjetra se kontaktet shqiptaro-baltiko-sllave... Këto raporte duhet të vendosen, prandaj, qysh në atdheun verior të greqishtes, do të thotë të vendosen në kapërcyellin e mijëvjeçarit të tretë me të dytin].

Hamp-i për kontaktet midis veriut e jugut

Sa i përket situatës ballkanike mund të përmbliidhet kështu. Mendohet se, pos greqishtes, në Ballkanin e lashtë fliteshin: pellazgishtja (para-greke), ilirishtja (me të mbahet e afërt mesapishtja në Itali të Jugut; me të shkon ajo që është quajtur ‘dardanishte’), trakishtja (këtu përket dhe “besishtja”), dakishtja(-mezishtja), peonishtja, makedonishtja, frigjishtja. Pak gjë mund të thuhet tani për ‘dardanishten’ e ‘peonishten’. Gjithnjë e më shumë po theksohet aspekti krejt i ndryshëm i dakishtes me trakishten, madje disa tiparet e materialeve onomastike të dakishtes i shohin më të afërta me të ilirishtes. Që të gjitha gjuhë indoeuropiane.

Me cilën prej tyre do të ketë qenë më e afërt para-shqipja që bashkë me greqishten flitet më së gjati në Ballkan, përkatësisht prej cilës prej tyre do të ketë dalë ajo? Fakti se nuk janë dokumentuar na pengon t’i njohim ato gjuhë. Për disa prej tyre shkenca ka arritur një shkallë njohjeje. Vështrimi kritik i elementeve leksikore dhe vendosja përkatëse e zhvillimeve fonetike të krahasuara kanë bërë të mundshme të nxirren disa përfundime.

Njohjet për frigjishten i kemi nga mbishkrimet dhe shkalla e tashme e tyre gjithsesi e përjashton raportin e afriës së saj me para-shqipen në shkallë bijërie. Makedonishtja, edhe pse ka pasur aluzione të natyrave të ndryshme makedono-shqiptare, me afrinë e saj me greqishten po ashtu përjashtohet nga ky relacion. Nga materialet onomastike dhe elementet strukturore të rindërtuara nga mbishkrimet e glosat mund të thuhet se përjashtohet lidhja e bijërisë trakase të shqipes. Në kohët e vona gjithnjë e më shumë është theksuar dallimi tërësor i dakishtes-(mezishtes) nga trakishtja dhe ndonjëherë madje afria e saj më e madhe me ilirishten. Ideja e Hamp-it për grupin albanoid, në gjendjen aktuale duket tepër e pandërtuar. Hipoteza pellazgjike, si shtresë IE para-greke, nëse do të gjendejshin elemente më qenësore për afrinë me ilirishten e jo me trakishten, mund të merrte peshë në një konceptim më kompleks për lindjen e gjuhëve, pra për prejardhjen e shqipes. Por më parë të gjitha këto duan njohur më konkretisht.

Më pak e kritikueshme mbetet hipoteza ilire: huazimet latine dhe greke të lashta me shumëçka atje të çojnë. Mbetet hipoteza për burimin e saj të pavarur.

Konceptimi i B. Sergent-it

Edhe më tej në drejtim të rikonceptimeve të atilla përpiquej të shkonte Bernard Sergent në botimin e tij për indoeuropianët pikërisht duke e interpretuar më tej grupimin e përmendur të Hamp-it, edhe pse me njohje më modeste të zhvillimeve të shqipes në raport me Klingenschmitt-in e Hamp-in.

Sergent-i e interpretonte pikëpamjen e Hamp-it për familjen gjuhësore ballkano-baltike, ku sllavishtja është e afërt me gjuhët baltike, ndërsa shqipja i përket të njëjtit grup, duke u larguar prej tyre. Sipas tij, kemi një bosht veri-jug, nga Baltiku në Adriatik; mund të jetë që këtij grupi në lashtësi, pas tij, i bashkohej grupi trakas, midis grekëve e sllavëve. Interpretimet e mëtejme duken jokonkluzive, por e vlen të shihet këmbëngulja për të parë një grupim eventual tjetër nga ata që janë hetuar më herët në kuadër të gjuhëve indoeuropiane, domethënë mospajtimi me ta. Në koordinata të tilla ka pasur botime të ndryshme, qoftë në kuadër më të gjerë, apo edhe vetëm ngushtësisht, siç kanë qenë ato në grupin trakas. Në vazhden e kërkimeve të atilla hyjnë edhe studimet e rumunit M. Rădulescu me supozimet për një grup të veçantë gjuhësor mesapishte-ilirishte-shqipe.¹⁷⁶

Le ta shohim pak më gjerësisht kundrimin e Sergent-it (Sergent 1995: 102, 103 etj.). Me ilirët indoeuropianistika ndesh një problem, niste ai. Romakët quanin *Illyricum* një territor të gjerë përballë Italisë në anën

¹⁷⁶ Rădulescu 1984, Mircea-Mihai: *Illyrian, Thracian, Daco-Mysian, the substratum of Romanian and Albanian*, in *JIES* 12, 1-2, p. 77-131; Rădulescu 1987, Mircea-Mihai: *The Indo-European Position of Illyrian, Daco-Mysian and Thracian: a historico-methodological approach*, in *JIES* 15, 33-4, p. 239-271; Rădulescu 1994, Mircea-Mihai: *The Indo-European Position of Messapic*, in *JIES* 22, 3-4, p. 329-344.

tjetër të Adriatikut. Këtë hapësirë ata e quanin kështu në administrimin imperial. Në aspektin gjuhësor, tërë hapësira midis Greqisë e Italisë ishte njëfarë *no man's land*: gjuhët e popujve të Illyricumit nuk njihen, s'ka mbishkrime. Ishte bërë zakon nga lashtësia që banorët e Illyricumit të quheshin ilirë. Në sh. 19 u shtrua çështja e gjuhës. 'Ilirishtja' njihej vetëm nga emrat e përveçëm. Kjo bëri të mundshme të spekulohesh intelektualisht në bazë të atribuumit për 'ilirishten' të tipareve të ndryshme varësisht nga materiali që merrej në vështrim, për të ndërtuar pastaj hipoteza të ndryshme, ashtu si dhe nga fakti se, duke mos pasur mundësi të tjera, klasifikoheshin si 'ilire' sa më shumë që të ishte e mundshme nga materialet e gjetura. E afërt gjeografikisht me Illyricumin, venetishtja merrej për ilirishte, ashtu si mesapishtja me mbishkrimet e saj dhe gjuhët e Epirit të lashtë dhe të Makedonisë para helenizimit. Te disa autorë 'ilirishtja' përfshiu të gjitha rajonet ku zbuloheshin toponime që mund të jepnin paralele me ato të Ilirisë së lashtë: përfshirë Sicilinë, Alpet te H. Krahe, i cili i përfshinte aty lepontianët dhe besonte se shtresa indoeuropiane te ligurët ishte tashmë me prejardhje ilire; tërë Europën qendrore dhe brigjet baltike, e deri në Francë sipas Pokorny-t, ndërsa sipas Bonfante-s, Borgeaud-së, Schwyzer-it, 'ilirishtja' jepte çelësin për një material të tërë onomastik grek me prejardhje johelenike, Sergent 1995: 102. Kjo "hipertrofi e 'ilirishtes'" e denoncuar nga Pisani më 1937, pastaj nga Whatmough më 1950, u shfry më vonë. Ishte e drejtë hipoteza e Krahe-s se toponimia ruante gjurmë të shtresave të ndryshme gjuhësore që suksedoheshin në këtë territor. Ky parim ishte i dobishëm në vendet parahistorike deri te pushtimi romak i Illyricumit (Krahe 1955), f. 103. Por doli se kishte një fond të hershëm toponimik që mbulonte Illyricumin, por dhe një pjesë të madhe të Europës deri në Spanjë e në ujëdhësat britanike, vende ku, ndryshe nga Pokorny, ky autor theksonte se s'ka pasur kurrë ilirë. Kjo shtresë toponimike, gjithsesi indoeuropiane, nuk mund t'i atribuohesh një gjuhe të veçantë dhe as një epoke, prandaj u desh të dezinjohesh një koncept i ri – *Alteuropäisch* (Krahe 1957-1962; 1964 a), f. 103. Në të njëjtën kohë doli se venetishtja, mesapishtja e lepontishtja dallonin midis tyre. Në vitet '60 ndodhi kritika për 'iliromaninë' (Kronasser 1962, 1965, Meid

1964, Alföldy 1964, Katičić 1966). Pas botimeve onomastike të Alföldy-t dhe Katičić-it u rishikua ndarja e hapësirës ilire.¹⁷⁷ Sot nuk ka autor linguist që do të pranonte idenë për ilirishten në kuptimin e Pokorny-t apo të Krahe-s, mendonte Sergent-i. Përnjëherë kapituj dhe libra të tërë të autorëve si P. Kretschmer, A. Mayer, W. Porzig, G. Bonfante u bënë të padobishëm. Materiali i mbledhur aty do riparë në tërësi dhe me themel, vlerësonte Sergent-i 1995: 103.

A nuk po rrëshqitet kështu në fazën e ‘ilirofobisë’?

Sipas Bernard Sergent-it,¹⁷⁸ situata e mesapishtes ndryshon nga e ilirishtes. Mesapët, përkatësisht daunët, pedikulët (poediculi), peuketët, japigët, mesapët dhe kalabrët, nga latinët quheshin *apulë*. Gjatë gjithë shekullit është vërejtur se toponimet, antroponimet e etnonimet e këtyre rajoneve të kujtojnë ato të pjesës tjetër të Adriatikut në Ballkan. Më vonë u zbuluan mbishkrime dhe fakte të tjera arkeologjike sidomos nga zona e mesapëve dhe japigëve, mbi 300 mbishkrime me germa greke nga sh. VI para K. Ai referonte sidomos Parlangueli-n 1960, Santoro-n 1982-83, 1984, Rădulescu-n 1994 për vrojtimet vijuese:

- mbishkrimet e zbuluara në më shumë hapësira në Apuli janë të një gjuhe: fjala është për një migrim parahistorik (para kolonizimit të parë grek në sh. VIII para K.);

- gjuha është shumë e ndryshme nga italikja, përfshirë venetishten;

- konfirmohen lidhjet antroponimike, sidomos teonimet e këtij rajoni, me anën tjetër të Adriatikut, pra me ilirishten e mirëfilltë (Lejeune 1974, 164, 170; 1983, 255; Santoro 1988, Rădulescu 1994);

- në rrafshin krahasimtar leksikografik afritë e kësaj gjuhë shkojnë me gjuhët perëndimore (Krahe, 1955, 251-258; Haas, 1962; Georgiev, 1966 [1981] 307-309), por te foljet ka një izoglosë me tokarishten arshikuçi (Bader 1994 16) – për foljen ‘jam’, të tjera me gjuhët anatolike (Geor-

¹⁷⁷ Duhet të theksojmë se në fakt, sipas Katičić-it, fjala ishte vetëm për zona onomastike, çka ende nuk do të thoshte se kishim të bënim me gjuhë të ndryshme.

¹⁷⁸ Sergent 1995, Bernard: *Les indo-européens. Histoire, langues, mythes*, Paris, Payot, f. 105 e tutje.

giev 1981, 307); më së shumti raporte të sakta në leksik mesapishtja paraqet me shqipen; në një vokabular mjaft të reduktuar që është identifikuar deri tash, më shumë terma të mesapishtes shfaqin afri me të shqipen: *menzana*, cilësor i *Iuppiter*; apo mesap. *Zis*, barasvlerë e *Zeus* dhe *Iuppiter* si kalorës, shih shq. *mës* (cf. *mâz*); mesap. *brendos* “dre”, shq. *brî*; mesap. *bili(v)a* shq. *bijë* (Hamp 1957, Lejeune 1975, 283; 1983, 256); cf. Hamp tash vonë, Matzinger.

Prandaj duhet të nxirret përfundimi se apulianët përfaqësonin vazhdimin e një grupi gjuhësisht të afërt me të trakasve, por të ndryshëm, që shtrihej nga Dardania e Iliria e deri në Adriatik, Sergent 1995: 106.

Ç'mbetet nga ilirishtja?

Materiali antroponimik tregon se fjala ishte për së paku tri gjuhë në Illyricumin e lashtë (zonat onomastike kështu avancohen pënjëherë në gjuhë; nga ana tjetër, asgjë nuk e ndalon të ketë pasur më shumë).

“Dhe një prej tyre i përgjigjet, gjeografikisht, zonës në të cilën autorët grekë kishin sinjalizuar fillimisht popuj të cilët ata i kishin quajtur ‘Ilirë’”, Sergent 1995: 104.¹⁷⁹

Para se të përhapej ky emërtim në tërë territorin e shënuar kështu nga romakët, në greqishte ky term shënonte vetëm një grup fisesh në veriperëndim të Greqisë, ku hynin taulantët, enkelejtë, pireit, çka i përgjigjet zonës meridionale të Katičić-it. Duket të ketë pasur kontinuitet midis këtyre ilirëve të njohur nga grekët dhe atyre nga romakët – këta të fundit flasin për ‘mbretëri ilire’ si një shtet i vendosur në këto hapësira; më në veri-perëndim popujt e shënuar nga autorët grekë të sh. V-VI para K. ishin zhdukur në epokën kur romakët kishin filluar të interesoheshin për këtë rajon dhe ishin zëvendësuar nga dalmatët, Sergent 1995: 104.

M. Lejeune ka ngulur këmbë në dallimet midis kësaj antroponimie dhe asaj më në veri, të afërt me venetishten (Lejeune, 1974, 164; 1983 255; Katičić 1976, 179.) Por ka pasur dhe përzjerje. Raportet me pjesën përtej Adriatikut dalin më sqaruese dhe për ilirishten: ishte gjuhë e një

¹⁷⁹ “Et l’une d’elles correspond, géographiquement, à la zone dans laquelle les auteurs grecs avaient initialement signalé des peuples qu’ils ont appelés ‘Illyriens’”.

grupi me mesapishten, pra e afërt me shqipen, dako-mezishten, më tej me trakishten.

“Gjithëçka duket sikur ilirishtja, shqipja e mesapishtja përfaqësonin tri dialekte të një gjuhe të vetme”, Sergent 1995: 104.¹⁸⁰

Sipas Sergent-it, Katičić-i ka konstatuar sa vijon: antroponimia e zonës panono-ilire ndahej në tri zona;

I veriperëndimi i Illyricumit të lashtë në dheun e lashtë të liburnëve kemi një antroponimi të shënuar me dendurinë e disa emrave të përveçëm; kjo antroponimi përfshinte dhe pjesë venete të Istrisë dhe deri te Alpet lindore; e quante zonë ‘veriadriatike’, Sergent 1995: 80;

II zona e dytë i përgjigjet jug-lindjes së Illyricumit të lashtë, përkatësisht pjesës që banohej nga popujt që grekët e vjetër njihnin si *Illurioi*, që tek romakët i dhanë emrin tërë provincës; këtë antroponimi mund ta quajmë, pra, ‘ilire në kuptimin e mirëfilltë të fjalës’, Sergent 1995: 80;

III zona e tretë antroponimike përfshihej midis të dyjave, i përgjigjet dheut të dalmatëve e japodëve në periudhën e pushtimeve romake dhe shtrihet drejt Panonisë; Katičić-i e quante ‘*dalamato-panone*’ (Katičić 1976, 178-184), Sergent 1995: 80.

Sipas Lejeune 1983, 254-255, zonës veriadriatike i afrohej dhe dalmato-panonia me disa tipare, Sergent 1995: 80. Në rajonet latine janë shënuar gjurmë të popujve protolatinë para kolonizimit grek; për kohën e ‘ilirizmit’ autorë të ndryshëm kanë sinjalizuar pika të përbashkëta midis kësaj popullate dhe ‘ilirëve’; një nga gjurmët më evidente është emri i popullatës *Khônes* në Itali të Jugut, që i përgjigjet *Kháones* në Epir; emri i kolonisë së famshme greke *Súbaris*, emër jogrek që lidhet me *Soubarai* e *Suberos* në Greqi. Këto hamendësime interpretohen përmes idesë së një migrimi të lashtë nga Ballkani drejt Italisë, pra grupit apulian, Sergent 1995: 106-107.

¹⁸⁰ “Tout se passe comme si illyrien et messapien représentaient trois dialectes d’une même langue”, referonte Mircea-Mihai Rădulescu: *Illyrian, Thracian, Daco-Mysian, the substratum of Romanian and Albanian*, në *JIES* 12, 1-2, 1984, p. 77-131; Mircea-Mihai Rădulescu: *The Indo-European Position of Illyrian, Daco-Mysian and Thracian: a historico-methodological approach*, *JIES* 15, 33-4, 1987, p. 239-271; Mircea-Mihai Rădulescu: *The Indo-European Position of Messapic*, *JIES* 22, 3-4, 1994, p. 329-344.

“Fjala është për popullata që më herët kanë qenë në raport me botën adriatike, të shtyra pastaj drejt perëndimit dhe veri-perëndimit me ardhjen e mesapëve”, M. Lejeune, Sergent 1995: 107.¹⁸¹

Prandaj ai propozonte që ky grup të quhet *sud-italik* e jo *proto-latin*, sepse asgjë nuk e provon afrinë e gjuhës së tyre me latinishten (Lejeune 1983, 251). Toponimia tregon se kjo gjuhë ishte IE. *Sybaris*, *Su-baris* interpretohet si ‘le confluent’ (Krahe 1955, 97; Porzig, 1954, 199), Sergent 1995: 107. Kështu shihet se koncepti ilirian u shpërthye në tri zona gjeografike, por edhe në tri shtresa: I ajo që çon nga Ballkani në Sicili, shtresa ‘sud-italike’; II ajo e ilirëve të mirëfilltë e lidhur me mesapët; dhe III shtresa e dalmatëve dhe popujve të afërt me ta, tashmë e afrueshme me familjen italice, Sergent 1995: 107. Pason një diskutim i gjatë për çështjen e filistinëve/ palaistëve, që parapëlqejmë të mos e raportojmë këtu.

Të kthehemi te konceptimet që avanconte Sergent lidhur me grupin ballkanik, konkretisht shqipen. Nga referimi i autoetnonimit si *Skiptarë* (sic!), gjuha *shqip*; heteroetnonimi bizantin pas sh. XI *Albania*, deri te referimi si vepra bazë i Mann-it 1977, G. Meyer-it 1891, Huld-it 1979, janë gjëra që nuk flasin për begatinë e informacionit. Megjithatë, le të shohim ato që thoshte. Shqipja për një kohë të gjatë është parë gjuhë IE e izoluar, nuk njihet burimi i saj i lashtë, ndërsa vetë ka pësuar zhvillime për pasojë kontaktesh; shqipja lidhet me të njëjtin grup si baltishtja e sllavishtja (Porzig 1954, 174, 216; Çabej 1964; Huld 1979; Hamp 1966, 1990 a; Rădulescu 1994, Jokl 1963, Pisani, 1959, 115-119; Georgiev 1980, 143, Sergent 1995: 93-4). E folur në të njëjtin territor, mbahet pasardhëse e ilirishtes; kjo nuk është e sigurt, sepse janë 15 shekuj midis dokumenteve të fundit ilire dhe shkrimeve të para shqipe; në këtë kohë ka mundur të ndodhin lëvizje me rëndësi popullatash; emrat e vendeve nuk paraqesin zhvillime të shqipes nga lashtësia, po të sllavishtes, vokabulari detar i huazuar nga greqishtja e latinishtja, pra s’ishin bregdetarë në lashtësi, ndërsa sipas Georgiev-it latinizmat më të lashtë në shqipen u përgjigjen latinizmave lindorë si të ruma-

¹⁸¹ “Il s’agit de populations plus anciennement en rapport avec le monde adriatique, refoulées ensuite vers l’ouest et le nord-ouest par l’arrivée des Messapiens”.

nishtes e jo të dalmatishtes (Georgiev 1957, 283; Kronasser 1965, 179-180; Katičić 1976, 1184-185; Di Giovine 1988; Ködderitzsch 1988, Sergent 1995: 94). Shumë nga këto duan verifikuar dhe me siguri nuk dalin ashtu. P.sh. latinizmat e hershëm të shqipes nuk janë të shtresës së përbashkët me rumanishten, siç përsëriste Georgiev-i, dhe janë më të hershëm nga ata.

Pas veçimit të elementeve të përbashkëta të shqipes me të rumanishtes, që i atribuoheshin substratit dak e trakas, C. Pauli e H. Hirt emetuan tezën për prejardhjen trakase të shqipes (u ndoqën nga Vasmer, Pușcariu, Whatmough, Weigand, Schuchardt, Rosetti, Detschev, Reichenkron, Barić), ndërsa tezën ilire e kanë përkrahur, pos autorëve shqiptarë, Hahn, Meyer, Jokl, Kretschmer, Ribezzo, Mladenov, Bonfante, Katičić, Polome. Sergent këtu ndiqte V. Georgiev-in që veçoi trakishten e dakishten, duke supozuar se fonetizmi i dakishtes afrohet me të shqipes: *bathë* dhe *dhi* dalin nga **bhaka* e **agyos*, pra me kalim nga rendi gutural në dental, si në dakishten *boudathla* nga **gwou-dngh(we)la* (Delamarre 1984, 156; Georgiev 1957, 283-288). Prandaj, pas tij, Kronasser, Hamp (sic!), Kortlandt, Rădulescu shkojnë pas Georgiev-it si hipotezë: shqipja del mbase më besueshëm nga një dialekt dako-mez sesa nga ilirishtja.

Shumëçka këtu do verifikuar. Për Hamp-in shih më poshtë. Punimet e reja për trakishten (Duridanov) kanë nxjerrë përfundime që e përjashtojnë shqipen prej andej (Ködderitzsch 1988, 110, Di Giovine, etj.). Toponimet në Shqipëri e Maqedoni janë zhvilluar sipas ligjeve të shqipes; nëse s'ishin bregdetarë, në brendi do të kenë qenë gjithsesi (Barić 1954, Cimochofski 1958, Hamp 1966, 98-99; Katičić, Rădulescu 1984, Ködderitzsch 1988), a më në lindje (Georgiev 1957, 283, 1966 [1981], 140-143; Lejeune 1983, 250), 95. Habitete që toponime të tilla ndeshen në Makedoni, në afërsi të së cilës Ptolomeu i pat shënuar Albanoit, edhe pse fakti i kontestueshëm për shkak të dëshimit të vonë bizantin, thoshte Sergent-i; por ishte zonë jo në Iliri po në Dardani, trakase (sic!). Jokl-i në këtë gjuhë shihte një pasardhës të dardanishtes. Por, sipas Stadtmüller-it, Dardania ishte romanizuar. Pyeste ky, a vlen kjo dhe për zonat malore?, Sergent 1995: 96.

Dhe pa shumë argumentime ai si të besueshme merrte këto supozime: shqipja rrjedh prej një dialekti dako-mez; paraardhësit e shqiptarëve në lashtësi banonin zonën malore midis Makedonisë e Dardanisë, vend i brigëve të dikurshëm, ku Ptolomeu shënoi Albanoit, këta Albanoi janë degë e dakomezëve, që zëvendësoi brigët në një kohë që s'mund të saktësohet, qoftë përmes ekspansionit të dardanëve, qoftë në raport me pushimet dakase në tre shejkujt e fundit para erës sonë, f. 96. *Summa summarum*, konstruktion hipotezash përmes të panjohurash.

Që të kemi mundësi të shohim se ç'mendonte ai për dardanishten, le ta paraqesim shkurtimisht idenë e tij për grupin ballkanik, familjen trakase. Për grekët *Thracas* shtriheshin nga Egjeu në Karpate; këta trakas ishin shtrirë dhe në veri, siç thotë hidronimia moldave, besarabe e ukrainase. Te Herodoti del se në Anatoli kemi armenasit nga frigasit, në Anatinë qendrore, ndërsa këta të fundit nga Ballkani, ku quheshin Briges (Historitë VII, 73); Straboni e më vonë thonë se frigasit vinin nga Trakia, ishin të afërt me trakasit, kështuqë flitet për një grup 'trako-frigas' (Tomaschek 1893-94, Kretschmer 1896, 174-185); ky koncept nuk qëndroi: O. Haas 1966 tregoi se çka dimë nga frigishtja e çka supozojmë për trakishten nuk pajtohen (Vraciu 1976, Georgiev 1977, 1985; Polome 1982 a, 888; Rădulescu 1987, 241; Kortlandt 1988).

Dega dakase: gjuhë e veriut që përfshinte getishten midis Karpateve e Danubit; dakishte në Karpatet lindore e Transilvani; mezishte, midis Danubit e Haemos në kohë romake, që ishte me prejardhje getike: pa dyshim dardanishtja (sic!); shqipja, e dalë nga njëra prej këtyre gjuhëve, duhet të jetë nga një fis dardan; mezishtja, në mezi aziatike, e afërt me Moiso të bregdanubit, që i dhanë emrin në kohën romake *Moesias* të banuar nga getë; *Musoi* duket të paraqesin një shtresë të vjetër para imigrimit të trakasve të jugut; Homeri në Ballkan njihte vetëm *Musoi* (Sergent 1995: 98).

Dega trakase: gjuha trakase e mirëfilltë midis Haimos e Egjeut, me besët, odrysët, edonët, satrët, bisaltët, odomantët; trakasit e Azisë, tunë e bitunë; më larg, armenishtja. Trakishtja është gjuhë IE, por vendi i saj

është i diskutueshëm; në fazën e parë të trakologjisë flitej për trako-frigishte. Me trakishten pas tij shkonte dhe dardanishtja, (Sergent 1995: 99).

Grupi ballkanik dardan, sipas tij, ishte popull i fuqishëm në malet rreth Moravës dhe Vardarit të Epër, midis trakasve e ilirëve; rivalë të makedonasve, të papajtueshëm me romakët, që i pushtuan midis -75 e -72; Iliada i përmend midis popujve të Troadës si Dardanoi, një qytet të Dardanisë dhe një personazh me emrin Dardanos, paraardhës të mbretërve të Trojës; burimet egjiptiane i përmendin në betejën e Qadeshit midis egjiptianëve e hititëve në vitin -1309; hititët ishin aleatë të *Drdnn* = *dardanë*. Në fund të epokës së bronzit elemente dardane u vendosën në veri-perëndim të Anatólisë, para trakasve, frigasve, keltëve galatë; shumica mbeti në Ballkan, duke u organizuar me kohë në mbretëri. Nuk i përmend mendimet për afri me kulturën ilire. *Dardani* sipas tij vjen nga *dardë* (sic!). Prandaj, sipas tij, dardanët janë ndër popujt më të hershëm të vendosur në Ballkan, qysh në sh. 14 para K.

Çfarë përfundimesh mund të nxirren nga të gjitha këto diskutime?

- Loja me emërtime nuk shpie gjëkund;
- çmitizimi i qëndrimeve iliromanike u shpu në skaj: deri në ilirofobi;
- mbeti megjithatë diçka që ka të bëjë me kontekstet që shpreh historia e shqipes si gjuhë dhe kjo e bën të domosdoshme marrjen parasysh të një gjuhe paleoballkanike të ndryshme nga ajo që njohim si trakishte për bazën prej nga doli ajo; ky kontekst e vendos atje ku është folur ajo që është quajtur ilirishte;

- ky fill ndërmjetës drejt fazës paraindoeuropiane nuk është dokumentuar, prandaj rindërtimi i brendshëm i shqipes merr peshë më të madhe, dhe prandaj shpesh parapëlqehet të flitet për protoshqipen si fazë më të hershme, për protoalbanishten, ndërsa Hamp në këtë kuptim përdor një term më të gjerë – protoalbanoid, pra grupim dialektesh indoeuropiane prej të cilave është ruajtur vetëm shqipja dhe prej të cilave, pra prej njërit prej tyre, është ruajtur një pjesë e elementit subtracial të rumanishtes, që është i ngjashëm ose i njëjtë me të shqipes;

- grumbulli i emërtimeve: trakishte, dakishte, besishte, dardanishte,

peonishte, mezishte, getishte, trako-dako-mezo-getishte, prapa të cilave nuk ka më shumë se materiale onomastike shpesh vështirë të përcaktueshme, na bën të vëmë pikëpyetje për përmbajtjen e tyre, relativizojnë çdo gjë. Kronologjia e zbritjeve indoeuropiane në raport me realitetet që fshihen prapa këtyre emërtimeve mbetet vage;

- raportet midis (proto)shqipes dhe protobaltishtes e protosllavishtes, ashtu si midis protoshqipes e protogjuhëve të tjera indoeuropiane duan parë me kujdes, që të mos nxjerrim përfundime duke u nisur nga gjendjet e sotme apo të periudhës së shkruar të shqipes të krahasuara me gjendje më të hershme të gjuhëve të tjera. Pamundësia e identifikimit të parashqipes me trakishten, për aq për sa mund të dokumentohet, për kaq e largon edhe perspektivën e krahasimit të saj me paleobaltishten a paleosllavishten, për të cilat një raport afrie me trakishten duket i vendosshëm.

- realitetet etnike janë të ndryshueshme historikisht, ndërsa me kohë edhe në hapësirë.

Venarimet e Simona Klemenčič-it

Simona Klemenčič në dorëshkrimin e saj të disertacionit të doktoratës të mbrojtur në Lubjanë në vitin 2005 me titull *Starejše jezikovne povezave albanščine, baltščine in slovanščine*,¹⁸² shqyrtonte dhe çështjet e raporteve të shqipes me gjuhët baltike e sllave. Kishte qëndrime kritike për etimologjizimet, sidomos për etimologjitë që sillen në rreth. Duke folur për shqipen, baltishten e sllavishten, duke pasë veçuar paralelet midis shqipes, baltishtes e sllavishtes, pastaj paralelet me baltishten, paralelet me sllavishten, lidhjet shqipe, baltishte, sllavishte, gjermanikishte; shqipe, baltishte, gjermanikishte; shqipe sllavishte, gjermanikishte; paralele që përfshijnë gjuhët e lashta ballkanike dhe paralele që përfshijnë rumanish-

¹⁸² Simona Klemenčič tashmë e ka botuar pjesën e studimit të saj që ka të bëjë me vrojtimit e rëndësishme të natyrës metodologjike në këto hulumtime Klemenčič 2007, S.: *K metodologiji dialektologije jezikovnih družin: sklepanje o obstoju narečenega areala*, in *Slovenski jezik/ Slovene linguistic studies*, 6, pp. 133-150.

ten, ajo shprehte mendimin se shumë etimologji nuk u qëndrojnë kritereve shkencore, sidomos nëse krahasohen gjuhët paleoballkanike. Sipas saj korrespondencat hipotetike midis gjuhëve paleoballkanike, baltishtes e sllavishtes nuk mund t'i përfshijmë bashkë me korrespondencat hipotetike midis shqipes, baltishtes e sllavishtes. Shënonte 45 paralele shqip, baltisht, sllavisht; 67 paralele leksikore shqip-baltisht; shqip sllavisht 26; shqip-baltisht-sllavisht-gjermanikisht 13; shqip-baltisht-gjermanikisht 10; shqip-sllavisht-gjerm. 5. Paralele që përfshijnë gjuhët lashtoballkanike – 16; paralele që përfshijnë rumanishten - *bredh, çupis, mushk, shpendër*; paralele midis rumanishtes, baltishtes e sllavishtes pa shqipen: *doina, hata, pat, teafar, a socoti*.

Katičić-i për provincat romake në Ballkan dhe gjuhët

Katičić-i iu kthye dhe një herë hapësirës gjuhësore lashtoballkanike në *Klokuiumun për gjuhët në Perandorinë Romake pas kohës imperiale* të vitit 1974. Sipas konceptimit të tij historik, në kohën kur hapësira ballkanike ishte në vështrimin e interesave të Romës me rëndësi ishte Mbretëria Makedone si faktor përcaktues. Në brigjet e Adriatikut dhe të Detit Jon ishin dhe dy ndërtime shtetërore: në jug fiset epirote dhe në veri Mbretëria Ilire. Epiri, si Makedonia kulturalisht ishin integruar në botën helenistike, ndërsa Iliria qëndroi në hapësirën e jashtme të rrezatimit të helenizmit, u ndikua prej tij, por megjithatë ruajti mëvetësinë në shkallën që ngulimet helenistike në hapësirat e saj (Apollonia, Epidamnos, Kerkyra, Melaina, Pharos dhe Issa) vazhduan të jenë trupa të huaj. Roma ndërmori së pari pushtimin e Ilirisë dhe pastaj kontrollin mbi Ballkanin drejt Trakisë, fiset e së cilës ndodheshin në hapësirën e rrezatimit të pushtetit makedonas. Në kohën e sundimit të plotë të Ballkanit Roma, në kohën e Diocletian-it, krijoi provinca dhe dioqeza në Ballkan, me dy prefektura: *Praefectura Orientis* me dioqezën e Trakisë, ndërsa provincat ishin: Moesia Inferior, Scythia, Theacia, Haemimontium, Rhodope dhe Europa; *Praefectura Illyrici* në përfundim me pjesën më të madhe të dioqezës Dacia dhe pjesën veriore të Dioqezës Macedonia. Në Dacia hynin provincat Moesia Supe-

rrior, Dacia ripensis, Dacia mediterranea dhe Dardania. Aty e fundit ishte Praevalis, që i përkiste Dalmacisë së vjetër. Nga Macedonia këtu hynin provincat Epirus nova, Macedonia prima dhe Macedonia secunda. Edhe pse ishin në fillim ngushtësisht të lidhura me Provincën Macedonia, Epiri, Thessalia, Achaia dhe Kreta kishin mbetur jashtë fushës së përshtuar (Katičić 1974: 108).

Nga aspekti gjuhësor, mendonte ai, këto provinca ishin heterogjene. Po ta shikojmë gjendjen në bazë të pasqyrës së tërësishme të *Orbis romanus*, pasqyra del komplekse dhe shumëstresore: për asnjërin prej gjuhëve vendore në veri të Greqisë nuk ka mbishkrime apo tekste të tjera të ruajtura, kështu që gjithandej jemi të varur nga dëshmitë letrare dhe të dhënat onomastike. Makedonia del pa dyshim njësi më e vjetër dhe më komplekse politike. Qysh në kohën e Filipit dhe të Alexandrit ajo ishte etnikisht vend johomogjen. Vetë makedonët, sipas tij, ishin popull malor nga masivi i Pindit, ndërsa për gjuhën e tyre nuk kemi shënime të qarta, edhe pse rrethanat na bëjnë të besojmë se ishte një dialekt grek me ngjyrim dorik. Emrat e njerëzve qysh herët ishin grekë, por të ndryshëm nga bota kulturore helenistike. Në pjesët drejt detit makedonasit ndeshën fiset trakase në jug dhe peone në veri. Mbretëria makedonase u shtri në veri dhe qysh herët mbi trakasit dhe peonët. Peonët njiheshin si popull i veçantë, por nuk kemi burime për të krijuar një pasqyrë të qartë për ta. Kështu në literaturën shkencore disa i kanë trajtuar si ilirë, të tjerët si trakas dhe të tjerë si grekë johelenikë. Më vonë Georgiev-i i trajtonte si frigas. çështja mbetet e hapur, por nuk i përkisnin popullit grek, f. 109.

Për pjesën e fiseve epirote po ashtu kemi një pasqyrë tjetër. Ato ishin jashtë rrethit kulturor helenistik, kështu që ata mund të jenë nga grekët që nuk mërguan në jug, por dhe me ilirët kishin lidhje etnike e gjuhësore, mendonte ai në bazë të materialeve onomastike e gjuhësore.

Brenda Makedonisë në lindje kishte edhe popullatë trakase. Por pas Aleksandrit në Mbretërinë e Makedonisë greqishtja ishte e vetmja gjuhë e kulturës dhe kishte depërtuar në të gjitha porët e jetës. Nuk është e lehtë të dihet sa kohë dhe në çfarë shkalle u ruajtën gjuhët e vendit në kohën

helenistike dhe pas pushtimitit romak nëpër fshatra. Vetëm për trakasit më në lindje mund të thuhet se e kishin ruajtur gjuhën dhe përkatësinë etnike deri kohën romake. Në kohën romake në Makedoninë e vjetër dhe në Peoni janë shënuar dhe emra trakas e ilirë. Provinca e Makedonisë mbeti deri nga fundi i lashtësisë në jetën e përditshme dhe kulturalisht greke. Thyerja e perandorisë dhe pushtimet sllave ia ndryshuan pasqyrën.

Në provincën e Makedonisë përkiste dhe një pjesë e madhe e ish Mbretërisë ilire, në jug të Lisit. Banorët ishin ilirë, ndër ta taulantët, parthinët, dasaretët, pastaj enkelejt, penestët.

“Këto fise ilire flisnin gjuhën e tyre të veçantë, dhe nuk ka asnjë shkas për të dyshuar që ajo ishte indoeuropiane”, f. 110.¹⁸³

Nuk kemi tekste. Më vonë u zbuluan emra njerëzish e vendesh në gjetjet epirafike e numizmatike në Shqipëri, ndër të cilat: *Anna, Gentius, Glavus, Grabus, Epikadus, Monnunius, Pleuratus, Teutana, Verzo*. Për studimet ilire me rëndësi është se këta emra lidhen me hapësirat veriperëndimore ilire dhe mesape në Itali të Jugut. Është vështirë të thuhet nëse këta ilirë dhe delmatët, japodët e panonët ishin të së njëjtës përkatësi etnike dhe flisnin të njëjtën gjuhë, qoftë dhe të nyjetuar në dialekte të ndryshme. Mendohet po ashtu se gjuha e tyre mund të jetë e lidhur me mesapishten, por të dyja këto pohime duan provuar. Çështja mbetet e hapur. Ilirisht flitej dhe në pjesët jugperëndimore të provincës së Dalmacisë, ndërsa në Provincën e Makedonisë gjuha e tyre pësoi helenizim dhe romanizim të fuqishëm.

“Në male ky proces i asimilimit etnik nuk shkoi mbase deri në fund asnjëherë. Kjo çështje është me shumë rëndësi për ndriçimin e prejardhjes së gjuhës shqipe”, f. 111.¹⁸⁴

Sa i përket Trakisë, provincës së Trakisë, që përfshinte bërthamën e popullit që banonte në pjesën lindore të Siujdhesës, ai thoshte se për grekët qysh herët ata ishin barbarë. Por kishin dhe lidhje me ta, çka mund të

¹⁸³ “Diese illyrischen Stämme sprachen eine eigene Sprache, und es besteht kein Anlaß, daran zu zweifeln, daß sie indogermanisch war.”

¹⁸⁴ “Im Gebirgsland hat dieser ethnische Assimilierungsprozeß wohl nie ganz durchgegriffen. Die Frage ist sehr wichtig für die Erhellung des Ursprungs der albanischen Sprache”.

shihet nga mitologjia greke. Ata qenë nën ndikim të fuqishëm grek. Buri- met për njohjen e trakishtes janë pak më të mira se për të tjerat. Ka mbi- shkrime të gjetura në Qolmen dhe në Ezerovo në Bulgari, por ato mbi- shkrime ende nuk janë deshifruar si duhet, kështuqë nuk nxjerrim shumë prej tyre për gjuhën. Por kemi disa glosa, shumë emra njerëzish e vendesh dhe kjo na ndihmon të kemi një përfytyrim për gjuhën, që ishte indoeu- ropiane satem. E karakterizonte mutacioni konsonantik i ngjashëm me të gjermanishtes e të armenishtes, shkrirja e IE *a* me *o* dhe zhvillimi i zan. *u* para sonanteve silabike. Georgiev-i e krahasonte me elementin e njohur si pellazgjik, pra IE paragrek. Tash vonë Duridanov-i ka gjetur pikëpjekje të saj leksikore me baltishten e sllavishten, por mund të dyshohet nëse dësh- mitë janë vërtet të tilla. Historikisht njihen fise të ndryshme trakase: në luginën e Hebrit, midis maleve Haimos dhe Rodopeve jetonin besët dhe odrizët, pastaj në perëndim denteletët, në veri e në Ballkan artakët, në jug drirët, trauzët e odomantët, në Bosfor tynët e bitynët. Gjuha e besëve ish- te ruajtur deri vonë në Antikë, f. 112-113.

Dakasit në Karpate dhe getët në Vllahi, sipas autorëve të lashtë, ishin të afërt në etnicitet e në gjuhë me trakasit, ashtu si moesët dhe tribalët që shtriheshin në jug të Danubit deri në malet Haemos, madje në luginën e Moravës. Kohët e vona Georgiev-i, në bazë të materialeve ono- mastike, ka veçuar një zonë onomastike trakase dhe një tjetër dako-meze. Emrat me elementet *-ava*, *-upa*, *-sara* (*Dacidava*, *Burridava*, *Axiopa*, *Ger- misara*) shfaqen kryesisht në veri dhe janë dakase, meze dhe tribale, ndër- sa emrat me *-para*, *-diza*, *-bria* (*Bessapara*, *Tyrodiza*, *Selymbria*) dalin në Traki në jug të Haemos. Me këtë shkon dhe një element tingullor: në veri dhe në perëndimin tribal-moezian emrat nuk shfaqin mutacion konsonan- titk. Këtë Georgiev-i do ta dëshmojë me emrat e dy lumenjve që derdhen në Danub (*Utus* IE **udes-* ‘ujë’, *Athrys* IE **ētrus* ‘i shpejtë’, hind. e vj. *ātar* ‘i prehtë, i shpejtë’, let. *ātrs* ‘i rrëmbyeshëm’ – mutacion konsonantik tra- kas), dhe një lumë në veri Vedeā (IE **ved-* ‘ujë’) me tingull mbylltor të pa- ndryshuar. Kështu mendonte Georgiev-i se mutacioni konsonantik ishte vetëm i trakishtes, ndërsa dako-mezishtja nuk e njihte. Këta të fundit mër- guan në jug të Danubit dhe lanë gjurmë. Nuk ka mbishkrime për dakish-

ten, por është materiali me emra bimësh i Dioskorid-it, f. 113-114.

Provinca *Moesia inferior* ishte romanizuar fuqishëm, ashtu si *Moesia superior*. Përjashtim bënte Dardania në jug, një mbretëri e vjetër me emra ilirë. Në lindje të Dardanisë emrat janë trakas, ndërsa në perëndim i përkasin kompleksit dalmato-panono-japod.

“Është e sigurt se këtu u ruajtën gjuhët vendëse deri thellë në kohën romake”, 114.¹⁸⁵

Në veri të dardanëve jetonin autariatët ilirë dhe përtej në veri një pjesë e skordiskëve keltë. Mezia e epër ishte romanizuar, Dakia u robërua me luftë, popullata u zvogëluar ndjeshëm, shumë njerëz u vranë, shumë të tjerë ikën nga vendi. Në vendin e shkretuar Traiani solli kolonistë nga e tërë Perandoria, në Karpate u sollën pirustë për miniera. Dakia u romanizua, ndërsa dakasit si bashkësi etnike nuk luajtën ndonjë rol në Provincë.

Lidhur me prejardhjen e shqipjes dhe të rumanishtes Katičić-i niste me këtë vlerësim:

“Megjithë gjendjen e burimeve, nuk ka asfarë dyshimi se shqipja është shkallë moderne e zhvillimit e një gjuhe të lashtë ballkanike: në shqipen ka, siç dihet, huazime nga greqishtja e lashtë dhe një shtresë shumë të rëndësishme latine në leksik, që tregon një valë të fuqishme romanizimi. Të dyja, mbishtresa greke e lashtë ashtu si mbishtresa latine e leksikut, mund të kenë ndodhur vetëm në hapësirat ballkanike”.¹⁸⁶

Shqipja sot flitet vetëm në hapësirat e mirëfillta ilire dhe prej andej në mesjetë u përhap në Greqi të Jugut dhe në Itali të Jugut. Nuk ka asfarë njoftimesh për çfarëdo imigrimi në këtë hapësirë gjatë mesjetës.

“Në këtë gjendje të dijës sonë imponohet përfundimi se shqipja është

¹⁸⁵ “Es ist sicher, daß sich die einheimischen Sprachen hier bis tief in die Römerzeit hinein gehalten haben”.

¹⁸⁶ “Es kann aber trotz dieser Quellenlage kein Zweifel darüber bestehen, daß das Albanische die moderne Entwicklungsstufe einer alten balkanischen Sprache darstellt: im Albanischen gibt es nämlich altgriechische Lehnwörter und eine sehr bedeutende lateinische Schicht im Wortschatz, die von einer starken Romanisierungswelle zeugt. Beides, sowohl die altgriechische als auch die lateinische Übersichtung des Wortschatzes, konnte nur im alten Balkanraum stattgefunden haben”.

një formë moderne e ilirishtes".¹⁸⁷

Ky qëndrim ka pasur shumë përkrahës. Ka pasur dhe diskutime, sidomos nga dijetarët që ilirishten e mbanin për një gjuhë *centum*, ndërsa shqipja është gjuhë *satem*, kështu që nuk mund të rridhte nga një gjuhë *centum*. Prandaj iu drejtuan trakishtes, karakteri *satem* i së cilës nuk diskutohet. Kjo i nxiti kundërshtarët e karakterit *centum* të ilirishtes të shihnin të dhënat eventuale të një diskontinuiteti në hapësirën gjuhësore të shqipes. Kështu lindi ideja se shqipja rridhte nga mesi i Ballkanit, ku pati një kontakt më të ngushtë me rumanishten, nga baza trakase me një mbi-shtresë të fuqishme të latinishtes ballkanike. Prej andej ajo do të jetë zhvendosur në mesjetën e hershme, në kohën e shpërnguljes së popujve, në hapësirat e sotme dhe do ta ketë mbuluar atje shtresën e ilirëve të romanizuar. Argument kryesor për këtë ka qenë vërejtja se emrat gjeografikë të lashtësisë të Shqipërisë në gjendjen moderne nuk mund të shpjegohen përmes ligjeve fonetike të shqipes, po me ndërmjetësim të gjuhëve të tjera, sidomos romane dhe sllavojugore. Nga ana tjetër, format e sotme të vendeve të lashta të Ballkanit qendror shpjegohen përmes shqipes. Janë sjellë si argument edhe çështja e numrit të vogël të huazimeve greke të lashta në shqipen, ashtu si dhe terminologjia e detarisë e huazuar nga gjuhët fqinje. Përputhje në zhvillimin fonetik dhe në leksik sa i përket shtresës leksikore latine në shqipen e në rumanishten janë sjellë po ashtu si argument për burimin e kësaj gjuhe nga Ballkani kontinental. Megjithatë, mendonte Katičić-i, teza për prejardhjen trakase nuk mori ndonjë mbështetje vendimtare. Thuhet se mund të tregohet që analiza fonetike e emrave të vendeve nuk është bërë me saktësinë e nevojshme, se numri i fjalëve greke të lashta ka qenë më i madh, se sa i përket terminologjisë detare ka dhe fjalë shqipe. Këtu mund të shihet edhe terminologjia detare e greqishtes së re, që po ashtu ka probleme të ngjashme.

“Kështu hipoteza trakase është vetëm një konstruksion interesant dhe supozimi për prejardhjen ilire të shqipes mbetet në saje të rrethanave

¹⁸⁷ “Bei dieser Lage unseres Wissens drängt sich der Schluß frömllich aus, das Albanische sei eine moderne Form des Illyrischen”.

të përshkruara në fillim alternativa më e besueshme, edhe pse jo e dëshmuar me siguri".¹⁸⁸

Më tej ai vërente se brezi bregdetar i Shqipërisë nën sundimin romak ishte romanizuar dhe helenizuar, se emrat e vendeve tregojnë po ashtu një shtresë sllave. Atij i dukej më e besueshme se popullsia malësore, që bënte një jetë të lashtë baritore, do ta ketë ruajtur gjuhën e lashtë ilire dhe pastaj ta ketë përhapur mbi shtresën e helenizuar, të romanizuar e të sllavizuar, f. 115-116.

Këto vrojtme Katičić-i i kishte shprehur edhe më herët në veprën e tij për gjuhët e Ballkanit të lashtë, po edhe në disa studime të botuara ndërkohë. Thelbi i idesë së tij është përkrahur dhe nga studiues të historisë së shqipes, sepse pajtohej me idenë themelore që ishte përvijuar nga Çabej e të tjerët. Në të vërtetë, mund të diskutohet pjesa e fundit e këtij pasqyrimi. Koncepti që shqiptarët e hershëm i shihte të tërhequr vetëm në male dhe vetëm si barinj duket tashmë i diskutueshëm. Kjo u pa dhe me rastin e diskutimit të tezave të Stadtmüller-it. Nga ana tjetër, nuk ka mundësi të mos hetohet një bashkëjetesë më komplekse shtresash të ndryshme të popullatës së lashtë të romanizuar e të grecizuar në shkallë të ndryshme. Thelbi i gjuhës që mbijetoi megjithë transformimet që sollën ndikimet e fuqishme greke, latine e sllave ishte atje në shkallë të ndryshme.

Por, të shohim se si e shihte Katičić-i çështjen e rumanishtes, gjuhë romane që u zhvillua në Ballkanin kontinental. Dialektet e saj popullore kanë një ndikim të fuqishëm sllav, çka flet për një simbiozë të gjatë me popullatën sllave të jugut. Hapësira bërthamë e rumanishtes është në veri të Danubit në Rumaninë e sotme, por ajo është folur edhe në jug të Danubit deri në Maqedoni dhe në malet e Pindit. Në përfundim ka gjurmë të shtrirjes deri në Dinaridet. Një pikë e fundit gjendet në Istrië edhe sot. Zo-

¹⁸⁸ "Somit ist die thrakische Hypothese nur eine interessante Konstruktion, und die Annahme einer illyrischen Abstammung des Albanischen bleibt wegen der einleitend beschriebenen Verhältnisse die wahrscheinlichere, freilich auch nicht sicher erwiesene Alternative".

na e mirëfilltë rumune përputhet me provincën romake të Dakisë. Pra duket e përshtatshme të flasim për latinishten vulgare të Dakisë, pra për romanishten e Dakisë. Por dakia u sundua nga romakët vetëm pak kohë dhe pastaj u zbraz. Sundimi romak zgjati më shumë vetëm në jug të Danubit, kështu që ndryshoi mendimi për këtë çështje, pra se rumanishtja doli nga latinishtja që flitej në jug të Danubit dhe vetëm pastaj u bart në Karpate dhe te fiset e atjeshme baritore. Atje kjo gjuhë mbuloi një shtresë popullore sllave jugore. Prejardhja jugore e rumanishtes lejon të shpjegohen më mirë përkimet e saj me shqipen. Të gjitha këto janë brenda së mundshmes, porse atij nuk i dukej e kuptueshme se përse pas zbrazjes së Dakisë duhej të zhdukej dhe latinishtja vulgare nga ato hapësira. Edhe në jug të Danubit kanë sunduar rrethana të ngjashme për fiset baritore. Lëvizshmëria e madhe e njatyre fiseve baritore ka bërë të mundur kontakte të popullatave të romanizuara nga jugu e veriu i Danubit, kështu që gjuha rumune në veri u përforcua nga jugu. Në jug të Danubit ajo përfundoi gjithandej në hapësira të sllavishtes jugore, porse u ruajt në male ku flitet edhe sot në Homoljske planine, f. 117.¹⁸⁹ Do të shohim te diskutimi i ideve të Rosetti-t se baza e këtyre ideve nuk mungonte as atje.

Diskutime të tjera

Një fushë pak më konkrete e diskutimeve në rrafshin e lashtësisë ka qenë ajo e hulumtimeve të raporteve midis shqipes, gjuhëve baltike dhe sllavishtes. Do të përmend këtu disa shqyrtime.¹⁹⁰

¹⁸⁹ Radoslav Katičić: *Die Balkanprovinzen*, in *Die Sprachen im römischen Reich der Kaiserzeit*, Kolloquium vom 8. bis 10. April 1974, Beihefte der Bonner Jahrbücher Band 40, pp. 103-119.

¹⁹⁰ Bednarczuk 1986, L.: *On the development of the Indo-European Syllabic Sonants in Balto-Slavic and Albanian*, in *Acta Balto-Slavica*, 17, 77-83; Breidaks, A.: *Concerning the parallels between Baltic and ancient Balkan languages*, in *Linguistique balkanique*, 33 (1-2), 43-53; Desnickaja, A. V.: *Drevnye balkano-baltijskie sootvestvija i albanskij jazyk*, in *Baltisitca XIX* (1), 15-22; Liukkonen, K.: *Albano-balto-slavjanskije etimologii*, in *Scando-slavica*, 35, 197-202; Orel 1994, V.: *Albanian and Indo-European*, in *In honorem Holger Pedersen*, Wiesbaden; Orel 1998, V.: *Albanian Etymological Dictionnaire*,

Tani mendohet se diku në mijëvjeçarin I para Krishtit sllavishtja do të jetë folur në jug të Karpateve, ndërsa në Ballkan u shfaq pas sh. 6 të erës sonë. Para-shqipja është në Ballkan së paku nga kontaktet me greqishten e lashtë dhe me latinishten e hershme (nga sh. III-III para K.). Në dekadat e fundit janë vënë në dyshim edhe etiketat ilirishte, trakishte, dakishte, mezishte, dardanishte, peonishte, etj.

Linjë tjetër me interes më duket ajo që ka nisur me diskutimet e Pedersen-it 1900 për raportet e shqipes me armenishten.¹⁹¹ Ashtu të pakta ato indicie ishin shfrytëzuar e zhvilluar më tej nga Barić-i për të ngritur hipotezën e tij për lidhjet shqipe-trakishte-frigishte-armenishte. Ndërkohë mbishkrimet frigase dhe analiza e tyre kanë treguar se armenishtja s'ka të bëjë me frigishten në aspektin e filiacionit, dhe as trakishtja me shqipen.

Mbetet raporti i shqipes me ilirishten. Së pari të themi se afria e mesapishtes me ilirishten shpesh shihet si mjaft e besueshme. Materialet onomastike mesape në disa raste japin bazë për supozime lidhjesh me materialet onomastike ilire e dardane. Nga mbishkrimet mesape ka elemente që mendohet se zbërthehen përmes shqipes. Ilirishten vetë e njohim kryesisht nga materialet onomastike e ndonjë glosë. Disa nga ato pak glosa interpretohen besueshëm përmes shqipes. Ilirishtja është folur afërsisht në hapësirën ku flitet shqipja në kohë të reja, ndërsa bota antike nuk kishte shënuar shpërngulje popullatash nga lindja e Ballkanit drejt Ballkanit perëndimor. Se shqipja është folur pikërisht në këto hapësira dëshmojnë huazimet e shumta latine me të gjitha specifikat e tyre të kohës kur kanë hyrë, dhe huazimet nga greqishtja e lashtë. Për këtë flet fakti se një

Leiden, Boston, Koeln, Brill; Toporov, V.: *Balto-albanica*, in *Acta Balto-slavica* 17, 275-293, etj. Për K. T. Witczak shih dhe Witczak 1994, K. T.: *Proto-Albanian and the Problem of the Ethnogenesis of the Albanian Nation*, in *Biuletin polskiego towarzystwa jezykoznawczego* 1, ff. 21-26; Witczak 1995, K. T.: *Were the Bessans Ancestors of the Albanians? A new opinion on the ethnogenesis of the Albanian nation*. In *Thraco-Dacica XVI (1-2)*, ff. 309-312.

¹⁹¹ Pedersen 1900, Holger: *Albanesisch und Armenisch*, in *KZ* 36, Neue Folge 16, ff. 340-41. Shih përkthimin shqip nga A. Dhrimo, në Pedersen 2003, H.: *Studime për gjuhën shqipe*, ASHAK, Prishtinë, ff. 115-116.

numër toponimesh nga lashtësia në gjendjen e sotme ka arritur vetëm përmes shqipes. Ka dhe një numër elementesh gjuhësore që flasin në të mirë të prejardhjes ilire të shqipes. Prandaj hipoteza për prejardhjen ilire të shqipes merr më shumë peshë. Me këtë, e duke i pasur parasysh njohjet në shkencën e gjuhësisë IE, gjasat për afri të shqipes me gjuhët IE veriore dhe, pra për qenien e saj në një kohë të hershme në ato hapësira, duken më konkrete. Në rast se hapësira e hershme e paragjuhës IE shihet më me gjasë drejt Europës Juglindore dhe Panonisë do të implikoheshin me siguri dhe ndryshime në aspekte të caktuara të konceptimit të raporteve të hershme. Gjithsesi konceptimi që do ta afronte para-shqipen më shumë me grupin e gjuhëve greke-armene të jugut si *Balkanindogermansch* lindore do të kërkonte shpjegime shtesë për raportet e para-shqipes me gjuhët IE të veriut dhe për afritë e tjera të shqipes me gjuhët IE. Po edhe për konceptimin e përgjithshëm të lëvizjeve më të hershme IE.

Duke lexuar raportet për studimet keltike dhe hipotezat për qenien e keltishtes në lashtësi, të bien në sy ngjashmëri me trajtimet për shqipen. Vështrimet gjuhësore, ashtu si me rastin e ilirishtes më herët, sidomos në ngjashmëritë toponimike, e kishin theksuar shtrirjen e saj paneuropiane, ndërsa vështrimet e kundërta kishin shpënë deri aty sa të mohojë vetë ekzistenca e keltëve nga arkeologë seriozë britanikë. Shqyrtimi i kombinuar gjuhësi – arkeologji – kulturë – etnologji ia ka dalë të krijonte një pasqyrë më të pranueshme për keltët, si thotë Wolfgang Meid me librin e tij tash vonë.¹⁹²

Tani, skajshmëritë në vijën iliromani-ilirofobi duken të kalueshme përmes vështrimeve komplekse. Nxjerrja e një ngjashmërie në zhvillimet fonetike 3-4 mijëvjeçare në suaza të dy gjuhëve i ka vlerat, por edhe kufizimet. Vendosja e tyre në kontekstin historik-kulturor e historiko-sociolinguistik mund të sjellë rezultate të besueshme. Fakti se shqipja ka huazime greke të lashta dhe latine të hershme edhe në raport me gjuhët romane perëndimore, interpretimi i plotë i tij dhe i kontekstit përkatës vjen e merr peshë për të ritheksuar hipotezën për

¹⁹² Meid 2007, Wolfgang: *Die Kelten*, Reclam, Stuttgart.

bijërinë ilire të shqipes. Nga ana tjetër, duket fare e nevojshme që në bazë të elementeve të veçuara strukturore, të ngjashmërive në zhvillime, apo të ngjashmërive jo mjaft të sqaruara, sidomos nga aspekti kronologjik, të mos nxitohet me nxjerrjen e përfundimeve kështu largvajtëse.

PREJARDHJA E GJUHËS SHQIPE - DISKUTIME

Tema për të cilën do të flasim sot është nga të rëndësishmet në albanistikë. Është e vjetër, ndërsa për mua nuk është hera e parë që të flas për të. Qysh në vitet '80 të shekullit të kaluar kam provuar të thosha diçka në këtë drejtim (Ismajli 1987).¹ Kuptohet, një paraqitje si kjo nuk mund të mëtohet të jetë shterruese as plotësisht sistematike, po më parë të jepen disa kënde vështrimi që janë bërë nxitës për diskutime.

Në vitin 1964 indoeuropeisti italian Vittore Pisani (Pisani 1964) shtronte çështje të metodës së studimit të këtij subjekti. Në atë vështrim parimor Pisani tërhoqte vërejtjen:

“Historia e një gjuhe mund të bëhet vetëm ‘duke u nisur nga e tashmja për të arritur te traditat që presupozon ajo’.² Nga e tërë kjo del se për të rindërtuar historinë e shqipes do të duhej të niseshim nga shqipja ashtu siç flitet në Shqipëri nga një popullatë që në shumicën e saj të madhe paraqet vazhdimësinë gjenetike të grupeve njerëzore që kanë jetuar në këtë vend qysh nga kohët e parahistorisë më të hershme, duke konsideruar se gjuha shqipe e sotme është rezultati i krijimeve gjuhësore të brezave që kanë trashëguar njëri tjetrin në Shqipëri nga ato kohë deri në ditët tona” (përkthimi r.i., Pisani 1964: 63).³

¹ Ky tekst paraqet tejkshkrimin e ligjëratës së folur në Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë 2013, prandaj e ruan tërësisht atë strukturë.

² Teksti në thonjëza është i M. Devoto, tek *Omagiu lui Iorgu Iordan*, București, 1958, f. 236, të cilin e referonte me këtë rast Pisani.

³ "... l'histoire d'une langue ne peut se faire 'qu'en partant du présent pour arriver aux traditions qu'il présuppose'. Il s'ensuit de tout cela, que pour reconstruire l'histoire de l'albanais il faudrait partir de l'albanais tel qu'il est parlé en Albanie par une population qui dans sa grande majorité représente la continuation génétique des groupements humains qui ont vécu dans ce pays dès les temps de la préhistoire la plus reculée, en

Në këto rrethana, sipas tij, çështja nëse shqipja është vazhduesja e ilirishtes apo e trakishtes nuk ishte shtruar mirë. Nëse në Shqipëri në lashedësi flitej një gjuhë ilire, ai nuk shihte se si ka mundur që ajo popullatë ta ketë zëvendësuar gjuhën e vet me trakishten. E kuptonte mirë sesi ka mundur që ilirët të romanizoheshin gjuhësisht, si ka qenë e mundur të merrnin një gjuhë të madhe qytetërimi si greqishtja, por nuk e kuptonte sesi paska ndodhur që ilirët, të cilët deri në pushtimin romak kanë folur gjuhën e tyre, ta kenë ndërruar atë me një gjuhë të një populli që kurrë nuk e ka pushtuar Shqipërinë dhe nuk kishte një qytetërim me prestigj të atillë që ta justifikonte atë ndryshim. Për fat të keq, në këtë rast duhet të flasim në bazë të emërtimeve që mbulojnë entitete gati të panjohura. Më tej ai shpjegonte se i tërë diskutimi nëse shqipja vinte nga ilirishtja apo nga trakishtja ka lindur pas shqyrtimeve të Hermann Hirt-it dhe vazhdimeve të Henrik Barić-it (cf. Barić 1955), sipas të cilave, meqë gjuhët indoeuropiane ndaheshin në të tipit *centum* e *satəm*, meqë shqipja në elementet e saj indigjene shfaqej e grupit *satəm*, ndërsa ilirishtja në vështrimet e tyre ishte *centum* e trakishtja *satəm*, edhe shqipja duhej parë si pasardhëse e trakishtes (Pisani 1964: 64). Dhe vërente:

“... një gjuhë mund të jetë satəm, jo pse ka qenë e tillë gjithmonë prej kohës së përbashkësisë indoeuropiane, ... po për shkak se kjo është arritur nga vala që sillte asimilimin e palataleve. Mund të thuhej megjithatë se kjo valë ka arritur në Iliri mjaft vonë që ilirishtja të na paraqitej si gjuhë centum dhe shqipja si gjuhë satəm” (Pisani 1964: 65).⁴

Meqë ilirishten nuk e njohim, rindërtimet e ligjeve fonetike mund të

considérant que la langue albanaise d'aujourd'hui est l'aboutissement des créations linguistiques des générations qui se sont succédées en Albanie depuis ces temps-là jusqu'à nos jours". Këtu ai rikujtonte se këtë ide e kishte shprehur në studimin e mëhershëm *L'albanais et les autres langues indoeuropéennes* në *Mélanges Grégoire II*, f. 521, rimarrë te Pisani (1959: 98).

⁴ “... [que'] une langue peut être satəm, non parce que elle l'a toujours été à partir des temps de l'unité indo-européenne..., mais parce qu'elle a été atteinte par la vague portant l'assibilation des palatales. On pourrait pourtant dire que cette vague est arrivée en Illyrie assez tard pour que l'illyrien nous apparaisse comme une langue centum est l'albanais comme une langue satəm”, f. 65.

jenë arbitrare, prandaj edhe ka pasur diskutime lidhur me karakterin *centum* apo *satəm* të ilirishtes.

Pak më vonë se Pisani, Radoslav Katičić-i, të cilin Akademia jonë e zgjodhi anëtar të jashtëm, një studiues shumë i rëndësishëm i kohëve moderne për gjuhët e Ballkanit të lashtë, sidomos për ilirishten, por edhe për trakishten, për ato pak materiale që kemi në dorë nxirrte këtë përfundim:

“Asgjë në natyrën e provës nuk është paraqitur deri tash për prejardhjen trakase të gjuhës shqipe, por vetëm akumulim indiciesh që, pa e vendosur çështjen, na ndalojnë ta hedhim poshtë krejtësisht hipotezën. E vetmja gjë që mund të bëjmë tash është ta kemi mendjen të hapur duke mbajtur parasysh në këtë kontraverzë se barra e provës u bie atyre që mohojnë prejardhjen ilire të shqipes.” (Katičić 1976: 187-8).⁵

Teoritë për prejardhjen e gjuhës shqipe janë të vjetra, në fakt shkojnë në baraz me fillimet e këtyre studimeve. Johanes Thunmann më 1784, në baza historike jo gjuhësore, kishte nxjerrë përafërsisht përfundimin se shqiptarët janë pasardhës të ilirëve dhe shqipja pasardhëse e ilirishtes, sepse ata ishin pjesë e botës romake, ishin në fqinjësi të pandërmjetme me grekët e lashtë dhe kjo ishte e vetmja hapësirë ku mund të ndodheshin në atë situatë që të krijohej një popull siç ishin shqiptarët. Më pas studimet kanë vijuar në drejtime të ndryshme. E para, gjuha shqipe qysh me Bopp-in në mesin e shek. XIX ishte parë përfundimisht si gjuhë indoeuropiane në bazë të analizës së përmerave, të numërorëve, të strukturës gramatikore. Bopp-i thoshte madje se shqipja përbën një degë të veçantë të gjuhëve IE pa lidhje më të mëdha afërie me asnjërën prej degëve o gjuhëve simotra IE, pra një degë të veçantë dhe prej atëherë edhe sot shkenca këtë e ka marrë si një të vërtetë tashmë të verifikuar (Bopp 1855: 1).

Me kohë gjatë atij shekulli, në kuadër të gjuhëve indoeuropiane, disa studiues i caktuan shqipes një vend të afërt me greqishten,

⁵ “Nothing in the nature of a proof has been presented so far for the Thracian origin of Albanian, only a cumulation of indications which, without deciding the question, prevent us from rejecting the Thracian hypothesis outright. The only thing one can do is to keep an open mind while remembering that in this controversy the burden of proof is with those who deny the Illyrian descent of Albanian”.

çka u bë e pëlqyeshme për arbëreshët e Rilindjes, po dhe për një pjesë të studiuesve arbëreshë në përgjithësi, sidomos kur dihet se ide të ngjashme mund të kishin dhe autoritete të mëdha në fushën e studimeve krahasimtare-historike si August Schleicher (Schleicher 1861).⁶

Pas Bopp-it kemi një hov të ri zhvillimesh në studimet albanistike dhe të prejardhjes së gjuhës shqipe, me Gustav Meyer-in sidomos, në fund të shek. XIX, i cili e kishte vendosur edhe fonetakisht edhe gjuhësisht gjuhën shqipe në kuadër të gjuhëve IE, e kishte vendosur në kuadër të terminologjisë, të kategorive me të cilat flitej atëherë në gjuhësinë IE, si gjuhë të tipit *satəm* dhe gjuhë që kishte lidhje me gjuhët IE të veriut.⁷

Çka domethënë gjuhë *satəm*?

Pa dashur të përsërisim, ndoshta mund të përmbledhim diçka që mund të sugjerojë ndonjë gjë lidhur me mundësitë e interpretimit. Në gjuhët IE ka pasur bashkëtingëllore që sot quhen *tektale*, atëherë quheshin *guturale*, *grykore*, dhe aty janë afërsisht bashkëtingëlloret *k*, *g*, *gh* - sot i quajmë *velare*; dhe *palatalet* (qiellzore) *k̂*, *ĝ*, *ĝh*. Mendohet gjithashtu se paragjuha indoeuropiane kishte dhe bashkëtingëllore labiovelare (buzore-velare) *kʷ*, *gʷ*, *gʷh*. Gjithashtu mendohet se tri radhët e bashkëtingëlloreve tektale (qiellzore, velare dhe labiovelare) u shkrinë në dy në shumicën e gjuhëve bija, me ç'rast me velaret e pastra u shkrinë ose qiellzoret, ose labiovelaret. Në disa prej tyre rezultati ishte kundërvënia e velareve me labiovelaret: *k*, *g*, *gh* / *kʷ*, *gʷ*, *gʷh*. Në rastin e dytë kishim kundërvënie të velareve të pastra me qiellzoret: *k*, *g*, *gh* / *k̂*, *ĝ*, *ĝh*. Shqipja dhe armenishtja japin dëshmi për ruajtjen e të tri radhëve të tektaleve (në shqipen, derisa qiellzoret u bënë sibilante, velaret u ruajtën, ndërsa labiovelaret në kontekst para zanoreve të përparme u bënë sibilante, ndërsa në kontekstet e tjera u velarizuan: **penkʷe* > *pēs* (*pêsë*), **dorkʷo-* > *darkë*, **dorkʷe/imā-* > *darsëmë*. Të frymëtuarat u shkrinë me përkatëset mbyll-

⁶ Në fakt, Bopp qysh atëherë shprehte mendimin kundër afrisë së posaçme të shqipes me greqishten.

⁷ Cf. Meyer, G. 1889. *Die Stellung*.

tore të pastra. Gjuhët që bënë spirantizimin e palataleve drejt ç ose c, apo sibilanteve s, sh u quajtën *satəm*, sipas fjalës së avestishtes për numrin '100' – *satəm*, në kontrast me të latinishtes *centum* [kɛntum], të dyja nga IE **k̑mtom-*.⁸ Pjesa tjetër e bashkësisë gjuhësore palatalet e tilla i kishte spirantizuar. Çka d.m.th. spirantizoj? Kemi të bëjmë me një proces kalimi nga mbylltore të mirëfillta drejt fërkimoreve (frikativeve), që njëherësh nënkupton edhe lëvizjen përpara në boshtin e shpinës së gjuhës. D. m. th. këto palatale kishin shkuar pak përpara, ishin bërë diçka si ç, xh, pastaj c, x, pastaj s, z, në shqipen deri në th, dh. Është afërsisht ai fenomeni që kemi në gjuhët romane: lat. kemi *centum* ['kɛntum], it. *cinque* ['tʃɪnkue], fr. kemi *cent* [sɑ̃], spanjisht kemi *ciento* [θjento]. Siç vërente Hamp-i (1998: 333), dikotomia *satəm-centum* në terma IE nuk mund të jetë diagnostike. "Palatalet IE nuk u bënë universalisht sibilante, në fakt". Dhe këtu referonte situatën e shqipes në hapësirat nga Mali i Zi drejt Ohrit e më tej në Greqi lidhur me realizimet për [k̑] drejt [č], [č̑], [ts], apo nga Peja drejt Gusisë e Thethit, ku [č] bëhet [ś]. Te Korça do të keni q, gj psh. *gjarpën* dhe *gjashtë*, në Pogradec tashmë kemi lëvizje në pjesën e përparme të shpinës së gjuhës, e edhe pak më tej, në Dibër do të keni ['dʒarpən, dʒāfi]. Edhe këtej në Kosovë po ashtu, nëse shkoni pak më larg në Junik ose pak më në veri do të keni [d̑arpən, d̑āft], d.m.th. diçka pak më në mes. Po të shkoni pak më tutje midis Gusisë dhe Kelmendit, midis Malit të Zi dhe Shqipërisë, atje do të kemi ['zarpən, zāsht], d.m.th. do të kemi një spirantizim të plotë, por edhe sulkalizim (shtegorëzim).

Pak a shumë një proces i ngjashëm ka ndodhur edhe në paragjuhën IE dhe kështu me kohë janë ndarë dialektet, pastaj gjuhët. Më vonë kjo ndarje u absolutizua shumë dhe mendohej se gjuhët që kanë qenë në njërën anë ishin krejt të ndryshme nga gjuhët në anën tjetër. Por nuk duhet të harrojmë që këtu ndërmjet ka pasur proces kronologjik: në disa dialekte procesi ka ndodhur më herët, në disa më vonë, në disa, si në parashqipen, e ka përfshirë hapësirën pjesë-pjesë, në disa pjesë të tjera

⁸ Nuk e dimë shqiptimin e saktë të atëherëshëm, ato që shënojmë me asterisk janë vetëm formula të gjuhëtarëve, jo realitet gjuhësor.

ndryshe, d.m.th. nuk mund të absolutizohet në gjendjen e sotme kjo çështje, pikërisht ashtu siç tërhiqte vërejtjen Pisani.

E dyta, gjuha shqipe vendosej në paralele me gjuhët IE veriore, konkretisht me gjuhët baltike dhe sllave, sepse gjindeshin më shumë relacione sidomos leksikore specifike, të vjetra me gjuhët sllave dhe baltike dhe ngapak edhe relacione me gjermanikishten. P.sh. zanorja **ǫ* e shkurtë IE në shqipen është bërë *a*: *natë*, lat. *nox*, gjerm. *Nacht*. Kjo është një paralele me gjuhët gjermanike dhe shqipen. Ka të tilla edhe me gjuhët baltike dhe gjuhët sllave. Pak a shumë kjo ishte vendosja e Gustav Meyer-it (shih Pellegrini 1995, Meyer 1898). Meyer-i për palatalet, pra për **k̑*, **ǵ* indoeuropiane thoshte se në shqipen kishin dhënë edhe *s*, *z* edhe *th*, *dh* dhe shembulli për refleksin e parë ishte *vis* e krahasueshme me lat. *vicus*. Më vonë Çabej ka dëshmuar, dhe Jokl-i, Pedersen-i më herët, e të tjerët, se në shqipen nuk del një rezultat i tillë, shqipja ka vetëm *th* dhe *dh* atje ku gjuhët perëndimore si gjermaniket, si italiket ose edhe greqishtja, kanë *k*, *g*. Armenishtja, gjuhët sllave, gjuhët baltike, gjuhët indase, iraniane kanë *s*, *sh*, *kh*, por jo *k*, *g*. Kjo ndarje, pra, është parë si e rëndësishme.

Holger Pedersen-i (Pedersen 1900) e korrigjoi teorinë e Meyer-it në etimologji dhe në refleksin e palataleve IE. Palatalet IE, pas tij, në shqipen janë reflektuar si vijon: *k'*, *k'h* > *th*; *g'*, *g'h* > *dh*, *d* dhe jo *s*, *z*. Në rastin e shqipes, sipas tij, vërtetohet se kishte tri radhë guturalesh (grykoresh): *palatale (qiellzore)*, *velare*, *labiovelare*. Palatalet në shqipen, janë spirantizuar, velaret janë ruajtur; labiovelaret kanë pësuar një zhvillim të veçantë: para zanoreve të përparme *k^w*, *g^w*, *k^wh*, *g^wh* > *s*, *z*: *pesë*: lat. *penque*; *dar-sëmë* në raport me *darkë*, *vdes* në raport me *vdekje*, etj. Para zanoreve të tjera janë velarizuar. Pra me këtë, me ndihmën e shqipes dëshmohej se paragjuha IE kishte tri radhë të këtyre guturaleshve ose tektaleshve. Dhe ka një vend pak specifik në kuadër të këtyre gjuhëve perëndimore dhe lindore. Këtë rrugë e kanë ndjekur shumë albanologë seriozë të kohës sonë. Sigurisht apote të reja kanë sjellë Jokl-i e Çabej. Çabej është figura kyçe në këto hulumtime, por edhe studiues si Wacław Cimosowski, Agnja V. Desnickaja, Eric P. Hamp kanë ndihmesat e tyre. Në kohët e fundit një libër

shumë të mirë sintetizues për zhvillimet në albanistikë ka botuar Giovan Battista Pellegrini në Itali (Pellegrini 1995). Natyrisht, ne kemi këtu libra të Sh. Demirajt (Demiraj 1988, Demiraj 1999), veprat e K. Topallit, të gjitha të ndërlidhura me veprat e Çabejtë (Çabej 1970, Çabej 1976), e edhe të tjerët kanë shkruar për këtë çështje.

Përveç këtij aspekti në gjuhësinë historike u shtrua një çështje tjetër: mirë, meqë qenka gjuhë pasardhëse, një degë e veçantë e gjuhëve IE, e tipit *satam*, me vendosje veriore, me lidhje të veçanta - Çabej ka shtuar - me gjuhët jugore, me greqishten më vonë, ndoshta në raporte me armenishten, siç ka thënë Pedersen-i, dhe pastaj ka edhe sot si Klingenschmidt (1993) e të tjerë që përhapin këtë ide: *Ku ka qenë shqipja në botën e lashtë?* Në bazë të dokumenteve në Gadishullin Apenin ne e dimë që latinishtja është folur nga shek. VI-VII para K., që gjuhët gjermanike janë dokumentuar më vonë, gotishtja në Ballkanin verior afër Danubit, gjuhët kelte kanë qenë fqinje këtu në veri të Danubit, pastaj kanë ikur në perëndim, sot vetëm në Francën perëndimore dhe në Britani, gjuhët sllave në lindje, gjuhët baltike në veri etj. Ku ka qenë ajo gjuhë prej së cilës doli shqipja? Ku është folur? Dokumente të shkruara ne për këtë nuk kemi, shqipja është gjuhë e shkruar nga viti 1462 - "Formula a pagëzimit". Kemi 15 shekujt në mes për të cilët nuk dimë gjë, praktikisht errësirë. Tani, shkenca në këtë situatë ka qenë e detyruar të përdorë mjete ndihmëse: kontaktet e shqipes me gjuhët e tjera, dhe eventualisht dokumentacionin ndihmës onomastik, emrat e njerëzve, të vendeve, të lumenjve, të zotërve etj. Në aspektin e parë Thunmann-i e kishte vendosur mirë çështjen. Shqipja ka një numër shumë të madh fjalësh latine, në shkallën që G. Meyer e quante gjuhë gjysmëromane. Pedersen-i e kishte kritikuar pastaj, sepse ishte e tepruar kjo, vërtet. Megjithatë mbetet fakti që ka shumë huazime latine. Këto huazime latine na ndihmojnë që të rindërtojmë faza më të hershme të shqipes. Duke parë si kanë hyrë latinizmat ne shohim si ka qenë sistemi i shqipes. Dhe këta latinizma janë të vjetër në shqipen. Iliria u pushtua në vitin 167 p. K. Ilirët kanë pasur kontakte me romakët në Adriatik, ndanin detin e përbashkët, luftonin, grabisnin anijet romake, i

plaçkisinin e plaçkiteshin nga ta, d.m.th. kishin kontakt së paku nga shek. II ose III p.K. Dhe këto kontakte kanë zgjatur shumë.

Në Europën jugore përgjithësisht dy janë gjuhët që kanë shpëtuar nga romanizimi i plotë. Lëmë anash greqishten, me të ishte kultura greke, gjuhë e shkruar etj. Nga të tjerat vetëm shqipja dhe baskishtja në Francën jugore e Spanjën veriore, vetëm këto gjuhë, këta dy popuj kanë shpëtuar nga romanizimi i plotë pas pushtimit romak. Të gjithë janë shkrirë, janë bërë francezë, italianë, piemontezë etj. Pse? Si ndodhi?

Janë parë edhe argumente të tjera. P.sh. është menduar që mos është kjo e pamjaftueshme të thuhet se shqipja është folur në këtë pjesë, dhe është shtuar argumenti tjetër që në shqipen ka një numër fjalësh greke, por ka më pak. Në raport me fjalët latine në shqipen ka shumë pak fjalë greke, janë rreth 40. Që nga 1910 Albert Thumb dhe pastaj Norbert Jokl, albanologët e kishin ngritur këtë çështje (Mansaku, 1997: 182-186). Do të sjell këtu një mendim të Jokl-it. Në studimin e tij të botuar pas vdekjes *“Sprachliche Beiträge zur Paläo-Ethnologie der Balkanhalbinsel”* ai merr me marrëdhëniet më të vjetra greko-shqipe, konkretisht me fjalët greke në shqipen. Sipas tij, në raportet midis greqishtes e shqipes duan veçuar tri lloje të dhënash, që u përgjigjen tri fazave të ndryshme.

“Kështu do të përipiqem të gjej tipare për të mbështetur raportet e stërlasshta të afrië, ashtu si dhe të shqyrtoj huazime të shqipes nga greqishtja e vjetër, që në literaturën e derisotme nuk janë paraqitur. Por do të shqyrtohen edhe elemente që përbëjnë një grup të tretë, që nuk u përkasin as veçorive të përbashkëta para ndarjes në gjuhë të veçanta as huazimeve të qarta, pra që duan parë si një lloj tiparesh të ndërmjetme. Këtu të dy gjuhët janë të pavarura nga njëra tjetra, por sugjerojnë njëfarë zhvillimi paralel... Ndarja që unë kam vendosur në bazë të konceptimit tim është kronologjike: raportet para ndarjes në gjuhë të veçanta përbëjnë segmentin e parë, që ndiqet nga grupi i karakterizuar si i mesëm, që përfundon me huazimet e lashta të shqipes. Po ta shtrojmë çështjen në terma të renditjes gjuhësore-gjeografike të këtyre grupeve, grupi I mund të ketë ndodhur me siguri jashtë Siujdhesës Ballkanike, kjo do të ishte më e besueshme. Me

grupet II dhe III jemi në Siujdhesën Ballkanike, çka mund të shihet nga rrahjet e përhapjes dhe të kuptimit të fjalëve në shqyrtim” (Jokl 1984: 15-16).⁹

Pra, edhe greqishtja edhe shqipja në Ballkan janë të ardhura nga diku më në veri. Ka arkeologë, sidomos arkeologë shqiptarë, që thonë se ilirët janë formuar këtu në Ballkan, s’kanë ardhur nga veriu dhe kanë lidhje ballkanike dhe anatolike, me pjesën anatolike. Diskutimi ekziston dhe Çabej ka një kontraverzë gjysmë të heshtur me arkeologët dhe historianët. Edhe Buda, që gjithandej ndjek mendimin e Çabejtë, kur vjen këtu thotë se kishte *‘edhe lidhje anatolike’*. Është një koncesion që i bëhet të ashtuquajturës teori pellazgjike?

Në pjesën e dytë Jokl-i saktëson se fjala shqipe *gëzof* të çon drejt gjurmëve nga kohët pararomake. Në këtë pikë ai vijonte më tej me shpjegimet për raportet në hapësirën ballkanike në lashtësi (Jokl 1984: 36). Përmbledhja e ideve të ekspozuara më herët i jepte atij të drejtë të konstatonte se

“... shqipja është gjuha e një populli që qysh në lashtësi, dhe pikërisht në kohën pararomake ashtu si në romaken, kishte këmbime me greqishten dhe mëtej se shqipja e greqishtja përkasin bashkë”¹⁰

dhe më tej edhe më qartë se

⁹“Ich werde demnach sowohl Belege für urverwandtschaftliche Beziehungen nachzuweisen suchen, als auch Entlehnungen des Alb. aus dem Altgriechischen, die in der bisherigen Literatur noch nicht festgestellt sind, besprechen. Aber auch Elemente, die eine dritte Gruppe bilden, die also weder den voreinzelsprachlichen Gemeinsamkeiten noch den klaren Entlehnungen angehören, demnach eine Art Mittelstellung einnehmen, sollen zur Sprache kommen. Hier sind beide Sprachen voneinander unabhängig, weisen aber dennoch eine Parallelentwicklung auf. ... Die Gliederung, die ich der Darstellung zugrunde lege, ist eine chronologische: Voreinzelsprachliche Beziehungen bilden den ersten Abschnitt, die eben charakterisierte Mittelgruppe folgt, die alten Entlehnungen des Alb. bilden den Schluß. Fragt man nach der sprachgeographischen Zuordnung dieser Gruppen, so kann Gruppe I sehr wohl außerhalb der Balkanhalbinsel ihren Schauplatz haben, ja dies wäre das allerwahrscheinlichste; mit Gruppe II und III befinden wir uns auf der Balkanhalbinsel, wie dies Verbreitungsbezirk und Bedeutungsinhalt der zu bearbeiteten Wörter ergeben wird”. Jokl 1984: 15-16.

¹⁰“... so ergibt sich, das das Alb. die Sprache eines Volkes ist, das schon im Altertum, und zwar sowohl in vorrömischer als in römischer Zeit mit dem Gr. in sprachlichem Austausch stand, des weiteren, daß Alb. und Illyr. zusammengehören”, f. 46.

“shqipja qëndron shumë afër me ilirishten, ashtu siç na doli tek gausapes, γαύσαπος; hapësira gjuhësore shqipe qysh nga kohët pararomake duhet të shihet në afërsi me të greqishtes dhe të latinishtes”.¹¹

Këtë mendim të Jokl-it e pashë të arsyeshme ta përsërisja sepse është botuar pas vdekjes së tij. Më 1924 në një studim tjetër ai kishte thënë pak ndryshe dhe citohet teoria e tij për shkrimin midis ilirishtes dhe trakishtes, ose për dy komponente brenda shqipes, jo për shkrimin, por për ekzistencën e dy komponentëve. Jokl-i këtë studimin e fundit e kishte bërë si diskutim lidhur me hipotezat e studiuesve rumunë A. Philippide dhe V. Pärvan, nga të cilët i pari shqipen dhe shqiptarët në lashtësi i shihte në periferinë e jashtme të Orbis Romanus, në Panoni, ndërsa tjetri i sillte nga Karpatet. Prandaj Jokl-i nxirrte këtë përfundim:

“Kontaktet gjuhësore të shqipes me greqishten e latinishten të shqyrtuara më sipër paraqesin, siç dua të besoj, fundin e të gjitha hipotezave të atilla. Studimeve të mëtejme u mbetet të tregojnë se cilit prej dy popujve – shqiptarëve dhe grekëve – i përket e drejta për të qenë i parilenë në Ballkan”.¹²

I parilenë është një fjalë shqipe që e ka përdorur Buzuku, ai që lindi i pari, *primogenitus. Erstgeborene* e ka Jokl-i. Jokl-i vendin e shqipes në ato kohë e shihte ndërkaq në një mënyrë pak më të përcaktuar, jo në të gjithë hapësirën e sotme shqiptare, por konkretisht në Dardani, çka d.m.th. se përjashtonte pjesë si Shkodra me rrethe – mendonte se forma e sotme e emrit *Shkodra* për do arsye të tjera, që janë kontestuar nga Çabej, nuk mund të vinte përmes shqipes, dhe prandaj i shihte më shumë në Dardani. Dardania ishte hapësira që përfshin Kosovën e sotme, pjesë të Shqipërisë veriore: Kukësin, Malësinë e Gjakovës etj., Maqedoninë veriore deri te Tetova, në jug të Shkupit, Serbinë jugore deri në veri të Nishit. Kjo Dardani, sipas Jokl-it, mund të ishte djepi i shqipes së hershme.

¹¹ “Das Alb. steht also jedenfalls dem Illyr., wie es uns in *gausapes, γαύσαπος* entgegentritt, sehr nahe; das Alb. Sprachgebiet ist seit vorrömischer Zeit in der Nähe des Gr. und des Lat. zu suchen”, f. 36.

¹² “Die hier besprochenen sprachlichen Berührungen des Alb. zum Gr. und Lat. bereiten, wie ich glauben möchte, allen derartigen Hypothesen ein Ende. Gegenstand weiterer Untersuchung wird es sein festzustellen, welchem von den beiden Völkern – Albanern und Griechen – auf der Balkanhalbinsel das Erstgeburtsrecht zukommt”, f. 47.

Këto diskutime kanë zgjatur pak më shumë. Rumunët e kanë parë lidhjen e prejardhjes së shqipes me prejardhjen e rumanishtes - është problematike a është formuar rumanishtja në jug të Danubit apo në veri të Danubit - si një çështje shumë të rëndësishme. Romakët e pushtuan Dakinë në shek. II pas K. dhe qëndruan atje në veri vetëm pak, 70 vjet saktë, dhe pastaj ikën në jug, aty krijuan Limesin dhe aty sollën kolonë. Mendohet se pikërisht në jug u formua rumanishtja nga romanishtja popullore e folur, ndërsa në veri shkuan më vonë, ashtu siç zbritën arumunët drejt jugut në Greqi, Shqipëri, Maqedoni. Ka hipoteza të tjera që e shpjegojnë ndryshe këtë punë. E vërteta është se romanizimi ka ndodhur gjithandej. Romakët kur erdhën romanizonin të gjithë, ilirë, trakas, çkado që ishte bëhej romane. E kemi parasysh p.sh. Perandorinë Osmane, shkoni në Stamboll, Stambolli është gjithçka, por më së paku turq të viseve tatarë. Mund të jenë shumë shqiptarë, grekë, serbë, bullgarë, popuj të Kaukazit etj. Por të gjithë flasin vetëm turqisht, të gjithë thonë jemi turq. Pra, kur vinin romakët këtu, romanizonin të gjithë, të gjithë bëheshin romanë, pos atyre që nuk romanizoheshin. Pra, e kemi të vështirë t'i diferencojmë etnikisht në rrafsh të romanizimit.

Ka pasur një teori që thoshte se në Ballkan janë dy aspekte të romanitetit: një që krijoi dalmatishten në ujdhesat e Bregdetit dalmatin dhe në Dubrovnik e tjetri që krijoi rumanishten në lindje. Shqipja ka shumë elemente latine. Ku përkohet këto elemente? Studimet kanë treguar se elementet latine të shqipes janë të vjetra, disa janë më të vjetra se ato që dëshmohen në gjuhët romane, se perëndimoret e se lindoret. P.sh. shqip kemi *qepë*, diku *kepë*, lat. *cēpa*. Pra, kemi pasur *k* të ruajtur, velare, që u palatalizua më vonë, ndërsa në të folmet ku edhe tash del velarë, kemi depalatalizim. Sipas romanistit H. Mihăescu, ka një numër fjalësh latine që vetëm shqipja i ka ruajtur, nuk janë ruajtur as në perëndim as në lindje, nja 90 fjalë, s'janë pak. D.m.th. ka mjaft fjalë që janë të ngjashme me të rumanishtes, por këto janë pas shek. VI e më vonë, jo më të hershme. E. Banfi veçonte një zonë të tretë ballkanike të latinizmave, zonën e Via Egnatia, ku ka ngjashmëri mes latinizmave të shqipes dhe të greqishtes së re (Banfi 1972, shih më poshtë). Pra, përgjithësisht shqipja është folur në një

hapësirë romane, latine. Ky është një argument i rëndësishëm. Dhe ku ka mundur të marrë fjalë greke. Fjalët greke nuk kanë hyrë si ato të latinishtes, grekët nuk e kanë pushtuar truallin shqiptar, me grekët paraardhësit tanë kanë pasur një raport tjetër. Grekët kanë krijuar koloni në bregdet kudo, pra Apollonia, Dyrrachion, Epidamnos, pastaj Epidaururs, Issa. Gjithandej kanë krijuar koloni, ishin popull detar, jetonin në koloni buzë detit, merreshin me tregti dhe me kulturën e tyre. Dhe po të shikoni mirë fjalët greke në shqipen, ato që janë ruajtur janë të vjetra dhe janë kryesisht të fushave të kulturës mesdhetare, p.sh. *lakër, drapër, pjepër*. Ka dhe fjalë të tjera, *machanon – mokën* – një makinë e vogël për thyerjen e grurit, *draphanon – drapër*, etj. Pra janë të kulturës materiale të zonës mesdhetare. Ndoshta edhe *venë, presh* kanë hyrë andej dhe pak a shumë reflektojnë dialektin dorik, që flitej në pjesën perëndimore, që u shpërnda dhe në Italinë e Jugut pastaj.

Këto elemente janë shumë të rëndësishme për përcaktimin e vendit ku ka qenë paraardhësja e shqipes. Në atë vend ka pasur vetëm ilirë. Ilirët ishin popullatë që shtrihej në jug të Danubit deri në Adriatik dhe poshtë deri në malet Akrokeraune ose andej pak a shumë deri te Korfuzi. Në jug ishin makedonët, grekët, në lindje ishin trakasit, në lindje të lumit Morava dhe Vardar. Afërsisht kjo është pasqyra që na kanë lënë autorët e lashtë grekë dhe romakë në shkrimet historike të tyre. Megjithatë, ka pasur një teori që ilirët i lidh me kulturën e Hallstadtit, i binte të ardhur nga Europa e mesme dhe pastaj Hans Krahe, një gjuhëtar gjerman, i çonte nëpër gjithë Europën, shpjegonte shumë emra të lumenjve me anë të ilirishtes. Më vonë u pa, në vitet '60 të shek të kaluar, se kjo ishte gabim dhe u bënë kritika të rrepta në këtë drejtim. U pa se venetët p.sh. në veri ishin më të afërt me latinët në Itali. Katičić në studimet e tij për onomastikën ilire, se s'dimë më shumë, vetëm emrat e njerëzve, ka veçuar tri zona onomastike: një të ilirëve, që latinët i quanin *Illyrii proprie dicti*, ilirët në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, që shtriheshin në jug të lumit Neretva (Narona), pastaj zonën dalmato-panone dhe në fund zonën liburne, që ishte krejt tjetër. Nuk thuhet a pasqyrore kjo gjendje tri gjuhë, por më vonë gjuhëtarët kanë nxjerrë përfundimin se mund të ishin tri gjuhë. Qysh G. Meyer-i

thoshte se shqipja ishte pasardhëse e njërit prej dialekteve të ilirishtes, edhe Pedersen-i - thoshte e ilirishtes së jugut, edhe të tjerët pastaj dhe kjo u precizua me kohë. Studimet arkeologjike, etnografike, historiografike bënë një kompleks të tërë që e shohin shqipen pasardhëse të ilirishtes së jugut ose të ilirëve në kuptimin e mirëfilltë të fjalës.

Aty u shtrua çështja, po çfarë ishin dardanët? A ishin dardanët ilirë? Ka pasur shumë diskutime dhe sot mbisundon mendimi se dardanët ishin ilirë. Ka porse një diskutim të vogël që thotë se dardanët ishin ilirë, por dardanët e shek. X para K. dhe dardanët e shek. IV para K. mund të mos ishin të njëjtit, më herët mund të ishin diçka tjetër dhe ndërkohë u ilirizuan. Këtu hymjë në fushën e historianëve dhe nuk kemi mundësi të japim gjykime me vlerë. Por do të themi se mbi këtë bazë është ndërtuar një teori, shih sidomos V. Popović pastaj M. Garašanin, i cili në fillim mendonte ndryshe, pjesërisht F. Papazoglu, që në vitin 1988 botuan librin "*Iliri i Albanci*", në të cilin insistojnë të thonë se dardanët të paktën para shek IV para K., kur e krijuan shtetin e tyre dhe ishin ilirë, mund të kenë qenë diçka tjetër dhe janë pak ndryshe nga ilirët e tjerë.

Fanula Papazoglu, në studimin e përmendur, nisej nga kritika e përgjithshme e pikëpamjeve të shkencës shqiptare për ilirët, ku përfshihen dardanët, madje dhe peonët. Vërejtja e saj ka të bëjë me bindjen se

"midis ilirëve dhe dardanëve nuk mund të vihet shenjë barazimi", Papazoglu 1988: 143.¹³

Ajo përpiqej të saktësonte se, edhe pse kishte një komponent të padiskutueshëm ilir tek dardanët, ata nuk mund të identifikoheshin me ilirët. Për më tepër, ajo vinte në pah gjithashtu se, sipas studimeve të vona, në formimin e dardanëve donte njohur dhe një shtresë më e vjetër dako-meze e ndoshta edhe protofrige.¹⁴ Në kohët historike ajo mendonte se ka pasur dhe ndërfitje elementesh trakase dhe duhet të jetë ky element që do

¹³ "Izmedju Ilira i Dardanaca se ne može staviti znak jednakosti".

¹⁴ Këtu referonte Georgiev 1976, VI.: *Les Illyriens et leurs voisins*, in *Iliria* 5, 47, ku ai dardanishten e konsideronte dako-mezishte. Vetë ka pohuar më herët se në Dardanië jugore mund të ketë pasur dhe një komponent parailir, frigas.

t'ua ketë dhënë atyre vulën sa i përket strukturës etnike.

“Por më shumë se struktura etnike, ajo që i ndan dardanët nga ilirët është zhvillimi politik. Vërtet, nga momenti kur dalin nga parahistoria – ilirët rreth mesit të mijëvjeçarit I para e.r., dardanët pak më vonë, në gjysmën e dytë të shekullit IV – bashkësitë ilire dhe dardane kishin fat qartësisht të ndarë”, Papazoglu 1988: 146.¹⁵

Autorja shënonte se midis Mbretërisë Ilire dhe Mbretërisë Dardane në jug kufiri i përgjigjej kufirit etnik e politik, ndërsa lëvizte afërsisht rreth vijës ku kalonte kufiri shqiptaro-jugosllav. Në anën e Maqedonisë së sotme kufirin e përbënte Mali Shar. Edhe pse i përkiste provincës makedone, rajoni i Tetovës kishte popullatë ilire. Duke pasur parasysh se Dardania i përkiste sferës latine, ndërsa rajoni i Tetovës sferës greke, ajo nxirrte përfundimin se as më herët kjo hapësirë nuk i ka përkatur Dardanisë, po Ilirisë, 163-164.

Sa për shtrirjen e kufijve gjuhësorë-etnikë, në lashtësi, ashtu si sot, nuk është e lehtë të përshtaten gjithherë dhe kudo shtrirjet politiko-shtetërore, kjo është e evidente. Besoj se është thënë mjaft qartë në shumë studime edhe vërejtja tjetër, se ndarja e mbishkrimeve sipas gjuhës – latine apo greke, ashtu siç lë të kuptohet linja Jireček, nuk është domosdo në përputhje me realitetet gjuhësore vendore (jolatine, jogreke, sepse fenomeni i shkrimit lidhet me një shtresë të caktuar zanatçinjsh dhe të përkatësisë kulturore).

Dhe në fund fare, Papazoglu vinte me këtë qëndrim:

“Dardania hyn ndër rajonet më së paku të romanizuara antike në Ballkan, ku popullata autoktone u ruajt më së miri”, Papazoglu 1988: 169.¹⁶

Pasi pohonte se vetëdija etnike te dardanët ishte shprehur përmes emrave të cilësuar *Daradania, Dardanus, Dardana*, madje edhe *Nat(ione)*

¹⁵ “No više nego etnička struktura, ono što deli Dardance od Ilira je politički razvitak.¹⁵ Doista, od trenutka kada izlaze iz preistorije – Iliri oko sredine I milenija pre n.e., Dardanci nešto kasnije, u drugoj polovini IV veka – ilirska i dardanska zajednica imale su jasno razdvojene sudbine”.

¹⁶ “Dardaniya spada medju najmanje romanizovane antičke oblasti na Balkanu gde se autohtono stanovništvo najbolje održalo”.

Dardanus, ajo vinte me përfundimin:

“Nuk përjashtohet që kjo popullsi ta ketë mbijetuar epokën e depërtimeve barbare dhe të shpërnguljeve të mëdha, sidomos në rajonet më pak të urbanizuara, dhe të ketë hyrë në mesjetë me emrin e Albanëve”, Papazoglu 1988: 169.¹⁷

Në fusnotë rikujtonte se ka shumë dijetarë (G. Weigand, N. Jokl, H. Barić, Vl. Georgiev) që vendin e formimit të shqiptarëve e shohin në hapësirën e Ballkanit qendror duke u nisur nga supozime gjuhësore.

Në fjalën e hapjes të atij tubimi shkencor, sekretari i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, shkrimtari i njohur akademik A. Isaković nuk e fshihte synimin që përmes këtij libri ajo Akademi të merrte rolin që

“çështjen e shtruar Ilirët dhe shqiptarët, që në shumë vende është larguar nga objektiviteti shkencor dhe e vërteta, ta kthejmë në rrjedhat dhe konturat e vërteta shkencore”.¹⁸

Një faqe më herët tërë çështjen e lidhte me ngjarjet e vitit 1981 në Kosovë, sepse:

“është fakt i padyshimtë se shkenca shqiptare, e ndihmuar për fat të keq dhe nga disa punonjës shkencorë nga Kosova, shpesh fakteve shkencore u qaset në mënyrë jokritike, duke i paraqitur njëanshëm, duke heshtur disa syresh dhe duke vënë në plan të parë të tjerat, për të gjetur kështu arsye-tim për aspiratat politike dhe ashpërsim të marrëdhënieve”, Isaković 1988: 5-6.¹⁹

Fjala është, pra, meqenëse Isaković ishte vetëm shkrimtar, për një orientim programatik për të korrigjuar një shkencë të tërë kombëtare dhe

¹⁷ “Nije isključeno da je ovo stanovništvo preživelo doba varvarskih najezda i velikih seoba, naročito u manje urbanizovanim oblastima, i da je ušlo u srednji vek pod novim imenom Albanaca”.

¹⁸ “... da zadato pitanje Iliri i Albanci, koje se na mnogim mestima udaljilo od naučne objektivnosti i istine, vratimo u prave naučne tokove i okvire”, f. 6.

¹⁹ “Nesumnjiva je činjenica da albanska nauka, potpomognuta nažalost i nekim naučnim radnicima sa Kosova, često nekritički pristupa tumačenju naučnih činjenica, predstavljajući ih jednostrano, prećutkujući neke od njih a stavljajući u prvi plan druge, kako bi našla opravdanja za političke aspiracije i zaoštavanje odnosa”.

për të hequr bazat për aspirata politike. Natyrisht, duke shpallur të vërtetën e vet për jopolitike. Dhe duke i parë të gjithë autorët shqiptarë si një, pa diferencime, dhe me aspirata politike.

Vladislav Popović, arkeolog, ndërkaq, nuk i fshihte vlerësimet e tij politike, natyrisht, gjithnjë 'në frymën dhe me mëtesën e objektivitetit shkencor':

"... Gjorgje Kastrioti, i quajtur Skanderbeg, i cili iu kundërvu turqve pa kursim në rrethana tragjike deri në vitin 1468, dhe të cilit sot në Shqipëri i ngrihen përmendore, në të vërtetë ishte armiku më i egër i njerëzve vendësve historikisht të turbullt të paromanizuar dhe të pahelenizuar, për të cilët shkencëtarët shqiptarë pohojnë se janë ilirë dhe me një guxim gati mrekullitar mendojnë se bashkëkombësit e tyre të sotme janë pasardhës të tyre të drejtpërdrejtë. E parë në këtë dritë, teza ekspansioniste ilire nuk është gjë tjetër pos një surrogat bashkëkohës dhe i varfëruar i politikës së gjysmëhënës turke, i mbështetur fort me jatagan", Popović 1988: 249.²⁰

Dhe më tej përfundimi i tij shtrihej tek 'ringjallja e ilirëve'²¹

"të trupëzuar në arbanasët, si prodhim i hamendësimeve të filologëve të mësuar mirë në shkollat gjermane", Popović 1988: 249-50.²²

Edhe pse ua njihte cilësinë e shkollave gjermane, mbase si armiq të kohës së Hitler-it, studimet shqiptare më herët përpiquej t'i zhvlerësonte tërësisht.

Në fjalën e mbylljes, autoriteti i arkeologjisë Milutin Garašanin e shihte të nevojshme të vinte në pah disa elemente. Sipas tij, ilirët u krijuan përmes një procesi të gjatë etnokulturor të rigrupimit, dezintegrimit e re-

²⁰ " ... Djordje Kastriota, zvani Skenderbeg, koji se pod tragičnim okolnostima bespoštedno odupirao Turcima do 1468. god, i kome se danas u Albaniji dižu spomenici, upravo bio najljući neprijatelj tih istorijski mutnih neromanizovanih ili nehelenizovanih domorodaca, za koje albanski naučnici tvrde da su Iliri i sa skoro zadivljujućom smelošću smatraju da su njihovi današnji sunarodnici neposredni potomci. Vidjena u toj svetlosti, ekspansionistička ilirska teza nije ništa drugo no savremeni i osiromašeni surogat politike turskog polumeseca, čvrsto poštapanog jataganom".

²¹ Vaskrs Ilira, term që lidhet me ringjalljen e Krishtit!

²² "Otelotvorenim u Arbanasima, kao proizvod nagadjanja filologa dobro obučenih u nemačkim školama".

integritetive të reja fisesh të ndryshme dhe grupacionesh kulturore në Ballkanin Perëndimor.

“Ata u diferencuan gradualisht ndër banorët e asaj treve në hapësirën nga Shqipëria e Jugut deri te Përdrini e Drini i Bardhë e deri te Dalmacia e sotme e mesme. Banorët e Posavinës, të bregut verior të Adriatikut dhe të prapavijës së tij, dhe posaçërisht të Dardanisë, veçohen ashpër nga ta. Ata, e sidomos këta të fundit, formohen nga një substrat krejt tjetër. Dardanët nuk mund të identifikohen me ilirët”, Garašanin 1988: 362.²³

Nuk do shumë mend se këtu shpërfaqet mëtesa për të projektuar kufij qysh në lashtësi pikërisht aty ku ishin midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë dhe për të treguar kështu se ata kufij politikë atëherë shprehnin dallime etniko-gjuhësore! Natyrisht, nuk linte pa e theksuar lidhjen veriore me substratin dako-mez. Përfundimi i tij kryesor flet vetiu:

“Ngjashëm me vllhtë, mbetje të popullatës së romanizuar në male, që këndeju u tërhoq në kohën e dyndjeve të popujve dhe të imigrimit sllav, shqiptarët u krijuan nga mbetjet e popullatës së paromanizuar paleobalkanike të atyre trojeve, ndër të cilët me siguri ka pasur edhe mbetje të ilirëve dhe të dardanëve. Me kohë, sidomos në kuadër të lëvizjeve baritore, ndodhi integrimi i njatyre elementeve fillimisht me prejardhje të ndryshme që tash në histori hyjnë si popull i ri vetëm në shekullin XI-XII, kur për herë të parë, siç duket, tashmë të formuar, përmenden në burimet bizantine dhe sllavojugore. Është e qartë se këtyre elementeve më vonë u bashkohen dhe komponente të tjera, sidomos sllavja, rëndësinë e së cilës në Shqipëri e dëshmojnë toponimitë”, Garašanin 1988: 366.²⁴

²³ “Oni su se postepeno izdiferencirali medju stanovnicima toga područja na prostoru od južne Albanije do Podrinja i od Belog Drima do današnje srednje Dalmacije. Stanovnici posavine, severne jadranske obale i njenog pozadja, a posebno Dardanije, oštro se izdvajaju od njih. Oni, a naročito ovi poslednji, formiraju se iz sasvim drugog supstrata. Dardanci se ne mogu identifikovati sa Ilirima”.

²⁴ “Slično Vlasima, ostaci romanizovanog stanovništva u planinama, koje se ovamo, kao stočari, povuklo u vreme seobe naroda i slovenskog naseljavanja, Albanci su nastali iz ostataka neromanizovanog paleobalkanskog stanovništva tih područja, medju kojima je bilo sigurno i ostataka Ilira i Dardanaca. Tokom vremena, naročito u okviru stočarskih kretanja, došlo je do integrisanja tih primarno raznorodnih elemenata koji sada u istoriju ulaze kao nov narod tek u XI-XII veku kada se prvi put, kako izgleda, već formirani pominju u vizantijskim i južnoslovenskim izvorima. Jasno je da se ovim elemen-

Si zgjidhje për etnogjenezën e shqiptarëve ai shihte dy komponente:

1. Rolin më të madh e kanë luajtur

*“mbetjet e elementeve të ndryshme nga substrati i vjetër paleobalkanik: ilirë, dakomezë (dardanë) dhe trakas”;*²⁵

2. Këto elemente marrin pjesë në formimin e shqiptarëve në kohën kur për to nuk mund të flitet si për formacione etnike, popuj, që u zhdukën bashkë me Perandorinë, Garašanin 1988: 366.

Mendoj se këtu ka një ndikim periudha politike e kohës sonë. Libri në fjalë ishte krijuar pas vitit 1981 kur teoria për prejardhjen ilire të shqipes kritikohej me të madhe për arsye politike dhe bile edhe në parathënie thuhej qartë se libri po bëhej kundër ‘*pretendimeve shqiptare*’ që edhe ilirët edhe dardanët paskan qenë ilirë dhe shqiptarët janë pasardhës të tyre. D.m.th. arsyetimi, i thjeshtësuar, natyrisht, mund të ishte diçka si ky: shqiptarët paskan menduar se nëse themi që edhe ilirët edhe dardanët janë paraardhës të shqiptarëve, Dardania është vendi i shqiptarëve si ilire; kjo mund të përkthehej në rast supozimesh të atilla që arsyetoheshkan pretendimet territoriale të shqiptarëve për Kosovën, Dardaninë. Natyrisht, hamendësime të atilla as si thjeshtësime nuk mund të qëndrojnë as në relacionet politike, as në relacionet shkencore, prandaj edhe nuk bëhen krejt eksplicite. Megjithatë qoftë shqipja pasardhëse e ilirishtes qoftë e dardanishtes, apo e mbetjeve të mjegullta, siç do të donin autorët e përmendur në (zh)vlerësimet e tyre, ajo është e kësaj hapësire. V. Popović bile shkonte edhe më larg me cilësimet e tij:

“këta pasardhës të turbullt të popullatës së lashtë ballkanike”, “me shpatën e gjysmëhënës erdhën të pushtojnë vendin”.

Ajo që bie në sy si theksim është sikur mëtohej të veçoheshin dardanët nga ilirët e tjerë, e para, dhe e dyta dhe më e rëndësishmja, se shqiptarët mund të jenë dhe janë pasardhës të popullatave lashtobalkanike

tima kasnije pridružuju i druge komponente, osobito slovenska, čiji značaj u današnjoj Albaniji potvrđuju toponimije.”.

²⁵ “Zaostaci raznih elemenata iz starog paleobalkanskog supstrata: ilirskih, dakomezijskih (dardanskih) i tračkih”.

(kjo nuk duket e mohueshme arsyeshëm), por jo të ilirëve drejtpërdrejt, jo të trakasve drejtpërdrejt, por të mbetjeve nga ato popullata lashtoballkanike që nuk u romanizuan dhe që në mesjetën e vonë disi nga shek. IX u shkrinë ndër vete dhe krijuan atë që në shek. XI doli në histori si popull shqiptar. Natyrisht kjo nuk qëndron as historikisht dhe historianët e kanë kritikuar. Dhe bashkë me të shkon edhe teza tjetër që është pak më e hershme. Seliščev, studiues rus i kohës së jehonave të pansllavizmit, që botoi një libër me vlerë për huazimet sllave në gjuhën shqipe, theksonte se kur sllavët erdhën në Ballkan nuk gjetën shqiptarë, shqiptarët nuk ishin bile as në Shqipëri, nuk ishin fare aty, por gjetën vetëm romanë, dhe pastaj ata romanë u sllavizuan. Këtë tezë e ka rimarrë Ivan Popović në *Geschichte der serbokroatischen Sprache* në vitin 1960 dhe në studimet e tjera dhe ka theksuar edhe më shumë:

“shqiptarët kanë ardhur në Shqipëri pas sllavëve, bile pas shek. IX”.

Në anën tjetër kjo shkon krahas me teorinë tjetër që ka lindur në fillim të shekullit për prejardhjen trakase të shqipes, sepse argumentimi është ky: shqipja është gjuhë *satəm*, ilirishtja mendohej *centum*. Ka pasur për ilirishten, sa e njohim, edhe argumente që donin ta tregonin *satəm*, dhe të atilla që e shfaqnin *centum*. Kemi emrin *Bersiminium –Podgorica* e sotme, që, mbase, është quajtur kështu, pra kemi pasur palatale që është bërë z (mbi bazën **bherǵ-*). Kemi *Vesclaves*, ku në fqinjësi të sonanteve palatalja është ruajtur si velare, nuk është bërë *th*, pra nuk është bërë sepse është ndodhur në fqinjësi të sonanteve. Ka edhe të tjera që mund të thonë të kundërtën.

Trakishtja ishte gjuhë *satəm* thonë, prandaj shqipja është pasardhëse e trakishtes. Teoria e trakasve pastaj ka pasur histori. G. Weigand-i erdhi me historinë për mungesën e toponimeve. Toponimet në trollin shqiptar kanë pasqyrë vetëm sllave ose romane nga lashtësia, jo shqipe, thoshte ai; më tej theksonte që shqiptarët nuk kanë terminologji detare në gjuhën e tyre, e shumë elemente të tjera. Diskutimet kanë qenë të shumta. Çabej i kishte marrë në detaje në vitet '70. Edhe ne kishim diskutuar (Ismajli 1987). Tash vonë ka pasur një shqyrtim të gjerë nga Sh. De-

miraj (Demiraj 1999). Por po të nisim ashtu, çdo gjë bëhet absurde. Merrni trupin tonë: *flokë, faqe, fytyrë, shpindë, llërë, kofshë*, të gjitha janë fjalë latine, *qiell, gjel, qen, peshk*, etj. po ashtu. A do të thotë kjo që shqiptarët s'kanë qenë as në fusha as në male, se s'kanë njohur pjesë të trupit e çka jo tjetër? Anglezët fjalët për ushqimet prej mishi i kanë frënge. Fjalët për kafshët për mishin përkatës i kanë të vetat sepse shtresa e pasur ushqehet si në Paris, atëherë Parisi ishte model, dhe i merrte prej France emërtimet, kurse fshatari britanik i kishte fjalët e vjetra për kafshët prej nga merrej mishi, i ruante. Njësoj kanë ndodhur proceset edhe në shqipen. Prandaj prej kësaj nuk mund të nxjerrim asnjë argument sado që Çabej e L. Dodbiba kanë bërë përpjekje të tregojnë se në shqipen edhe terminologjia detare ekziston. Për terminologjinë detare është thënë po ashtu se shqiptarët kanë edhe terminologji të tillë, p.sh. fjala *det* është fjalë e vjetër IE në shqipen. E dyta. Janë të njohur emrat e vendeve: *Scodra* nga shek. IV para K., *Scupi* nga shek. II, *Scampinus* pak më vonë, *Scardus mons*, *Isamnus*, *Matis* – lumi Mat etj. Është thënë se *Scodra* nuk do të jepte Shkodër në zhvillimet e pandërmjetme shqipe, sepse qysh Jokl-i thoshte se grupi *-dr-* në zhvillimet e shqipes do të birrej. Por mund të ketë fjalë të tjera që e kanë grupin *-dr-*. Çabej është përgjigjur se kjo gjendje reflekton periudhën e huazimeve romane. Kurse *shkamb* e të tjera fjalë me *sc [sk]* nga latinishtja edhe *Scodra* edhe *Scupi* kanë dhënë të njëjtën gjë. *Scupi* (shumës) u bë *Shkup* në gjuhën shqipe. Këtu kemi një problem me *Sharrin - Scardus mons*, nuk e kemi zhvillimin si do të duhej në një fazë më të hershme, nuk e kemi **Shkarr*, d.m.th. ka mbetur *Sharr* (mbase për arsye ekspresiviteti sot me *-rr*). Shpjegimin nuk e kemi. Por Argumentimi shkon në tjetër anë. Sikur të ishte nga sllavishtja do të bëhej **Skrad* sikurse te *Sacrdona - Skradin*. Pra, sllavët e kanë marrë nga të tjerët. Dhe nga kush tjetër pos nga shqiptarët që ishin atje. Të tjerë s'kishte. Emri *Mat*, *Matis* është një emër që vjen nga lashtësia, që është trashëguar e domethënë *breg, buzë lumi*. Te Kaçaniku na del një *Matlumë* – '*Breglumi*', që duhet të jetë e vjetër sepse në këtë hapësirë s'ekziston as *mat* as *lumë* si apelativ, por vetëm te ky toponim. Pra, është një fjalë e vjetër. Kjo shtresë, sipas Çabejtë, paraqet zhvillimin fonetik të shqipes nga periudha e

lashtë e tej. Nuk mund të flitet për periudha më të hershme. Dhe kjo tregon se shqipja është folur gjithë kohën, ashtu siç thoshte Jokl-i, në këtë hapësirë.

Përkrahësit e teorisë trakase dhe sidomos me modifikimet e V. Georgiev-it, ngritën një teori tjetër. Duke u mbështetur te Weigand-i dhe duke e rimarrë teorinë e tij, duke thënë a priori që shqiptarët nuk janë pasardhës të ilirëve sepse nuk janë vendës, sepse emrat e këtyre vendeve, siç thoshte Weigand-i, nuk tregokan vazhdimësinë, shqiptarët nuk kanë terminologji detare të trashëguar, etj., duhet të jenë trakas, të ardhur nga hapësirat trakase, madje në veri të Danubit, sepse andej paska një emër lumi që nuk e manifestoka zhvillimin e mutacionit konsonantik, karakteristik për trakishten; atje, në veri të Danubit, pra, dakasit paskan folur një varietet pak të ndryshëm nga trakasit, dhe prej tyre rridhkan shqiptarët. Të gjitha janë të mundshme, por me një emër të vetëm lumi për dëshmimin e një dukurie fonetike me kaq peshë dhe me gjithato supozime askund të mbështetura nuk dëshmohet gjë.

Qysh nga fundi i sh. 19, fillimi i sh. 20 lindi hipoteza për prejardhjen e shqipes nga trakishtja *satam*. Kjo hipotezë sa vinte e theksohej, sidomos nga ballkanologu gjerman G. Weigand, i cili kundërshtoi një numër argumentesh që mendohej se flisnin në favor të prejardhjes ilire të shqipes, duke theksuar sidomos mungesën e terminologjisë detare vendëse në shqipen, mendimin e tij se emrat e vendeve nga lashtësia në gjendjen e sotme nuk kanë arritur përmes shqipes, elementet e përbashkëta leksikore që ka shqipja me rumanishten, etj. Prandaj, sipas tij, shqipja nuk mund të ishte pasardhëse e ilirishtes, po do lidhur me trakishten (Weigand 1927).

Ndërkaq materialet e interpretuara onomastike dhe të glosave në interpretimet e gjuhëtarit bullgar I. Duridanov kanë lënë të kuptohet më shumë se trakishtja dhe dakishtja duhej të kishin pasur afri me gjuhët e lashta baltosllave, ku mund të ketë diçka. Dhe lidhur me shqipen.

Afërsisht këto kanë qenë dijet që konsideroheshin të njohura deri në vitet '80 të sh. XX e ndoshta deri sot. Botimet serioze në këtë fushë kanë qenë ato të emrave që përmendëm: Çabej, Cimohovski, Desnickaja, Hamp, e albanologë të tjerë për shqipen. Paraqitja e bërë atëherë nuk ka ndryshuar shumë ndërkohë, siç mund të shihet në librin e botuar nga Sh. Demiraj tash vonë (Demiraj 1999), ku kemi një paraqitje të gjerë e me shumë diskutime. Për ilirishten, trakishten e kompleksin lashtoballkanik ka pasur botime të ndryshme. Përveç atyre të Krahe-s, të Mayer-it, të Dechev-it, duan përmendur studimet përmbledhëse të Katičić-it (1976), të Нерознак-ut (1978), studimet e Çabejtë, të Georgiev-it, të Cimoehowski-t, të Duridanov-it, të Poghircut, të Vraciu-it, të Hamp-it, të Brixhe-Panayotu-it, e të tjerëve.

Dija në vijim ndoqi rrugë të ndryshme. Studimet iliristike, për mungesë materialesh, kanë qenë më të pakta. Në studimet trakologjike është investuar shumë energji në Rumani e në Bullgari. Raportet e kompleksit trako-dakas me gjuhët balto-sllave kanë qenë një fushë e hulumtimit. Aspekti tjetër ka qenë ai i hulumtimit të raporteve midis elementit autohton të rumanishtes dhe trako-dakishtes, e të gjitha këto të para në raport me shqipen. Pista tjetër e hulumtimeve ka qenë ajo e studimit të elementeve të përbashkëta të shqipes me rumanishten. Lidhur me këtë, disa studiues kanë ngulur këmbë në hetimin e leksikut baritor të përbashkët për këto dy gjuhë, duke e lidhur atë me hapësirën karpato-ballkanike.

Në këtë pikë janë shquar botimet e shpërndara nëpër revista të ndryshme të Eric P. Hamp. Pikëpamjet e tij kanë ndryshuar gjatë këtyre 40 vjetëve të fundit. Në vitet '50-'60 ai kishte bërë shkrime me interes për interpretimin eventual të elementeve të identifikuar në mbishkrimet mesape përmes shqipes. Më vonë ai sikur nuk shihte qartë se çka fshihet prapa emërtimit *ilir* dhe *ilirishte*. Studimet lidhur me trakishten tek ai sikur tregojnë se shqipja nuk mund të lidhej me atë gjuhë. Studimet e tij përvijohen në disa pista. Në një anë ai merret me vendosjen e shqipes në kuadër të gjuhëve indoeuropiane. Në shumë studime ka theksuar se shqipja është e tipit satëm dhe ka ngulur këmbë në raportet e saj të hershme me

gjuhët indoeuropiane veriore – baltosllave e gjermanike. Kjo do të thotë se protoshqipja do të jetë folur dikur në hapësirat e Europës veriore-qendrore, ku do të ketë qenë e mundshme afria. Mendim të ngjashëm kanë pasur shumë albanistë.

Për Hamp-in në vijim shtrohet çështja e statusit të elementeve të përbashkëta të shqipes me rumanishten. Ato fjalë ai i konsideronte jo huazime, po fjalë mbetje. Kjo kërkon një shpjegim që do ta vendoste para-shqipen dhe para-rumanishten (dakishten, mezishten?) në një hapësirë të përbashkët. Këtu tani ndërthuret hipoteza për elementin karpato-ballkanik.

Pista e tretë e studimit të këtyre aspekteve të E. Hamp-i ka të bëjë me interpretimin e glosave apo të emrave të vendeve/ njerëzve të lashtësisë përmes shqipes.

Pista më e rëndësishme e studimeve të Hamp-it lidhur me këto çështje ka të bëjë me raportet midis dialekteve indoeuropiane në lashtësi dhe të gjuhëve para-shqipe, para-sllave, para-baltike, etj. me to. Në botimet e tij të vona Hamp-i ka sugjeruar se në një kohë relativisht të lashtë një grup dialektesh para-indoeuropiane është folur në një hapësirë të Europës Veriore; aty janë ndodhur pranë e pranë para-gjuhë të ndryshme në raporte unioni gjuhësor dhe jo afrie, sado që të gjitha kanë qenë indoeuropiane, por të degëzimeve të ndryshme. Aty ai ka përfshirë para-albanishten, para-balto-sllavishten, po edhe atë që quhet dakishte. Pak më herët Hamp-i, duke folur për hipotezën për raportet e shqipes me elementin leksikor ‘karpato-ballkanik’ e me rumanishten, kishte supozuar se ato i sugjeronin relievimin e një zone të hershme dialektore indoeuropiane që mund të quhet ‘protoalbanoid’ dhe shtrihej nga hapësirat ku flitet ukrainishtja perëndimore, polonishtja jugore, sllovakishtja, pjesërisht çekishtja, rumanishtja bashkë me dialektet jugdanubiane e arumune deri në Greqinë veriore, dialektet e bullgarishtes perëndimore dhe të maqedonishtes e të Banatit, të serbishtes dhe të shqipes. Sipas tij, e tërë kjo zonë do të ketë formuar një fashë nga Karpatet deri në Shqipërinë e Veriut. Një gjendje e tillë, sipas tij, mund të ketë ekzistuar afërsisht rreth 3 mijë vjet

më herët. Tash vonë, ai këto qëndrime i ka interpretuar më tej, duke theksuar se tash edhe më shumë beson në afrinë e para-shqipes me mesapishten. Natyrisht, idetë e Hamp-it janë të shpërndara nëpër artikuj të ndryshëm të specializuar, studime etimologjike nëpër revista nga më të ndryshmet, dhe kjo paraqet një vështirësi për lexuesit, sepse nuk gjinden lehtë. Dhe ato nuk janë të njëjta në kohë të ndryshme, sepse shfaqen si diskutime, jo si rezultate përfundimtare (shih Ismajli 1997).

Veçimi i grupit të gjuhëve indoeuropiane verieuropiane nga ana e Hamp-it në vitet '90 sikur qe një shtysë për vështrime të tjera. Do të përmend me këtë rast studimet e lintuanistit Harvey Mayer, i cili në një sërë artikujsh në revistën '*Lituanus*' ka kërkuar të shpjegojë raportet e mundshme midis shqipes, gjuhëve baltike dhe gjuhëve sllave. Interpretimet e tij mbështeten në dy baza: në një anë i elaboron raportet midis trakishtes-dakishtes e gjuhëve baltike e sllave, duke u mbështetur te Duridanov-i, ndërsa në anën tjetër i hulumton raportet e mundshme strukturore midis para-shqipes dhe para-sllavishtes e para-baltishtes (studimet e tij përqendrohen në reflekset e mundshme të segmentit bashkëtingëllor IE *sk-*, *ks-*, të sonanteve, etj. në shqipen, në një anë, dhe në baltishten e sllavishten në anën tjetër). H. Mayer-i supozon dhe argumenton se trakishtja do të ketë qenë më e afërt me baltishten, duke e quajtur këtë grup hipotetik "baltoid", ndërsa para-shqipja (në këtë rast ilirishtja e mesapishtja) më e afërt me sllavishten, duke e quajtur atë grup hipotetik "albanoid". Në këto interpretime ka shumëçka të pasaktësuar dhe lartësisht të supozuar, por është me interes diskutimi i raporteve të hershme të shqipes me baltishten e me sllavishten.

Në këtë grup çështjesh Desnickaja i fuste dhe raportet me gjermanikishten, ndërsa në një studim të vonë për elementin latin të shqipes ajo vijonte ta mbështeste tezën për prejardhjen ilire të shqipes, por duke vendosur një raport të ri midis elementit të romanizuar në shkallë të ndryshme dhe atij relativisht të paromanizuar të ilirëve dhe duke supozuar se shqipja lindi si rezultat i një shkrirjeje të re të këtyre shtresave ilire nga fillimi i epokës së vjetër.

Botimet standarde të indoeuropeanistikës sa i përket vendit të shqipes në kuadër të gjuhëve indoeuropiane i mbahen zakonisht rrugës së rrahur më herët, ndërsa në atë kuadër, megjithë kujdesin e dukshëm, më shpesh përparësi i japin lidhjes së shqipes me ilirishten. Pak më tej në këtë drejtim ka shkuar B. Sergent në botimin e tij për indoeuropeanët, duke e interpretuar më tej grupimin e përmendur të Hamp-it. Sergent-i e interpretonte pikëpamjen e Hamp-it për familjen gjuhësore ballkano-baltike, ku sllavishtja është e afërt me gjuhët baltike, shqipja i përket të njëjtit grup, duke u larguar prej tyre. Kemi një bosht veri-jug, nga Baltiku në Adriatik; mund të jetë që këtij grupi në lashtësi, pas tij, i bashkohej grupi trakas, midis grekëve e sllavëve. Interpretimet e mëtejme duken jokonkluzive, por me interes del këmbëngulja për të parë një grupim eventual tjetër nga ata që janë hetuar më herët në kuadër të gjuhëve indoeuropiane (Sergent 1995).

Në vazhden e botimeve që parashtrojnë hipotezën trakase për prejardhjen e shqipes hyn dhe vepra e G. Schramm-i për krishterimin e hershëm të shqiptarëve. Hipoteza e tij thotë se shqipja është pasardhëse e gjuhës së besëve (fis trakas që jetonte rreth hapësirave Nish-Sofje). Në argumentimet e këtij varianti të ri të hipotezës trakase albanistët nuk kanë gjetur shumëçka pozitive, sepse ka shumë hipoteza. Nuk ka asgjë konkrete nga gjuha e besëve.

Në përgjithësi në periodikun e specializuar ka pasur botime për këtë çështje të parë nga aspekti indoeuropian dhe nga aspekti brendaballkanik në raport me gjuhët e lashta. Ka tendenca që edhe raportet e gjuhëve indoeuropiane në thellësi kohe 3 e më shumë mileniumeve më parë të shihen ndryshe sot. Por në të njëjtën kohë ka dhe përpjekje për t'i vendosur raportet e shqipes ndaj gjuhëve të lashta indoeuropiane duke bërë rindërtime strukturore dhe etimologji të reja. Janë botuar në këtë kohë dy fjalorë etimologjikë (nga B. Demiraj 1997, e V. Orel, 1998), studime etimologjike (M. Huld, 1984), janë propozuar interpretime të gramatikës historike (pas Bokshit e Sh. Demirajt, tani dhe Orel, Topalli, Ibanes, më herët

Mann), janë botuar studime për fonetikën historike (ndër to vepra e gjerë e K. Topallit), etj.

Në albanistikë mbisundon mendimi se shqipja është gjuhë indoeuropiane e tipit satəm, grup më vete, me prejardhje në lashtësi nga ilirishtja (apo kompleksi iliro-mesap), me afri në rrafshin indoeuropian me gjuhët veriore balto-sllave e gjermanike, me lidhje kohësisht mbase më të vona me greqishten në jug; mendohet po ashtu se shqipja është folur në Ballkanin e lashtë afërsisht aty ku flitet sot e ndoshta pak më gjerë, në kontakt intensiv me latinishten, po edhe me greqishten e vjetër. Vështrimi kompleks i këtyre elementeve, i formave të emrave të vendeve që në gjendjen e sotme kanë arritur përmes transformimeve fonetike brenda shqipes, i elementeve të kulturës materiale, ndërlidhja e emrit *albanoi* dhe *Albanopolis* me *arbër/ albër* (arbanët/ albanët) e mëvonë, e elemente të tjera e bëjnë për shumëkënd të besueshme këtë hipotezë. Po ashtu deri tash ka mbisunduar hipoteza për lidhjet e lashta indoeuropiane të shqipes me gjuhët veriore balto-sllave dhe gjermanike, hipotezë që të detyron ta kërkojë lëvizjen e proto-shqipes, ashtu si të proto-greqishtes, nga veriu evropian drejt jugut diku në mijëvjeçarin e dytë para Krishtit. Mirëpo, në indoeuropeistikë, sidomos në studimet që mbështeten më parë në arkeologji, ka dhe mendime të tjera për djepin e hershëm indoeuropian.

Ka pasur dhe botime që synojnë shpjegimin e prejardhjes së shqipes në rrugë të tjera, si p.sh. përmes pellazgjishtes, por njohjet nga kjo gjuhë janë krejtësisht të pakta. Ka pasur të tjerë që në Ballkan kanë parë dhe gjuhë të tjera në lashtësi, si dardanishtja, peonishtja etj., por as këtu nuk ka pasur dëshmi materiale që do t'i veçonin ato.

Me më pak mbështetje konkrete dalin supozimet e K. T. Witzak (1994: 21-26; Witzak 1995: 309-312). Ai nisët nga argumentet mohuese. Thotë se besët numërohen si të mbetur gjallë edhe pas ardhjes së sllavëve. Shqipja nuk është pasardhëse e ilirishtes, sepse ajo është satəm, ndërsa ilirishtja centum. Pra as e makedonishtes e frigishtes. Dakasit ishin gjeografikisht në tjetër hapësirë; ndërsa romakët i

vranë. Vetëm trakasit mbeten, pas tij, si mundësi: tribalët rreth Danubit apo besët në Rodope. Për gjuhën s'ka asgjë.

Një fushë pak më konkrete e diskutimeve në rrafshin e lashtësisë ka qenë ajo e hulumtimeve të raporteve midis shqipes, gjuhëve baltike dhe sllavishtes. Do të përmend këtu fillimisht disa shqyrtime. L. Bednarczuk (1986: 77-83); A. Breidaks (*Linguistique balkanique*, 33 (1-2), 43-53); A. V. Desnickaja (1984); K. Liukkonen (*Scando-slavica*, 35, 197-202); V. Orel (1993); V. Orel (1998); V. N. Toporov (*Acta Balto-slavica* 17, 275-293), etj.

Edhe pse kishte vënë në pah disa momente me vlerë në diskutimet më të hershme për raportet midis shqipes e ilirishtes, sidomos sa i përket kontekstit të refleksëve të palataleve IE në fqinjësi me sonantet, apo edhe afri të tjera leksikore, me kohë Hamp-i nuk iu kishte kthyer më raportit të shqipes me ilirishten. Ka gjasë që, në vijim të diskutimeve të E. Polomé-ut e të tjerëve, në këtë drejtim ai të ketë shkuar në rrugën e atyre që realitetet e ilirishtes i shohin tepër të reduktuara për të folur për këtë gjuhë, apo ndoshta mendojnë se emërtimi 'ilirishte' thjesht nuk thotë gjë në aspektin gjuhësor. Lidhjet e shqipes me rumanishten dhe nevoja e shpjegimit të përbashkësive midis këtyre dy gjuhëve, ashtu si dhe supozimi se djepi i hershëm i gjuhëve IE do të ketë qenë Europa Verilindore, prandaj indo-europianët që u bënë protoalbanë, si duket, e kanë shtyrë atë më tej drejt vështrimit për fazën në të cilën paraardhësit e atyre protoalbanëve do të kenë kaluar nëpër vise më të gjera ndërmjet Europës Verilindore dhe Jugut të saj Ballkanik. Studimet e V. Georgiev-it për trakishten e dakishten dhe diferencimin e tyre, sidomos studimet e mëvona të I. Duridanov-it për trakishten-dakishten dhe lidhjet e tyre me gjuhët balto-sllave i kanë shërbyer Hamp-it më se një herë si rast për të shprehur mendime në këtë drejtim.

Grupimin "*Europa Veriore*" Hamp-i e cilësonte hapur si areal, Sprachbund, i cili mund të jetë mbase 4 mijëvjeçarë i largët prej nesh, por që mund të hetohet si një substrat përmes tipareve që kanë dalë nga kontakti shoqëror me të. Tipare të tilla karakterizojnë degë gju-

hësh IE si gjermanikishtja, balto-sllavishtja, shqipja, prahelenishtja (pellazgjishtja), më pak keltishtja, marginalisht italikishtja. Këtë territor ai e vendoste në veri të Alpeve (f. 329).

Duke folur për trakishten dhe paqartësitë që e shoqërojnë historikun e studimit të saj për shkak të mungesave të materialit, Hampi shënonte:

“studiuesit thjesht akceptonin emrat dhe termat për etnicitetet nga antikët dhe i zbatonin pastaj në tufën e të dhënave areale apo gjenetike duke lidhur argumentet e tyre apo linjat e prejardhjes me popullatat tashmë të supozuara nga nomenklatura. Kështu, pa korrespondencë të qartë justifikuese linguistike ndeshim terma si trako-frigjishtje, ilirishtje, trako-ilirishtje, trako-dakishtje, dako-getishtje, geto-dakishtje, trako-getishtje dhe shoqërime si trakishtje + shqipe, +ilirishtje, +frigjishtje dhe frigjishtje + armenishtje”, 330.

E vlerësonte lidhjen nga Georgiev-it të dako-mezishtes me shqipen, por theksonte se dakishtja e trakishtja ishin gjuhë të ndryshme. Këtu ai jepte diçka më konkrete nga argumentimet për prejardhjen e shqipes. Vendosja gjeografike e dako-mezishtes mund të pajtohej me praninë e shqipes para ardhjes së sllavëve të jugut, por edhe nëse merremi me segmentin e elementit autokton të rumanishtes të cilin ne e gjejmë në shqipen e periudhës së hershme.

“Në bazë të pranisë së huazimeve latine në shqipen, por të mungesës relative të huazimeve greke, rezidenca e shqiptarëve në veri të linjës Jireček (në veri-perëndim të linjës Shkumbi – Scupi – Naissos dhe Sofia deri te malet Ballkan, me çka pajtohet demarkacioni midis mbishkrimeve me gjuhë latine dhe greke, pajtohet me pretendimin për dako-mezishten (mezishten)” (331-2).

Më herët ai kishte treguar se trakishtja dhe proto-shqipja dalloheshin në shkallën që, psh., në shqipen *gwhermo- tashmë ishte në rrugë për zjarr, si dak. *zermi*, ndërsa trakishtja e kishte *Germas*, pa palatalizim. Aty shtonte po ashtu faktin se dakishtja dhe shqipja paskan më shumë lidhje pozitive me baltishten se trakishtja. Do të themi menjëherë se në kohën kur në dakishten kishim *Zermi* është gati e

pamundur që në shqipen të kemi frikative z-, po më parë diçka si dj, kështu që as argumentet e tillë nuk na duket se qëndrojnë. Për mendimin tim, argumenti i elementit të përbashkët të shqipes me rumanishten nuk mund ta marrë peshën që të heshtë të gjithë të tjerët, sepse, pos tjerash, ai mund të shpjegohet dhe ndryshe.

Agnja V. Desnickaja njihet dhe për studimet e saj të shqipes në raport me gjuhët e tjera IE të hershme dhe më të vona të kontaktit (shih më sipër). Si dhe në raste të tjera ajo aty vlerëson rezultatet e studimeve që kishin theksuar karakterin satëm IE të shqipes me lidhjet me gjuhët e Europës veriore dhe prejardhjen e shqipes nga ilirishtja paleoballkanike në vijën Meyer-Pedersen-Jokl-Çabej-Cimochowski-Katičić, etj. Gjithë duke i vënë në pah raportet e shqipes me ilirishten, madje duke pasë bërë dhe një kritikë me interes për hipotezën e Georgiev-it lidhur me prejardhjen trakase të shqipes, Desnickaja kërkonte të dinte më shumë për raportet e shqipes me gjuhët e tjera IE dhe për vendin e saj më të hershëm. Për këtë arsye ajo qysh më 1965 kishte shqyrtuar një numër përkimesh leksikore dhe strukturore midis shqipes dhe gjuhëve gjermanike, duke përfunduar:

“lidhjet e lashta areale të shqipes me gjuhët e zonës gjuhësore veri-europiane dalin lidhje areale që rindërtohen përmes ilirishtes. Në pajtim me konceptin e zhvilluar me kohë nga Krahe, gjuha ilire parahistorike (deri te migrimi i pjesëve të fiseve ilire në Ballkan) ka pasur kontakte më të afërta me gjermanikishten, sllavishten dhe në mënyrë të veçantë me baltishten. Ky është rrethi i kontakteve parahistorike të vendosura për proto-shqipen.” (239).

Duke vazhduar këtë interesim, Desnickaja i bëri objekt studimesh të veçanta raportet e shqipes me baltishten. Duke i njohur dhe studimet e Duridanov-it për raportet dako- dhe trako-baltike, ajo ngulte këmbë në hulumtimin e raporteve iliro-baltike dhe shqipe-baltike. Lidhjet e indikuara nga ajo me gjermanikishten, qoftë për ilirishten, qoftë për shqipen, marrin një kuptim të veçantë: të tilla lidhje në studimet trako-dake nuk janë vënë re dhe kjo flet vetvetiu dhe për prejardhjen e shqipes në raport me gjuhët paleoballkanike. Nevojën e

hulumtimit të lidhjeve të gjuhëve paleoballkanike me gjuhët baltike e arsyetojnë jo vetëm kontaktet parahistorike të këtyre popujve me para-baltikët po edhe fakti se

“vetë gjuhët paleoballkanike dalin nga një areal i përbashkësisë së vonë indoeuropiane dhe se, meqë të bartura në Siujdhesën Ballkanike për pasojë shpërnguljesh të fiseve trak-dakase dhe ilire, ato, me siguri, duhet të ruajnë një shkallë të rëndësishme afrie”, 195.

Në këtë kuptim ajo sheh mundësi studimi në fushën e leksikut, po sidomos në fushën e fonetikës, po edhe të segmenteve të tjera strukturore. Të dhënat e rendit të brendshëm historik dhe ato pak të dhëna gjuhësore (mesape e ilire) flasin për faktin se paraardhësit e shqiptarëve në periudhën antike kanë jetuar në pjesën perëndimore të Ballkanit, prandaj shqipja është pasardhëse e ilirishtes. f. 196.

Posaçërsiht me peshë i dalin rindërtimet e formanteve fjalëformuese, këto pastaj mund të krahasohen me përkatëset baltike.

Në vlerësimin e E. P. Hamp-it te *Albanian* (Trends...) thuhet:

“Janë shprehur gjithashtu pikëpamje të ndryshme lidhur me afritë brenda indo-europianishtes. Bartoli (1932) mendonte se shqipja përkonte me baltishten më tepër në tipare konservative, por me greqishten dhe gjuhët e jugut në risime. Më herët Pedersen-i (1900) kishte vërejtur afri me armenishten. Edhe pse Jokl-i pajtohej me një relacion më të afërt me baltishten, ai studioi po ashtu lidhje të mundshme me keltishten (1927)...” (Hamp, *Albanian*; Hamp 2007;²⁶ Fiedler 2006: ftn 41, 42).

Fiedler-i (2006) e shihte të udhës të shtonte dy shënime lidhur me këtë vrojtim të Hamp-it. Për vrojtimin e parë ai sillte ndër mend se lidhur me armenishten duheshin parë dhe mendimet e armenistëve armenas,

²⁶ “Various views have also been expressed with respect to pairings within Indo-European. Bartoli (1932) thought that Albanian agreed with Baltic more in features of conservatism but with Greek and the southern languages in innovations. Earlier Pedersen has seen a kinship between Albanian and Armenian (1900a). Though Jokl subscribed to a closer relation to Baltic, he also explored possible connections with Keltic (1927)...”.

në radhë të parë të Džaukjan-it e të tjerë.²⁷ Në fusnotën 42 ai sillte mendime pak më specifike të baltistëve baltë. Konkretisht referonte Z. Zenkevičius-in: *Lietuvių kalbos istorija. I. Lietuvių kalbos kilmė*, f. 112:

“... përbashkësi të atilla që do të tregonin për kontakte të ngushta në të kaluarën në të vërtetë nuk ka. Më së largti gjuha shqipe mund të rrjedhë nga një dialekt i paragjuhës indoeuropiane që nuk ishte larg nga hapësira dialektore nga e cila dalin baltët” (nga përkthimi gjermanisht i Fiedler-it).

Do të vë në pah gjithashtu që në shqyrtimet e mëvona për këto çështje sikur ka një rikthim tek ndonjë prej ideve të Stadtmüller-it e të tjerëve, qoftë përmes referimit të tyre si të tilla, qoftë dhe përmes kritikave të tezave të Çabejtë. Në shqyrtimet e tyre Gottfried Schramm (1981; 1998), Aleksandar Loma (1991) e të tjerë nisen nga diskutimi i pohimeve të Çabejtë lidhur me vazhdimësinë shqipe të toponimeve të hapësirës shqiptare, si: *Shkodër, Shkumbin, Shkup, Shar, Durrës*, etj. Rezultatet e tyre kanë pika të përbashkëta, por kanë edhe dallime. Për mjaft prej këtyre toponimeve ka pasur diskutime të shumta edhe më herët. Për to është shprehur mjaft ndryshe nga ta Sh. Demiraj (1999) në librin e tij.

Edhe pse mund të mos e kishte bërë eksplicite deri në fund e për çdo rast, Çabej kishte bërë një vërejtje paraprake lidhur me kontestimet e tilla të mundshme: në shqyrtimin e zhvillimit fonetik të këtyre emrave ka dhe çështje kronologjie. Sipas disa diskutuesve, *Scupi, Scodra, Scampinus* janë përshtatur sipas ndryshimit *sk: shk*, ndërsa te *Scardus* sipas *sk: sh*, ndërkohë që mendohet se *sk-* e hershme do të ketë dhënë *h*. Ashtu si te *Durrës* nga *Durrazzo* apo *Дьраць*, mendojnë ata, në rastet e sipërme nuk shihet shqipja, çka do të thoshte se shqiptarët s’kanë qenë në ato anë. Për G. Schramm-in kjo do të thotë se ata janë të ardhur atje nga brendia e Ballkanit, do të kenë lëvizur drejt hapësirave shqiptare veriore duke ikur si të krishterë nga bullgarët para-sllavë paganë. Emrat *Astibos* dhe *Naissus*

²⁷ Për këtë referonte: Г. Б. Джаукян, *Очерки по истории дописменного периода армянского языка*, Ереван 1967; Г. Б. Джаукян, *Сравнительная грамматика армянского языка*, Ереван 1982; Г. Б. Джаукян, Л. А. Сараджева, Ц. Р. Арутюнян, *Очерки по сравнительной лексикологии армянского языка*, Ереван 1983.

në gjendjen e sotme të tyre, siç kishte theksuar qysh brezi Barić-Weigand, *Shtip* dhe *Nish* kanë arritur vetëm përmes shqipes, e si të këtilla nuk kanë mbetur pa u shqyrtuar nga historianë të kohës sonë.²⁸

Bartësit e teorive për prejardhjen trakase të shqipes e shqiptarëve shpesh shfaqin vlerësime për ata që mbështesin teori të tjera, sidomos për prejardhjen ilire të shqipes e shqiptarëve, duke i cilësuar, kur janë shqiptarë, si nacionalistë, etj. Në fakt, të kenë qenë paraardhësit ilirë apo trakas është krejt njësoj, rëndësi ka e vërteta. Në Traki janë gjetur mbishkrime, p.sh. është një mbishkrim afër Plovdivit DADALEME dhe Georgiev e interpretonte kështu: “*dhe del më*” d.m.th. ai ose ajo që kishte vdekur e luste zotin në këtë mënyrë “*dhe mbamë*”. Por këtu gjuhësisht problemet nuk janë të vogla: si u bë *dhe* nga *da*, ka qenë ajo *ǵ* IE dhe prandaj u bë *dh*? Si u bë *më* nga **mem*? Në shqipen përemri duhet të ketë qenë *mēm* ose *mon* në atë kohë, shek. V para Krishtit, kurrsesi jo *më*. Çabej e ka pasë pranuar një kohë edhe pse e korigjonte pak, por ky interpretim nuk qëndron, gjuhësia s’i ka dhënë të drejtë.

Për mendimin tim, në këtë situatë kur nuk e njohim asnjë prej gjuhëve të lashta ballkanike, pos latinishtes e greqishtes, mund të zgjedhim: është një hipotezë që thotë se shqipja është pasardhëse e ilirishtes dhe ka këto argumente, është një tjetër që paravendon trakishten dhe ka argumentet përkatëse. Kur bëjmë krahasimin, shohim dhe mbishkrimet e trakishtes, vërejmë se argumentet për trakishten në aspektin gjuhësor nuk janë. Ka pasur kritika edhe për Gerorgiev-in, di Giovine, Ködderitzsch, Desnickaja, se rindërtimet nuk i ka pasur të mira. As ilirishten nuk mund ta rindërtojmë, s’e kemi. I kemi ato fjalë, glosa, një numër glosash, p.sh. *drēnis* lidhet me fjalën *dre-dreri*, pastaj *rinon*, *rinon* lidhet me shqipen *rê-rêja*, më herët ka qenë *ren*, pra mund të lidhet me **rin* në këtë kuptim; *lugeon lug-lugat*, *tsika-thikë*, *mal*, e ndonjë tjetër. Këto pak fjalë nuk na japin të drejtë që të nxjerrim përfundim për gjuhën, sepse fjalët mund të hua-

²⁸ Tani, shembulli i *Naissus*: *Nish* na shpie më në veri, por gjithnjë brenda hapësirës dardane, pra ende jo bese; nga ana tjetër, *Astibos*: *Shtip* na çon më tepër drejt peonëve, për gjuhën e të cilëve ka shumë hamendësime: ishte ilire, trakase, apo gjuhë më vete. Të gjitha këto, natyrisht, nuk flasin në të mirë të supozimit të përmendur.

zohen. Por kur i mbledhim argumentet e këtilla, latinizmat, greqizmat e të gjitha të tjerat, situatën historike-gjeografike, atëherë na del më e pranueshme hipoteza për prejardhjen ilire të shqipes. Prandaj në këtë gjendje do të themi vetëm këtë: nuk e dimë a mund të themi që është dëshmuar prejardhja ilire, sepse për ta dëshmuar duhet ta kishim ilirishten dhe atë nuk e kemi. Shkenca punon me hipoteza, me teori. Në albanistikën vendëse, Sh. Demiraj p.sh., në librat e fundit është marrë me problemet e onomastikës dhe ka pasqyruar gjerësisht mendimet edhe të Çabejtë edhe të tjerëve në mënyrë relativisht të plotë. Demiraj është pak më i prerë në këtë drejtim. Thotë *“shqipja është pasardhëse e ilirishtes”* në shkallën që ilirishtja është nëna e saj dhe në periodizimin e historisë së shqipes ai bën kështu: deri nga shek.. 4-5 është nëna, pastaj vjen shqipja e lashtë dhe me radhë. Një ide të ngjashme e ka thënë edhe Fiedler, duke pohuar se shqiptarët u formuan në shek 5-6. Nuk e dimë shumë argumentimin historik dhe sa qëndron kjo, por është referuar si ide e tij. Për mendimin tim, ne kur flasim në aspektin IE duhet të flasim me terminologji IE, duhet të flasim për shqipe, shqipe të lashtë, para-shqipe, proto-shqipe deri te IE. Ndoshta kjo do të ishte më e saktë sa kohë që nuk i dimë gjuhët e lashta të Ballkanit, nuk i kemi. Ndoshta një ditë do të gjinden mbishkrime, do të kemi më shumë argumente.

Hamp-i, Paliga, Brâncuș-i supozojnë që shqiptarët do të kenë qenë më në veri – d.m.th. të jenë formuar në veri të Shkumbinit, në Dardani, a diku tjetër, por pastaj toskët të kenë shkuar në jug. Kjo do të duhej, sipas tyre, të shpjegonte afritë e pretenduara më të mëdha midis toskërishtes e dakorumanishtes. Por kur? Në studimet dialektore të shqipes ne dimë se gegnishtja dhe toskërishtja u ndanë pak a shumë me rotacizmin dhe rotacizmi në bazë të hulumtimeve del se nuk është më i vjetër se shek. VI-VIII. Rotacizmi ka ndodhur vetëm në jug, pra në jug të Shkumbinit ata ishin para kësaj kohe. Në shek. XIII tashmë kemi në Greqi popullatë rotacizuese. Në qoftë se do të kenë qenë në veri, pse u nda ai dialekt? Dispozicioni dialektor i shqipes dhe historia e tij nuk i tumir këto hipoteza.

Për ta mbyllur dua të them edhe një gjë. Është menduar se emri *alban - arbën* lidhet me emrin e përmendur te Ptolomeu. Në shek II e.r. Ptolomeu kishte shënuar *Albanoi* dhe *Albanopolis*. *Albanopolis* ishte te Zgër-

dheshi afër Krujës, qyteti i albanëve, Albanoi ishte fisi i albanëve. Ka disa hipoteza për këtë, por kryesorja është kjo: albanët janë fisi që më vonë, në porocetin etnolitik, shkriren e fiseve të ndryshme, luajti rolin në krijimin e arbërve të mesjetës. *Shqiptarë* janë nga shek. XVII-XVIII, më herët kanë qenë *arbën* dhe *Arbënë* ka qenë emri i vendit. Edhe tek autorët e vjetër Buzuku, Budi etj., vetëm në një vend Buzuku ka *nd'Arbanit*. Në sllavishten pak para vitit 1200 është shënuar *Рабънь*. Tani, *Rabënë* është një formë që është me metatezë. Në gjuhët sllave në shek. IX ka ndodhur metateza, grupet *ar*, *al* u bënë *ra*, *la* dhe kjo mund të verifikohet saktësisht. Metateza ndodhi në fund të sh. VIII dhe në fillim të sh. IX. *Рабънь*, po të ishte marrë nga *Arbanum* ose *Arbanon*, në sllavishten do të kishim diçka si **rabon* dhe jo *Rabënë*. Ndryshe nga të tjerët, dua të vë në pah supozimin se kur erdhën në kontakt me popullatën vendëse emërtimin mund ta kenë marrë nga shqipja, që ishte *Arbënë*, dhe kjo formë të ketë dhënë *Rabënë* në sllavishten. Të themi po ashtu se lpushkvia e Krujës ishte formuar në shek. VII-VIII.

Duke iu kthyer çështjes së parme, përfundimi do të ishte afërsisht ky: pavarësisht se ka shumë diskutime, sepse ka vend për diskutime, ka shumë mundësi për argumentime të ndryshme, ne po përmbledhim duke iu rikthyer disi Çabejtë se shqipja është gjuhë IE, është e tipit satam, si e një areali disi qendror ka afritë e saj me gjuhët lindore dhe perëndimore, jugore dhe veriore në shumë aspekte të lashta, shfaq afri me greqishten e vjetër në risime, p.sh. krijimi i nyjës. Nyja në shqipen së pari u krijua si e përparme. Edhe në greqishten u krijua si e përparme nga dëftori. Dhe kjo është një areal që u krijua ndoshta rreth kohës së Krishtit (pak para saj), në atë periudhë në disa gjuhë europiane. Më vonë brenda shqipes ka ndryshuar vendosja, për pasojë të zhvillimeve në rrethanat e renditjes së fjalëve me fiksimin e vendit të theksit dhe rënien e mbaresave. Ne kemi këtu një autor të rëndësishëm, Bokshi me librin e tij *"Prapavendosja e nyjave në gjuhët e Ballkanit"*, që ka argumentuar se prapavendosja ka ndodhur më vonë dhe aglutinimi në shek. VI-VIII; ato do të kenë qenë kohë të kontakteve direkte midis romanëve që po bëheshin rumunë dhe shqiptarëve të hershëm, pra, kur pati mundësi që shqipja të ndikonte te rumunët, ku nuk kishte ndodhur ende aglutinimi, ndërsa rumunët te bullgarët pastaj. Pra, një proces më kompleks.

Teoria për prejardhjen trakase të shqipes mund të jetë një episod interesant për studimet e gjuhësisë, por mua më duket se nuk qëndron. Ndërkaq, hipotezë më e mundshme mbetet kjo për prejardhjen ilire, me mundësinë që e ka lënë të kuptohet Benveniste-i më herët në skicën e tij, ndërsa Hans Krahe më 1970 thoshte se shqipja mund të ishte gjuhë e veçantë, as ilirishte, as trakishte, por *albanishte* e veçantë. Në frymën e grupimeve IE diçka të ngjashme thoshte dhe Hamp derisa ngulte këmbë tek *Protoalbanoidi* i tij, të cilin pastaj konceptualisht e afronte me dako-mezishten në frymën e Georgiev-it, por rrënjësisht të ndryshme nga trakishtja. Kësaj i shtohet edhe koncepti i tij për NWEIE, por edhe për lidhjet e parashqipes me mesapishten. Në këtë frymë kishte argumentuar edhe Nerosznak. Koncepti për *Balkanindogermanisch*, i padiferencuar, që do të përfshinte greqishten, armenishten, trakishten frigjishten e protoshqipen, duket më pak i pranueshëm nëse lihet anash ilirishtja, dardanishtja, etj. Ndoshta sprova për të veçuar brenda *Balkanindogermanisch* një formim më lindor me greqishten, armenishten, trakishten e frigjishten dhe një tjetër më perëndimor me atë që Nerosznak e quante "*obščeilirijski*" - protoshqipen, ilirishten, mesapishten, mund të duket me interes në këto rrjedha idesh.

Në këtë fazë mendoj se është i drejtë qëndrimi që nisët - ashtu siç thoshte Pisani – nga vendi e që, kur s'ka argumente të tjera atëherë me këto argumente që kemi të themi se shqipja është pasardhëse e ilirishtes.

BALLKANISTIKA DHE PREJARDHJA E SHQIPES¹

Le të pyesim menjëherë: a merret ballkanistika me çështje si kjo në titullin tonë?

Ballkanisti i shquar sllavist Henrik Birnbaum, lidhur me librin e G. R. Solta-s,² dallonte dy zona të ndryshme të gjuhësisë ballkanike:

1. hulumtimi në substratin ballkanik,

"që janë gjuhët e shuara parahistorike dhe historike të hershme indo-europiane (që ruajnë dhe ndonjë dëshmi para-indoeuropiane), të cilat fliteshin dikur dhe janë dëshmuar në mënyrë fare fragmentare në Ballkan, me ç'rast të dhënat relevante janë kryesisht onomastike",³

2. rrafshi tjetër është ai i studimeve të gjuhëve të sotme ballkanike, në kuptimin tipologjik dhe jo në radhë të parë gjeografik, pra në kuptimin e referimit të gjuhët që përbëjnë *"Lidhjen gjuhësore ballkanike"*.

Prandaj, mendonte ai, kemi dy disiplina të ndryshme. E para

¹ Botuar së pari si *Ballkanistika dhe prejardhja e shqipes*, in *Studime* 3, 1996, Prishtinë, 1997, 255-274.

² G. R. Solta, *Einführung in die Balkanlinguistik mit besonderer Berücksichtigung des Substrats und des Balkanlateinischen*, Darmstadt, 1980. Henrik Birnbaum, *New approaches to Balkan linguistics*, in Deanović, Mirko (urednik): *Zbornik u čast Petru Skoku o stotoj obljetnici rođenja (1881-1956)*, Zagreb, JAZU, Zagreb, 1985, 79-87. I referohet tubimit "Ziele und Wege der Balkanlinguistik", Berlin 1981, materialet e të cilit botohen më 1992 nga N. Reiter. H. Birnbaum, *Untersuchungen zu den Zukunftsumschreibungen mit dem Infinitiv im Altkirchen-slavischen. Ein Beitrag zur historischen Verbal-syntax des Slavischen*, Stockholm, 1958.

³ "... that is, the extinct, prehistoric and early historical Indo-European Languages (retaining also some pre-Indo-European evidence) which were once spoken and are recorded", f. 79-80, Birnbaum, H. 1985: *New Approaches to Balkan Linguistics*, in Deanović, Mirko (urednik): *Zbornik u čast Petru Skoku*.

përbën një degë të gjuhësisë komparative indoeuropiane dhe është e orientuar gjenetikiisht, ndërsa e dyta përbën një nënfushë specifike në kuadër të gjuhësisë tipologjike

"me fenomene areale të akomodimit dhe të integritimit politik, kulturor dhe social si faktorë përcaktues jashtëgjuhësorë".⁴

Çështjet që lidhen me dakishten, trakishten, ilirishten e greqishten, me pellazgjishten, peonishten, dardanishten eventuale, janë me rëndësi për studimet indoeuropiane, por s'kanë peshë për kristalizimin e Sprachbundit (Lidhjes gjuhësore) ballkanik në mesjetë e në kohët moderne, mendonte Birnbaum-i. Dhe po të ketë luajtur ndonjëra prej këtyre gjuhëve rol me rëndësi në formimin e ndonjë gjuhe moderne ballkanike - siç duhet të supozohet për shqipen në lidhjet e saj në mënyrë të veçantë me ilirishten, fakti se nuk dimë gjë për sistemin gramatikor të asnjërës prej gjuhëve të lashta indoeuropiane të Ballkanit, e përjashton mundësinë serioze për ta lidhur lindjen e tipit gjuhësor ballkanik, qoftë dhe vetëm në fillim, me gjuhët e shuara të zonës.

Prandaj Birnbaum-i këshillonte të ndahej mirë ballkanistika e lashtë nga modernia dhe të shiheshin rezultatet e së parës si irelevante për të dytën.

Ndryshe qëndron puna me gjuhët e shkruara, të cilat nuk mund të quhen *substrat*, po më saktësisht do të quhen gjuhë të *adstratit* e që janë greqishtja dhe latinishtja.

Për këtë arsye, sipas tij, ka rëndësi të interpretohet e ashtuquajtura '*linja Jireček*' (që shkonte afërsisht nëpër vijën e rrugës Egnatia) lidhur me sferat e ndikimit roman e bizantin dhe të shtrirjes gjeografike të latinishtes dhe të greqishtes. Interpretimi korrekt tregon se vetëm latinishtja ishte në ekspansion, kështuqë nuk duan konsideruar të gjitha territoret në jug e në lindje të linjës imagjinare si të banuara nga grekë, theksonte ai. Latinishtja ishte gjuha zyrtare e Perandorisë deri në shekullin VII.

⁴ "... with areal phenomena of political, cultural and social accomodation and integration as the determining extra-linguistic factors", Birnbaum 1985, f. 80.

Roli i latinishtes vulgare ka qenë i madh në lindjen e Sprachbundit ballkanik, më i rëndësishëm se i greqishtes, e cila sot është "*ndër gjuhët më periferike ballkanike*", mendonte Birnbaum-i. Por, zona më e romanizuar - Dalmacia, u sllavizua, ndërsa zona më pak e sunduar nga Roma – Dakia, u bë atdhe i të vetmes gjuhë romane – rumanishtes. Më tej Birnbaum-i theksonte se shpesh harrohet një gjuhë romane perëndimore – gjuha ladino e ebreitëve sefardinë të qyteteve të Ballkanit, që nuk u bë ballkanike. Ndoshta koha e ardhjes së ladinis në Ballkan (fundi i sh. XV) mund të merret si pikë *terminus ad quem* për formimin e Sprachbundit.⁵

Megjithatë, po dalin arsye që çështja e 'prejardhjes' lashtoballkanike të shqipes, me këtë dhe e vendit të saj në lashtësi, pra edhe e raporteve të saj me gjuhët paleoballkanike dhe me gjuhët klasike, të mos veçohet nga ballkanistika. Siç bën indoeuropeisti dhe ballkanologu bullgar Vladimir I. Georgiev, duket më reale të supozohet se

"shkaku kryesor i vendosjes së një unioni gjuhësor është interferenca gjuhësore, përkatësisht format e ndryshme të bilinguizmit, për shkak të substratit, adstratit e superstratit",

që shtrihet në tre mileniume.⁶

Por kur qenka vendosur '*unioni ballkanik*'? Pse ta shohim çështjen

⁵ I. I. Russu kundërshtonte termin, saktësinë e tij, domosdonë e një 'linguistike ballkanike'; citonte gjerësisht për këtë qëllim Al. Graur, *Coup d'oeil sur la linguistique balkanique*, in *Bulletin linguistique*, publ. par A. Rosetti, Bucuresti-Paris (I- 1933- XV/ XVI 1948), IV 1936, 31-45. Theodora Bynon në *Historical Linguistics*, Cambridge University Press, 1977, në kapitullin për *Kontaktet midis gjuhëve*, fliste për '*Linguistic areas*', '*The Balkan linguistic area*', '*Europe as a linguistic area*', secila me nënkapitull të veçantë. "*Termi zonë gjuhësore përdoret për të shënuar një grup gjuhësh gjeografikisht në vijimësi të karakterizuara nga një numër izoglosash strukturore specifike, duke qenë këto tipare të përbashkëta areale të krijuara si rezultat i kontaktit dhe jo të trashëguara*", 244. Kështu zona gjuhësore shihet si e kundërta e natyrshme e familjes gjuhësore, siç mëtonte të bënte Trubeckoi me konceptin *Sprachbund* të vitit 1928. Pra, mund të bëhen grupime gjuhësh mbi bazë të trashëgimisë nga një paraardhës, po edhe mbi bazë të tipareve të përbashkëta që i kanë krijuar në saje të kontaktit. Zona linguistike mund të ketë pasur edhe në të kaluarën, siç supozonte Trubeckoi për paraindoeuropeanishten me grupe të tjera gjuhësh.

⁶ Actes du Premier Congrès, t. IV, 9, 14.

kështu të ngurtësuar dhe të caktojme madje edhe *terminus ad quem* të kësaj vendosjeje? Si dukej shqipja para se të bëhej "ballkanike" dhe ku ishte? Shumë pyetje për të cilat është vështirë të gjenden përgjigje.

Si i shihte çështjet E. P. Hamp?

Tema e parë kështu në të vërtetë parashtron diskutimin e dy çështjeve problematike në përcaktimet e derisotme lidhur me ballkanistikën; prejardhja e gjuhës shqipe, si çështje që buron nga trajtimi komparativ, nga konceptimi i lidhjeve të saj në familje, dhe ballkanistika, si fushë në të cilën shtroheshkan në radhë të parë çështje të lidhjes gjuhësore me gjithë ç'nënkupton ajo.

Le të merremi për pak me vrojtimit konkrete për këto çështje të Eric P. Hamp-i, profesor emeritus i Universitetit të Chicagos, anëtar i jashtëm i ASHAK-ut, njërit nga indoeuropeistët, albanologët, po njëherësh edhe ballkanologët më të shquar sot. Sadoqë do të meritonte një trajtim të gjithanshëm dhe të detajuar, kontributi i gjerë i Hamp-it në këto studime nuk mund të bëhet objekt i privilegjuar i këtij diskutimi tani. Megjithatë, do të themi se ai shtrihet, sa i përket shqipes, thelbësisht në këto fusha: dialektologji e skajeve (arbërishte e Greqisë dhe e Italisë, shqipe e Bullgarisë, të folme gege të Tetovës, të Malit të Zi, etj.),⁷ histori e gjuhës shqipe me përqëndrim të veçantë në raportet e saj me gjuhët e tjera indoeuropiane, studim i raporteve të shqipes me gjuhët e tjera përreth dhe etimologji.⁸ Dhe në të gjitha këto fusha Eric P. Hamp-i ka dhënë rezultate

⁷ *On the Arvanitika Dialects of Attica and Megarid*, in *Balkansko ezikoznaine* 3/2, 1961, 101-107; *The Albanian Dialect of Mandres*, in *Sprache* 11, 1965, 137-154; *The Diphthongs of Mandrica*, in *Balkansko ezikoznanie* 14, 1970, 21-25, etj.

⁸ *Albanian and Messapic*, in *Studies presented to Joshua Whatmough*, 1957, 73-89; *Gender shift in Albanian plurals*, in *Romance Philology* 12, 1958, 147-155; *Palatal before resonant in Albanian*, in *KZ* 76, 1960, 257-280; *Albanian be, besë*, in *KZ* 77, 1961, 252-253; *Indo-European bhendh in Albanian*, in *KZ* 77, 1961, 253-254; *Evidence in Albanian*, in *Evidence for Laryngeals*, The Hague 1965, 123-141; *The position of Albanian*, in *Ancient Indo-European Dialects*, Berkeley 1966, 97-122; *Underlying forms versus historical reconstruction*, in *Bulletin du Cercle linguistique de Copenhague* 1966, 239-242; *Acculturation as a late rule*, in *Fourth regional meeting of the Chicago Linguistic*

që nuk mund të shpërnjihen. Në dialektologji vlerë të veçantë kanë studimet e tij për të folmen e Vakaricës,⁹ për të folmet arvanite dhe për atë të Mandricës; studimet e tij për historinë e gjuhës janë të shkruara me ato për etimologjitë dhe prandaj të shpërndara nëpër gjithë botën: duan veçuar trajtesat për vendin e shqipes dhe për raportet e saj me mesapishten, kontributet substanciale lidhur me gjurmët e laringaleve indoeuropiane në shqipen, saktësimet dhe kontributet lidhur me kronologjitë e ndryshimeve fonetike të shqipes dhe sqarimet e një numri jo të vogël etimologjish. Në dritën e këtyre rezultateve ai nuk ka ngurruar të rimarrë e të përshtasë idetë dhe mendimet e shprehura më parë dhe nga ai vetë.

Duke u marrë me çështjen e pozitës së shqipes në kuadër të grupeve të lashta dialektore indoeuropiane, pra me çështjen e *'prejardhjes'* së saj, Hamp-i qysh më 1966 në studimin *"The position of Albanian"* kon-

Society, 1968, 103-110; *Early slav ic influeces on Albanian*, in *Balkansko ezikoznanie*, 14, 1970, 11-17; *Albanian*, in *Current trends in lingusitics*, Hague 1972, 1626-1692; *On the distribution and origin of Vatra*, in *Opuscula slavica et linguistica*, Klagenfurt, 1976, 201-210; in *On Late Mediaeval Linguistic Contacts of non-Slavs with Slavs in South-eastern Europe: the Quality of Evidence*, in *Les cultures slaves et les Balkans* 2, 1978, Sofia, 313-322; *Albanian gat, Slavic gotovu, and Balkan adverbials*, in *Revue roumaine de linguistique* 28, 1978, 333-345; *Strunga*, in *Balkansko ezikoznanie* 20, 1978, 115-119; *Thracian, Dacian and Albanian-Romanian correspondences*, in *Actes du Ile congrès international de thracologie*, 1980, 575-60 (nuk e kam pasur); in *Autochthonous vatra*, in *RRL* 24, 1981, 315; *On the distribution and origin of (h)urda*, in *BE* 24.4, 1981, 47-50; *La langue albanaise et ses voisins*, in *Actes du premier congrès international des etudes balkaniques et sud-est européennes VI*, Sofia 1968, 663-668; *The oldest Albanian Syntagma*, in *Balkansko ezikoznanie* XXV, 1982, 77-79; *The Albanian diffusion of Slavic toponyms in Greece*, *Atti del VII Congresso internazionale di scienze onomastiche*, v. II - Toponomastica, Firenze 1963, 137-144; *Nissia - Nis*, in *Balkansko ezikoznanie* XI, 1; *Biso*, in *Actes du Xle Congrès int. des Sciences Onomastiques*, t. 1, Sofia 1974, 367-369; etj. Studimet etimologjike të Hamp-it janë të shpërndara nëpër revista të ndryshme, ndërsa bibliografia e plotë e botimeve të tij do të kapte një vëllim më vete.

⁹ Eric Pratt Hamp, *Il sistema fonologico della parlata di Vaccarizzo Albanese*, *Studi e testi di albanistica*, Centro editoriale librario dell'Universita della Calabria, Rende, 1993, 1-20 të panumëruara me Indice, Presentazione nga F. Altimari, Di fjalj prpara, Premessa, Foreword, Nota del curatore G. M. G. Belluscio dhe Prefazione; I-XXVII Introduzione dhe 1-194 teksti themelor; pasojnë 30 Appendice dhe pastaj teksti anglisht: 6 të panumëruara me përmbajtjen dhe Preface, I-XXV Introduction dhe 1-171 Phonetics. Di-sertacion i mbrojtur më 1954.

statonte se për këtë çështje duan kombinuar rezultatet dhe hulumtimet në tri fusha - ballkanistikë, linguistikë klasike (filologji e epigrafi) dhe studime indoeuropiane, për çka, siç thoshte ai me të drejtë, askush nuk mund të jetë njësoj kompetent. Në bilancin e bërë nga ai për lidhjet e shqipes me ilirishten e mesapishten, ku reflektohen rezultatet e arritura më parë nga Jokl-i e deri te Çabej, sadoqë linte dyshime për përmbajtjen e termave, nuk del se në këto raporte të shqipes me ato gjuhë s'do të ketë pasur gjë. Pasi të ketë shprehur bindjen e tij se

*'mungesa e vokabularit të trashëguar detar nuk provon gjë,*¹⁰

Hamp-i sikur pohonte se do të ketë argumente bindëse që flasin kundër shtrirjes së parashqipes buzë Adriatikut. Ndryshe nga Çabej, ai megjithatë mendonte se ato pak fjalë të konsideruara të fondit detar autokton janë kryesisht metaforike. Atëherë si më vonë, ai do të anojë që vendin e shqipes ta shohë nga Dardania e më në veri. Në këtë raport të gjerë dhe sprovë spastrimi të materialit, ai merrej me diskutimin e rëndësishëm të Cimochowski-t lidhur me kontraverzën *centum/ satam* të ilirishtes. Për të, iliro(-mesapishtja) shfaq bashkëtingëllore velare aty ku të tilla velare shfaqin gjuhë të pakontestuar të tipit *satam*, prandaj ilirishtja nuk merret dialekt centum. Për Hamp-in,


*"është e vërtetë, faktet flasin kundër statusit centum të ilirishtes".*¹¹

Pas tij kjo ka të bëjë me një bazë tjetër: me shkrirjen e palataleve e të velareve në shqipen në fqinjësi me sonantet.¹² Disi në këtë kontekst të theksimit të afrive të shqipes me ilirishten Hamp-i, në vijën e Pedersen-it dhe të Jokl-it, theksonte faktin se në shqipen kemi refleks të veçuar të labiovelareve para zanoreve të përparme. Madje pajtohej me Jokl-in edhe për shfaqjen e tyre në ilirishten, por jo në trakishten, çka është një element me rëndësi në të mirë të vazhdimësisë iliro-shqiptare.

¹⁰ "... absence of inherited maritime vocabulary can prove nothing", Hamp: *The position of Albanian*, in *Ancient Indo-European Dialects*, Berkeley 1966, f. 98.

¹¹ "True, the facts speak against a centum status for Illyrian...", Hamp: *The position of Albanian*, in *Ancient Indo-European Dialects*, Berkeley 1966, f. 110.

¹² Shih Hamp, KZ 76, 1960, 275-80.



"Por, përballë gjithë kësaj, besoj se duhet të kemi parasysh se dëshmitë pozitive labiovelare të ilirishtes janë të pakta dhe skajshmërisht koniunkturale. Për më tepër, po të flasim hollë, edhe po të jenë, ato do të jenë vetëm pak diagnostike".¹³

Pas diskutimit të pikëpamjeve të Çabejtë, Cimochofski-t, Reichenkron-it e Barić-it, sidomos të atyre lidhur me ndarjen e dy shtresave të ndikimit latin – brendaballkanike e adriatike, Hamp-i sikur pajtohej me mendimin se statusi i fjalëve të rumanishtes të përbashkëta me shqipen do të jetë ai i *'Restwörter'* (fjalë mbetje) jo i *'Lehnwörter'* (fjalë të huazuara). Dhe këto i ndërlidhte me shtresimin e trefishtë të elementeve të përbashkëta të rumanishtes me shqipen: të arealit karpato-ballkanik, të huazimeve të ndërsjella të mesjetës dhe të vona. Natyrisht se kjo do të ketë konsekuenca lidhur me çështjen tonë, siç do të shohim pak më vonë.

Është me interes të përmendet po ashtu përgjigja e Hamp-it lidhur me pyetjen: ku ishin shqiptarët kur erdhën sllavët në Ballkan? Pasi rikujton mendimet e Seliščev-it, pas të cilit në Shqipëri sllavët do të kenë ndeshur vetëm romanë, pasi shprehte bindjen se

"ndoshta është naivë të shikosh hapësira të pastra, të pashkëputura banimi, sidomos në gjendjen parakombëtare të Ballkanit",¹⁴

Hamp-i thoshte:

"U muar vesh, në çdo rast ne vetëm mund të provojmë se shqiptarët aty erdhën para sllavëve dhe kurrë e kundërta".¹⁵

Në vijim të diskutimit të materialeve të Georgiev-it për trakishtendakomezishten në raport me shqipen, Hamp-i rikthehej te kërkimi i lidhjeve të shqipes me grupin verior të gjuhëve IE, përkatësisht me balto-sllavishten, pikërisht në frymën e Jokl-it. Më 1976 ai këtë e formulonte kështu:

"Më duket se Jokl-i kishte të drejtë kur thoshte se në këtë kuadër shqipja


¹³ "But, in face of all this, I feel we must bear in mind that the positive Illyrian labiovelar evidence is sparse and conjectural in the extreme. Moreover, as a retention it would be, strictly speaking only weakly diagnostic", po aty, f. 110.

¹⁴ "Perhaps it is naïve to look for neat, unbroken settlement areas, and doubly so far for those familiar with the prenatal state of the Balkans", aty, f. 106.

¹⁵ "Of course, in any event we could only prove the Albanians did, and never that they did *not*, precede the Slavs", Po aty, 106.

ishte më e afërt me grupin e madh të gjuhëve baltosllave. Ka gjasë që dikur të kemi pasur edhe njëfarë afërsie më të madhe të shqipes me gjuhë të tjera më gjerë, siç janë gjuhët gjermanike dhe gjuhët keltike. Ndoshta kjo afërsi ishte më tepër e natyrës së lidhjes gjuhësore (Sprachbund). Kështu më duket se mund të shpjegohen disa momente të vështira në këtë fushë. Kjo lidhje do të kapte, përveç shqipes, edhe gjuhët baltosllave".¹⁶

Paraqitje grafike e 'drurit' të gjuhëve IE nga E. P. Hamp në bisedë më 1978, dorëshkrim



Siç shihet në skicën e bërë nga ai për gazetën 'Rilindja' atëherë, ai e afronte armenishten më shumë me greqishten, ndërsa midis gjuhëve italice, frigjishtes, trakishtes e greqishtes shihte një lidhje më të madhe afrie. Ai parapëlqente të fliste për gjuhë 'albanoide', në vend se për ilirishte, trakishte e madje dhe dako-mezishte, sakohë që i referohej protoshqipes.

Duke u nisur nga fakti se shqipja është gjuhë indoeuropiane, Hamp i natyrshëm supozonte se dikur ajo do të jetë folur në Ukrainën juglindore, pra jo gjithmonë në brigjet e Adriatikut. Meqenëse është i bindur, si

¹⁶ Intervistë e E. Hamp, *Rilindja*, Prishtinë, 28 gusht 1976, shih R. Ismajli, *Artikuj mbi gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1987, 34-35. Skicën e dytë Hamp e bëri në Horën e Arbëreshëve më 1988. Këto skica i sjellim këtu për të treguar dinamizmin e të menduarit të Hamp-it për këto çështje në kohë të ndryshme.

Jokl-i e Desnickaja, për afrinë më të madhe IE të protoshqipes me balto-sllavishten, del e arsyeshme

"të merret me mend një vendosje qendrore për proto-albanoidishten në lindje drejt Ukrainës veriore dhe perëndimore... Del gjithashtu e lejueshme të supozohet një tufë dialektesh të lidhur me shqipen brenda së njëjtës degë indo-europiane që shtrihej nëpër harkun e Karpateve dhe drejt veriut të Trakisë së paku deri në Banat dhe në ultësirën Sava-Danub e më në fund te shqipja në veri të linjës Jireček".¹⁷

Pasi vendoste rezervën se një zonë e tillë nuk mund të popullohej njëherësh vetëm nga një popullatë dhe se kronologjia është e vështirë të vendoset, Hamp vijonte:

"Shtrirja në lindje jo vetëm që merr parasysh përhapjen e tashme shqiptare në rrethina të Leskovcit dhe emrat e vendeve si Nish, por edhe elementet e qarta të përbashkëta 'autoktone' me rumanishten. Në fakt, siç kam argumentuar gjetiu, këto elemente të përbashkëta përquendrohen fuqishëm te një rajon në mënyrë specifike të rrafshë që në mënyrë plauzibilë mund të gjendet në zonën Sava-Danub në rrethinat e Singidunum-it. Nëse është ashtu, banorët e Serbisë, të Banatit, të Oltenisë dhe të harkut të Karpateve do të kenë përfshirë folës të dialekteve albanoide në kohën e pushtimeve romake. Shtrirja lindore e kësaj fashe do ta ketë adoptuar latinishten, përfshirë përhapjen jugdanubiane drejt perëndimit, ndërsa pjesa perëndimore mbeti autoktone albane dhe më vonë e lëvizi qendrën e gravitetit në perëndim drejt detit. Duket e arsyeshme të mendojmë se është inkursioni i sllavëve të jugut ai që shtyri shqiptarët në perëndim; kjo duket të ketë ndodhur para se kontaktet e afërta me hungarezët të jenë bërë të mundshme. Mbase nga kjo periudhë mund të kemi huazime të tilla si grusht, me trajtimin e tij të hershëm të jer-it dhe zhvillimin e hershëm të s në sh (š); ky mund të ishte niveli gjithashtu që shohim te porosis porositi, edhe pse këtu zanorja e parë e plotë kërkon të merret një vendim që unë nuk jam gatri ta marr tash. Gjatë gjithë kësaj kohe albanishtja e hershme do të ketë qenë në veri të linjës Jireček dhe numri i vogël i huazimeve nga greqishtja klasike e konfirmon këtë" (Hamp 1978, On late.: 319).¹⁸

¹⁷ E. P. Hamp, *On Late Mediaeval Linguistic Contacts of non-Slavs with Slavs in Southeastern Europe: the Quality of Evidence*, in *Les cultures slaves et les Balkans*, 2, Sofia, 1978, 313-322.

¹⁸ "The extension eastwards not only accounts for the present Albanian distribution to

Diku në mijëvjeçarin e parë, mendonte Hamp-i, shqipja do të jetë shtrirë më tej në perëndim të malit Shar, duke krijuar kështu dialektin e diferencuar mirë të toskërishtes dhe bazën e shtrirjes më tej në jug. Pasi supozonte se toskërishtja u krijua me mbivënien e shqipes në një shtresë të hollë sllave në jug të linjës Jireček, ndërsa sllavizmat gege veriore do të jenë rezultat i ndikimeve recente të serbishtes së Malit të Zi dhe të Kosovës, sikur për të mbështetur hipotezën për shtrirjen e protoshqipes në një ultësi si ajo e Sava-Danubit, rikujtonte se shq. *baltë*/ rum. *baltă* nuk do të jenë huazime nga sllavishtja.

"Fjala rumune është relik i gjuhës 'autoktone', e cila ishte e afërt me formën shqipe, ndërsa kjo e fundit është thjesht indoeuropiane në kuptimin që janë shumë fjalë IE" (Hamp 1978, *On late.*: 320).¹⁹


Mund të hetohet se këtu nuk është fjala as për iliromani të fillimit të shekullit, por as për ilirofobi të mëvonë, po për ndryshim jo të vogël pikëpamjesh.

Gjithë duke pranuar konceptin e përgjithshëm për afritë e hershme

the environs of Leskovac and the place names of the category of Niš, but also for the clear shared elements with the 'autochthonous' component of Romanian. In fact, as I argued elsewhere, these common elements point strongly to a specifically lowland region which might plausibly be found in the Sava-Danube area in the environs of Singidunum. If that is so the inhabitants of Serbia, of the Banat, of Oltenia and the Carpathian arc would have included speakers of Albanoid dialectes at the time of the Roman conquest. The eastern extension of this range would have adopted Latin, including a south-Danubian spread toward the west, while the western part remained autochthonous Albanian and later moved its center of gravity west to the sea. It seems reasonable that it was the incursion of the South Slavs that moved the Albanians west; this seems to have been well before close contacts with Magyars would have been possible. Perhaps from this period we may date such loans as *grusht*, with its early treatment of the *jer* and the early development of *s* to *sh* (*š*); this may also be the level that we see in *porosis poročiti*, although here the full first vowel requires a decision which I am not yet prepared to make. During all this time early Albanian should have been north of the Jireček line, and this sparsity of Classical Greek loans conforms this".

¹⁹ "... the Romanian word is a relic of the 'autochthonous' language, in which it was a cognate to the Albanian form, and the later is purely Indo-European in the sense that many IE words are".

IE të shqipes me grupin balto-sllav, po edhe me gjermanikishten e kel-tishten në perëndim, ashtu siç ngulte këmbë Jokl-i, pas tij sidomos Çabej e Desnickaja, por me përfundime pak më të ndryshme, këtu mbetet përshtypja për pamjaftueshmërinë e shpjegimeve dhe të mbështetjes së kronologjive të supozuara nga Hamp-i lidhur me ato që ai i konsideronte ndryshime në shqipen të lidhura me kontaktet me sllavishten, konkretisht kompleksin e rotacizmit. Natyrisht se mbetet nevoja për shpjegime më të pranueshme lidhur me kontaktet me latinishten, me kompleksin e huazimeve latine të shqipes dhe përgjithësisht me vijën Jireček, që merret si një nga shtyllat e referencave kur diskutohet përgjithësisht lindja e ballkanizmave dhe vendi i hershëm i shqipes.



Kufiri midis greq. e lat. në mbishkrime sipas Jireček-ut, Philippide-s e Skok-ut (sipas Banfi-t 1983, riprodhuar te Mihăescu 1993 bashkë me komentet e tij e të tjerë. Sipas Mihăescu-t linja Jireček në të vërtetë nuk paraqiste ndonjë ndarje me rëndësi.)

Konstantin Jireček-u²⁰ në bazë të materialeve epigrafike kishte nxjerrë përfundimin se në lashtësi në Ballkan kemi dy sfera të mëdha

²⁰ *Die Romanen in den Städten Dalmatiens des Mittelalters I*, Wien 1901, 13.

ndikimi: duke filluar nga *Lissus* nëpër *Via Egnatia* e në veri kemi latinishten dhe ndikimin ekskluziv latin, në jug greqishten. Petar Skoku,²¹ në bazë të analizës së toponimeve dhe të hidronimeve në të dy anët e *Via Egnatia* kishte nxjerrë përfundimin se ekzistonte

"një popullatë që fliste latinisht edhe në jug të të famshmes *Via Egnatia*".²²

Kjo linjë imagjinare do të shkonte afërsisht nga *Aulona* (Vlorë) në *Lychnid* (Ohër), pastaj *Stobi*, *Serdica* (Sofje) dhe *Odesa*. Pa dashur të sjell ndërmend këtu rezultatet jo pa peshë lidhur me latinizmat e shqipes, deri në kohë të fundit të Çabejtë, të Mihăescu-t, të Haarmann-it, të Rossilandi-t, të Kristophson-it, të Bonnet-së, të Vătăşescu-t, etj.,²³ le të më lejohet të theksoj diçka që kishte vënë në pah qysh Schuchardt-i në shekullin e kaluar: ndikimi i madh i latinishtes në shqipen nuk shihet vetëm në numrin e fjalëve, po edhe në cilësinë e tyre.²⁴ Këtu do të pajtohem me E. Banfi-n kur thoshte se prania ashtu e gjerë e latinizmave në shqipen provonte që kjo gjuhë ishte formuar në një hapësirë ku latinizmi ishte i fuqishëm.²⁵

²¹ Zum *Balkanlatein IV*, in *Zeitschrift für romanische Philologie*, LIV (1934), 175-215 dhe *Byzance comme centre d'irradiation pour les mots latins des langues balkaniques*, in *Byzantion VI* (1931), 371, edhe sipas Banfi 1972: 219.

²² "... das Bestehen einer lateinisch sprechenden Bevölkerung auch südlich der berühmten *via Egnatia*", 177, edhe sipas Banfi 1972: 219.

²³ E. Çabej, *Zur Charakteristik der Lateinischen Lehnwörter des Albanischen*, in *Revue de linguistique* 7, Bucureşti, 1962, 161-199; H. Mihăescu, *Les éléments latins de la langue albanaise*, in *Revue des études sud-est européennes* 1-2-3-4, 1966, Bucureşti; *Locul elementelor latine din limba albaneza în cadrul romanităţii sud-est europene*, in *Semantica şi semiotica*, red. I. Coteanu, L. Wald), Bucureşti, 1981, 216-235; H. Haarmann, *Der Lateinische Lehnwortschatz im Albanischen*, Hamburg 1972; J. Kristophson: *Romanische Elemente im Albanischen*, in *Zeitschrift für Balkanologie* 24, 1988, pp. 51-93; A. Landi: *Gli elementi latini nella lingua Albanese*, Corso di lezioni universitarie, Edizioni Scientifiche italiane, Napoli 1989, pp. 178; Guillaume Bonnet: *Les mots latins de l'albanais*, L'Harmattan, Paris, 1998, pp. 478; Cătălina Vătăşescu: *Vocabularul de origine latină din limba albaneză în comparație cu româna*, Institutul român de Thracologie, Bibliotheca thracologica XIX, Bucureşti 1997, pp. 543.

²⁴ H. Schuchardt, *Vokalismus des Vulgärlateins III*, Leipzig, 1868, 46.

²⁵ Emanuele Banfi, *Aree latinizzate nei Balcani. Una terza area latino-balcanica (Area della via Egnatia)*, in *Rendiconti dell'Istituto Lombarde di Scienze e Lettere, Classe di lettere*,

Ndërkaq, analizat e adaptimeve kronologjike dhe të krahasuara me latinishten e me dalmatishten mund të tregojnë se kjo nuk ka mundur të ndodhte diku në Limesin danubian në kohën e latinizimit të tij, po pikërisht më në jug, dhe atje ku edhe më herët do të ketë pasur kontakte midis protoshqipes e greqishtes së vjetër. Numri i vogël i greqizmave të lashtë në shqipen në atë rast do të shpjegohej me natyrën e kontaktit dhe me gjurmët e zhdukura në lashtësi.

Tri zonat e latinizimit para invazionit sllav në Ballkan


Këtu ndoshta është vendi të shquhet një tjetër gjë: sa mund të mbahet e qëndrueshme hipoteza e vjetër për unitetin e latinitetit ballkanik? Dëshmitë antike, ashtu si dhe mbishkrimet, që paraqesin edhe modele zyrtare, mundësia e imitimit të modeleve kishtarë a klasike në to, nuk lënë vend të besojmë shumë. Duket se Banfi kishte të drejtë kur këmbëngulte në hulumtimin e gjurmëve latine në gjuhët moderne të Ballkanit, posaçërisht nga latinishtja e folur në momentin e izolimit të Ballkanit nga mbetja e Perandorisë (shekulli 6), para invazionit sllav, dhe mbi këtë bazë veçonte tri zona të latinizuara:

- zona dalmatine,
- zona danubiane,
- zona e Via Egnatia.

Kjo pajtohet me vijat e depërtimit të latinitetit në Ballkan:

Vol. 106, 1972, Milano, 185-233. Këtu ai shënonte se për herë të parë praninë e elementeve të shumtë latinë në shqipen e kishte hetuar H. Schuchardt: *Vokalismus des Vulgärlateins III*, leipzig 1868, i cili në f. 46 kishte shënuar: “*Dëshmia në besimin tim qëndron jo dhe aq në numrin e fjalëve me prejardhje latine në shqipen (...) sesa në cilësinë e tyre. Për pjesën më të madhe nuk janë fjalë të huaja (...) janë parafjalë, numërorë (...), emra, mbiemra, folje me përdorim të përgjithshëm*” [Der Beweis für meine Behauptung liegt weniger in der Anzahl der Wörter lateinischen Ursprungs im Albanesischen (...) als in ihrer Qualität. Es sind zum grossen Teil nicht Fremdwörter (...) es sind Praepositionen, Zahlwörter (...), Substantiva, Adjektiva, Verba des allergewöhnlichsten Gebrauches].

- nga Aquileia drejt Singidunumit (Beogradit) nëpër luginën e Savës, me degëzime nëpër Naissus (Nish) e Serdica (Sofje) për Thessalonica (Selanik) e Constantinopolis (Stamboll);
- nga Aquileia drejt Durrësit nëpër bregun dalmat;
- nga Durrësi drejt Thessalonica e Constantinopolis.



Skica e tri zonave të romanizimit në kohën para pushtimit sllav, sipas Banfi 1983. Zona I = bregdeti dalmat; zona II = Dacia; zona III = hapësira rreth Via Egnatia.

Kjo mund të mbështetet disi edhe me kronologjinë e pushtimeve romake të Ballkanit: në sh. III dhe II para erës së re – Istria (v. 219), Iliria (v. 186) dhe Greqia e Makedonia (v. 146); në fund të erës së vjetër - mezia (v. 29) dhe Panonia (v. 9); ndërsa në sh. I – Trakia (v. 56) dhe në fillim të sh. II të e. r. Dacia. Nuk do shumë mund të hetohet se në këto zona u formuan dy gjuhë romane – dalmatishtja dhe rumanishtja, ndërsa në zonën Via Egnatia kemi elementin e veçantë latin të shqipes dhe të greqishtes së re.

Disi në këtë kuptim mund të kërkohen edhe shpjegime të tjera lidhur me kontaktet e pararumunëve dhe të rumunëve të hershëm me paraarbërit dhe arbërit e hershëm. Para ardhjes së sllavëve kontakti midis zonave të përmendura të latinizimit nuk ishte i ndërprerë, por as pas depërtimit të sllavëve kjo nuk kishte ndodhur në mënyrë

abrupte. André Du Nay ka avancuar edhe argumente të tjera për shpjegimin e krijimit të rumanishtes së paku në të dy anët e Danubit, po më shumë në jug të tij: zberthimi dialektor relativisht i vogël i dakorumanishtes në raport me hapësirën e gjerë po të kihen parasysh fillimet e romanizimit; ekzistenca e popullatës romane deri vonë në Mesjetë në tërë Serbinë e sotme në Jug të Danubit, etj.²⁶ Kjo sikur e bën të panevojshëm kërkimin e përshtatjes së vendit të hershëm të shqipes.

Tani le të shohim mbështetjet më konkrete të Hamp-it për hipotezën e tij jo pak të menduar. Le të marrim dy shembuj. Në një anë kemi elementet leksikore të përbashkëta midis shqipes e rumanishtes, në anën tjetër një shpjegim gramatikor që flet për lashtësinë e elementeve nyjore.

Shumë më herët Eric Hamp-i kishte bërë një dallim midis fjalëve të fondit të përbashkët midis rumanishtes e shqipes. Ekziston një numër fjalësh që, sipas tij, flasin për një vendosje më të hershme të parashqipes në kontekstin karpato-ballkanik. Thelbi është ky: shqyrtimi i etimologjisë dhe i përhapjes së fjalëve si *vatër*, *vatră* tregon diçka të veçantë. Kemi të bëjmë me një fenomen '*të ndryshëm nga ata që u rritën në ballkanizma tipikë*'. I rëndësishëm këtu del fakti se kjo fjalë dëshmohet në ukrainishten me kuptimet 'ogon, žar' dhe 'mesto gde gorit/gorel ogon', ku kuptimi i parë del nga i dyti. Në rumanishten *vatră* del me kuptimin 'otkryty očaj' dhe 'mesto v kuznecnom gorne gde razvodjat ogon', por edhe si 'dom', 'rodnoe mesto', 'centr sela', 'goloe mesto na pole'. G. P. Klepikova²⁷ mendonte se kjo fjalë me gjithë ato variacione në gjuhët e ndryshme sllave, në rumanishten e shqipen, në hungarishten, nuk i përket terminologjisë baritore, po leksikut të përbashkët.

"Kështu ne kemi vendosur focus si kuptimin më të hershëm për vatër në një hapësirë të gjerë që shtrihet nga mesi i Adriatikurt nëpër Sava

²⁶ André du Nay, *The early History of the Rumanian Language*, Lake, Bluff, Illinois, 1977.

²⁷ *Iz Karpato-Balkanskoj terminologii vysokogornogo skotovodstva. 2. Vatra*, in *Balkanskoe jazykoznanie*, Moskva 1973, 149-169.

e Danub nëpër Karpate dhe mbi Dnjestër deri në Ukrainë. Kësaj mund t'ia referojmë territorin shqiptar (Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni veri-perëndimore), si zona 'vatra"', thotë Hamp-i.²⁸

Supozimi për huazim nga iranishtja duket se nuk qëndron, për shkak se avestishtja *āt(a)r 'ogon'* është emër veprimi, ndërsa *vatra* në fillim kishte kuptimin 'focus', 'vendi apo gjëja për të djegur'. Duket poashtu i drejtë mendimi se përjashtohet mundësia e përhapjes së fjalës nga rumanishtja, ndërsa Hamp-i pandeh se as shqipja nuk mund të jetë burimi i saj në kuptimin e përhapjes së mëtejme, për shkak të vokalizmit. Këtu fillon hipoteza e Hamp-it: kemi një huazim të përbashkët në sllavishten e rumanishten nga një burim i vjetër. Këtu, mendon ai, shqipja jep dëshminë themelore. Jokl-i shqipten *votër, vatër* e shpinte më tej te forma e vjetër fonetike **ātrā*, ndërsa Hamp-i e analizonte atë si nomen instrumenti **ā-trā* (femëror) < **(H)ah-tro-m*, nga baza **ā-* = *(H)ah-* 'djeg, burn'. Sipas tij, etimoni sllavo-rumun duhej të kishte të njëjtin burim si proto-albanishtja.

*"Por një formë e rendit *oatrā, që është e domosdoshme për të shpjeguar zhvillimet rumune e sllave, mund t'i ketë takuar një gjuhe apo një grupi dialektesh të lidhur ngusht me paraardhësin e shqipes. Në bazë të fonetikës duket se ai dialekt apo grup dialektesh ishte ndarë nga shqipja: derisa nistorja rumune parasllave duhet të ketë pasur *oa- ose *ua- (me zanore të hapur), geg. vo- dhe tosk. va- duhet të shkojnë prapa te *uē-, që duket nga ana e vet të jetë diftongim i *ē-së (sot o) që përfaqëson IE *ā. Kështu dialekti parasllav-rumun duket të ketë qenë më pak konservativ se proto-albanishtja"... "Shkurt, kemi gjurmët e një nënfamiljeje të dialekteve të vjetra së cilës dikur i përkiste shqipja. Tani që po e shohim shtrirjen e këtyre fakteve - 'hapë-*

²⁸ "We have thus established 'focus' as the earliest reachable meaning for *vatra* (pre-Magyar in time) in a wide band extending from the mid-Adriatic across the Sava and Danube through the Carpathians and over the Dnestr into the Ukraine. We may refer to this, plus the Albanian territory (Shqipëri, Kosovë, and northwest Makedonija), as the "*vatra-bend*". Eric P. Hamp, *On the distribution and origin of Vatra*, in *Opuscula slavica et linguistica, Festschrift für Alexander Issatschenko, Schriftenreihe Sprachwissenschaft, Universität für Bildungswissenschaften, Klagenfurt, 1976, B. 1, 201-210, sidomos 205-6.*

sira vatra' - provizionalisht këtë zonë mund ta interpretojmë si të një shtrirjeje më të hershme të një nënfamiljeje IE, prej së cilës shqipja është i vetmi relik modern".²⁹

Pasi të rikujtonte lidhjet me grupin balto-sllav, nxirrte përfundimin se nënfamilja e shqipes dikur do të jetë folur në një zonë midis Polonisë e Ukrainës. Pak më vonë, po lidhur me *vatra*, ai rikujtonte se fjala ishte për burimin prej një vargu dialektesh autoktone pararomane të lidhura, por jo identike me shqipen; kjo '*fashë albanoide*' duhet të jetë një shtresë më e hershme dhe e ndryshme nga ajo e tipareve dhe leksemave rumuno-shqiptare; ajo nuk mund të jetë as e njëjtë me elementin trakas.

Siç e ka përmbledhur vetë Eric Hamp-i,³⁰ në këtë studim ai pretendonte të kishte dëshmuar që:

- Leksema shqipe do shpjeguar si trashëgimi e pandërmjetme indoeuropiane;
- dëshmimet e tjera të këtij etimoni nga Europa Juglindore dhe nga Karpitet dalin nga një 'fashë' autoktone pararomane dialektesh të lidhura, por jo identike me proto-albanishten;
- vrojtimit semantike shpjegohen në kuadër të kontakteve;

²⁹ "But a form of the order of **qatrā*, which is necessary to explain the Slavic and Romanian developments, could plausibly have belonged to a language or set of dialects closely related to the ancestor of Albanian. On phonetic grounds it seems that that dialect or set of dialects was differentiated from Albanian; whereas pre-Slavic-Romanian initial must have been **qa-* or **ua-* (with an openvowel), Geg *vo-* and Tosk *va-* (by unrounding) must go back to **uo-*, which itself seems to be a diphthongization of the **ǵ* (> modern *o*) which represents internal IE **ā*. Thus the pre-Slavic-Romanian dialect seems to be a less conservative one than proto-Albanian... In short, we have traces of the subfamily of ancient dialects to which Albanian once belonged. Now that we see the geographic extent of these facts - the "*vatra*-band" - we may provisionally interpret this area as that of the earlier extent of the IE subfamily of which Albanian is the solitary modern relic". Eric P. Hamp, *On the distribution and origin of Vatra*. f. 309-310, shqip te Hamp 2007: 379-380.,

³⁰ *Autochthonous vatra*, in *Revue roumaine de linguistique*, XXVI, Bucuresti, 1981, 4. Shqip te Hamp 2007: 381-382.

- mungesa e termit në sllovenishten, po edhe në bullgarishten e maqedonishten, zhvillimet e veçanta në serbokroatishten, kërkojnë shpjegime të veçanta dhe të shpien te vargu autokton albanoid;
- në mbështetje gjeografike dhe të tjera, vargu albanoid duhet të jetë i ndryshëm dhe më i hershëm se shtresa e shumë elementeve dhe leksemave të përbashkëta shqiptarë-rumune;
- kjo shtresë autoktone nuk mund të jetë e njëjtë me elementin trakas.

Idenë e tij Hamp-i do ta shtjellojë dhe lidhur me etimonin e fjalës së përbashkët të shqipes e të rumanishtes *shtrungë* - *strungă*. Hamp-i nisej nga vrojtimi i tij se në fondin e leksemave të përbashkëta midis shqipes e rumanishtes janë për t'u veçuar së paku tri kategori: huazime të vona nga shqipja (p. sh. *moş*), njësitë e famshme 'të substratit' (p.sh. *mazăre*); dhe elementet që ai i veçonte si protoalbanoide (*vatră, hurdă, strungă*).³¹ Me këtë rast idenë e tij ai do ta shqiptonte si vijon:

"... vatră dhe (h)urdă përshkruajnë për ne një zonë të hershme dialektore IE që mund ta quajmë proto-albanoid, dhe që (...) përfshinte territoret e ukrainishtes perëndimore, të polonishtes jugore, të sllovakishtes, pjesërisht të çekishtes, të rumanishtes (duke përfshirë u muar vesh dialektet jug-danubiane dhe prandaj arumune deri në greqishten veriore), të dialekteve të bullgarishtes perëndimore dhe të maqedonishtes e të Banatit, të serbishtes dhe të shqipes. E tërë zona formon një fashë nga Karpatet në Shqipërinë e Veriut. Kjo, natyrisht, nuk implikon asgjë më shumë se ç'ka qenë e vërtetë për pjesët e tjera të Europës juglindore, se këto fakte gjuhësore reflektojnë pandërmjetshëm një vendosje solide homogjene nëpër të tërë këtë zonë të gjerë. Por me siguri gjejmë në këto fragmente pas mbase tre mileniumesh një tufë kompakte dhe në vazhdimësi të gjurmëve".³²

³¹ Eric P. Hamp, *Strunga*, in *Linguistique balkanique XX*, 1977, Sofia, 1-2, 114-117.

³² "... vatra and (h)urda describe for us an early IE dialekt area wich we may call Proto-

Duke ndjekur sërish autoren Klepikova³³ lidhur me shtrirjen e fjalës *strunga*, *shtrungë*, Hamp-i do të sillte saktësimet. Sipas Klepikova-s, elementet ballkanike të terminologjisë baritore të Karpateve do të ndaheshin në tri klasa, prej të cilave këtu kanë rëndësi dy: ato që kanë shtrirje ballkano-karpatike që përjashton sllavishten e jugut dhe ato që përfshijnë tërë zonën. Tek ajo *strungă* hyn në klasën e parë, ndërsa *urdă* në të dytën. Shtrirja e shënuar nga ajo për *strungă*, sipas Hamp-it, i përgjigjet saktësisht asaj që ky e ka quajtur shtrirje të proto-albanoidishtes, “me përjashtim të shënueshëm të sllavishtes së jugut”. Në diskutimin e tij të mëtejme, Hamp-i tregonte se *strungă* ka po atë shtrirje si *vatră* dhe *urdă*, prandaj edhe vendos ta trajtojë si të së njëjtës prejardhje gjuhësore me dy të tjerat. Më tej diskutimi i tij shtrihet në çështje rindërtimi fonetik dhe kuptimor të etimonit në fjalë. Në fakt ai mendonte se duheshin flakur propozimet e mëhershme të I. I. Russu-it e të tjerëve për formën e rindërtuar **strong*~, ashtu si dhe propozimin e Jokl-it **strng*-. Hamp-i propozonte rindërtimin IE **stronHgo*, **stronH-gā*, ndërsa kuptimisht ai mendonte se **strunga* fillimisht nuk kishte gjë të përbashkët me 'narrow'.

Rindërtimit etimologjik të fjalës *vatra*, sidomos aspektit kuptimor, vështirë se mund t'i bëhet ndonjë vërejtje, ashtu si dhe saktësimi të shtrirjes. Besoj se edhe lidhur me *shtrungën* Hamp-i për shumëçka ka të drejtë, sidomos në paralelet me *hurdë-murg*, *bung*. Por

Albanoid, and which... embraced the territory of Western Ukrainian, southern Polish, Slovak, part of Czech, Romanian (including of course the south-Danubian dialectes and therefore Aromunian, whence to north Greek), Western Bulgarian and Macedonian and Banat dialectes, Serbian, and Albanian. This is not of course to imply, any more than has been true for other parts of Southeast Europe, that these linguistic facts directly reflect a solid homogeneous settlement throughout the whole of this vast area. But we certainly find after perhaps nearly there millennia a strikingly compact and contiguous set of traces in these fragments.” Hamp: *Strunga*.: 114, shqip te Hamp 2007: 383-390.

³³ G. P. Klepikova, *Balkanskije elemnty v karpatskoj terminologii gornogo pastušestvo*, in *Doklady i soobcenija sovjetskoj delegacii*, Moskva 1974, III Congrès International des Etudes Sud-est-européennes, București 1974.

pse *vatra*, e më tej edhe *shtrunga*, të mos mund të jetë huazim në shqipen?, vërtet nga një dialekt i lashtë, por krejt i ndryshëm nga protoshqipja, pra edhe 'proto-albanoidishtja'?

Idenë e tij Hamp do ta përforcojë me inspektimin e prejardhjes dhe të shtrirjes së fjalës tjetër (*h*)*urdă* 'gjizë'.³⁴ Pa pasur ndërmend të merremi me shtrirjen dhe rindërtimin, le të themi menjëherë se na duket i dyshimtë dëshmimi i saj në shqipen. Hamp edhe vë një dyshim, duke thënë se Leotti mund ta ketë marrë te Weigand-i, i cili, për mendimin tonë, mund ta ketë dëgjuar në arumanishten. Në të folmet që mund të kontrolloj vetë nuk del, ose mund të paraqitet si huazim i qartë bullgaro-serboshopishte *vrda*. Tani, mos ka ndonjë të tillë prejardhje edhe shqipja *vatër/ votër*? Shqipja ka edhe një fjalë *hurdhë*, me kuptimin 'vend i ulët me lagështirë, pus'. Si të shpjegohet ruajtja e homonimisë?

Pak më larg dhe për mendimin tim më radikalisht drejt dëshmitë të pamundësisë së një hipoteze së tillë, Hamp-i vete në studimin e tij '*The oldest Albanian Syntagma*',³⁵ ku përpiquej ta motivonte shpjegimin e V. Georgiev-it të toponimit *Drobeta, Drubetis* përmes fjalës rumune *druete*, të afërt me shqipen *dru*, përmes rindërtimit *druveta* e prej këndej *drubeta, drobeta*. Ndryshe nga M. Davidescu, që sufiksën *-eta* e shpjegonte me lat. *-etum*, si te *Bungetul, Frasinetul, Bradet*, Hamp-i këtu shihte shumësin si te *druète druëti*, **dru(u)ā-ta+plural*, pra **druuā+t~*, saktësisht paraforma e nyjshme si në shqipen *dru-të*. Në të vërtetë, rindërtimi shkon më tej te asnjësi **druuom+tod* > dakisht (-albanoidisht) **druua(n)+ta*. Romani ose dakasi i akulturuar, duke i përshtatur frazat me latinishten e tij që nuk kishte një të prapavendosur, format e njëjësit **druua(n)+ta_druuVta* dhe të shumësit **druu~+tā_druu~t~*, do t'i ketë trajtuar si lat. *dru(u)Vta* 'dru(ri)', femërore apo asnjësi kolektiv (shumës). Duke kombinuar dëshmitë e një toponimi të lashtë dhe të një forme moderne dialektore me 'zgjerimin semantikisht të zbrazët 't', Hamp-i

³⁴ E. P. Hamp, *On the distribution and Origin of (h)urda*, in *Linguistique balkanique XXIV*, 1981, 3, 47-50. Shih poashtu I. Duridanov, *Linguistique balkanique XVII*, 1974, 51-62.

³⁵ E.P.Hamp, *The Oldest Albanian Syntagma*, in *Linguistique balkanique XXV*, 1982, 77-79.

besonte të kishte ndeshur kolokacionin e frazës nominale **druuo-+DEIX_druua-+ta-* (*druuā+tā*) në Mezinë e Poshtme në periudhën romake. Kjo i dukej e ngjashme me *'asnjanësin njëjës të shqipes arkaike dhe dialektore'* krye-të, neje-të. Përfundimi i tij është:

*'Kemi gjithashtu një dëshmi të pandërmjetme nga ky regjion në periudhën romake të njërit nga ndërtimet më të shquara sintaksore të Sprachbundit ballkanik, përkatësisht një shembull nga gjuha autoktone të gjedhes për njëjën e prapavendosur të rumanishtes që ishte kaluar nga materialet latine. Prandaj Drubetis ilustron gjedhen për strukturën që shihet në lemnu-l, lemne-le (druri, drutë), pomu-l (pema frutore), arbore-le (pema, druri), floare-a, flori-le (lulja, lulet). Kemi siguruar dëshmi të pandërmjetme për pasjen e këtij tipari të rëndësishëm të përbashkët që lidh shqipen moderne me mezinë e Poshtme: në terma IE, *EMËR+so/s /tod 'definite+NP'.'³⁶*

Ky rindërtim interesant, përveç dobësisë në shpjegimin e prejardhjes së elementit ndërzanor që u bë *-b-*, nuk duket ta ketë qartësuar as kronologjinë e prapavendosjes, e aq më pak të përngjitjes së njëjës që do të bëhej pjesë e kësaj sintagme. As kalimi nga *Drobreta* në *Drubeta* nuk është bash i qartë, pavarësisht se baza rum. *druëte* e dëshmuar në Olteni, Gorzh dhe Haceg, mund të lidhet me shqipen *dru*. Po forma e shquar në emër vendi?

Megjithatë, merita kryesore e këtij diskutimi qëndron në faktin se problemet e Sprachbundit ballkanik i shihte në një shtrirje kohore shumë më të gjerë nga diskutimet e tjera dhe në ndërlidhje kontaktesh. Ato lidhen poashtu me çështjet themelore që shtruan në fillim të diskutimit

³⁶ E. P. Hamp, *The oldest Albanian Syntagma*, in *Linguistique balkanique XXV*, 1982, Sofia, 1, 77-79. [We also have direct evidence from this regjion in the Roman period of one of the most notable syntactic constructions of the Balkan Sprachbund, i.e. a specimen from the autochthonous language of the model for the Romanian postposed article which was calqued out of Latin materials. *Drubetis* therefore illustrates the model for the structure seen in *lemnu-l*, *lemne-le* 'the wood(s)', *pomu-l* 'the fruit-tree', *arbore-le* 'the tree', *floare-a*, *flori-le* 'the flower(s)'. We have secured direct attestation for the common possession of the important feature linking modern Albanian with Moesia Inferior: in IE terms, *NOUN+so/sā/tod 'DEFINITE+NP'/.]

tonë. Duke zgjeruar kështu diskutimin nga çështjet ballkanike Hamp-i kalonte në çështje që shkojnë thellë në identifikimin e hershëm të proto-shqipes në grupimet indoeuropiane, së pari në periudhën romake drejt rindërtimit të strukturës gramatikore me një të prapavendosur në mezinë e Poshtme, pra me mëtesë të shpjegimit të njëjës rumune, pastaj me shtrirje më të thella përmes rindërtimit të arealit në të cilin dalin fjalë specifike baritore (*vatër, hurdhë, shtrungë*), në zonën Karpato-Ballkanike, duke e ndërlidhur këtë me identifikimin e nënfamiljes, së cilës i përkiste shqipja dikur dhe e cila do të jetë folur në Poloni e Ukrainë. Kështu ai i lidhte pashkëputshëm fushat e sipërcekura.³⁷

Të kthehemi tani te tema jonë e parme. Mund të pajtohem me Birnbaum-in se për hir të qartësisë duhet të diferencojmë mirë ç'i përket paleoballkanistikës (jo ballkanistikës antike, sepse bota antike lidhet me grekët e romakët) e çka asaj që quhet sot '*lidhje gjuhësore ballkanike*'. Por a mund t'i pranojmë pasojat e një prosedeu të tillë? Nëse vendosim një *terminus ad quem* për përfundimin e krijimit të ballkanizmave, a nuk supozojmë një lidhje krjetësisht të veçantë në një kohë të caktuar? Prandaj edhe na duhet një veprues strumbullar i kësaj lidhjeje, i cili është parë herë në greqishten, herë në latinishten, e herë në substratin. Natyrisht se në një rast të tillë do të mbesnim pa shpjegime për çështjet si këto që shtron Hamp-i në hipotezat e tij. Hamp-i nisej nga dallimi midis studimit krahasimtar që merret me rindërtimin e gjuhës-nënë dhe studimit të afiniteteve, të konvergjenca-ve, që sheh efektet e një bilinguizmi në të kaluarën. Kjo mbase jep mundësinë që në zonat e afiniteteve, konkretisht të Ballkanit, të vërejmë ndryshimet dhe varietetet në izoglosa.

Në studimin *Thracian, Dacian, and Albanian-Romanian correspondences* (1980) Hamp-i ngrinte disa çështje me rëndësi për shqyrtimet e tij. Së pari ngrinte çështjen sa gjuhë dhe cilat janë ato që duhet të marrim parasysh në Ballkanin e lashtë për shqyrtimet tona në ra-

³⁷ Te *Thracian, Dacian, and Albanian-Romanian correspondences* (1980) Hamp-i ngrinte disa çështje me rëndësi për shqyrtimet e tij.

port me gjendjen e sotme, por të parë jo në raport me përkatësitë etnike, mbi bazë të kriterëve vetëm të relacioneve gjenetike dhe të ri-ndërtimit. Prandaj dhe në bazë të kriterëve të tilla ai përpqej të gjente dhe përkufizimin paralel me atë që sugjeronte emërtimi “*Illyrii proprie dicti*”, pra çka mund të ishte “*Thracian proprie dictum*”. Me këtë rast dëshironte të linte anash çështjen e ilirishtes, por njëherësh mernte distancat për atë që e kishte referuar më herët Rosetti (*Istoria limbii române* 1968: 221), se Hamp-i paskësh pasur mendimin se shqipja konsiderohej dialekt trakas:

“*tani gjithashtu duhet të korrigojohet*”.³⁸

Në bazë të studimit për emrin *Biso* (në *Actes du XIe congrès international des sciences onomastiques*, Sofia 1974, 1, pp. 367-369), kishte provuar të përdëshmonte se trakishtja duhej përjashtuar nga identifikimi me proto-shqipen, sepse -s- nuk ka mundur ta kishte atë vlerë në parashkallën e asaj kohe të shqipes.

Pas kësaj i kthehet korpusit të elementeve që njihen si përvojë e përbashkët midis gjuhëve që me kohë u zhvilluan në shqipe e rumanishte dhe që tek rumunët njihen si ‘*autoktone*’. Në këtë vazhdë ai shprehte bindjen se kishte hetuar tri kategori elementesh, të ndërlihdura me tri shtresa zhvillimesh kronologjike:

1. E para kap një shtrirje shumë më të gjerë se rumanishtja e shqipja dhe shtrihet nga Karpatet (Ukrainase) deri te Shqipëria e Veriut (ashtu siç ishte sugjeruar nga G. P. Klepikova, *Balkanskie elementy v karpatskoj terminologii gornogo pastušestva*, *Doklady* për Kongresin III të studimeve të Europës Juglindore në Bukuresht 1974, ku diskutohej terminologjia baritore. Sipas Hamp-it, nuk është fjala vetëm për terminologji të atillë prandaj rikujtonte studimet e tij për *(h)urda*, *strunga*, *murg*. Por, sipas tij, e rëndësishme nuk ishte moshja dhe përndarja e asaj shtrese, po

³⁸ “... where the attribution of Albanian as a Thracian dialect should now also be corrected”, f. 58.

“fakti se kisha qenë në gjendje të tregoja se këto njësi kanë të përbashkëta ndryshime të natyrës kruciale me historinë e shqipes”.³⁹

Prandaj këtë material ai do ta quante *Proto-albanoid*.

2. Kategoria e dytë përfshinte një pjesë të gjerë të elementeve autoktone. Këto elemente kufizohen kryesisht në shqipen e rumanishten, shfaqin zhvillime tipike të shqipes, por mund të kronologjizohen si më të hershme se kontaktet romane në këtë hapësirë. Si shembull këtu sillte rastin e rum. *cioarǎ* – shq. *sorrë*, që njihet prej kohësh po që nuk ka pasur analizë përkatëse etimologjike. Këtu ai kërkonte të pranoni se *rr* e shqipes nuk lidhej me **rn*, po me **rsn*, kështuqë kemi **k^wērsnā* (sanskrit. *कृष्णा-*, sl. *čr̥nъ*). Ky formim *vṛdhi* në aspektin morfologjik pajtohet me etimonin e serb. *vràna*, lit. *vārna*. Nistorja shq. *s* = rum. *č* tregon se para periudhës romane proto-shqipja, pra edhe në elementin ‘*autokton*’ pasardhësit e labiovelareve IE tashmë e kishin pësuar palatalizimin para zanoreve të përparme.

3. Shtresa e tretë e atyre elementeve reflekton kontaktet pasromane. Ka dëshmi, thoshte ai, se për një kohë pas shfaqjes së latinishtes kishte kontakte aktive gjuhësore midis shqipes dhe rumanishtes. Kuptohet, shqipja huazoi shumë elemente latine (“proto-Rumune”). Por pati huazime edhe në drejtim të kundërt, dhe jo vetëm në terminologjinë pastorale. Si ilustrim për këtë sillte fjalën *moș* tingulli *ʃ* i së cilës mund dalë vetëm nga shqipja, por që duhet të jetë më i ri se *s* latine e rumanishtes. Kjo do të thotë, sipas tij, se palatalizimi i labiovelareve para zanores së përparme në gjuhën që reflekton elementet e përbashkëta të rumanishtes e të shqipes ka ndodhur para periudhës romane. Kjo gjendje duhet të jetë e vërtetë për zonën në veri të linjës Jireček. Tani atij i dilte e nevojshme të merrte parasysh elementet trakase për të bërë krahasimet fonologjike dhe këtu kujtonte shembullin *Zeus Kersullos* që në krahasim me dëshmitë baltike duhet të niset nga **k^wers-*. Edhe më me interes i dukej

³⁹ “... the fact that I have been able to show that these items share changes of a crucial nature in common with the history of Albanian”, f. 59.

krahasimi i *Γέρμας* dhe *Γέρμανία* me shqipen zjarm dhe këtu i dukej mos po shkonte përtej në hapësirë tjetër gjuhësore në krahasimin me *Germol*, emër fshati te Tetova pranë *Brza voda*. Është e qartë se në trakishten labiovelaret IE nuk u palatalizuan në periudhën paramane, prandaj kështu përjashtojmë një numër jo të vogël mbetjesh dialektore nga trakishtja në kuptimin e ngushtë të fjalës. Dhe sërish vërente:

*“Nuk na ndihmon përdorimi i termave si “Trakishte” në një kuptim të gjerë; në këtë kohë duhet të lëvizim, nëse duhet, në drejtim të mbingushtimit”.*⁴⁰

Në shumicën e studimeve ballkanistike të derisotme, në një mënyrë a në një tjetër, shqipja del pikë kyçe: në të disa reflektohen më së shumti ballkanizma, ndërsa disa prej tyre, me kronologjinë dhe tiparet e tyre, flasin edhe për çështje si vendi i shqipes në kohë më të hershme, ndërsa kjo lidhet më tej me saktësimin e vendit të parashqipes në suaza të dialekteve indoeuropiane. Nëse edhe kronologjikisht mund të identifikohen gjurmët e kontaktit të shqipes me gjuhët përreth pikërisht në korpusin e saj, nuk ka arsye të mos pajtohemi me mendimin e atyre që thonë se ballkanistika pa shqipen del gati e pamundshme. Kur themi *pa shqipen*, duhet të kemi parasysh tërësinë e problematikës që shtron ajo, pra edhe atë të prejardhjes.

Në trajtimet e Hamp-it lidhur me këto çështje, mund të gjenden shembuj me interes për supozime të lidhjeve të kontaktit të tipit Sprachbund në kohë të hershme jo vetëm në Ballkan, po edhe në Veri të Europës në kohë më të hershme. Ai po ashtu indikon raporte afrie midis trakishtes e baltishteve.

Edhe pse kishte vënë në pah momente me vlerë në diskutimet më të hershme për raportet midis shqipes e ilirishtes, sidomos lidhur me kontekstin e reflekseve të palataleve IE në fqinjësi me sonantet, apo dhe afri leksikore, me kohë Hamp-i nuk iu kishte kthyer më ra-

⁴⁰ “It is of no help to use terms like “Thracian” in extended senses; for the time being we must err, if at all, on the side of over-restriction”, f. 60.

portit të shqipes me ilirishten. Ka gjasë që, në vijim të diskutimeve të E. Polomé e t.j., ai të ketë shkuar në rrugën e atyre që realitetet e ilirishtes i shohin tepër të reduktuara për të folur për këtë gjuhë, apo ndoshta mendojnë se emërtimi 'ilirishte' thjesht nuk thotë gjë në aspektin gjuhësor.⁴¹ Lidhjet e shqipes me rumanishten dhe nevoja e shpjegimit të përbashkësive midis këtyre dy gjuhëve, ashtu si dhe supozimi se djepi i hershëm i gjuhëve IE do të ketë qenë Europa Verilindore, prandaj indoeuropianët që u bënë protoalbanë, si duket, e kanë shtyrë atë më tej drejt vështimit për fazën në të cilën paraardhësit e atyre proto-albanëve do të kenë kaluar nëpër vise më të gjera ndërmjet Europës Verilindore dhe Jugut të saj Ballkanik. Studimet e V. Georgiev-it për trakishten e dakishten dhe diferencimin e tyre, sidomos studimet e mëvona të I. Duridanov-it për trakishten-dakishten dhe lidhjet e tyre me gjuhët balto-sllave i kanë shërbyer Hamp-it më së një herë si rast për të shprehur mendime në këtë drejtim. Në një artikull të shkurtë "*Shqipja dhe baltishtja si çelësa për trakishten*"⁴² ai theksonte se Duridanov-i po bënte punë me vlerë në kërkimin e lidhjeve të hershme midis Ballkanit të lashtë dhe Baltikut IE. Duke mbindërtuar në një sugjerim më të hershëm të Jokl-it edhe ai vetë kishte shtruar çështje që e lidhin shqipen me grupin balt,⁴³ tipare, që, po të dëshmohej të sakta, do të flisnin për një lidhje të funtme gjenetike gjuhësore, të një faze shumë të lashtë pas-IE. Tani, karakteri shumë arkaik i baltishtes, njohjet e reduktuara të trakishtes, po edhe afërsia gjeografike e saj me proto-baltishten, na e bëjnë të vështirë të themi nëse ato lidhje trako-baltike janë të natyrës gjenetike më të afërt, apo të natyrës së kontaktit parahistorik.⁴⁴ Shembulli *Akmonia* (lit. Ak-

⁴¹ Shih Sergent (1995), 102, 103 etj.

⁴² E. Hamp: *Albanian and Baltic as clues to Thracian*, in *Thracia II, Primus Congressus Studiorum Thracicorum*, Academia Literarum Bulgarica, Serdicae, 1974, 367-8. Shqip te Hamp 2007: 177-178. Shqip te Hamp, Eric, P.: 2007: *Studime krahasuese për shqipen*, përgatiti dhe redaktoi R. Ismajli, ASHAK, Prishtinë, ff. 177-178.

⁴³ *Rocznik slawistyczny*, 1969, 44-45.

⁴⁴ Shih Hamp për bashkimin e tipit Sprachbund Verieuropean, në artikujt e tij të përkthyer në Hamp 2007..

muo, sll.vj. *kamy*) flet për një tip më të përgjithshëm *centum* të velareve, por pikërisht në kuptimin e zhvillimit specifik të velareve dhe palataleve në pozitë para sonanteve, që, sipas tij, është një veçori e historisë së shqipes dhe për një fqinjësi me baltishten. Kjo nuk ka të bëjë me relacionin gjenetik, po me afërsinë e baltëve me paraardhësit e shqipes. Këtu forma dakase mund të vinte natyrshëm. Në tërësi,

“lidhjet baltike me dakishten (dhe me shqipen) më duken më trimëruese se ato me trakishten”,⁴⁵

thoshte ai. Më herët, madje, Hamp-i përmes analizës së emrit trakas *Biso* kishte provuar të tregonte, për mendimin tim me sukses, se

“trakishtja nuk mund të jetë paraardhës gjenetik i shqipes”.⁴⁶

Duke dhënë shpjegimet për prejardhjen e këtij emri (*Biso*) nga **bhidh-t(ó)-*, ai e shihte të nevojshme të ikte nga kurthi i barazimit të trakishtes *-s-* me shqipen *-s-*, sepse, siç e dimë nga historia e huazimeve sllave dhe nga rindërtimi i brendshëm, nga mesi i mijëvjeçarit të parë pas Krishtit paraardhësi i *s-së* së sotme do të ketë qenë afërsisht diçka si [č]. Kjo do të thotë se trakishtja nuk e kishte të përbashkët me shqipen zhvillimin e grupit **tt*, edhe pse në të dy rastet kemi *s*. Dallimi i dilte dhe kuptimor: **bhoidh-ā*, si lat. *toga* – be; **bhidh-tó-* gr. ‘besues, besnik’, ku hyn dhe *Biso*; **bhidh-tí-*, **-tā* (shqip) – *besë*.

Për ta parë më afër mënyrën e rindërtimit të raporteve shqipe-baltike sipas Hamp-it le të shohim rastin e rrënjës IE **leugh-*, që ka shërbyer për të shpjeguar *hélos Lougeon* të Strabon-it, që është lidhur me shqipen *lëgatë* dhe format balte *liūgas* “morast” dhe *ludza*, rus. sll. k. *luža*. Me këtë rrënjë ai lidhte një numër fjalësh në shqipen: folja *lag* me derivatet *lagët* nga

**loug-* - **laug* > *lag*;

emri *lagë* nga **lougā*;

këtu shihet të *larat* (menstruacionet) - nga derivat. **lougā* asnj. sh.;

⁴⁵ “... Baltic connections with Dacian (and with Albanian) lok to me more encouraging than thoshe with Thracian”, f. 368.

⁴⁶ “... that Thracian cannot be a genetic ancestor of Albanian”, f. 368. Hamp 2007: 398.

lang < **laung-* < *laugno-* < **laug-no-* si te *bung, fagus*;
 përmes **lukta-* > **lut-* nga **lug-to-* me prapashtesën **-tja – lucë*;
 pastaj *lumë* prej **lug-mōn-*;
 **lougro-*, **lug-ro-* del te **leugro-/ legura* > *lerë*.

Të gjitha këto lidhen me lit. *liūgas*, që lidhet me *lug-*, *liaug-* < **leug-*, pra **leugh*.⁴⁷

Qysh në *The position of Albanian* (1966) Hamp-i e kishte vënë në pah veçimin e Jokl-it të raporteve midis shqipes dhe gjuhëve balto-sllave, problematikë që nuk u hoq nga vëmendja asnjëherë, por që nuk u shterua. Kësaj çështjeje iu kthyen më se një herë A. V. Desnickaja, E. Çabej dhe vetë E. Hamp-i. Në studimin e gjatë "*Kush ishin tokarët? Nëngrupimi gjuhësor dhe idiosinkrezia diagnostike*",⁴⁸ E. Hamp-i shtronte çështje me rëndësi në aspektin që na intereson këtu. Përveç shumë shënimeve në raportet e shqipes me tokarishten dhe me gjuhët e tjera IE, ai këtu i trajtonte në mënyrë të veçantë raportet e shqipes me balto-sllavishten,⁴⁹ ai fliste për një grupim të ri të gjuhëve IE, që e quante N(orth)W(est)l(Indo-)E(uropean), e që i atribuonte natyrën e Sprachbundit në raportet midis tyre. Siç e ka shprehur në një artikull më herët, aty ai përfshinte gjuhët: keltike, itallike, frigase, mesape, 'ilire', tokare, gjermanike, para-helenike, albanike, dakase, trakase, baltike, sllave.

Është e qartë se trakishtja mund të cilësohet si tipikisht *satəm*, por po ashtu është e qartë se satemiteti as është thëllësisht diskriminues, siç mendohej, as kohësisht proces i njëjtë në të gjitha gjuhët. Shembulli që jepte Hamp-i për të treguar relativitetin e zhvillimeve të tilla është vetëfolës: le të dëgjojmë shqipen <*q*> duke shkuar nga Ohri

⁴⁷ Eric P. Hamp, *Indo-European *laugh- in the Ponto-Baltic Region*, in *Ponto-baltica* 2-3, 1982-83, Academia Toscana di Scienze e Lettere "La Colombaria", ff. 7-8. Shqip te Hamp 2007: 403-406.

⁴⁸ Të botuar në Mair, Victor H. (ed.): *The Bronze Age and Early Iron Age Peoples of Eastern Central Asia*, Volume One: Archaeology, Migration and Nomadism, Linguistics, The Institute for the Study of Man in Collaboration with The University of Pennsylvania Museum Publications, 1998, pp. 307-346.

⁴⁹ Hamp (1998), f. 321-322.

në Mal të Zi dhe rrugës do të ndeshim [c, ć, ś]. Po shkuam nga Greqia mund të dalë dhe [c]. Mbetet të pyesim: megjithë argumentimet e Hamp-it, a mund të mbështetemi në kritere të tilla për të diferencuar gjuhë që në çështje të tjera nuk i njohim?

Kur jemi te mesapishtja, le të kujtojmë disa momente nga studimi i Hamp-it i vitit 1957 (Hamp (1957: 73-89, shqip te Hamp, Eric P.: 2007: 147-170).

“Nuk mund të ketë dyshime se mesapishtja dhe ilirishtja janë gjuhë motra, edhe pse të ndara mbase me një gjysmë mijëvjeçari divergjencë dhe se në përgjithësi ajo që themi për mesapishten vlen me siguri edhe për ilirishten” (Përkthimi te Hamp 2007: 148).

Qysh atëherë ai mendonte se ilirishten duhet ta kuptojmë vetëm si të vendosur në Adriatikun lindor dhe në zonat dardane, mbase deri në Danub, jo ashtu si e kishin kuptuar Pokorny e vijuesit e tij, çka ishte kritikuar qysh nga Whatmough (*Word* 6. 242 (1950). Ai atëherë konsideronte se mënyra se si e kishin shtruar çështjen e pellazgjishtes Georgiev-i dhe van Windekens-i ishte e lehtë dhe spekulative, prandaj i dukej e rrezikshme dhe e dëmshme të përdroreshin ato të dhëna nga hapësira greke lidhur me vështrimin e problemit ilir. Prandaj mbeten probleme edhe lidhur me emërtimet pellazgjishte, trakishte, makedonishte, keltishte e lepontishte (në raport me ilirishten), ‘Alteuropäisch’ (H. Krahe (1954)), etj. Kuptohet që venetishtja donte përjashtuar nga shqyrtimet mesapo-ilire, sepse analizat kishin treguar se ajo i përkiste familjes italike (Këtu Hamp jepte këtë indikacion: Hamp (1954), 183-186 (1954), literatura e cituar atje; korpusi në proces ribotimi nga Lejeune; shih *Latomus* 13. 117-28 (1954) dhe artikujt parashkues; shqip te Hamp 2007: 149. H. Krahe (1954), Hamp 1957: 74, Hamp 2007: 149).

Më tej ai theksonte se në kohë të Jokl-it mungonte një botim i përgatitur mirë i mbishkrimeve mesapike, ashtu si dhe rezultatet e studimeve leksikore dhe për prejardhjen e shqipes që ishin arritur ndërkohë. Pas këtyre studimeve dhe me pasqyrën që kishte bërë W.

Porzig-u për nyjëtimin e dialekteve IE Hamp-i mendonte të arrinte rezultatat në vijim. Dy konsiderata i dukeshin me rëndësi:

1. Është folur për afrinë farefisnore midis trakishtes e ilirishtes, ose më mirë për emërtime të ndryshme socio-politike për një njësi gjuhësore. Kjo çështje tashmë ishte kapërcyer, por raporti midis shqipes e ilirishtes nuk është i atillë që të përjashtojë afrinë midis ilirishtes e trakishtes, nëse kjo mund të dëshmohej. Ndërkaq, lidhjet e supozuara shqipe-ilirishte-trakishte-frigjishte-armenishte nuk japin ndonjë dëshmi (Hamp 1957: 76).

2. Sipas Porzig-ut ilirishtja mbahej e afërt me indoeuropianishten perëndimore; më e afërt me këtë njësi se me greqishten; në leksik, p.sh., fjala *burrë*, e afrueshme me gjermanishten e lartë të vjetë *gibur(o)* i përket '*komponentes ilire të shqipes*'; ilirishten e ndajnë nga shqipja: shqipja ka të përbashkët me keltishten zhvillimin IE $*r > ri$, ndërsa ilirishtja ka 'zanore me ngjyrë të errët' (të prapme); meqenëse shqipja është *satəm*, sakohë që ilirishtja merret si *centum*, ajo nuk mund të jetë paraardhëse e shqipes.

Sipas Hamp-it, komenti lidhur me greqishten është i qëndrueshëm; sakohë që Porzig-u e përjashton balto-sllavishten nga grupi perëndimor IE, gjetjet e tij për ilirishten janë në variacion me atë që ka hetuar Jokl-i për shqipen e balto-sllavishten; një refleksi i $*r$ është *ri*, por në shqipen mund të ndeshet dhe *ur*; zhvillimi i sonanteve të tjera është më i errët; për *satəm-centum* ka zhvillime të veçanta;

"argumentet e sjella kundër afrisë së ilirishtes me shqipen nuk janë aspak të forta", (përkthimi shqip te Hamp 2007: 152),

thoshte Hamp-i. Kjo do të thotë se mbetet vetëm materiali leksikor, dhe ai mund të shihet si huazim, sipas Porzig-ut.

Më vonë Hamp-i sikur e la anash lidhjen e mundshme të shqipes me ilirishten, sado që ideja për afrinë e shqipes me mesapishten erdhi e iu forcua. Megjithë dyshimet e përgjithshme për 'ilirishten', që ka mundësi të lidhen drejtpërdrejt me fazën e kritikës së 'iliromanisë', më duket sikur

kanë mbetur pa shpjegim në lëvizjen drejt *albanoïdishtes* apo dako-mezishtes çështje si sasia dhe natyra e huazimeve latine të shqipes në raport me rumanishten dhe dalmatishten, po edhe me gjuhët romane perëndimore, pastaj huazimet nga greqishtja e vjetër, forma të sotme të toponimeve si *Mat, Durrës, Tomor, Shar, Ishëm, Nish, Shtip*, që mund të flasin për një shtrirje të mundshme të shqipes së hershme në zona që nuk rezultojnë të përputheshin me hapësirat dako-meze. Megjithë deprëtimet me interes jo të paktë në analizat fine etimologjike, mbeten dyshime lidhur me të përgjithshmen. Përballë indiceve të natyrës arkeologjike-historiko-kulturore e gjeografike për lidhjet e mundshme të shqipes me ilirishten, çkado që të fshihej pas këtij emërtimi, duken të kërkuara supozimet pa indicie për shtrirjet karpato-danubiane, etj. Për më tepër, afritë e shqipes me baltishten nuk duken aq vendimtare, sepse shumë të hershme patjetër. Për më tepër, më vonë vetë Hamp-i thoshte se tani i ishte pjekur edhe më shumë bindja për afritë e shqipes me mesapishten. Kjo do të thotë se termat për shënimin e gjuhëve të lashta të Ballkanit, siç u citua ta thoshte ai vetë, vërtet duan marrë me rezervë, duke kërkuar gjithnjë të shihet përmbajtja konkrete që u jepet. Pra edhe në rastin e proto-albanoïdishtes, të dakishtes, dako-mezishtes, të ilirishtes, etj. Megjithatë, ai shkonte përtej kësaj dhe në përcaktimin e grupit indoeuropian verior shqipen e vendoste mjaft larg nga 'ilirishtja', duke i rezervuar kësaj të fundit një vend më në perëndim.

Siç u pa në shënimin e mësipër, edhe Desnickaja, derisa fliste për lidhjet e hershme të parashqipes me gjuhët në veri të Europës, kishte parasysh relacione areale, jo gjenetike, sidomos me gjermanikishten. Duke qenë se të tilla lidhje, që ajo shihte në raportet e shqipes apo të ilirishtes me gjermanikishten në ato faza të hershme, në rastin e trako-dakishtes nuk ishin vërejtur, kjo vetvetiu, mendonte ajo, flet për prejardhjen e shqipes në raport me gjuhët paleoballkanike.

Hipoteza e Hamp-it për NWEIE dhe konceptimin e tij si grupim areal, po edhe vështrimet e tij të përgjithshme për relacionet gjenetike në grupimin verieuropian nuk ka mbetur pa u diskutuar dhe nga

të tjerë. Harvey Mayer-i në revistën *Lituanus* ka botuar një numër artikujsh për nevojën e studimit të raporteve ballkano-baltike, në radhë të parë të shqipes dhe të trakishtës-dakishtës. Për to shih më sipër.

PREJARDHJA E GJUHËS DHE E POPULLIT SHQIPTAR - REFLEKSE PËR DISA IDE TË SHFAQURA NË STUDIMET HISTORIKE

Aleks Buda si përfaqësues i një rryme studiuesish

Ndryshe nga kolegët apo nxënësit e Aleks Budës, që kanë dëgjuar nga afër idetë e tij dhe bashkëpunuar me të në procese të ndryshme, edhe hulumtuese, unë kam pasur mundësi ta njihja atë vetëm ndërmjetshëm, përmes mikut të tij Eqrem Çabej, apo përmes paraqitjeve të tij më shumë protokollare publike dhe, natyrisht, vetëm përmes shkrimeve. Në perceptimet e mia, debordimet përtej fahut të ngushtë të historianit pozitivist janë ato elemente shtesë që veprën historiografike të Aleks Budës e bëjnë të dobishme për fushat e afërta. Nga studiuesit e historisë kam mësuar se Aleks Buda në shkencat historike shqiptare ka luajtur një rol më të gjerë se të një studiuesi, rolin e orientuesit të studimeve më parë se të hulumtuesit me rezultate konkrete. Mbase kjo mund të ketë qenë një nga arsyet për vlerësimet e ndryshme, madje të kundërta për punën e tij shkencore e tjetër. Nuk është në synimin tonë të merremi këtu me aspekte të tilla, por për lexuesit po referojmë se ka vlerësime nga të tjerët.¹

Duke studiuar veprimtarinë e gjuhëtarëve Eqrem Çabej, Selman Riza, Mahir Domi, sikur kam arritur të nëpërkuptoja një aspekt për mua me interes: për A. Budën dhe brezin e intelektualëve shqiptarë të shekullit XX, që në jetën publike po vinin në një kohë kur ishte for-

¹ Diçka mund të shihet në kujtimet e Budës, Haxhimihali (2005). Për mendim ndryshe e vlerësime të natyrës ideologjike shih Schmitt (2003), 143-166. Shih dhe Bartl (2000).

muar shteti i Shqipërisë në kufijtë londinezë, me gjysmën e popullit shqiptar të mbetur jashtë këtij shteti në mëshirën e shteteve serbe/jugosllave e greke, gjithnjë e më shumë po shtrëngonte situata thellësisht kundërthënëse: në një anë ishte shteti i ri me kërkesat për ndërtimin e jetës dhe të shoqërisë në kuadër të tij si shtet kombëtar, në anën tjetër gjysma e kombit e mbetur jashtë tij në gjendje për-t'u-vajtuar. Një kundërthënie e tillë jo gjithmonë e kuptuar midis efekteve të arsyes së shtetit (*raison d'État*) e të shtetasve, që duhej t'i shtroheshin asaj medoemos, në njërën anë, dhe intelektualitetit të lartë me të gjitha premisat e përgjegjësisë morale, në anën tjetër. Kur kësaj i shtojmë faktin se Buda tërë formimin e kishte marrë në Austri, madje duke shkuar në atë mjedis në moshë krejt të vogël, kur ishte, si thoshte vetë, *"si një fletë e pashkuar"*, në të cilën do të mbriheshin idetë e profesorit të tij austriak me orientim politik dhe botëkuptimor të majtë, i cili u mor me Aleksin qysh herët, kur t'i marrim parasysh të gjitha këto, nuk është e vështirë të merren me mend aspektet dramatike të botëkuptimit të një të riu që po kthehej në vend me entuziazmin e rindërtimit të tij dhe me kufizimet drastike, për pasojë edhe shndërrimet e mëvona nëpër shtrëngesa e kompromise të të gjitha llojeve. Pa këtë refleks dhe pa refleksin për shtrëngesat që sillte interpretimi klasor i një marksizmi rigjid të variantit bolshevik në dijet shoqërore në Shqipëri, duket e vështirë të kuptohen drejt përmasat e arritjeve të këtyre dijetarëve. Për një vlerësim kritik të figurës dhe veprës së Budës sidomos nga aspekti i ideologjisë dhe i ndikimeve të saj të mundshme në dijet dhe orientimin shkencor shih Schmitt (2003). Kuptohet që perceptimi ynë indikon dhe nuanca e aspekte të tjera që lidhen me vlerësimin e ideve dhe të mendimit të këtij dijetari që ka luajtur një rol me rëndësi në historiografinë shqiptare të rreth gjysmë shekulli. Këtu do të përpiqemi të vëmë në pah vetëm disa elemente të një segmenti për ne të rëndësishëm të mendimit të tij, gjithnjë me përpjekje për të dalë përtej dhe jashtë kornizave ideologjike, ose së paku duke i bërë ato eksplicite.

Çështja e prejardhjes së popullit shqiptar tërhoqi vëmendjen e

A. Budës prej kohësh.² Krahas punës në fushën e historisë së mesjetës së hershme, ku mungesën e theksuar të dokumenteve studiuësit si Buda janë të shtrënguar ta superojnë për një pjesë duke qenë të ndihmuar nga arkeologjia gjithnjë në rritje në ato vite në Shqipëri, të ndihmuar sidomos nga studimet e thelluara e të gjithanshme në fushën e gjuhës të Eqrem Çabejtë, Buda kishte arritur të krijonte dhe një interpretim dhe bindje për prejardhjen e popullit shqiptar nga ilirët e jugut. Buda nuk ka lënë studime specifike të specializuara në këtë fushë, po më parë vështrime sintezë me përpjekjen për të integruar vështrimet e historianit të lashtësisë me të parahistorianëve e arkeologëve dhe gjuhëtarve. Në këtë mënyrë vrojtimit e tij marrin dhe një peshë më të përgjithshme, atë të historianit që synon të vendosë kornizat dhe orientimet e hulumtimeve të një fushe. Kuptohet që sa i përket gjuhësisë ato nuk mund të jenë me status të atillë. Mund të besohet po ashtu diçka e tillë për fushën e arkeologjisë.

Meqenëse, sipas tij, prejardhja e gjuhës dhe e popullit në këtë rast duken të pandashme, kjo pikëpamje bëhet e rëndësishme dhe për gjuhëtarët. Përfundimet e tij i mbështeste në vrojtimin e kompleksit të të dhënave dhe në interpretimin e tyre shoqëror, etnografik, kulturor, historik, arkeologjik, gjeografik, duke theksuar në mënyrë të veçantë aspektet gjuhësore. Interpretimet e tij, në vazhden e rezultateve të arkeologëve dhe të historianëve të lashtësisë si S. Anamali, S. Islami, H. Ceka, F. Prendi e të tjerë, merren me proceset e formimit të ilirëve, duke lënë të supozohet se në ato procese të gjata duhet të merret parasysh dhe elementi para-ilir për proceset e formimit të ilirëve dhe të historisë së tyre me referime të ideve të autorëve të tjerë.³ Buda e bënte të vetën hipotezën e arkeologëve pas së cilës etnosi ilir nuk u formua në një vatër jashtëballkanike për të ardhur pastaj në Ballkan bashkë me kulturën e hekurit, diku nga Euro-

² Shih Buda, A. (2006): 11-18; 78-101, 102-118 dhe tërë pjesën 11-145.

³ Shih Buda 2006; Anamali & Biçoku & Duka & Islami & Korkuti & Naçi & Prendi & Pulaha & Xhufi 2002: 39-195; Anamali 1984: 65-94; Prendi & Zheku 1984: 106-116. Për një konceptim të ndryshëm shih: Garašanin 1988: 9-80; Papazoglu 1988: 145-172).

pa e Mesme e Veriore, por qe një formim autokton në Ballkan:

“në trevën shqiptare qysh nga koha e bronzit, mbi bazën e një kompleksi kulturor ballkano-anatolik”.

Kjo jep mundësi që në aspektin arkeologjik të shihet në dritë të re *“lidhja e ilirëve dhe e gjuhës së tyre me popullsitë e lashta parahele- ne, protoindoeuropiane të Ballkanit”.*

Këto ide duken sikur marrin parasysh supozimet për pellazgët dhe lidhjet eventuale të ilirëve me ta, më tej në përputhje me mendimin e arkeologut M. Korkuti, për të cilin, bashkësia e gjerë e formuar në Ballkanin Perëndimor gjatë Eneolitit mund të quhet pellazgjike. Këta pellazgë, në vështrimet e tij, nuk kanë qenë homogjenë në aspektin gjuhësor; në gjuhë ata kanë pasur kryesisht elemente indoeuropiane dhe pjesërisht joindoeuropiane (shih Korkuti 2003: 18-25; Frashëri 2013: 170 e në vijim).⁴ Në kalimin nga Neoliti në Bronz, sipas Korkutit shfaqen tumat. Por elementi etnokulturor eneolitik, sipas Korkutit, mori pjesë në formimin e etnosit ilir gjatë epokës së bronzit. Siç shënonte dhe citonte Frashëri, sipas tij,

“ky përbërës është edhe nyja lidhëse midis banorëve ilirë të epokës së bronzit dhe të banorëve të tejlashtë të epokës eneolitike të parailirëve, të cilët i quajtmë konvencionalisht pellazgë” (Korkuti 2003: 25; Frashëri 2013: 171).

Frashëri idetë e Korkutit nga Kuvendi I i studimeve ilire i përmbledhte si vijon:

“Shkurt, ilirët, sipas Korkutit, nuk kanë ardhur as nga vatra fillestare e stepave jugore të Rusisë, as nga trevat e Europës qendrore, por janë popullatë autoktone me origjinë të hershme joindoeuropiane, por të indoeuropianizuar në Ballkan gjatë mijëvjeçarit III p.e.r.” (Frashëri 2013: 149).⁵

⁴ Ky konceptim të kujton atë të M. Budimir-it, pas të cilit miksoglotia është gjendje e zakonshme, jo idioglosia. Megjithatë, te Korkuti nuk gjejmë asgjë konkrete.

⁵ Kjo e bën të kuptueshëm qëndrimin e Çabejtë që të mos fliste lidhur me ide të tilla në librin e tij *Hyrje në historinë e gjuhës*, për çka Korkuti e të tjerë e kishin akuzuar përmes fletërrufeve për injorim të arkeologjisë vendëse.

Nga ana tjetër, sipas Frashërit, Frano Prendi, arkeolog i shquar, fillimin e etnosit ilir nuk e kërkonte te popullatat parailire të Ballkanit Perëndimor. Lëvizjet e studiuara për qeramikën dhe për mënyrën e varrimit në tuma ai i interpretonte ndryshe, si të sjella përmes dyndjes së madhe indoeuropiane në Ballkan rreth fundit të mijëvjeçarit III dhe fillimit të mijëvjeçarit II p.e.r. Me këtë dyndje Prendi, sipas interpretimit të Frashërit, kishte parasysht shtegtimin e ilirëve në Ballkanin Perëndimor në fillim të epokës së bronzit (Frashëri 2013: 172).

“Shkurt, sipas Frano Prendit, ilirët shfaqen në Ballkanin Perëndimor si gjymtyra të popullatave indoeuropiane, të cilat shtegtuan në Europën juglindore në fillim të epokës së bronzit” (Frashëri 2013: 174).

Valët IE sipas Gimbutas-it

Çështja e etnogjenezës së ilirëve duket më komplekse se paraqitja e këtushme, ndërsa studiuesit për të duket të mos kenë përfytyrime të njëjta gjithandej. Për këtë duan parë dhe studiues si M. Garašanin (1988), etj. Arkeologia dhe prehistoria lituano-amerikane Marija Gimbutas ka nxitur një valë të tërë idesh lidhur me vatrat e hershme dhe lëvizjet e indoeuropianëve drejt Europës. Në një studim të saj të vonë (Gimbutas 1986: 5 e vijim) jepte një pasqyrë të përmbledhur të këtyre rezultateve. Pas saj, Europa e Neolitit dhe e Bakrit (6,500-3,500 B.C.), ‘*Old Europe*’, ishte jo-indoeuropiane. ‘*Old Europe*’ e saj nuk do ngatrërruar me ‘*Alteuropäisch*’ të H. Krahe-s, që përdorej për të shënuar shtresën më të hershme indoeuropiane të emrave të lumenjve në Europën qendrore, që i përket atdheut dytësor indoeuropian në Europën qendrore. Kjo kulturë paraqet antitezën e veçorive të kuptuara me indoeuropianë të rindërtuara nga gjuhësia krahasimtare dhe nga mitologjia. Arritjet më të larta të civilizimit ‘*old-European*’ janë manifestuar në mileniumin 5 para K. Kjo kulturë dhe hapësira e saj në kulmin e lulëzimit u bënë shënjestër e pastoralistëve të hapësirës së stepave Volga-Dnjepër, ndërsa rreth një mijë vjet më vonë e pastoralistëve nga Veriu i Pontit-Veriu i Kaukazit, që e transformuan atë. Fitimtarët qenë proto-indoeuropianët luftarakë dhe mobilë, që ajo, për konvencë, i

quante popull “*kurgan*“. Valë të popujve kurganë janë shënuar në Europën e epokës së Bronzit në periudhat: 4,500-2,500 para K., e sipas kronologjisë së radiokarbonit të kalibruar konkretisht: *vala 1*, rreth 4,400-4,200 para K.; *vala 2*, rreth 3,400-3,200 para K. dhe *vala 3*, rreth 3,000-2,800 para K. Secila valë solli efekt kurganizimi të popullatës lokale me ndryshime të konsiderueshme kulturore. Ky proces transformimi është sinonimik me atë të indoeuropianizimit. Evidencat arkeologjike, mitologjike dhe gjuhësore flasin për fitoren e strukturave shoqërore patriarkale mbi matrifikalitetin dhe mbase matrilinearitetin e vjetër evropian. Popullatat kurgane sollën sistem administrativ të qendëruar në vendbanime të fortifikuara kodrinore (gradina) dhe një religjion të ri me perënditë luftarake mashkullore që dominonin panteonin e tyre (në kundërvënje me perëndeshat femërore si krijuese të Europës së lashtë). Folësit indo-europianë sollën metalin e fortë (bronzën arsenike). Ekonomia agrikulturore e Europës së lashtë u vu përballë ekonomisë pastorale të popullatës kurgane, shpesh edhe me bashkekzistencë të dy sistemeve pranë njëri tjetrit. Procesi i indoeuropianizimit ishte esencialisht kulturor, jo fizik. Mund të kuptohet si fitore ushtarake në kuptimin e imponimit të vazhdueshëm të një sistemi administrativ, të gjuhës e të religjionit mbi grupet indigjene. Organizimi shoqëror e favorizonte efektivitetin e popullatës kurgane në luftë. Struktura patriarkale e patrilineare dhe sistemi tripartit klasor i sundimtarëve, fisnikërisë luftarake dhe bujqërve përmes mjeteve gjuhësore provohet si indoeuropiane. Po kjo reflektohet në mitologji. Evropianët e lashtë nuk kishin as klasë luftarake as kuaj. Ata jetonin (mbase) në monarki teokratike të prira nga mbretëresha-priftëresha, f. 5-6. Inkursionet kurgane prodhuan një kulturë hibride. Ndërthurja e dy sistemeve shoqërore, ekonomike e simbolike karakterizon kulturat lindore të Europës Qendrore pas fundit të mijëvjeçarit 5 para K. Në jug dhe në perëndim kultura e Lashtë evropiane vazhdoi shumë më gjatë, në disa mjedise në jug si ujdhesat mesdhetare, edhe afërsisht për 3 mileniume.

Sa i përket paraqitjes indoeuropiane ajo i fillonte analizat me valën e dytë të lëvizjes kurgane të pjesës së dytë të mileniumit 4 para K. Sipas saj, njësitë kulturore që u kristalizuan në këtë periudhë kanë rëndësi thel-

bësore për etnogjenezën e grupeve të folësve të indoevropianishtes në Europë (Gimbutas 1986: 7).

Pas valës II territoret e indoevropianizuara apo pjesërisht të indoevropianizuara mbulonin tërë Europën Qendrore. Edhe pse popullatat substraciale kishin luajtur një rol të rëndësishëm në formimin e entiteteve të reja kulturore, kufijtë e përndarjes së grupeve të reja kulturore nuk përputheshin me ata të grupeve të Europës së lashtë (Gimbutas 1986: 6-7).

Me ardhjen e valës II, territoret e kurganizuara (indoevropianizuara) në Europën Qendrore formuan atdheun e dytë si djep prej nga u nisën rrezatime të reja dërguese pas 3,000 para K. Tronditje e re u shkaktua nga vala III kurgane, me inkursionin e pastoralistëve nga stepat e hapësirës Dnjepër-Volga në Europën Qendrore lindore e në Hungarinë verilindore në perëndim e në Bullgari në jug. Europeanët qendrorë lëvizën tani drejt veriperëndimit apo verilindjes dhe drejt perëndimit, jugut e juglindjes (lëvizja e vonë Baden-Vučedol drejt Italisë, Shqipërisë dhe mbase përgjatë bregdetit deri në Peleponez). Pas proceseve të përsëritura të hibridizimit me popullatat indigjene u formuan njësi të reja kulturore dhe ndoshta u zhvilluan edhe degë të reja gjuhësore. Këto do të bëheshin grupet veriore dhe jugore të familjeve folëse të indoevropianishtes: gjermanike, baltike dhe greke. Popullata e mbetur e Europës Qendrore qëndroi në një rrafsh relativisht të padiferencuar deri nga epoka e mesme e Bronzit (sh. XV para K.) dhe te epoka e vonë e Bronzit (sh. XIII para K.), kur lëvizi drejt perëndimit, jugut dhe juglindjes.

“Formimi nga bërthama evropiane qendrore i grupeve kelte, italiane, venetike, ilire, frigase, sllave, shqipe e armene me siguri nuk e kalon mesin e mileniumit II para K.” (Gimbutas 1986: 7).⁶

Këtu Gimbutas diskutonte idenë e Hans Krahe-s (1957) për shtresën e hershme të emrave të lumenjve në Europë, të cilën e konsideronte si indoevropianishte të hershme. Ajo shtresë shfaq korrespondenca midis

⁶ “The formation from the central European core of Celtic, Italic, Venetic, Illyrian, Phrygian, Slavic, Albanian and Armenian groups probably does not precede the middle of the 2nd millennium BC.”

emrave të lumenjve në baltishte, gjermanikishte, keltishte, ilirishte, venetishte, italikishte dhe marginalisht sllavishte. Seri të tilla emrash të hershëm janë, psh: *Ala, Alsa, Aura, Drava, Mara, Nava, Neta, Sala, Sava*, f. 8. Në bazë të atyre ngjashmërive Krahe supozonte që gjuhët në fjalë dikur kishin formuar një njësi gjuhësore në pjesën e mesme të Europës dhe se Europa Qendrore mund të konsiderohej si zonë e atdheut indoeuropian. Nëse emrat janë IE (mbase shumica), mendonte Gimbutas-i, duhet të merren si dëshmi për njësinë (unitetin) e zonës sekondare të atdheut IE, por jo primare, siç besonte Krahe (Gimbutas 1986: 9).

Indoeuropianët në atdheun e tyre të dytë, europian, nuk ishin më pastoralistët nomadë të stepave, po ishin bërë bujqër mikstë. Në mileniumin III kemi përhapje të valëve nga Europa qendrore dhe jo nga stepat Volga-Dnjepër.

Sipas Gimbutas-it, ka pasur shumë diskutime për ardhjen e indo-europianëve në Greqi dhe kjo vendoset vonë. Ardhja më e vonë e indoeuropianëve në Greqi mund të vendoset diku midis 2,900 e 2,600 para K. Një nga rrugët ishte me siguri bregu i Detit Adriatik, diku nga kultura Baden-Vučedol. Grupet luftarake indoeuropiane të vendosura në Greqi nuk ishin të shumta, por ia dolën të indoeuropianizonin kulturën lokale (Gimbutas 1986: 11).

Ekspansioni i tumulusve drejt Europës lindore qendrore e preu zhvillimin gradual të kulturës së poçerisë së inkrustuar në Hungarinë perëndimore e në Bosnje-Mali i Zi, kulturën Vatja në Hungarinë qendrore, kulturën Otomani në Transilvani dhe Periam në Hungarinë juglindore dhe Rumaninë perëndimore.

“Shtrirja e popullatave tumulus në Bosnje dhe Mal të Zi drejt jugut është thelbësore për çështjen e formimit të familjes ilire. Në të njëjtën kohë zona e Adriatikut Verior u banua nga popullata tumulus nga veriu, çka mund të shënojë lindjen e grupit gjuhësor venet, të lidhur me italikishten dhe ilirishten. Lugina e lumit Po në Italinë Veriore u banua po ashtu nga popullata prej basenit të Danubit të mesëm. Kjo nisi të ashtuquajturën kulturë ‘Terra-mare’, të ndjekur nga simbioza në Itali e kulturës indigjene Apenine me

europianen qendrore" (Gimbutas 1986: 16).⁷

Në sh. XIV-XIII para K. të gjitha këto grupe shfaqën vitalitet të jashtëzakonshëm në prodhimtarinë metalurgjike. Europa Qendrore me zgjatjen e saj në Basenin e Danubit të Mesëm u bë fuqi militare kërcënuese e kontinentit. E tërë Siujdhesa Ballkanike tani ishte nën shenjë të fuqisë militare të europianëve qendrorë. Shfaqja e bronzave të Europës qendrore në Greqi koincidoi me katastrofën e kulturës mikeniane nga fundi i periudhës IIIB heladike të vonë. Ka vetëm një shpjegim: bronzat, që në Europën Qendrore tipizonin ekipimin e prijësit dhe fisnikërinë luftarake, në Greqi i sollën luftëtarët e Europës Qendrore, f. 16. As ilirët, as frigasit as të afërmit e tyre armenë nuk u vendosën përhershëm në Greqi, por nuk mund të vihet në dyshim pjesëmarrja e tyre në fushatat kundër botës mikenase. Frigasit u vendosën në Anatoli pas shkatërrimit të perandorisë hitite. Gjuhësisht të afërmit me ta - armenasit do të kenë vazhduar më tej drejt lindjes në Anatinë Lindore. Gjatë sh. 13-12 para K. kultura e Italisë u riformësua në mënyrë drastike. Në Apuli e Kalabri u shfaqën folësit mesapë. Në Sicili kulturë të re nisën sikulët. Nga aspekti gjuhësor të dyja konsiderohen *'of Illyrian stock'* (Gimbutas 1986: 17).

Ekspansioni territorial nga Europa Qendrore drejt perëndimit, jugut dhe jugperëndimit pati konsekuenca enorme për formimin etnik të Europës. Gjithandej substratet lokale luajtën rol madhor në formimin përfundimtar të kulturës, f. 18. Territori Unetice-Tumulus-Urnenfield ishte atdheu i grupeve IE, shumë prej të cilave u zhvilluan në kultura dhe gjuhë të veçanta vetëm pasi u degëzuan nga bërthama dhe u hibridizuan me kulturat lokale substraciale. Ndër familjet me rrënjë tek kultura Unetice-Tumulus-Urnenfield janë: keltikja, italikja, venetikja, ilirikja me nëngrupet

⁷ "The extension of the Tumulus people to Bosnia and Montenegro in the south is essential to the question of the formation of the Illyrian family. Simultaneously, the area north of the Adriatic was settled by tumulus people from the north which may mark the birth of the Venetic linguistic group, related to Italic and Illyrian. The River Po valley in northern Italy was also settled by people from the Middle Danube basin. This started the so-called 'Terramare' culture, followed by the symbiosis in Italy of the indigenous Apennine culture with the central *European*".

mesape e sikeliane, albanikja, frigikja dhe armenikja. Në Europën qendrore do vendosur po ashtu proto-tokarishtja, siç sugjeron raporti gjuhësor midis tokarishtes e gjermanikishtes, sllavishtes e baltishtes.⁸

Gimbutas mendonte se për sllavët më e pranueshme është të shihet djepi i tyre në veri të Karpateve. Aty gjendet një toponimi e hershme sllave dhe vazhdimësi kulturore me poçerinë e kordeluar verikarpatiane gjatë epokës së Bronzit dhe të hekurit të hershëm. Lidhja më e ngushtë midis hidronimisë sllave e balte gjendet në jugperëndim të lumit Pripjat.

Përfundimet Gimbutas-i i përmblihte si vijon: formimi i familjeve gjuhësore IE në Europë ishte në fluks konstant nga mil. IV para K. deri nga fundi i epokës së Bronzit.

1. Ka dëshmi arkeologjike e gjuhësore për një gjendje të padiferencuar ose të diferencuar pak europiane të indo-europianëve. Kronologjikisht kjo ka të bëjë me grupet kulturore të formuara risht të gjysmës II të mil. IV para K. në Europën qendrore lindore (komplekset Amfora globulare-Baden-Coțofeni-Ezerovo të elementeve kurgan e të Europës së lashtë).

2. Shtrirja e kulturës së tipit të vonë të amforës-globulare-poçerisë kordelare të hershme rreth 3,000-2,800 para K. drejt Europës veriperëndimore e verilindore rezultoi me ndarjen e indo-europianëve veriorë. Hibridizimi me popullatat e substratit prodhoi familjet e folësve gjermanikë e baltikë. Infiltrimi në Greqi nga Europa qendrore jugore, mbase nga kultura Baden-Vučedol, dhe përzierja me kulturën heladike të hershme II-III të mil. III para K. rezultoi me formimin e grekëve mikenas (Gimbutas 1986: 19).

3. Bërthama e grupeve të mbetura indo-europiane ishte kultura

⁸ Këtu do vërejtur se koncepti pas të cilit grupet e popullatave ilire do të kenë depërtuar nga veriu, kryesisht i Adriatikut, pra nga Europa Qendrore pas një ardhjeje nga një fazë më e hershme më tej nga veri-lindja, sikur na jep koordinata të tjera për raportet e grupeve gjuhësore ballkanike (ilire, trakase, frigase) midis tyre gjatë vendosjes në Ballkan dhe në periudhën paraballkanike. Këto mund të bëhen bazë për interpretime të tjera. Kuptohet që nuk ka qenë gjithnjë e mundshme të vendosen korrespondenca të sakta midis lëvizjeve gjuhësore dhe të kulturës.

Unetice-Tumulus-Urnenfield e periudhës së bronzit nga Europa qendrore. Përhapja territoriale rreth 1,500 para K. (tumulus) dhe rreth 1,250 (Urnenfield) nga Europa qendrore drejt Italisë dhe Siujdhesës Ballkanike dhe përzierja me kulturat e substratit (në shumicën e rasteve të indoeuropianizuar, si poçeria e inkrustuar, Otomani e Vatya) përfundoi me formimin e familjeve të reja, midis tyre: *italike, venete, ilire, albane, frigase dhe armene*. Kthimi i popullatës Urnenfield nga baseni i Rinit të epër i çoi protokeltët drejt Francës e Iberisë (Gimbutas 1986: 19).

4. Sipas modelit balt, demonstron se identifikimi i familjeve të hershme të folësve IE është i vështirë pa përdorur elementet gjuhësore, ashtu siç është e vështirë të bëhet pa evidencat arkeologjike, të hidronimisë e të toponimisë. Rezultatet e hulumtimeve antropologjike fizike lidhur me çështjet etnogjenetike kanë rëndësi të madhe për të provuar migrimet dhe persistencën e elementeve të substratit (Gimbutas 1986: 19).

Dua të shtoj me këtë rast se një adoptim të posaçëm të teorive të Gimbutas-it në studimet gjuhësore e kishte bërë A. Martinet në konceptimet e tij për lëvizjet e popujve indoeuropianë.⁹


Ilirët sipas Čović-it

Në të njëjtin vëllim për etnogjenezën e popujve europianë, Borivoj Čović vinte me një studim përmbledhës për etnogjenezën e ilirëve nga aspekti i parahistorisë dhe historisë së hershme (Čović 1986). Në kuptimin historik të fjalës ilirët ishin populli që krijoi shtetin ilir. Ky shtet në lashtësi shtrihej midis Epirit dhe gjirit të Kotorit, apo edhe pak më tej në veri.

Čović-i bënte dallimin midis kuptimeve etnografike dhe politike të termave *ilir* dhe *ilirishte*. Ky i fundit lidhet me krijimin dhe zhvillimin e shtetit ilir. Hapësira që i përkiste këtij shteti duhet të shihet në kuptimin politik të ngushtë të fjalës si Iliri, thoshte ai, duke iu referuar qartazi konceptit të përdorur nga Fanula Papazoglu.

⁹ Martinet 1986, A.: *Des steppes aux océans*, cf. Ismajli 1994.

Sa i përket përdorimit etnografik të termave 'ilirë' dhe 'ilirisht', sipas tij, mund të thuhet se zhvillohej paralelisht me politikun, por kishte kuptim më të gjerë dhe shtrihej në një hapësirë më të gjerë. Qysh tek Hekateu termi *ilirë* përdorej si emërtim i përbashkët për më shumë grupe popullatash dhe territori i tyre shtrihej afërsisht nga kufiri verior i Epirit në jug deri te lumi Drilon në veri. Diçka të ngjashme ndeshim edhe tek Herodot-i. Koncepti gjeografik i Ilirisë për grekët e kohës së tij përfshinte një hapësirë që në veri shkonte deri tek ujëndarja e Adriatikut dhe Detit të Zi.



Kështu paraqitej gjendja sipas Čović-it: "Ilirët" dhe "panonët" sipas konceptimit të kohës së Augustit (Strabo-Appian). 1. Shtrirja e shtetit ilir; 2. "Illyris" sipas grekëve.

Në shekujt në vijim autorët grekë e shtrinë përdorimin e konceptit 'ilirë' në veriperëndim në popuj të tjerë më tej. Në sh. 3 nën emrin *ilirë* përfshiheshin edhe *autariatët* dhe *ardiejtë*, kështu që Iliria e kësaj kohe përfshinte edhe territorin e sotëm të Malit të Z, mbase edhe hapësirat

në kufi të Bosnjës Jugore dhe të Serbisë Jugperëndimore dhe hapësirat bregdetare të Adriatikut deri te lumi Neretva. Nga fillimi i sh. I para Krish-tit, sipas autorëve grekë, Iliria shtrihej edhe pak më në veri deri te lumi Cetina. Asnjë burim më i vjetër se pushtimi romak i Ballkanit nuk i numëron si ilirë popujt që banonin në Adriatikon verior dhe në prapavijën e tij: *liburnët, histriotët, japodët* e të tjerë. Nga diskutimet e tilla ai nxirrte përfundimin se emërtimi grek *Illyrioi* dhe *Illyris* edhe në kuptimin më të gjerë shtrihej vetëm mbi një territor të kufizuar midis Epirit dhe lumit Cetina, ndërsa në brendi arrinte deri atje ku këto hapësira paraqisnin sferë interesi për historianët, gjeografët dhe udhëpërshkruesit grekë. Ky ishte koncepti i fillmë etnografik grek për ilirët dhe Ilirinë, thoshte Čović.



Grupet kulturore në Ballkan në kohën e ‘fushave të urnave’. 1. Hapësira e fushave të urnave; 2. grupet e kulturave të “kompleksit jugor”. Nga veriu në jug: grupi i hershëm japod; grupi i hershëm liburn; grupi i Bosnjës së mesme; grupi i mesëm dalmat; grupi Glasinac; grupi dalmat jugor; grupi Gajtan-Mat i hershëm; Grupi i Shqipërisë jugore (Devoll), sipas Čović 1984.

Vetëm pas pushtimit romak të Ballkanit veriperëndimor dhe të hapësirës danubiane zgjerimi i përdorimit të konceptit *ilirë* dhe *Iliri* mori përhapje më të gjerë. Konceptit të dikurshëm *ilirë* dhe *Iliri* si shtet dhe si hapësirë më e gjerë gjeografike i përgjigjej koncepti *Illyricum* dhe shënon-te një shtrirje të gjerë politike dhe hapësinore administrative romake. Paralelisht me pushtimet romake edhe koncepti *Illyricum* u zgjerua. Kështu koncepti *Illyricum* përfshiu një zonë të gjerë administrative nga Deti Adriatik e deri te bregu i Danubit. Kufiri midis ilirëve e panonëve sipas Strabon-it shkonte afërsisht tek ujëndarësi i detit Adriatik. Edhe fiset panone më në veri numëroheshin si ilire dhe kjo mund të ketë qenë e lidhur edhe me shërbime për doganat. Burimet më të rëndësishme, pra Strabon-i dhe Appian-i, nuk jepnin pasqyrën e një etnosi njësor ilir në hapësirën midis Adriatikut dhe Danubit, mendonte Čović-i. Përkundrazi, ata shënonin numër të madh grupesh etnike me emrat e tyre. Por ata dallojnë midis tyre dy koncepte: *ilirët* në jug dhe në perëndim dhe *panonët* në brendi dhe në pjesët veriore.

Përfundimet Čović-i i përmblihte vetë: 1. Kishte një bërthamë të ilirizmit, që shtrihej krejt në jug të hapësirës. Ajo përputhet me territorin e shteti ilir në kohën e lulëzimit më të madh. Kësaj duhet t'i shtohen disa hapësira fqinje, që nuk ishin pjesë të shtetit ilir, por që shënoheshin si ilire. Kjo hapësirë përfshinte kryesisht zonat midis Epirit dhe Liqenit të Ohrit në jug dhe jugperëndim dhe të Grykës së Kotorit apo të lumit Neretva në veri, përfshirë hapësirat e burimeve të Ibrit, të Pivës dhe të Tarës në Verilindje. Duket e besueshme që kjo hapësirë të jetë banuar nga fise të afërta përnga prejardhja, zakonet dhe gjuha, kështu që këta banorë mund t'i quajmë ilirë në kuptimin e ngushtë të fjalës, mendonte ai. 2. Zgjerimi më i vonë i konceptit *ilirë* dhe *ilirishte* erdhi nga jashtë, së pari nga autorët grekë e më vonë romakë. Përmbajtja vinte gjithnjë e më shumë gjeografike dhe më pak etnografike. Hapësira administrative romake "Illyricum" përfshinte më shumë grupe popullatash, të cilat me ilirët burimorë as përnga prejardhja as përnga zakonet, as përnga gjuha nuk ishin të afra, duket e besueshme. Prandaj ato nuk mund të njehen ndër ilirë. 3. Vlerësonte dallimin e grupeve kryesore popullore, në veri panonët, në jug ilirët. Mbe-

ten dilemat se deri ku shtriheshin ilirët, deri te Neretva, Cetina apo deri te caput Adriae? Referonte dhe konceptimet e Katičić-it 1964 e De Simone-s 1973. Simpoziumi i Sarajevës i vitit 1964, pas tij, bëri një hap përpara në këto pika: studimet për ilirët po sillleshin aty ku përkasin, në Ballkanin Perëndimor; u theksua se bartësit e kulturës së fushave të urnave nuk mund të lidheshin me ilirët; u kundërshtua besimi se etnogjeneza e ilirëve zinte fill në Ballkanin perëndimor; u tha se fjala ishte për një proces të gjatë, fillimi i të cilit niste qysh në periudhën e Bakrit dhe të Bronzit të hershëm.

Čović kishte dhe një përfundim: në dekadat e fundit rezultatet e hulumtimeve në terren të arkeologëve shqiptarë sollën një vlerë të jashtëzakonshme. Ne këtu i raportuam shkurt përmes paraqitjes së K. Frashërit.

Budimir-i

Meqë u morëm me konceptimet e studiuesve jugosllavë, ndër të cilët, ç'është e vërteta, ka varietet pikëpamjesh dhe interpretimesh, le të themi nja dy fjalë edhe për një gjuhëtar të hershëm nga kjo zonë. Fjala është për M. Budimir-in. Ai, në të vërtetë, sillte një vështrim tjetër, më parë të një filologu klasik me formim të gjerë komparatist. Konceptimi tij lidhej me idenë e pellazgjishtes, ashtu siç e ka paraqitur gjerësisht dhe në mënyrë kritike R. Katičić-i (1976). Këtu do të përmbledhim një studim krejt të vonë të tij, që merret me vendin e shqipes në kuadër të gjuhëve indo-europiane (Budimir 1965: 5-13). Sipas tij, popujt e lashtë ballkanikë: ilirë, trakas, dardanë, makedonë e liburnë përbëjnë një grup të veçantë. Venetët që përmenden bashkë me ilirët më shpesh dalin në lidhje me sllavët, ndaj duan lënë veç. Ilirët e lashtë duhet të përcaktohen sa i përket shtrirjes, sepse për një kohë në gjuhësi sundonte lëvizja e panilirizmit. Ka dhe një ilirizëm më modest: *Illyrii proprie dicti* në jug të Bokës së Kotorit drejt bregdetit epirot. Por kjo, nga ana tjetër, është hapësirë tepër e ngushtë (Budimir 1965: 6). Vërente se Anton Majer-i i mbahej konceptimit *Illyrii proprie dicti*; edhe kur e zgjeronte pak hapësirën, qëndronte në lindje të Alpeve dhe të Adriatikut, nuk futej në Gadishullin Apenin.

“Mendoj se ai këtë e bënte për shkak të konsideratave ndaj kolegëve të tij fashistë nga Italia. Gjuhëtarëve Italianë nuk u pëlqente shumë kur flitej për dofarë ilirësh në perëndim të Adriatikut,”¹⁰

vlerësonte Budimir-i.

Por, edhe vetë gramatikanët në Romën e lashtë dinin për kolonitë ilire në Itali. Këtë e dinin ata të kohës së Augustit, por dhe më herët – Marco Pontius Caton. Në veprën *Origines* ai thoshte:

“Qyteti Pisa (që ekziston edhe sot) më herët quhej Teutana, e kishin theme-luar Pellazgët. Sipas Caton-it, Pisa ishte vendbanim ilir” (Budimir 1965: 6).¹¹

Përtej kësaj vijnë analizat gjuhësore të tij për emrin *Pisa, Teutana, Teuta me varietetet Eteudanos, Oteudanicos, pra Teudan*, si *Teutana*, IE, si got. *tiudans* nga IE *teutones* ‘popullor, që sundon popullin, sundimtar’, f. 6; bënte më tej krahasimet me gjerm. *Deutsch* nga *Teodisco*, e kjo, pas tij, do të thoshte se ata nuk ishin arianë përnga emri, por të indoeuropianizuar. Argumentet: zhvendosja e nyjëtimimit - *b, d, g* u bënë të shurdhëta *p, t, k*, ndërsa *p, t, k* u bënë aspirata.

“Kështu këta shkencëtarë nazistë shpesh kanë pasur rast të dilnin në kontradikta jo vetëm me shkencën, po edhe me veten. Por, Julius Pokorni, nxënësi i Majer-Lybkes, që nuk është gjerman i vërtetë, kështu që si ebre vienez u detyrua të ikte nga nazizmi në Zvicër, ku botoi fjalorin e tij etimologjik të gjuhës indoeuropiane, bashkë me arkeologun Pitioni, shkroi një monografi për ilirët. Sipas tij ilirët mbanin në kohë të lashta tërë Europën Jugore, nga kanali i Lamanshit e deri te Siria Veriore, nga Taurusi e te Antitaurusi. Atëherë të gjithë këlthitën se kjo ishte megjithatë tepër,” (Budimir 1965: 7).¹²

¹⁰ “Ja mislim da on to čini iz obzira prema svojim fašističkim kolegama iz Italije. Italijanski lingvisti nisu mnogo voleli kad se govorilo o nekim Ilirima zapadno od Jadrana,” Budimir 1965: 6. Denoncim i qartë për kolegun e vet.

¹¹ “Grad Pisa (koji i danas postoji) zvaog se ranije Teutana, osnovali su ga Pelazgi. Prema Katonu, Pisa bi bila ilirsko naselje”. Nuk thuhet nëse fjalët pas dy pikëve ishin të Caton-it apo të Budimir-it.

¹² “Tako su ovi nacistički naučnici često imali prilike da dodju u kontradikciju ne samo s naukom nego i sa samim sobom. Medjutim, Julius Pokorni, djak Majer-Lipkea, koji nije pravi Nemač, pa je kao bečki jevrejin morao da beži od nacizma u Švajcarsku, gde je izdao svoj Etimološki rečnik indoeuropskog jezika, zajedno s arheologom Pitonijem napisao je monografiju o Ilirima. Po njemu su Iliri držali u starija vremena celu Južnu

Sipas Pokorny-t as emri i Parisit nuk ishte kelt, po ilir, ashtu si dhe Pisa. Në këtë vazhdë referonte edhe mendimin e Bonfante-s për emrin *Baltik* të shpjegueshëm përmes *balta*, *baltë*, *blato*. Në interpretimet e tij prej filologu klasik, lidhur me emrin *Teuta* sillte dhe dëshmi për emrin *Bato*, *Batiades* “Kraljević” (*Batos* = “Mbret”), f. 8. Diskutonte dhe emra të tjerë në Sicili si *Zancle*, drapër, që e lidhte me *žeti*, *žnjeti*, gjithë duke u përpjekur të gjente krahasime me gjurmët në Sirakuza.

“Mjafton, pra, Siracuza, Zancle, Segesta dhe mbiemri saucos. Sepse secila nga këto katër shprehje e dëshmon prejardhjen ilire,” (Budimir 1965: 9).¹³

Kuptohet që sot nuk duken të pranueshme as të mjaftueshme shënimet e atilla. Por ai vijonte me argumentimin sicilian, duke rikujtuar se sipas Herodot-it, fshatarët autoktonë gjysmë të lirë, kolonët në Sicili quheshin *Killyrioi*, ndërsa te Plauti ilirët quheshin *Hilurii*. Prandaj

“paraardhësit tanë të famshëm ilirë në ato treva kanë qenë indoeuropianët më të lashtë, shumë të lëvizshëm, sepse i gjejmë jo vetëm në Ballkan, po edhe në hapësirat fqinje,” (Budimir 1965: 9).¹⁴

Dhe vijonte të përmendte në Itali japodët, japigët dhe kalabrët, galabrët nga Sanxhaku i sotëm.

Në jug të Italisë janë mesapët, që konsiderohen ilirë centum,

“edhe pse kriteri i guturaleve nuk është as i thjeshtë as i sigurt, sidomos kur dalin në kontakt me likuidet. Por në Itali ka gjurmë satemike, që të drejtojnë te Ballkani,” (Budimir 1965: 9).¹⁵

Pasi bënte dhe disa krahasime të tjera, vinte me pohimin se në Itali kishte kushërinj të ilirëve liburnë, japigë, kalabrë, mesapë e të tjerë.

“Prandaj duhet të pranojmë tezën që fiset ilire janë indoeuropianët më të lashtë në mesdhe, indoeuropianët që u paraprinë akejve më të lashtë. De-

Europu, od kanala Lamanša pa sve do severne Sirije, od Taurusa i do Antitaurusa. Ona su svi povikli da je to ipak previše.”

¹³ “Dovoljno je, dakle, *Sirakuza*, *Zankle*, *Segesta* i pridev *saukos*. Jer svaki od ova četiri izraza potvrđuje ilirsko poreklo”.

¹⁴ “Naši slavni ilirski preci bili su u tim oblastima najstariji Indoeuropljani, vrlo pokretni, jer ih nalazimo ne samo na Balkanu nego i u susednim oblastima”.

¹⁵ “... Iako kriterijum guturala nije ni prost ni pouzdan, pogotovu kad stoje u kontaktu sa likvidama. Ali u Italiji ima satemskih tragova, koji ukazuju na Balkan”.

risa ata emigruan, përkatësisht filluan të migronin, nga mesi i mijëvjeçarit të dytë të epokës së vjetër. Prandaj, ilirët janë më të lashtë se Iliada, sepse Teutamos i Homerit shfaq kalimin dytësor o/a,” (Budimir 1965: 10).¹⁶

Pas diskutimit për gjurmë të tjera, Budimir-i shtronte pyetjen: a janë shqiptarët pasardhës të ilirëve apo të ndonjë populli tjetër? Meqë hapësira e ngushtë e ilirëve *proprie dicti* përputhet me hapësirën e *shqiptarëve* toskë e gegë, mendohet se ata janë pasardhës të drejtpërdrejtë të ilirëve, sepse nuk e kanë ndryshuar vendbanimin, mendonte ai. Por nuk e linte pa diskutuar më tej kritikën e H. Hirt-it lidhur me karakterin *centum* të ilirishtes dhe *satəm* të shqipes, ashtu si me idetë atëherë të reja të Georgiev-it e të tjerëve për supozimin që thotë se shqiptarët janë të ardhur andej nga Nishi, nga hapësira dardane nga Nishi e Krushevcit deri te Danubi, madje me distancim lehtësisht ironizues:

“Linguistëve më të rinj as kjo nuk u mjafton. Linguistët bullgarë, si Dechev, nën ndikimin e Georgiev-it, i bartën paraardhësit e arbanasëve të sotëm përtej Danubit, atje në Daki” (Budimir 1965: 11).¹⁷

Në bazë të argumentit të Georgiev-it për një lumë në Moesia inferior që derdhet në Danub me emrin *Utus*, jo *Udus*, pra *d* u bë *t*, çka nuk ngjet në shqipen,

“Georgiev nxori përfundimin se ata duhet të shpërngulen edhe më tej drejt veriut, dmth. tutje përtej Danubit” (Budimir 1965: 11).¹⁸

Natyrisht, vërente se me një shembull nuk jemi në gjendje ta gjejmë kuptimin e vërtetë, e pa këtë s’ka etimologji. Por më tej diskutonte teorinë për raportet midis ilirishtes e trakishtes, raporte që nuk janë saktësuar. Aty midis tyre janë dardanët, dhe në mbështetje të etimologjisë së këtij emri nga *dardhë*, u tha se shqiptarët janë pasardhës të dardanëve.

¹⁶ “S toga moramo da prihvatio onu tezu da su ilirska plemena najstariji Indoeuroljani na Mediteranu, oni Indoeuroljani koji su prethodili najstarijim Ahajcima. A oni su se doseljivali, odnosno počeli su se doseljavati, sredinom drugog milenija stare ere. Prema tome Iliri su stariji od Ilijade, jer Homerov Teutamos pokazuje sekundarni prelaz o/a”.

¹⁷ “Najnovijim lingvistima nije ni to dovoljno. Bugarski lingvisti, kao Dečev, pod uticajem Georgijeva, prebacili su pretke današnjih Arbanasa s one strane Dunava, tamo u Dakiju”.

¹⁸ “Georgiev je zaključio da oni moraju da se sele još dalje ka severu, tj. dalje preko Dunava.”

Në kundërshtim sillte pohimin e August Fick-ut pas të cilit *Dardanos* do të thotë ‘njeri me ngjyrë të errët të flokëve dhe të lëkurës’. Sido që të jetë, sipas tij, dardanët dhe peonët janë më të afërt me trakasit. Por në peoni-shte kemi *Λυκπειῶς* ‘ujk’, pra është ruajtur labiovelari IE, ndërsa te Tito-gradi (Podgorica) kemi *Birziminium* ilir me gjurmë të besueshme satemiteti, f. 11. Këtu sillte edhe argumentin e tij me etimologjitë e përmendura, ku shihet, mendonte ai, se ato të folme IE ruajnë të tri guturalet, e prandaj paraqesin gjendjen më të lashtë të tipit gjuhësor IE.¹⁹ Përfundimi kryesor i tij këtu është:

“Prandaj paraardhësit linguistikë të gjuhës shqipe bien në atë grup që përbëjnë Pellastët në Ballkanin antik dhe që duhet të konsiderohet jashtëzakonisht arkaik dhe konservativ. Vendbanimet e hershme të paraardhësve shqiptarë nuk mund të jenë larg nga malet Scardus, emri i të cilave në sllavishten nuk e tregon atë metatezën e likuideve të cilën e shfaqin emrat ilirë në perëndimin ballkanik – Scard e Scardona – Skradin. Vokalizmi ilir me ndryshimin o/a në oronimin Scardus përkundër keltishtes Scordisci dokumentohet qysh te homeriana καρδαμύλη përkatësisht Cκαρδαμύλη në ujdhesën Hios dhe në Meseni. Varianti homerik pa s mobile në formën καρδαμύλη përballë terrenianes Cκαρδαμύλη, σκ e së cilës, pos të tjerash, në heksametrin homerian nuk përbën pozicion. Ndryshimi o/a në këtë oronim, si dhe në antroponimet Teutamos Eteudanos Oteudanikos na forcon bindjen padysishëm në konceptin që Pellastët indoeuropianë në Ballkanin e lashtë dhe në hapësirat fqinje, ku përkasin dhe paraardhësit e arbana-sëve, më të lashtë edhe se fjalori homerian dhe se helenët akajanë dhe protoakajanë, edhe pse duhet të kemi në mendje vazhdimisht se copëtimi i jashtëzakonshëm gjeomorfologjik ballkanik nuk i përgjigjet aspak evolucionit gjuhësor konvergjent,” Budimir 1965: 12.²⁰

¹⁹ Shënonte rastet e *sjel* [sjell!], nga *quel*, koradikale me *belo* e *kolo* përkundër *kohë* e *čas* nga arketipi IE **qēsā*, çka pas tij do të duhej të tregonte se indoeuropianët arbënë, ndryshe nga IE satem, dallonin qartë velaret e labiovelaret. S’ka rëndësi se edhe në shqipen reflekset e palataleve guturale IE dalin në mënyrë të veçantë, por ngjashëm me të folmet e IE të tjerë satemistë, ‘të cilët nuk dinë për asfarë dallimi midis guturaleve velarë dhe labiovelarë’, f. 12

²⁰ “S toga lingvistički precizno arbanaškog jezika spadaju u onu grupu koju čine indoeuropski Pelasti na antičkom Balkanu i koja se mora smatrati izuzetno arhaičnom i konzervativnom. Starija naselja arbanaških predaka ne mogu biti daleko od planina Scardus, čije

Kristo Frashëri për dy shkollat e arkeologëve

Te Buda vështirë se do të gjenim, e as prisnim shpjegime për të tilla çështje, por le të shohim çka mendon sot K. Frashëri *'si historian i interesuar mbi etnogjenezën e ilirëve dhe mbi identitetin e tyre etnokulturor'*, si thoshte vetë. Frashëri ka qenë pjesëmarrës në të gjitha debatet në këto fusha në kohën kur Buda ishte autoriteti në studimet historike në Shqipëri. Frashëri nisej nga vrojtimi i bërë qysh nga Bopp-i se *'ilirët i përkasin familjes etnogjuhësore indoeuropiane'*, prandaj etnogjeneza e tyre do kërkuar në vatrën fillestare, *'ku u mbrujtën popullata indoeuropiane'*. Për vatrën fillestare të popullatave IE raportonte dy teoritë: 1. Atë që këtë vatrë e shihte në stepat e Rusisë jugore; 2. Atë që vatrën e gjente në Kontinentin evropian. Për të parën jepte argumentet e ngjashmërisë së varrezave tumulare ilire me varrezat e tipit kurgan, të cilat ilirët do t'i kenë adoptuar së paku në periudhën e Neolitit të vonë, para se të shtegtonin drejt Europës. Për të dytën referonte ngjashmëritë e objekteve arkeologjike ilire të zbuluara në Europën qendrore me ato të zbuluara në Ballkanin perëndimor, ashtu si toponimet, që së bashku flasin për praninë e popullatave ilire në Europën qendrore para se të shtegtonin në Ballkan (Frashëri 2013: 175-176). Por ato nuk e përjashtojnë njëra tjetrën. Më tej ai sillte dhe idetë që ilirët i shohin të ardhur në Ballkan afërsisht nga fundi i epokës së bronzit (nga fundi i mijëvjeçarit II para e.r.), apo edhe në fillim të epokës së hekurit (nga fillimi i mijëvjeçarit I p.e.r.). Po ashtu raportonte se tash

ime u slovenskom obliku ne pokazuje onu metatezu likvida koju pokazuju ilirska imena na balkanskom zapadu - *Skrad* i *Scardona* - *Skradin*. Ilirski vokalizam s promenom *o/a* u oronimu *Scardua* nasuprot keltskom *Scordisci* dokumentovan je već u homerskom *καρδαμύλη* odnosno *Σκαρδαμύλη* na ostrvu Hiosu i u Meseniji. Homerska varijanta bez *s* mobile u obliku *καρδαμύλη* nasuprot terenskom *Σκαρδαμύλη* iste je prirode kao u epskim dubletama hidronima *Κάμανδρος* i *Σκάμανδρος* čije *σκ* uostalom u homerskom heksametru ne čini pozicije. Promena *o/a* u ovom oronimu, kao i u antroponimima *Teutamios* *Eteudanos* *Oteudanikos*, nedvosmisleno nas utvrđuje u shvatanju da su indoeuropski *Pelasti* na starom Balkanu i u susednim oblastima, kojima pripadaju i arbanaški preci, stariji i od homerskog rečnika i od ahajskih odnosno protoahajskih Helena, iako stalno moramo imati na umu da balkanska izuzetna geomorfološka iscepanost nimalo ne pogoduje konvergentnoj jezičkoj evoluciji”.

mendohet që para grekëve ka pasur dhe popullata të tjera IE qysh nga fillimi i epokës së Eneolitit apo të Bakrit (2500 vjet para e.r.).²¹ Ka dijetarë që ato popullata IE i quajnë *pellazge*, por ka edhe mendime që aty i shohin dhe *brigët* (Frashëri 2012: 177).

Frashëri më tej raportonte për kulturën e Halshtatit, pra të ilirëve të vendosur në Europën qendrore dhe për shtegtimin e tyre drejt Ballkanit perëndimor qysh në sh. XII para K. Mendohet po ashtu se ka pasur dhe një dyndje tjetër më të hershme të ilirëve nga Gjermania lindore drejt Ballkanit perëndimor, çka shihet në kulturën e Augneticit, bartësit e së cilës ndaluan në Ballkanin veriperëndimor. Këta janë quajtur *protoilirë*, ndërsa ata të Halshtatit *ilirë*. Në përgjithësi në Europën qendrore janë shënuar tri stacione të ilirëve para shtegtimin drejt Ballkanit – *Augnetic* (fillimi i epokës së Bronzit), *Lauzic* (fundi i epokës së bronzit) dhe *Halshtat* (fillimi i epokës së Hekurit), çka mund të thotë se ka pasur së paku tri shtegtime ilire drejt Ballkanit. Ato që identifikohen me kulturat e Lauzicit dhe të Halshtatit u shtrinë në tërë hapësirën ilire. Frashëri mendonte se këtyre shtegtimeve duhet t’u shtohet

“edhe një shtegtim ndoshta më i fuqishëm, i cili sipas konstatimeve të Frano Prendit duhet të ketë ndodhur në drejtim të Gadishullit Ballkanik që në fillim të kohës së bronzit, pra që në kohën e dyndjes së madhe të popullatave indoeuropiane” (Frashëri 2013: 181).

Duke folur për idetë e shprehura nga Buda në Kuvendin e ilirëve, K. Frashëri theksonte gjykimin e Budës se

“historianët, arkeologët, gjuhëtarët dhe etnografët shqiptarë kanë shfuqizuar përfundimisht tezën intuitive e romantike të etnogjenezës shqiptaro-pellazge që sundonte deri në çerekun e tretë të she. XIX dhe përforcuan pikëpamjen e gjuhëtarit të shquar Gustav Meyer, i cili pohonte që në fund të she. XIX se gjuha shqipe ishte vazhdim i një prej dialekteve të ilirishtes së vjetër...” (Frashëri 2013: 142-3).

Në dritën e supozimeve të tilla shumëçka që është ndërtuar në shkencat krahasuese-historike në raportet e shqipes me gjuhët IE të

²¹ Shih këtu Gimbutas dhe Martinet.

veriu (balto-sllave e gjermanike), me gjuhët IE të jugut (kohësisht më vonë), me greqishten e armenishten etj., do të kërkonte shpjegime plotësuese. Në studimet gjuhësore historike prej kohësh mendohej se ilirët ishin popullatë IE, ilirishtja gjuhë IE, djepi më i hershëm i së cilës donte kërkuar në hapësirat qendrore e veri-lindore të Europës. Kjo do të thoshte se indoeuropianët që u bënë para-ilirë do të kishin zbritur drejt jugut diku në mijëvjeçarët III-II të Erës së Vjetër, menjëherë pas valëve para-helene.²²

Këto vrojtime shpesh lidheshin me shqyrtimet e raporteve të ndër-sjella midis shqipes e gjuhëve të tjera IE. Është bërë e zakonshme teoria e formësuar fillimisht nga G. Meyer (Meyer 1884: 185-189; Meyer 1885: 52-56; Meyer 1891; Jokl 1917: 109-154) dhe e theksuar më tej nga tradita Jokl-Çabej (Jokl 1924: 84-94; Jokl 1926: 78-95; Jokl 1927a: 13-70; Jokl 1929: 63-91; Jokl 1963: 113-156; Jokl 1984, Çabej 1976: 7-146) për lidhjet e gjuhës shqipe me gjuhët IE veriore (Hamp 1966: 97-122, shqip Hamp 2007; Desnickaja 1984: 192-210; Desnickaja 1987) - balto-sllave dhe gjermanike. Argumente në këtë drejtim ishin sjellë sidomos me numrin jo të vogël të fjalëve të përbashkëta midis shqipes e balto-sllavishtes.

Në kohë më të vona janë vërejtur dhe aspekte të natyrës gramatikore si mbaresat e pjesoreve, foljet mesore-pësore me **sk' > h: jehati, vihet*, etj. (Bednarczuk 1986: 77-83; Desnickaja 1984: 214-215; Desnickaja 1987; Mayer, H. 2003; Mayer, H. 1991; Mayer, H. 1993; Hamp 1973: 45-50; Hamp 1982: 7-8; Hamp 2007: 407; Hamp 1988: 501-504, Hamp 2007). Nga vrojtime të tilla është nxjerrë përfundimi se para-shqipja/ -albanishtja do të jetë folur dikur në Veri dhe do të ketë pasur në faza të hershme raporte më të afërta me gjuhët IE veriore (balto-sllave).²³ Me kohë folësit e saj do të kenë zbritur drejt jugut dhe në ndonjë prej qëndrimeve të tyre në malet e larta do të kenë lënë emërtimet *Beskide* dhe *Karpate*,

²² Shih Čović dhe Gimbutas, më sipër.

²³ Huld (1984), 158-170. Shih dhe Meyer, sipas Pellegrini; Jokl, Çabej; sipas Fiedler, në vlerësimet e vetë baltistëve baltikë raportet e supozuara të shqipes me ato gjuhë shihen si të parëndësishme dhe të largëta.

që zakonisht shpjegohen përmes apelativëve shqip *bjeshkë* dhe *kar-pë*. Për Çabejnë nuk duheshin lënë pa vënë në pah as lidhjet e shqipes së lashtë me keltishten perëndimore, por dhe me jugoret greqishte e armenishte (sidomos në vijën e Pedersen-it). Atij madje do t'i jetë dukur e kritikueshme teoria e Stammbaum-it e Schleicher-it dhe mund t'i ketë pëlqyer mbase plotësimi me teorinë e valëve të Schmidt-it, që i relativizonte hierarkitë e pasqyruara gjeografikisht (Çabej 1976).

Tani vonë linja e të menduarit që thekson lidhjet e protoshqipes me Europën Veriore u riaktualizua nga E. P. Hamp lidhur me raportet e proto-shqipes me gjuhët veriore. Sa u përket lidhjeve me ilirishten, Hamp kishte mendim të vetin. Qysh herët ai kishte pandehur se raportet midis shqipes e mesapishtes, të shkuar në Itali nga Ballkani, flasin për një afri midis dy gjuhëve (për vetë ilirishten ishte më i heshtur; Hamp: 1957: 73-89; Hamp 2007: 147-170; Rădulescu 1994: 329-344; Matzinger 2005: 29-54; për Hamp shih Ismajli 1996: 255-274). Tash vonë ai thoshte se bindja për raportet e afrisë mesapishte/ shqipe i ishte forcuar, ndërsa për raportet proto-shqipe-mesapishte-ilirishte kishte një mendim më pohenik (për shkak të lidhjeve midis shqipes e latinishtes – *sica/thikë, sybina/thupër*, etj. kumtim personal - 2008). Të gjitha duan marrë në një raport kompleks diskutimesh me teoritë e Georgiev-it për gjuhët e lashta të Ballkanit (trakishte, dako-mezishte, ilirishte) dhe për lidhjet e tyre eventuale me shqipen. Në ato kohë më duket se më kritike ndaj rindërtimeve të sistemit fonetik të dako-mezishtes së lashtë nga Georgiev-i kishte qenë A. V. Desnickaja, pas së cilës ato rindërtime të kujtojnë ose janë identike me rindërtimet që mund të bëhen për ilirishten:

“shumica e tipareve fonetike që rindërton Georgiev për dako-mezishten pajtohen me tiparet fonetike të tipit ballkano ilirik të gjuhës; pamje të ngjashme ofron edhe e ashtuquajtura gjuhë mesapike” (Desnickaja: 1984, 214-215).²⁴

²⁴ “Boljšaja čast fonetičeskikh priznakov rekonstruiruemyh Georgievim dlja dako-mizijškogo, sovpadaet s fonetičeskim čertami balkano-ilirijškogo tipa reči; shodnuju kartinu obnaruživaet i tak nazvyvaemyj mesapski jazyk”.

Diskutimet e tilla vijnë e marrin vlerën në gjendjen e mungesës së dokumentimit të gjuhëve të hershme dhe të fazave të moçme të shqipes. Sido që të jetë, pasardhëse e ilirishtes drejtpërsëdrejti apo e grupit proto-albanoid, kjo linjë e të menduarit për raportet e shqipes së lashtësisë me gjuhët IE veriore sikur i bën më të ndërmjetme e të largëta idetë për lidhje specifike të proto-shqipes me gjuhët jugore e lindore. E vërteta, këtu nuk harrohen lidhjet sidomos me greqishten, të theksuara qysh nga Kamarda, por ato shihen më të vona (Camarda 1864; Çabej 1976; Riza: 2004, 91-114; Mansaku 1995-1999: 111-124; Mansaku 1997: 182-186), ndërsa ato me armenishten (Pedersen, Barić) janë parë jo shumë të rëndësishme.

Tani në këtë pikë nisin diskutimet me idenë që përfaqësonte edhe Buda, i cili, sa i përket prejardhjes së shqipes në raport me gjuhët e lashtësisë, mbështetet tek interpretimet gjuhësore të Çabejtë për lidhjet me ilirishten (Çabej 1972: 71-99; Çabej 1970: 157-170). Por për vetë ilirishten, për të cilën të dy mendonin se ishte paraardhësja e shqipes, gjykimet e tyre mund të mos ishin të njëjta: Buda kërkonte shpjegime që të çojnë te raportet ballkano-anatolike, si disa arkeologë, ndërsa Çabej, gjithë duke theksuar raportet me gjuhët veriore, i hetonte rrathët e zhvillimeve të ngjashme midis gjuhëve gjeografikisht në anë të ndryshme në raport me shqipen. Kjo të shpie po ashtu te pohimi se ilirët nuk ishin të ardhur nga hapësira më në veri dhe të afron me konceptet që këto grupe gjuhësh i shihnin afërsisht në zonat e mëvona. Në aspektin linguistik teoria për lidhjet ballkano-anatolike mbetet për t'u arsyetuar konkretisht, sidomos në raport me atë që njihet si kompleks pellazgjik, që ka shërbyer për aq shumë spekulime mbi baza të ideologjisë kombëtariste të lashtësisë.²⁵

Me këtë rast dua të theksoj se midis autorëve shqiptarë, të cilët pak a shumë në tërësi e mbështesin hipotezën për prejardhjen ilire të shqipes, në këtë pikë, pra në çështjen e etnogenezës ilire, ashtu si në nuanca lidhur me vetë prejardhjen ilire të shqipes, ndryshe nga ç'kuj-

²⁵ Shih Konda e vargu tjetër. Cf. Demiraj; për interpretim tjetër të çështjes pellazgjike shih më herët: Budimir, Katičić; Van Vindekens, Hüttenbach, Georgiev, Zajmov.

tojnë autorë të ndryshëm nga ish-Jugosllavia (sidomos autorët serbë), mund të kishte dallime pikëpamjesh dhe diskutime.

Më vonë u zhvillua pikëpamja për prejardhjen trakase të shqipes (C. Pauli, H. Hirt, G. Weigand, H. Barić). Në atë kompleks u shtrua çështja e raporteve midis shqipes e armenishtes, te Pedersen-i në rrafsh të thjeshtë IE, ndërsa te H. Barić-i, meqë atëherë mendohej se armenishtja ishte pasardhëse e frigjishtes, trakishtja jepte shpjegimin për këto ndërlidhje shqipe-armene (Pedersen 1900: 340-341, Pedersen 2003: 115-117; Barić 1954: 7-48 dhe Barić 1955).

Teoria për prejardhjen trakase të shqipes me variantet e ndryshme u theksua nga G. Weigand-i 1927, pastaj nga V. Georgiev-i, tash vonë nga historiani G. Schramm (prej besishtes: Schramm 1999; Schramm 1981, por edhe Witczak). Tani vonë lidhjet e shqipes me armenishten janë diskutuar me një cilësi të re nga G. Klingenschmitt-i, për t'u ndjekur nga diskutime në ditët tona. Klingenschmitt fliste për një bashkësi gjuhësore IE ballkanike (Balkanindogermanisch), ku lidheshin trakishtja, frigjishtja, greqishtja, shqipja e armenishtja (Klingenschmitt 1994: 221-233; Klingenschmitt 1994a: 235-251; Matzinger 2006: 47-92; Matzinger 2009: 13-36).

Këmbëngulja te djepi i hershëm ballkanik, jo i ardhur nga veriu, e afron idenë që përqafoje Buda me këtë të fundit, me dallimin që Buda ngulte këmbë te prejardhja ilire, ndërsa kjo tjetra të çon te grupi gjuhësor që lidhet me greqishten, trakishten, frigjishten e armenishten. Në çdo rast kemi një teori që supozon një vazhdimësi hapësinore midis gjuhëve të ndryshme IE në Ballkan dhe jo lëvizje nga veriu. Por, po të shprushim më shumë, te komponenti i dytë i përmendur nga Buda – anatoliku, mund të dalin oportunitete për ndërlidhjen me pellazgjishten apo para-helenishten, çka mund të bëhej objekt diskutimesh të mëtejme brenda vetë kulturës shqiptare. Budës i dilte e rëndësishme mbështetja tek argumentet arkeologjike për prejardhjen e gjuhës shqipe nga ilirishtja kur ishte fjala për kulturën e Komanit dhe të Mesjetës së hershme. Për faza si kjo për të cilën e kemi fjalën tani, ndryshe nga ç'mund të sugjeronte mbështetja linguistike, ajo mund ta çonte në ujëra të tjerë.

Buda dhe kërkesa për trajtim multidisiplinar

Sa u përket vetë zhvillimeve brenda komponentit ilir, te Buda bie në sy vrojtimi për proceset dinamike etnolitike tek ilirët në raport me paraardhësit e tyre dhe me popullatat e tjera përreth. Kështu etnosi i fillmë ilir prej Budës konsiderohej si i gjerë dhe i ndryshueshëm, që mund të ndahej, rigrupohej, të përzihet me etnose të tjera e të asimilohej. Në të atilla procese me kohë ilirët e jugut, *“ilirët e mirëfilltë”*, siç i quanin romakët, filluan të veçoheshin si bashkësi etnokulturore më vete, me të folme e kulturë materiale e shpirtërore të njëjtë, me rrezatimin e një vargu qytelesh, me afërsinë e bregdetit, me rrugët e mëdha të qarkullimit, me përvojën e përfshirjes në Mbretërinë shtetërore ilire, nga ai grup fisesh me në krye albanët doli bashkësia me përmbajtje të reja shoqërore, bashkësia e arbërve. Dhe në këtë pikë Aleks Buda vinte, megjithatë, me vrojtimin metodologjikisht të saktë:

“asnjëri nga faktorët që marrin pjesë në formimin e këtyre bashkësive nuk do të ishte i mjaftueshëm për të shpjeguar, i vetëm, formimin e një etnosi. Rrjedhimisht, asnjëra nga shkencat historike-kulturore nuk mund të thotë e vetme fjalën përfundimtare për zberthimin e proceseve etnogjenetike. Këtu duhet të përputhen rezultatet e gjuhësisë me ato të etnologjisë e të arkeologjisë dhe të gjitha së bashku me ato të historisë” (Buda 2006: 22).

Duke marrë parasysh të gjithë faktorët e tillë, ai arrinte në përfundimin se procesi etnogjenetik i kristalizimit të arbërve arrin në shekujt e antikitetit të vonë, në kohën e *“ngjizjes së shqipës në gjirin e ilirishtes”*, në shekujt e parë të mijëvjeçarit të parë, përfundim që është sugjeruar e ndërtuar në mënyra të ndryshme sa i përket gjuhës qysh nga G. Meyer-i, H. Pedersen-i, N. Jokl-i, E. Çabej, A. Desnickaja, deri te gjuhëtarët e ditëve tona (Çabej 1972: 71-99; Çabej 1970: 157-170).

Në gjendjen e sotme të studimeve të prejardhjes së gjuhës shqipe, vrojtimit e Budës dhe të grupit që ai përfaqësonte për çështjen e prejardhjes së popullit shqiptar, për fazat e hershme dhe të errëta të sh. IV-XII në tërësi dhe VIII-XII në veçanti, për interpretimin e të dhënave arkeologjike e të burimeve rrëfimore antike, për lëvizjet shoqërore-ekonomike

të paraarbërve dhe të arbërve të hershëm, janë të dobishme dhe për studiuesit e prejardhjes së gjuhës. Vështrimet e tij për shtetin dhe faktorët shtetformues në faza të hershme të historisë mesjetare shqiptare, për gjykimet e gatshme të shumëve që nuk ngurrojnë të nxjerrin përfundime dhe për çështje që nuk lidhen fort këtu, si për

'aftësinë e shqiptarëve për të ndërtuar shtet, për mungesën e aftësisë shtetformuese',

duke i parë ata në radhë të parë turma barinjsh nomadë, më duken të rëndësishme. Konceptet e atilla reduktuese të realiteteve shoqërore, A. Buda i kritikonte me të drejtë duke nxjerrë përpara analizën e proceseve që kanë shpënë logjikisht në zhvillimet në drejtime të caktuara.

Nuk është vështirë të hetohet se A. Buda, me mprehtësinë e hetimit të proceseve historike dhe me aftësinë e ngritjes mbi detajin e zakonshëm, periudhën e historisë shqiptare të shekujve IV-XII e gjeti të trajtuar keq. Për të ishte e qartë se historiografia nuk bëhet vetëm me dokumente të shkruara, po edhe me interpretime të drejta të një vargu elementesh të dedukuara nga rrjedhat e përgjithshme shoqërore, nga argumentimet e natyrës kulturore, etnografike, arkeologjike, gjuhësore. Edhe pse nuk ka dokumente të shkruara për raportet e paraarbërve (ilirëve) dhe të arbërve me botën romane, madje vetë arbërit përmenden në formë të shkruar shumë vonë në sh. XI, fakte si ekzistenca e një numri kaq të madh dhe me cilësi të atillë të huazimeve latine në shqipen, apo ekzistenca e huazimeve greke të lashta, nuk mund të mos bëhen me peshë në aspektin e dokumentimit të proceseve historike për popullin shqiptar. Duke u nisur nga vështrimi se për historinë e popujve të rëndësishme janë, siç thoshte ai,

"...energjitë e brendshme krijuese, me të cilat njerëzit kanë punuar, mbrujtur e plazmuar për mijëra vjet truallin e vet atëror, duke e kthyer me gjakun e djersën e tyre, në kuptimin e plotë, në tokë kulture",

duke marrë parasysh proceset që impononte, pas pushtimit romak, varësia prej Perandorisë Romake të Lindjes qysh nga sh. IV, zhvillimet e stuhi-shme që ndodhën në tokat e Ilirisë për pasojë të migrimeve të mëdha të popullive, sidomos sllave në Ballkan, e prandaj edhe të ndryshimeve etnike, duke mos harruar konfliktet politiko-ushtarake dhe kishtarë-fetare,

duke vënë në pah faktin se tokat shqiptare qenë pjesët më të ekspozuara të Perandorisë së Lindjes drejt Perëndimit, prandaj jo vetëm në kufijtë politikë, po edhe shoqërorë e kulturorë, qenë pjesët ku ndesheshin dy kulturat e dy gjuhët universale të kohës – greqishtja e latinishtja, bashkë me format e ndryshme të institucioneve feudale, të tipit bizantin me ato të tipit perëndimor-anzhuin, A. Buda nxirrte këtë përfundim përgjithësues:

“Këto rrethana nuk munguan të ushtronin ndikimin e tyre negativ në historinë e tokave shqiptare e të banorëve të tyre. Por ato nuk mundën të ndryshonin një fakt themelor: praninë e pandërprerë të elementit të vjetër etnik vendës, të shqiptarëve, të cilët, duke kaluar përmes një sërë transformimesh lidhur me zhvillimin e punës, konsolidohen mbi bazën e vjetër etnike, duke ruajtur emrin e tyre antik, si një nga kombësitë përbërëse të Europës mesjetare” (Buda 2006: 13).

Konditat e tilla u kishin imponuar shtresave të larta vendëse zhvillim të ngadalësuar të proceseve, duke i shtrënguar të integroheshin në sisteme e regjime të huaja, duke riprodhuar vlera pas modeleve të tyre,

“duke marrë funksione si feudatarë e dinjitarë bizantinë, si baronë e kontë vasalë të anzhuinëve... duke huazuar tituj, stema e kostume,”

por në të njëjtën kohë, paralelisht me të drejtën dhe kulturën bizantine, apo osmane më vonë, në gjirin e atij populli gjëllinin e drejta vetanake zakonore, kultura gojore e një shkalle të lartë, jeta vendëse me të gjitha aspektet që ia siguronin asaj mundësinë e mbijetesës nëpër rrugë tjetër zhvillimi. Ndikimet e zhvillimeve të tilla të ndryshme e nga shumë anë përnjëherë japin mundësinë të hetojmë diçka që Buda e shpreh kështu:

“Të mbështetur mbi një komunitet etnik e gjuhësor të lashtë e në një territor të përbashkët, të dalluar nga ai i fqinjëve, mbi një habitus shpirtëror të njëjtë që shprehet në kulturën e tyre popullore, shqiptarët afirmohen tashtëm edhe si një faktor i rëndësishëm politik në Europën Juglindore” (Buda 2006: 15).

Analizat e natyrës shoqërore për Ilirinë e Jugut i kishin dhënë Budës mundësi të konstatonte se brenda diversitetit ilir në një trevë të caktuar u krijua një unitet me tipare etno-gjuhësore e kulturore të diferencuara aty ku zhvillohet procesi i etnogjenezës së shqiptarëve.

Ndikimet latine sipas tij tregojnë se gjuha vendëse tashmë ishte kristalizuar në strukturën themelore gramatikore që ndikimeve të gjuhëve me të cilat ra në kontakt iu përgjigj si *'një unitet i formuar'*, reagoi ndryshe nga dalmatishtja e dakishtja, etj. Në analizat e latinizmave të shqipes janë hetuar ndryshime të natyrës kohore, shtresore e të tje-
ra, por edhe të natyrës së refleksit të ndryshëm për shkak të gjuhës që qëndron prapa. Vazhdimësia etno-kulturore përforcohet me faktin se shumica e vendbanimeve qytetare ose rurale të mëdha e qendrave të fortifikuara, e monumenteve kryesore kulturore të antikës së vonë vazhdojnë ekzistencën në mesjetën e hershme topografikisht, toponimisht ose si *'metastaza'* qendrash të banuara, krahas krijimeve të reja. Toponimia dhe hidronimia kryesore e trevave shqiptare përputhet pak a shumë me vendbanimet arbëre të mesjetës së hershme, këta emra kanë qenë pa ndërprerje në gojën e një popullate shqipfolëse, sepse evolucioni i tyre u shtrohet ligjeve fonetike të shqipes (civitate Çabejnë). Duke mos dashur të mohonte ngulimet sllave, të cilat i krahasonte me ato në Greqi apo në Rumani, theksonte se një pjesë e emrave të fshatrave, është e huaj.

"Ajo lidhet me veprimtarinë e aparatit shtetëror, administrativ-ushtarak të huaj, prapa saj nuk qëndronte një realitet etnik".

Mikrotoponimia është shqip, lidhet me popullsinë vendëse, mendonte ai. Në interpretimet e tilla mund të gjendet dhe një kritikë për vrojtimet e historianëve që djepin e shqiptarëve e kërkojnë në hapësira si ajo e Matit (Stadtmüller), apo tek statusi i tyre si popullatë migratore, siç kanë pretenduar disa (Schramm 1999: përkthimi nga S. Gashi, Schramm 2006: 316; Schramm 1981; Witczak 1995: 309-312; Matzinger 2009: 13-36).²⁶

²⁶ Një përgjigje të anticipuar nga Çabej për vërejtjet e tilla e kishim qysh në vitet '70: "Opiniononi që lidhet me këtë hipotezë [regjioni gjuhësor i shqipes të ishte zhvendosur në periudhën historike nga një territor më në veri dhe më në lindje në hapësirën e sotme, r. i.], sipas së cilës në këtë rast kemi të bëjmë me një popullatë barinjsh transhumantë, lëvizjet e të cilëve nuk do ta kishin tërhequr vëmendjen e bashkëkohësve, jo vetëm që nuk është mjaft realiste nga aspekti ekonomik i përgjithshëm, por nuk pajtohet as me të dhënat kulturore, historike e shoqërore konkrete, mbështetet pra në një shqyrtim të njëanshëm... Gjuha e vendit na jep dëshmi të tilla mbi historinë popullore që ne do të

Këtë bindje mund të themi se ai e kishte refuzuar parimisht qysh përpara përmes analizave për shqiptarët e Mesjetës së hershme:

“Vetë analiza e trashëgimit të lashtë të leksikut të shqipes dhe të elementeve të saj të huazuara nga latinishtja, së bashku me të dhënat e rëndësishme të arkeologjisë mesjetare, po edhe të palontografisë, tregojnë se te shqiptarët mesjetarë kemi të bëjmë me një popullsi që ab antiquo bën një jetë ndenjëtare të zhvilluar bujqësore-blegtorale e zejtare në një mjedis që e njuh jetën qytetare. Për këtë flasin gjetjet e dendura arkeologjike jo vetëm në zonat fushore dhe kodrinore, po edhe në viset e brendshme malore; ato vërtetojnë në mënyrë bindëse se procesi i formimit të popullit shqiptar nuk u zhvillua në kushte amullie ose regresi ekonomik-shoqëror, por në kushte të një zhvillimi relativ, me gjithë pasojat që sillnin me vete dyndjet e pushtimet e huaja shkatërruese” (Buda 2006: 30).²⁷

Buda/ Stadtmüller

Aleks Buda nuk kishte ngurruar që, përtej vërejtjeve ndonjëherë me prapavijë ideologjike, të shprehte kritikën e tij as ndaj pikëpamjeve të caktuara të autoriteteve si Georg Stadtmüller:

“I ndikuar fuqimisht nga konceptet gjeopolitike reaksionare gjermane të viteve ‘30, faktorin vendimtar që vepronte në jetën e shoqërisë së shqiptarë-

ndodheshim më afër realitetit historik duke lejuar, përbri elementeve sedentarë, përbri barinjve, bujqër që kultivonin tokat e tyre, përbri fshatarëve qytetës, përbri luftëtarëve zejtarë paqësorë”, Çabej: 1972, 83.

²⁷ Në referatin e vitit 1962, te Buda (2006), 67, thoshte: “Te popullsia shqiptare u ruajt një element qytetar me prejardhje të lashtë, i vendosur ndër të tjera në qytete si Kruja, Drivast-Drishti, Bylis-Ballshi, që ishte vazhdim i drejtpërdrejtë a i tërthorët i qyteteve antike. Këtë e vërteton edhe fakti që emrat e qyteteve kryesore të Shqipërisë së sotme si Durrës, Shkodër, Vlorë, si dhe të Dardanisë antike: Scupi-Shkupi, Naissus-Nish, tregojnë një evolucion fonetik, që u përgjigjet plotësisht ligjeve të zhvillimit të brendshëm të gjuhës shqipe. Kjo popullsi e lashtë shqiptare me karakter qytetar dhe që kishte përçafuar krishterimin qysh herët, si e tregon terminologjia kishtarë me karakter latin-adriatik, përbën, siç e pati parë drejt ballkanisti i shquar Jireček, popullsinë kryesore të asaj province bizantine në breg të Detit Adriatik, e cila me emrin “Thema e Durrësit” i përgjigjej një pjese të mirë të Shqipërisë së sotme. Nuk është aspak në kundërshtim me këtë që themi fakti se ekzistonin njëkohësisht barinj transhumantë shqiptarë, karakteristikë kjo, ku më shumë e ku më pak, për të gjitha vendet ballkanike”.

rëve të hershëm, Shtatmyleri e shihte në 'ligjet' e hapësirës dhe të 'shpërthimeve demografike', që paskan konkretizuar dhe përcaktuar shkallën e zhvillimit shoqëror dhe kulturor të tyre. Ligji i dhunës, karakteristikë për një shoqëri barinjsh shtegtarë luftarakë, siç i cilësonte Shtatmyleri në mënyrë aprioristike dhe të njëanshme shqiptarët, paska vepruar sidomos në kushtet e mungesës së një pushteti qendror politik të fortë, siç e përfaqësonte Roma, Bizanti dhe shteti serb në kulmin e fuqisë së tyre. Duhet thënë se këto ishin thjesht konstruksione shabllon, të cilat as në kohën e vet, e aq më pak sot, nuk kishin ndonjë bazë metodologjike pak a shumë të shëndoshë dhe në përputhje me realitetin historiko-kulturor të kohës" (Lidhur me Stadtmüller 1966, te Buda 2006: 24-25).

Pikëpamjet e Stadtmüller-it i kritikonte Buda edhe nga një aspekt tjetër parimor, tani në raport me konceptimet e tij të përgjithshme për historinë e Ballkanit:

"Këto rezultate të një pune çerekshekullore e bëjnë absurde thënien prezuntuoze të një ballkanologu të njohur si G. Shtatmyler, se popujt e 'rinj' ballkanas nuk e paskan distancën e nevojshme, as dhe një konsolidim të mjaftueshëm të ndërgjegjes së tyre morale-shkencore, për të përballur problemet e mëdha të historisë së tyre dhe se, rrjedhimisht, u përkitka përfaqësuesve të popujve të 'mëdhenj' të thonë fjalën e tyre 'autoritare' edhe në këtë fushë".²⁸

Për Stadtmüller-in Buda kishte shprehur mendimin e tij edhe në raste të tjera. Duke u marrë me vlerësimin për rezultatet dhe konceptimet e përgjithshme historiografike për ilirët dhe historinë e tyre, në po atë referat për Ilirët e jugut si problem i historiografisë, A. Buda nxirrte edhe këtë përfundim:

"Rezultatet e fituara nga kërkimet në fushën e arkeologjisë mesjetare

²⁸ Buda (2006), 43. Botuar dhe në Buda (1986): *Ilirët e jugut si problem i historiografisë*, in *Shkrime historike 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë*, Instituti i Historisë, Tiranë, ff. 13-41. Studimi është referat i mbajtur në Kuvendin e Studimeve Ilire, Tiranë 1972, botuar si *Kuvendi i Studimeve ilire, v. I*, Tiranë, 1974, ff. 43-64; më parë është botuar te *Studime historike 3*, 1972, ff. 7-25, pastaj te *Studia albanica 2*, 1972, Tiranë, ff. 31-53, *Përparimi*, Prishtinë, 10-11, 1972, ff. 887-906, te *Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave historike*, Prishtinë, 1972, XI (II), Prishtinë, 1974, ff. 7-28, pastaj greqisht në *Balkanikê Bibliographia*, v. 4, 1975, Thessaloniké, 1977, ff. 177-204, te *AIESEE Bulletin*, X, 1972, nr. 2, ff. 47-69. Kritikën e tij e referonte ndaj Stadtmüller (1950), 10-11.

të Shqipërisë, veçanërisht në lidhje me qytetet e shekujve VII-X, na lejojnë ta konsiderojmë si të papërputhur me realitetin historik atë kuadër shumë të thjeshtuar, që ka gjetur kaq përhapje në historiografinë e përgjithshme; shqiptarët si barinj rravgues, një relikut primitiv e arkaik i fshehur në disa skuta malore. (Refereonte Stadtmüller 1941: 122). Një varg qendrash të fortifikuara e vendbanime me prejardhje të vonë antike vazhduan drejtpërsëdrejti ose me anë metastaze ndërruan vend në mesjetën e hershme” (Buda 2006: 61; Buda 1986: 40).

Në referatin *Rreth disa çështjeve të historisë së formimit të popullit shqiptar, të gjuhës e të kulturës së tij*, të mbajtur në kongresin e AIESEE në Ankara më 1979, të plotësuar pastaj në botimin shqip (*Studime historike*, 1, 1980: 165-180, frëngjisht në *Studia albanica* 1, 1980: 41-61 dhe në Buda 1986: 105-128), pas shumë komentimeve për interpretimin e historisë dhe të fenomeneve të ndryshme në atë kuadër, në radhë të parë për etnogjenezën e popullit shqiptar dhe të historisë së tij të hershme, pas vrojtimit krejtësisht pa vend, mbase me detyrim, se

“nevojën e studimeve ndërdisiplinore për zgjidhjen e këtij problemi qendror të historisë sonë kombëtare e pati theksuar më 1962 shoku Enver Hoxha, duke u ngarkuar shkencave tona historike detyra për zgjidhjen e këtij problemi të rëndësishëm të historisë sonë kombëtare” (Buda 1968: 109),

Buda vijonte kontekstualizimin e filluar më herët në kuadër të nxitjeve ideologjike në këto fusha, duke e cituar drejtpërsëdrejti E. Hoxhën, që nuk njihet për dijet në këtë fushë, po madje, siç më kanë thënë kolegë në Tiranë, këmbëngulte më parë të shiheshin teoritë e Z. Mayani-t e të tillëve në frymën e ideologëve të sh. XIX:

“Etnogjeneza e popullit shqiptar është një problem sa i rëndësishëm, aq edhe kompleks, për studimin e të cilit do të nevojitet aktivizimi dhe bashkëpunimi i mjaft punonjësve shkencorë...” (Enver Hoxha, Vepra, vl. 23, f. 547, referuar sipas autorit, ne nuk e kemi parë),

për të vënë në pah se kishin qenë pikërisht përpjekjet për ta kapur tërë problematikën e etnogjenezës në mënyrë ndërdisiplinore ato që përbënin elementin dallues të studimeve ku vendosej dhe i tiji për arritjen e rezultateve pozitive në raport me rezultatet e studiuësve të huaj,

“të cilët janë nisur zakonisht vetëm nga një aspekt i vetëm, ose i burimeve

të shkruara historike, ose nga aspekti gjuhësor, ndërsa materialet e rëndësishme arkeologjike të nxjerra në dritë në kërkimet tona ose nuk njihen, ose injorohen qëllimisht” (Buda 1968: 109).

Këto konstatime i vinte drejtpërsëdrejti para vrojtimeve të tij kritike për idetë e G. Stadtmüller-it:

“Përpyekja e bërë nga G. Shtadtmyleri (referonte veprën e përmendur, konkretisht Stadtmüller 1966: 29, 32, 37, 49, 61 etj.) për të ndjekur rrugën e çarë nga N. Jokl-i para Luftës së Dytë Botërore, për një kapje ndërdisiplinore, gjuhësore-historike dhe antropogjeografike të problemit, nuk dha rezultate pozitive, përkundrazi duhet konsideruar si shembull negativ, pas të cilit nuk duhet ecur për zgjidhjen e problemeve të tilla. Arsyeja për këtë nuk qëndron në ‘mosnjohjen’ e materialeve elokvente arkeologjike të nxjerra në dritë nga arkeologët tanë, por, në radhë të parë, nga pikënisja metodologjike-metodike e shtrembër.” “Sipas Shtadtmylerit etnogjeneza e shqiptarëve është një proces që zhvillohet jashtë ligjësive të zhvillimit normal ekonomik-shoqëror, nuk lidhet me një territor të fiksuar, po iu nënshtrika ligjeve biologjike, ‘eksplozioneve demografike’, ekspansionit të dhunshëm; janë këta faktorët që shpjegokan formimin e popullit shqiptar. Pikëpamje të tilla janë karakteristike jo vetëm për Shtadtmylerin, por edhe për historianë të tjerë borgjezë-revizionistë. Prapa tyre fshihen në një varg rastesh qëllime të mirëfillta politike antishqiptare” (Buda 1968: 109-110).²⁹

Stadtmüller-in ai e përmendte edhe në Referatin e mbajtur në Konferencën Kombëtare për Formimin e Popullit Shqiptar, të Gjuhës e të Kulturës së tij, në Tiranë 1982 – “Etnogjeneza e popullit shqiptar në dritën e historisë”, botuar në *Studime historike*, Tiranë, 3, 1982 169-184, frëngjisht në *Studia albanica* 2, 1982: 13-30, në Buda 1986: 129-150, Buda 2006: 19-37. Më duket i rëndësishëm debati ku hynte ai me këtë rast. Pas tij, në disa periudha të historisë sonë të lashtë ka mangësi materialesh, çka e vësh-tirëson punën e studiuesit brenda një fushe të vetme. Absolutizimi i një rrethane të tillë, ndërkaq, ka çuar në shumë raste në teza të gabuara, të cilat japin pamje të shtrembëruar të realitetit historik. Në mënyrë të veçantë ai këtu shtronte për debat tezat sipas të cilave midis antikitetit dhe mesjetës së vonë në Ballkan do të ketë pasur zbrazëti të plotë

²⁹ Bien në sy shtampat ideologjike: *studiues yni/ i huaj, borgjez-revizionist*, etj.

“të shkaktuar nga ndryshimet e mëdha politike, shoqërore e etnokulturore, që karakterizojnë periudhën prej shekullit V deri në shekullin X”(f. 134).

Në atë periudhë, pas romanizimit të plotë të ilirëve, sipas atyre dijetarëve, do të ketë ndodhur sllavizmi i plotë i të romanizuarve. Kjo e bën të pamundur shpjegimin e shfaqjes së shqiptarëve në trojet e tyre mesjetare dhe të sotme, pos përmes një dyndjeje të mëvonë nga drejtime të ndryshme, qoftë nga trojet trakase, madje edhe në veri të Danubit, qoftë dhe nga trojet ilire të Ballkanit Qendror. Këtu Buda nuk përmbahej as nga ironizimi. Mendoj se në këtë pikë Buda kishte plotësisht të drejtë. Më duket madje se në pikëpamje të tilla mbështeten shumë interpretime që vetëm kështu i shohin të shpjegueshme raportet e shqipes me rumanishten dhe për pasojë tezat për djepin më të hershëm të shqipes më në lindje, çka gjithsesi nuk duket e përfillshme. Ato teza i shohim në themelin e një konceptimi të pranishëm gjithandej në historiografinë e Europës Qendrore për Ballkanin dhe Europën Juglindore, që sikur nuk resht së pari historinë e kësaj pjese të Europës kryesisht nga periudha e depërtimeve sllave e këndeje. Në këtë pikë kanë qëndruar edhe historianë që merren me Kosovën apo historinë shqiptare.

Në analizën e Budës, për mendimin tim, racionale, pas kësaj teze, si pasojë direkte janë pikëpamjet pas të cilave ardhësit e këtillë të dhunshëm e të vonë cilësoheshin me zhvillim të ulët shoqëror-ekonomik, prandaj ata shihen më parë si barinj shtegtarë nga zona të mbyllura e të prapambetura, ku paska qenë e mundur t'i shpëtonin romanizimit të plotë por në kushte primitiviteti. Për Budën ky ishte një konstruksion

“i ndërtuar me njëfarë logjike që përpiquej të mbështetej mbi fakte e argumente, po në të vërtetë më tepër në një varg tezash të marra ‘kallëp’, plot kundërthënie të brendshme dhe në radhë të parë me faktet. Nuk mund të fshehim mendimin se prapa këtyre argumenteve në një varg rastesh qëndronin jo vetëm dobësi metode dhe metodologjike, po edhe synime politike pak a shumë të maskuara. Nuk qe e rastit që një varg nga përfaqësuesit më të ‘shtyrë’ në guximin e tyre për mbrojtjen e këtyre tezave vinin, me pak përjashtime, nga radhët e sllavistëve me koncepte të theksuara të pansllavizmit të vjetër (H. M. Seliščev, I. Popović, I. Zaimov, etj.)” (Buda 1986: 134).

Pasi e thoshte këtë, Buda kërkonte të shpjegohej se nuk i mohonte meritat shkencore të një vargu studiuesish që u përpoqën të çonin përpara studimet e të hapnin rrugë të reja. Këtu veçonte sidomos Norbert Jokl-in. Vijonte pastaj logjika e nxjerrjes në pah të ndryshimeve që po ndodhnin me ardhjen në skenë të studimeve të shkencës shqiptare, e cila nisi ta thoshte fjalën e vet, *‘pa pretenduar se do të thotë fjalën e fundit’*. Pamja që mund të krijohet sot, pas Budës, natyrisht përmes rezultateve të shkencave në këtë vend,

“është krejtësisht e ndryshme nga ajo që paraqet vepra e njohur e G. Shtadtmylerit (G. Stadtmüller) ‘Hulumtime mbi historinë e herët të shqiptarëve’ (1941, botimi i dytë 1966), e cila mund të themi se është e para vepër kërkimore kushtuar krejtësisht problemit të formimit të popullit shqiptar në mesjetë” (Buda 1986: 135).

Por në rastin e Stadtmüller-it Buda shihte arsye të tjera, të ndryshme nga ato të sllavistëve, për angazhimet e tij në këtë vijë, më parë të rendit ideologjik.

Idetë e Stadtmüller-it

Le ta shohim në ndonjë detaj pikëpamjen e Stadtmüller-it të formuluar nga ai vetë. Pas kohës parashqiptare (pararomake), që për historinë e popullit shqiptar mund të merret parasysh vetëm pjesërisht, periudha e parë e rëndësishme e historisë së popullit shqiptar është periudha e stërlashtë shqiptare (*Uralbanische*, bizantine e hershme):

“Shqiptarët jetonin atëherë në Grykën e Matit si një ishull gjuhësor dhe popullor brenda botës latino-greke” (Stadtmüller 1966: 29).³⁰

Hapësirën e dytë me rëndësi, pas tij, e përbënte periudha e lashtë shqiptare (*Früh-albanische Zeit*), në gjysmëmijëvjeçarën pas pushtimit sllav të vendit:

³⁰ “Die Albaner lebten damals im Mati-Gau als eine Sprach- und Volkstumsinsel innerhalb der lateinisch-griechischen Umwelt”. *Gau* në gjuhën gjermane nënkupton një krahinë, hapësirë, landshaft të izoluar dhe të mbyllur në vete. Konotacionet që bart kjo fjalë në kontekstin e interpretimeve përkatëse historiografike nuk është e mundur të jepen me fjalët përkatëse shqipe.

“Hapësira jetësore shqiptare edhe atëherë kufizohej kryesisht brenda Grykës së Matit, në skajet e së cilës u zhvillua një simbiozë e ngushtë shqiptaro-sllave. Në fillim të shekullit 11, kur, nën goditjet e ushtrive bizantine, u shkatërrua perandoria e madhe bullgare, kur u mund trashëgimia bullgare në perëndim nga bizantinët dhe normanët, atëherë erdhi ora e madhe historike e shqiptarëve. Tani filloi përhapja e hapësirave banuese të këtij populli. Fuqia deborduese e kësaj popullate ishte akumuluar për shekuj të tërë prapa diga malesh. Tani u thye dhe vërshoi të gjitha landshaftet fqinje. Luftëtarët baritorë shqiptarë vërshuan nga kantoni i tyre malor, fillimisht si hyzmeqarë tokash të ushtrive të huaja, pastaj si banorë” (Stadtmüller 1966: 29).³¹

Vijonte pastaj tregimi për pushtimin gradual nga kjo popullatë të hapësirave jugperëndimore të Krujës e Tiranës dhe veriore të Luginës së Drinit, për të vijuar në perëndim deri në bregdet dhe malet e brigjet e jugut. Pastaj përhapja u ndal për disa shekuj. Landshaftet e Shqipërisë u integruan në mbretërinë e Dushan-it, kështu që sundimi i fortë e ndaloi përhapjen e mëtejme. Por ngrehina mbretërore serbe u rrënuar me vdekjen e themeluesit të saj, për t’u shprishur sërish në landshaftet e saj natyrore të pjesshme. Sundoi një kaos midis shteteve të vogla dhe ndodhi

*“vala e dytë e dyndjeve shqiptare. Njëkohësisht drejt veriut dhe drejt jugut”.*³²

Në veri mori, sipas tij, së pari hapësirën e dikurshme serbe të Alpeve shqiptare veriore, prej nga pastaj u shtri në landshaftin e butë të Koso-

³¹ “Der albanische Lebensraum hat sich auch damals noch in der Hauptsache auf den Mati-Gau beschränkt, an dessen Rändern sich eine enge albanisch-slavisches Symbiose entwickelte. Als dann zu Anfang des 11. Jhs. das Großbulgarische Reich unter den Schlägen der byzantinischen Armeen auseinanderbrach, als die bulgarische Erbschaft im Westen von den Byzantinern und Normannen umkämpft wurde, da war die große geschichtliche Stunde der Albaner gekommen. Nunmehr begann die große Siedlungsausbreitung dieses Volkes. Die überquerende Kraft dieses Volkstums war seit Jahrhunderten hinter Gebirgswällen aufgestaut worden. Jetzt brach sie hervor und berschwemmte alle Nachbarlandschaften. Die albanischen Hirtenkrieger strömten aus ihrem engen Bergkanton heraus, zunächst als Landsknechte fremder Soldherren, dann als Siedler”.

³² “Der zweite Vorstoß der albanischen Wanderung ein. Gleichzeitig nach Norden und nach Süden”.

vës e Metohisë. Edhe më i dhunshëm qe depërtimi në jug: Epiri, Akarnania, Etolia u plaçkitën dhe pastaj u pushtuan, për të vazhduar më tej nga Greqia e Mesme dhe nga Morea, ku u vendosën (Stadtmüller 1966: 29). Prej atëherë janë ishujt gjuhësorë e popullorë në Atikë, Beoti, Megara, në More dhe në ujdhesat greke. Një valë e tretë e përhapjes së shqiptarëve ndodhi pas rënies nën sundimin turk në sh. 15, kur shumë syresh ikën në Itali të Jugut, ndërsa vala e katërt nisi në fund të sh. XVII, këtë herë nga verilindja dhe në ndërlidhje me dhunën shtetërore turke. Shtypja e popullatës shqiptare shtynte pjesën më të madhe të popullatës serbe drejt veriut dhe vendosej vetë në hapësirat e mbetura të zbrazëta:

“Në hapësirat e zbrazëta vërshuan shqiptarët” (Stadtmüller 1966: 30).³³

Rrjedha vazhdoi tërë sh. XVIII e XIX dhe Serbia e Vjetër, që në Mesjetë ishte landschafti bërthamë i shtetit serb, u bë kështu hapësirë popullore e gjuhësore shqiptare.

Këtë konceptim, shpesh fjalë për fjalë të ngjashëm me të autorëve serbë të shekullit XIX, si p.sh. *‘pustonosna arbanaška reka’* (lumi shkretues shqiptar) të J. Hadživasiljević-it, e të ngjashme, nuk ke si të mos e kundërshtosh, madje kam përshtypjen se një historian si A. Buda ka qenë i kursyer në kritikën e tij. Çfarë populli barinjsh paskan qenë ata që tërë kohën qenkan struktur në male për të pritur *‘orën e historisë’* kur do të shtriheshkan gjithandej? Dhe çfarë jete paskëshin bërë ata në male për të qenë kaq të numërt dhe populluar pastaj hapësirat jetësore serbe e greke gjithandej, madje edhe italiane! Nëse te serbët qëndrimet e tilla mund të shpjegohen si të motivuara me interesa propagande, cila do të ishte mbështetja për një studiues, përndryshe me jo pak dijeni, nga Gjermania?

Pisani për Stadtmüller-in dhe atdheu i pammë i shqiptarëve

Për më tepër, Stadtmüller-i përmes një paraqitjeje të këtillë

³³ “In die leeren Gebieten strömten Albaner ein”, vini re termin: *strömten ein*, që korrespondon me kuptimet e përmbajtura në shprehjet e historiografisë serbe të sh. 19-20: *pustonosna arbanaška reka*, etj..

pretendonte të sillte një pasqyrë shembull për shtrirjen e hapësirës jetësore. Edhe më tej, ai theksonte rolin që në konceptimet e tij do të luante landshafti në historinë e një populli, duke referuar shkrime të tij të mëhershme.³⁴ Përthyerja e brendshme e landshaftit, duke krijuar hapësira të mbyllura banimi përmes vargmaleve–kantone malore dhe rrafshinave detare i ka kushtëzuar përthyerjet shtetërore në aq shumë shtete fisnore më herët.

*“Kjo kundërvënie landshafti midis maleve në brendësi dhe rrafshinave bregdetare buzë Adriatikut do të thoshte kundërvënie midis Ballkanit dhe Adriatikut, e cila sundon tërë historinë e Shqipërisë dhe të popullit shqiptar, si luftë forcash politike midis fuqive udhëheqëse në Adriatik dhe në Gadishullin Ballkanik dhe si përleshje dhe ndërdepërtim midis botëve kulturore adriatike dhe ballkanike, të cilat qëndruan në ndeshje të përhershme me njëra tjetrën në rrafshinat e kontestuara bregdetare. Kjo përpyetje e dy botëve [për territore] është tema e madhe e historisë së vjetër dymijë e pesëqindvjeçare e këtyre landshafteve”.*³⁵

Pretendimi shkon më tej, derisa duke dashur që historia shqiptare dhe e Ballkanit të vështrohen jo më nga jashtë, po nga brenda.

*“Vetëm përcaktimi i hapësirës së lashtë jetësore shqiptare dhe hulumtimi i përhapjes graduale të vendbanimeve të popullit shqiptar bën të mundur, siç kemi parë, të shkruajmë një histori të popullit shqiptar”.*³⁶

Këtu dua të bëj një sqarim për termin *Landschaft*. Përdorimi i sotëm

³⁴ te Leka 7 (1935), ff. 140-145 dhe 313-321, ashtu si te *Revue internationale des études balkaniques*, Beograd, 3, 1937-38, ff. 345-370.

³⁵ “Der landschaftliche Gegensatz zwischen dem Bergland im Inneren und den Küstenebenen am Adriatischen Meer bedeutete den Gegensatz zwischen Balkan und Adria, der die ganze Geschichte Albaniens und des albanischen Volkes beherrscht, als machtpolitischer Kampf zwischen den führenden Mächten der Adria und der Balkanhalbinsel und als Auseinandersetzung und innere Durchdringung zwischen der adriatischen und balkanischen Kulturwelt, die in den ewig umstrittenen Küstenebenen aufeinander stießen. Dieses Ringen zweier Welten ist das große Thema der zweieinhalb Jahrtausende alten Geschichte dieser Landschaften”, f. 31.

³⁶ “Die Feststellung des uralbanischen Lebensraumes und die Erforschung der allmählichen Siedlungsausbreitung des albanischen Volkes ermöglicht es erst, wie wir gesehen haben, eine Geschichte des albanischen Volkes zu schreiben”. f. 32

gjerman, sipas fjalorëve ka kuptimet: krahinë, trevë, skenë (politike), peizazh,³⁷ pra jo vend, jo shtet, sepse ato kanë identitetin e tyre. Tani, termi *Landschaft* përdoret për vende të këtilla, sidomos në Ballkan, edhe nga shefi i shkollës bavareze të historisë Edgar Hösch, po edhe në raste të tjera. Rezervimi i tij kryesisht për rastin e historisë së Kosovës, ndërkaq, parësisht se mund të mos i kem të qarta të gjitha nuancat përdorimore në gjermanishten, më le përshtypjen e një animi. Nuk kam parë të përdoret për rastet si Maqedonia, Serbia, Bosnja, apo ndonjë vend tjetër ballkanik. E ruajta termin gjerman *Landshaft* në gjuhën shqipe edhe për arsye se ai si i tillë, pra jo lehtë i përkthyeshem, ka depërtuar dhe, ta zëmë, në rusishten në studimet dialektore.

Sa i përket konceptimit të përgjithshëm, dua të bëj një vrojtim të vogël me mbështetje në gjuhësi. Interpretimet rindërtuese lidhur me zhvillimet dialektore të shqipes, sa i përket rotacizmit, kanë vërejtur vjetërsinë e tij, që shkon diku midis shekujve VI-VIII. Rotacizmi ka përfshirë tërë hapësirën shqipfolëse në jug të lumit Shkumbin. Tani, si u bë që të shtrihej në jug të Shkumbinit, madje më përtej në shekullin XIV një popullatë nga Lugina e Matit, asnjëherë rotacizuese? Në vështrimet e tilla historike dispozicioni historiko-gjeografik i fenomeneve dialektore ka po ashtu një vlerë shpjeguese dhe shpërfillja e argumenteve të tilla i bën të paqëndrueshme disputat.

Pas këtij ekskursi shpjegues për kritikën ashtu të vendosura të A. Budës lidhur me konceptet e Stadtmüller-it, efekti i të cilave nuk mund të asgjësohet me komentime aktualizuese ideologjike antikomuniste duke u nisur nga prezumimi dhe e vërteta se Buda vërtet ishte marksist dhe nën ndikimin e marksizmit stalinist ashtu si shihej në Shqipëri në periudhat përkatëse. Thelbi i koncepteve të tij në këtë pikë shkon më tej.

Pak më herët pikëpamjet e Stadtmüller-it janë diskutuar dhe nga studiues të tjerë. Më 1947 indoeuropianisti italian V. Pisani, i cili ishte marrë dhe me çështjen e gjuhës shqipe, në radhë të parë me pozitën e saj

37 Pjesë e sipërfaqes së tokës që ka veçori të caktuara në paraqitjen e saj; pjesë e tokës që dallon nga të tjerat përmes tipareve karakteristike të jashtme. Fjalori Duden online.

midis gjuhëve indoeuropiane dhe me çështjen e prejardhjes së saj, kishte botuar një kritikë për veprën e Stadtmüller-it, që u rimor në veprën e tij të vitit 1959 në formë shtojce për kapitullin *Për problemin ilirik*.³⁸ Në fillim ai e cilësonte vepër me rëndësi për paraqitjen e hulumtimeve të mëparme, por vërente se për gjuhëtarin dalin vështirësi në momentin që autori i librit të përmendur përdor argumenta gjuhësorë për të rindërtuar elemente të kulturës shqiptare të lashtë, apo *'protoshqiptare'*, dhe për ta përcaktuar të ashtuquajturin *'atdhe të parmë'* të shqiptarëve. Arsyetimi i tij, sipas Pisani-t, është ky: këto apo ato fjalë janë huazuar nga një gjuhë tjetër, kjo do të thotë se *'protoshqiptarët'* nuk i njihnin konceptet përkatëse. Derisa emri për *zgjoin* është latin, ndërsa termat për *bletë, mjaltë, dyllë* indigjenë, protoshqiptarët do të kenë njohur bletët e egra, por apikulturën do ta kenë nxënë nga romanët; fjalët që shënojnë 'fusha' e të ngjashme janë me prejardhje latine, sepse *"shqiptarët i njohën rrafshinat në rajone pyjore në kohën kur ato ishin tashmë të romanizuara"*, ndërsa vërejtjes së mundshme që *det* është indigjene, ai i kundërvinte pohimin se *"shprehje të tilla janë të zakonshme edhe ndër popuj të brendisë"*. Por, që ta emërtosh detin duhet ta njohësh, e kjo do të thotë ta njohësh dhe rrafshin, për të shtruar pyetjen: athua malësorët *'protoshqiptarë'* vërtet do të kenë qenë kaq larg nga luginat? Duke referuar f. 120, ku Stadtmüller-i thoshte se barinj të shtegtarë protoshqiptarë i shpinin gjatë dimrit tufat e tyre në fshatra dimërorë në fusha të romanizuara, pyeste: e ku i shpinin? Mospajtimet e tij Pisani i shprehte edhe në mënyrë tjetër. Nëse huazimet do të kishin vlerë ashtu të përgjithshme dëshmuese dhe ekskluzive, do të dilte se grekët para pushtimit romak nuk do të kishin njohur as *shtëpi* as *duq* as *furtuna* as *kandela*, sepse termat neogrekë *spíti, bisákki, fortúna, candíli* janë me prejardhje latine; po as romanët para se t'i merrnin nga grekët nuk do të kishin njohur *shpata, ulëse, gropte, vapë, gambe*, sepse fjalët romane *spatha, cathedra, crupta, cacma, gamba* janë me prejardhje greke, ndërsa *lufta (guerra: werra)* do t'u jetë mësuar paqësorëve romanë

³⁸ Pisani, V.: *Il Problema illirico, Appendice 2: Su Georg Stadtmüller, Forschungen zur albanischen Frühgeschichte*, 1941, in *Linguistica generale e indeuropea, Saggi e discorsi*, I. Torino, 1959, pp. 100-101, së pari në *Archivio Glottologico*, XXXIV, 1942, p. 128 e vijim.

nga gjermanikët. Dhe si do të ishte përfytyrimi i Stadtmüller-it për familjen ‚*protoshqiptare*‘ meqë fjalët *unk*, *emtë*, *fëmijë*, *print* janë latine, ndërsa romakët nuk paskërkan xhaxhallarë, sepse rom. *thius* është greke. Në këtë frymë Pisani diskutonte me distancim të qartë idetë e Stadtmüller-it lidhur me huazimet sllave të shqipes. Pra, nga huazimet sllave ai nxirrte se shqiptarët e hershëm nomadë do të kenë nxënë përmes kontakteve me bujqit sllavë. Në të vërtetë ai njih po ashtu se protoshqiptarët një numër të madh të këtyre të mirave do t’i kenë nxënë më herët përmes kontakteve me romanët. Por pushtimi sllav (600) e paska ndërprerë këtë bashkëjetesë të frytshme kulturash dhe do t’i ketë ndaluar barinj të nomadë në zhvillimin e tyre; vetëm pas nisjes së një bashkëjetese kulturore me popullsinë bujqësore sllave të fushave do të niste ndikimi i frytshëm i të mirave të reja kulturore. Dhe Pisani pyeste, me të drejtë, në çfarë mënyre u ruajtën shprehjet e numërta latine për bujqësi, ndër to edhe parmenda, nëse do të ishin zhdukur konceptet përkatëse?

“Është evidente se Stadtmüller-i mbështetet në një postulat që ka harruar ta demonstrojë: që është se shqiptarët e sotëm qenkan pos për gjuhën, ekskluzivisht vazhdues të barinjve të tyre errantë, për çka askush kurrë nuk ka provuar se popullata e rrafshinës, gjithë duke futur në gjuhën e vet shumë fjalë latine e duke përdorur, pos në klasat më të kulturuar, latinishten, e ka harruar gjuhën kombetare,”³⁹ f. 101.

Po të mendojmë, thoshte ai më tej, mbijetesën e gjatë të galishtes e oskishtes përbri latinishtes, kolonitë greke të Italisë Jugore, ku pushtimi bizantin gjeti të gjalla dialektet e vjetra, do të shohim se postulati i atillë është krejtësisht arbitrar. Dhe më tej: nëse romaniteti dhe greçiteti u atribuohet vendeve ku gjinden mbishkrime në gjuhët përkatëse, duhet të pyesim: sa thellë kishte shkuar ky romanizim apo helenizim? Kjo, na duket, mund të ndërlihet dhe me idenë e Jireček-

³⁹ “Evidentemente lo Stadtmüller si fonda su un postulado che ha dimenticato di dimostrare: che cioè gli Albanesi odierni siano, alieno per la lingua, esclusivamente i continuatori dei suoi pastori erranti, laddove nessuno ha mai provato che la popolazione della pianura, pur introducendo molte parole latine nella sua lingua e usando, alieno le classi più colte, il latino, abbia abbandonato la lingua nazionale”.

ut për ndarjen kulturore afërsisht te via Egnatia me mbishkrimet mbi-sunduese greke në jug, latine në veri. Kështu ai kundërshtonte dhe idenë sipas së cilës tërë Shqipëria qendrore-jugore do të paskësh qenë *'kernbulgarisch'* (bërthamë bullgare), sepse rezistenca bullgare kundër Bizantit paska ndodhur në mënyrë të veçantë në viset malore të Shqipërisë jugore, f. 101. Por koncepti *'bullgar'* për bizantinët ishte një koncept ekskluzivisht politik, jo etnik e gjuhësor, kundërshtonte Pisani. Dhe më tej ai vinte me një përfundim më të përgjithësuar për ne shumë të vlefshëm:

"I tërë i ashtuquajturit problem i 'atdheut primitiv' është shtruar keq në hulumtimet historike apo parahistorike ballkanike, dhe përbën fare mirë çiftin me 'problemin' e vështirë të 'Urheimat' indoeuropian: kemi mbetur këtu tek konceptet e lindura në romantizmin e tetëqindshes, tashmë ka kohë të superuar. Kështu, po ashtu, askush nuk të autorizon t'u atribuosh shqiptarëve të lashtë cilësinë e vetme të barinjve nomadë, mu sikur një popull të duhej të kishte një formë të vetme të jetesës", f. 101.⁴⁰

Pisani rikujtonte se në territorin kombëtar shqiptar njihen *Albanopolis* dhe *Albanoi* të Ptolomeut. Siç mund të shihet në f. 14 të botimit të atëhershëm të veprës së Stadtmüller-it, ai besonte se teoria që tek shqiptarët gjen pasardhësit e ilirëve të lashtë kishte marrë grushtin vendimtar nga zbulimi i venetishtes, që për shumicën e dijetarëve është ilirishte. Por po të përmysej pohimi, të thuhej se venetishtja nuk është ilirishte, sepse nuk pajtohet me shqipen?

Recensionin e Pisani-t ngre çështje me rëndësi për studimet e kësaj fushe jo vetëm lidhur me pikëpamjet e Stadtmüller-it, po edhe me të sllavistikës e të studiuesve të mëvonë, ka rëndësi, por ka mbetur i pahetuar.

⁴⁰ "Tutto il cosiddetto problema della 'patria primitiva' è malposto nelle ricerche di storia o protostoria balcanica, e fa bellamente il paio col barbosso 'problema' della 'Urheimat' indoeuropea: siamo rimasti qui a Concetti nati nel romanticismo del primo Ottocento, e ormai da lunga pezza superati. Così pure nessuno ci ha autorizzati ad attribuire agli antichi Albanesi la sola qualità di pastori nomadi, quasiché un popolo debba avere una sola forma di vita".

Tagliavini/ Stadtmüller

Albanologu dhe romanisti italian Carlo Tagliavini, në veprën *La stratificazione del lessico Albanese. Elementi indoeuropei*, Pàtron, Bologna, 1965 kishte bërë komente lidhur me idetë e Stadtmüller-it. Në pjesën për prejardhjen e gjuhës shqipe, diskutonte dhe për ata që kanë qenë prekur nga teoria për prejardhjen trakase të shqiptarëve, përveç H. Barić,⁴¹ G. Weigand,⁴² së fundi Stadtmüller.⁴³ Pas paraqitjes së teorisë së Barić-it mbi shqipen si një dialekt trakas të ilirizuar, të teorisë së N. Jokl-it, “*albanologut më të mirë bashkëkohës*”, për të cilin thoshte se kishte arritur gradualisht në përfundimin “*që shqipja është e afërt po aq me trakishten sa me ilirishten*”,⁴⁴ ndërsa, po të pranojmë teorinë trakase kjo do të thoshte të nxjerrim përfundimin se paraardhësit e shqiptarëve do të kenë jetuar në një zonë më në lindje se ajo e Shqipërisë aktuale, vijonte me shpjegimet për pikëpamjet e Weigand-it⁴⁵ kundër autoktonisë së shqiptarëve në hapësirat aktuale, që, sipas tij, janë: emrat e vendeve me prejardhje romane nuk e ndjekin përgjithësisht zhvillimin e veçantë fonetik të elementeve latine të shqipes, po të dalmatishtes së vjetër; terminologjia detare dhe e peshkatarisë e shqipes për pjesën më të madhe është formuar nga elemente të huazuara në kohë mjaft të vona, çka nuk do të ishte e mundshme për një popull që do t’i kishte pasur vendbanimet e tij gjithnjë në brigjet e Adriatikut; por një nga kriteret kryesore për origjinën më oksidentale të shqiptarëve e sjell prania e kontakteve të numërta midis shqipes e rumanishtes; jo të gjithë nga ta mund të shpjegohen njësoj; disa do të provonin ngjashmërinë e një substrati etnik, të tjerë për huazime të lashta; në çdo rast duhet të pranojmë që vendi i hershëm i shqiptarëve do të ketë qenë në afërsi të rumunëve, mendohej.

Kjo do të thotë, pas Tagliavini-t, të zëvendësosh një të panjohur me

⁴¹ Në *Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju II*, f. 153 e vijim, Beograd 192...

⁴² Në *Balkan-Archiv II*, 1928, f. 227 e vijim.

⁴³ Tagliavini, f. 21. Referonte: *AECO*, Archivum Centro-Orientalis, Budapest, VII, 67, n. 50.

⁴⁴ ‘Che l’Albanese è imparentato tanto col Trace quante coll’ Illirico’.

⁴⁵ Në *Balkan-Archiv III*, 231.

një edhe më të panjohur sa i përket prejardhjes së rumunëve dhe të vendit të formimit të gjuhës rumune. Historianët dhe filologët rumunë gati njëzëri pranojnë *'teorinë e kontinuitetit'*, çka domethënë se gjuha rumune është formuar në veri të Danubit në Dakinë Trajane, ndërsa arumunët do të kenë emigruar drejt jugut. Historianët dhe filologët e huaj, me pak përjashtime, bashkë me ndonjë filolog rumun (si A. Philippide), lejojnë që vendi i formimit të gjuhës rumune të ketë qenë Dacia Aureliana në jug të Danubit, ndërsa dakorumunët më vonë të kenë emigruar në veri. Në këto diskutime, vërente Tagliavini, ndërhyjnë dhe kritere jashtëshkencore, të rendit politik, që e turbullojnë objektivitetin. Jokl-i,

"duke u mbështetur në argumenta krejtësisht gjuhësorë, kishte besuar ta identifikonte vendin e formimit të gjuhës shqipe në Dardani",⁴⁶

me ç'rast edhe emrin e saj e shpjegonte përmes shqipes *dardhë* < IE **ǵhor-d-*, në afërsi të *Nishit*, prejardhja e emrit të të cilit nga *Naissus* pajtohet me ligjet e fonetikës shqipe.⁴⁷ Këtë përfundim e kishte pranuar dhe Tagliavini.⁴⁸ Këtu ai vijonte me paraqitjen e pikëpamjeve të Stadtmüller-it, sipas të cilit djepi i shqiptarëve do kërkuar në Mat,

"por ku arrin më shumë me argumente negative se sa me prova pozitive"⁴⁹

duke luftuar tezën *dardane* të Jokl-it, sepse

"territori i Dardanisë (Serbia e vjetër e dikurshme dhe një pjesë e Maqedonisë veriore) në epokën romane dhe bizantine arkaike ishte me siguri tërësisht i romanizuar".⁵⁰

Këtu ai i jepte pa dyshim të drejtë Stadtmüller-it, i cili, lidhur

⁴⁶ "Basandosi su argomenti puramente linguistici, ha creduto di identificare il luogo di formazione della lingua Albanese nella Dardania".

⁴⁷ Jokl, Gr. Alb. St, 89 e vijim;

⁴⁸ Tagliavini, *La stratificazione.*, f. 21-22; për pajtimin me mendimin e Jokl-it, cf. Tagliavini, *Dialetto alb. zhego or.* f. 12;

⁴⁹ 'Ma a ciò giunge più con argomenti negativi che con prove positive', referonte Tagliavini, *Rivista d'Albania III*, Roma, f. 4.

⁵⁰ "Il territorio della Dardania (la vecchia Serbia odierna e una parte della Macedonia settentrionale) nell'epoca romana e bizantina arcaica era certamente completamente romanizzata", referonte *AECO VII 43*, Tagliavini, *La stratificazione 22*.

me një popull kryesisht baritor si shqiptarët,


“mendonte se nuk është e drejtë të kërkosh një ‘atdhe’ (Heimat), po më parë një ‘hapësirë jetësore’ (Lebensraum). Në periudhën e pushtimit romak territori albanofon duhej të paraqiste një lloj relikti, si ai i baskëve në Iberi; gjatë epokës romake dhe fillimit të bizantines paraardhësit e shqiptarëve duhej të kishin jetuar në një rajon të brendshëm, kryesisht malor, së paku në muajt e freskët, ndërsa gjatë dimrit do të kenë zbritur në rrafshinat gjuhësisht të romanizuara. Aty ata do të kenë nxënë, në kontaktet paqësore dhe të armiqësisë me romanët organizimin shtetëror dhe format e jetësës sedentare dhe do të kenë nxënë nocione të tilla materiale si apikultura dhe format më të zhvilluara të bujqësisë, siç dëshmojnë elementet latine të leksikut të shqipes”, f. 23.⁵¹

Territori i formimit të shqiptarëve duhej të kishte qenë në fqinjësi me territorin e romanizuar, por edhe në afërsi me territorin gjuhësisht grek, siç dëshmojnë huazimet e numërta greke të lashta të shqipes, elemente që më kot janë kërkuar në rumanishten. Nga ana tjetër, krishterimi i shqiptarëve do të ketë nisur nga qytetet dalmatine.

“Pas analizës së thellë të Stadtmüller-it ‘hapësira jetësore’ e protoshqiptarëve do të duhej të kërkohet në një vend të afërt me Dalmacinë, që do të jetë edhe mjaft afër me kufirin gjuhësor grek. Në këtë mënyrë hapësira në fjalë ngushtohet në zonën e Serbisë së vjetër e të Alpeve veriore shqiptare”.⁵²

⁵¹ “Pensa che non sia giusto cercare una ‘patria’ (Heimat), ma piuttosto uno ‘spazio vitale’ (Lebensraum). Il territorio albanofono, nel periodo della conquista romana, dovette rappresentare derto una specie di relikto, come quello basco nell’ Iberia; durante l’epoca romana e il principio di quella bizantina i progenitori degli Albanesi dovettero vivere in una regione dell’ interno, prevalentemente montuosa, per lo meno nei mesi freddi, mentre durante l’inverno saranno sesi nella pianura linguisticamente romanizzata. Quivi essi appresero, in contatti pacifici e ostili con gli stanziamenti romani finitimi, l’organizzazione statale e le forme di vita sedentaria e appresero anche parecchie nocioni materiali come l’apicoltura e le forme più elevate dell’agricoltura, come dimostrano gli elementi latini del lessico Albanese”. Tagliavini, *La stratificazione*, f. 23.

⁵² “Secondo la profonda analisi dello Stadtmüller ‘lo spazio vitale dei Protoalbanesi deve essere incercato in un paese vicin alla Dalmazia, che si trovi anche abbastanza vicin al confine linguistico greco. In questo modo lo spazio in questione si restringe nella conca della vecchia Serbia e delle Alpi albanesi settentrionali”, Stadtmüller, *AECO VII*, 84, Tagliavini 23.



1. || = dardanët; 2. ≡ = autariatët; 3. ≡ = skordiskët; 4. ≡ = tribalët; 5. ≡ = mezët; 6. / = rrugët kryesore romake

Në skicën më sipër, të shkëputur nga harta më e gjerë që jep F. Papazoglu te *Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba*, Akademija nauka i umjetnosti Bosne i Hercegovine, Sarajevo 1969, shih dhe botimi Equilibrium, Beograd, 2007, shihet pozita që zënë sipas saj, fiset qendrore të Ballkanit: në perëndim dhe jug janë fiset ilire të ardiejve, më tej të dalmatëve e të liburnëve, të parthinëve, taulantëve, dasaretëve, penestëve, orestëve, në juglindje të peonëve dhe në lindje të fiseve trakase të dentelejve, të besëve në qendër të Trakisë midis Ballkaneve dhe Rodopeve, e në verilindje të dakasve; dardanët janë në qendër, ndërsa pandërmjetshëm në perëndim kanë autariatët; në pjesën lindore të Dardanisë, në zonat e Naisit e në lindje vërehet një përzjerje e dardanëve me tribalët dhe skordiskët, të cilët shtriheshin më afër Danubit në veri dhe veriperëndim; në jug të Danubit e në veri të Ballkaneve vërehet mbisundimi i mezëve. Për tribalët ka pasur diskutime nëse ishin trakas, ilirë apo më vete; për përkatësinë e skordiskëve, po ashtu ka pasur diskutime, ndërsa për mezët mendohet përgjithësisht se ishin trakas; Georgiev-i ka ngritur hipotezën që thotë se dako-mezët flisnin një gjuhë të ndryshme nga trakasit dhe se ajo do të ketë qenë paraardhësja e shqipes; për peonët ka pasur po ashtu diskutime nëse ishin ilirë apo trakas, ndërsa tash vonë ka mendime që ishin popullatë më vete; edhe për dardanët ka pasur

shumë diskutime nëse ishin ilirë apo trakas, a diçka e tretë; në iliristikë më i shpeshtë është mendimi se ata ishin ilirë, por ka dhe studiues, sidomos në Rumani, që i shohin si trakas; historia e tyre në periudhën romake i sheh si pjesë të botës ilire. Ata që 'djepin e hershëm' të shqiptarëve e shohin më parë në lindje të Dardanisë, mbështeten kryesisht tek emrat e vendeve Nais (Nish) e Astibos (Shtip), kjo do të thotë se ata paskan qenë në hapësirat e Peonisë dhe pjesërisht të dentelejeve, ndërsa besët, të cilët studiues si Schramm e të tjerë i shohin si paraardhës të pandërmjetmë dalin në zemër të Trakisë me qendër Philippopolis (Plovdiv), ku janë gjetur mbishkrime trakase, por asnjë indicie që do t'i bënte ato të interpretueshme në ndonjë aspekt përmes shqipes. Remesiana (Bela Palanka) që përmendet si vendlindja e Niketës së Dardanisë shtrihet në lindje të Naisit, pikërisht atje ku Papazoglu shihte përzjerje popullatash. Studiuesit si Jokl, Tagliavini e të tjerë si hapësirë të hershme të parashqiptarëve shihnin pikërisht Dardaninë, ndërsa Stadtmüller-i nuk e përfshijte në përfshirjen e një pjese të saj bashkë me grykën e Matit; Hamp-i tërë këtë hapësirë, të shtrirë dhe në jug deri te lumi Shkumbin e në veri deri te Karpatet e shihte hapësirë të gjuhëve IE albanoide, ndërsa Çabej dhe shumë studiues shqiptarë hapësirën dardane e shohin si ilire dhe prandaj edhe pjesë intergrale të hapësirës së hershme parashqiptare. Kështu afërsisht mendonte dhe Katičić-i. Për një pjesë shih dhe diskutimet brenda kësaj pjese të librit.

Kështu Stadtmüller-i, duke lejuar si rajon të mundshëm të hapësirës jetësore të protoshqiptarëve Serbinë e vjetër, i afrohet Dardanisë. Kjo e bënte të drejtohej te rajoni i Matit më shumë sesa te Dardania, ndërkaq, është mungesa e toponimeve latine dhe e rrugëve romane vetëm në rajonin e Matit, pra *"një kriter kryesisht negativ"*, f. 23. Duke marrë parasysh se dy zonat në fjalë (Dardania e Mati) janë larg detit dhe në veri të paraleles së Tiranës,

"mbetet e sigurt që hapësira jetësore e shqiptarëve në lashtësi duhej të kishte qenë së paku në Shqipërinë veriore drejt brendisë. Personalisht jemi të prirur më tej të besojmë për Dardaninë dhe për Matin edhe për shkak se zona e Dardanisë është më e afërt me atë që, sipas disa studiuesve, do të ketë qenë zona e formimit të gjuhës rumune dhe bën të mundur kështu të shpjegohen më mirë raportet gjuhësore shqiptaro-rumune. Nga ana tjetër Dardania mund të duket një rajon pak tepër verior sa i përket pranisë së elementeve të lashta greke në shqipen", f. 24.⁵³

⁵³ Rimane assodato che lo spazio vitale degli Albanesi nell'antichità doveva essere per lo meno nell'Albania settentrionale e verso l'interno. Personalmente siamo poi portati a credere alla Dardania che alla Matia, anche perchè la zona della Dardania e più vicina a quella che, secondo alcuni studiosi, sarebbe stata la zona di formazione della lingua romena e si presta quindi meglio a spiegare i rapporti linguistici albano-rumeni. Dall'altra parte la Dardania può sembrare una regione un po troppo nordica rispetto alla pre-

Nuk do harruar, shpjegonte ai më tej, se kufiri gjuhësor midis greqishtes e latinishtes, sipas K. Jireček-ut, në bazë të mbishkrimeve, nga Lezha kalonte nga rruga midis Shkodrës e Prizrenit, për të arritur në veri afër Scupi-t e më tej drejt Serdica-s.⁵⁴ Nuk do harruar se linja Jireček nuk ishte mur kinez dhe se P. Skok e kishte shpënë atë pak më në jug.⁵⁵ Tagliavini vetë mendonte se rajoni i Matit është ngapak tepër jugor dhe se

*“hapësira e Dardanisë e Maqedonisë perëndimore mund të paraqiste më mirë nga çdo rajon tjetër hapësirën jetësore të protoshqiptarëve”.*⁵⁶

Nëse flasim për “hapësirë jetësore” dhe jo për “djep”, mund të lejohej një zonë relativisht e gjerë prej së cilës fise të ndryshme zhvendoseshin pastaj. Kështu shqiptarët përmenden për herë të parë në vitin 1079 midis Ohrit dhe Selanikut, pra mjaft më në jug,⁵⁷ por në sh. XIII shënohen edhe në Shkup.⁵⁸ Nga ky moment fillon diaspora shqiptare.⁵⁹

Banfi dhe zona e tretë

Emanuele Banfi në studimin e tij për situatën e latinishtes në Ballkan në kohën e invazioneve sllave nisej nga konstatimi se, edhe pse latinishtja kishte kohë që kishte depërtuar në Siujdhesën ballkanike, për sh. V-VI, pra për kohën e depërtimeve sllave,

*“nuk mundet gjithsesi të flitet për një latinizim njësoj homogjen në tërë Ballkanin”.*⁶⁰

senza degli elementi greci antichi in Albanese”, f. 24.

⁵⁴ Referonte K. Jireček: *Die Romanen in den Städten Dalmatiens während des Mittelalters*, Wien 1901-1903, vol. I, p. 13 e tutje.

⁵⁵ Ref. P. Skok, në *Zeitschrift für romanische Philologie*, Heidelberg, LIV (1934), 175 e 179. Udhëzonte edhe tek Philippide, *Originea romînilor I*, Iași, 1925, 71 dhe Rosetti, A.: *Istoria limbii române II*, 28 e tutje.

⁵⁶ ‘Possa rappresentare meglio di ogni altra regione lo spazio vitale dei Protoalbanesi’.

⁵⁷ Cf. Skok, në *RIEB I*, 9).

⁵⁸ Referon Carlo Tagliavini: *Dial. alb. ghego or.* 13.

⁵⁹ Tagliavini, *Stratificazione*, 25.

⁶⁰ Banfi 1972, Emanuele: *Aree latinizzate nei Balcani e una terza area latino-balcanica (area della Via Egnazia)*, në Istituto Lombardo - Academia di Scienze e lettere, *Estratto*

Në shënimin e parë ai veçonte: depërtimi i latinishtes në Ballkan nga sh. III p. K. (luftërat ilirike) kishte kaluar nëpër këto faza: 219 p. K. pushtimi i Istrës; 186 p. K. pushtimi i Ilirikumit; 146 p. K. nënshtrimi i Greqisë dhe Makedonisë; 29 p. K. pushtimi i mezisë; 9 m. K. pushtimi i Panonisë; 56 m. K. pushtimi i Trakisë dhe në fillim të sh. II nënshtrimi i Dakisë.

Rrugët e përhapjes së latinizimit ishin: via Aquileia e Singidunum (Beogradi i sotëm) nëpër luginën e Savës me degëzimet për Naissus (Nish) e Serdica (Sofje) drejt Salonikës e Konstantinopolit; lidhja midis Aquileia e Durrachium përgjatë tërë bregut dalmat; via Durrachium – Thessalonica, pastaj drejt Konstantinopolit, via Egnatia.

Latinishtja u përhap jo vetëm si gjuhë e administratës, po edhe si një *lingua franca* në hapësirën etnikisht johomogjene, gjuhë e këmbimeve dhe e tregtisë. Nga sh. II-III përhapja e krishterimit e favorizoi tërë procesin. Për rrugët dhe proceset e depërtimit të krishterimit në Ballkan dhe pasojat e tij rekomandonte të shihet E. Panaitescu⁶¹ dhe G. Stadtmüller.⁶² Invazioni sllav pati pasoja edhe mbi latinitetin ballkanik:

*“sllavët u vendosën në ato rajone të Ballkanit ku latiniteti ishte më pak i fuqishëm”.*⁶³

Nuk mund të bënin gjë atje ku kontingjenti latin manifestonte rezistenca. Invazioni sllav bëri të përcaktoheshin brenda latinitetit ballkanik tri zona kryesisht të latinizuara: ana bregdetare e Adriatikut nga Dalmacia në Epir; zona përgjatë rrjedhës së poshtme të Danubit, me rëndësi të madhe strategjike; zona përgjatë via Egnatia, me komunikim të vazhdueshëm me bregun italojugor dhe hapësirën e latinizuar të Dalmacisë.

Meqë në sh. V-VI latiniteti ballkanik qe posaçërisht i fuqishëm në këto zona, pjesa tjetër e Ballkanit me latinizim më të vogël u asi-

dai rendiconti. Classe di lettere, v ol. 106, 1972, Milano, ff. 185-233. Këtu: “non si può tuttavia parlare di una latinizzazione egualmente omogenea per tutti i Balcani” f. 215.

⁶¹ E. Panaitescu: *Latinità e Cristianesimo nella evoluzione storica del popolo romeno*, në *Studi sulla Romania*, Roma, 1925.

⁶² Stadtmüller: *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte*, Wiesbaden, 1966, ff. 82-84.

⁶³ “Gli Slavi si insediarono in quelle regioni dei Balcani dove la latinità era meno forte”, 217.

milua më lehtë nga vala sllave.⁶⁴ Të tri zonat kishin kontakte midis tyre deri në ardhjen e sllavëve, pastaj nuk u ndërprejnë krejtësisht, por u zvogëluan ndjeshëm. Gjatë bregut adriatik u zhvillua zona romane me dalmatishten e vjetër; përgjatë Danubit u formua nukleusi më i rëndësishëm i dialekteve rumune, ndërsa në rajonet epirote e makedone përgjatë via Egnatia u zhvillua zona latine prej nga dolën shumë elemente të greqishtes së re dhe të shqipes.⁶⁵ Në zonën e tretë dalin probleme me përkufizimin e kufirit midis latinishtes e greqishtes. Sipas K. Jireček-ut,⁶⁶ në bazë të mbishkrimeve, ajo nisej nga Lissus mbi via Egnatia. P. Skok-u⁶⁷ e ri-dimensionoi tërë çështjen duke arritur përfundimin se zona e ndikimit latin dhe zona e ndikimit grek kufizoheshin mjaft më në jug. Prania e elementeve të shumtë latinë në gjuhën shqipe dëshmon se kjo gjuhë është formuar në një zonë latinizmi të fuqishëm. Këtu jepte shënime për theksimin e këtij elementi nga H. Schuchardt: *Vokalismus des Vulgärlateins III*, Leipzig 1868, pastaj të G. Meyer: *Lateinische Elemente im Albanesischen*, neubearbeitet von W. Meyer-Lübke: në *Grundriss rom. Phil.* I, Strassburg, 1904-1906, ku shqipja cilësohej si një '*halbromanische Mischsprache*'. Në këtë pikë referonte G. Stadtmüller-in, pa komente:

“Ndikimi latin ka vepruar aq thellë dhe fuqishëm saqë shqipen pikërisht për këtë mund ta karakterizojmë si një gjuhë pjesërisht të romanizuar” (Stadtmüller, 1966: 77).⁶⁸

⁶⁴ Banfi, 217-218.

⁶⁵ Aty, f. 218-219. Sa i përket vendit të formimit të rumanishtes, autorë si I. F. Sulzer, *Geschichte des transalpinischen Daziens*, Wien, 1871, sidomos R. Roesler, *Rumänische Studien. Untersuchungen zur älteren Geschichte Rumäniens*, Leipzig, 1871 e vendosin në mezi, ndërsa N. Tomaschek, *Zur Kunde der haemus-Halbinsel*, Wien, 1881 në Dardani, O. Densuşianu, *Histoire de la langue roumaine I*, Bucureşti, 1929, f. 294 - në Iliri. cf. M. Friedwagner: *Über die Sprache und Heimat der Rumänen*. Studimet e vona anojnë nga vendi i formimit të rumanishtes më parë në rajonin dako-miz midis sh. VII e IX.

⁶⁶ K. Jireček: *Die Romanen in den Städten Dalmatiens während des Mittelalters I*, Wien, 1901, f. 13. Banfi, 219.

⁶⁷ P. Skok: *Zum Balkanlatein IV*, in *Zeitschrift für romanische Philologie LIV*, 1934, ff. 175-215; po ai *Bysance comme centre d'irradiation pour les mots latins des langues balkaniques*, in *Byzantion VI*, 1931, f. 371. Banfi, 219.

⁶⁸ “Der lateinische Einfluss hat so tief und stark gewirkt dass man das Albanische geradezu

Pa përmendur kundërshtimin e Pedersen-it, Banfi konsideronte se këtë pozitë e superoi C. Tagliavini, i cili, gjithë duke e njohur ndikimin e madh të latinishtes mbi shqipen, e vuri në pah karakterin autonom të saj (Tagliavini 1941: 90-94).⁶⁹ Sipas Banfi-t, territori ku u formua gjuha shqipe përfshinte hapësirën midis Shkodrës-Prizrenit-Ohrit-Vlorës, duke referuar, pas Jokl-it (Jokl 1924: 85),⁷⁰ Jireček-ut (Jireček 1916; 69),⁷¹ Rosetti-t (Rosetti 1938: 34-36),⁷² Stadtmüller-in:

“Hapësira jetësore e popullit shqiptar të lashtësisë shtrihej brenda kufirit gjuhësor greko-latin në anën e hapësirës gjuhësore latine” (Stadtmüller 1966: 81).⁷³

Dhe menjëherë theksonte faktin se vendi i formimit të shqipes ndërlidhej me zonat I e III latino-ballkanike, dalmatine dhe të via Egnatia. Lidhjet me zonën dalmate qenë posaçërisht intensive gjatë përhapjes së krishterimit:

“Konceptet kishtare, që shqipja i ka huazuar nga latinishtja, shfaqin një përfytyrim tingullor që të çon pamohueshëm tek gjuha e vjetër romane e Dalmacisë”.⁷⁴

Prandaj do kuptuar se në zonën III latino-ballkanike u përhap një latinishte e ngjashme me të Italisë jugore, puleze. Po cilat qenë pasojat e invazionit sllav në zonën III latino-ballkanike? Vendosija e sllavëve në fund të sh. VI e në fillim të VII në tokat e Jonit e zvogëloi ndikimin politik të Bizantit atje, popullata me gjuhë greke iku drejt Egjeut dhe u përcaktua

als eine teilweise romanisierte Sprache bezeichnen kann”. G. Stadtmüller: *Forschungen*, 1966, f. 77.

⁶⁹ C. Tagliavini: *Gli elementi latini nell'albanese*, in *Cultura neolatina I, II*, 1941, ff. 90-94.

⁷⁰ N. Jokl: *Reallexicon der Vorgeschichte*, Berlin 1924, f. 85.

⁷¹ K. Jireček: *Albanien in der Vergangenheit*, in *Illyrsch-albanische Forschungen*, München-Leipzig 1916, f. 69.

⁷² A. Rosetti: *Istoria limbii române II*, București 1938, ff. 34-36.

⁷³ “Der Lebensraum des uralbanischen Volkes lag in der lateinisch-griechischen Sprachgrenze auf lateinischen Sprachgebiet”. Stadtmüller: *Forschungen*, f. 81.

⁷⁴ “Die kirchlichen Ausdrücke, die das Albanesische dem Lateinischen entlehnt hat, zeigen eine Lautgestalt, die unverkennbar nach der altromanischen Sprache Dalmatiens weist”. G. Stadtmüller: *Forschungen*, 83, Banfi 221.

'ndarja e kontingjentit grek nga latini, që mbeti më i qëndrueshëm në territoret e romanizuara', f. 224, 225.

Këtu prapë referonte Stadtmüller-in:

"Gjatë imigrimit të përgjithshëm sllav nga fundi i sh. 6 dhe fillimi i të shtatit sundimtaria bizantine mundi të mbante vetëm zonat bregdetare dhe vende të veçanta të armatosura në brendi. Në Shqipërinë veriore mbajti rrafshin bregdetar me qendër në Durrës", Forschungen, 129.⁷⁵

Dhe po këtu lidhur me qëndrueshmërinë e popullatës latine në zonat e romanizuara referonte edhe një herë Stadtmüller-in:

"Në brendi të kësaj province romake lindore (Praevalis dhe Epirus Nova) popullata e romanizuar mund të jetonte edhe më tej. Prandaj (...) janë ruajtur emra të shumtë latinë vendesh", f. 128.⁷⁶

Midis sh. VI e VII zona III latino-ballkanike

"mblodhi një kontingjent të shënueshëm të latinizuarish të ardhur nga vija danubiane".⁷⁷

Përmes luginës së Vardarit kjo popullatë zbriti në territoret malore të Greqisë Veriore dhe determinoi

"bërthamën themeluese të dialektit maqedorumun: dialekt që edhe sot mbijeton në disa qendra të Greqisë veriore (Epir, Tesali, Maqedoni), të Jugosllavisë jugore (rreth liqenit të Ohrit) dhe të Shqipërisë jugore".⁷⁸

Buda në vështrimin e tij për prejardhjen e gjuhës dhe të popullit vijonte me paraqitjen e pikëpamjeve të gjuhëtarëve, me ç'rast i theksonte meritat e G. Meyer-it, të N. Jokl-it a të R. Katičić-it, po edhe të J.

⁷⁵ "Bei der allgemeinen Slaweneinwanderung zu Ende des 6. und Anfang des 7. Jhs. hatte die byzantinische Herrschaft nur die Küstengebiete und einzelne Waffenplätze in Binnenland behaupten können. In Nordalbanien hielt sie die Küstenebene, die ihren Mittelpunkt in dem festen Dyrrachion hatte".

⁷⁶ "In Inner dieser ostromischen Provinz (sc. Praevalis ed Epirus Nova) konnte die romanisierte Bevölkerung weiterleben. Daher haben (...) zahlreiche lateinische Örtlichkeitsnamen erhalten", Forschungen, f. 128.

⁷⁷ "Accolse un notevole contingente latinizzato proveniente dalla linea danubiana".

⁷⁸ "Il nucleo costitutivo del dialetto macedorumeno: dialetto che ancor oggi sopravvive in alcuni centri della Grecia settentrionale (Epiro, Tessaglia, Macedonia), della Jugoslavia meridionale (attorno all lago di Ohrid) e della Albania meridionale'. f. 225-226.

Thunmann-it, J. G. von Hahn-it, e të tjerëve, për të theksuar sidomos idetë e Eqrem Çabejtë, për të cilat rezervonte hapësirë më të madhe. Kuptohet që ai nuk i njihnte idetë e autorëve të mëvonë si Banfi. Meqenëse ato njihen gjerësisht, ne nuk do t'i paraqesim me këtë rast.

Schramm/ Malcolm

Do të vë në pah, porse, që në shqyrtimet e mëvona për këto çështje sikur ka një rikthim tek ndonjë prej ideve të Stadtmüller-it e të tjerëve, qoftë përmes referimit të tyre si të tilla, qoftë dhe përmes kritikave të tezave të Çabejtë. Në shqyrtimet e tyre Gottfried Schramm (1981; 1998), Aleksandar Loma (1991), Joachim Matzinger (2009) e të tjerë nisen nga diskutimi i pohimeve të Çabejtë lidhur me vazhdimësinë shqipe të toponimeve të hapësirës shqiptare: *Shkodër, Shkumbin, Shkup, Shar, Durrës*, etj. Rezultatet e tyre kanë pika të përbashkëta, por kanë edhe dallime. Për mjaft prej këtyre toponimeve ka pasur diskutime të shumta edhe më herët. Për to është shprehur mjaft ndryshe nga ta Sh. Demiraj (1999) në librin e tij.

Edhe pse mund të mos e kishte bërë eksplicite deri në fund e për çdo rast, Çabej kishte bërë një vërejtje paraprake lidhur me kontestimet e tilla të mundshme: në shqyrtimin e zhvillimit fonetik të këtyre emrave ka dhe çështje kronologjike. Sipas disa diskutuesve, *Scupi, Scodra, Scampinus* janë përshtatur sipas ndryshimit *sk: shk*, ndërsa te *Scardus* sipas *sk: sh*, ndërkohë që mendohet se *sk-* e hershme do të ketë dhënë *h*. Ashtu si te *Durrës* nga *Durrazzo* apo *Дъраць*, mendojnë ata, në rastet e sipërme nuk shihet shqipja, çka do të thoshte se shqiptarët s'kanë qenë në ato anë. Për G. Schramm-in kjo do të thotë se ata janë të ardhur atje nga brendia e Ballkanit, do të kenë lëvizur drejt hapësirave shqiptare veriore duke ikur si të krishterë nga bullgarët para-sllavë paganë. Emrat *Astibos* dhe *Naissus* në gjendjen e sotme të tyre, siç kishte theksuar qysh brezi Barić-Weigand, *Shtip* dhe *Nish* kanë arritur vetëm përmes shqipes, e të këtilla nuk kanë

mbetur pa u shqyrtuar nga historianë të kohës sonë.⁷⁹

Noel Malcolm-i në veprën *Histori e shkurtë e Kosovës* e kishte rivështruar çështjen duke e rikthyer pjesërisht te koncepti i mëhershëm i ngjashëm i Jokl-it për djepin e lashtë të shqiptarëve në Dardani e përreth. Malcolm-i ishte marrë me kritikën e pikëpamjeve të Schramm-it lidhur me prejardhjen e shqiptarëve nga fisi i besëve trakas. Besët që jetonin në zonat e Bullgarisë perëndimore dhe në malet jugore të Bullgarisë, siç ishte e njohur, e flisnin gjuhën e tyre deri në shekullin e gjashtë; dihet po ashtu se ishin kristianizuar. E tërë kjo lidhet me historinë e raportuar të murgjve besë që flisnin gjuhën e tyre ashtu si latinishten e gjuhë të tjera në një manastir të Malit Sinaj në vitin 560. Kjo histori e besëve është diskutuar në mënyra të ndryshme, ndërsa Schramm-i në konceptimet e tij këta i konsideronte paraardhës të shqiptarëve. Këta besë do të kenë lëvizur nga atdheu i tyre drejt viseve shqiptare veriore nga fillimi i shekullit nëntë, mbase për të ikur nga përndjekjet e të krishterëve nga ana e kanëve bullgarë paganë. Sipas tij, besët ishin kristianizuar herët përmes ndërmarrjes së peshkopit Niketa, mbase në shekullin e katërt, ndërsa, siç thuhet, nga shkrimet e një miku të tij, mësohet se Niketa e kishte mësuar gjuhën e besëve dhe u kishte mësuar atyre ta ushtronin krishterimin në atë gjuhë. Kjo do të thotë se besishtja përdorej si gjuhë liturgjike. Më tej shtrihet supozimi se Niketa, gjuhë e të cilit ishte latinishtja, mund të kishte përkthyer pjesë nga Bibla, diçka sipas modelit të peshkopit heretik Wulfila, i cili e kishte përdorur gotishten për liturgji e përkthim të Biblës te popullata fqinje gote në hapësirat e Bullgarisë veriore. Dhe sipas tij, siç tregojnë edhe rastet e armenishtes a të koptishtes, mbijetesën e një gjuhe nga kohë të hershme e bën të mundur ekzistenca e një lloj kisha nacionale. Por si u bë që te shqiptarët, megjithatë, gjuha u shkrua mjaft vonë?, kjo mbetet pezull.⁸⁰

⁷⁹ Tani, shembulli i *Naissus: Nish* na shpie më në veri, por gjithnjë brenda hapësirës dardane, pra ende jo bese; nga ana tjetër, *Astibos: Shtip* na çon më tepër drejt peonëve, për gjuhën e të cilëve ka shumë hamendësime: ishte ilire, trakase, apo gjuhë më vete. Të gjitha këto, natyrisht, nuk flasin në të mirë të supozimit të përmendur.

⁸⁰ Për një kritikë të ideve të Schramm-it të shihen po ashtu Schütz dhe sidomos Fiedler (1996: 495-501).

Tani, historiani me njohuri jo të vogla filologjike, N. Malcolm, nuk e kishte të vështirë të pranonte se shqiptarët e morën krishterimin nga mësues latinishtfolës. Gjithashtu nuk e kishte të vështirë të shënonte se gjuha shqipe kishte huazuar shumë fjalë nga latinishtja, nga romanët fqinj apo nga barbarë të romanizuar dhe kjo mund të shkonte madje deri nga sh. II para Krishtit. Ai gjithsesi nuk mund të mos shënonte se elementi latin i shqipes është mjaft i gjerë në fushën e besimit të krishterë dhe të praktikës kishtarë të krishterë. Ai shënonte fjalë si *meshë*, *peshk*, *ungjill*, *mrekull*, nga fusha e pandërmjetme, por edhe fjalë që mund të dalin në fusha të afërta, si psikologji, moral a bota e natyrës (*qiell*, p.sh.). Shumë prej fjalëve latine në shqipen nga këto fusha në fakt nuk janë terma thjesht kishtarë: për *shpirt*, *mëkat*, *i shenjtë* në shumë gjuhë edhe para krishterimit ka fjalë vendëse. Përkthyesit e Biblës armenisht, gotisht a anglo-saksonisht kishin përdorur fjalë vendëse për këtë qëllim. Pas këtij konstatimi, Malcolm-i pyeste:

“Pse do të duhej Niketa, duke përkthyer në proto-shqipen, thjesht të transferonte një sasi të gjerë fjalësh latine?”⁸¹

Arsyet kulturore që përmend Schramm-i, në sytë e Malcolm-it, nuk mjaftojnë për të shpjeguar se pse, ta zëmë, në shqipen ishte marrë edhe fjala baritore latine *grigjë* (*gregem*), ndërkohë që shqiptarët si popull bariotor do të kishin fjalë të tyre për të. Tërë këtë Malcolm-i e shihte të zgjidhshme përmes interpretimit të zakonshëm të huazimeve latine në shqipen.

“Këto elemente të vokabularit latin kanë kaluar saktësisht nëpër të njëjtat lloje të ndryshimeve tingullore, tkurrje dhe rrëgjime, si të gjitha fjalët e tjera latine që kanë hyrë në shqipen gjatë disa shekujve; dhe arsyeja pse ato fjalë hynë në gjuhë ishte se shqiptarët ishin në kontakt, gjatë një periudhe të gjatë, me njerëz që flisnin latinisht. Ekzistenca e sasive të gjera të fjalëve latine të lidhura me Krishterimin nuk tregon se dikush e ka ‘përkthyer’ ligjëratën e krishterë në shqipen e hershme. Ajo tregon pikërisht të kundërtën - pra, se shqiptarët për një kohë të gjatë i ishin ekspozuar sjelljes në fe-

⁸¹ “Why should Nicetas, translating into proto-Albanian, have simply transferred huge quantities of Latin words?”, Malcolm (1998), f. 36.

në e tyre jo në përkthim po në origjinalin latin” (përkthimi R.I.).⁸²

Ai merrej dhe me analiza gramatikore, të cilat duhet ta dëshmojnë këtë pohim të Malcolm-it, e të cilat janë të njohura në albanistikë. Malcolm-i vinte me përfundimin e qartë:

“Teoria e Schramm-it, pra, bie; dhe duke bërë kështu ajo na jep një shërbim të shënueshëm. Falë Schramm-it, trakasit tani mund të eliminohen nga hulumtimet e tilla. Hulumtimi i tij për veprimtaritë e Niketës tregon se besët e morën krishterimin e tyre, të themi kështu, në përkthim; kjo duhet të na detyrojë të konkludojmë se shqiptarët, të cilët e morën të tyrin në origjinalin latin, nuk mund të identifikohen me besët...”⁸³ “Prandaj, prejardhja e shqiptarëve duhet të kërkohet në anën ilire, sidomos në malet përreth Kosovës, në Malësi dhe në vargjet e maleve që shtrihen në veri prej andej nëpër Mal të Zi” (përk. r. i.).⁸⁴

Më tej ai shpjegonte dhe teorinë pas së cilës kjo hapësirë duhej të shtrihet në jug deri në Mat e Dibër, deri te Shkumbini, por njëherësh sillte çështjen e raporteve me rumanishten, për të parapëlqyer teorinë që këto raporte i shpjegon përmes kontakteve midis rumunëve e shqiptarëve të hershëm. Hapësira ku mund të ketë ndodhur kontakti midis vllahve dhe shqiptarëve, sipas tij, pas invazionit sllav, do të ketë qenë ajo e luginës së Moravës, e Maqedonisë së epër dhe tërë Kosovës, pra pjesët e larta të

⁸² “These elements of Latin vocabulary have undergone exactly the same sorts of sound changes, compressions and erosions as all the their Latin words which entered the Albanian language over several centuries; and the reason why those words entered the language was that the Albanians were in contact, over a long period, with people who spoke Latin. The existence of large quantities of such Christianity related Latin vocabulary does not show that someone ‘translated’ Christian discours into early Albanian. It shows the precise opposite – namely, that the Albanians were for a long time exposed to the conduct of their religion not in translacion but in the original Latin.”, Malcolm (1998), 36-37.

⁸³ “Schramm’s theory falls, therefore; and in so doing it performs a signal service. Thanks to Schramm, the Thracians can now be eliminated from these inquiries. His research into Niceta’s activities does indeed show that the Bessi received their Christianity, so to speak, in translacion; this must force us to conclude that the Albanians, who received theirs in the original Latin, cannot be identified with Bessi”, Malcolm 1998: 37;

⁸⁴ “The origins of the Albanians must be sought, therefore, on the Illyrian side of the divide - particularly in the mountains round Kosovo, in the Malësi, and in the tangle of mountains streching north from there through Montenegro”, Malcolm (1998), 37-38.

Kosovës, sidomos në anën perëndimore, përfshirë Malin e Zi:

“Kjo sugjeron se rajoni i Kosovës, bashkë me së paku një pjesë të Shqipërisë Veriore ishte fokusi crucial i dy historive të ndërlidhura por të ndryshme etnike: i mbijetesës së shqiptarëve dhe i emergjencës së rumunëve dhe të vllahve. Një grup i madh i vllahve duket të jetë larguar dhe të ketë ikur drejt jugut rreth sh. nëntë ose dhjetë; proto-rumunët mbetën në kontakt me shqiptarët ndjeshëm më gjatë, para se të largoheshin në verilindje dhe të kalonin Danubin në shekullin dymbëdhjetë”(përkth. R. I.).⁸⁵

Ka mjaft vend për diskutime lidhur me këto pohime. Në Kosovë, në Mal të Zi e në tërë Serbinë ka pasur popullatë vllahe (romane, pra ilirë-dardanë të romanizuar, ashtu si dhe më në lindje trakas të romanizuar). Gjurmet romane-vllahe në Kosovë në toponimi ekzistojnë (*Partesh, Sharban, Llashticë, Vlashnje, Lashnje, Lashkobare, Vllasi, Stanishor, Nishor, Muçibabë (Munçi Baba), Miçivërcë (Minçi Vîrç), Ponesh, Kukulean*, etj.), por ato janë mbase më të pakta se në Serbi a në Mal të Zi e madje edhe në Bosnje, ku shënohen dhe male si *Visitor, Pirlitor, Palator, Romanija*, etj. Nuk më duket e dyshimtë se kontaktet e shqiptarëve të hershëm me rumunët e hershëm për një pjesë do të kenë ndodhur në zonat e përmendura (sidomos në luginën e Moravës Jugore - *Vlasina, Vlasotince, Surdulica, Korbevac, Kriva Feja*, etj.). Por rumunët e hershëm do të jenë shtrirë edhe ndjeshëm më larg në veri; shqiptarët e hershëm edhe ndjeshëm më në jug. Lokalizimi i përmendur i hapësirës së shqiptarëve të hershëm, nga ana tjetër, nuk arrin të shpjegojë shtrirjen dhe dispozicionin dialektor të shqipes, sidomos jo në raport me izoglosa të mëdha si rotacizmi, që kohësisht vendoset para sh. VIII. Koncepti i Budës, i ndërtuar mbi supozimet e Çabejtë sa i përket aspektit gjuhësor-toponimik, i plotësuar me tendencat për të bërë dhe shpjegime sociale, më duket historikisht gjithnjë depërtues, porse këmbëngulja për inkludim të thjeshtë etnik e gjuhësor të hapësirave bregdetare, pa mbetje, mund të zgjojë diskutime, po ashtu.

⁸⁵ “What it suggests is that the Kosovo region, together with at least part of north Albania, was the crucial focus of two distinct but interlinked ethnic histories: the survival of the Albanians, and the emergence of Romanians and Vlachs. One large group of Vlachs seems to have broken away and moved southwards by the ninth or tenth century; the proto-Romanians stayed in contact with Albanians significantly longer, before drifting north-eastwards, and crossing the Danube in the twelfth century”, Malcolm 1998: 40.

Sërish emërtimet

Aleksandar Loma⁸⁶ në diskutimet historiko-fonetike dhe etimologjike, ku e ku mbase të sforcuara, tërë çështjen e kthente në fakt te pikëpamjet e mëhershme të G. Weigand-it⁸⁷ e I. Popović-it për prejardhjen e shqiptarëve.⁸⁸ Pas këtij të fundit, në vazhden e diskutimeve të mëhershme të M. Seliščev-it, shqiptarët në hapësirat e sotme qenkan të ardhur, madje vonë, pas sllavëve. Meqë nuk dihet as vendi prej nga erdhën as koha, sikur del e nevojshme, supozoj, t'i shohim ata si popull migrator, pra popull barinjsh (*"në sh. XI shfaqen shqiptarët dhe e desllavizojnë krejt vendin"*, mendonte për Shqipërinë, pa marrë mundimin të tregonte ku ishin ata shqiptarë më parë dhe prej nga u shfaqën tani, si e bënë desllavizimin, etj).⁸⁹ E argumentuar në aspektin historik, analiza e Budës u bie ndesh vështrimeve të tilla dhe jep arsyetimin pse ato nuk kanë gjasa të merren si bazë.

Kritikës së Budës vështirë se i qëndrojnë as konceptimet e Vladislav Popović-it e të tjerëve për paraardhësit e Antikitetit të vonë të shqiptarëve si për një masë amorfe të dalë nga lashtësia ballkanike. V. Popović, ndër të tjera, kishte shënuar se leksiku i shqipes përtreguaka që folësit e saj paskan qenë popull gjysmënomad, që mënyra e tij e jetesës mund të krahasoheshka me të vllëve, që paskan shitur kryesisht prodhime qumështi e leshi, paskan blerë kripë që u qenka dashur dhe patjetër rrugës paskan bërë edhe plaçkitje.⁹⁰

⁸⁶ Loma 1991: 279-327.

⁸⁷ Weigand 1927.

⁸⁸ Popović, I. 1958: 301-324. Popović, I. 1960: 158. Weigand 1927.

⁸⁹ Lidhur me tezën e Seliščev-it të mbështetur e avancuar nga I. Popović, Çabej tashmë e kishte shprehur kritikën, Çabej 1972: 81.

⁹⁰ "U suštini, albanski leksički fond odaje semi-nomadski i čobanski narod koji je za vreme hladne sezone nastanjivao kontinentalni pojas brežuljaka, gde je uspostavljao dodir sa stanovništvom iz nižih predela, a preko leta odlazio prema pašnjacima visokih planina. Njihov način života mogao bi se uporediti sa onim što, prema arhivskoj građi, znamo o Vlasima i Morovlasima, koji su u primorske krajeve karavanima prevozili različite sirovine, mlečne proizvode i vunu i dovozili stoku, kako bi zauzvrat dobijali u prvom redu

Anash njohjet gjithsesi të dyshimta të shqipes nga V. Popović, i cili, megjithatë, merrte guximin të gjykonte kështu prerazi për të dhënat, historiani i kalibrit të Budës nuk mund të mos reagoonte ndaj formulimeve të këtilla të polemikës me prapavijë etnocentrike. Në disa vende në tekstin e V. Popović-it ndeshen madje edhe tone të tjera.

Për mendimin tim, edhe po të ishin të sakta pohimet e përmendura për emrat *Durrës, Shkumbin, Shkodër, Shkup, Sharr*, si të painterpretueshme përmes shqipes, çka vështirë se mund të përlligjet, ka toponime të tjera, si *Mat, Bunë, Tomor, Ishëm, Drî*, që flasin të kundërtën. Për emrin *Durrës* ka pasur shumë diskutime. Shih për këto më gjerësisht Sh. Demirajn në librin e përmendur. Për *Astibos: Shtip* mund të diskutohet edhe çështja e shurdhimit në fund. Nga ana tjetër, fakti që zhvillimet fonetike tek *Astibos: Shtip* dhe *Naissos: Nish* mund të interpretohen si zhvillime brenda shqipes nuk mjafton për të vendosur që paraardhësit e shqiptarëve t'i shohim si të ardhur nga pjesët lindore të Ballkanit, po mbase më parë mund të jetë argument për të përkapur shtrirjet e mëhershme të tyre edhe në hapësira të tjera, pra deri atje, si vazhdimësi e hapësirës së tyre.

Te shembujt e kontestuar *Scodra, Scupi, Scampinus, Scardus mons*, le të vërejmë se në të gjitha rastet, pos te *Sharr*, kemi të bëjmë me refleksin e rregullt *sk: shk*, si te huazimet latine të shqipes. *Scodra, Scupi, Scampinus* kanë qenë qendra të mëdha romake dhe kjo e shpjegon faktin se emrat e tyre trajtohen njësoj si fjalët latine me grup të tillë nistor. Te *Sharri* kemi të bëjmë me një refleks më të hershëm. Kjo e shpjegon faktin se te sllavët, ku do të pritej refleksi normal **Skrad*, si te *Scardona: Skradin* në Dalmaci, nuk kemi gjurmë të tilla. Thjesht ata nuk e kishin ndeshur formën *Skard-*. Emra të tjerë si *Tomarus: Tomor, Drivastum: Drisht* (te Bogdani kemi *Drîsht* – athua nga *Drî?*), *Mat, Drî*, etj. flasin vetiu.

Buda, në frymën e diskutimeve të Çabejtë, fliste për njësinë e shqipes në kohën e huazimeve latine e greke të lashta, për numrin e vogël të

so, toliko neophodnu za stočarstvo, baveći se uzgred i po potrebi pljačkom”, Popović, V. 1988: 242-244.

sllavizmave të përbashkët në shqipen, pra për vendosjen dhe dispozicionin e shtrirjes dialektore të shqipes, që historikisht nuk mund të shkonte në hapësira të tjera, ndërsa ndarja dialektore shtrihet deri në sh. IV-V, etj.

Rabънь

Me të këtilla interpretime mund të ndërlidhej çështja e emrit *arbën/ arbër* te fqinjët tanë veriorë.

Emërtimi për *Arbënë* te sllavët në Mesjetë ishte *Rabънь*, *rabънь-ski*.⁹¹ Siç shënonte S. Ćirković, në tekstin *Žitija Stefana Nemanje* të vitit 1208, apo në versionin pak më të hershëm nga i biri Sava, në regjistrin e gjërave të arritura dhe të trashëguara që ai i kishte shtuar vendit, ndër të tjera, shënohej:

“od pomorske zemlje Zetu s gradovima, a od Rabna Pilota oba”.⁹²

Rabънь të kujton formën që gjallonte edhe më vonë te Budi *Arbë-në*, prej së cilës, sipas mendimit tonë, do të jetë metatetizuar forma sllave. Pra, vendi identifikohet si *Arbënë* > *Rabънь*. Kjo e fundit vështirë se mund të dilte nga *Arbanum* apo *Arvanon*: në rastin e parë do të kishte dhënë, mbase **Rabon*, ndërsa në të dytin diçka si **Ravan*. *Rabънь* do të jetë nga *Arbënë*, ndërsa shënimi në sh. XIII e XIV do të jetë më parë libresk. Në fund të sh. XIV del *господињь Рабъньски*. Më tej Ćirković e lidhte këtë me një përmendje të ngjashme në Dokumentin e Nemanjës për Hilandarin, të hartuar më 1198, ku thuhet: *“i ot Arbanas Pilot”*.⁹³ Më tej ai komentonte:

“Raban është forma e emrit Arbanum apo Arbanon të burimeve latine e greke e ndryshuar me metatezë. Dy shekuj më vonë në të njëjtin mbishkrim tregjuhësh zoti Karl Topia veten e quante ‘rabanski gospodin’... Më në fund, në Dokumentin e Nemanjës ‘Arbanasi’ është baras-

⁹¹ Ćirković (1988), 323-340.

⁹² “nga toka bregdetare Zetën me qytetet, e nga Arbëni të dy Pultët” [od pomorske zemlje Zetu s gradovima, a od Rabna Pilota oba], f. 328, referonte *Spisi sv. Save*, ed. Ćorović (1928), 151-152.

⁹³ Citon: Miklosich (1858), 4; Solovjev (1926), 12.

vlerë për ‘Raban’, çka heq çdo dyshim”.⁹⁴

Në të vërtetë këtu mund të lindin disa dyshime. Së pari, forma sllave e shkruar nuk ishte emërore *Raban*, po gjinore *ot Rabьna*, pra *Rabna* dhe i referohej vendit, ndërsa forma për përkatësinë ishte *ра-бьньски*, jo *rabanski*. Forma konkurruese *Арьбанас* në po atë kohë, përveç se flet për statusin atëherë më libresk të *Рабьнь*, mund të japë indikacione për emërtimin e vendit jo me apelativ abstrakt, po pikërisht përmes etnikut, çka mund të ndikojë në bazën *Arbënë*. Për më tepër, në dokumentet sllave kemi edhe formën e tretë me referim te greqishtja – *арванитьчески, арванитьчeskaja zemlja*.

Metateza ar/ra i përket sllavishtes së përbashkët dhe ka ndodhur mjaft herët. Shaban Demiraj, i mbështetur te Georgiev, supozonte:

*“Dukuria e ‘metatezës së lëngëzoreve’ apo ‘ligji i hapjes së rrokjeve të mbyllura nëpërmjet metatezës’ së lëngëzoreve në sllavishten perëndimore, pra edhe në sllavishten e Ballkanit, është përfutur në periudhën e vonë (të dytën ose të fundit) të zhvillimit të gjuhës parasllave. Kjo dukuri ka nisur të shfaqet aty nga fundi i shekullit IX të erës sonë”. Pra trajta më e vjetër *Rabënë* < *Arbënë*, që ka pësuar metatezën *arb* > *rab*, ka hyrë në sllavishten e Ballkanit nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta midis stërgjyshërve të shqiptarëve dhe stërgjyshërve të fqinjëve tanë veriorë sllavë në periudhën pas shekullit IX dhe para shekullit XII, d.m.th. për afërsisht aty nga shekulli X ose të shumtën në shekullin XI.”*⁹⁵

Po aty Demiraj trajtën *Арьбанась* të dokumenteve sllave të sh. XII e shihte si variant jopopullor (pa metatezën *ar-* < *ra-*) të stilit të gjuhës zyrtare. Këtu gjithsesi do të themi se në atë kohë nuk vepronte më metateza, prandaj kjo formë ishte normale, ndërsa forma e vjetër tashmë përdorej

⁹⁴ “Raban je metatezom izmenjeni oblik imena Arbanum ili Arbanon, latinskih i grčkih izvora. dva veka kasnije u istom torjezičnom natpisu albanski velikaš Karlo Topija sam sebe naziva ‘rabanski gospodin’. ... Uostalom, u Nemanjinoj povelji ‘Arbanasi’ su ekvivalentat za ‘Raban’, što otklanja svaku sumnju”, f. 328. Në fustotë ai ka shënuar: *Карль Топииа господинь Рабьньски* u slovenskoj verziji natpisa iz 1381. Shih Thallóczy & Jireček & Šufflay (1918), reg. nr. 375. 328.

⁹⁵ Demiraj, Sh. (1989), 222-223; referon Georgiev (1964), 13 v., 98, 38 dhe Mirčev (1958), 138 v.

për inerci të gjuhës së shkrimit.

Te Georgiev-i, ndërkaq, kemi këto shënime kronologjike: në emrat sllavë deri në fillim të sh. IX nuk kishte metatezë e për këtë sillte shembuj nga hapësira greke. Për gjuhët sllave perëndimore ai do të thoshte se

*“procesi i metatezës ka mundur të fillonte më vonë dhe të zgjaste shumë dhjetëvjetësia. Kështu për shembull metateza e (t)alt > (t)lat mbaron në bullgarishten e vjetër nga fundi i sh. IX”.*⁹⁶

Aleksandar Loma, ndërkaq, gjithë duke pranuar se forma metatetike e emrit *Arbënë – Рабынь* (ai shënonte dhe *Лабынь*, çka nuk është dokumentuar) tregonte se sllavët vendin e kishin njohur mjaft herët, para shekullit X, thoshte se forma *Arbanas* është më e vonë, për të nxjerrë përfundimin:

*“njohja sllave e kësaj krahine në Shqipërinë e sotme, sipas kësaj gjetjeje, do të ishte më e hershme se njohja e tyre e vetë shqiptarëve me atë emër, që për këtë popull është shënimi më i vjetër i njohur.”*⁹⁷

Në të vërtetë kjo do të thotë diçka tjetër: sllavët njohën vendin *Arbënë* me statusin përkatës politik së paku në shekullin IX dhe kjo ishte shprehur në formën metatetike, ndërsa më vonë emërtimi për popullin u përshtat sipas gjendjes në gjuhë. Krahas *Рабынь* kemi, për vendin, cilësimin *рабыньски*. Por nuk janë dëshmuar kund format **Рабынас*, si etnik, as **Рабынија*.

Na duket i drejtë mendimi i sllavistëve, pas të cilëve metateza e përmendur do të ketë ndodhur në kapërcyell të sh. VIII-IX, ashtu siç kishte menduar F. Ramovš më 1936: në sllavishten *Carolus* (sipas Carolus Magnus, i cili kishte vdekur më 814) ka dhënë *kralj*, me metatezë (*Karl* > sl. **kǎrlъ* > *kralj*), ndërsa latinishtja *altare: oltarъ*, pa metatezë, ndërkohë që krishterimi i sllavëve u bë nga mesi i pjesës së

⁹⁶ Georgiev (1964), 98-99.

⁹⁷ “... slovensko poznanstvo sa tom oblašću u današnjoj Albaniji bilo bi, po ovom nazivu, ranije od njihovog poznanstva sa samim Albancima pod tim imenom, koje je za ovaj narod najstarija poznata oznaka”, Loma (1991), 281.

dytë të sh. IX.⁹⁸ Analiza e Ramovš-it do të thotë se metateza kishte vepruar në fillim të shekullit, por jo në pjesën e dytë të tij. Tani, po të kishte vepruar metateza sipas emërimit latin *Arbanum*, do të pritej që në sllavishte të kishim **Rabonь* apo **Rabona*, ngjashëm me *Albona*: *Labin* në Dalmaci. Kjo do të thotë, po ashtu, se ai emërtim do të ketë hyrë në sllavishten nga forma shqipe, e ajo do të ketë qenë *Árbanë*, *Árbënë* me theks mbi *a*-në nistore, ndërsa zanoret e pathek-suara të shqipes në vijim të fjalës (*a*, *ë*) do të kenë dhënë zanore të reduktuar (*ь*) në sllavishten. Sipas kësaj mund të avancohet supozimi se qysh në fund të shekullit VIII sllavët do të kenë njohur hapësirën e Arbënit përmes formës gege të parotacizuar. Formën e përbashkët para rotacizmit e kishin ndeshur dhe grekët, e kjo do të thotë para sh. V-VI. Mendoj se të gjitha këto i shtojnë argumentet për lidhjen midis *Albanum*, *Alvanon* të sh. XI dhe *Albanoi*, *Albanopolis* të sh. II, lidhje të cilën Buda e mbështeste me argumente të natyrës historike.

Vështrime të kësaj natyre sikur i japin të drejtë Çabejtë për të mos e pranuar interpretimin e Skok-ut e të tjerëve për lidhjen e *Lab* e *Labëri* me **Alb* e **Albëri* përmes metatezës së përmendur. Format **Alb* e **Albëri* nuk janë dëshmuar, por kemi në veri fisin ilir *Labeates*, në kohë të reja emrin e lumit *Llap* dhe *Laplje Selo* te Prishtina, etj.

Çështjet komplekse të studimeve ndërdisiplinore për prejardhjen e gjuhës dhe të popullit shqiptar në relacionet me popullatat e la-

⁹⁸ Ramovš (1995), 24-27; Ivšić (1970) nuk cakton kronologji, por në shënimin në fund të faqes 102 botuesit J. Vrana e R. Katičić kanë shënuar: "Në një shënim të papërpunuar marginal Ivšić i kthehet mendimit se metateza duhet të ketë ndodhur rreth vitit 800 të erës së re, sepse e ka përfshirë emrin Karl, me të cilin, sipas Karlit të Madh, në gjuhët sllave shënohet sundimtari, dhe thekson se vetë metateza ka mundur të shfaqej shumë më herët..." [na nerazrađenoj marginalnoj bilješci osvrće se Ivšić na mišljenje da je metateza morala nastupiti oko 800 n. e. jer je zahvatila ime Karl, kojim se prema Karlu Velikom u slav. jezicima označuje vladar, i ističe da se sama metateza mogla aviti mnogo prije, ali je pravac razvitka trajao i mnogo dulje]. Cf. *Poredbena gramatika hrvatskog jezika*.

shta ballkanike (komplekset ilirë, trakas, etj.), lidhur me këtë edhe vendi i formimit të hershëm të popullit shqiptar dhe të gjuhës shqipe, bashkë me to çështjet e fazave të mëhershme lidhur me formimin e ilirëve dhe me raportet e tyre me popujt e tjerë indoeuropianë, ashtu si të gjuhës shqipe me gjuhët e tjera IE, në një anë, ashtu si çështjet që lidhen me Lashtësinë e vonë dhe Mesjetën e hershme shqiptare, kanë nxitur dhe vazhdojnë të nxisin diskutime nga më të ndryshmet. Për disa prej tyre nuk është e lehtë, ndonjëherë madje fare e mundshme, të jepen përgjigje të thjeshta e të prera. Personalitete të shkencës si Eqrem Çabej, me ndihmesat e tij thelbësore në fushën e gjuhës, dhe Aleks Buda, me përgjithësimet dhe sintetizimet mjeshtërore në fushat historike, na kanë bërë të mundur ta kuptojmë më mirë kontekstin historik dhe kulturor-shkencor të zhvillimeve dhe të studimeve lidhur me to, duke dhënë përgjigje, apo duke hapur shtigje për kërkimin e tyre më konkretisht. Në interpretimet përgjithësuese të hulumtimeve të veta apo të rezultateve të hulumtimeve konkrete të bëra nga të tjerët, në sintetizimin e dijeve në këto hulumtime, në interpretimet e gjera të proceseve të formimit të popullit shqiptar dhe të lindjes së marrëdhënieve feudale në sh. VIII-XII, çka çoi te proceset e një shtetformimi të ri, me një natyrë dhe ndërtim për të cilat ai fliste përmes analizave të atyre proceseve, Aleks Buda ka shfaqur sens dhe zotësi të veçantë. Erudit i gjithandeshëm, nga historianë nxënës të tij Aleks Buda është quajtur *mjeshtër i historiografisë*. Figura diturore e Aleks Budës karakterizohet me një gjerësi të madhe, me ide shpjeguese për fenomenet, me kërkim të njohjes së horizonteve të zhvillimit të fenomeneve dhe jo vetëm të detajeve. Në rrethanat e mungesës së theksuar të dokumentacionit për faza të caktuara të historisë shqiptare vizioni i tij mund të ishte orientues për studime të frytshme më tej. Le të përsërisim, më parë se me studimin e detajit, të proceseve konkrete historike apo të interpretimeve të materialeve gjuhësore, mbase edhe të të dhënave të arkivit apo të truallit, të të dhënave në përgjithësi, Aleks Buda u mor me vrojtimin përgjithësues dhe sintetizues, interpretimin e proceseve, qartësimin e horizontit dhe të vështrimit që do të bëhet i rëndësishëm në historiografinë shqiptare dhe si i tillë i identifikueshëm dhe i njohur në stu-

dimet më të gjera historiografike, po edhe për studimet e historisë gjuhësore. Nuk do mend se në këtë bazë të trashëgimisë së tij vjen e bëhet barrë interpretimi ideologjizues i mbishtuar.

PËR RAPORTET E SHQIPES ME RUMANISHTEN

Hyrje

Historia e studimit të raporteve midis shqipes dhe rumanishtes është e gjatë. Shqipja është gjuhë indoeuropiane, e karakterizuar si e tipit *satəm*, me afri të veçuara qysh nga G. Meyer e të theksuara nga N. Jokl, për një pjesë nga E. Çabej, më vonë E. Hamp, A. Desnickaja, me gjuhët e veriut (baltosllave dhe gjermanike). H. Pedersen-i i kishte vënë në pah afritë e saj me grupin e idiomave jugore, ku hyn dhe armenishtja.

Shqipja flitet në Ballkan nga lashtësia, prandaj kanë lindur hipoteza të ndryshme për lidhjet e saj me gjuhët paleobalkanike, në radhë të parë me ilirishten qysh nga fillimet, ndërsa më vonë ka pasur hipoteza për raportet e saj të bijërisë me trakishten apo varietetin dakomez.

Fakti se gjuhët e lashta ballkanike nuk janë regjistruar, ndërsa shqipja është dokumentuar pas shekullit XV hap shtigje për spekulime në drejtime të ndryshme. Arsye të rendit historik, të tjera të rendit të kontakteve me gjuhët e lashta (latinisht e greqisht), arsye të natyrës së rindërtimit të brendshëm, japin mundësi më të shumta për afrimin e shqipes më parë me ilirishten, ndërsa mungesat në njohjen e ilirishtes sikur duan ta vënë në dyshim këtë lidhje.

Shqipja ka pasur një histori të saj në Ballkan dhe këtë e dëshmon mjaft mirë numri i madh i huazimeve të saj nga latinishtja (së paku nga sh. II para K. e më tej), ashtu si dhe një numër më i vogël nga greqishtja e vjetër edhe më të lashta, pastaj huazimet nga sllavishtja, nga turqishtja e më vonë nga të tjerat. Si e tillë, shqipja është gjuhë tipikisht ballkanike, por me një pozitë të saj të kundërthënëshme në raport me ballkanizmat the-

melorë: toskërishtja ka zanore ë të theksuar – gegnishtja jo;¹ toskërishtja e zëvendëson gjithandej paskajoren e tipit *me punue* me lidhore, por jo të tipit privativ *pa punuar*; derisa tosk. ka vetëm një të ardhme me *do*, në gegnishten e kemi të ruajtur qartë të ardhmen me *do* dhe të ardhmen e domosdosë me *kam*, etj. Për më tepër, ballkanizmat e shqipes i shtrohen një shtresëzimi kohor, çka mund të shihet sidomos në leksik. Të gjitha këto bashkë me elemente të tjera të dispozicionit brenda shqipes e vendosin atë qysh herët afërsisht në hapësirën ku ajo njihet historikisht, pra në Ballkanin Perëndimor, ndërsa kufijtë e shtrirjes së saj kanë lëvizur varësisht nga rrethanat e tjera (Çabej e quante tkurrje të hapësirës folëse).

Disa studiues, duke u nisur nga karakteri *satəm* i shqipes në rrafshin IE dhe nga supozimi i kontestuar nga shumë të tjerë i karakterit *centum* të ilirishtes, ndërkohë që të gjithë pajtohen për karakterin *satəm* të trakishtes, nga raportet e shqipes me rumanishten, nga diskutimet lidhur me emrat e lashtë të vendeve e format e tyre të trashëguara në gjendjen e sotme, e nga ndonjë element tjetër, kanë ushqyer supozimin që shqipja duhej lidhur me trakishten, ndërsa prej kohës që midis trakishtes dhe dako-geto-mezishtes u supozuan ndryshime të rëndësishme përtej varieteteve dialektore, atë e lidhnin më parë me dako-mezishten.² Në këtë pikë ka pasur variacione, si ai që e lidhte me besishten,³ tjetri me karpishten (gjuhën e karpëve)⁴ e kështu me radhë.

Në hapësirat ballkanike qendrore shqipja sot shtrihet në Republikat e Shqipërisë dhe të Kosovës, në pjesë të Republikës së Maqedonisë, në

¹ Në të vërtetë kështu mund të thuhet vetëm për shtresën e hershme të leksikut. Në hua-zimet e mëvona nga serbishtja e turqishtja të folme të ndryshme gege kanë dhe [ê] të theksuar. Në të folmen e Preshevës kemi: [sɔ̃rʃ], [gɔ̃rb], [fɔ̃rʃ], etj., ndryshe nga, ta zëmë, në të folme të Gjakovës e të Rrafshit të Dukagjinit, ku kemi: [gɔ̃rb], [fɔ̃rʃ], etj. Në gegnishten e mesme lindore kemi: [mɔ̃r], etj.

² Moesia ishte krahina, ndërsa Moesi, Mysi etj. emri etnik. Shqip mund të themi: meze, mezishte, si meze, mezishte.

³ Gjuha e supozuar e besëve, fis qendror trakas, për të cilën, pos emërtimit që i japim ne sipas fisit, nuk dimë gjë, madje as nëse do të ketë ekzistuar si gjuhë e veçantë, apo si dialekt me specifika të mëdha.

⁴ Si vërejtja në shënimin e mësipër: gjuha e fisit të karpëve.

Luginën e Preshevës e pjesë të Sanxhakut në Republikën e Serbisë, në pjesë të Republikës së Malit të Zi, në pjesë të Greqisë Veriore, si e hershme vendëse, dhe më vonë e bartur në Atikë, Peleponez, Beoti dhe në ujdhesat e Greqisë (e njohur si arvanitika, së paku nga sh. XIII, disa e çojnë në sh. X); në Greqinë Veriore në fqinjësi me Turqinë e Bullgarinë më vonë, e prej andej në Bullgari e Ukrainë; në Arbënesh të Zarës nga sh. XVIII dhe në Sllavoni tashmë e zhdukur po ashtu nga kjo kohë; në diasporën tjetër historike – në Itali të Jugut – Kalabri e Sicili, nga sh. XV e në hapësirat e Turqisë së sotme nga kohë të ndryshme, në Siri, Egjipt, etj.

Rumanishtja është gjuhë romane e mëvetësuar jo më herët se sh. VII-VIII. Flitet në Rumani dhe Moldovë, në pjesë të Banatit, në Serbinë Verilindore, gjithandej e njohur si rumanishte apo *dakorumanishte* në terma të hisotrisë gjuhësore. Në Ballkan, konkretisht në Maqedoninë Qendrore e Jugore, në pjesë të Shqipërisë së Jugut, në Greqi rreth maleve të Pindit flitet *arumanishtja*, ndërsa në zonat e lumit Meglena në afërsi të liqenit të Dojranit në Maqedoni e Greqi flitet varieteti i *meglenorumanishtes*; në Istrië edhe sot flitet varieteti i *istrorumanishtes*. Të gjitha këto varietete të rumanishtes, shumica e historianëve të kësaj gjuhe i njehin dialekte të saj të ndara diku pas sh. X; si gjuhë romane ajo është zhvilluar në mjedis të ndryshëm nga ai i gjuhëve të tjera romane, me gjuhë autoktone dhe fqinje të ndryshme dhe me qytetërim të ndryshëm. Elementet që vijnë nga mjedisi ballkanik, pra elementet tipikisht ballkanike dhe zhvillimet shekullore brenda saj bashkë me to, e bëjnë rumanishten dukshëm të ndryshme nga gjuhët e tjera romane.

Vështrimet e brezit Rosetti, Çabej

Sipas gjuhëtarit të shquar A. Rosetti, gjuha rumune është formuar në një territor më të gjerë, që përfshinte Dakinë veridanubiane (aty ai numëronte rajonet e sotme të krahinave të Oltenisë, të Banatit, të Transilvanisë, të Muntenjës, të Moldovës së Jugut, zonat jugore bridanubiane dhe Dobrukhën), ashtu si dhe provincat e romanizuara në perëndim dhe juglindje të këtyre zonave të romanizuara, të cilat kanë pasur lidhje të for-


ta administrative dhe tregtare me Dakinë, si Dardania dhe dy mezitë e lashtësisë. Latinishtja ballkanike, koncept i diskutuar nga dijetarë të ndryshëm (sa njësores ishte ajo, a ka dallime të tjera pos 'latinitetit perëndimor'? – dalmatishtes dhe 'latinitetit lindor apo danubian' – rumanishtes; si ishte puna me një zonë të tretë romanizimi rreth via Egnatia? (shih Banfi), si puna e latinizmave të shqipës, etj.), sipas Rosetti-t përfshinte dalmatishten tani të zhdukur, rumanishten (dakorumanishten dhe dialektet jugdanubiane maqedo-, megleno- dhe istro-rumanishte), ashtu si dhe elementet latine të shqipës, të bullgarishtes dhe të serbishtes e të kroatishtes, por këto i lidhte me momentin e ekspansionit të saj në Europën Lindore. Këtu mbetet pa u përmendur elementi latin i greqishtes së re me interes në këtë pikë. Por ai nuk linte pa shënuar se dalmatishtja dhe shqipja paraqesin dhe tipare të veçanta të grupit perëndimor të gjuhëve romane (Rosetti 1965: 313; më gjerësisht Rosetti 1968). Të tjerë dijetarë kanë shprehur ide të ndryshme lidhur me këtë shtrirje të rumanishtes në kohën e formimit të saj: disa formimin e saj e kanë vendosur tërësisht në jug të Danubit, të tjerë tërësisht në veri të Danubit dhe të tjerë në të dy anët e lumit, por me nuanca pak a shumë të ndryshme (Frâncu 1999, kap. III).

Që t'i përmbahemi vijës së Rosetti-t, të themi se për kohën e shtrirjes së latinishtes në Ballkan dhe në hapësirat danubiane jugore, sipas tij, ndesheshin këto gjuhë: trakishtja dhe ilirishtja, ashtu si dëshmohen në monumentet e vjetra, në toponimi e onomastikë të Siujdhesës Ballkanike dhe të vendeve danubiane. Për rumanishten me rëndësi, sipas tij, janë dhe elementet e saj të përbashkëta me shqipën, të cilat "*shpjegohen, në radhë të parë, përmes gjuhës trakase*".⁵ Dhe pikërisht pohimet si ky i fundit kanë qenë objekt i diskutimeve të shumta.

Në të vërtetë, fondi roman (latin) i shqipës dhe rumanishtja shfaqin mjaft elemente të përbashkëta, por edhe dallime, për arsye të ndryshme: të natyrës kronologjike (kontaktet e shqipës me latinishten janë shumë më të hershme: Iliria u pushtua në sh. II para K., Dardania në sh. I, ndërsa

⁵ "... Care se explică, în primul rând, prin limba tracă", Rosetti 1965: 314.

Dakia në sh II pas Kr.); të natyrës gjeografike (shqipja ka huazuar nga një varietet roman më perëndimor); të natyrës strukturore (shqipja ka më pak diminutiva nga latinishtja, çka shpreh më parë një gjuhë jorurale në raport me rumanishten), etj., prandaj, numri i fjalëve me prejardhje të përbashkët latine vetëm për shqipen e rumanishten është më i vogël se numri i fjalëve të huazuara vetëm në shqipen, apo në shqipen e në gjuhët romane perëndimore) (shih për këtë sidomos Mihăescu 1981, Russu 1995, Vătășescu 1999, etj.).



Përndarja dialektore e dakorumanishtes (sipas E. Petrovici), këtu sipas Mihăescu 1993.

1. Të folme të tipit vllah;
2. Të folme të tipit 'banatian (Banat)';
3. Të folme të tipit 'Maramureș';
4. Të folme të tipit 'Krishana'

Dy gjuhët paraqesin afërsi të shumta midis tyre. Qysh herët është vërejtur se disa prej ngjashmërive mund të jenë të lashta, gjithsesi ka dhe dallime të kohës para ardhjes së sllavëve në Ballkan, ka të tjera më të vona; disa karakterizojnë vetëm këto dy gjuhë, të tjera tipare ngërthehen në një rrjet më të gjerë Ballkanik. Një aspekt të veçantë të këtyre stu-

dimeve paraqesin elementet e përbashkëta strukturore, si p. sh. *zanorja ë/ rum. ă, bullg. ъ, nyja e prapavendosur, përsëritja e kundrinës, numërimi 11-19, krahasimi analitik, apo elementet leksikore pararomane*, për të cilat rumanistët rumunë kërkojnë shpjegim kryesisht te substrati trakodakas i rumanishtes, duke implikuar me këtë edhe përfundime të caktuara për raportet e shqipes me gjuhët e lashta të Ballkanit dhe për vendin ku është folur ajo në lashtësi. Janë shënuar dhe veçanti në fushën e trashëgimisë romane (shih Mihăescu 1982, Ismajli 1987). Aspektet e ndryshme të ngjashmërive strukturore në shumë raste kanë edhe përkatës me gjuhë të tjera ballkanike, prandaj shpesh trajtohen si ballkanizma të mirëfilltë, për prejardhjen e të cilëve ka shumë diskutime. Ka të tjerë që këto afri ballkanike i shpjegojnë me atmosferën e kontakteve midis më shumë gjuhëve, pra të konvergencës së krijuar nga bashkëjetesa, të cilën Georgiev-i nuk ngurronte ta shtynte dhe në Ballkanin e lashtë.

Rosetti, siç është bërë e zakonshme në dekadat e fundit, nisej nga supozimi i V. Georgiev-it për dallimin midis dakomezishtes në veri të hapësirës së përmendur (Daki – afërsisht Rumania e sotme dhe Hungaria deri te lumi Tisa, mezi – Serbia verilindore dhe Bullgaria veriore; Skiti Minore – Dobruxha e sotme) dhe trakishtes në pjesën lindore të Siujdhesës Ballkanike deri te bregu i Detit të Zi (Rosetti 1965: 314; Georgiev 1961: 5-11). Përfundimi i Georgiev-it, të cilin e shihte të nevojshme ta theksonte Rosetti me këtë rast, ishte ky:

*“Gjuha dakase (dako-meziane) është gjuha nënë e shqipes”.*⁶

A ishte dakishtja dialekt i trakishtes? Rosetti besonte tek cilësimi i Strabon-it, sipas të cilit gjuha e dako-getëve ishte trakishte, ndërsa Georgiev-i e kontestonte tërësisht dëshminë e Strabon-it. Dijetarët rumunë, pos Poghiric-ut e ndonjë tjetri, zakonisht nuk e pranojnë këtë dallim, ndërsa të tjerët tashmë procedojnë sipas tij si një gjë e dëshmuar. Por Rosetti vetë mendonte se në dako-mezishten kishte dallime dialektore në raport me trakishten tjetër, çka mund të shihet dhe nga shqyrtimi i elementeve të

⁶ “Limba dacă (daco-moesiană) este limba-mamă a albanezei”, përkthimi rum. i Rosetti 1965: 314, Georgiev 1961: 8.

përbashkëta leksikore midis shqipes e rumanishtes: korrespondencat fonetike që mund të vendosen midis trakishtes e rumanishtes, nga një anë, dhe midis trakishtes dhe shqipes, nga ana tjetër, tregojnë se rumanishtja e shqipja, të nisura nga i njëjti burim, paraqesin trajtime të ndryshme. Kjo e bënte atë të supozonte ekzistencën e një “*unioni gjuhësor ballkanik*” dhe të konstatonte se ndikimi i gjuhëve ballkanike në rumanishten ka ndodhur në veri dhe në jug të Danubit, ndërsa gjuha rumune është formuar në veri dhe në jug të Danubit (Rosetti 1965: 314-315).

Rosetti në këtë vështrim të përgjithshëm për vendosjen e vizionit të tij për rumanishten nuk linte pa e theksuar aspektin e simbiozës së popullatës së romanizuar danubiane me sllavët pas sh. VI. Para kësaj ai paraqiste vizionin e tij për elementet që rumanishtja ua detyron gjuhëve ballkanike. Dhe këto janë: zanorja <ǎ>: sistemi i trashëguar latin i rumanishtes u begatua fillimisht me zanoren <ǎ> dhe në vijim me <î>, ndërsa e para ka paralelizëm me shqipen <ë> dhe me bullgarishten <ъ>; ka paralelizëm midis rumanishtes e shqipes në trajtimin e mbylltores hundore në një pjesë të Transilvanisë dhe në toskërishten: -n- > -r- (ky element nuk mund të trajtohet si ballkanizëm); këtu fuste dhe trajtimin e lat. <ct, cs> në të dy gjuhët, për çka do të flasim në mënyrë të veçantë. Në fushën e morfologjisë në këtë pjesë ai merrte parasysh paralelizmin në ndërtimin e përemrit të pacaktuar dhe ndajfoljes: rum. me -va (nga *volet*), shq. me -do (nga *dua*): *careva, unde va – kudo, sado*.⁷ Prapavendosja e nyjës në rumanishten e në shqipen po ashtu i dukej element i përbashkët, ndërsa në bullgarishten për këtë çështje shihte zgjidhje tjetër. Tendenca e zëvendësimit të infinitivit me lidhoren, vjen, pas tij, nga greq. e re. Në fushën e sintaksës si ballkanizëm të mirëfilltë e shihte prirjen e fjalive qëllimore me një pjesëz – rum. *să*, shq. *të*, gr. *va*, bullg. *da* me lidhore (Rosetti 1965: 316-17; shih Friedman 2004: 249-290).

Në fushën e leksikut ai shihte ngjashmëri në fjalëformim: *de-parte/ për-anë, nici un/ asnjë*; sufiksi -*ešte* shq. -*isht*, -*ușor* (ș + ior - -sh); for-

⁷ Këtu kemi të bëjmë me formime të vona, që nuk mund të llogariten trashëgimi e ndonjë fondi të përbashkët.

mime deminutivash: *coacăză*: *kokazë*. Por më me rëndësi i shihte 82 fjalët e përbashkëta midis dy gjuhëve, prania e të cilave

“nuk mund të shpjegohet përmes shqipes në rumanishten, as përmes rumanishtes në shqipen”.⁸ *“Ato rrrjedhin nga dy dialekte të një gjuhe të përbashkët, e cila u ka transmetuar secilës prej këtyre dy gjuhëve fjalë përkatëse, që janë formuar sipas rregullave specifike të secilës gjuhë”*.⁹

Diskutimet për këto aspekte do të shtrihen gjithandej në vijim. Ndërkaq, më duket vrojtim i drejtë ai që veçonte disa fjalë të terminologjisë baritore (*baci, balebë, çapuşă, fluier, gâlbează, gard*, etj.).

Çabej në anën tjetër

Në nisje të pjesës për raportet e shqipes me rumanishten të veprës së tij *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, historiani më i rëndësishëm i shqipes në sh. XX, Eqrem Çabej vlerësonte se

“rumanishtja e shqipja kanë lidhje fort të ngushta midis tyre. Historia e këtyre lidhjeve ka mbetur gjer më sot e pasqaruar; spjegimi i tyre përbën një nga problemet kryesore të gjuhësisë ballkanike” (Çabej 1976: 74).

Ngjashmëria midis këtyre dy gjuhëve shtrihet në fonetikë, në strukturën gramatikore (fleksion nominal, sintaksë e verbit), në leksik, në formimin e fjalëve, në frazeologji e në proverba, në tërë sistemin gjuhësor. Përmasat e këtyre ngjashmërive të krijojnë përshtypjen se para nesh kemi

“një të vetme lëndë gjuhësore, që paraqitet me dy forma të ndryshme”.

Prandaj, sipas tij, mund të thuhet me mjaft siguri se

“populli shqiptar e populli rumun dikur në historinë e tyre kanë qenë gjeografikisht më afër njëri me tjetrin, vise-vise mbase kanë qenë dhe në bashkëjetesë (simbiozë)” (Çabej 1976: 74).

I tërë vizioni i Çabejtë lidhet me raporte të natyrës së *kontaktit*:

⁸ “Prezența lor nu poate fi explicată prin albaneză în română, nici prin română în albaneză”, Rosetti 1965: 317.

⁹ “Ele provin din două dialecte ale unei limbii comune, care s-au conformat pe urmă regurilor specifice fiecărei limbă”, Rosetti 1965: 317.

ballkanik (të konvergjencës) apo të simbiozës, duke lënë anash aspektet e trashëgimisë gjenetike. Aspekti ballkanik do të implikonte edhe gjuhë të tjera dhe një frymë të përgjithshme konvergjence dhe do ta ndryshonte sadopak perspektivën e shpjegimit.

Çabej shtronte pyetjen: *kur u zhvilluan këto marrëdhënie dhe ku?* Sa i përket kohës, ai gjykonte sa vijon: meqenëse tiparet e përbashkëta të shqipes me rumanishten ndeshen në të katër dialektet e rumanishtes, kjo do të thotë se ato i takojnë kohës kur ato dialekte ishin gjeografikisht afër njëri tjetrit, pra kohës kur ekzistonte një rumanishte e përbashkët, nga sh. VI deri në sh. IX. Ndërkaq, sa i përket vendit ku ndodhën këto marrëdhënie, atij i dukej se çështja është edhe më e errët. Ka ndodhur në Ballkan, por më tej nuk mund të caktohet. E tërë historia lidhet me çështjen e

*“djepit të Shqiptarëve dhe me atë të djepit të Rumunëve në Gadishullin Ballkanik”.*¹⁰

Vetë Çabej kishte këtë mendim: për çështjen e parë referonte pikëpamjet e shprehura në këtë vepër të tij, ndërsa për çështjen e djepit të hershëm të rumunëve raportonte tri teoritë kryesore:

1. *Teoria jugdanubiane*, sipas tij, e pranuar prej shumicës së dijetarëve; shënonte kumtin e kronistëve romakë, konkretisht të *Vopiscus* (shih dhe Mirdita 2003: 96; Friedwagner 1934: 647-648)¹¹ dhe *Eutorpius* (shih po ashtu Mirdita 2003: 96),¹² sipas të cilëve, kur

¹⁰ Metafora e djepit supozon një kohë dhe një hapësirë të lindjes së një gjuhe. Nëse u referohemi rrethanave të antikitetit, dalin gjëra të ndryshme. Lidhur me rumanishten mund të flitet për lindjen e saj njësoj si të gjuhëve të tjera romane në një periudhë mjaft të vonë – mbase në sh. VIII-IX. Ndërkaq për shqipen nuk jemi të sigurt kur do vendosur ndarja e saj nga protoshqipja.

¹¹ Te Çabej përmendej *Vopiscus*, ndërsa Friedwagner e tash së fundi dhe Mirdita i japin me fragmente. Në Rumani ka pasur diskutime të gjera dhe të detajuara me shumë kontraverza lidhur me këtë dëshmi. “Cum vastatum Illyricum ac Moesiam deperditam videret, provinciam transdunaviam Daciam, a Traiano constitutam, sublato exercitu et provincialibus reliquit, desperans eam posse retineri, abductosque ex ea populos in Moesia collocavit...”, *Vopiscus, Vita Aureliani*, cap. 39, 7.

¹² “Provinciam Daciam quam Traianus ultra Danubium fecerat intermisit, vastato omni Illyrico et Moesia, desperans eam posse retineri abductosque Romanos ex urbibus et agris Daciae in Moesia collocavit...”, *Eutorpius, Breviarium IX*, 15, 1.

gotët u dyndën në Ballkan në vitin 273 të ER, perandori Aurelian shkuli nga Dakia koloninë romake të themeluar para tij nga Trajani, për në mezi (Bullgaria e sotme). Në të mirë të kësaj flasin argumentet gjuhësore, në radhë të parë ngjashmëritë e rumanishtes me shqipen. Meqë është vështirë të mendohet që shqiptarët të kenë kontaktuar rumunët në Rumani, ka më shumë gjasë që rumunët të jenë formuar në jug të Danubit e më vonë të kenë kaluar dhe andej.

“Kështu Weigandi e kërkon djepin e popullit rumun ... në trekëndëshin Nish-Sofje-Shkup”.

2. *Teoria e kontinuitetit* djepin e rumanishtes e vendos në Rumani. Pas këtyre dijetarëve, pas tërheqjes së kolonisë së përmendur nga Aureliani, prej andej nuk u shpërngulën të gjithë romanët. Rumunët e sotëm janë pasardhës të atyre romanëve. Pra, ka pasur kontinuitet të popullsisë me gjuhë romane në Rumani, si mendojnë gati të gjithë dijetarët rumunë. Për Çabejnë kjo kuptohet, sepse

“çështja e kontinuitetit për Rumunët përveç interesit shkencor ka dhe një rëndësi të madhe nacionale” (Çabej 1976: 75).

Ndër albanologë, ashtu si ndër shumë studiues jorumunë sundon një bindje e ngjashme. Kështu Zef Mirdita (2004: 97) vlerëson:

*“Teoria e kontinuitetit e ka përshkuar aq shumë frymën e shkencëtarëve rumunë sa shkohet deri aty sa të mos pranohet asfarë lidhjeje me Siujdhesën Ballkanike. Merret vesh, ata kanë mohuar edhe elementet e romanitetit ballkanik në mënyrë që të mohohej çfarëdo argumenti që do të fliste në të mirë të teorisë për formimin e popullit rumun në jug të Danubit”.*¹³

3. *Teoria e tretë* përpiqet të bëjë sintezën. Pas këtyre dijetarëve djepi i hershëm i popullit rumun ka qenë i gjerë, ka përfshirë krahina në jug e në veri të Danubit. Ndër dijetarët e këtij grupi Çabej përmendte: M. Bartoli, A. Rosetti, G. Stadtmüller e D. Macrea.

¹³ “Teorija kontinuiteta toliko je prožela duh rumunjskih znanstvenika da se je išlo dotle da se ne priznaje bilo kakva veza s Balkanskim poluotokom. Dapače, oni su poricali i elemente balkanskog romaniteta da bi se negirao bilo kakav argumenat koji bi govorio u prilog teoriji o formiranju rumunjskog naroda južno od Dunava”.

Përbashkësitë midis dy gjuhëve në fushën e elementit latin Çabej i shihte si trashëgimi të latinishtes ballkanike, me zhvillime paralele në të dy gjuhët. Në fushën e fonetikës Çabej veçonte paralelizmat e vokalizmit: ndërrimi i *a*-së së pathekse në *ë*, rum. *ă*, si te *camisia*: *këmishë*, rum. *Că-measă*; ruajtja e *u*-së së hapur latine në *u* – *furca*: *furkë*, rum. *furcă*, it. *o* – *forca*. Në konsonantizëm: *ct* me rezultate të afra – shq. herë *ft*, herë *jt*, herë *t*, rum. *pt*: *lucta* – *luftë*, *luptă*; *directus* – *drejt*,¹⁴ *drept*; *fructus* – *fryt* (autorët e vjetër *frujt*), *frupt*; *factura* – *fëtyrë*. Çabej mendonte se

“nuk është sqaruar arsyeja pse shqipja ka tri reflekse të këtij grupi latin”.

Grupi *cs* (*x*) në shqipen ka dhënë *fsh*, *sh*, ndërsa në rumanishte *ps*, *s*: lat. *coxa* – *kofshë*, rum. *coapsă*; *fraxinus* – *frashër*, rum. *frasin*.

“Edhe këtu nuk dihet mirë shkaku i trajtimit të dyfishtë”, Çabej 1976:75-76.

Çabej këtu referonte Weigand-in, i cili mendonte se elementet latine të rumanishtes kanë kaluar në këtë gjuhë jo drejtpërdrejtë, po përmes shqipes. Pikëpjekje midis dy gjuhëve Çabej shënonte, pos në leksik, në fushë të morfologjisë, të fjalëformimit e të sufiksive: prapashtesat *-onjë* te *ulkonjë*, rum. *-oaie* te *ursoaie*; shq. *-ush* te *kalush*, rum. *-us* te *lemnus*; shq. *-isht* te *shqiptarisht*, rum. *-ește* te *românește* (Çabej 1976: 76).

Në punë të leksikut Çabej hetonte po ashtu afrime të shqipes me rumanishten sa i përket fondit të latinishtes ballkanike. P.sh. *filianus* – *fijan*, rum. *fin*; *mergere* – *mërgoj*, rum. *merge*; *sanitatem* – *shëndet*, rum. *sănătate*; *sanitosus* – *shëndoshë*, rum. *sănătos*.¹⁵

Elementet jolatine

Por Çabej mendonte se rëndësi të madhe kanë përkimet jolatine midis dy gjuhëve. Me këtë rast ai shënonte dhe rreth 20 fjalë (Çabej 1976:

¹⁴ Çabej shënonte se te Buzuku kemi *dëreq*, ndërsa tosk. jugore e arbërishtja kanë *dreq*; këtë të dytën e shënonte edhe Demiraj; do të shtojmë se e tërë gjuha ka *ndreq*, (*n-dreq* si te *n-drit*), geg. veriore *nreçi*, *ureçi*, *ureci*.

¹⁵ Për idetë e Çabejtë lidhur me raportet midis rumanishtes e shqipes shih po ashtu B. Demiraj (1988: 119-123).

76).¹⁶ Janë tri mundësi shpjegimi për prejardhjen e atyre fjalëve:

1. mund të jenë fjalë rumune;
2. mund të jenë fjalë të shqipes;
3. mund të vijnë nga një gurrë e tretë, e përbashkët.

Rumune, mendonte ai, nuk janë, sepse në atë gjuhë dalin të izoluara, nuk kanë shpjegim brenda sistemit. Prandaj ose i përkasin shqipes ose janë të burimit të përbashkët. Shumë dijetarë i shohin të substratit, ka të tjerë që e vënë në dyshim shpjegimin përmes substratit. Po të nisemi nga shpjegimi brenda shqipes, metodologjikisht duket më e drejtë, mendonte Çabej. Brenda shqipes shumë prej tyre nuk janë të izoluar, po gjejnë shpjegim brenda sistemit. P.sh. *hamës* nga *ha*, si *pimës* nga *pi*; *këlbazë*, *gëlbazë* është me zgjerim *-zë* prej *kalb*, **kalbëzë*; *avull* në raport me *valë*, *brez* me *brej*, *flutur* me *fluturoj* e *fletë*, *gërresë* me *gërreje*, *gropë* me *gërmoj*, *moshë* me *mot*, *shtrungë* me *shtroj*, *tharbët* me *ther*, *thërime*, *vjedhull* me *vjedh*, *gjon* me emrin vetiak *Gjon*, prandaj fjalët përkatëse rumune dalin prej shqipes. Por kjo nuk mund të thuhet për të gjitha fjalët e përbashkëta. Shumë të tjera gjejnë shpjegim brenda sistemit indoeuropian, si *baltë*, *bardhë*, *gropë*, *kurth*, *sorrë*, *shark(ë)*, *shkrumb*, etj. (Çabej 1976: 77).

Në vijën e G. Meyer-it, sipas të cilit disa cilësi fonetike e semantike të elementeve shqipe të rumanishtes na shpjen në kohë më të hershme se formimi i gjuhës dhe i kombësisë rumune. Sipas Sandfeld-it fjalët që puthiten me fjalët e shqipes duan parë si të shqipes, të tjerat duket të jenë nga një burim i përbashkët. Çabej bënte fjalë po ashtu për raportet me arumanishten, e cila ka marrë shumë fjalë të shqipes, si *areapit* – *rëpjetë*, *bană* ‘jetë’ – *banoj*, *beruc* ‘bërruc’, *dot*, *gjela* ‘gjellë’, *izote*, *zvercă*, ndërsa toskërishtja ka marrë prej saj fjalë baritore, si *fiçor*, *kënut* ‘i përhimë’, *milor* ‘dash motak’. Vinte në dukje dhe fjalë të shqipes nga vlla-

¹⁶ *ajkë* – *alcă*, *avull* – *abure*, *baltë* – *baltă*, *bardhë* – *barză*, *bredh* – *brad*, *brez* – *brîu*, *daltë* – *daltă*, *dhallë* – *dzare*, *fluturë* – *fluture*, *gardh* – *gard*, *gërresë* – *gresie*, *gropë* – *groapă*, *Gjon* – *ghionoaie*, *hamës* – *hameş*, *këlbazë* – *gălbează*, *kurth* – *cursă*, *moshë* – *moş*, *mugull* – *mugur*, *nepërkë* – *năpîrcă*, *përrua* – *părîu*, *qafë* – *ceafă*, *sorrë* – *cioară*, *shark(ë)* – *sarică*, *shkrumb* – *scrum*, *shtrep* – *strepede*, *shtrungë* – *strungă*, *tharbët* – *sarbăd*, *thërime* – *fărîmă*, *udhos urlë* – *urdă*, *vjedhull* – *viezure*.

hishtja që në mesjetë flitej në luginë të Drinit të Zi: *partallë, me trasë - a trage*, siç thoshte Jokl-i (Çabej 1976: 78).¹⁷

Të tjerat Çabej i shihte në një kuadër ballkanik, përfshirë dhe njëjën e prapavendosur e të përparme, futurin, zhdukjen e infinitivit, çka do të thotë se shpjegimet për to duan kërkuar në proceset komplekse të Sprachbundit. Vështrimet sintaksore dhe zgjerimet në frazeologji, për mendimin tim, kanë më shumë mundësi të ngërthejnë elemente të natyrës tipologjike, apo të kontakteve të shumanshme ballkanike.

Më 1983, në dy artikuj të botuar te gazeta *Rilindja* (Ismajli 1983: Rilindja, Prishtinë, 15. I. 1983 dhe 29. I. 1983) ne kishim bërë komente lidhur me këto elemente të përbashkëta midis dy gjuhëve, gjithë duke u mbështetur tek idetë e Çabejtë e duke mbindërtuar mbi to, po edhe duke diskutuar pikëpamjet e studiuesve rumunë (Ismajli 1987: 74-87).

Për një paraqitje të përmbledhur të diskutimeve në albanistikë lidhur me këto raporte, do të duhej të shihen idetë e M. Domit në fushën e sintaksës (Domi 1966: 145-160; Domi 1975: 81-91; Domi 1982: 345-358), ashtu si të S. Floqit (1966: 129-144), të J. Thomait-Xh. Lloshit (161-174) e të tjerëve në fushat e frazeologjisë. Këtu do të mjaftohemi me paraqitjen e përmbledhjes së Sh. Demirajt (1988, botimi i plotësuar tek Onufri, Tiranë 2013). Natyrisht, nuk i kemi parasysh këtu studimet për raportet e veçanta me arumanishten, ato do të sillnin dhe perspektiva të tjera.

Vazhdimi te Shaban Demiraj

Demiraj vinte po ashtu me një përmbledhje, por me përfundime jo krejtësisht të njëjta me të Çabejtë dhe pa referim të të tjerëve. Edhe Demiraj mendonte se fjalët e përbashkëta midis këtyre gjuhëve kanë rëndësi për shkak se ato shoqërohen me bashkëpërkime në sistemin gramatikor. Ndër elementet gramatikore përmendte prirjen e vjetër të dy gjuhëve për

¹⁷ *partallë* më duket të jetë e një areali më të gjerë, shtrihet dhe në Kosovë e në Preshevë, prandaj mund të jetë edhe fjalë e vllahishtes. Me raportet e veçanta të shqipes me arumanishten këtu nuk do të merremi.

të prapavendosur përcaktorët e pavetmjaftueshëm të emrit, ose elemente që ndeshen dhe në gjuhë të tjera ballkanike, si prapavendosja e nyjës shquese, formimi i kohës së ardhme me foljen ndihmëse ‘dua’, njësimi i rasëve dhanore gjinore, etj. (Demiraj Sh. 2013: 143, Demiraj 1994).

Për fjalët e përbashkëta Sh. Demiraj nisej nga vrojtimitet e F. Miklosich-it (1861) për ekzistencën e fjalëve të përbashkëta me paraqitje fonetike e përmbajtje kuptimore të ngjashme. Sipas tij ato fjalë janë të trashëguara në të dy gjuhët nga faza më të hershme. Lashtësinë e tyre e dëshmojnë dukuritë e vjetra fonetike.

“Është fjala për dukuri të tilla fonetike, që si në shqipe ashtu edhe në rumanishte kanë prekur vetëm fjalët e trashëguara nga gjuha ‘nënë’ (për shqipen), përkatësisht nga gjuha substrat (për rumanishten) si edhe fjalët me burim nga greqishtja e vjetër dhe latinishtja. Si rrjedhim, këto dukuri nuk shfaqen në huazimet sllave të shqipes dhe të rumanishtes, prandaj janë më të hershme se depërtimi i sllavizmave në këto dy gjuhë, d. m. th. janë për afërsisht më të hershme se shekujt VII-VIII të erës sonë” (Demiraj Sh. 2013: 143-144).

Kështu ai merrte rrugë pjesërisht tjetër nga Çabej dhe afrohej më shumë me traditën rumune të shpjegimit. Në vijim ai diskutonte hetimin e ndryshimeve si *-l- > -ll-* në shqipen dhe *-l- > -r-* në rumanishten të fjalët si *avull, mugull – abure, mugure*, apo *s > sh* në shqipen (që Jokl-i i shihte të para sh. X), *shtrungë, shtrep – strungă, strepede*, ku fuste edhe fjalën *mo-shë – moş, moaşă*, që nuk është e njëjta gjë. Përmendte dhe diftongimin e **o* në *ua/ue* të *përrua*, në lidhje me rum. *pîrîu*, çka mund të diskutohet.

Me këtë rast ai vërente se ka dukuri të vjetra fonetike që vërtohen në rumanishten dhe në të folmet jugore të shqipes, si shndërrimi i zanores së theksuar në *ë* para një bashkëtingëlloreje hundore, si të *brîu*, sh. *brine*, khs. shqip *bre-z < bren-z* (Demiraj Sh. 2013: 144).¹⁸

Demiraj raportonte se numri i fjalëve të përbashkëta midis dy gju-

¹⁸ Ndoshta do thënë këtu që kemi të bëjmë me zhvillim tjetër brenda rumanishtes. Derisa në shqipen kemi zhvillimin *o > uo, ua, ue*, siç supozohet edhe lidhur me etimologjinë e *përrua* nga **per-ron*, por në rumanishten kemi zhvillim tjetër: **per-ron > *pîrrîn > pîrîu*, si të *brîu* nga **brîn*,

hëve arrin në 91, ndërsa sipas Brâncuș-it 1983 - 89 të sigurta dhe 43 të mundshme. Mendonte se dikur ky numër duhet të ketë qenë më i madh. Vërente po ashtu se në rumanishten ka fjalë të trashëguara nga substrati, por që nuk dalin në shqipen. Disa nga fjalët e përbashkëta nuk dalin në të gjitha dialektet e rumanishtes (Demiraj 2013: 145-146).¹⁹

Sipas pikëpamjeve të shprehura lidhur me shpjegimin e burimit të këtyre fjalëve në të dy gjuhët Demiraj gjuhëtarët i gruponte në:

1. *ata që burimin e këtyre fjalëve e gjejnë në gjuhët e lashta të Ballkanit - teoria e substratit*; ndër këta ka që burimin e shohin te trakishtja, si paraardhëse të shqipes; ka të atillë që këtë e sjellin si argument për të avancuar hipotezën se shqipja nuk mund të jetë pasardhëse e ilirishtes; dhe

2. *ata që i shohin me burim nga shqipja*, të hyra në kohën e kontakteve midis dy gjuhëve ende të pandërprera nga gjuhët sllave.

Pikëpamjen e dytë, e bashkë me të dhe tezën për prejardhjen e shqipes nga ilirishtja, e mbështeste Çabej dhe këtu Demiraj e gjente rastin të raportonte idetë e tij të shprehura tek artikulli i Çabejtë *Disa mendime mbi marrëdhëniet gjuhësore rumune-shqiptare* (Çabej 1/1975), që në fakt është ligjëratë e mbajtur në Akademinë rumune më 1964, botuar gjermanisht (Çabej 1964: 101-115). Demiraj prej aty raportonte këto reflekshe:

a. Substrati, si ndërrim gjuhe, mund të pranohet për rumanishten, po nuk mund të pranohet patjetër për shqipen;

b. Nga gjuhët e vjetra kemi të ruajtura shumë pak elemente,

¹⁹ Fjalët e përbashkëta që shënonte ai janë: *avull* – *abure*, *baltë* – *baltă*, *bardhë* – *barză*, *bashkë* – *bască*, *bollë* – *balaur*, *bredh* – *brad*, *brez* – *brîu*, *bukur* – *a se bucura*, *buzë* – *buză*, *dhallë* – *zară*, *droje*, *droe* – *droaie*, *flutur* – *fluture*, *gardh* – *gard*, *gërresë* – *gresie*, *gropë* – *groapă*, *gurmaz* – *gurmaz*, *gushë* – *gușă*, *gjemb* – *ghimpe*, *gjysh* – *ghiu*, *këlbazë* – *gălbează*, *kulpën* – *kurpen*, *kurth* – *kursă*, *mal* – *mal*, *moshë* – *moș*, *mëz* – *mînz*, *mugull* – *mugur*, *niegull* – *negură*, *nepërkë* – *năpîrcă*, *përrua* – *pîrîu*, *qafë* – *ceafă*, *rëndës* – *rînză*, *sorrë* – *cioară*, *shkrumb* – *scrum*, *shtrep* – *strepede*, *shtrungë* – *strungă*, *tharbët* – *sarbăd*, *thark* – *cark*, *thërime* – *fărimă*, *urlë* – *urdă*, *vatër* – *vatră*, *vjedull* – *viezure*. Kështu e përfillte teorinë e substratit si mënyrë shpjegimi. Të nënvizuara fjalët që shënonte dhe Çabej.

prandaj është e vështirë dhe metodologjikisht e dyshimtë që atyre gjuhëve t'u atribuohen

“fjalë dhe trajta fjalësh që ato më të shumtën, pas gjase, as nuk i kanë pasur fare ndonjëherë”;

3. *midis dy popujve ka pasur kontakte me shekuj, prandaj duan veçuar elemente të shtresave më të vjetra dhe asosh më të reja.* Elementet e përbashkëta të këtyre gjuhëve Çabej, pas Demirajt, i ka shpjeguar me fqinjësinë e moçme midis stërgjyshërve të shqiptarëve e të rumunëve dhe këtu theksonte vlerësimin e Çabejtë, sipas të cilit skajet verilindore të etnosit shqiptar në Mesjetën e hershme kanë qenë në fqinjësi, pra dhe kontakte, të pandërmjetme me skajet e etnosit rumun, duke qenë kështu në kontakte përmes transhumancës që shkonte deri në simbiozë. Dhe më tej saktësonte se fjala ishte për kontakte të periudhës së rumanishtes së përbashkët, para shkëputjes së arumanishtes në sh. X (Referonte Çabej 1975: 52 e v.; Demiraj Sh. 2013: 146-148). Çabej anonte nga shpjegimi përmes huazimit midis dy gjuhëve.

Demiraj shqyrtonte çështjen e atyre fjalëve që në parim mund të vijnë nga një gjuhë tjetër, e substratit, çështje të cilën e linte të hapur, për shkak të shtresëzimit të paqartë të këtij leksiku të të dy gjuhëve. Dukuritë e vjetra fonetike mund të ndihmojnë ndonjëherë për të veçuar një shtresë më të hershme. Nëse në këtë shtresim mund të shkohet në kohë më të hershme se formimi i shqipës e i rumanishtes, në raste të tilla nuk mund të bëhet fjalë për huazime eventuale nga rumanishtja, po anasjelltas. Aty Demiraj lejonte mundësinë që shqipja të ketë trashëgimi nga ‘nëna’ e saj – ilirishtja, ndërsa rumanishtja nga substrati trako-dak apo geto-dak. Për më tej çështja i lihej shqyrtimit të raporteve midis atyre gjuhëve në rrafsh indoeuropian (Demiraj Sh. 2013: 149). Mendohet se rumanishtja është formuar në sh. V-VIII, ndërsa shqipja në sh. IV-VI, kështu që fjalët para këtyre kohëve do të shihen si të fondit të trashëguar. Këtu ai fuste fjalët e tipit *mal*, tek emrat e lashtë si *Dimalum*, *Maluensis* (Demiraj Sh. 2013:

150) (Demiraj (2013): 145-146).²⁰

Te kohët parasllave Demiraj vendoste fjalët me rotacizëm *-n- > -r-* në shqipen jugore dhe *-l- > -r-* të rumanishtes, ashtu si ato me zhvillimet *-l- > -ll-* e *-s- > -sh-* të shqipes.²¹ Mbetet mundësia që ato të jenë të fondit të hershëm indoeuropian, të kenë hyrë nga njëra në tjetrën midis atyre gjuhëve të lashta, apo edhe të jenë më të hershme.²² Por në shqipen ato kanë pësuar zhvillimet e fjalëve të trashëguara dhe të greqizmeve e latinizmeve të lashtë. Prandaj, animet e disa studiuesve që këto të shpjegohen përmes shtegtitimit të stërgjyshërve të shqiptarëve nga vise më lindore të Ballkanit në trevat e sotme në kohë relativisht të vona,

“mbeten pa asnjë mbështetje jo vetëm historike por edhe gjuhësore” (Demiraj Sh. 2013: 151).

Në vijim Demiraj raportonte bashkëpërkime në ndërtimin e disa përemrave dhe ndajfoljeve të përngjitura me kuptim të pacaktuar, si: *ku-shdo, cilido, çfarëdo, kudo, kurdo, ngado* me përkatëset rumune *cine-va, care-va, unde-va*, por në rumanishten ka edhe *ori-cine, ori-care, ori-unde*. Ngjashmëri ai shihte edhe tek *dikush, disa – neșcare, neștine*. Por këto ngjashmëri nuk i dukeshin të vjetra (Demiraj 2013: 152; ato janë vërejtur më herët; shih Rosetti 1968, Du Nay 1977, etj).

Në pjesën për bashkëpërkimet gramatikore, Demiraj thoshte se elemente si *nyja* e prapavendosur duan trajtim ballkanistik, por çështja e *nyjave* të përparme dhe e përcaktorëve të pavetëmjaftueshëm i dilte specifike për këto dy gjuhë. Mendonte se *nyjat* e përparme të mbiemrave e të gjinoreve në shqipen shkojnë në shekujt VII-VIII, kurse në rumanishten duhet të jenë më të vona.

“Ato duhet të jenë përfutur pas periudhës së rumanishtes së përbashkët a

²⁰ Supozimi se shqipja është bijë e ilirishtes do të thotë se kemi të bëjmë me gjuhë tjetër, jo me një fazë të re në zhvillimin e protoshqipes në arbënishtes e pastaj shqipe e re.

²¹ Të tilla jepen: *brin-i/ brir-i – brîu, kulpën/ kulpër – curpen, avull – abure, mugull – mugur, niegull/ mjegull – negure, dhallë – zară, shtrep – shtrepede, shtrungë – strungă, dhe baltë – baltă, i bukur – bucur, buzë – buză, gardh – gard, gushë – gușă, kurth – cursă, mëz – mînz, nepërkë – năpîrcă, përrua – pârîu, sorrë – cioară, urlë – urlă, vatër – vatră.*

²² Teoria për substratin para-IE në shqipen del te Trombetti, Barić 1955: 53-58.

protorumanishtes dhe pikërisht pas shekullit XIII ose midis shekujve XII-XIV” (Demiraj Sh. 2013: 225),

prandaj këtu mundësia e ndikimit reciprok përjashtohet. Lidhur me prapavendosjen e nyjës shquese, duke lënë bullgarishten e maqedonishten anash për shkak se atje ajo shfaqet më vonë, për shqipen e rumanishten ai konsideronte se ato janë të një kohe para shekujve VII-VIII në shqipen, pas sh. VII në rumanishten. Këtë e lidhte me tendencën për të prapavendosur përcaktorët e pavetëmjaftueshëm (Demiraj Sh. 2013: 226). Në këtë pikë në albanistikë ka pasur shumë diskutime, siç janë ato për lashtësinë e madhe të nyjës së prapavendosur nga Çabej, apo mendimet krejt të kundërta për lashtësinë e nyjës, por edhe për paravendosjen në fillim dhe prapavendosjen më vonë nga Riza e Bokshi. Ky i fundit madje, ndryshe nga Demiraj, kishte dhe një sugjerim për kohën e mundësisë së ndikimit të shqipes së hershme në rumanishten. Për këto do të flasim më vonë.²³

2. Në trajtimin e raporteve të shqipes me rumanishten implikohen vështrime të natyrës diakronike, tipologjike, areale e të kontaktit të gjuhëve bashkë me qëndrimet përkatëse në fushë të metodës, herëherë në kundërshtim me njëri-tjetrin. Që nga J. Kopitar (1829), e te F. Miklosich, H. Schuchardt, G. Meyer, B. P. Hasdeu, O. Desusianu, W. Meyer-Lübke, S. Pușcariu, I. A. Candrea, P. Papahagi, Th. Capidan, K. Treimer, H. Barić, L. Spitzer, G. Weigand, K. Sandfeld, A. Rosetti, I. I. Russu, A. Graur, C. Poghir, A. Du Nay, G. Brâncuș, C. Frâncu, S. Paliga, C. Vătășescu, A. Xhuvani, E. Çabej, M. Domi, S. Floqi, M. Gabinschi, E. Hamp, V. Georgiev, I. Schütz, L. Tamás, studiuës të shumtë janë marrë me çështjen e raporteve shqipe-rumanishte, nga aspekti i gjendjes aktuale, apo nga një perspektivë diakronike, shpesh ballkanike, a nga aspekti i historisë së hershme të këtyre gjuhëve.

Në sh. 18 J. Thunmann në veprën për popujt e Europës lindore kishte bërë komente lidhur me fjalorin e gjuhëve rumune e shqipe:

“Gjuha e vllahve që banojnë në të dy anët e Danubit është njajo gjuhë e ndryshuar trakase. Saktësisht gjysma e saj është latinishte (kam numëruar). Tri të tetat janë greke, dy gote, sllave dhe turke; ato që mbeten janë të një gjuhe që me shqipen ka pasur shumë ngjashmëri: sepse mbi shtatë-

²³ Për vështrimet ballkanike të këtyre çështjeve shih Demiraj 1994, Sh.

dhjetë fjalë vllahe, që me ato që mbeten nga 3/8 e gjuhës vllahe kanë të njëjtin kuptim, për pjesën më të madhe janë me prejardhje latine" (Thunmann 1774: 339).²⁴

Konceptimet e tij për prejardhjen ilire të shqiptarëve dhe trake të rumunëve janë të njohura. Njihet po ashtu përfytyrimi i tij për afrinë midis atyre dy gjuhëve të lashtësisë. Ndërkaq qëndrimet e J. Kopitar-it për hapësirën ku sundon *"një formë me tri materie gjuhësore"*, sa u përket këtyre gjuhëve ndërliidhen me idenë që gjuha rumune në fakt do të ketë filluar të formohej qysh në kohën e pushtimit romak të Ilirisë, ndërsa shqipja është gjuha ilire që nuk iu shtrua pushtimit romak (shih Kopitar 1829: 59-106).

*"Kështu, pra, madje edhe deri në këtë çast, në veri të Danubit në Bukovinë, Moldavi dhe Vllahi, në Transilvani, Hungari, më tej në të dy anët e Danubit, në Bullgarinë e mirëfilltë, pastaj në tërë vargun e Alpeve të Hemusit, në kuptimin më të përhapur për këto male, nga njëri det në tjetrin, në malet e Maqedonisë, në Pind dhe nëpër tërë Shqipërinë sundon vetëm një formë gjuhësore, por me materie gjuhësore të trefishtë (prej tyre vetëm njëra vendore, dy të tjerat janë sjellë nga jashtë, nga Lindja dhe Perëndimi). Numerikisht flasin shqip mbi një milion njerëz, bullgarisht mbi dy milion dhe vllahisht mbi tre milion. Pra dhe gjashtë milion trakasish të vjetër e të rinj midis tre milion grekëve në jug dhe pesëdhjetë milion sllavëve në veri"*²⁵ (Kopitar 1929: 59-106, botimi 1945 227-273, këtu 253).

²⁴ "Die Sprache der jenseits der Donau wohnenden Walachen ist diese veränderte thracische Sprache. Gerade die Hälfte derselben (ich habe nachgezählt) ist lateinisch. Drei achtheile sind griechisch, zwei gotisch, slavisch und türkisch; die übrigen einer Sprache, die mit der albanischen viele Ähnlichkeit gehabt hat: denn über siebenzig wlachische Wörter, die mit den übrigen von den letzten 3/8 der walachischen Sprache gleiche Bedeutung haben, sind mehrentheile lateinischen Ursprungs".

²⁵ "So daß also, noch bis auf diese Stunde, nördlich der Donau in der Bukovina, Moldau und der eigentlichen Bulgarey, denn in der ganzen Alpenkette des Hämus, in der ausgedehntesten alten Bedeutung dieses Gebirges, von einem Meere zum andern, in den Gebirgen Macedoniens, im Pindus und durch ganz Albanien nur eine Sprachform herrscht, aber mit dreierley Sprachmaterie (davon nur eine einheimisch, die zwey andern fremdher, von Ost und West eingebracht sind). Numerisch sprechen albanesisch über eine Million Menschen, bulgarisch über zwey Millionen und walachisch über drey Millionen. Also noch sechs Millionen Alt- und Neu-Thracier zwischen den drey Millionen Griechen im Süden und den funfzig Millionen Slawen im Norden".

Hasdeu dhe historia rumuno-shqiptare në fillim të shekullit XX

Pa synuar historikun e plotë të këtyre studimeve,²⁶ të shohim më konkretisht vlerësimin e studiuesit, etimologut dhe intelektualit të shquar rumun të sh. XIX Bogdan Petriceicu - Hasdeu jo vetëm pse paraqet një nga personalitetet e mëdha të gjuhësisë dhe të kulturës rumune, por edhe pse indikon një vijë të rëndësishme të këtyre studimeve.

Sipas C. Poghirc-ut, autorit të monografisë për Hasdeu-n, çështja e raporteve midis rumanishtes e shqipes në pikëpamjet e tij përmbledhet si vijon. Hasdeu e konsideronte shqipen si pasardhëse të dialektit trako-epirot (= ilir), ndërsa rumanishten rezultat të përzjerjes midis elementit roman dhe atij trako-dak. Ngjashmëritë midis shqipes e rumanishtes i shpjegonte përmes substratit dhe elementit latin. Raporti midis elementit latin dhe elementit autokton është proporcionalisht invers në rumanishten dhe në shqipen, duke qenë shqipja ilirishte me komponent latin,²⁷ ndërsa rumanishtja latinishte me elemente dakase, kështuqë raporti i rumunëve me shqiptarët është shumë më i qartë se me italianët,

“me të cilët ne jemi bërë fis vetëm pas babait, derisa me këta të tjerët ndeshemi nga të dy prindërit” (Hasdeu: *Istoria critică I*: 306, sipas Poghirc 1968: 190).²⁸

Por ai theksonte dhe elemente që dallojnë të dy gjuhët midis tyre, si p.sh. fjalë latine të shqipes që nuk i ka rumanishtja, po edhe faktin se zhvillimi fonetik i elementeve latine është i ndryshëm në rumanishten dhe në shqipen. Sipas të tillave të dhëna del se latinizmat e shqipes janë më arkaike; këtu i referohej *k'-së* latine që nuk u bë *č* në shqipen si në rumanishten (Hasdeu: *Istoria critică a românilor* (CXLII), 306).²⁹ Poghirc rapor-

²⁶ Një historik të tillë e ka bërë I. I. Russu në veprën e tij *Elemente autohtone în limba română. Substratul comun româno-albanez*. Ed. Academiei RSR, București 1970, pp. 14-47, me qëndrime mjaft radikale.

²⁷ Mbetet e paqartë si e mendonte ai në një rast të tillë raportin midis ilirishtes e trakishtes, sakohë që më vonë shqipen e cilësonte pasardhëse të trakishtes.

²⁸ “... cu carë noi sîntem îcuscriți numai după tata, pe cînd cu ceilalți ne lovim după amîndoi pîrintî”

²⁹ Ky elementi i fundit ishte hetuar dhe nga romanistë të tjerë, si W. Meyer-Lübke, apo edhe nga G. Meyer në atë kohë. Për karakterin më arkaik për një pjesë të leksikut latin

tonte për idetë e Hasdeu-t edhe sa vijon: shqipja është

“një dialekt më antik, sepse e tërë Shqipëria u bë provincë romane një shekull më herët se lufta e pamëshirshme e Traian-it me Decebalin” (sipas Poghiric 1968: 190, ref. Hasdeu: *Istoria critică a românilor* (CXLII), 306).³⁰

Elementet e tjera autoktone në të dy gjuhët si rotacizmi që ekziston në të folmet rumune të veriut dhe në toskërishten nuk paraqesin dëshmi se atdheu i parmë i këtyre dy popujve do të ketë qenë në fqinjësi me njëri tjetrin, po thjesht se kanë substrat të përbashkët pararomak. Poghiric-u e çmonte si posaçërisht të drejtë përfundimin e tij vijues:

“pa lëvizur njërët nga Dakia Traiane dhe të tjerët nga Epiri, romanët apo dako-latinët dhe shqiptarët apo epiro-latinët janë dhe nuk mund të mos ishin të lidhur përmes një ngjashmërie të skajshme gjuhësore, meqënëse njërët dhe të dytët dalin nga elemente romanike dhe elemente trakase, të përzier kështu në epoka të ndryshme, përmes dialekteve të ndryshme, me doza të ndryshme dhe në kushte të ndryshme klimatologjike”.³¹

Poghiric-u e konsideronte meritë të Hasdeu-t faktin se nuk bëri si disa të tjerë që donin të lëviznin rumunët në jug të Danubit, disa të çonin shqiptarët në veri, duke konsideruar se nuk janë autoktonë në atdheun e tyre të sotmë. Dhe e gjente rastin të kritikonte O. Densusianu-in për shkak se kishte konsideruar që substrat i rumanishtes nuk ishte dakishtja, po ilirishtja, duke u mbështetur tek konsiderata që shqipja është pasardhëse e ilirishtes (Poghiric 1968: 191).³² Sipas Poghiric-ut, shumë hulumtues rumunë pastaj së paku në heshtje e kanë pranuar ilirizmin e Densusianu-it (por Rosetti tek *Istoria limbii române* ishte më i kujdesshëm dhe i lejonte si të

të shqipes në raport me rumanishten shih H. Mihăescu 1982, siç referohet në vijim.

³⁰ “Un dialect mai antic, pentru că Albania întreagă devenise provincie romană cu un secol înainte de crîncena luptă a lui Traian cu Decebal”.

³¹ “Fără a se mișca unii din Dacia Traiană și alții din Epir, români sau daco-latini și albanezii sau epiro-latinii sînt și nu pot a nu fi legați printr-o extremă asemănare lingvistică, deoarece provin unii și alții din elemente romanice și elemente tracice, amestecate însă în diverse epoce, prin diverse dialecte, cu diverse doze și sub diverse condițiuni climatologice”, sipas Poghiric 1968: 190-191, referohej e njëta vepër e Hasdeu-t, f. 309.

³² Që Densusianu mendonte se substrati i gjuhës rumune ishte ilirishtja e jo dakishtja, këtë ide Poghiric e referonte tek vepra *Istoria limbii române* I, f. 30, ndërsa pohimin kategorik për substratin e referonte në f. 34.

mundshme burimet ilire apo trakase, pa qenë i vendosur për njërin). Mendonte se nuk mund të ishte dakord me tezën e tillë,

“të pambështetur as nga aspekti gjuhësor, aq më pak historik e arkeologjik, që rumunët të jenë formuar në jug të Danubit” (Poghirc 1968: 191).³³

Disa hulumtues (p. sh. Georgiev 1960: 1-19), kanë provuar të shpjegojnë ngjashmëritë midis rumanishtes dhe shqipes duke i konsideruar shqiptarët pasardhës të trakasve, jo të ilirëve, dhe të ardhur në atdheun e tyre aktual më vonë nga verilindja. Kjo ide, sipas Poghirc-ut, ishte formuluar ndër të parët nga Hasdeu në ligjëratën e tij *Cine sunt Albanezii?* (1901), për të cilën do të bëjmë fjalë në vijim.

Poghirc-u, ndërkaq, mendonte se fakti që paskësh pasur zbritje fisesh dakase (kostobokët, karpët e besët) nuk e mohonte ekzistencën e elementit mbisundues ilir në gjuhën shqipe. Themeluesi i trakologjisë, W. Tomashek më herët kishte provuar të shpjegonte elementet ‘shqipe’ në rumanishten përmes kolonistëve ilirë që çuan romakët në Daki, mbisundues të elementit fshatar, por kjo është konsideruar teprim nga të tjerë. Me rëndësi është ideja që ka pasur raste infiltrimi dak në Shqipëri dhe ilir në Daki, çka mund të shpjegonte disa nga përkimet rumune-shqipe. Poghirc-u mendonte se shpjegimi i shumë prej këtyre përkimeve do kërkuar në afërsinë midis trakishtes dhe ilirishtes.

“Këto dy gjuhë ishin qartësisht entitete të veçanta gjuhësore, por, si gjuhë indoeuropiane më drejtpërdrejt të afra dhe për më tepër fqinje, ato kanë mundur të përmbanin pa diskutim një numër shumë më të madh elementesh të përbashkëta nga ato që konstatojmë midis rumanishtes dhe shqipes ...” (Poghirc 1969: 192).³⁴

Dhe pastaj vinte me një lëvdatë për Hasdeu-n, që kishte kërkuar nga studiuesit e atillë të linin këta popuj të qetë atje ku janë, të mos i lëviznin në hartë si figura shahu.

³³ “Neîntemeiată nici din punct de vedere lingvistic, cu atât mai puțin istoric și arheologic, că românii s’iar fi format în sudul Dunării”.


³⁴ “Cele două limbi erau evident entităţi lingvistice deosebite, dar, ca limbi indoeuropene îndeaproape înrudite și în plus și învecinate, ele puteau să conțină un număr mult mai mare de elemente comune decât cele pe care le constatăm între română și albaneză...”.

Nga sh. VII deri sot

Nga sh. III deri në sh. VII

Nga 1500 para K. deri në sh. III

Rreth 2000 vjet para K.



Skicë ku i shihte shqiptarët e romanët në këto hapësira Hasdeu

Studimin *Strat și substrat* (të rimarrë te B. Petriceicu-Hasdeu 1976: 7-30), Hasdeu e fillonte me gjenealogjinë e popujve ballkanikë dhe pikërisht me tabelën më sipër: siç mund të shihet, shtresa e parë etnike e Siujdhesës Ballkanike, sipas tij, ishte shtresa pellazgjike, popull josemitik dhe joindoeuropean. Mbi këtë substrat pellazgjik, duke u përzier me të, rreth 2000 vjet para K., u vendosën dy popuj të veçantë indoeuropeanë: grekët e trakasit. Grekët e sotëm, megjithë përzierjet e mëvona, janë pasardhës të grekëve të lashtë, ndërsa pasardhës të drejtpëdrejtë të trakasve të dikurshëm janë shqiptarët e sotëm, që përfaqësojnë vetëm një prej dialekteve të shumta trakase. Nën sundimin roman të gjithë popujt e tjerë, pos shqiptarëve, u shkombëtarizuan dhe trakasit në jug të Ballkaneve u greqizuan, ndërsa ata në veri u latinizuan. Latinizimi i trakasve veriorë midis shekujve III-VI prodhoi tri dialekte *trako-latine*: dialektin *mezo-latin* midis Danubit dhe Ballkaneve, tjetrin *iliro-latin* midis Ballkaneve dhe Adriatikut, dhe të tretin *dako-latin* në Karpate. Në sh. VII një popull sllav zbriti midis *mezo-latinëve* dhe, duke u përzier me ta, dha kombin romano-sllav që më vonë u quajt *bullgar*; një tjetër popull sllav nga Bohemia zbriti midis iliro-latinëve dhe duke u përzier me ta dha popullin romano-sllav të *serbëve*. Dako-latinët jetonin të patrazuar në Olteni, në Banat e në një pjesë të Ardealit. Me ardhjen e magjarëve në sh. X, përveç dako-latinëve të vjetër në Karpate, me emrin *români*, u veçuan dy degëzime të tyre përtej Danubit: *armâni* drejt jugut të Ballkanit dhe *rumeri* afër Triestes (Hasdeu 1976: 29).

Siç shihet në tabelën e riprodhuar, në këtë konceptcion mungonin fare ilirët, ndërsa vazhdimësia e albanezëve shtrihet nga koha e pellazgë-

ve paralelisht me grekët deri në kohët moderne. Trakasit janë vendosur po ashtu mbi shtresën pellazge dhe nën latino-romanët, çka do të thotë se ata u romanizuan tërësisht, ndërsa mbi shtresën romane erdhën shtresat bullgare e serbe paralelisht me romanët që vazhduan ekzistencën, ashtu si albanezët. Megjithatë, në shpjegimet e tij kuptojmë që ai i konsideronte po ashtu të latinizuar e pastaj të sllavizuar ilirët. Pra, nga lash-tësia kemi vazhdimësi të grekëve nga grekët e lashtë, të albanezëve, që paskan pasur kontinuitet me trakët, dhe pastaj të të latinizuarve Ilirë e Trakas, prej të cilëve, pas sllavizimit, dolën serbët e bullgarët.

Në ligjëratën me titullin *Cine sunt Albanezii?*, të mbajtur në Akademinë Rumune më 25 maj 1901, Hasdeu nisej nga vrojtimit që kishte bërë më herët tek studimi *Strat și substrat*, ku kishte nxjerrë dy përfundime të cilat ai i konsideronte kapitale:

1. Në sh. VII në jug të Danubit ekzistonin dy elemente latine kompakte: mezo-romanët në Bullgarinë aktuale, dhe iliro-romanët në Serbi, para së gjithash në Dalmaci. Këta më vonë u sllavizuan pjesërisht nga bullgarët dhe nga serbët;

2. Ata që sot njihen si maqedo-rumunë dhe istrorumunë janë dakorumunë të ndjekur nga Panonia në sh. IX nga magjarët.

Këto ai do t'i trajtonte më tej në ligjëratat po në atë Akademi *Kush janë bullgarët dhe serbët?* dhe *Kush janë dako-rumunët dhe panono-rumunët?* Por, pyeste ai: *Kush janë shqiptarët?* Kur dhe prej nga erdhën për t'u vendosur në Epir? Dhe pyeste pikërisht vetëm për Epirin, sepse:

*“Nëse shqiptarët do të ishin autohtonë atje, ku jetojnë tash, atëherë deshëm s’deshëm, do të jemi të detyruar të pranojmë që kombësia rumune u formua në Iliri, apo gjithsesi jo në veri të Danubit. Vetëm përmes komunitetit të parmë, dhe përmes një bashkëjetese intime gjithsesi, mund të shpjegohet natyra e parme organike e lidhjeve midis gjuhëve rumune dhe shqipe”.*³⁵

Në ligjëratën *Cine sunt Albanesii?* Hasdeu fillimisht jepte një listë

³⁵ “Dacă Albanesii ar fi în adevăr autoctoni acolo, unde locuiesc ei astăzi, atunci vrënd-nevrënd am fi siliți a recunoște că naționalitatea română s’a format anume în Iliria, iar nici de cum la Nord de Dunăre. Numai print’o comunitate de origine, și print’o inimă veche conlocuire totodată, se pôte explică natura cea organică primordială a legăturilor între limbile română și albanesă”, Hasdeu 1901, f. 104.

fjalësh rumune që gjenden dhe në shqipen,³⁶ për të theksuar se afërsitë midis këtyre dy gjuhëve nuk shfaqen në radhë të parë në vokabular, po në veçoritë fonetike, morfologjike e sintaksore. Përmendte këtu kalimin e *-n-* në *-r-* midis zanoreve: *feréstră* < *fenestra* në dialekte të ndryshme rumune;³⁷ kjo gjë ndodh dhe në toskërishten. Vijonte më tej me ngjashmëritë kuptimore: p.sh. *omușor* (*omu-șor* – ‘njeri i vogël’) e rumanishtes i dilte e formuar sipas modelit të përbashkët vetëm me shqipen po me atë kuptim *njerith* (*njeri-th*). Kapakun ia vënë ngjashmëritë morfologjike dhe sintaksore, mendonte ai. Ndër to numëronte nyjën e prapavendosur substantivale, të paravendosurën adjektivale; dyfishimin, trefishimin e nyjave; normën e njëjtë në ndërtimin e emrit me mbiemër; të njëjtën formë adjektiv-adverbiale dhe gjenitivo-dativale; përdorimin e njëjtë gjenitival të nyjës së shquar prepozitive, etj. Termat janë të Hasdeu-t. Në fushën e sintaksës gjatë formimit të idiomës nacionale komponenti roman u marginalizua dhe u përdor material latin mbi fondin shqiptar. Këtu bënte krahasimin e elementit shqip të rumanishtes me keltikun në frëngjishten:

*“si keltizmi te francezët ashtu dhe albanizmi te rumunët nuk mund të hiqet pa një katastrofë totale”.*³⁸

³⁶ *brad, buză, codru, ghimpe, mal, bucur, gjëuj, gurmaz, năpârcă, bunget, barză, stăpân, viezure, gata, sat, vatră, moș, mire, pârû, văpae, etj.*

³⁷ Rotacizmi në albanistikë nuk konsiderohet i lidhur me rotacizmin e rumanishtes.

³⁸ *“Pe când celtismul la Francesi și albanismul la Români nu se pôte atinge fără o catastrofă totală”,* Hasdeu 1901, f. 107. Të krahasohet kjo me idenë e Hamp-it: *“We may say that historically Romanian is Latin spoken with an Albanian stress system; i.e. Romanian reflects Danubian Late Latin to which the proto-Albanian prevailingly penult accent was applied to morphological words and in which noun and verb phrases with clitics were constructed according to the proto-Albanian plan of syntax and phrasal accent”* (Hamp 1989: 47). [Mund të themi se historikisht rumanishtja është latinishte e folur me sistem theksor shqip; përkatësisht rumanishtja reflekton latinishten e vonë danubiane në të cilën zbatohet theksi shqip mbiundueshëm penultim në fjalët morfologjike dhe në të cilën sintagmat emërore dhe foljore me klitikë ndërtoheshin në pajtim me planin protoshqip të frazës dhe theksit]. A. Philippide mendonte të kundërtën: *“Cea mai mare deosebire există însă între limbile romînă și albaneză din punct de vedere al accentului. Deosebirea este importantă nu numai prin faptul că altfel este accentul în aceste două limbi, ci mai ales prin acela că accentul este cel mai sigur fenomen fiziologic, după care poți conchide că ai a face cu altă bază de articulație. .. In albaneză vocalele sonante din silabele accentuate sînt de șese feluri de lungimi... In romînește nu se poate deosebi decît o singură cantitate a vocalelor sonante din silabele*

Këto ngjashmëri ai i shpjegonte përmes supozimeve historike. Pas rënies së prijësit dakas Decebal një pjesë e dakëve iu shtrua Traian-it dhe nisi të shkrihej me kolonët romanë, duke krijuar kështu kombësinë dako-romane. Të tjerë dakas, duke u tërhequr në Karpate apo më në lindje të provincës Traiane, e ruajtën individualitetin e tyre me emra të ndryshëm etnikë; popull dakas krejt i panënshtuar ndaj Romës ishin *kostobokët*, *karpët* dhe *besët* (për vendosjen e tyre të hershme shih skicën më sipër).³⁹ Një shekull e gjysmë pas Traian-it, kur ‘*dakasit e domestikuar*’ tashmë ishin romanizuar, ‘*dakasit rebelë*’ përfituan nga lëvizja e madhe gjermanike e ‘*bellum Marcomannicum*’ dhe u bënë të rrezikshëm për pro-

accentuate... (Philippide 1927: 592). ... *In albaneză vocalele scurte din silabele accentuate sînt deschise, cele lunghe închise*” (Philippide 1927: 593). [Dallimi më i madh midis gjuhëve rumune dhe shqipe qëndron nga aspekti i vështrimit të theksit. Dallimi është i rëndësishëm jo vetëm për faktin se i atillë është theksi në këto dy gjuhë, po mbi të gjitha për faktin se theksi është fenomeni më i sigurt fiziologjik, pas të cilit mund të konkludoni se keni të bëni me bazën e artikulimit... Në shqipen zanoret sonante të rrokjes së theksuar janë gjashtë llojesh gjatësie... Në rumanishten mund të veçohet vetëm një kuantitet i zanoreve sonante në rrokje të theksuar... (Philippide 1927: 592). ... Në shqipen zanoret e shkurta të rrokjeve të theksuara janë të hapura, të gjatat të mbyllura” (Philippide 1927: 593)]. Kuptohet, Hamp-i fliste për theksin dhe vendin e tij brenda fjalës dhe përbërësve të saj, ndërsa këtu kemi ngatërrim të theksit me gjatësinë. Çështja e theksit dhe e gjatësisë në shqipen ka shpjegime pak më komplekse. Aktualisht kemi gjatësi zanoresh vetëm në gegnishten, ndërsa vetëm aty bëhet dallimi midis zanoreve të hapura e të mbyllura sipas gjatësisë, toskërishtja nuk e ka. Burimi i Philippide-s do të ketë qenë Pekmezi, tek i cili ka vërejtje të sigurta për dallimin e të gjatave, të mesmeve dhe të shkurtave, ashtu si midis të hapurave të shkurta dhe të mbyllurave të gjata, ndërsa mund të ketë ngatërrime të tjera lidhur me implikimet lidhur me melodinë që mund të kishte sugjeruar Nahtigal pas përvojës së tij slaviciste.

³⁹ **Kostobokët**, fis që jetonte në veri të Dakisë, Moldavisë e Besarabisë (midis lumenjve Prut e Nistru) e deri në jug të Galicisë në Poloni, në Karpate veriore. Mendohet se nuk ishin nënshtruar deri në sh. II pas Krishtit dhe se i përkasin grupit të madh trakas, pra ishin indoeuropianë. Njihen në literaturën historiografike rumune si ‘*dakas të lirë*’. I tillë është përfytyrimi i përgjithshëm, por ka të tjerë që mendojnë se mund të jenë të një përkatësie tjetër – gjermanike, gote, sarmate apo sllave. Raportohet që Ptolomeu i kishte përmendur ndër 15 fiset trakase. Qyteti më i rëndësishëm i tyre ishte *Piroboridava*, pastaj *Tamasidava*, *Utidava*, etj. Thuhet se në kohën e Marc Aurelit kostobokët dhe bastarnët e sarmatët kaluan Danubin dhe shkretuan Mezinë, Trakinë, Makedoninë, shkuan deri në Atikë. **Biessi**, **biesët**, a **besët**, të ndryshëm nga besët e Trakisë, raportohet t’i ketë përmendur Ptolomeu në brigjet e lumit Muresh. **Karpët** ishin fis dakas; jetonte në Malet Karpate e në Moldovë deri te lumi Nistru. Këta raportohen si dakas të lirë. Nuk njihen të dhëna për vendosjen e jetën e tyre në jug të Danubit.

vincialët romanë. Taktika imperiale ishte e atillë që lejonte lëvizje përtej Danubit dhe vendosje atje të fiseve dhe popujve dakas. ‘*Dakasit e lirë*’, të paromanizuar, lëvizën në Mezi e më tej. Në rrethana të reja në raport me gjermanikët, Roma u desh të lejonte dakasit të vendoseshin në provincë dhe ata pastaj vazhduan deri në Epir. Fisi i fuqishëm dak i kostobokëve erdhi në Greqi, në zonat ku jeton sot dega toske e fisit shqiptar. Ai madje mendonte se emri i tyre *Tosko* paraqet formë metatetike të pjesës *Kosto* të emrit të fisit (Hasdeu 1901: 108).⁴⁰

Migrimi i dytë dakas në rrugën e kostobokëve që ai i karpëve. Pas shkatërrimit të Ilirisë e të Mezisë, atje kishte nevojë për popullatë, mendonte Hasdeu. Dhe këta karpë vazhduan më tej në Iliri për të formuar degën veriore të shqiptarëve – gegët, vazhdonte rrëfimi. Madje këtë përpjekje ta mbështeste me emrin *karpë* përmes barazimit me fjalën shqipe *karbë* ‘aigle, Adler’ (sic!). Dhe këtë e lidhte me emrin *shqiptar*, pra *shqiponjë*, sidomos te gegët. Emri i gegëve, të quajtur kështu nga toskët dhe me përçmim, siç paskësh dëshmuar Hahn-i, për veten ishte *shqiptar*, pra *karp* po me të njëjtin kuptim (Hasdeu 1901, f. 109-110).⁴¹


Kështu kostobokët e pastaj karpët, paskan vendosur dy dialekte të veçanta në epokën dakase në Iliri, duke formuar atje kombin e ri të shqiptarëve me dy degë, tashmë para vitit 300. Fisi i tretë dakas i vendosur në Ballkan, vazhdonte Hasdeu, ishte ai i besëve dakas, të ndryshëm nga besët trakas, larg Danubit në Ballkan. Emri i tyre të kujton fjalën shqipe *besë*, thoshte ai.⁴²

⁴⁰ Ky lloj arsyetimi, gjuhësisht i papërligjur, ndeshet shpesh në shkrime të këtij lloji me variacione të tjera edhe më vonë; s’ka të bëjë me argumentimet.

⁴¹ Kemi të bëjmë me hamendësime: nëse do të ketë diçka më të besueshme për etimologjinë e emrit *Karpate*, kjo lidhet me shqipen *karpë*, që do të thotë ‘shkëmb, shkëmb i thyer’, etj. Shih Demiraj, B. 1997: 213. Diçka të afërt me fjalën *karbë*, që nuk ekziston në shqipen, por me kuptimin e një shpendi grabitqar, paraqet fjala *korb*, nga lat. *corvus*. Ndërkohë që shpendi me të cilin identifikohen shqiptarët, e për të cilin bëhet fjalë këtu në gegnishten është *shqype*, *shype*, *shqipe*, *shipe*, *shqiponjë*, assesi jo *korb*.

⁴² Është shpjeguar sa herë se *bessoi* me *s* te besët e lashtë, siç shihet te leksiku latin apo i trashëguar i shqipes, nuk mund të lidhet me fjalën *besë* të shqipes së sotme, sepse *s* e fjalës së sotme shqipe vjen nga **tj*, ose **tt* < **dt*, që në ato kohë e shumta mund të ishte **[ts]* ose **[tʃ]*, ndërsa *[s]* e asaj kohe do të kishte kaluar në/ ose anonte drejt *[ʃ]*.

Kështu, pra, gjenezën e shqiptarëve ai e gjente thjeshtë dhe në pajtim me bindjen për t'i parë ata në Veri të Danubit në një kohë për të shpjeguar kështu elementin shqip të rumanishtes: tri fise dakase – *kostobokët*, *karpët* dhe *besët*, të ikur nga Karpitet, formuan shqiptarët këtej në Ballkan. Rrëfim i bukur, por duhen dhe prova. Kjo vlen dhe për versionet e mëvona të një ideje të ngjashme.



Në skicën më poshtë, të marrë nga botimet rumune, shihet vendosja e fiseve trakase në veri të Danubit dhe provincat në jug: kostobokët, karpët janë në verilindje të Karpateve, ndërsa dakasit në Karpate dhe në jug të tyre deri në Danub. Hapësirat e Dardanisë bënin pjesë në Moesia superior. Skica është vetëm orientuese.

Siç do të shohim më poshtë, këtë rrëfim të bukur të Hasdeu-t të shekullit XIX në fillim të sh. XX, me këmbëngulësi dhe përtej njohurive që janë arritur ndërkohë, do ta rimernte Ion. I. Russu, madje në ligjëratën e tij në Akademi, që u botua rumanisht dhe gjermanisht pas vdekjes së tij, në fund të sh. XX.

Kritikat e Densusianu-it e më tej

Ovid Densusianu, gjuhëtar i shquar rumun i pjesës I të sh. XX, vinte me një mendim tjetër. Pikënisja e tij ishte kjo:

“Origjinat e gjuhës rumune nuk duhet të kërkohen ekskluzivisht në latinishten e transplantuar në veri të Danubit” (Densusianu 1975: 29).⁴³

⁴³ “Les origines de la langue roumaine ne doivent pas être recherchées exclusive-



Le province del Sud-Est europeo dal IV al VI sec. (tratta da A. Mihăescu, *La langue latine dans le Sud-Est de l'Europe*).

Provincat romake sipas Mihăescu-t

Shkolla e Transilvanisë çdo gjë në fushën e veçantive të rumanishtes donte të shpjegonte përmes latinishtes së transportuar në veri të Danubit.

“E shqyrtuar nga afër, gjuha rumune nuk mund të përfaqësojë vetëm latinishten e Dakisë”,⁴⁴

mendonte ai. Romanizimi mjaft i thellë i tërë Ballkanit, raportet që kanë ekzistuar midis elementit roman të Dakisë dhe të Trakisë e të Ilirisë nuk na lejojnë ta izolojmë lindjen e gjuhës rumune në rajonin e Karpateve, vijonte ai më tej.

“... Latinishtja flitej nga Adriatiku deri në Detin e Zi dhe nga Karpitet deri në Pind” (Densusianu 1975: 30).⁴⁵

ment dans le latin transplanté au nord du Danube.”

⁴⁴ “Examinée de plus près, la langue roumaine ne peut représenter uniquement le latin de la Dacie” (Densusianu 1975: 29).

⁴⁵ “... le latin était parlé de l’Adriatique à la Mer Noire et des Carpathes jusqu’au Pinde”.

Vetëm grekët dhe një pjesë e popullatës trakase e ilire qenë më refraktarë ndaj kulturës romake, thoshte Densusianu.

“Nga ana tjetër, fiset trakase dhe ilire u tërhoqën para rrjedhës gjithnjë e në rritje të popullatës romane në male, pa mundur megjithatë të shkoqeshin tërësisht nga ndikimi i saj. Idioma e tyre u mbre nga elementet latine dhe i dha lindje një të folmeje të përzier që duket të jetë ruajtur në shqipen e sotme” (Densusianu 1975: 31).⁴⁶

Në Iliri, sipas tij, popullata latine ia doli të mbivendosej në më shumë se një rajon të elementit të vjetër autokton dhe të shrinte në vend një idiomë romane gjurmët e fundit të së cilës, si duket, janë ruajtur në dialektin e ujdhesës Veglia (Krk - Kërk) në bregdetin dalmat. Po të kishte ndodhur që, pas pushtimit të Ilirisë, romakët të kishin avancuar drejt Dakisë, pasi të kishin romanizuar Mezinë, Trakinë e Makedoninë, sot nuk do të kishim rumanishte. Romanishtja që do të zhvillohej në veri të Danubit do të rikthehej drejt perëndimit për t’u shkrire me italishten apo retoromanishten. Po të ishin ndalur te Danubi pa kaluar në Daki e Panoni, nga ana tjetër, rumanishtja lindore sot do të përfaqësohej nga një dialekt i vogël si maqedorumanishtja. Ekzistenca e rumanishtes me 4 dialektet e saj kryesore duhet t’i atribuohet latinishtes së folur nga Karpitet e deri në kufijt e Greqisë. Gjuha e popullatave të lashta ballkanike, sipas tij, njihet tepër pak për të thënë me saktësi se çka u detyron rumanishtja dakishtes, trakishtes, ilirishtes (Densusianu 1975: 31-33). Nuk duhet të tregohet me mundësinë e ndikimeve trakase e ilire në romanishten, pra rumanishten, shënonte më tej Densusianu (Densusianu 1975: 43). Por gjuhët e lashta nuk njihen, pos materialit të përfshirë në leksikon e Dioskoridit, glosave dhe emrave të ndryshëm. Prandaj është e kotë të kërkohet elemente dakase në rumanishten, sa kohë që nuk dëshmohen

⁴⁶ “D’autre part, des tribus thraces et illyriennes s’étaient retirées dans les montagnes devant le flot toujours croissant de la population romaine, sans pouvoir cependant se soustraire complètement à l’influence de celle-ci. Leur idiome fut imprégné d’éléments latins et donna naissance à un parler mixte qui semble s’être conservé dans l’albanais d’aujourd’hui”.

shkencorisht, sugjeronte ai (Densusianu 1975: 43-44).

Sa i përket ilirishtes, Densusianu-i ishte i bindur që nuk jemi në gjendje të themi se deri kur do të jetë folur ajo. Studimi i shqipes mund të ndihmojë disi për njohjen e ilirishtes. Mirëpo veçoritë e venetishtes e të mesapishtes nuk përkohjnë gjithnjë me të 'substratit' IE të shqipes, prandaj është vënë në dyshim prejardhja e saj ilire. Sipas kësaj do të thuhej që shqipja nuk vjen prej ilirishtes, por kjo nuk është e domosdoshme. Do të thuhet që shqipja është vazhdim i një dialekti ilir të ndryshëm nga venetishtja e mesapishtja (Densusianu 1975: 47). Kështu disi mendonte Pederesen-i. Pas referimit të ideve për prejardhjen ilire të shqipes dhe të atyre që nuk e pranojnë këtë, shprehte besimin se teza e Hasdeu-t për prejardhjen e shqiptarëve nga karpët trakas nuk është e besueshme, për të vijuar:

"Megjithatë, në rumanishten gjejmë disa veçori për të cilat mund të lejojmë, me shumë gjashmëri, një prejardhje ilire" (Densusianu 1975: 48).⁴⁷

Referonte këtu historinë e kolonëve dalmatë në Daki e në Karpate, dhe depërtime të tjera.

"Por ndodhi sidomos në jug të Danubit që ndikimi ilir mund të ushtrohej më lehtë, dhe pikërisht aty do kërkuar prejardhja e ndonjë prej veçorive të rumanishtes që e afrojnë atë me shqipen" (Densusianu 1975: 4).⁴⁸

E vlen të shënohet se Densusianu-i si të prejardhjes ilire e shihte kalimin e grupeve bashkëtingëllore *ct, cs (x)* në *pt, ps* në rumanishten: latinisht *lucta, coxa* dakorumanisht *luptă, coapsă*; po kjo ndeshet në dalmatishten (*gupto = octo*, rag. *kopsa = coxa*) dhe në shqipen, por këtu *ft, fsh* del për *pt, ps* dhe vetëm në fjalët lat. *luftë (lucta), kofshë (coxa)*. Faza e ndërmjetme midis *ct, cs* e *pt, ft, ps, fsh* do të ketë qenë **χt, *χs*.

Densusianu-i mendonte se këtu kemi të bëjmë me një veçori fonetike me prejardhje ilire, sepse shfaqet njëherësh në rumanishten, në dal-

⁴⁷ "On trouve cependant en roumain quelques particularités pour lesquelles on peut admettre, avec beaucoup de vraisemblance, une origine illyrienne".

⁴⁸ "Mais ce fut surtout au sud du Danube que l'influence illyrienne pouvait s'exercer plus facilement, et c'est la qu'il faut chercher l'origine de quelques-unes des particularités propres au roumain et qui le rapprochent de l'albanais".

matishten dhe në shqipen, gjuhë të cilat kanë pasur kontakte intime me ilirishten. Sipas tij, ilirishtja, si duket, do të ketë ndikuar dhe në leksikun e rumanishtes; është e vështirë të thuhet që një element që ekziston në shqipen e në rumanishten do konsideruar element i vjetër ilir, apo huazim i vonë nga shqipja; por kur fonetika apo kuptimi i kundërvihet hipotezës për prejardhjen shqipe të re, nuk mbetet tjetër pos të supozojmë se elementi në fjalë vjen drejtpërdrejt nga ilirishtja; kështu duan shpjeguar elemente të rum si: *barză*, *mazăre*, meglënorum. *madzore*; *mînz*, meglënorum. *mondzu*; dakorum. *viezure* (Densusianu 1975: 51). Pra, ai shihte shtresime kohore, e me këtë edhe të statusit për elementet e përbashkëta, nuk i mernte ato bllok, çka duket qëndrim më i pranueshëm.

Sipas Densusianu-it, mund të nxirret përfundimi se rumanishtja ofron një numër të kufizuar fenomenesh për të cilët kemi të drejtë të themi se janë me shumë gjasë me prejardhje ilire. Përzgjedhëm vetëm elementet më të gjasshme; ka tashmë një shekull që në ilirishten a në dakishten kërkohet të gjendet shpjegim për çdo gjë të errët për rumanishten, pa sjellë prova të mjaftueshme. I pari që zbatoi këtë metodë qe J. Kopitar-i, që, duke saktësuar idetë ngapak të mjegullta të Thunmann-it, formuloi parimin pas të cilit gjithëçka është e përbashkët midis shqipes e rumanishtes e nuk ka prejardhje latine, sllave, etj., duhet të konsiderohet si e ardhur prej një idiome të lashtë ballkanike, u quajt ajo ilire a trakase. Kështu ai u sforcuua të mbronte karakterin ekskluzivisht ilir të disa veçorive fonetike e morfologjike të rumanishtes, ndryshe nga dijetarët transilvanas që donin që çdo gjë të shpjegohej përmes latinishtes; teoria e Kopitar-it u rimor e zhvillua nga Miklosich-i, i cili besonte të kishte sjellë elemente të reja ilire. Më tej ishte H. Schuchardt-i ai që provoi të sillte elemente të shumta të ndikimit ilir në latinishten vulgare të Ballkanit.

Nuk duhet që çdo gjë të shpjegohet përmes ndikimit të një idiome, thoshte Densusianu-i. Ka fakte që ndryshimet mund të jenë prodhuar spontanisht, pa ndërhyrje të një gjuhe tjetër (Densusianu 1975: 52-3). Është mungesa e metodës rigoroze ajo që na bën të kemi kujdes për t'i atribuuar një elementi prejardhjen ilire apo trakase; nuk mjafton të kon-

statosh ekzistencën e një fenomeni në shqipen e në rumanishten për të nxjerrë përfundimin për ekzistencën e një fenomeni të atillë në një idiomë të lashtë ballkanike. Së pari do parë mos fenomeni në fjalë është huazim nga njëra gjuhë në tjetrën në lashtësi dhe vetëm kur kjo hipotezë të kundërshtohet nga faktet, mund të flasim për diçka që mund të vinte nga ilirishtja. Veçonte studimet e G. Meyer-it për raportet midis rumanishtes e shqipes lidhur me elementet e përbashkëta (Densusianu 1975: 52).

Mungesë tjetër, sipas tij, është ajo e konceptimit të afrisë midis gjuhëve të lashta: për shumë trakishtja e ilirishtja duhej të ishin gati e njëjta gjuhë, çka do të thotë se dakishtja, e afërt me trakishten, mund të lidhej me shqipen, pasardhëse e drejtpërdrejtë e ilirishtes. Ilirishtja, trakishtja e dakishtja nuk dallonin shumë midis tyre, ishin dialekte të së njëjtës gjuhë.

“Nëse krahasimi i rumanishtes me shqipen mund të na zbulojë ekzistencën e disa elementeve pararomane në të parën, nuk kemi të drejtë t’i konsiderojmë tjetër pos ilire, assesi jo si dakase” (Densusianu 1975: 54).⁴⁹

Densusianu dhe Philippide sikur mendonin se së paku deri në sh. VII-VIII rumanishtja do të jetë zhvilluar në Ballkan, në jug të Danubit, pra ngjashëm me Rösler-in (Rösler 1871, Du Nay 1977: 4) e më vonë Tamás-in (Tamás 1936). Friedwagner-i 1934 mendonte se në Dardani qenë kushtet më të favorshme për lindjen e një gjuhe të veçantë romane.

Këtu mund të bëhet një digresion lidhur me një aspekt të vështrimit të Du Nay-it. Në këtë pjesë atij i kishte dalë e nevojshme të jepte një raport për vendin e hershëm të shqipes në Ballkan. Për këtë arsye i ishte drejtuar G. Stadtmüller-it, sipas të cilit djepi i hershëm i shqiptarëve në kohën e kolonizimit romak do të ketë qenë në grykën e Matit dhe përreth, ndërkohë që në zonat e ulëta ata kishin mundësinë të kontaktonin popullatën e romanizuar (Stadtmüller 1966: 95-96, 120, Du Nay 1977: 15). Por më tej ai rrëshqiste edhe pak dhe sugjeronte që ka argumente për të menduar se formimi i shqiptarëve do të ketë ndodhur në Dardani, Serbi të

⁴⁹ “Si la comparaison du roumain avec l’albanais peut nous decouvrir l’existence de quelques éléments antéromains dans le premier, on n’a le droit de les considérer que comme illyriens et nullement comme daciques”.

Vjetër e Bullgari Perëndimore, ku mendonte se do të ketë pasur ndikim të shqipes. Për këtë arsye përmendte argumentet si emri i sotëm *Ohrid*, *Ohër*, gr. *Λουχιδ* me ndryshimin e pretenduar të shqipes $n > r$; pastaj *Shtip* nga *Ἀστίβοσ*, me ndryshimin $s > sh$ dhe rënien e zanores së patheksuar nistore; *Nish* > *Naissus*, *Ναῖσσός* me $ai: ei > i$, $s > sh$,⁵⁰ *Dardania* që lidhet me *dardhë*; *Shqiptar* që lidhet (sipas idesë së Skok-ut të rimarrë nga Popović-i, Duridanov-i, etj.) me *Shkup* nga *Scupi*, të gjitha këto sipas I. Popović-it të referuar eksplicite (Du Nay 1977: 15; Popović 1960: 80, 83-84). Dihet që etimologjitë për *Shtip* nga *Astíbos* e *Nish* nga *Naissus* gati unanimitisht shpjegohen si zhvillime fonetike përmes shqipes. Dhe për *Dardania* në raport me *dardhë* ka shumë dijetarë që mendojnë ashtu. Sa i përket zhvillimit të cekur të *Ohrid/ Ohër* ka pasur më shumë diskutime, sado që teza e mbrojtur këtu ka më shumë gjasë të jetë e drejtë. Mendimi për rrjedhën e *shqip*, *shqiptar* nga *Scupi*, *Shkup* nuk duket të ketë gjasë, ndërsa vazhdimi i *Scupi* në *Shkup* përmes zhvillimeve të shqipes është krejt i saktë. Tani, a mund të nxirren përfundime kaq largvajtëse për vendin e hershëm të shqipes në saje të këtyre emërvendeve? A mund të jetë kjo arsye e mjaftueshme për të përjashtuar mundësinë që shqipja të jetë folur në ato kohë në hapësirat ku mendohet zakonisht e ku është ajo sot, edhe pse atje ka pokështu toponime zhvillimi i të cilave shpjegohet përmes shqipes?⁵¹

⁵⁰ Në të vërtetë, nëse ky barazim shpjegohet përmes shqipes, do të kishim ndryshimin $a: \ddot{e}$, pra **Nëish* > *Nish*.

⁵¹ Është interesant se në shumë raste synohet të ofrohen hapësira të veçanta si ato midis Nishit e Sofjes, apo zonat e Maqedonisë lindore rreth Ovçe Pole dhe më tej të Peonisë së lashtë si të mundshme për "*djepin e hershëm të shqiptarëve*". Në pjesën më të madhe fjala është për hapësira në të cilat do të ketë pasur dhe popullatë romane – vllahe. Madje në hapësirat më në veri të tilla ka edhe sot. Në Zonat në jug të Nishit drejt Vranjës e në lindje, më tej në hapësirat e Pçinjës në lindje të Bujanovcit e Preshevës ka gjurmë jo të pakta vllahe në emërtime vendesh (*Surdulica*, *Vlasotince*, *Corbul*, e shumë të tjera), por nuk gjenden gjurmë shqipe, pos emrit të qytetit *Shtip* nga *Astíbos*, që në formën e sotme shpjegohet vetëm përmes zhvillimeve fonetike të shqipes: a -nistore e patheksuar u bor si të *amicus* – *mik*, ndërsa $-b$ fundore u shurdhuan sipas zhvillimeve të shurdhimit në shqipen. Veçse një detaj nuk përputhet: shurdhimi në fund ndodh vetëm në toskërishten, ndërsa kjo zonë do të binte në kontinuitet mbase

Për ta bërë mendimin edhe më të besueshëm Du Nay sillte tezën tjetër që lidhet me huazimet sllave të shqipes. Sipas tij, barinjtë shqiptarë do të kenë jetuar në ato zona në kohën e kontakteve të para me sllavët në sh. VII, kur filluan huazimet sllave, të cilat u shtuan pas sh. XI; dhe më tej ai sugjeronte që këto huazime kanë karakter të dialektit sllav të zonave të Dibrës (Du Nay 1977: 15-16).

Këtu nuk mund të ndalemi shumë në këto aspekte, por do të themi se vlerësimet si ky për sllavizmat nga dialekti i Dibrës e të ngjashme duken më shumë konstruksione dhe mosnjohje realitetesh në terren.

Alexandru Philippide, studiues shumë i njohur i historisë së gjuhës rumune, ishte marrë po ashtu me çështjen e raporteve midis shqipes e rumanishtes. Atij i kishte interesuar më shumë aspekti strukturor i këtyre raporteve, në fushat e fonetikës, të morfologjisë dhe të sintaksës. Ai pranon se kishte dhe huazime nga shqipja, kështu që ngjashmëritë i shpjegonte edhe si pasojë të afërsisë gjeografike midis dy gjuhëve. Rumunët, sipas tij, ishin formuar në Mezinë e Poshtme dhe të Epër, në Skitinë e Vogël, në Daki dhe në Panoni, ndërsa shqiptarët ishin pasardhës të ilirëve. Për një pjesë, pra, ndikimet ndërgjuhësore shpjegohen përmes kontaktit, pjesërisht përmes substratit të përgjithshëm lashtoballkanik. Shqiptarët ai i shihte pasardhës të ilirëve panonas, çka ishte kritikuar nga Jokl-i (1984). Ai po ashtu kishte vërejtur se në ngjashmëritë midis shqipes e rumanishtes më shumë përbashkësi kishte midis toskërishtes e dakorumanishtes.

geg, ose do të duhej të supozonim se toskërishtja do të jetë folur në këto hapësira, pra lindore, dhe do të ketë pasur zhvendosje të toskërishtes në ndonjë kohë drejt jugut. Pra, në një periudhë mjaft të hershme, ata që më vonë u bënë folës të toskërishtes do të kenë jetuar në hapësira të atilla në kontakt me 'dako-rumunët', prej nga do të buronin afrinë më të mëdha të dakorumanishtes me toskërishten. Por kur, pse dhe si? Sido që të jetë, janë të gjitha gjasët që ky zhvillim të ketë ndodhur vetëm brenda shqipes, sepse shpjegim tjetër nuk ka. Ekziston dhe një mundësi: që kjo zonë të përbënte pjesë të shtrirjes së parashqipes, siç tregon rasti i zhvillimit *Naiss* > **Nëish* > *Nish*, që shtrihet brenda Dardanisë, pjesë e hapësirës së parashqipes.

Ndarja dialektore e shqipes dhe raportet toskërishte/ dakorumanishte

Më sipër paraqitëm historinë e dijetarit të shquar rumun – Hasdeu për ta nxjerrë në pah fillin e rikthimit të idesë së prejardhjes së shqiptarëve nga *'dakët e lirë'* që rishfaqet, ndër të tjerë, tek I. I. Russu në vitet '80 të sh. XX dhe në kohën tonë te S. Paliga. Por këtë mund ta hetojmë dhe tek studiuesi i njohur i këtyre raporteve, G. Brâncuș, derisa bënte fjalë për fenomenin e rotacizmit në dy gjuhët tona. Ai mendonte se rotacizmi donte sqaruar si e dhënë që buron nga ndikimi i substratit trako-dak. Madje rotacizmi, sipas tij, në mënyrë specifike është relikto nga gjuha e *'dakasve të lirë'*. Këta, përveç në Daki, mbijetuan në veri dhe në perëndim të Provincës deri në sh. VI. Prandaj, duhet të merret që paraardhësit e toskëve, si më vonë të istrorumunëve, do të kenë shtegtuar nga hapësira e *'dakasve të lirë'* drejt jugut e perëndimit (Brâncuș 1995: 116).

Fillin e këtyre ideve duhet ta kërkojmë në njëfarë mënyre edhe më herët te Philippide-ja. Duke theksuar peshën e ngjashmërive midis dy gjuhëve, çka sipas tij indikonte edhe lidhjet etnike e historike nëpër territore të ndryshme. Më tej në mënyrë specifike ai theksonte ngjashmëritë më të mëdha të toskërishtes me dakorumanishten, çka domethënë njëherësh të dialektit shqip më jugor me dialektin rumun më të largët në veri, por në mënyrë të veçantë me pjesën perëndimore të dakorumanishtes. Toskërishtja atij i dilte më e largët njëherësh nga territori dikur më i romanizuar i Siujdhesës Ballkanike (Philippide 1927: 585-587). Po të pajtohemi që afri të rumuno-shqipe kanë për shtrat bazën e nyjëtimit të tingujve, pra një afri gjithsesi etnike, kjo do të thotë se midis rumunëve e shqiptarëve ka pasur dhe një afërsi gjeografike proporcionale me ngjashmëritë në gjuhë. Prandaj nxirrte përfundimet vijuese:

1. shqiptarët dikur kanë jetuar më afër me dakorumunët se maqedorumunët;
2. shqiptarët që kanë qenë më afër me dakorumunët janë toskët;
3. meqenëse, me gjasë, maqedorumunët kanë emigruar në terri-

- toret e tyre të sotme, edhe toskët do të kenë jetuar dikur në afërsi të veriut të romanitetit;
4. pozita relative gjeografike e toskëve në raport me gegët do të ketë qenë e tillë edhe në ato kohë; në kohën kur toskët jetonin në afërsi të trojeve veriore të romanitetit, gegët duhet të kenë jetuar ose në territore më në veri të toskëve ose më larg nga rumaniteti; pra, drejt perëndimit;
 5. prandaj shqiptarët në hapësirat e sotme kanë ardhur diku nga veriu në kohë relativisht të vonë; do të ishte një mrekulli po të kishin mbijetuar në një territor kaq intensivisht të greqizuar si Shqipëria (mbase jugore) (Philippide 1927: 587).

Sipas vendit ku jetojnë sot, shqiptarët duhej të ishin ilirë. Por diskutimet e materialeve që kishte ai në dispozicion sikur e orientonin të kërkonte zgjidhje tjetër, sepse po të kishin qenë aty në lashtësi ata do të ishin greqizuar. Trakas nuk i dukeshin, sepse vërente, përveç ngjashmërive, dallime të mëdha midis rumanishtes e shqipes, sidomos në atë që ai quante mënyrë nyjetimi dhe në elemente të tjera. As romanizimi nuk i kishte përfshirë tërësisht, prandaj do të kenë ardhur nga një hapësirë ku nuk kishte ndodhur romanizimi i plotë e këtë e gjente në Panoni, ndërsa fiset panone, i shihte të afërta ose identike me ilirët. Kështu gjente shpjegim dhe për afërsinë më të madhe të toskërishtes me dakorumanishten perëndimore.

Në të vërtetë, Brâncuș-i dallonte nga Philippide-ja në idenë themelore për prejardhjen e shqipes, sepse ai mendonte që ngjashmëritë midis dy gjuhëve janë shumë të rëndësishme dhe rrjedhin nga një burim i përbashkët.

Në veprën *Vocabularul autohton al limbii române* (1983), duke diskutuar shtrirjen e atyre elementeve nëpër dialektet rumune, Brâncuș-i arriti në përfundimin vijues: dihet që në dialektet rumune në jug të Danubit ka më pak elemente autoktone të përbashkëta me shqipen sesa në dakorumanishten. Do të pritej e kundërta. Diçka të ngjashme sugjeron edhe situata dialektore e shqipes. Sipas tij, përkimet midis toskërishtes dhe rumanishtes janë më të numërta sesa midis gegnishtes e rumanishtes, edhe pse toskërishtja flitet në jug, pra më larg nga rumanishtja se gegnishtja.

“Ky fakt shpjegohet me atë që, shumë e besueshme, shqiptarët toskë banonin dikur në një rajon të vendosur diku më në verilindje nga Shqipëria e sotme, në fqinjësi me zonën trako-romane, nëse jo krejt në brendësi të kësaj zone” (Brâncuş 1983: 164).⁵²

Idetë e Puşçariu-t dhe diskutimet e Brâncuş-it

Me çka u tha më sipër lidhet edhe një çështje tjetër. Arsyet pse në arumanishten mungon një numër fjalësh të fondit të përbashkët midis shqipes e rumanishtes bëhen objekt diskutimesh të veçanta për Brâncuş-in. Qysh Puşçariu më 1910 kishte vërejtur se në arumanishten mungonin jo vetëm rotacizmi, po edhe fjalët si: *mugur, pîrîu, gata, ghiuj, măgar, strepede, ceafă, bung, ghimpe, gresie, balaur, cursă, viezure, zară, hameş* (referonte S. Puşçariu 1974: 90). Sipas tij, nuk duket e besueshme që ato fjalë të kenë ekzistuar në arumanishten. Në fillim ai kishte menduar se elementet autoktone të rumanishtes ishin huazime nga shqipja para sh. VII. Ai mendonte se kjo mungesë në arumanishten duhej shpjeguar kështu që

“vetëm një pjesë e stërgjyshërve tanë jetonte në afërsi me shqiptarët”.

Kjo do të thotë se arumunët nuk i kishin pasur ato fjalë kurrë (Brâncuş 1983: 169).

Kjo çështje kishte qenë objekt interesimi dhe për T. Capidan-in në veprën e tij *Aromăni*. Ai mendonte se, pas ndarjes nga dakorumunët, stërgjyshërit e arumunëve do të kenë qenë në afërsi të pandërmjetme me shqiptarët, diku te Haemusi, në Traki, në Rodope (Capidan: *Aromăni*, 169-70, sipas Brâncuş 1983: 169).

Kjo çështje mund të zgjidhej vetëm nëse do të pranohet që elementet e tilla nuk janë trashëguar pavarësisht nga substrati, po janë huazime nga shqipja. Por, mendonte Brâncuş-i, nuk ka dëshmi për

⁵² “Faptul acesta se explică prin aceea că, foarte probabil, albanezii tosci locuiau odinioară într-o regiune situată undeva mai la nord-est de actuala Albanie, în vecinătatea ariei traco-romane, dacă nu chiar în interiorul acestei arii”.

ndikim të shqipes në rumanishten. Edhe Pușcariu më vonë ato elemente i kishte lidhur drejtpërsëdrejti me substratin, ndërsa shpjegimin e mungesës së përmendur e kishte gjetur tek teoria e zonave skajore të M. Bartoli-t: zona qendrore e rumunëve do të ketë qenë në veri të Danubit, ku i përmendin kronikanët bizantinë. Atje ata përbënin një zonë qendrore, ndërsa krahët anësorë të kësaj hapësire i përbënin gjuhët e folura në periferi të saj, në Daki dhe në brigjet e Adriatikut. Pra, ngjashmëritë midis rumanishtes së Dakisë dhe shqipes nuk rrjedhin nga një kontakt direkt as janë huazime të drejtpërdrejta, po shpjegohen si forma arkaike të ruajtura në zonat anësore.

Sextil Pușcariu në veprën e tij *Limba Română I*, ribotim Minerva, București 1976, duke përmbledhur çfarë thuhej më herët lidhur me raportet rumuno-shqiptare, nxirrte në pah që përkimet e tilla janë sjellë në radhë të parë si argument për të pohuar që rumanishtja ka prejardhje jugdanubiane. Për këtë referonte P. Skok-un (*Slavia* 1929, 785), pas të cilit, trajtimi i njëjtë i grupit *a+hundore* në rumanishten e shqipen dhe i *cs, ct* në shqipen, rumanishten e dalmatishten, na bën që atdheun e parmë të këtyre tre popujve ta zbresim në dy mezitë dhe për një pjesë në hapësirën ilire. Ndërkaq M. Friedwagner 1934: 665 besonte që elementi i huaj që i dha rumanishtes karakterin e veçantë ka qenë nga shqipja e stërlashtë, ndërsa ndikimi i saj ka mundur të zhvillohej vetëm në Dardani (Pușcariu 1976: 267). Albanizmat e rumanishtes, sipas Pușcariu-t, bashkë me përkimet e rumanishtes me shqipen, na bëjnë të sigurt një gjë:

“stërgjyshërit tanë kanë banuar bashkë me stërgjyshërit e shqiptarëve aktualë. Meqë nuk kemi as shënime as indicie që shqiptarët të kenë jetuar në veri të Danubit, jemi të shtrënguar të pranojmë se së paku një pjesë e romanëve të vjetër ka banuar në jug të lumit” (Pușcariu 1976: 267).⁵³

Por për ta kuptuar më mirë çështjen, ai jepte disa shënime për shqiptarët: ata janë qysh në lashtësi në hapësirat ku jetojnë sot; shfaqen vonë

⁵³ “Strămoși ai noștri au locuit împreună cu strămoși de-ai albanezilor actuali. Deoarece n-avem nici știri, nici indici că albanezii ar fi trăit în nordul Dunării, suntem nevoiți să admitem că *cel puțin o parte a vechilor romani au locuit la sudul fluviului*”.

në dokumente historike, ndërsa emrat e vendeve në hapësirën ku jetojnë shfaqin karakter sllav. Si barinj, kanë lëvizur deri në Greqi e Itali të Jugut. Si tek arumunët, vërehet një lëvizje e fuqishme e tyre nga veriu drejt jugut. Raportonte idetë për paraardhësit e shqiptarëve dhe ndalonte më shumë te Jokl-i dhe ideja e tij për atdheun e hershëm të tyre në Dardani. Thekson ideën që paraardhësit e shqiptarëve, ilirët, do të kenë huazuar nga trakasit dhe e kundërta. Kështu mendonte se mund të shpjegoheshin përkimet midis dy gjuhëve aktuale, sidomos në aspektin fonetik: fjala dakase a trakase e ruajtur në rumanishten, kur hynte në ilirishten, merrte trajtën e gjuhës së stërgjyshërve të shqiptarëve (Pușcariu 1976: 268-9).

Brâncuș-i, ndërkaq, besonte se dialektet rumune të jugut në rrugën e tyre të zhvillimit kanë humbur disa prej fjalëve autoktone. Këtu ai i drejtohej Rosetti-t:

“Fakti se disa prej këtyre termave nuk janë të njohur nga arumanishtja [...] dhe nga meglenorumanishtja [...] mund të shpjegohet përmes bjerrjes së tyre eventuale [...] apo përmes së thënës se nuk kanë qenë shënuar ende nga hulumtuesit e dialekteve jugdanubiane” (Rosetti 1968: 267, Brâncuș 1983: 171).⁵⁴

Nga hulumtimet që kishte bërë vetë tek arumunët e Shqipërisë, Brâncuș-i raportonte se atje kishte gjetur që, në raport me fjalët e *‘fondit autokton’*, mungonin në arumanishten dyfish më shumë nga fondi që kishte shënuar Capidan-i.⁵⁵ Fakti se në një gjysmë shekulli midis anketave të Capidan-it dhe të tijave (Brâncuș-it) janë bjerrë kaq shumë fjalë të këtij fondi tregon që dialekti arumun fillimisht nuk ka ndryshuar për asgjë nga të tjerët edhe sa i përket kësaj fushe (Brâncuș 1983: 171-2).

Jo, kjo ende nuk do të thotë asgjë, më duket mua.

⁵⁴ “Faptul că unii din acești termeni nu sînt cunoscuți în aromână [...] și meglenoromână [...] poate fi explicat prin pierderea lor eventuală [...] sau prin aceea că ei nu au fost încă relevați de cercetători în dialectele sud-dunărene”. Vërtet tani më jo krejt në veri drejt Moldovës, por gjithsesi në verilindje në raport me pozitën e sotme.

⁵⁵ Ndër fjalët që ai priste të ndeshte e nuk i gjeti, ishin: *baci, baltă, bilc, cioară, ciuf, ciumă, coacăză, druete, leurdă, mazăre, măgură, mușcoi, știră*, etj.

Diskutimi i Hamp-it

Ide të ngjashme për shtegtimin e toskëve nga hapësirat e Dardanisë (zonat Leskovac-Nish në Serbinë e sotme) në një version tjetër do të gjejmë të hedhura edhe nga Hamp-i (1978), sipas të cilit, shtrirja e shqipes së hershme drejt lindjes merr parasysh përhapjen e tashme të shqipes drejt rrethinave të Leskovacit dhe emrat e vendeve të llojit Nish. Në të njëjtën kohë ajo merr parasysh edhe elementet e përbashkëta me komponentin autokton të rumanishtes.

“Në fakt, siç kam argumentuar gjetiu, këto elemente të përbashkëta të drejtojnë fuqishëm tek një rajon specifikisht i ulët që mund të gjendet në mënyrë plauzibile në hapësirën Sava-Danub në rrethinat e Singidunum-it (Beograd). Nëse do të jetë kështu, banorët e Serbisë, të Banatit, të Oltenisë dhe të harkut të Karpateve do të kishin përfshirë folës të dialekteve albانية të kohës së pushtimit romak. Shtrirja drejt lindjes e kësaj fashe duhej ta kishte adoptuar latinishten, përfshirë dhe përhapjen jugdanubiane drejt perëndimit, ndërkohë që pjesa perëndimore të ketë mbetur autoktone albانية dhe më vonë ta kenë lëvizur qendrën e gravitetit në perëndim drejt detit”.⁵⁶

Supozimi i tij ishte se do të ketë qenë inkursioni i sllavëve jugorë ai që do t'i ketë shtyrë ata drejt perëndimit; madje para se të jenë bërë të mundshme kontaktet e afërta me magjarët.

“Mbase nga kjo periudhë mund të datojmë huazime të tilla si grusht, me trajtimin e hershëm të jer-it dhe me zhvillimin e hershëm të s në sh (š); ky mund të jetë poashtu rrafshi që ne shohim në porosis porositi, edhe pse këtu zanorja e parë e plotë kërkon të merret një vendim që unë nuk jam gati ta marr tani. Gjatë gjithë kësaj kohe shqipja e hershme do të ketë qenë në veri të linjës Jireček, dhe këtë e konfirmon

⁵⁶ “In fact, as I have argued elsewhere, these common elements point strongly to a specifically lowland region which might plausibly be found in the Sava-Danube area in the environs of Singidunum. If that is so the inhabitants of Serbia, of the Banat, of Oltenia and the Carpathian arc would have included speakers of Albanoid dialectes at the time of Roman conquest. The eastern extension of this range would have adopted Latin, including a south-Danubian spread towards the west, while the western part remained autochthonous Albanian and later moved its center of gravity west to the sea”.

sasia e paktë e huazimeve nga greqishtja klasike” (Hamp 1978: 319).⁵⁷

Në raport me këtë pjesë të komenteve të albanologut indoeuropeist, që gjithnjë ngulte këmbë tek saktësimi i detajeve, duhet të shtojmë ndërdymjet vijuese: a është huazimi sllav *grusht* vërtet aq i vjetër, sa le të supozohet ky qëndrim? A është ai më i vjetër se rotacizmi apo diftongimi *o: vo/va*? A është *grusht* huazim fare? Raporte të tjera lidhur me kontaktet gjuhësore shqiptaro-sllave, edhe parimisht, na lënë të mendojmë dhe ndryshe: nëse në rumanishten nuk ka arsye të shohim huazime sllave më të vjetra se sh. VIII, siç thonë sllavistët rumunë, madje mjaft më të vona, ku qëndron arsyeja të gjenim të tilla në shqipen e hershme? Nuk kemi dëshmi të padyshimta për huazime sllave në shqipen që do ta tregonin këtë me kronologjinë e tyre të ndryshimeve fonetike të ndodhura para metatezës së likuideve në sllavishten, që merret si e fillimit të sh. IX. Konkretisht, lidhur me trajtimin e hershëm të *jer-it* le të shënojmë se M. Camaj e kishte kundërshtuar mendimin e Meyer-it për fjalën *grusht* nga sllavishtja e vjetër kishtare *grъstъ*, sepse në atë rast do të prisnim të kishim **gërsht* apo **grësht*, si në rum. *gîrșt*. Kjo lidhet me huazimin nga sllav. e lashtë e *ʃ* silabike *-ъʃ* (vërtit: *въʃt-ěti*) ose *-ʃъ* (*gërbë*: *gъʃbъ*). Prandaj në shqipen në këtë rast duhej të kishim vetëm **gërsht*. Fjalën shqipe *grusht* Camaj e mbante të afërt me baltosllavishten **gurti*, let. *gûrste* “Flachsknocke”, sllav. e vjetër *grъstъ*, sll. e vjetër kisht. *grъcmъ*, ndërsa tek *-ru* e shqipes shihte refleksin e vjetër IE *ʃ* (M. Camaj 1966: 35). Po kalimi *s > sh* në shqipen është aq i vjetër sa të shkojë te shekujt VI-VII? Nga ana tjetër, folja *porosis* formën e saj të plotë të sotme nuk e kishte assesi në krye të herës: te P. Budi (1621) ndeshim formën *porēsii* [porēsī], çka domethënë se fillimisht nga **poročiti* do të kemi pasur **porësit*, që gjithsesi nuk shkon kaq herët, madje jo para sh. XI-XII.⁵⁸ Ndërdymjet vijnë e shto-

⁵⁷ “Perhaps from this period we may date such loans as *grusht*, with its early treatment of the *jer* and the early development of *s* to *sh* (š); this also may be the level that we see in *porosis porositi*, although here the full first vowel requires a decision which I am not yet prepared to make. During all this time early Albanian should have been north of the Jireček line, and the sparsity of Classical Greek loans confirms this”.

⁵⁸ Po të ishte kaq e vjetër një fjalë trirrokëshe me theks në rrokjen e fundit do të pritej të ishte mbledhur në diçka si **përsi*.

hen nga fakti se, siç dëshmon historiografia, para invazionit sllav, nga veriu i Ballkanit nëpër këto zona kaluan gotët dhe vandalët gjithashtu shkretues. A nuk kishin bërë dhe ata trysni për ikje drejt jugut? Shumë pyetje për një supozim, që gjithsesi më shumë ngre dilema se ç'zgjdh.

Lidhur me idenë për hapësirën e kontaktit në zona të ulëta afër Danubit e Savës Hamp-i mund të ishte ndërlidhur edhe me elemente të tjera të natyrës gjuhësore. Për shembull, fakti që në shqipen e në rumanishten ka huazime të tilla si *pyll* (> **pëyll* > **pëdule* > **padule* > *palude*; **palude* > *pădure*, pra 'pyll i rrafshit jo i maleve'), apo që kemi emra vendesh si *Drobeta*, pikërisht në anën tjetër të Danubit, e që sipas Hamp-it e Georgiev-it shpjegohet përmes shqipes *dru* (*dru-të*), etj. Pak më larg, dhe për mendimin tim më radikalisht kundër idesë së tij dhe drejt dëshimit të pamundësisë së një hipoteze së tillë, Hamp-i shkonte në studimin e tij '*Sintagma më e vjetër shqipe*' (Hamp 1982: 77-79), ku përpiquej ta motivonte shpjegimin e V. Georgiev-it të toponimit *Drobeta*, *Drubetis* përmes fjalës rumune *druete*, të afërt me shqipen *dru*: rindërtimi **druveta* e prej këndeje **dрубeta*, **dрубeta* (shih për këtë pjesën *Ballkanistika dhe prejardhja e shqipes*). Hamp-i aty shihte shumësin si te rum. *druète druëti*, **dru(u)ā-ta-*+plural, pra **druuā+tā*, paraformën e nyjshme si në shqipen *dru-të*, domethënë asnjansin albanoid **druuom +tod*, **druua(n)+ta*.

“...*Drubetis* ilustron gjedhen për strukturën që shihet tek *lemnu-l*, *lemne-le* (druri, drutë), *pomu-l* (*pema frutore*), *arbore-le* (*pema, druri*), *floare-a*, *flori-le* (*lulja, lulet*). Kemi siguruar dëshmi të pandërmjetme për pasjen e këtij tipari të rëndësishëm të përbashkët që lidh shqipen moderne me mezinë e Poshtme: në termat IE, *EMĒR + so/ sā/ tod ‘definite+NP’” (Hamp 1982: 77-79).⁵⁹

Te *Ballkanistika dhe prejardhja e shqipes* kishim bërë vërejtjen për dobësinë në shpjegimin e prejardhjes së elementit ndërzanor që u bë *-b-*,

⁵⁹ “*Drubetis* therefore illustrates the model for the structure seen in *lemnu-l*, *lemne-le* ‘the wood(s)’, *pomu-l* ‘the fruit-tree’, *arbore-le* ‘the tree’, *floare-a*, *flori-le* ‘the flowers’. We have secured direct attestation for the common possession of the important feature linking modern Albanian with Moesia Inferior: in terms, *NOUN + so/sā/tod ‘DEFINITE + NP’.

për mungesën e qartësisë lidhur me kronologjinë e prapavendosjes dhe të përngjitjes së nyjës që do të bëhej pjesë e kësaj sintagme. Kishim pyetur po ashtu: po forma e shquar në emër vendi? (Ismajli 1996: 272-273). Natyrisht, nuk duket i pranueshëm supozimi që nyja shquese e prapavendosur të dilte me formën *-ta shekuj para Krishtit.

Midis kohës për të cilën aludonte Hamp-i, fillimit të mijëvjeçarit dhe kthesës së mijëvjeçarit, shqipja, sidomos ajo që do të bëhej toskërishte, e supozuar më e afërt me dakorumanishten, do të jetë shtrirë drejt jugut:

“mbase në perëndim të malit Sharr, duke zhvendosur kështu dialektin e diferencuar mirë të toskërishtes, e me këtë bazën për një shtrirje në vazhdim drejt jugut (është e qartë jo me pushtim kulturor po me migrim fizik) nëpër territorin lashtogrek (si Himara)⁶⁰ drejt Epirit për të kaluar në Tesali dhe në Golfën korintian” (Hamp 1978: 319).⁶¹

Më tej ai e shpjegonte idenë e tij duke shtuar se, meqenëse ti-paret kryesore që dallojnë toskërishten nga gegnishtja i lidhte me zhvillimet e njohura në sllavishtet e jugut (ashiqare, fjalën e kishte për denazalizimin, e me këtë dhe rotacizmin), gjithsesi si fenomen i Sprachbundit, nxirrte hipotezën tjetër:

“...zhvillimi i toskërishtes paraqet një mbishtresim të shqipes në një territor të hollë sllav; kjo sugjeron që sllavët e jugut më herët kishin ndjekur anën jugore të dobët greke të linjës Jireček drejt limitit perëndimor” (Hamp 1978: 319).⁶²

Supozimi i tillë mund të çohet më tej drejt idesë që në një fazë më të hershme shqipja e folur në veri të linjës Jireček, në të vërtetë

⁶⁰ Kush e njeh terrenin e Shqipërisë së Jugut, jo vetëm vështrimin nga hartat, e kupton gjithsesi se asnjë lëvizje e supozuar e popullatave nga pjesët më në veri nuk do të shkonte përmes Himarës.

⁶¹ “Probably west of Šar Planina, also yielding the well-differentiated Tosk dialect, and with this the basis for a continuing southward extension (apparently not by cultural conquest but by physical migration) through old Greek (e.g. Himara) territory on past Epiros into Thessaly and to the Corinthian gulf.”

⁶² “... the development of Tosk represents an overrunning of Albanian in thinly held Slavic territory; this suggests that the South Slavs had earlier roughly followed the southern and weakly Greek side of the Jireček line towards their western limit”.

të ketë pasur shtrirje perëndim-lindje: pra, ajo që do të bëhej toskërishte do të jetë folur në pjesët lindore të Dardanisë e më tej: Nish-Leskovac-Ovçe Pole-Shtip... Në një rast të tillë do të ketë qenë i mundshëm kontakti me dakorumanishten, që supozohet të jetë folur më tej drejt veriut e në fqinjësi me Dardaninë.

Këtu mund të kemi vështirësi me kronologjitë që lidhen me denazalizimin sllav dhe me rotacizmin e shqipes, që për ne është më i hershëm se sh. VIII. Natyrisht, kalimi i tillë nuk gjen mbështetje askund në dokumentim, qoftë edhe të skajshëm. Mua më duket se ngjashmëritë që ai dhe të tjerë shohin në pika si këto që supozohen këtu ndërlidhen pikërisht me reflekse të ngjashme të kontakteve të sllavishtes së tipit bullgar me shqipen, në një anë, e me romanishtet rumune, në anën tjetër, pra më shumë një veçori e pjesës lindore të Siujdhesës.

Alexandru Rosetti edhe në mënyrë eksplicite e kishte mënjanuar këtë diskutim si të pamundshëm. Sipas tij, argumentet e atilla nuk janë bindëse (shih Vasmer, *Zs. Sl. Phil.*, V, 286; Seliščev, *Slav. Nas. v Alb.*, 49, 73). Dallimet e thella midis gegnishtes dhe toskërishtes do të tregonin, përkundrazi, lashtësi të madhe të gjuhës shqipe në kufijt e saj aktualë; por tiparet e veçanta të dialektit gegë dhe tosk janë shfaqur vonë. Sipas tij, as përmendja e vonë e shqiptarëve në burimet nuk përbën një argument bindës kundër lashtësisë së tyre në Shqipëri të sotme, sepse ata nuk përmenden as më vonë, kur prania e tyre në territorin aktual është e dëshmuar. Përveç kësaj, thoshte ai, emrat e majave të maleve në Shqipëri janë shqip ashtu si dhe gjysma e emrave të vendeve dhe të lumenjve, ndërsa mungesa e një terminologjie autoktone të peshkimit provon vetëm atë se stërgjyshërit e shqiptarëve kanë jetuar në një epokë të lashtë larg bregut të Detit Adriatik, (Rosetti: 211). Pas raportimit për autorët që mbështesnin autoktoninë ashtu si të tjerët, ai sillte konceptimin e përhapur në historiografi, sipas të cilit shqiptarët jetonin në rajonin midis Shkodrës, Prizrenit, Ohrit e Vlorës (Jokl, *RLV*, I, 85, Jireček, *Alb. In d. Vergangenheit.*, 69; Hamp, *Alb.*, 99), ndërsa zbritja në jug është më e vonë, por nuk e linte pa i raportuar dhe idetë e Barić-it për *'trakishten e ilirizuar'* dhe të

Tagliavini-t për prejardhjen ilire, por në hapësirat e Dardanisë.

Natyrisht, në asnjërin rast nuk gjendet ndonjë mbështetje në të dhënat, apo në dispozicionin kohor dhe hapësinor të shtrirjes dialektore të rindërtueshme së paku nga sh. VI-VII. Shpjegimi i ngjashmërive të supozuara midis toskërishtes dhe dialekteve rumune do të ketë arsye të tjera, dhe të rendit të Sprachbundit ballkanik, por jo të një natyre që do të shkonte kundër tërë rindërtimit historik të shqipes dhe shtrirjes së saj.

Ka rëndësi veçimi i këtij pohimi, në fakt, sepse kështu me të merrte mbështetje edhe më të madhe, edhe linguistike, ideja që elementet e përbashkëta të saj me shqipen, rrjedhin nga një komponent i rëndësi-shëm i trashëguar, që do të ketë qenë i përbashkët me shqiptarët, pra nga një substrat, i cili nuk vjen nga Iliria, po pikërisht nga hapësirat dakase, sepse kështu evitohej detyrimi që formimi i rumanishtes të vendosej në jug të Danubit, në Ballkan.

Hahn, Polák, Beci e të tjerë për ndarjen dialektore të shqipes

Në të vërtetë, ide të ndryshme lidhur me ndarjen dialektore të shqipes dhe me kohën e ‘vendosjes’ së toskërishtes në jug kanë qenë artikulluar më herët nga sllavistë, sidomos V. Polák, e të tjerë. Për arsyet e ndarjes dialektore të shqipes ka folur qysh J. G. von Hahn-i më 1854, i cili ndarjen dialektore të shqipes e kishte shpënë tek realitetet etnike të atëhershme: e shihte të ndërlidhur me ndarjen në epirot(i-shte) dhe ilir(ishte). Sipas tij, qysh Strabon-i e kishte vërejtur se kufiri i Shkumbinit dhe vija Egnatia paraqisnin kufi politik dhe etnik midis ilirëve dhe epirotëve. (Hahn 1854: 219, botimi shqip f. 27):

“Mbas një mendimi të përgjithshëm duket se asht Shkumbini kufini në mes Toskënisë dhe Gegënisë. E vërteton këtë një shënim i Strabonit se ky kufi i gjuhës asht shumë i vjetër dhe emnat e rinj janë baraz me fjalët epirot dhe ilir”.

Në një studim të veçantë B. Beci (Beci 1982: 157 e vijim; Beci 2002: 157) idenë e Hahn-it e sillte në kontrast me komentimin e Meyer-it për të:

“Kjo gjë është e mundshme, madje do të thosha që ka gjasë që të jetë, por nuk është aspak e provuar... Në çdo rast, ndryshimi i sotëm në mes të gegërishtes e toskërishtes, i cili në fund të fundit nuk është dhe aq i madh, mund ta ketë burimin nga një dallim i mëvonshëm. Studimi i shqipes së folur në Greqi më bën të ruaj këtë mendim si më të pranueshëm” (Meyer 1885: 588, sipas Beci 2002: 157; përkthimi i Becit).

Ai aty sillte dhe komentimin relativizues të N. Jokl-it, pas të cilit gjuhëtari nuk e ka të vështirë ta vërtetojë risinë relative të ndarjes dialektore të shqipes (Jokl 1917: 125; Beci 2002: 157). Po ashtu C. Tagliavini dallimin midis toskërishtes e gegnishtes e shihte të vonë dhe jo të kohës së ilirëve e epirotëve (Tagliavini 1935-1936: 9, sipas Beci 2002: 157). Për E. Çabejnë çështja e ndarjes dialektore të shqipes gjithsesi nuk është shumë e lashtë. Ai pajtohej me Meyer-in e Jokl-in, por shtonte se dallimet midis dy dialekteve nuk janë të gjitha të një kohe, janë krijuar shkallë-shkallë (Çabej 1964: 6; Çabej 1959: 69-70; Çabej 1974: 433-434; Beci 2002: 158-160):

“tiparet që dallojnë dialektet nga njëri tjetri, edhe në këtë gjuhë nuk janë përftuar njëkohësisht po pak nga pak e shkallë-shkallë dhe me grumbullimin e tyre erdhën e u formuan me kohë dy grupe dialektore më vete. Me këtë gjendje, nga fusha etnografike pajton fakti që në dokumentet mesjetare nuk dalin asgjëkund emrat gegë dhe toskë” (Çabej 1973: 96).

Beci ka shënuar gjithashtu që J. Gjinari, edhe pse pranonte vjetërsinë e disa tipareve dalluese midis dy dialekteve, mendonte se dispozicioni që kemi sot është më i vonë. Aty referonte dhe veten me pohimin se veçoritë dalluese midis dy dialekteve janë të periudhës parasllave (Beci 1974: 344; Beci 2002: 160).

“... Kalimi i n-së në r në toskërishten si edhe tiparet e tjera dalluese të dy dialekteve të shqipes, i përkasin fundit të periudhës antike ose mesjetës së hershme, kështu që edhe ndarja e shqipes në dy dialekte është e kësaj periudhe” (Beci 1979: 29; Beci 2002: 160-161).

Nuk ka arsye që për disa prej dallimeve midis dy dialekteve të mos mendohet kështu.

Vetë Beci shprehte mendimin se për ta përcaktuar kohën e ndarjes dialektore të shqipes është e nevojshme të caktohen së pari tiparet që

dallojnë këto dialekte. Mendonte se ato kanë qenë shënuar në detaje që nuk reflektojnë kritere relevance dhe kjo mund të jetë një nga arsyet pse autorë të ndryshëm kanë nxjerrë përfundimin që kjo ndarje është relativisht e re. Mendonte se tiparet dalluese themelore janë:

1. prania në gegnishten e kundërvënies së zanoreve hundore;
2. prania në gegnishten e gjatësisë funksionale dhe mungesa e saj në toskërishten;
3. prania në toskërishten e zanores /ë/;
4. prania në toskërishten e fonemës /r/ ndërzanore në një grup fjalësh që në gegnishten dalin me /n/;
5. prania në toskërishten e grupit *va-* në gegnishten *vo-*;
6. prania në toskërishten e grupit të zanoreve *ua*, ndërsa në gegnishten disa variante: *-ue, -u, -au, -ou*;
7. Prania në gegnishten e paskajores *me+punue* dhe mungesa e saj në toskërishten.

Kjo do të thotë se dallimet janë të pakta, prandaj pikëpamjet e sforcuara të disa studiuesve janë aprioristike. Këtu e shihet të nevojshme të kundërshtonte idenë e J. Erdeljanović-it, i cili ndarjen dialektore të shqipes e paska shpjeguar

“me praninë e një baze krejt të ndryshme në veri tek gegët, në krahasim me toskët në jug” (Erdeljanović 1920: 20, sipas Becit).

Pas diskutimeve për tiparet e ndryshme dalluese, atij i dilte se ato janë të kohës para huazimeve sllave. Prandaj ndjente nevojë të përcaktonte kohën kur kanë hyrë ato në shqipen. Dhe diskutimet e tij tregojnë se fjala është për kohë para sh. IX, për të përfunduar:

“dy dialektet e shqipes u formuan në territoret e tyre të sotme në mesjetën e hershme (shek. VI-VIII) ose në antikitetin e vonë (shek. IV-V) para ardhjes së sllavëve. Ata dëshmojnë për një shqipe tanimë të formuar si zhvillim i mëtejshëm i ilirishtes” (Beci 2002: 168).

“Përpyekjet e disa gjuhëtarëve për të hedhur poshtë pikëpamjen e Hahn-it me argumentin se ndarja e shqipes në dy dialekte është e re, pas shqyrtimeve që i kemi bërë këtij problemi, mendojmë se duhet quajtur e kapërcyer” (Beci 2002: 185; Beci 1982: 65-74; Beci 1986: 243-252).

Duke pranuar se tiparet themelore të toskërishtes janë të vjetra, të zhvilluara para ndikimit të gjuhëve sllave në shqipen, ai përfundonte:

“Tiparet dalluese të dy dialekteve territoriale të shqipes, me vjetërsinë dhe shtrirjen që paraqesin sot, nuk mund të jenë formuar në një territor tjetër jashtë territorit të banuar sot nga shqiptarët” (Beci 2002: 173).

Po ta ndjekim idenë e shtruar kështu, hetimi i zhvillimeve të rëndësishme si nazalizmi/ rotacizmi, diftongimi i zanores së mesme të prapme *o* në *uo*: *ua*: *ue*, *vo*-: *va*- apo prania/ mungesa e paskajores, ç’është e vërteta, të çojnë në kohë jo më të hershme se sh. VI dhe pikërisht kjo është koha e kontakteve të reja në Ballkan me gjuhët sllave të jugut në kontekst të kontakteve më herët të vendosura me romanishten e greqishten. Këtu shfaqen mundësi të zhvillimeve, disa prej të cilave janë komentuar në këtë drejtim: si pasojë e kontakteve me sllavishtet dhe me vllahishten e greqishten, pra do të favorizohej konteksti ballkanik. Për ide të ngjashme shih Mansaku lidhur me tipologjinë romane në shqipen.

Për t’i sqaruar përmasat e huazimeve sllave në shqipen autorë të ndryshëm në vijën e Seliščev-it (1931), të P. Skok-ut (1934, 1948), të I. Popović-it (1960), në një formë tjetër të V. Polák-ut (1963) e pjesërisht të A. Desnicakja-s (1976), kishin kredituar idenë sipas së cilës në pjesë të hapësirës ku është folur shqipja do të ketë jetuar një popullatë e rëndësishme sllave, e cila, për shkak të masës dhe fuqisë më të madhe të popullatës baritore-malsore (shqiptare) ishte asimiluar dhe kështu në shqipen kishte sjellë një numër të madh sllavizmash. Derisa Polák-u (1963) mendonte se krejt diferencimi dialektor i shqipes në gegnishte/ toskërishte i detyrohej pikërisht ndikimit të adstratit sllav, për çka kishte marrë vërejtjet serioze kritike të dialektologut J. Gjinari (1968), pjesërisht dhe distancat e Desnickaja-s (1976: 187), e cila hidhte poshtë supozimin e tillë, sepse tipari themelor (sipas saj) dallues midis dy dialekteve – tipari i rotacizmit nuk i përfshinte huazimet sllave (aty: 186), por nga ana e saj supozonte se në hapësirat e toskërishtes veriore do të ketë pasur një popullatë më të gjerë sllave që ishte vendosur atje dhe që me kohë ishte asimiluar (para sh. XIV-XV), duke lënë pasoja në mënyrën e shqiptimit të

zanoreve dhe të tingujve të shqipes në përgjithësi, çka, nga ana tjetër, krijoi dallime dialektore në raport me toskërishten tjetër labe, e cila, sipas saj, manifeston tipare arkaike e inovuese të përbashkëta me gegnishten e të ndryshme nga toskërishtja tjetër. Pra, paskemi një ndarje më të hershme rotacizuese në gegnishte/ toskërishte, që s'ka të bëjë me kontekstin e asaj që ajo e quan '*substrat sllav*', dhe ndarjen tjetër midis toskërishtes veriore dhe toskërishtes labe, që lidhet me të.

Sido që të jetë, nuk bëhet fjalë për ndonjë '*imigrim*' të toskëve e të dialektit të tyre nga hapësirat veriore ndaras, ku do të paskëshin pasur mundësinë të kenë kontakte të afërta me dakorumanishten, nga gegët dhe dialekti i tyre, ashtu siç linte të supozohej ideja e Brâncuș-it, në një formë tjetër e Hamp-it. Ky dimension i shpjegimit të ngjashmërive më të mëdha midis dakorumanishtes dhe toskërishtes në raport me gegnishten nuk qëndron. Shpjegimi do gjetur gjetiu. Mbase kemi të bëjmë me një dispozicion më lindor të toskërishtes dhe me kontaktet në ato hapësira me variantin e sllavishtes jugore që i dha komponentin më të madh të sllaviz-mave rumanishtes dhe me kontekstin e vargëzuar shumëgjuhësh, nga i cili gegnishtja më veriperëndimore do të ketë qenë më anash dhe më shumë në hapësirën romane. Kjo mund të thotë po ashtu se dakorumanishtja do të jetë folur në hapësirat në jug të Danubit.

Edhe pak për idetë e Brâncuș-it për substratin

Grigore Brâncuș-i në fund vinte me përfundimet se nga '*substrati trako-dak*' në rumanishten ka rreth 90 fjalë, të cilat në gjuhën shqipe kanë përkatëset e tyre identike apo shumë të ngjashme, etimologjikisht të raportueshme te rrënjorët indoeuropianë. Përveç këtij fondi janë edhe nja 50-60 fjalë të cilat mund t'i relatohen vetëm substratit. Sa i përket fonetikës ka pasur dhe dyshime lidhur me etimologjitë. Mendonte se ishte e drejtë që në hulumtimin e këtyre elementeve të substratit të nisej nga gjendja aktuale dhe nga krahasimi me shqipen. Identifikimi i ngjashmërive midis këtyre gjuhëve është i lehtë, thoshte ai, por interpretimi etimologjik nxjerr vështirësi. Duan rindërtuar format e rumanishtes së përbashkët

ashtu si të shqipes së përbashkët. Këtu ai nxirrte përfundimin se fondi leksikor indoeuropian i shqipes sa i përket shtresës së përbashkët me rumanishten identifikohet me substratin rumun. Kjo do të thotë se shqipja kishite strukturë trakase (shih Barić 1955, Gabinski), dako-meze (Georgiev 1960) apo të sintezës trako-ilire (Jokl, Capidan), ose ilire me ndikime trakase (Çabej,⁶³ Rosetti), pra mund të flitet për një komponent trakas në elementet konstitutive të shqipes. Kjo nuk e përjashton mundësinë që disa prej termave të identifikuar të kenë qenë të njohur edhe nga gjuhë të tjera të Ballkanit të lashtë, si ilirishtja, etj. Përmendte këtu *mal*, *mînz* – *mëz*, etj. (Brâncuş 1983: 183-184).⁶⁴

Ndikimi autokton në gjuhën e romanëve në lashtësi në këto zona do të ketë qenë i mundshëm në tërë hapësirën folëse për shkak të njësisë social-politike (dakase) që ishte krijuar, është një tjetër hipotezë e Brâncuş-it që do dëshimim. Por le ta shohim të plotë konceptin e tij sociolinguistik. Rol me rëndësi themelore për ruajtjen e këtij uniteti të gjuhës latine të Dakisë, mendonte ai, ka luajtur krishtenizmi. Bjerrja e një numri elementësh autoktonë në jug të Danubit ka të bëjë me pozitën inferiore social-politike të folësve. Përsa i përket kuptimit, termat e substratit, ashtu si përkatësit të shqipes, kanë karakter popullor. Lidhen me jetën bari-tore. Aspekti rustikal i elementeve të substratit përkon me karakterin rustikal të latinishtes së trashëguar në rumanishten. Të gjitha këto reflektojnë rustikalitetin e jetës së dako-rumunëve pas vitit 275 të shkaktuar sidomos nga invazionet e popujve migratorë (Brâncuş 1983: 185). Ndikimi i tillë në latinishten e Dakisë do të ketë zgjatur deri në shekullin VI kur supozohet që dakasit e lirë të ardhur nga verilindja të jenë shkrirë plotësisht me getodakasit e romanizuar (Brâncuş 1983: 186).

“Elementet që rumanishtja i ka të përbashkëta me shqipen nuk shpjegohen në rumanishten përmes huazimit nga shqipja. Ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme që këto elemente janë transmetime direkte nga substrati

⁶³ Nuk duket krejt kështu te Çabej.

⁶⁴ Natyrisht, nuk është e lehtë të pranohen tërë këto eventualitete lidhur me substratin, pa asfarë dëshmish konkrete.

trako-dak” (Brâncuș 1983: 186). “Nuk mund të dëshmojmë se këto elemente, qoftë edhe vetëm disa prej tyre, kanë hyrë më vonë, në periudhën e rumanishtes komune, nga shqipja. Fjalët e përbashkëta të dy gjuhëve vijnë nga i njëjti burim, nga trako-dakishtja.⁶⁵ Në këtë rrafsh pararoman duhet të shihet afria midis rumanishtes e shqipes, afri që shpjegohet jo vetëm me elemente të vokabularit, po edhe nga fakte të numërta të fonetikës dhe të morfo-sintaksës” (Brâncuș 1983: 186-187).⁶⁶

Brancuș-it i dukej e pamundur që një numër kaq i madh të dhënash identike apo të ngjashme në këto dy gjuhë të shpjegohet përmes ndikimit të thejstë në një drejtim. Ekzistencën e fondit gjuhësor shqiptaro-rumun, mendonte ai, e justifikon vetëm veprimi i substratit, dhe në këtë pikë nuk ka dallim midis tij e Russu-it dhe shumë rumanistëve rumunë, sidomos të gjysmës II të sh. XX.

Natyrisht, këtu mbetet shumë për t’u diskutuar, sa u përket zhvillimeve fonetike dhe të formës shpesh të parrafshuar brenda vetë rumanishtes, sidomos në raport me pohimin se ato kanë hyrë qysh në latinishten ballkanike. Shumë gjëra të supozuara të substratit në fushën e strukturës lënë vend po ashtu për të diskutuar gjerësisht sa i përket kohës dhe kronologjisë. Diçka edhe mund të thuhet në vijim, ose do të jetë thënë më herët. Lidhur me (pa)mundësinë e prejardhjes trakase të shqipes shih Ismajli 1987, Katičić 1976, Нерознак 1978, Di Giovine 1982, Hamp: *Biso*, etj.

⁶⁵ Ç’të themi për ato që shihen ilire, apo për ato me derivacion brenda shqipes si *mal, këlbazë, droje, moshë*...

⁶⁶ “Elementele pe care româna le are în comun cu albaneza nu se explică în română prin împrumut albanez. Există dovezi suficiente că aceste elemente sînt transmisiuni directe din substratul traco-dac. Ele au intrat mai întîi în latină, așadar, din punctul de vedere al românei comune, aceste cuvinte nu reprezintă un grup separat de fondul latin, pentru că în română ele au fost moștenite ca elemente ‘latine’, evoluînd după aceleași legi fonetice ca cele latine propriu-zise. Nu putem dovedi că aceste elemente, fie și numai unele dintre ele, au pătruns tîrziu, în timpul perioadei românei comune, din albaneză. Civuntele comune din ambele limbi vin din același izvor, din traco-dacă. La acest nivel preroman trebuie văzută înrudirea dintre română și albaneză, înrudire care se exprimă nu numai prin elemente de vocabular, ci și prin numeroase fapte de fonetică și morfo-sintaxă”.

Në shkrimet e viteve '80 sa i përket çështjes së substratit ne kishim ndjekur pak a shumë logjikën e Çabejtë, por kishim shprehur dhe dyshime të tjera në këtë drejtim. Sh. Demiraj, edhe pse e mbështeste idenë e Çabejtë për pamundësinë e substratit në shqipen, sepse aty nuk ka pasur ndërrim gjuhe, lejonte mundësinë e shpjegimit përmes substratit për rumanishten, e kjo do të thotë se duheshin gjetur shpjegime për situatat dhe shtresat e ndryshme të këtij fondi të përbashkët.

Bardhyl Demiraj, në recensionin që i bënte librit të G. Brâncuș-it, kishte nyjtuar vërejtjet e tij lidhur me këtë çështje. Demiraj këtu merrej me aspektet e raporteve leksikore të rumanishtes e shqipes, por qysh në fillim shprehte vlerësimin për

“të ashtuquajturin substrat të gjuhës rumune, i cili sot përfaqëson fushën më të errët dhe më pak të sqaruar në historinë e asaj gjuhe” (f. 196).

Pas vërejtjes për mangësitë e metodës së ndjekur në rrugën për të ndërlidhur elementin e trashëguar jolatin të rumanishtes dhe elementin indoeuropian të trashëguar të shqipes, sidomos pas vendosjes për të ndjekur rrugën që supozon se struktura etimologjike e fjalorit të shqipes do të ketë një komponent trakas, sepse trakishtja ishte gjuhë *satəm*, Demiraj bënte vërejtjet me rënëdsi:

1. Ky përfundim nuk mund të arrihet nëpërmjet krahasimit historik të fjalëve të vjetra të përbashkëta të të dy gjuhëve; në vijën e Çabejtë, ai theksonte se në përcaktimin e formave të shqipes rindërtimi i brendshëm është themelor, ndërsa krahasimi me rumanishten vetëm ndihmës; për rumanishten vlen e kundërta; ndërkaq gjuha e trakasve, trako-dakasve a geto-dakasve mbetet e panjohur.
2. bënte vërejtje për idenë e autorit që elementi *satəm* i shqipes të shqyrtohet si komponent trakas, ndërsa elementi *centum* si i një gjuhe jogreke të Ballkanit, ilir. Kjo, sipas Demirajt, është në kundërshtim me rezultatet e albanologjisë, e cila konsideron se

“shqipja në elementet e saj konstitutive është vijim i pandërmjetshëm i një gjuhe satəm të Ballkanit”, f. 198.

Prandaj ngrinte pyetjen se ç'pozitë zë komponenti *satəm* trakas në

përbërjen e shqipes. Këtu konstatonte:

“Këtë çështje autori (Brâncuș, r.i.) nuk mund ta zgjidhë dot në të mirë të trakishtes”,

jo vetëm sepse trakishtja nuk njihet, por edhe sepse elementi leksikor satəm, i përbashkët për shqipen dhe rumanishten, nuk mund të veçohet nga karakteristikat e përgjithshme e të veçanta të leksikut të trashëguar indoeuropian të shqipes.

“Për rumanishten mund të thuhej se në të kanë depërtuar elemente satəm sepse kemi të bëjmë me një gjuhë thelbësisht centum si neolatine”.

Shqipja është me bijëri nga një idiomë jogreke e Ballkanit. Mendohet se është më pak e diskutueshme teza që vendos lidhje gjenetike të pandërmjetme midis shqipes dhe ilirishtes.

“Kurse teza për një prejardhje trake ndesh vështirësi të pakapërcyeshme. Prej saj vërejmë të tërhiqet, me të drejtë, edhe vetë Brâncuși”, f. 198.

Më herët Brâncuș-i kishte pohuar se shqipja ishte pasardhëse e trakishtes ose e një idiome trakase (Brâncuș 1963: 55 e vijim), për çka kishte qenë kritikuar nga E. Lafe (*Studime filologjike* 1/ 1969, ff. 181-183). Prania e elementeve që Brâncuș-i i konsideronte trakase nuk flet për një komponent trakas në shqipen e hershme a ilirishten. Demiraj e diskutonte posaçërisht shqyrtimin e Brâncuș-it lidhur me dilemën a janë elementet leksikore të rumanishtes të përbashkëta me shqipen huazim nga shqipja apo trashëgim nga substrati, dilemë përmes së cilës Brâncuș-i dhe studiuesit rumunë përcaktojnë edhe burimin e shqipes, pra, nëse është trashëgim, atëherë del se shqipja duhej të buronte nga trako-dakishtja. Prandaj, theksonte Demiraj me fjalët e Brâncuș-it se

“detyra e hulumtimit është të tregojë se këto lidhje nuk janë zhvilluar vonë, në rumanishten e përbashkët, përkatësisht në shqipen e përbashkët” (Brâncuș, aty: 20-21, Demiraj 199).

Ndër argumentet me të cilat Brâncuș-i e mbronte teorinë e prejardhjes së atyre elementeve nga substrati, veçonte tre: a. afrimet etimologjike karakterizojnë fazën antike të shqipes/ rumanishtes; b. elementet rumune të substratit u janë shtruar të njëjtave trajtime fonetike me të latinishtes, prandaj dallohet /dz/ < /g'/ te brîndză: shq. *brenzat*; *budză*:

*buzë; /j/ < *gu/ /gj/ - jumătate: gjymës; rotacizimi i l-së ndërzanore: aburre: avull, mägură: mugull; grupe bashkëtingëlloresh, theksi, etj. Këto nuk shfaqen te huazimet e vona, p.sh. sllave, të rumanishtes. c. Në këto bashkëpërkime ka dhe dallime, sidomos reflekse të ndryshme fonetike në të dy gjuhët. Të shtojmë se këtë e theksonte si argument dhe Rosetti. B. Demiraj në lidhje me këtë grup çështjesh bënte vërejtjet vijuese: 1. edhe sikur të pranohet që njësitë e shqyrtuara janë nga substrati, kjo nuk e provon dot lidhjen gjenetike të drejtpërdrejtë midis substratit të atillë dhe 'nënës' së shqipes; 2. sqarimi i këtyre bashkëpërkimeve kërkonte shtresimin kohor të njësive leksikore. Këtu ai e ndërlidhte çështjen me kohën e formimit të të dy gjuhëve dhe të kontaktit, prandaj njësitë që u takojnë periudhave kur s'ishin formuar shqipja dhe rumanishtja nuk mund të vihen në kuadrin e raporteve midis këtyre gjuhëve, f. 200. Këtu shihen dysitë si *çjap/ thjap: çap; thark: țarc; dhallë: zară*, apo elementet leksikore nga toponomastika e lashtë: *mal – Malya, Maluensis, Dimallum*; raporti *mëz: mînz* me *mezhenai, Menzana*, etj. Kjo të çon te studimi në fushë IE. Këtu duhet mbajtur parasysh: 1. njësitë përkatëse në shqipen kanë pësuar zhvillimin fonetik të fjalëve të fondit autokton, kurse ato të rumanishtes janë përshtatur me të latinishtes ballkanike; 2. pos përbashkësive, ka edhe tipare dalluese. Një numër njësisish i takojnë periudhës së kontakteve midis stërgjyshërve të shqiptarëve e të rumunëve: *hameş: hamës, moş: moshë*, etj. f. 201. Rikujtonte idenë e Çabejtë për kontaktet e hershme midis dy popujve në skajin verilindor të etnosit shqiptar, para dyndjes sllave; në shqipen njësitë e tilla nuk dalin të izoluara.*

B. Demiraj raportonte dhe diskutonte lidhur me atë që Brâncuş-i e kishte ndarë si *Fjalë autoktone të sigurta* e *Fjalë autoktone të mundshme*. Bënte vërejtje lidhur me shtresimin kohor dhe me shembuj konkretë: *gresie*, që afrohet me shqipen *gërresë*, e të cilën në rum. Brâncuş-i e sillte nga **gres* > rum. e përbashkët *greasă*. Por në shqipen *gërresë* vjen nga *gërryej* me prapashtesën *-esë*, ku *-s-* nuk i përket fazës së lashtë të shqipes. Nga ana tjetër, prapashtesa *-esë* në shqipen është prodhimtare, ndërsa *-să* në rumanishten e izoluar, f. 203. Kjo njësi nuk mund të shihet e vjetër, aq më pak e substratit, po më parë një huazim nga shqipja, vërente me të drejtë.

Për disa njësi ai gjente vështirësi shpjegimi. Ta zëmë, te *drojë* 'frikë': rum. *droaie* 'bandë, turmë',⁶⁷ rum. *leurdă* 'bimë në familjen e zambako-rëve me erën e hudhrës' – *hudhër*, rum. *noian* 'oqean, gjerësi' – *ujanë*, etj. Këtu ai vërente me të drejtë diskrepanca në interpretimin etimologjik lidhur me rrafshet fonetike e gramatikore, semantike. Ka raste të tjera kur interpretimi etimologjik duket i sforcuar, natyrisht, me prapavijë synimin për të dëshmuar karakterin autokton të rumanishtes, f. 204. Demiraj nxirte përfundimin se ka nevojë për hulumtime të mëtejme lidhur me sqarimin historik të fjalëve të përbashkëta midis shqipes e rumanishtes.

Recensuesi i librit të Brâncuș-it të vitit 1995, Genc Lafe e ka parë të arsyeshme të bënte një diskutim lidhur me konceptin themelor të përdorur nga ai: të substratit. Ai nisej nga vrojtimi se në rastin e substratit kemi të bëjmë me zëvendësim gjuhe dhe me gjurmë që lë ky zëvendësim nga gjuha e mëparme në të renë. Për rumanishten ai e pranonte një gjë të tillë, por për shqipen, që është vazhdim i një idiome ballkanike të periudhës paralatine nuk shihte kuptim. Qysh Çabej kishte theksuar se për rastin e shqipes lidhur me trashëgiminë lashtoballkanike nuk kishte kuptim të flisnim për substrat, sepse ajo është vazhdim i njëjës prej gjuhëve të lashta ballkanike, konkretisht, pas tij, e ilirishtes. Sipas Brâncuș-it, shpjegimi i afiniteteve midis shqipes e rumanishtes bëhet përmes pranisë në shqipen të një komponenti trako-dakas (diku fliste për substrat trako-ilir). Sipas G. Lafe-s, gjuhëtarët mendojnë se shqipja u formua si gjuhë e veçantë në sh. IV-VI, ndërsa në strukturën e saj fonologjike e morfologjike nuk ka indicie për të dëshmuar ndonjë këmbim të tipareve themelore që do ta justifikonte relacionin e substratit midis saj e gjuhës nënë. Rindërtimi brenda shqipes flet për një raport evolutiv me protoshqipen. Pra, nëse për rumanishten mund të flitet si për një substrat, për shqipen kemi të bëjmë me një trashëgimi. Këtë e kishte thënë shumë më herët dhe Çabej, e kanë përsëritur shumë të tjerë. Më tej ai bënte edhe një vërejtje në këtë fushë: meqë kemi të bëjmë me gjuhë të folura në hapësira të gjera, duan parë

⁶⁷ Edhe ne për këtë fjalë kishim shprehur mendimin se shpjegohej brenda shqipes: *dro*, *droje*: *d+ro* (*roje*), folja *ruaj*, që në arbërishten e Italisë ka dhe kuptimin 'bëj kujdes'.

edhe burimet e tjera për leksikon e shqyrtuar, burime jashtë rrethit trakodakas, apo edhe trako-dako-ilir (Lafe 2000: 255-364).

Lidhur me çështjen e substratit edhe Нерознак 1978: 189 thekson te se shqipja zinte një vend të veçantë midis gjuhëve ballkanike. Në rastin e saj, lidhur me trashëgiminë paleoballkanike, nuk është fjala për substrat, si në rastet e tjera që u përkasin grupeve të caktuara të gjuhëve, sepse

“shqipja është vazhdues unik i gjuhëve paleoballkanike”.⁶⁸

Ai madje vinte në pah se problem më vete paraqesin raportet e përgjithshme shqiptaro-rumune në fushën e leksikut. Përbashkësitë janë të gjera nga shtresat latine, sllave, greke, turke, dhe ato janë gjithëballkanike. Por ka dhe fjalë të përbashkëta që u përkasin vetëm këtyre dy gjuhëve dhe janë cilësuar si trakase apo dako-meze. Ai mendonte se ato duhet të cilësohen si paleoballkanike, sepse prejardhja trakase e shqipes nuk është dëshmuar, madje, përkundrazi, nuk janë pak ata që mendojnë se shqipja është vazhduese e traditës gjuhësore ilire. Rosetti (*Chestiuni de metodă*, in *Fonetica și dialectologie III*, 1961, f. 65) vinte në pah po ashtu se përbashkësitë leksikore në shqipen e në rumanishten mund të burojnë nga trakishtja, po aq sa nga ilirishtja.

Për ne duket po ashtu i diskutueshëm qëndrimi i Brâncuș-it lidhur me idenë e shprehur qysh nga W. Meyer-Lübke e A. Philippide, të rimarrë nga I. Russu e G. Ivănescu, po edhe nga ne këtu dhe më herët, pas së cilës dallimet midis dy gjuhëve janë më të mëdha se ngjashmëritë. Sipas Brâncuș-it, dy gjuhët janë gjenealogjikisht të ndryshme, ndërsa krahasimi i rumanishtes komune me shqipen e përbashkët tregon se ndryshimet nuk janë të rëndësishme në raport me të përbashkëtat (Brancuș 1983: 187). Dhe këtu sikur harrohet se shqipja është gjuhë që ka pësuar ndikim shumë të fuqishëm të latinishtes. Nuk i duket e pranueshme që geto-dakasit të kenë folur idiomë tjetër nga trakishtja, siç thoshte Georgiev. Përpjekjet për të dalluar traditën dako-meze nga trakja nuk kanë dhënë rezultat bindës, mendonte. Ka pasur dallime dialektore; shqipja qysh atëherë mund

⁶⁸ “... albanskij javljaetsja edistvennym prodolžatelem paleobalkanskih jazykov”.

të merrej si term krahasimi për disa prej tipareve të saj shumë të vjetra dialektore. Prandaj pandehte se gjuhën e substratit duhet ta quajmë tra-ko-dakishte. Varietetet dialektore vërehen edhe në fushën e latinitetit të rumanishtes e të shqipes. Në tërësinë e vokabularit rumun transmisionet nga substrati kanë po atë rëndësi sa edhe elementet latine. Përveç leksikut, me peshë i duken dhe rezultatet e studimeve të tij të çështjeve të zanores *ǎ*, të *-n-së* ndërzanore, të laringales *h*, të gjinisë asnjane, të sintaksës, të frazeologjisë, të etnografisë e të folklorit, etj. (Brâncuş 1983: 188).

Numërimi

Lidhur me mënyrën e të numëruarit nga 11-19 në shqipen ka pasur shumë diskutime. Disa e kanë parë ndikim nga sllavishtet e jugut, ndërsa të tjerë, meqë janë parë formime të ngjashme në gjuhët baltike, tek shqipja kanë parë në këtë pikë një trashëgimi indoeuropiane, jo ndikim.

Le të raportojmë këtu vetëm dy mendime albanologësh. Eric P. Hamp më 1992, në kuadër të diskutimeve të tij për numërorët në shqipen, në pjesën e diskutimit për *dhjetë* < **dékmt*, që në shqipen si në sllavishten u bë emër, por në shqipen femëror (*tridhjetë*), në sll. mashkullor (*trideset*). Kjo i dukej me peshë lidhur me atë që ai e quante

“keqkuptim universal i historisë së numërorëve dhe dhjetësheve në rumanishte”.

Thuhet se këto të fundit në rumanishten janë bërë pas modelit të sllavishtes, që atij i dukej e pamundur, sepse në rumanishten kemi femr. *douăzeci*, jo **doi zeci*. Kjo do të thotë se nuk është e mundur që *zece* (fem.), *zeci*, shumë të jetë kalkuar nga sllavishtja mashkullore. Kjo do të thotë se *zece* duhet të shtohet në inventarin e elementeve ‘autoktone’ të rumanishtes

“dhe ta nxjerrim si tipar gramatikor të huazuar nga një dialekt i hershëm shqip i Dakisë ose i mezisë” (Hamp 2007: 248).

Sugjerimi mund të shkonte te koha kur dialektet IE që u bënë sllavishte, shqipja dhe gjuha që u latinizua në rumanishte i përkisnin Sprachbundit tashmë të përmendur European Veriperëndimor para se të ndodh-

nin shpërnguljet drejt Ballkanit (shih dhe Friedman 2006: 665).

Constantin Frâncu 1999 konstatonte se rumanishtja, derisa për numërimin 1-10 qëndronte në vijën e gjuhëve romane, për 11-19 ndiqte modelin *unus super decem* (protor. **unuspreadzeace* > rum. *unsprezece*), shprehte bindjen që është e mundshme që të kemi këtu diçka nga substrati autokton, sepse kemi formim të tillë në shqipen, që buron nga ilirishtja. Ndeshet dhe në gjuhë të tjera IE: armenishte, gjuhët baltike. G. Reichenkron kishte shënuar po ashtu se ndërtime të tilla ndesheshin në greqishte të vjetër, lituanishte, letonishte, armenishte të vjetër, keltishte, tokarishte dhe sllavishte (Reichenkron 1958: 152-174). Kështu dalim te supozimi se mund të kemi të bëjmë me një grup të vjetër ku hynin ilirishtja-trakishtja, greqishtja veriore, armenishtja e lashtë, frigjishtja, keltishtja e balto-sllavishtja. Për Frâncu-n supozimi i vjetër për origjinën sllave të kësaj mënyre të numërimit është i mundshëm, por assesi i sigurt, ndërsa mundësia e shfaqjes së pavarur brenda substratit nuk është e pabesueshme.

Disi ndryshe këtë çështje e kishte parë B. Demiraj në diskutimin e tij (Demiraj 1990: 185-189). Përfundimi i tij është ky: nuk ka dyshim se përhapja e kësaj mënyre të ndërtimit në arealin gjuhësor ballkanik u detyrohet raporteve të ngushta midis popujve të rajonit. Por, i dilte e nevojshme të theksonte interferencën në formimin e këtyre numrave në dy drejtime: së pari është struktura fjalëformuese ku kemi ndikim të sllavishtes së lashtë mbi rumanishten dhe hungarishten; dhe së dyti prania e theksuar në Ballkan ku rrethanat gjuhësore midis shqipes e sllavishtes së vjetër janë në rend të parë. Ai sillte aty diskutimet për këtë çështje në gjuhësinë indo-europiane dhe në sprovat etimologjike të mëparme. Ndërkaq, autori tjetër i fjalorit të vonë etimologjik, V. Orel (2000: 249-50) në *Gramatikën historike* mendonte se kemi të bëjmë me një risi brenda shqipes që

*“mund të shpjegohet në mënyrë të pranueshme si kalk i shprehjeve përkatëse sllave”.*⁶⁹

Një tjetër vërtetim kritik për teorinë e substratit kishin paraqitur L. A. Gindin, I. A. Kalužskaia, V. E. Orel në kongresin e Ankarasë (shih L. A. Gin-

⁶⁹ “... can be plausibly explained as a calque of the corresponding Slavic expressions”.

din, I. A. Kalužskaia, V. E. Orel 1982: 127-133). Duke u nisur nga vrojtimi se në gjendjen aktuale kemi një situatë paradoksale, në të cilën nuk jemi në gjendje të vendosim korrespondenca të domosdoshme midis fragmenteve të rindërtimeve ballkanike në fushën e leksikut apelativ dhe të gramatikës. Kjo gjendje ka bërë që të kemi

“shumëfishim atribuimesh arbitrare të fenomeneve të vrojuara në gjuhët moderne për gjuhët e lashta të Ballkanit, përdorim madje jokorrekt të vetë nocionit të ‘substratit’ ashtu si ekstrapolime të përfytyrimeve të unionit gjuhësor ballkanik në situatën gjuhësore antike të Ballkanit”, f. 127.⁷⁰

Këto çështje nuk mund të zgjidhen, sipas tyre, pa u pas bërë disa punë të veçanta, që do të na bënin të mundshme të veçojmë ç’është huazim i vjetër e çka veprim i substratit. Shumë prej çështjeve lidhen me strati-grafinë, çka vlen si për elementet e trashëguara nga fondi i lashtë IE apo para-IE, qoftë nga fondi i përbashkët roman. Për më tepër këtu mendojnë se duan marrë parasysh dhe çështje që lidhen me huazime të mundshme të lashta gjermanike lindore në të dy gjuhët, si: *brustur(e)/ brushtull* – gjerm. or. *brustilô* (angl. e vj. *brystl*), *gresie/ g(ë)rresë* – got. *griu*, aleman. *Grieß*, etj. Dhe kështu përkufizimi i trashëgimisë së përbashkët i huazimeve rumune nga shqipja dhe e kundërta bëhet ngapak fiktiv, sepse ky veçim nuk është gjithnjë i mundshëm. Sipas tyre, hulumtimet e vona etimologjike

“indikojnë mjaft qartë praninë në listën albano-rumune të konvergencave apelative të një numri të rëndësishëm të huazimeve nga rumanishtja primitive në shqipen primitive, që ne e vendosim afërsisht në epokën kur një numër i madh huazimesh romane të tipit ‘ballkanik lindor’ hyri në shqipen primitive, përkt. në epokën e kontaktit gjeografik të pandërmjetëm të stërgjyshërve të shqiptarëve modernë dhe të rumunëve” (Gindin et al: 130).⁷¹

⁷⁰ “... cela se traduit par la multiplication des attributions arbitraires des phénomènes observés dans les langues modernes à des anciennes langues des Balkans, par l’utilisation incorrecte de la notion même du ‘substrat’ ainsi que par l’extrapolation des représentations de l’union linguistique balkanique sur la situation linguistique antique des Balkans”.

⁷¹ “... indiquent assez nettement la présence dans la liste albano-roumaine des convergences appellatives d’un nombre importants d’emprunts du roumain primitif

Në këtë rast ata kishin parasysh etimologjitë që dëshmojnë vazhdimësinë e drejtpërdrejtë shqipe të leksemave indo-europiane (si *sorrë* < i.e. **k'orn-*, rum. *cioară*, por sipas Hamp-it më parë **k^wersnā-*; *gardh* < **ghordh-*, rum. *gard*; *gropë* < (*grēp-*/**grēbh-*, rum. *groapă*; *gjysh* < **sūsjo-*, rum. *ghiu*)), çka dëshmohet më mirë në historinë gjuhësore shqipe. Gjëra të tilla na bëjnë t'ua atribuojmë paralelet rumuno-shqipe në shumë raste huazimeve nga shqipja e lashtë, sepse:

“raportet fonetike midis fjalës shqipe dhe rumune janë identike me ato që vërehen gjatë zëvendësimit, psh. te afrikatet dhe ndërdhëmboret e shqipes së lashtë të velareve qiellzore, të afrikateve dhe të spiranteve në rumanishten (p.sh. rum. țeapă, shq. thep; rum. zară shq. dhallë). Po këto konsiderata na bëjnë të lidhim me shqipen e lashtë rastet e konvergencave shqipe-rumune që s’kanë etimologji të sigurt. Por fjala shqipe ka korrelativë morfologjikë që lidhen me fjalën në rrafshin sinkronik”, f. 130.⁷²

Po të shihen mirë dëshmitë e huazimeve që dalin pas një shqyrtimi të detajuar të lidhjeve shqipe-rumune të shtresave romane (nga rum. e hershme në shqipen e hershme), të huazimeve nga gjuhë të tjera IE (gjer-manike lindore, greke, sllave e mbase iraniane), në mënyrë simultane – në shqipen e pastaj në rumanishten dhe e kundërta, të gjitha këto lënë gjithnjë e më pak hapësirë për elemente të substratit. Në këtë drejtim u dukej sinjifikativ kalimi nga *o*, *u* në *a*, *ă* në paralelet shqiptaro-rumune. Kështu, te *balaur* – *bullar*, *mazăre* – *modhullë*, zanoret shq. *o*, *u* < *o* ngjiten tek **ē*

à l'albanais primitif, que nous situons à peu près à l'époque où un grand nombre d'emprunts romans de type 'balkanique oriental' a pénétré dans l'albanais primitif, c.a.d., à l'époque de contact géographique direct des ancêtres des Albanais modernes et des Roumains”.

⁷² “... d'attribuer le parallèle albanais-roumain à la catégorie d'emprunts de l'albanais primitif pour cette raison que les rapports phonétiques entre le mot albanais et roumain sont identiques à ceux qui sont observés lors de la substitution, par ex., au affriquées et au interdentes de l'albanais primitif des velaires palatales, des affriquées et des spirantes dans le roumain (par ex., roum. țeapă 'silie, dent', alb. thep 'idem', roum. zară 'petit-lai' alb. dhallë 'le lait aigre' etc.). Les mêmes considérations nous font rattacher à l'albanais primitif les cas de convergences albanais-roumaines à défaut d'une étymologie sûre. Mais le mot albanais possède des corrélatifs morphologiques se rapportant au mot sur le plan synchrone”.

e shqipes së hershme, që, sipas ligjeve fonetike të rumanishtes, në disa pozita jepete *ă*, *a*, edhe në fjalë romane: lat. *mēlum*, rum. *măr*, shq. *mollë* (referonte Dimitrescu, F. *Introducere în fonetica istorică a limbii române*, București 1967, f. 58), f. 131. Po aty vërejnë dhe vështirësitë që dalin me interpretimin e rotacizmit te fjalët si *viezure/* shq. *vjedull*, f. 131.⁷³

Pa i çuar në fund rrjedhojat e pohimeve të pjesës së parë të diskutimit, autorët e studimit i kthehen përfundimit që shqipen në lashtësi e shihet në hapësira më qendrore sesa perëndimore të Ballkanit. Pa e mohuar rolin e elementit iliro-mesap në formimin e shqipes ata theksonin se

“etapat më të hershme të këtij procesi lidhen më shumë me zonën e përhapjes së trakishtes, por edhe vetë nocioni i shqipes së hershme duhet të afrohet me trakishten në disa raste”,

pra nxjerrin përfundime që afrohen me të Jokl-it, po edhe të Weigand-it, Georgiev-it.

Më 1995 Brâncuș-i botoi librin që mund të merret vazhdim i atij të vitit 1983: *Cercetări asupra fondului traco-dac al limbii române*. Në këtë vepër, gjithë duke theksuar pikënisjet nga idetë e Hasdeu-t, po edhe tek idetë e Çabejtë për pjesën që thekson elementet e përbashkëta të shqipes me rumanishten, por jo edhe mendimet për prejardhjen e këtyre përbashkësive kryesisht nga kontakti ballkanik midis dy gjuhëve, as refuzimin e Çabejtë të idesë së substratit. Kësaj vepre i printe ideja se përbashkësitë midis dy gjuhëve janë dëshmi për ndikimin trako-dakas mbi latinishten vulgare të hapësirës karpato-danubiane dhe jo për ndikimin e mëvonë të shqipes në rumanishten. Si tendenca të tilla të trashëguara ai numëronte çështjen e afrikateve, të zanores *ă*, të rrafshimit të rasëve, të asnjansit, të strukturës së fjalëve numërore 11-19 etj.

Në këtë vepër janë shqyrtuar rimarrjet e fjalëve të substratit në onomastikë, ndër të cilat ndeshen fjalë si *bucur*, *bung*, *dru*, *leurdă*, apo

⁷³ Edhe këtu ka shumë interpretime sipas dëshirave. Do të themi se forma shqipe më e përhapur është *vjedull*, ka dhe *vjetull*. Te *vjedhullë* ka dy përshtatje: me *-ë* mund të dilte vetëm në një formë të vjetër, ndërsa me *dh* kemi ose formë rajonale të përshtatjes *d/dh*, ose thjesht një përshtatje vetëm për nevoja të përputhjes me formën rumune. Pra, as supozimi që e lidh me foljen shqipe *vjedh* nuk qëndron.

bardz, bradz, budzǎ, madzǎre, copaci, baltǎ, çätunet, çätunište, viezure, zarǎ, etj. Më tej merrej me mjetet e përbashkëta të fjalëformimit në kompozita me emër+mbiemër/ apo pjesore, etj. Rishqyrtonte elementet leksikore autoktone në dialektin arumun, duke nxjerrë përfundimin se të tilla elemente dikur ka pasur dhe ky dialekt, por e ka bjerrë një pjesë syresh me kohë. Në një kapitull të veçantë është marrë me shqyrtimin e zanores ë, me vështtrimin e bashkëtingëllores *h*, me bashkëtingëlloren *sh*, me rotacizmin, me numërorët dhe me prapavendosjen e njëjës shquese. Kështu ai nxirrte përfundimin se është e besueshme që rumanishtja *ă* dhe shqipja *ë* janë ndikim i substratit, tani trako-ilir,

“në çdo rast i një tendence të substratit”.

Ndërkaq për bashkëtingëlloren *ș* shihte vetëm mundësi që t’ia atribuonte substratit trako-dakas.⁷⁴ Te rotacizmi, madje, ai mendonte se kjo dukuri duhet të shihet si dëshmi e ndikimit të substratit trako-dak, si

“relikt i gjuhës së ‘dakasve të lirë’, të cilët mbijetuan jashtë Dakisë, në veri dhe në perëndim të Provincës së romanizuar deri në sh. 6. Duhet të merret ashtu që paraardhësit e toskëve (shqiptarët e jugut), më vonë edhe istrorumunët, mërguan nga hapësirat e ‘dakasve të lirë’ dhe nga zonat fqinje drejt jugut përkatësisht drejt perëndimit” (Brâncuș 1995: 116).⁷⁵

Lidhur me numërimin e tipit *njëmbëdhjetë – unsprezeci*, që për rum. është menduar të jetë ndikim i sllavishtes, atij i dukej e besueshme që të kemi të bëjmë me një ndërtim sipas modelit të latinishtes ballkanike *unus super decem* si kalk i një ndërtimi të ngjashëm në trako-dakishten. Për këtë, sipas tij, flet përgjegjësjë e shqipes, që përkon dhe me tipin balto-sllav, gjithsesi autokton (Jokl) (Brâncuș 1995: 116).

Lidhur me njëjën e prapavendosur shquese, Brâncuș-i sillte mendi-

⁷⁴ G. Lafe në recensionin e tij bënte një vërejtje, duke treguar se fenomeni i kalimit *s > ș* është i përgjithshëm në gjuhët romane e në gjuhë të tjera. Prejardhja e [ș]-së nga substrati për rumanishten e shqipen kështu i dilte e diskutueshme (Lafe 2000: 260).

⁷⁵ “Ein Relikt aus der Sprache der ‘freien Daker’, die außerhalb Dakiens, im Norden und im Westen der romanisierten Provinz, bis in das 6. Jahrhundert überlebten. Es ist anzunehmen, daß die Vorfahren der Tosker (Südalaner), später auch der Istrorumänen, aus dem Gebiet der ‘freien Daker’ und aus den benachbarten Bereichen nach Süden bzw. nach Westen abwanderten”.

min e përhapur tradicional. Por së pari jepte shembujt e përdorimit bashkë me mbiemër: *omul bun - njeriu i mirë, ose bietul om – i ndjeri njeri*. Pas linguistëve rumunë (Graur, Rosetti), nyja e prapavendosur e emrit vjen nga një përemër dëftor i paravendosur para mbiemrit: te *homo ille bonus* dëftori ishte përcaktor i emrit, jo më i mbiemrit. Kjo ishte thënë për shqipen nga H. Pedersen - *pusi thellë*, pastaj *pusi i thellë* (me një dëftore). Mendohet se prapavendosja e nyjës në shqipen e rumanishten i parapriu paravendosjes. Pra nyja shquese bëhet shenjë morfologjike të emëzimi i mbiemrit: *răul ‘i keq’, bunul ‘i miri’, shq. i miri, besniku*; këtu elementet proklitike *cel, cea*, shq. *i, e, të*, të mbiemrave morën vlerë tjetër nga të morfemës së përcaktimit. Tek ndërtimet në gjinore emri i përcaktuar del me një të prapavendosur: *calul vecinului – kali i fqinjit*; e ashtuquajtura një e gjinore e rum. *al, a*, e shq. *i, e, të* pajtohen me emrin paraprijës, është në fakt një përemër dëftor: *această fată a vecinului – kjo vajzë e fqinjit*. Në sintagmat me mbiemër pronor elementet proklitike rum. *al, a*, shq. *i, e, të* kanë vlerë përemërore: *acest priten al meu – ky mik i imi* (Brâncuș 1995: 117). Te mbiemrat elementet proklitike *cel, cea* (*casa cea frumoasă ‘kjo shtëpi e bukur’*) kanë funksion mbiemëror po edhe përemëror: *cel, cea* është mbiemër karshi emrit parashkues, por dëftor-përemër ndaj mbiemrit vijues, *cel, cea* mund të komutojnë me zero: *casa frumoasă*. Sipas tij, mbiemri *bunul* në sintagma të tipit *omul cela bunul*, që del në rumanishten më të vjetër, është i substantivuar, ndërkohë që *bunul* është apozicion i *omul acela*.

Edhe për shqipen mendonte se mund të tregohet që *i, e, të*, që shoqërojnë mbiemrat e leksikut të vjetër, kanë vlerë përemërore: këto pjesëza në disa tipa ndërtimi nuk shfaqen, në kompozita asnjëherë. Kur mbiemrat bëhen ndajfolje, e humbasin elementin shoqërues: *shkruan bukur*; nyja birret edhe kur mbiemri substantivohet.

Në shqipen si në rumanishten mungon nyja tek emrat me parafjalë paraprijëse: *trece pe drum – kalon në rrugë* (me përjashtim të parafjalës rum. *cu*, shq. nga *e* dhe *te*, që kërkojnë një).

Të dy gjuhët shfaqin të njëjtat ndryshime tingullore në ndërtimin e

nyjës shquese: *fată – fata, vajzë – vajza*; gjin.-dhan. rum. *unei fete – fete*, shq. *e një vajze – vajzës; vulpea – delja* (Brâncuș 1995: 118). Në tekstin më të gjerë rumanisht shihet se për shqipen njihete kryesisht teorinë e Çabejtë, por jo edhe idetë e Rizës, e sidomos jo të Bokshit.

Në shqyrtimin që mëtonte paraqitjen e përmbledhur të rezultateve të studimeve ballkanike në Rumani më 1978, Grigore Brâncuș-i kishte mundur të emetonte pohimin vijues:

“Në përfundim mund të thuhet se megjithë përpjekjet e mëdha të bëra nga linguistët rumunë në dekadat e fundit për të sqaruar problemin e trashëgimit nga substrati i rumanishtes, hulumtimi nuk ka shënuar përparim të madh” (Brâncuș 1978: 367-379, këtu: 374).⁷⁶

Dhe më tej:

“aspekti autokton i gjuhës rumune mbetet një enigmë” (Brâncuș 1978: 374).⁷⁷

Prej atëherë nuk ka pasur raporte për zhvillime që do të bënin të ndryshonim rrënjësisht vlerësimet në raport me çka ishte thënë më herët sa u përket të dhënave. Ka pasur interpretime më pak a më shumë të përkrahura për aspekte të ndryshme të implikuara në këto studime. Përfundimin e përmendur Brâncuș-i e kishte arritur pasi kishte paraqitur pikëpamjet e studiuesve rumunë lidhur me këto raporte, duke filluar nga B. P. Hasdeu në sh. XIX, për të vazhduar me O. Densusianu-in në fillim të sh. XX me vështrimet kritike, me I. A. Candrea-n, pastaj P. Papahagi-un, T. Capi-dan-in, S. Pușcariu-n, A. Philippide-n, etj.

Ka pasur studiues rumunë që raportet midis rumanishtes e shqipes i kanë shpjeguar si rezultat të jetesës së përbashkët të shqiptarëve dhe të paraardhësve të rumunëve në pjesët perëndimore e qendrore të Ballkanit. Ndër ta është Sextil Pușcariu (1910, 1940). Ky studiues i shquar veçonte elementet thjesht shqipe në rumanishten nga elementet që dalin nga substrati. Të parat ai i shihte ndër ato që përputheshin sa i përket formës

⁷⁶ “One can say in conclusion that, in spite of the great efforts made by Romanian linguists in the last decades to clarify the problem of their inheritance from the substratum of Rumanian, the research has not yet made great progress”.

⁷⁷ “The autochthonous aspect of the Romanian language remains an enigma”.

ashtu si kuptimit. Në rastet e tjera, pra kur ndeshen ndryshime fonetike a semantike, kemi të bëjmë më parë me elemente substrati. Se në rumanishten ka një shtresë huazimesh nga shqipja, këtë e theksonin dhe autorë si G. Weignad, I. Candrea, K. Treimer, T. Capidan, etj. Edhe G. Meyer-i më herët, ndërsa pas Weigand-it, i cili dallonte tri shtresa kronologjike të huazimeve, madje një syresh më të vonë në Transilvani, këto ide i përqaftuan disi Philippide, Barić, Jokl, Çabej, po edhe G. Brâncuş deri nga vitet '70.

Rikthimi triumfalist i Russu-it te Hasdeu

Me formim historian, por me pretendime në fushën e filologjisë dhe të gjuhësisë krahasimtare, studiues frymëgjatë dhe insistues i paepur për të dëshmuar autoktoninë e popullit rumun në vatrat e tij të sotme, kryesisht në veri të Danubit dhe në Transilvani, po se po, autor i shumë veprave në këtë fushë (të përmendim vetëm Russu 1970, Russu 1959, Russu 1967, Russu 1969, Russu 1981, Russu 1985), Ion Iosif Russu më 1981 në Akademinë e Shkencave të Rumanisë mbajti një ligjëratë me pretendime kritike dhe për të vendosur pikat mbi i lidhur me etnogjenezën e rumunëve dhe të rumanishtes, por që në fakt ishte një traktat ku shfaqeshin pikëpamjet e tij për prejardhjen e gjuhës shqipe (Russu 1995).

Në këtë vepër të re Russu rimerrte në formë referimi idetë e shprehura më herët te Russu 1970 dhe Russu 1981, duke ngulur këmbë që në fillim tek zgjidhja, sipas tij përfundimtare, e çështjes së etnogjenezës së rumunëve dhe e prejardhjes së rumanishtes, kështu që kishte mbetur të zgjidhej çështja e etnogjenezës së popullit shqiptar dhe e prejardhjes së shqipes, për të dhënë një përgjigje në pajtim me një pjesë të pohimit të H. Pedersen-it të vitit 1900:

"...sadoqë këtu asgjë nuk mund të thuhet me siguri, sakohë që lidhur me prejardhjen e rumunëve nuk kemi qartësi..."⁷⁸

⁷⁸ Mendimi i plotë i Pedersen-it është ky: "Für Hirt wenig günstig ist auch die übergrosse Zahl der lateinischen Lehnwörter und die ganz verschwindende Zahl altgriechischer Lehnwörter im Albanesischen; beides scheint mir für die Illyrier besser zu passen als für die Thraker, obgleich hier nichts mit Sicherheit gesagt werden kann, solange wir

Kështu që ai ngulte këmbë që zgjidhja për prejardhjen e shqipes donte kërkuar vetëm bashkë me të rumanishtes dhe kjo mund të bëhej

“... vetëm në kuadër (dhe jashtë) të etnive të mëdha indoeuropiane dinarike dhe ballkano-karpatike me gjuhë të tipit satəm mundet dhe duhet të kërkohet dhe identifikohet prejardhja e gjuhës dhe e bashkësisë social-etnike e shqiptarëve”.⁷⁹

Dhe më tej vinte me thumbimin për rumanistët e shquar O. Densușianu dhe S. Pușcariu që paskëshin qenë në ekuivok e konfuzion në përpjekjet dëshpruese për të shpjeguar dhe justifikuar elementet e përbashkëta pararomane të ndeshura vetëm në shqipen e rumanishten,

“të konsiderura në mënyrë simpliste dhe të gabuar nga shumica e tyre si ‘huazime’ të thjeshta leksikore të bëra nga gjuha rumune direkt nga shqipja diku në afërsi (disi në verilindje) të trojeve të Shqipërisë aktuale në periudhën e të ashtuquajturës ‘simbiozë’ albano-rumune”.⁸⁰

Për ta zgjidhur çështjen e prejardhjes së shqipes ai mëntonte të nisej nga disa aspekte të ideve të shprehura nga Hasdeu, i cili, edhe pa mjetet moderne, paskësh pasur intuitën pjesërisht korrekte për realitetin e fuqishëm social-historik dhe etnologjik të përkatësisë së gjuhës shqipe, të tipit *satəm*, në trungun e madh social-etnik trako-dako-get, ku bënte pjesë fisi veri-danubian dhe karpatik i karpëve. Provat për këtë Russu i gjente tek realitetet gjuhësore të përbashkëta të shqipes me rumanishten, pra përgjithësisht trakase. Bashkë me ‘dëshmitë’ historike dhe arkeologjike, men-

über die Herkunft der Rumänen im unklaren sind...”, H. Pedersen në KZ XXXVI, 1900, f. 301, Russu 1995: 37. [Për Hirt-in më pak i përshtatshëm është numri tepër i madh i huazimeve latine dhe krejtësisht i paktë numri i huazimeve greke të lashta në shqipen; të dyja këto mua më duket se pajtohen më mirë për ilirët sesa për trakasit, sadoqë këtu asgjë nuk mund të thuhet me siguri, që lidhur me prejardhjen e rumunëve nuk kemi qartësi...].

⁷⁹ “... ă numai în cadrul (și nu în afara) marilor ethnii indo-europene dinarice și balcano-carpatice cu limbă de tip satəm poate și trebuie să fie căutată și identificată obârșia limbii și comunității social-etnice a shqipëtarilor-albanezi”, Russu 1995: 17.

⁸⁰ “... considerate simplist și greșit de cei mai mulți ca simple ‘împrumuturi’ lexicale făcute de limba română direct din albaneză undeva în apropiere (cam la nord-est) de hotarele Albaniei actuale în perioada de așa-numită ‘simbioză’ albano-română”, Russu 1995: 18.

donte ai se kështu mund të shihet që në sh. III-IV kishte depërtim masiv të grupeve trakase veriore në romanitetin 'ballkanik' dhe ruajtja e tyre pas mutacioneve etno-linguistike në popullin shqiptar të mesjetës dhe kohëve moderne. Njëkohësisht shprehte bindjen se nuk ka argumente që do ta mbështesnin tezën për prejardhjen ilire të shqipes, madje asnjë indicie të vlefshme apo të mundshme, duke lëshuar rrugës, për ata që mendojnë ndryshe, kritika të rrepta.⁸¹ Nuk shihte motive për të pranuar që shqiptarët të jenë vendosur në Shqipëri e Maqedoni shumë kohë para arumunëve të atjeshëm (!). Të tjerët i kritikonte me një të rënë sëpate për mendime koniunkturale sipas parapëlqimeve personale subjektive, përveç Hasdeu 1901 dhe Dechev 1952. Tezën e Georgiev-it për gjuhën 'dako-meze' e cilësonte ekstravagante, të konfesionuar, atë vetë vag, konfuz, që injoron gjuhën rumune dhe substratin e saj trako-dak, ndërsa 'gjuhën dako-meze' e konsideronte konfesion rudimentar e artificial, të padobishëm dhe absurd. Më herët idetë e Kopitar-it i cilësonte romantike dhe bizare, ekscentrike, të palejueshme, absurde, ndërsa lidhur me idetë e Hahn-it, ku mendonte se gjithëçka humbet në mjegullën e miteve, ku

"elementi më konfuz, bizar deri në absurd janë të ashtuquajturit 'pellazgë', me të cilët amatorë të historisë dhe të arkeologjisë, diletantë dredhanë, kanë 'vepruar' dhe vazhdojnë në të gjitha zonat dhe fazat e pre- dhe të protohistorisë europiane dhe mesdhetare".⁸²

Nuk duket e nevojshme të komentoj vërshimat e tilla emocionale.

Rrugës në formë raporti kritikonte albanologjinë që nuk kishte qenë në gjendje të zgjidhte çështje të këtilla, madje që kishte lejuar që etnogjeneza e shqiptarëve dhe faktori etno-linguistik që qëndron në bazë të këtij komuniteti, politik e etnik, ka mbetur ekuivok dhe konfuz. Kritikonte çdo gjë, sepse albanologët po ngulkan këmbë te prejardhja ilire e shqipes; në

⁸¹ Punimet e Domit i karakterizonte me pak vlerë, të Mirditës me karakter amatorist, patriotard, të tjerëve pa asgjë origjinale (Philippide, Tagliavini, Rosetti, Stadtmüller, Reichenkron), etj

⁸² "... unde elementul cel mai confuz, bizar pînă la absurd sînt așa-numiți 'Pelazgi', cu care amatorii de istorie și arheologie, diletanții impostori au 'operat' și continuă în toate zonele și fazele pre- și protoistoriei europene și mediteranene", Russu 1995: 24.

një konferencë ndërkombëtare si ajo e Innsbruck-ut (sipas tij gjithsesi e fryrë dhe kot) nuk ishte shprehur në asnjë komunikim as përmbajtje as sugjerim që do të kërkonte etnogjenezën e shqipes jashtë ilirishtes (30-31).

Shqipja, sipas G. Meyer-it, është gjuhë IE e tipit *satəm* (sugjeronte etimologjitë *barth-*, *bardhi* **bherg*' 'shkëlqen, bardh'; *breth-*, *bredhi*, *brad* (*braz*) **bhreg*'; *math-*, *madhi*, **meg*'-, lat. *magnus*, *dimen-* **g'heimen*-) me asibilim të okluziveve qiellzore, tipare që sipas tij mund të jenë në bazë të ilirishtes apo të trako-getishtes:

"përkatësia e gjuhës shqipe në grupin e dytë indikon apo edhe provon relacionin e stërlashtë me gjuhën rumune dhe me romanitetin 'ballkanik' sa u përket elementeve të përbashkëta mbi të gjitha në leksik".⁸³

Studimet më të reja shqiptare, sipas tij, kanë dështuar lidhur me zgjidhjen e problemit në fjalë, sidomos për shkak të dogmës së prejardhjes dhe vazhdimësisë ilire të popullit shqiptar. Kështu Çabej mbështetet në '*analogji aleatore dhe false*', në toponiminë antike me barasvlera të pretenduara shqipe-ilire dhe referonte W. Zeitler-in me vërejtjet e tij në *Zeitschrift für Balkanologie* ku tërë çështjen e kthente tek diskutimet e Weigand-it, për të cilat, megjithatë, thoshte se kanë sjellë ngjashmëri me trakishten që nuk janë të bindshme. Argumentet për prejardhjen trakase janë të tjera. Vazhdonte të merrej edhe pak me etimologjitë e Çabejtë, si te *këlbazë* (< *kalb*+*azë*), *shtrungë* (*shtroj*, *shtrungë*, duket më e qartë po të jepej modeli si te *shtjelloj shtëllungë*), *brez* – *brîu mbrej*, *këputë* – *căpută këput*, krejtësisht të gabuara, sidomos semantikisht, duke lënë pa shpjegim fjalët albano-rumune, sepse

"ato duheshin përnxjerrë me mjete krahasuese indo-europiane që nuk kufizohen në të vonat brendashqipe që kanë vetëm një bashkëtingëllim të rastit".⁸⁴

Dhe më tej lëshonte edhe këtë:

⁸³ "...apartenența limbii albaneze-shkipetare la a doua grupă o indică sau chiar probează relația străveche cu limba română și cu romanitatea 'balcanică' în ce privește elementele comune mai ales în lexic...", Russu 1995: 31.

⁸⁴ "... ele trebuie ținute cu mijloace comparative indo-europene ce nu se limitează la cele țirzii înalbaneze care au numai o consonanță fortuită", Russu 1995: 32.

“... as Çabej as recensenti i tij në Zeitschrift für Balkanologie nuk janë të familjarizuar me komparatistikën dhe etimologjinë indo-europiane në përgjithësi, pra edhe me ‘ballkanologjinë’, ku hyn gjuha shqipe dhe substrati ilirik dhe trako-getik”.⁸⁵

Para se të vazhdojmë, le të themi se metoda e etimologjisë e Çabejtë është e njohur, kombinon traditat më të mira të hershme dhe i begaton ato me historinë e fjalëve brenda gjuhës. Para se të shkonte tek rrafshi indoeuropian, Çabej më parë shihte formimin dhe historinë brenda gjuhës shqipe, evitonte shembujt e gabuar në interpretimin historik të gjuhës si pikënisje për të bërë etimologji (*barth, breth, bres* reflektojnë forma të ndryshuara përmes rregullave fonetike të shurdhimit në toskërishten; pra duhet të nisemi nga *bardh, bredh* – prej nga kërkohet paraforma **bradh, brez* ose *brêz* (ku shihet hundorja për **brendi-*). Vrojtimit që tregojnë shenja mosnjohjeje të gjuhës leksikon e së cilës ia shtron etimologjizimit, nuk mund të bëhen bazë për karakterizime të atilla.

Mendimi i Russu-it është se tiparet e përbashkëta midis rumanishtes e shqipes janë shumë të vjetra, të shekujve të parë të erës sonë, pra të latinishtes vulgare.⁸⁶ Ngulte këmbë te dallimet që kishte hetuar, ta zëmë, në refleksin e velareve qiellzore IE në shqipen dhe në gjuhën substrat: derisa te substrati për **k'* kemi *s*, në shqipen kemi *th, çka*, sipas tij, do të jetë zhvillim i kësaj *s* të lashtë: **k'er-m* > rum. *sîrm-, fărîm*, shq. *ther-rim*; i.e. **g'(h)* bëhet *z* në substratin ballkanik dhe dinarik, si në përkatësin trakodak e ilirik, si i tillë në rum. *braz – brad, barz – barză, viezure*, ndërsa me spirante interdentalë në shqipen: rum. *braz-brad*, shqip *breth, bredh; viezure*, shq. *vjedhullë, mazëre – modhullë*; tingujt *th, dh* të shqipes nuk mund të mos jenë nga *s, z*, që ruheshka në rumanishten për 17 shekuj (!). Komenti im nuk do të jetë i gjatë: në shqipen i.e. **k', *g'* supozohet të jenë zhvilluar në *th, dh* (në disa pozita *d*) nëpër fazat më të hershme afër-

⁸⁵ “... nici Çabej, nici recensentul-comentator la ZfBalkan. nu sînt familiarizați cu comparatistica și etiologia indo-europeană in general, dar nici cu ‘balcanologia’ în care întră limba albaneză și substratul illyric și traco-getic”, Russu 1995: 33.

⁸⁶ Rumanishtja nuk njihet gjuhë e veçantë para sh. VII-IX. Më hertë kemi të bëjmë me latinishten popullore ballkanike.

sisht *ć, *j, më tej *c, *x dhe jo nëpër s. Edhe po të kenë hyrë nga substrati me s para 17 shekujsh, si ndodhi që në rumanishten ato të mos zhvilloheshin si tingujt e tjerë (s nga lat. popullore e sh. III-IV e madje VI ka një zhvillim në rumanishten, pastaj brenda rumanishtes ka zhvillime të tjera). Ndërkaq, refleksi z në rumanishten mund të jetë i zakonshëm në procesin e përshtatjes së formës fonetike shqipe me ndërthembore, siç ka ndodhur dhe në serbishten: *bardhë* atje është bërë *barzast*. Për më tepër, forma *barth s'*ka si të jepte *barz*, do të pritej **bars* ose *bart*; keqkuptimi qëndron në mosnjohjen e rregullave fonetike të shqipes, ku forma e parme në fjalë të tilla ka qenë me bashkëtingëllore të zëshme, siç tregon dhe etimologjia, ndërsa shurdhimi ka ndodhur më vonë në të folmet toske.

Po ashtu është e vërtetë se në rumanishten *-l* ndërzanore ka pësuar rotacizëm *-r-*, por ç'të themi atëherë për fjalët që shihen si të substratit dhe në rum. kanë *-l*? Mendohet se përgjithësisht fjalët sllave nuk e kanë pësuar rotacizimin e tillë, pra kemi një kufi kohor, kur dihet se studiuesit rumunë huazimet sllave nuk i çojnë shumë para sh. IX.⁸⁷ Mungesë njohjeje të shqipes jam i prirur ta marr supozimin se te *shkul-* u dashka të kërkojmë etimologji rrënje në këtë formë, derisa kjo folje është e lidhur me fjalë të tjera në shqipe: *ngul*, *përkul* (**n+kul*, *për+kul*, *sh+kul*), kështuqë etimologjinë do ta kërkojmë për *kul*.

Më tej Russu-i avanconte tezën për prejardhjen e shqipes nga trakishtja e karpëve, duke ngulur këmbë së pari që ilirët nuk do të kenë mundur të persistonin në sistemin romak, jo vetëm për shkak të proceseve që kanë ngjarë me shekuj, po edhe për shkak se kush e njeh Perandorinë romake dhe organizimin e saj të jetës,

“nuk do të mund të pranonte lehtë që një grup heteroglot dhe heterogjen siç ishin shqiptarët e mesjetës dhe të epokës moderne, pas konfigurimit të gjuhës së tyre indoeuropiane të tipit satəm – me një shtresë masive elementesh leksikore romane-latine – të konsideroheshin si popullatë provinciale e Ilirisë, një fis që do të supozohej si vazhdim në shekujt I-III të regjimit

⁸⁷ Fjalë si *balaur*, *balegă*, *baloš*, *čăciulă*, *colibă*, *sculă*. Për ndonjë prej tyre ka dhe etimologji tjetër, ndërsa shpesh avancohet mendimi se kemi të bëjmë me fjalë që lëvizin në hapësirën ballkanike dhe që është vështrië t'u dihet burimi. Shih edhe Frâncu 1999.

roman, procesit të romanizimit, dhe të ruante gjithsesi gjuhën atavike indo-europiane qartë të mbrejtur fuqishëm me elemente latino-romane shumë të numërta dhe të rëndësishme. Pra, shqiptarët nuk mund të konsiderohen as ilirë, as trako-getë, po 'dardanë' ('pellazgë'?) provinciale, të nënshtruar ndaj Romës imperiale", Russu 1995: 36,⁸⁸

prandaj në periudhën III-IV stërgjyshërit e shqiptarëve mund të ishin vetëm grup etnik i imigruar nga jashtë limesit danubian apo karpatik, nga fillimi i sh. III. Elementi leksikor pararoman i përbashkët me rumanishten (trako-dak) dhe elementi leksikor roman masiv në shqipen, pakësia e elementit grek të lashtë na çojnë te kufijtë verilindorë të Perandorisë, në zonat karpato-danubiane, ku duhet të kërkohet baza social-etnike dhe gjuhësore e shqiptarëve: karpët trakas. S'ka gjë që ai vetë e kishte raportuar gjykimin e Pedersen-it që pikërisht numri i madh i latinizmave dhe numri më i vogël i greqizmeve të lashtë flet në të mirë të prejardhjes ilire të shqipës. Po numri i madh i latinizmave, pa hyrë në analizat gjuhësore që ashikare kanë dhe gabime, a nuk flet për pozitën e asaj gjuhe brenda botës romane dhe jo jashtë saj? Kjo mënyrë e argumentimit shkon edhe përtej rrëfimit romantik të Hasdeu-t.

Tërë kësaj i shtonte dhe teorinë e vjetër të historianit të lashtësisë V. Pärvan, që në albanistikë e njohim nga kritikantët e Jokl-it. Russu nuk linte rast pa drejtuar kritika kundër supozimit që në Ballkan dikur dhe diku të ketë pasur 'simbiozë rumuno-shqiptare' dhe që kësaj t'i detyrohen elementet e përbashkëta midis dy gjuhëve si huazime. Nuk e hopenste as vërejtjen e Çabejtë për huazime të numërta nga shqipja në gjuhët e Ballkanit, duke shtuar se shumica e atyre fjalëve 'shqipe' janë huazuar nga gjuha rumune (mbi të gjitha arumune). Mendonte se është e evidentë që kemi të

⁸⁸ "... nu avea putea admite ușor ca o grupă eteroglotă și eterofonă cum erau Albanezii (Shkipetari) din evul mediu și epoca moderna, după configurația limbii lor indo-europene de tip satem – cu un masiv lot de elemente lexicale romanice-latine- ar putea fi considerați ca o populație provincială din Illyricum, vreun trib ce să fi fost supus continnu in veacurile I-III regimului roman, procesului de romanizare, și să-și păstreze totuși limba atavică indo-europeană chiar impregnată puternic cu elemente latine-romanice foarte numeroase și importante. Deci albanezii-shkipetari nu pot fi considerați nici illyri, nici traco-geto-daci, sau "dardani" ("pelasgi"?) provinciali, supuși ai Romei imperiale..."

bëjmë me mbetje të substratit dako-get dhe eventualisht të përbashkëta me shqipen, ndërsa disa mund të jenë dhe huazime në këtë gjuhë (*çăciulă*), mendonte autori që idetë e të tjerëve i cilësonte *patriotarde*.

Duke përsëritur historinë e prejardhjes së shqipes nga gjuha e karpëve trakas, dhe duke ngulur këmbë tek dallimi midis karpëve trakas veriorë dhe dako-getëve, rrëmbente kritikën për indoeuropeistin G. Bonfante, i cili, edhe ai i cilësuar ‘*florumun*’ dhe ‘*dakofil*’, por si duket nuk i ka përfillur idetë e Russu-it dhe ka shprehur idenë e vjetër se shqipja nuk paska mundësi të jetë pasardhëse e ilirishtes *centum*, ndërsa trakishtja ishte *satəm*; shqiptarët dhe rumunët dikur paskan qenë një popull, i cili ka pësuar latinizim të fuqishëm dhe kështu një pjesë janë bërë rumunë, ndërsa të tjerët që nuk janë romanizuar tërësisht kanë mbetur shqiptarë.⁸⁹

Sipas Ion I. Russu (1981: 103), nga e tërë paraqitja e ideve të Philipide-s duhet të nxirret një përfundim me interes: nëse ngjashmëritë na bëjnë të vendosim një afri gjenetike midis rumunëve dhe shqiptarëve,

“dallimet shumë më të mëdha na obligojnë t’i ndajmë këta dy popuj”,

çka, pas tij, dalka dhe nga

“struktura e tyre shpirtërore e veçantë” (Russu (1981), 103).

Russu-i shkante më tej dhe fliste për mungesën e mbështetjes për teorinë e “lidhjeve” të ngushta gjuhësore dhe etnike-shoqërore dhe të varësisë së gjuhës rumune si debitore ndaj shqipes:

“Supozimet e tilla mbështeteshin në disa tipare të veçueshme fonologjike dhe morfologjike, të cilat (të shqyrtuara me kujdes) janë pak konkludente, duke qenë plotësisht të shpjegueshme në kuadër të zhvillimit specifik të romanitetit lindor (ballkanik, karpato-danubian), të tjerat përmes një sub-

⁸⁹ Epitetet që përdorte për Bonfante-n janë: *autodidakt, entuziast dhe shumë i zellshëm, me prirje të fuqishme amatoriste*, sepse paska injoruar monografinë *Ilirët* të I. I. Russu; nuk paska dashur të dinte as për etimologjinë trako-gete, për të cilat studime paskësh shprehur mendimin *‘non meno severo e il mio giudizio sul suo contributo originale alla questione’*, kështu që s’paska kuptuar gjë nga studimi komparativ-historik; disa pohime të tij i cilësonte *diletante*, me *aglomerat proze prolixë, kompilim tekstesh, me pohime pseudofilologjike e romantike*, f. 44-5.

strati identik apo ngushtësisht të afërt, unitar në linja të përgjithshme, duke pasur pastaj gjatë epokës mesjetare, shumë elemente të përbashkëta kulturore-historike dhe politike” (Russu (1981), 104).⁹⁰

Në shqyrtimin e elementeve të përbashkëta romane midis shqipes e rumanishtes, Russu-i raportonte shkurt idetë e shfaqura në studimin e H. Mihăescu-t (Mihăescu 1966: 5-33 dhe 323-352; Çabej 1962: 161-199; Haarmann 1972) për huazimet latine të shqipes,⁹¹ katër grupe të fjalëve:

1. fjalë latine të dëshmuara edhe në shqipen, gjuhët romane e rumanishten - 270 terma, si: *admissarius, aer, aeramem, aestimare, aiunare, arctus, arena, argentum, agrum*, etj;

2. fjalë latine që ekzistojnë në gjuhët romane perëndimore dhe në shqipen, por jo në rumanishten – 151 terma, si: *adorare, amicus, armata, balsamum, benedicere, bestia, candela*, etj;

3. fjalë latine të ruajtura vetëm në shqipen e rumanishten – 39 terma, ndër të cilët 19 kanë qarkullim të gjerë: *canticum, capitina, coma, consocer, galgulus, Harae, imperator, linea, manicare, margella, mirari, orare, poenitere, perviligare, scortea, secretus, sella, sessus, status*, etj;

4. fjalë latine të ruajtura vetëm në shqipen – 85 terma: *apparamentum, bubulcus, furata, machina, sarcinarius*, etj. (Mihăescu 1966: 12-32).

Kjo do të thotë se kemi të bëjmë me fjalë latine me përdorim të dendur në tërë Perandorinë romane; kategoria e dytë përfshin elemente të përbashkëta romane me gjuhët romane perëndimore, ndërsa fjalët që ruhen vetëm në shqipen e në rumanishten janë më të pakta dhe për shumë prej tyre ka të dhëna se kishin qarkullim më të gjerë se juglindja europiane. Kjo bën, sipas Russu-it, të pohohet se

“elementet latine të shqipes dhe të rumanishtes që vijnë nga një burim i

⁹⁰ “Asemenia presupuneri se întindeau pe unele trăsături remarcabile fonologice și morfologice, care însă (examine mai atent) sînt puțin concludente, fiind deplin explicabile în cadrul evoluției specifice a romanității orientale (balcanice, car-pato-dunărene), altoită pe un substrat identic sau strîns înrudit, unitare în linii generale, avînd apoi în cursul epocii medievale, multe elemente de comunitate cultural-istorică și politică”.

⁹¹ Shih për këtë edhe Ismajli 1987.

përbashkët, i quajtur nga disa eruditë 'latinishte ballkanike', mungojnë"
(Russu 1981: 105).⁹²

Kështu e kemi të shpënë në skaj mendimin e kundërt me më të shpeshtin, që thoshte se latiniteti ballkanik ka qenë relativisht unik, apo, tek e shumta, në një anë kemi pasur latinitet bregdetar-dalmain, në anën tjetër të brendisë, ballkanik, pra rumun.⁹³

Russu-i raportonte idetë e Mihăescu-t për rrugët e ndryshme të depërtimit të latinizmave në shqipen dhe në Ballkan, prandaj nuk kanë mundur të shpinin tek një rezultat unitar e homogjen. Ai referonte mendimin e Mihăescu-t për *'atdheun e parmë'* të shqiptarëve, gjithë duke e cilësuar

"ingjenioz dhe shumë interesant, por verifikimi dokumentar duhet të pritët".

Dhe ky mendim i Mihăescu-t është:

"për ta përcaktuar grosso modo atdheun e parmë të shqiptarëve disponojmë provat vijuese. Greqishtja e vjetër ka lënë gjurmë në gjuhën e folur nga paraardhësit e shqiptarëve. Ato nuk janë shumë të numërta, për shkak se greqishtja e vjetër nuk kalonte në veri të kufirit aktual gjuhësor dhe se kolonitë e dobëta të bregdetit Adriatik nuk kanë mundur të ushtronin një ndikim të thellë mbi popullatën aborigjene. Kultura romane gëzonte një prestigj të madh për një kohë të gjatë, dhe u përhap shënimisht përmes luginës së Drinus-it (Drin), të Genusus-it (Shkumbin) dhe të Aous-it (Vjosë), pa përfshirë perimetrin malor, ku vendësit rezistonin ndaj romanizimit njësoj si ndaj sllavizmit. Huazimet latine të gjuhës shqipe kanë pak ngjashmëri me elementet latine të rumanishtes; paraardhësit e shqiptarëve kanë huazuar elemente gjuhësore nga popullata romane e bregut dalmat, gjithashtu. Prandaj ata ishin fqinj, në verilindje me popullatën romane të luginës së Danubit dhe të Dakisë; në jug ata ishin në kontakt me grekët; në perëndim ata kishin raporte me detin Adriatik dhe popullatën romane të bregut; në veri, më në fund, ata shkonin përtej majave të malit Durmitor. Kjo hapësirë e gjerë nuk ka mundur kurrë të mbetej e papërkueshme për

⁹² "... să se afirme că elementele latine din albaneză și din română vin dintr-un izvor comun, numit de unii erudiți 'latina balcanică', lipsesc".

⁹³ Banfi (1972), E.: *Aree latnizzate nei Balcani e una terza area latino-balcanica (area della Via-Egnazia)*, in *Rendiconti, Classe di Lettere* – vol. 106, 1972, Accademia di Scienze e lettere, istituto Lombardo, Milano, 185-231.

qytetërimet dhe popullatat e jashtme, por ka mbajtur në vatër pa dyshim për shumë kohë një shumicë etnike shqiptare” (Mihăescu 1966 : 353).⁹⁴

Russu-i mendonte se, megjithatë, për raportet e shqipes me rumanishten më të rëndësishme janë elementet e përbashkëta të shqipes e të rumanishtes nga fondi leksikor pararomak që i përkasin substratit karpato-ballkanik. Dhe vijonte pastaj diskutimet për elementet e përbashkëta të rumanishtes me shqipen dhe për elementet pararomane jo të përbashkëta të saj me shqipen. Dhe kjo i jepte dorë atij të konstatonte se duhet të flasim për një gjuhë karpato-ballkanike.

Këto elemente ai i quante qysh prej kohësh *‘fjalë pararomane (indoeuropiane) shqipe dhe rumune’*, dhe edhe me këtë rast vetëm referonte ato që kishte thënë më 1970 kur paskësh dëshmuar se janë

“independente, të stërlashta dhe të vetat në gjuhën rumune, të afra dhe identike si etimologji indoeuropiane me ato shqipe, duke pasur pra për burim të njëjtin prototip të gjuhës satəm, me disa diferencime të stërlashta” (f. 49).⁹⁵

⁹⁴ “Pour déterminer grosso modo la patrie primitive des Albanais on dispose donc des preuves suivantes. Le grec ancien a laissé des traces dans la langue parlée par les ancêtres des Albanais. Celles-ci ne sont pas très nombreuses, du fait que le grec ancien ne dépassait pas au nord la limite linguistique actuelle et que les faibles colonies du littoral de l’Adriatique n’ont pu exercer une influence profonde sur la population aborigène. La culture romaine a joui d’un grand prestige pendant longtemps, et elle s’est propagée notamment à travers les Vallées du Drinus (Drin), du Genusus (Shkumbi) et de l’Aous (Vojusa), sans embrasser le périmètre montagneux, où les autochtones résistèrent aussi bien à la romanisation qu’à la slavisation. Les emprunts latins de la langue albanaise ont peu de ressemblance avec les éléments latins du roumain; les ancêtres des Albanais ont emprunté aussi des éléments linguistiques à la population romane de la côte dalmate. Ils étaient par conséquent voisins, au nord-est, de la population romane de la vallée du Danube et de la Dacie; au sud ils venaient en contact avec les Grecs; à l’ouest ils avaient des relations avec la mer Adriatique et la population romane du littoral; au nord enfin, ils dépassaient les cimes du mont Durmitor. Ce vaste espace n’a jamais pu demeurer impénétrable aux civilisations et aux populations de l’extérieur, mais il a indubitablement abrité pendant longtemps une majorité ethnique albanaise”.

⁹⁵ “... independente, străvechi și proprii în limba româna, i n r u d i t e și identice ca etimologie indo-europene cu cele albaneze, avînd adică sursă același prototip din limbă satem, cu unele străvechi diferențieri”.

Shumë filologë të huaj, e pas tyre rumunë, i kanë konsideruar këto fjalë si huazime nga shqipja në rumanishten në një periudhë parafeudale në mesjetë në Ballkanin Qendror. Kjo teori, sipas tij, pa bazë shkencore linguistike a historike, më 1970, nga ai, u dëshmuar krejtësisht ‘pa vlerë dhe valabilitet’, sepse ato fjalë nuk janë huazime ‘pasromane’ në rumanishten, po kanë trajtim fonetik identik me tërësinë e leksikut të trashëguar latin, pra në procesin romano-trak të gjuhës rumune. Për më shumë, ai pretendonte të kishte dëshmuar qysh më 1970 e më herët që elementet fonetike, morfologjike a sintaksore të rumanishtes e shqipes nuk e justifikojnë përbashkësinë sociale apo territoriale në epokën postromane midis dy kolektiviteteve etnike, sepse fjalët e përbashkëta indoeuropiane ‘albano-rumune’ shfaqin një lloj autonomie në zhvillimin e formave fonetike në kuadër të gjuhës rumune. Si dëshmi historike, konsideronte se duhet të jepet lista e fjalëve si

*‘lidhje e sigurt gjuhësore antike, pra social-historike arkaike pararomane (B) dhe nga aspekti i sundimit roman (C) midis rumunëve dhe shqiptarëve’.*⁹⁶

Veçoritë fonetike të fjalëve ‘albano-rumune’ indoeuropiane pretendonte t’i ketë shkoqitur më 1970, 1981. Këtu po e rimarrim këtë, siç mëtonte ai

*“dokument lingvistik dhe social-historik të rangut të parë”,*⁹⁷

duke shënuar me kursiv vërejtjet tona eventuale:

rumanisht

shqip

abure ‘vapeur, exhalation, soufflé’, drom. arom **avull** ‘abure’

*Po të ishte e vjetër, nuk ruhej në rum. -b- ndërzanore; që t’i përgjigjej formës rumune shqipja duhej të ishte *avullë, ndryshe nuk kishte rotacizëm. Për këtë fjalë Çabej ka dhe etimologji tjetër.*

argea ‘sorte de hutte, cabane, baraque, drum. **ragál**’, artic. ragál’a, ‘Huette’

Kjo fjalë, me formën ragáll(ë) mund të jetë ndeshur vetëm në veri; nëse kishte -ll- në pozitë ndërzanore, siç dëshmon gjinia femërore dhe gjatësia e a-së, pse në rum. nuk

⁹⁶ “... certă legatură lingvistică antică, deci social-istorică arhaică preromană (B) și din timpul stăpânirii române (C) între români și albanezi”, f. 50.

⁹⁷ “un document lingvistic si social-istoric de prim rang”, f. 50.

u rotacizua kjo -ll-? Si ndodhi metateza? Ka plot pyetje për këtë interpretim. Ka pasur dhe etimologji që e lidhin me makedonishten e vjetër.

balaur ‘dragon, monstre, hydre’ drom., arom. **bollë** ‘grosse Schlange’, bullár.

Pse nuk ndodhi rotacizmi në rum.? Disa thonë për arsye disimilimi. Disa shohin një situatë ballkanike vështirë të reduktueshme në një burim

baligã ‘fiente, bousse; mollasse’, dr., ar., megl., istr. **baigë, bagë, bagëlë, bagel**

Komenti për të zëshmen ndërzanore -g- vlen edhe këtu. Forma shqip është bájgë, ose bágël. Ka pasur shumë diskutime për prejardhjen difuze ballkanike.

baltã ‘marécage; lac, masse d’eau’, dr. ar. mr. ir. **bal’të, bal’ta baltinë**

Forma shqipe është baltë, balta, ashtu si baltinë, pra s’ka l dhe l’. Njihet si fjalë e lashtë IE e afërt me baltosllavishten. Disa sllavistë e kanë numëruar huazim sllav para metatezës së likuideve, por kjo si duket qëndron.

barz ‘gris, grisatre, blanc’; drom., arom., megl. **barth, bardhi** ‘alb’

Forma shqipe është bardh; i, e bardhë; përshtatja e zakonshme dh shq. -z rum., ashtu si z serb. e në gjuhë të afra që nuk kanë ndërthembore flet në të mirë të huazimit nga shqipja;

bascã ‘toison, laine’; drom., arom., megl. **baskë** (!) ‘lînã’, bashkë

Për rumanishten shpesh jepet dhe forma başcă; në shqipen nuk ekziston forma bas-kë; të dy përshtatjet duket të jenë bërë në frymën e ‘dëshmimit’ të vjetërsisë në rum. Kuptimi i fjalës shqipe: ‘bashkë = tubë leshi të lënurur të bërë gati për të tjerë i vendosur në furkë’, pra një kuptim konkret, ndërsa kuptimi i përgjithshëm i bashk, bashkë është ‘ensemble’.

brad ‘sapin’; drom. arom. megl. **breth, artic. bredhi** ‘brad’

*breth, bredhi duket që në shqipen e hershme të ketë qenë *bradh dhe përmes shumës të singularizuar brenda shqipes të jetë bërë bredh; kjo formë e hershme e shqipes do krahasuar me rum.*

brîu ‘ceinture, ornament architect.’ dr., ar., megl. **bres, brezi** ‘brîu, generație’

*Format shqipe janë: brez, brezi, ose brêz me hundore në geg., çka sugjeron lidhjen me formën e hershme *bren- dhe prej këndeje edhe afrinë me rumanishten;*

brusture ‘bardane, glouteron’; drom., arom. **brushtullë** ‘brusture’

forma shq. e sotme është brushtull, më herët duhet të ketë qenë brushtullë. Cf. Klemenčič, Kaluzhskaja;

bucura ‘réjouir, récompenser’; dr., ar., megl. **bukurë** ‘frumos’, **bukuronj**

Forma shqipe është: ndajfolje bukur, mbiemër i, e bukur, pa ë në fund; folja prej andej bëhet me prefiks intensifikimi – zbukuroj ‘embellir’;

- bunget** 'forêt (épaisse); drom. **bunk**, artic. **búngu** 'stejar, gorun'
*Forma bazë e shqipes bung; *bungjet, ose *bunget mund të ishte formim me sufuksin -et, si te shelnjet, kashnjet.*
- buză** "lèvre, bord"; drom. arom. megl. **buzë**
cf. Demiraj B. etimologjinë, Orel
- căpușă** 'tique, poux; bourgeon'; drom., arom., megl. **kpushë, kpush, kpushë**
- căpută** 'empeigne (du soulier)'; drom., aro. **këputsë, kputsë, kput**
Format shqipe: këpucë, kpu:c, kpüt; pra nga këput me suf. -së kemi këputsë: këpucë.
- çätun** 'hameau, cabane, hutte'; drom., arom., megl., istr. **katund(i)** 'sat', **katund, ketun, kot-**
*Në shqipen vetëm katund, edhe tek arbëreshët e Italisë me kuptimin 'vendbanim'.
 Format ketun, -kot- nuk e di nga i ka marrë.*
- ceafă** (?) 'nuque'; drom. **tsafë** 'Kehle, Hals'
Në shqipen kemi qafë; geg. veriore e ka afrikatizuar q-në nistore dhe ka: çafë, jo tsafë = çafë; përgjegjësja e shqipes qafë në rum. do të ishte me che-, ch-, jo me ce-; kjo do të thotë se ka hyrë nga gegnishtja dhe është e vonë; nuk e di si mund të gjykohet dhe forma ceapă në raport me qepë.
- copac** 'arbre, tronc d'arbre'; dr., ar., megl., istr. **kopatsh**, kopaçe, -ja
me sa di, del vetëm në tosk. dhe më parë kopak; kopaç duket tepër sllave.
- cruța** 'ménager, proteger, épargner'; drom. **kurtsen** 'sparsam, shcone'
shqipja ka vetëm kursej, mbase nga lat.
- curma** 'couper, raccroucir, cesser'; dr., ar., megl. **kurm**, -i 'corpo, statura', kurmue
më duket se fjala shqipe është nga turq. (?); folja kurmoj nuk ekziston
- curpen** 'sarment, tige de citrouille'; drom., ar., megl. **kulpër(e), kurpen** 'clematite sauvage',
 (kul+pënë)
- kursă** 'trappe, piège, ruse, embûche; drom. **kurthë** 'curcă, capcană'
kemi saktësisht përgjegjësia s për th të shqipes.
- daș** 'agneau'; drom., arom., megl. **dash** 'berbece', pl. desh
*(po mundësia e interpretimit si *dal-m-sh?)*
- dărimă** 'demorilr, abbatre, détruir'; drom., arom. **dërmon'**, dermija-të, dërmehás
*shq. dërmoj lidhet me rrëmoj, pra *dë (prefiks intensifikimi)+rrëmoj; format e tjera mund të jenë ndeshur diku lokalisht, por nuk janë përgjithësisht të njohura.*
- druete** 'morceau de bois; tronc d'arbre'; drom. **dru, druja** 'lemn, copac', **drûe**

färimä, sîrmä 'bris, debris, miette'; drom., arom. **thërrime'**, **thërmon'**

*fjala shqip do të lidhet me ther, me sufiksin -imë; te folja kemi modelin *ther-m-oj; thërmoj.*

gard 'clôture, enclos; bordidgue'; drom., arom., **garth**, **gárdhi**, **gard**
meql., istr.

Fjala shqipe është e vjetër: gardh, gardhi, jo gard; mospërshtatja me z për dh të shqipes, po me d, mund të indikojë një huazim sillav para metatezës së likuideve, çka në rumanistikë nuk pranohet.

gardinä 'jable, margelle'; drom.

gardhen, **gardhnia** 'Furche, Gergel'

*Fjala shqipe gardh ka forma të ndryshme të shumësit: gardhni, gardhiqe, gjerdhe, ndërsa gardhën është ndrëtim tjetër, por me të njëjtin kuptim si gardh. Gardinë duket shumë e afërt me sll. *gardina, gradina, shq. gradinë.*

gata 'achevé, terminé, prêt'; drom.

gat, **gatuaj**, **gatuej** 'gata'

Shqip gati, gatuej/gatuaj, Jokl e bie nga sll.

gälbeazä 'clavalé, hépatite des brébis'; dr., ar.

këlbazë, **gëlbazë**, **kelbazë**

*Shqip sipas modelit *kalb+ázë: këlbázë.*

ghimpe 'piquant; épine'; drom.

g'emp, **gjemp** (artic. **g'ëmbi**), **gljimp**,
glëmbë, **g'ëm**

Shqip gjemb, gjëmb, geg. gêm(b), nga më e hershmja glemb, që ruhet në çamërishten e tek arbëreshët.

ghioagä 'massue'; dr., ar. (cl'oagä, gll'oagä);

kl'okë, **kël'okë**, **g'egë**

Shqipja klokë nuk ka të bëjë me gjegë; po të ishte e vjetër grupi kl do të shndërrohej në q ose kj, ose k, përveç në çamërishten.

ghionoaië 'picus, pivert'; dr., ar., meql. ghion;

g'on 'cucuvea'

Shqip gjon, kryesht në toskërishten.

grapä 'herse; drapeau'; drom, arom(?)

grep 'undiță, cârlig'

*Grep do të jetë nga shq. *grap: g+rap me transformime të mëvona a:e.*

gresie 'grès, pierre à aiguiser'; drom., istr.

gris, **gërris**, **gëresë**

*shqipja ndërtohet pas gjedhes: *gë+rryej+esë: *gërre+së, si te filloj: fillësë;*

groapä 'trou, fosse; cave, tombe'; drom., arom., **gropë**

meql., istr.

grumaz 'cou, gorge; col'; drom., arom.

gurmás, **grumás**, artic. **gurmazi**

Shqip gurmaz

grunz 'grumeau, pelote'; drom., arom.

grundë, **krundë**, **krunde** 'târîțe'

Shqip krunde, plural; grunde formë dytësore dhe e rastit; mund të jetë huazuar si *grunde, *grunde, pra plurali që u bë në rum. grunzi.

guşă 'goître, jabot; fanon'; dr., ar., megl., istr. **gushë** 'Hals, gozzo'
mal 'bord, ri(va)ge; colline, hauteur'; dr., ar., istr **mal'**, 'Berg, Gebirge', **mal-i**
mazăre 'pisum sativum; pois'; drom., arom. **modhullë**'mazăre' (**modhë,-në,-a**,
modhull 'loglio, neghina')

Shqip modhull, më herët modhullë; reflekse të rregullta shq. dh: rum. z, shq. -ll: rum. -r-; por i paqartë ndryshimi shq. o: rum a.

măgură 'tretre; éminence, colline'; dr., ar., istr. **magullë** 'măgură', **gamule, gomile**
Shqip magulë, jo me -ll-; gomile dhe gamule asociojnë qartë te sllavishtja.

mărat 'pauvre, malheureux'; drom., arom. **mjerë** 'infelice, misero, mjeri, -ja
Shqip mjerë; i, e mjerë, prej andej mjerim, mjeroj, s'ka të bëjë me mărāt; mbase romanizëm.

mătură 'balai, plumeau'; millet à ballais'; drom., arom., megl., istr. **nétullë, netull, netëll** 'scopa'

Mbase romanizëm

mînz 'poulin; les fils de la trame'; dr., ar., megl. **mës, mas, mēzë, mazë** 'mînz(ă)'
Shqip mēz, m̄z, pra prej *mandj-; shih edhe mēzat, mzuer; më tej mand, mēnd, mandeshë, mēndeshë.

moş 'vieux, viellard, aieul, oncle'; drom., arom., megl., istr. **mótshtë, moshë** 'greis, Alter,
motshim 'bejahrt', moshatar
shqip; mot; i, e moçëm (motshëm); moshë; moshatar; i, e moshuar
mugure 'bourgeon' **mugull** 'germoglio, il germogliare',
Mugullue 'germogliare'

shqip mugull, mugulloj, më herët mugullë; transformim i rregullt shq. -ll-: rum. -r-; por nuk shpjegohet rum. -g-, nëse është fjalë e vjetër.

murg 'bai, brun' **murk, artic. murgu, murgullue**
Shqip murg, -u; murgulloj duhet të jetë ndërtim nga mugulloj.

năpîrcă 'vipère; vipérine' **nepërkë, nepërkë, nepker, neperkë**
Shqip vetëm nepërkë, të tjerat gabime shënimi apo të rastit; vetëm toske.

păstaie 'gousse, cosse (de harricot...)' **pishtajë, bishtajë, besh-**
Shqip vetëm bishtajë.

pîrîu 'torrent; ruisseau' **përrua, artic. përroi, pl përrojë**
Rum. î implikon ekzistencën e -n prapa zanores, çka te përrua, prrue nuk justifikohet.

pururea ‘toujours, éternellement’	përhere ‘pururea’, përhershëm
<i>Shqip përherë nga për herë, sintagmë parafjalore e ngurosur, prej andej i, e për-hersh/ëm,-me; nuk duket të ketë të bëjë me fjalën rumune, pos nëse atje është ndonjë huazim i vonë lokal</i>	
rînză ‘estomac, gésier, caillet’	rëndës ‘chiag’
sarbăd ‘aigre (let), fade; pâle’	tharbët ‘acido’, tharptë, tharbë
<i>Refleks i rregullt shq. th: rum. s.</i>	
scăpăra ‘battre le brique; étinceler’	shkrep ‘schlage Funken; es blitzt’
scrum ‘cendre’	shkrump , artic. shkrumbi, shkrumb
scula ‘lever, (r)éveiller, se lever’	shkul, tskul, shkul’em
<i>Shqip shkul khs. me përkul, ngul (n+kul); formë dialektore çkul, jo ckul; rindërtimet IE mund të bëhen duke u nisur nga sh+kul dhe jo nga shkul.</i>	
sîmbure ‘noyau; pépin’	thúmbullë, thumull, sumbull
<i>Shqipja e sotme thumbull, e vjetër thumbullë; e folur thumëll, sumëll;</i>	
sîrmă, v. fărîmă	
spînz ‘éllébore’	shpëndër, shpëndël, shpen(ër) etc.
<i>Geg.: shpënd, shpení (*shpendí) (kolektiv.)</i>	
strep ‘stérile, bráhaigne, aride’	shterp , artic. shtrepi ‘vierme’
<i>Shqip: shtrep, shtërpinj, jo me -b të zëshme në fund, as pasi të shtohet nyja; rum. kam parë edhe ştrepede (?)</i>	
strungă ‘ouverutre étroite, défilé’	shtrungë, -a ‘la porta dell’ovile per cui passano le pecore...’
<i>Shqip mund të jetë nga shtroj – shtrungë, si te shtjelloj – shtëllungë. Në atë rast nuk duhet të jetë shumë e vjetër në rumanishten, jo nga substrati, po nga shqipja.</i>	
şale ‘lombes, reines’	shalë ‘coapsă, coscia, Schenkel’
şopîrlă ‘lézard’	shapí, shapiu, tshapi(ni)
<i>Shqip zhapi, zhapini, pra janë gjasët që të mos lidhen këto fjalë.</i>	
şut ‘écorné, écroute, gauche’	shut, shutë, shytë, shyt
ţap ‘bouc; satyre, osselet plombé’	stéap, tsap, sk’ap, c(j)ap
<i>Shqip: tosk. cјap, geg. cap, sqap. S’ka steap.</i>	
ţarc ‘parc à bestiaux; enclos’	thark ‘Hürde, recinto di siepe’
<i>Shih Schumacher</i>	
vatră ‘foyer; âtre’	vatrë, vetr(ë)

Shqip: tosk. vatër, geg. votër, e shquar vatra, votra. Ballkanizëm.

vätuiu ‘chevreau (agneau) d’un an’

vetul’, vëtul’ë, ftul’ë, ftujë

Shq. ftujë, ftujak.

viezure ‘blaireau’

vjedhullë, vjedhull, vjetull

Shqip: vjedull, vjetull, po edhe vjedhull.

zgardă ‘collier, tige tortillé’; drom.

shkardhë ‘Hundskette’

zgâria ‘étratigner, griffer, gratter’; dr., ar., megl.

shk’er ‘reise **auseinander**’

Rosetti dhe vështrimi ballkanistik

Sintezën e studimeve në këtë fushë në Rumani e bëri historiani i shquar i gjuhës rumune Alexandru Rosetti (Rosetti 1968), i cili tërë çështjen e ndërveprimit të gjuhëve ballkanike e kishte vendosur në suazat e rrethanave më të gjera politike, ekonomike e shoqërore. Studimet e tij në këtë fushë kanë zgjatur me dekada, prandaj dhe idetë kanë evoluuar. Rosetti sillte në vëmendjen e opinionit shkencor vrojtimit e tij për zanoren *ă* të rumanishtes në kontekst ballkanik, për çështjen e rotacizmit në shqipen e në rumanishten, për zhvillimet e grupeve latine *ct, cs*, për prapavendosjen e nyjës, për zhdukjen e paskajores, për dallimet midis fjalive qëllimore dhe objektore, për derivacionet me *-ește, -ză*, dhe për 85 fjalët e përbashkëta midis shqipes e rumanishtes (Rosetti 1968). Më duket se Brâncuș-i kishte të drejtë kur këtë vepër e cilësonte sintezën më të mirë të çështjes në Rumani. Mbështetës i teorisë së ‘unionit gjuhësor ballkanik’, Rosetti theksonte se gjenezën e paralelizmave në zhvillimet e gjuhëve ballkanike mund ta shpjegonin faktorë si bilinguizmi substracial dhe ndikimi i kulturës bizantine, se në këtë aspekt një rol e kishin luajtur latinishtja lindore dhe rumanishtja. Duke dashur të provonte karakterin njësor të qytetërimit të lashtë të rumunëve e shqiptarëve, ai kishte ndërmarrë grupimin e termave autoktonë e latinë në shqipen e në rumanishten. Më 1978 Rosetti, pasi kishte kritikuar teorinë e V. Georgiev-it për veçimin e dako-mezishtes nga trakishtja, kishte theksuar afrinë midis dy gjuhëve tona në bazë të substratit të njëjtë, trakas apo dako-mez. Ai e theksonte po ashtu faktin se afria e shqipes me ilirishten mbështetet në korrespondenca fo-

netike që nuk mund të mohohen dhe saktësonte:

*“Prej këndeje duhet të nxjerrim përfundimin se shqipja, vazhduese e ilirishtes, ka qenë në kontakt në një moment të caktuar të historisë së saj në Siujdhesën Ballkanike me trakishten apo dako-mezishten dhe ka qenë ndikuar nga kjo gjuhë,⁹⁸ e cila i ka dhënë elemente të një serie termash e tiparësh gramatikore karakteristike, të cilat i gjejmë në rumanishten”.*⁹⁹

Një ide e ngjashme sa i përket mënyrës së të shpjeguarit ndeshet edhe te Jokl-i e Barić-i.

Ndryshe nga Georgiev-i dhe përkrahësit e teorisë së tij për dallimin e dakishtes nga trakishtja, studiues të shumtë rumunë ngulin këmbë te përbashkësia e tyre, sepse në atë mënyrë duan të vendojnë një bazë të përbashkët për rumanishten, bullgarishten dhe shqipen. Anash mungesën e njohjeve për kontaktin e atij lloji me trakishten apo dako-mezishten, të ndryshme/ të njëjta, që vazhdueses së ilirishtes i paska dhënë tërë atë seri termash e tiparësh karakteristikë gramatikorë, anash mungesën e vendosjes kronologjike në raport me zhvillimet brenda shqipes, duket pak e vështirë të shpjegohet si u ndodh pasardhësja e ilirishtes në Traki apo në Daki. Në fusnotë Rosetti referonte Georgiev-in (Georgiev 1972, f. 50 e v.), duke pohuar se huazimet latine në shqipen vijnë nga lindja e Siujdhesës Ballkanike,¹⁰⁰ si në proto-rumanishten, se habitati i shqiptarëve në epokën e vjetër paskësh qenë Mezia e Epër (Dardania, Dacia Mediterranea) dhe perëndimi i Dakisë, se rumanishtja e shqipja qenkan formuar në rajonin dako-mez. Meqë rumanishtja nuk është formuar para sh. VI, madje edhe më vonë, neve na duket më se e vështirë

⁹⁸ Krejt e mundur që parashqipja apo ilirishtja të ketë huazuar fjalë nga trakishtja a ndonjë gjuhë tjetër e lashtësisë, çka mund të hetohet sidomos në rastet e fjalëve të parme apo në zbehje gjurmësh të fjalëformimit, por ç’të themi për fjalët me strukturë fjalëformuese transparente brenda gjedheve të shqipes?

⁹⁹ Rosetti 1978: 80: “Il faut en déduire que l’albanais, continuateur de l’illyrien, c’est trouvé en contact, dans la Péninsule Balkanique, à un moment donné de son histoire, avec le thrace ou le daco-mésien, et a été influencé par cette langue, qui lui a donné des éléments apparentés à une série de termes et de traits grammaticaux caractéristiques, que l’on retrouve en roumain”.

¹⁰⁰ Pohime të tilla nuk qëndrojnë. Shih për këtë Mihăescu 1966 dhe Mihăescu 1993.

të supozojmë që djepi i shqiptarëve të ketë qenë hapësira e përmendur në atë kohë. Nga ana tjetër, studimet e shumta kanë treguar ngjashmëri dhe ndryshime midis elementit latin të shqipes dhe rumanishtes, sa i përket moshës, apo fushave leksiko-semantike. Në një skicë të vonë Rosetti diskutonte kufijtë e latinshtes ballkanike duke u nisur nga vlerësimet e V. Arvinte, i cili nga ana e tij mbështetej tek E. Petrovici:

*“kufiri perëndimor i hapësirës burimore të romanizuar të gjuhës rumune dhe të popullit rumun ishte identik me kufirin lindor të “hendekut të romanizimit” si dhe me kufirin perëndimor të Provincës së hershme Moesia Superior pas Reformës së Dioclecianit. Në qendër të saj shtrihej përgjatë Drinës”.*¹⁰¹

Rosetti kishte një kritikë themelore për të dy: nuk e marrin në vëzhtrim kriterin kronologjik. Këtë e shihte dhe në raport me Petrovici-in:

*“kështu, territori i formimit të gjuhës rumune nuk shtrihej deri në afërsi të Dalmacisë”.*¹⁰²

Petrovici i mohonte raportet e rumanishtes me dalmatishten duke u mbështetur tek idetë e H. Barić-it. Por për Rosetti-n nuk janë të rëndësishme ato pak shënime të Barić-it për themelimin e atyre raporteve, po konstatimet se vokalizmi dhe konsonantizmi i dalmatishtes dëshmojnë se latinishtja e Dalmacisë përbënte një grup me latinishten lindore. Më konkretisht, sipas Rosetti-t, tashmë ishte vendosur që deri në fund të sh. III të ER, kur migrimet e popujve gjermanikë shkaktuan ndarjen e latinishtes së Lindjes nga ajo e Perëndimit, latinishtja e folur në Itali përbënte një grup me latinishten Lindore. Aty hynin të folmet e Italisë jugore e qendrore dhe të dalmatishtes, lat. e shqipes, lat. e gjetur në serbo-kroatishten e sllovenishten, latinishtja e provincave danubiane. Vetëm pas ndarjes së Perandorisë në sh. V e më tej latinishtja ballkanike u nda

¹⁰¹ “Die westliche Grenze der romanisierten Ursprungsgebietes der rumänischen Sprache und des rumänischen Volkes war identisch mit der Ostgrenze der “Romanisierungslücke” und auch mit der westlichen Grenze der früheren Provinz Moesia Superior nach Diokletians Reform. In ihrem Zentrum verlief sie längs der Dirna.”, Arvinte (1968), V.: 113.

¹⁰² “Așa dar, teritoriul de formare a limbii românești nu se întindea pînă în apropierea Dalmației”, Petrovici 1966), 79-83, 82.

nga latinishtja e Italisë. Në të vërtetë, Petrovici e Arvinte niseshin nga trajtimi bullgar i grupeve sllave *tj, *dj si št, žd në rumanishten për të vendosur kufirin perëndimor të rumanishtes. Por ky kriter, sipas Rosetti-t, është i vonë, sepse njësia e sllavishtes jugore u ruajt së paku deri në sh. IX-X. Kështu, mendonte ai, kufiri lindor i latinishtes ballkanike, prej nga doli rumanishtja, është zhvendosur nëpër shekuj. Vetëm pas ndarjes së Perandorisë latinishtja ballkanike u zhvillua në vazë të mbyllur.

*“Njësia e rumanishtes, të folur në veri dhe në jug të Danubit, në epokën e përbashkësisë (VII, VIII – X), u thye nga masat sllave të ardhura nga veriu i Danubit, e që depërtuan deri në Greqi”.*¹⁰³

Qysh në studimin *Situatja limbii române între limbile balcanice*,¹⁰⁴ Rosetti kishte saktësuar: latinishtja ballkanike përfshinte dalmatishten, rumanishten (dako-, macedo-, megleno- dhe istrorumanishten), elementet latine të vokabularit të shqipës, të bullgarishes dhe të serbokroatishtes; dalmatishtja dhe shqipja paraqesin edhe tipare të veçanta për grupin perëndimor të gjuhëve romane. Në raport me gjuhët e lashta, për çka krahasimi me shqipen i dilte shumë i rëndësishëm, ai nisej nga teoria e V. Georgiev-it, sipas të cilit

“gjuha dake (dako-meze) është gjuha nënë e shqipës”,

por që Rosetti, si shumë studiues rumunë, nuk ishte i gatshëm të pranon-te se ishte gjuhë tjetër nga trakishtja. Në fakt, thoshte ai,

“korrespondencat fonetike që mund të vendosen midis gjuhës trakase dhe rumanishtes, nga njëra anë, dhe midis gjuhës trakase dhe shqipës, nga ana tjetër, tregojnë se në raste të numërta rumanishtja dhe shqipja, gjithë duke u nisur pra nga i njëjti burim, paraqesin gjithsesi trajtime të ndryshme” (Rosetti 1965: 314).¹⁰⁵

¹⁰³ “L’unité du roumain, parlé au nord et au sud du Danube, à l’époque de communauté (VIIe, VIIIe – Xe s.) a été brisée par les masses slaves venues du nord du Danube, et qui ont pénétré jusqu’en Grece.”, Rosetti (1970: 505-506).

¹⁰⁴ Rosetti (1965): 313-322, versioni frëngjisht Rosetti 1963: 171-180.

¹⁰⁵ “Correspondențele fonetice care se pot stabili între limba tracă și română, pe de o parte, și între limba tracă și albaneză, pe de altă parte, arată că în numeroase cazuri româna și albaneza, deși pornesc de la aceiași sursă, prezintă totuși tratamente diferite”.

Ndikimi i gjuhëve ballkanike mbi rumanishten ka ndodhur në veri ashtu si në jug të Danubit, mendonte ai, kështu që në kohën tonë është gjë e njohur që rumanishtja u formua në veri dhe në jug të Danubit, e qartë, nga latinishtja lindore.

Për disa tipare, ndryshe nga gjuhët e tjera romane, rumanishtja del ballkanike – prapavendosja e nyjës dhe zëvendësimi i infinitivit me koniunktiv, ndërsa për disa të tjera afrohet me shqipen – të dhënat e vokabularit flasin në këtë kuptim.

Në pjesën tjetër të studimit ai merrej me raportet e rumanishtes me sllavishten e jugut, ndikimi i së cilës ka qenë i rëndësishëm. Shih për shembull fjalinë: *iubesc foarte mult pe prietenii mei dragi* “i dua shumë miqtë e mi të shtrenjtë”, të cituar nga ai; 3 fjalët kryesore: *iubesc – iubi, prieten dhe drag* janë sllave. Sado që përdorimi i tyre në gjuhë nuk është dhe aq i dendur, fakti se ka huazime të shumta të tipit: *drag, iubi, plăti, primi, scump, prieten, neprieten*, se ka ndikime në formimin e fjalëve: si *po-* te *ponegri* (<*negru*), *pre-* te *preface*, *rës-* te *rësfire*, apo *zã-* te *zãurdi* (< *urdã*),¹⁰⁶ se ka ndikime në fonetikë, si jotizimi i *e*-së nistore në *ie*: *el* < *iel*, futja në sistemin konsonantik e bashkëtingëllores *h*: *hranã*; përshtatja e *o* të vokativit: *soro, Anico*, prosedetë e numërimit nga 11 te 19: *un-sprezece – jedinũ na desęte*, po edhe *douãzeci – dũva desęti, řai zeci ři trei – řesti desętũ i trije*, pastaj numri *sutã* nga *sũto*, janë të dhëna që flasin për një shkallë të lartë ndikimi që shpjegohet përmes simbiozës. Përkëpamje të ngjashme shprehte ai pak më gjerësisht tek *Istoria limbii române* 1968, po edhe tek Rosetti 1972: 449-455, me këtë që këtu vlerësonte disa aspekte të studimeve të Brâncuș-it, ndrësa linte dyshime mbi metodën etimologjike të Russu-it.

Brâncuș-i e Poghirc-u

Vitet ‘60-’70 të sh. XX në Rumani sollën intensifikim të studimeve të kësaj problematike. U shquan sidomos autorët I. I. Russu, C. Poghirc, A.

¹⁰⁶ Formime tipike sllave: *beo – pobeliti* (*bardh – zbardh*); *raditi – uraditi*.

Vraciu, G. Brâncuș, etj. (Frâncu 1999). Në studimet e tyre janë shqyrtuar tiparet ballkanike të rumanishtes në strukturën fonetike e gramatikore, në fushën e etimologjisë së fondit që njihet si “i substratit”, i raporteve rumuno-shqiptare dhe i rindërtimeve trako-dakase. Një shtysë të fuqishme kësaj vale studimesh i kanë dhënë rezultatet e studiuesve bullgarë në fushë të trakologjisë, D. Dechev (Detschew 1957), V. Georgiev (Georgiev (1968); Georgiev (1960), 1-19; Georgiev (1977), ff. 348.), I. Duridanov (Duridanov 1976), etj., por janë marrë parasysh edhe studimet etimologjike të E. Çabejtë dhe vështrimet e tij për raportet midis dy gjuhëve (Çabej 1976: 7-146. Çabej 1959: 531. Çabej 1971-73: 365-377; Çabej 1975). Në hulumtimet e atyre dekadave mbisundonte koncepti sipas të cilit elementet autoktone rumune të përbashkëta me shqipen janë trashëguar drejtpërsëdrejti nga substrati nga secila gjuhë në mënyrë të pavarur. Kundërshohej ideja e mëhershme për ekzistencën e një simbioze rumuno-shqiptare në një periudhë parasllave e ndoshta pjesërisht edhe më vonë. Ngulej këmbë në dëshmimin e teorisë për formimin e rumanishtes e të rumunëve në Daki, në veri të Danubit, por për disa edhe në jug. Në rumanishten ato kanë ndjekur të njëjtin zhvillim si elementet latine:

“Teza për të ashtuquajturën ‘simbiozë’ albano-rumune, e huazimit nga shqipja nuk mbështetet më sot nga asnjë linguist rumun. Prandaj, etimologjia e sotme ngul këmbë në rindërtimin e trako-dakishtes (Russu), me referencë të korrespondencat e ndryshme indoeuropiane. Krahasimi me gjuhën shqipe implikon nevojën e rindërtimit të formave paralele në rumanishten komune dhe në shqipen e përbashkët respektivisht” (Brâncuș 1966a: 971, Brâncuș 1978: 370).¹⁰⁷

Më vonë Brâncuș-i ka botuar dhe dy libra me vlerë për këtë çështje, ku nuk fshihet këmbëngulja tek argumentet që ishin shprehur më parë nga ai vetë për shpjegimet e përbashkësive midis rumanishtes e shqipes

¹⁰⁷ “The thesis of the so-called Albanian-Romanian ‘symbiosis’, of the borrowing from Albanian is no longer backed today by any Romanian linguist. Therefore, present-day etymology insists upon the reconstruction of Thraco-Dacian (Russu), by reference to various Indo-European correspondences. The comparison of the Albanian language implies the necessity of the reconstruction of parallel forms in Common Romanian and Common Albanian respectively”.

përmes substratit të quajtur “trako-dak”, nga të tjerë “dako-get”, apo “trako-dako-geto-mez” (Brâncuş 1983: 197).

Në librin e dytë, ku rimerren studimet e tij të mëhershme për çështje të strukturës fonetike e gramatikore të dy gjuhëve, Brâncuş-i nxirrte këtë përfundim (citoj sipas Rezymesë gjermanisht):

“Studimi i substratit të rumanishtes kërkon patjetër të shtrihet vështrimi tek shqipja”,

sepse midis dy gjuhëve ka përkime leksikore, tingullore, gramatikore e frazeologjike.

“Elementet e përbashkëta të të dy gjuhëve më në fund tregojnë ndikimin trako-dak mbi latinishten vulgare të hapësirës karpato-danubiane, por jo ndikimin e mëvonë të shqipes mbi rumanishten.¹⁰⁸ Në vështrimin tonë nuk kanë shumë rëndësi dallimet midis dy gjuhëve, që te gjuhët me prejardhje të ndryshme janë të pritshme, po ngjashmëritë”, Brâncuş 1995: 111.¹⁰⁹

Me pak përjashtime, thoshte ai, fjalët e rumanishtes të trashëguara nga substrati ndeshen nëpër tërë hapësirën gjuhësore dakorumune, por

“në rumanishten e lashtë këto fjalë ndesheshin dhe në jug të Danubit” (Brâncuş 1995: 111).¹¹⁰

Zhdukjen e mëvonë të disa prej këtyre fjalëve në dialektet jugdanubiane e shpjegonte me zëvendësimin nga gjuhët përreth që ndikuan mbi to. Sipas tij,

“është shumë e besueshme që ã rumune dhe ë shqipe duhet t’i atribuohen një ndikimi të substratit trako-ilir, në çdo rast një tendence të substratit” (Brâncuş 1995: 114).¹¹¹

¹⁰⁸ Ndikimin e shqipes nga shtresa folësishe të ardhur në hapësirat rumune nga jugu shqiptar e kishin vënë në pah dijetarë si G. Weigand për hapësira të caktuara të Transilvanisë.

¹⁰⁹ “Die Erforschung des rumänischen Substrats verlangt notwendigerweise den Blick auf das Albanische“. ... „Die den beiden Sprachen gemeinsamen Elemente sind letztlich das Ergebnis des thrako-dakischen Einflusses auf das Vulgärlatein des karpato-danubischen Raumes, nicht aber späterer albanischer Einwirkung auf das Rumänische. Unserer Ansicht nach zählen nicht so sehr die Unterschiede zwischen beiden Sprachen, die bei Sprachen unterschiedlicher Herkunft zu erwarten sind, sondern die Gleichheiten“.

¹¹⁰ “Im Urrumänischen waren diese Wörter auch im Süden der Donau anzutreffen“.

¹¹¹ “Dies läßt den Schluß zu, daß rumän. ã und alb. ë sehr wahrscheinlich thrakisch-illyrischem Substrateinfluß zuzuschreiben sind, in jedem Fall aber einer Tendenz des Substrats“.

Këtë ai e mendonte sipas idesë së C. Poghirc-ut që në trakishten kishte lëkundje në shkrime të emrave e të materialit tjetër të paktë midis *a* dhe *e*, çka do të fliste për ekzistencën e një zanoreje [ə] në gjuhët e lashta të Ballkanit. Por kur është fjala për zhvillimin e zanores së tillë në shqipen, ne na duket se rindërtimi i brendshëm jep edhe kronologji relative, që mund të flasin ndryshe (Shih dhe Ismajli 1987).

Le të ndalojmë këtu pak tek një tjetër ndihmesë e Brâncuș-it lidhur me këto raporte e që përfshin tendencat që mund të jenë trashëguar nga substrati në gjuhët e sotme.

Ndryshime fonetike të vona të shqipes dhe të rumanishtes, diskutim i vitit 1987

Studimi i G. Brâncuș-it “*Ndryshime fonetike të vona në shqipen dhe në rumanishten*” (Brâncuș 1977: 289-293) ishte komentuar nga ne pak më gjerësisht (Ismajli 1987). Ishin bërë disa vrojtime të përgjithshme dhe disa konkrete. Do t’i rimarrim këtu, me mëtesën për të theksuar rreziqet nga përdorimi ekstensiv i konceptit të substratit, nevojën që të vëmë kufizime në këtë drejtim. Derisa teza për origjinën proto- dhe medioshqipe të elementit të përbashkët të shqipes e të rumanishtes është diskutuar në mënyra të ndryshme, sidomos nga Çabej, teza tjetër që supozon prejardhjen nga substrati merret e gatshme, e pazbërthyer, ndonjëherë madje edhe me emërtime problematike si trako-dako-mezo-getishte. Këto hamendje dhe hipoteza të shumta në numër, por të ngjashme me njëra tjetrën janë pasojë e tendencës për të bërë përgjithësime krahasimtare pa i pasë njohur mirë më parë realitetet gjuhësore që krahasohen. Ndonjëherë ndodh që edhe ndryshimet e vona në dukje të parë të ngjashme të shqipes e të rumanishtes të shpjegohen me ndihmën e substratit. Në studimin e sipërshënuar Brâncuș-i pohonte se disa ndryshime fonetike relativisht të vona në rumanishten, sidomos perëndimoren, shfaqen gati të njëjta a të ngjashme dhe në shqipen, sidomos në të folmet veriore.¹¹² Kuptohet që ato

¹¹² Kjo kontraston me idenë e mbrojtur nga ai për afri specifike midis toskërishtes e dakorumanishtes, duke lënë të kuptohet madje se tosk. do të jetë shpërngulur

janë të pavarura nga njëra tjetra, por shpjegimi i tyre do të jetë ky: disa kanë karakter spontan, të tjerat janë të determinuara nga një ndikim i përbashkët. Mëtesa e Brâncuș-it është me cak të largët:

“Faktet që do të rendisim më poshtë dëshmojnë se, edhe pse të ndara, këto dy gjuhë vazhdojnë të zhvillojnë tendenca të përbashkëta dhe, mbi të gjitha, të reagojnë njësoj ndaj ndikimeve të jashtme” (Brâncuș 1977: 290).¹¹³

Sipas Brâncuș-it ekziston në rumanishten, në nëndialektet e Banatit, të Oltenisë dhe të Hacegut, si dhe në istrorumanishten, një zanore e prapme [a] që zakonisht transkribohet si [ǎ] dhe që del nga zanorja [a] e theksuar. Për rumanishten ka hipoteza se ky ndryshim ka ndodhur nën ndikimin e serbokroatishtes (shih edhe Weigand 1898: 231; Densusianu 1915: 19-20; Kovačec 1971: 10). Në shqipen, [ǎ]-ja (e prapme), qoftë e hundorëzuar, qoftë gojore, del në të folmet gege, në afërsi të pandërmjetme me domenin kroat. Hulumtuesit vërejnë se buzorëzimi i [ǎ]-së së theksuar ka arritur në stadin e [o]-së: [omël], [hongër], [dhomb], [s'kom], [ćof], [jov].

“Dihet se transformimi i ā-së në ǎ (dhe më rrallë në o) karakterizon një pjesë të madhe të të folmeve kroate të tipit čakavian, në afërsi të pandërmjetme me istrorumanishten dhe shqipen e veriut. Për rrjedhojë, është shumë e besueshme që në rumanishten dhe në shqipen ky fenomen t'i de-tyrohet ndikimit kroat” (f. 289-290).¹¹⁴

Për shqipen ai mbështetet në vrojtimit e S. Mladenov-it (Mladenov 1925: 48, 54, 67, 69) e të C. Tagliavini-t (Tagliavini 1942: 37), për të folmet gege, të cilat duan koment.

Shënimi për këtë ndryshim në të folmet e čakavishtes është i saktë, porse s'ka si të merret seriozisht supozimi për ndikimin e čakavishtes në shqipen, kur dihet se shqipja është po aq afër me čakavishten sa me dako-

më vonë drejt jugut.

¹¹³ “Faptele pe care le vom urmări mai jos dovedesc că, deși separate, cele două limbii continuă să dezvolte tendințe comune și, mai ales, să reacționeze la fel la influențele externe”.

¹¹⁴ “Se știe că transformarea lui ā în ǎ (și mai rar o) caracterizează o mare parte a graiurilor croate de tip čakavian, din apropierea imediată a istroromânei și a albanezei de nord. Prin urmare, e foarte probabil ca în română și în albaneză fenomenul acesta să se datoreze influenței croate”.

romanishten, apo ta zëmë me turqishten e Stambollit, ndërsa ndërmjet ka hapësira të gjera të folmesh shtokaviane. Të folmet çakaviane përfundojnë diku afër Zarës, ndërsa skajet e shqipes në atë anë arrijnë te Tivari. Të folmet shqipe kanë kontakt me serbishten e jugut, domethënë me të folmet e tipit kosovsko-resavski, prizrensko-timočki, jožnomoravski dhe me të folmet e Malit të Zi të tipit zetsko-sjениčki (lovcenski), të gjitha të tipit shtokavian. Kjo do të thotë se fenomenet specifike dialektore të kontaktit mund të dalin vetëm te një nëndialekt. Ka gjithashtu kontakt edhe me maqedonishten perëndimore. Do të pritej që ndikimet e pësuar në shqipen t'i takonin ndonjëres prej këtyre zonave. Në harta dialektologjike mund të shihet se kontakte kështu të pandërmjetme midis shqipes e çakavishtes nuk ka. Nga ana tjetër, supozimi i tillë do të nënkuptonte që ai ndikim të jetë reflektuar njësoj në të gjitha zonat ku shtrihet. Po kështu ndryshimi që ndodh nën ndikimin sllav në shqipen në fqinjësi me maqedonishten dhe/përkatësisht me serbishten, nuk mund t'i atribuohet vetëm njëres gjuhë. Do thënë se pas sh. XVIII arbënishtja e Zarës ka kontakte me çakavishtën dhe atje mund të diskutohen këto fenomene.

Sistemi fonematik i të folmeve gege përgjithësisht karakterizohet nga bashkëlidhja e gjatësisë së zanoreve në pozitë të theksuar. Zanoret e shkurtra zakonisht janë më të hapura, ndërsa të gjatat më të mbyllura. Gjatësia është komplekse dhe përfshin dhe intensitetin e elemente të lëvizjes para prapa. Gjendja ndërliqet me zanoret hundore që mund të jenë të gjata e të shkurta, kështu që kumulativisht mund të kemi këtë repertor:

<i>ĩĩỹỹ</i>	<i>ũũ</i>	<i>ĩĩỹỹ</i>	<i>ũũ</i>
<i>ēē</i>	<i>ōō</i>	<i>ēē</i>	--
<i>ǎ</i>	<i>ā</i>	<i>ã</i>	<i>ã</i>

Argumentimi i mëtejshëm fonologjik mund të shihet tek Ismajli 1987.

Këto elemente të përshkrimit, që janë njëherësh edhe arsye të ndryshimit në fjalë, nuk janë hetuar nga autorët që citonte Brâncuș-i. Zanoret, të cilat Mladenov i shënonte me [o] për të folmet e ndryshme veriore, si te shembujt [ćof, jov] nuk janë të ngritjes II. Ato janë të buzorëzuara dhe të prapme. Ato nuk rimojnë me zanoret e gjata [ō]

te fjalët e tipit [cōf]. Pra kundërvënia midis zanores [ǎ] ose më mirë [o] dhe [ō] ruhet mbi bazë të shkallës së ngritjes. Për më tepër Mladenov-i fliste për të folme të Maqedonisë.

Në rumanishten, p.sh. në dakorumanishten, kemi të bëjmë vetëm me ndryshim të natyrës fonetike dhe jo edhe fonologjike, ndërsa në istrorumanishten mund të kemi edhe ndryshim fonologjik. Por është e qartë se në istrorumanishten ky ndryshim ndodh pikërisht për shkak të ndikimit të fuqishëm të kroatishtes, ndërsa në dakorumanishten nuk ndodh ky tipi i dytë si në shqipen pikërisht për shkak të mungesës së hundorësisë. Arsyet e ndryshimeve në njëërën dhe në tjetrën gjuhë nuk janë të njëjta, arsye të ndryshimeve sistemore.

Në rastin e të folmes gege të Arbneshit të Zarës, ku ka ndikim të çakavishtes pas sh. XVIII, me sa kam parë, kemi një lëvizje të plotë të sistemit me dallim kuantiteti në sistem me shkallë të ngritjes, ku nuk mund të përjashtohet interferenca dhe e italishtes.

Sido që të jetë, nuk kemi të bëjmë me ndonjë trashëgimi nga ndonjë substrat, po me zhvillime të zakonshme në gjuhë të ndryshme.

Elementi i dytë i raportuar nga Brâncuș-i ka të bëjë me një ndryshim bashkëtingëlloresh. Në të folmet rumune të Transilvanisë, të Banatit dhe në veriperëndim të Oltenisë ndodh ndryshimi i bashkëtingëlloreve dhëmbore *t, d* në bashkëtingëllore të qiellzorizuara (më tutje afrikate) përpara zanoreve të përparme *i, e*: *frate – frat'e, verde – verd'e* në *frăce, verd'e*. Ky qiellzorizim në rumanishten i atribuohet ndonjëherë ndikimit të hungarishtes (Rosetti 1942: 123; Pătruț 1953: 211-212.), ndërsa afrikatizimi-ndikimit të serbokroatishtes (Pătruț 1958: 67, 70; Coteanu 1961: 64 e tutje), sadoqë ka edhe mendime që këtë ndryshim e shpjegojnë ndryshe (Russu 1966, G.: 352). Për Brâncuș-in, ky ndryshim është i krahasueshëm me atë që ndodh në disa të folme të shqipes së veriut. Kështu ai mendonte se, si në Banat, ka ndodhur qiellzorizimi, më tutje afrikatizimi, i bashkëtingëlloreve *t, d* në të folmet e Dibrës: *tu çerr (: tjerrë), çetrin (: tjetrin), shçerra (: shtjerra), xhe (: dje), xhal (: djalë)*, etj. Po këtu Brâncuș-i e fuste edhe ndryshimin e qiellzoreve primare *q, gj* në afrikate në gegnishten e veriut: *çen (:*

qen), *çi* (: *qi*), *xhak* (: *gjak*), *xharpën* (: *gjarpën*), *xhasht* (: *gjashtë*), apo frikativizimin, siç thoshte ai sipas Mladenov-it (Mladenov 1925: 63),¹¹⁵ në të folmen e Gostivarit: *shen* (: qen), *shaf* (: qafë), *zharpën* (: zhapsën) (f. 290-91). Dhe nxirrte përfundimin:

*“Është e besueshme që ky ndryshim fonetik të ketë ndodhur edhe në shqipen nën ndikimin e serbokroatishtes”.*¹¹⁶

Vërejtja e parë është e natyrës gjeografike: të folmet gege kanë mundur të marrin ndikime nga dy gjuhë të ndryshme sllave – nga maqedonishtja dhe nga dialektet e serbishtes. E folmja e Dibrës dhe e Gostivarit fliten në fqinjësi me maqedonishten, në Gostivar edhe me turqishten. Në këto të folme ndryshimet e tilla në maqedonishten nuk ndodhin. Nga ana tjetër, ndryshime të tilla ndodhin në gegnishtet që janë në kontakt me serbishten (në Kosovë, në Luginën e Preshevës), ashtu si të folmet në kontakt me maqedonishten (Kumanovë, Shkup, Tetovë, Gostivar, Dibër, etj.), pra kjo do të mjaftojë për të hetuar se nuk kemi të bëjmë me asfarë ndikimi. Për më tepër, në të folmen e Dibrës kemi [‘çetri, ‘ǰcera, ʃɛ, ʃǎL], por [džǎk, ‘džǎrpǎn, džǎft].

Vërejtja e dytë gjuhësore lidhet me qiellzorizimin e dhëmboreve në pozitë para zanoreve të përparme *i*, *e*, në rumanishten, ndërsa në shqipen në këtë pozitë ky ndryshim nuk ndodh asnjëherë dhe askund. Në të folmet në fjalë, e edhe gjithkund tjetër, kemi: *tetë*, *ditë* (ose *tēt*, *dīt*), pa asfarë qiellzorizimi. Në shqipen në fjalë, porse, ndodh një ndryshim tjetër. Grupi bashkëtingëllor *tj*, *dj* ka përfunduar në qiellzore, e prej këndeje, në disa të folme edhe në afrikate. Afrikatizimi ka ndodhur vetëm në ato të folme ku ka ndodhur edhe afrikatizimi i qiellzoreve të mirëfillta në tërësi.

Shpjegimin vijues do ta rimarrim të plotë. Në gegnishten veriore bashkëlidhja e qiellzorësisë të bashkëtingëlloret ka pësuar ndryshime. Në disa të folme të gegnishtes verilindore qiellzoret janë afrikatizuar: *tšen*,

¹¹⁵ Sa i pasaktë është mendimi i Mladenov-it tregon edhe fakti se nuk e hetonte dallimin midis frikatives shushuritëse alveoprelinguale *ś*, *ž*, mu siç nuk e shënonte ndryshim midis zanores të *xhasht* [dʒǎft] e *xhak* [džǎk].

¹¹⁶ “E probabile că această modificare fonetică să se fi produs și în albaneză tot sub influență sîrbocroată”.

džarpën (: *ćen, ġarpën*), porse në këto të folme grupi *kl, gl*, ka përfunduar në *k, g*. Në disa prej këtyre të folmeve grupet *tj, dj*, janë ruajtur si të tilla, ndërsa në të tjera (p.sh. në Gjilan) kanë përfunduar në afrikate *ç, xh*. Në të folmen e Preshevës, për shembull, si në Dibër, çështja qëndron mjaft ndryshe. Këtu palatalet e hershme kanë përfunduar në afrikate: *çen, xharpren*; grupet *kl, gl* kanë përfunduar në *k, g*: [me kajt, gūh]; grupet *tj, dj* kanë përfunduar në qiellzore: [ćetər, ʒāL]; qiellzoret janë ruajtur edhe në leksikon me origjinë orientale: [‘cymÿr, ća’miĭ, ġjez’diġ, ġjy’nāh]. Afrikatizimi i palataleve në këtë të folme ka ndodhur më herët se palatalizimi i grupeve *tj, dj* dhe i velareve të palatalizuara turke *k’, g’*. Në të folmen e Dushmanit çështja qëndron ndryshe. Atje qiellzoret janë frikativizuar: [śen, miś, ‘zarpën, źasht], porse kundërvënia e tyre me shushuritëset *sh, zh* është ruajtur: *miś/mish*, nga ana tjetër afrikatet janë ruajtur si të tilla. Në këto të folme është destabilizuar edhe pozita e qiellzores *nj*, që ose është identifikuar me majegjuhoren *n*, ose është zbërthyer në *ni*.¹¹⁷

Në lidhje me tezën e Brâncuș-it, do të themi gjithashtu se në të folmet serbokroate që janë në kontakt me shqipen ndryshimet që mund të krahasohen me të shqipes janë të diversifikuara, në disa prej tyre ndodh njësimi i qiellzoreve me afrikatet, në disa të tjera kundërvënia ruhet në kuadër të butave dhe të fortave. Kështu kemi:

serbisht: č, dž	ć, đ
shqip:	ç, xh q, gj

Në Mal të Zi nuk përjashtohet mundësia e ndikimit të shqiptimit të afrikateve si më të forta dhe pak më të përparme, kështu që është ruajtur më mirë distanca e afrikateve me palatalet. Në shumicën e të folmeve të Kosovës kemi shkrirje, ndërsa në të folmen e Preshevës kemi rivendosje të dallimit për pasojë të asimilimit të grupeve *tj, dj* në *q* [ć], *gj* [ʒ] dhe të ndikimit të turqishtes (palatalja ruhet mirë në huazimet turke): *qetër* [‘ćetər] *tjetër, ġjeg* [ʒġg], *ġjath* [ʒaθ] për *djeg, djathë*, por *xharpën* [‘džārpən], *xhashtë* [džāšt], *ndreçi* [‘ndrečġi], *dreç* [drġč], ndërsa *Qerim* [ce’rġm], *qef* [ćġf], *Gjyndyz* [ʒün’düz], *ġjegġef* [ʒer’ġġf].

¹¹⁷ Shih Cimochofski 1954.

Sadoqë kemi të bëjmë me dy pika të ndryshme nyjetimi, edhe mënyrë të ndryshme nyjetimi, në shqipen e në serbishten, ato nëpër të folme të ndryshme të këtyre gjuhëve përfundojnë në një, megjithatë në një të ndryshme. Raporti i këtyre fonemave ndaj grupeve *tj, dj* në një të ndryshme. Raporti i këtyre fonemave ndaj grupeve *tj, dj* në një të ndryshme. Pra edhe lidhja midis këtyre ndryshimeve në këto dy gjuhë nuk ekziston. Më në fund këtë e tregon edhe shtrirja e tyre gjeografike. Pra, s'kemi të bëjmë me tendenca të trashëguara nga asfarë substrati i lashtë.

Këtu do të diskutojmë edhe dy pika të tjera në fushë të ndryshimeve të dy gjuhëve, që Brâncuș-i donte t'i lidhte me ndikimin e substratit. Bashkëtingëlloren *h* Brâncuș-i dhe disa gjuhëtarë të tjerë rumunë në rumanishten e shohin jo ndikim të gjuhëve sllave, po të substratit. Këtë e mbështesnin në krahasimin me disa fjalë të shqipes: *hamës – hameș, hut – hututui*. Më tutje Brâncuș-i shtonte se *h*-ja është shprehje e frymëtimit nistor para zanoreve në fjalë me origjinë të ndryshme, rum.: *harc, haripă, harmăsar, hasta, helesteu, hodaie, haină*; shq.: *hahu, harmëshuer, harmë, harushë, hecni, hoborr, hunazë*. Në raste të tjera thoshte se ndodh e kundërta: rum. *aiduc, arfa, artie, ot, maala, moor, paar, miai*; shq. *a, anan, arroj, eq, ko, saat, sho*. Numëronte edhe rastet e këmbimit të *h*-së me *f*: rum. *burduf, marfă, praf, stuf, virf*; shq. geg.: *dërsif (?) , glufë, nifem, shof*. Në rumanishten, pas tij, procesi është i vjetër dhe i përgjithshëm, ndërsa në shqipen karakteristik për gegnishten. Në shqipen këtë përpiquej ta lidhte disi me ndryshimin e vjetër *kt: ft* (lat. *ct, ft*). Nuk do shumë mend se kjo ka të bëjë me statusin fonematik të /h/, sa i përket shqipes. Për më tepër, nuk është i mundshëm asfarë përgjithësimi për gegnishten. Në të vërtetë, në gjuhën shqipe bashkëtingëlloret organizohen në bashkëlidhje të ndryshme në kuadër të sistemit kryesor. Kështu bashkëtingëlloret johundore hyjnë në bashkëlidhje të zëshmerisë:

të shurdhëta: p, th, f, t, s, sh, ç, c, k, q, -, h

të zëshme: b, dh, v, d, z, zh, xh, x, g, gj, j, -

Në këtë paraqitje vërehen zbrazëti vetëm në radhët e qiellzoreve dhe të pas velareve, (bashkëtingëllorja *h* është fërkimore, por fa-

ringale). Te qiellzoret, në rastet kur *j*-ja interpretohet si bashkëtingëllore fërkimore, kemi të bëjmë me një kundërvënie të mbylltoreve /q-gj/ ndaj fërkimores së vetme /j/. Pra, *j*-ja nuk ka pandan të shurdhët, nuk hyn në ndërlidhninë e zëshmërisë. Prandaj edhe ndodh që të kemi në disa të folme këmbimin e të shurdhëtës qiellzore *q* në të zëshmen fërkimore *j*. Te velaret kemi gjithashtu vetëm mbylltore. Fërkimorja *h* nuk është velare, por lidhet me to si fërkimore dhe si e shurdhët. Megjithatë, as ajo nuk ka kundërvënie të zëshmërisë. Në rastet kur këto lidhje janë interpretuar si të forta, asaj i është krijuar e zëshmja velare, si në disa të folme të arbëreshëve të Italisë. Në rastet e tjera ajo ka mbetur jashtë sistemit kryesor, e paintegruar. Duke mbetur jashtë sistemit kryesor, dhe duke mos pasur lidhje të tjera me grupin e të tingulltave, apo me gjysmëbashkëtingëlloret, ajo ka mbetur joekonomike. Në një situatë të tillë ka ndodhur që në shumë të folme të zhduket fare. Kjo ka ndodhur kryesisht në të folme toske, por edhe në ndonjë të folme gege. Pikërisht pse nuk është këmbyer apo transfonologjizuar, procesi i zhdukjes së saj zgjat aq shumë. Tendencën drejt rënies e hetojmë qysh te disa autorë të vjetër. Në ato të folme ku është zhdukur funksioni i saj dallues ndodhin procese të tilla që të dalë si frymëtim atje ku s'është etimologjike. Në rastet e tjera, ajo ka pësuar ndryshime në pozita të dobëta në rrokje. Ose është këmbyer me *f* në fund të fjalës a në fund të rrokjes, ose ka pësuar ndonjë përngjashmim nën ndikim të rrethit fonetik. Në të folmet e shqipes kjo është e qartë: në të folmet sistemi i të cilave ka *h* nuk mund të kemi *ana* për *hana*. Pra, s'kemi të bëjmë me kurrfarë substrati. Mbase edhe në rumanishten kemi të bëjmë me diçka të ngjashme. Duke mos pasur sistemi *h*, nga numri i madh i leksikut të huazuar me *h* më të fortë, siç është ajo e sllavishtes, u krijua një destabilizim, i cili pati për pasojë një qëndrim të tillë të përgjithshëm në rumanishten. Atje madje hynë edhe fjalë me grupe si *hr-*, që janë të mundshme vetëm nëse *h*-ja, është e fortë, si në sllavishten.

Në këtë pikë Brâncuș-i trajtonte kundërvënien *r-R* në shqipen dhe në rumanishten, ku është shfonologjizuar para huazimeve turke, siç vë-

rente M. Sala në shënimin që citonte Brâncuș-i (Sala 1970: 55). Kjo në rumanishten ka lënë pasoja me rëndësi në sistemin zanor. Ai më tutje tregonte se edhe në shqipen ekziston një ndryshim i tillë, në gegnishten dhe në toskërishten, dhe shtonte se në fillim të fjalës *rr*-ja zhduket më vështirë.

Kundërvënia sasiore e dy dridhëseve në shqipen është e vetmja e tillë në këtë sistem bashkëtingëllor. Ajo konsiston në numrin e dridhjeve, po edhe në intensitet. Në sistemin e shqipes kjo kundërvënie nuk është fare e integruar e as ekonomike: një tipar i veçantë bashkëtingëllor dallon vetëm dy fonema, ndërsa tiparet e tjera janë shumë ekonomike. Për këtë arsye në të folme të shqipes kanë ndodhur ndryshime në drejtime të ndryshme. Në disa të folme kundërvënia është shfonologjizuar dhe është krijuar një numër homonimesh, në disa të tjera kanë ndodhur ndryshime në nyjëtimin e *rr*-së së fortë. Kështu, në qytete, si në Berat, Korçë, Përmet, Vlorë, Gjirokastrë, po edhe në Pejë, në Dibër, etj. Në të folmen e Gjakovës, nga ana tjetër, ndryshimi ka shkuar në drejtim tjetër: aty kundërvënia është ruajtur, porse *r*-ja e dobët ka kaluar në [*r*] të tipit *flapp*, pra jo me dridhje, po me rënie të majës së gjuhës, dhe me dalje të ajrit pjesërisht anash. Në të folme të tjera kundërvënia është ruajtur mirë. Atje ku është zhdukur kundërvënia ndodh që të kemi forcime ekspresive në fillim të fjalës, ose edhe ngatërrime të pritura si hiperkorreksion. Ekziston një ndryshim i madh në zhvillim midis shqipes e rumanishtes për faktin se në shqipen zhdukja nuk ka lënë pasoja në sistemin zanor.

Në fund, të themi se nga gjithë kjo del qartë që nga përafrimi midis shqipes dhe rumanishtes në zhvillimin e tyre të vonë nuk mund të nxjerrim ndonjë përfundim me rëndësi për afrinë e tyre sipas substratit. Këto ndryshime nuk janë më të ngjashme se shumë ndryshime midis shqipes dhe, ta zëmë, gjermanishtes, apo anglishtes, apo frëngjishtes, me të cilat s'mund të supozohet ndonjëfarë substrati i përbashkët. Në disa pika sistemi fonetik i shqipes është shumë i afërt me të rumanishtes, ashtu siç është i afërt edhe me të maqedonishtes, të greqishtes, të serbishtes, të bullgarishtes. Kjo është ajo që quajmë domen ballkanik, afërsi në mënyrë të foluri në një rajon. Nga ana tjetër, ka elemente që këto dy gjuhë i largojnë mjaft nga njëra tjetra, madje më shumë se gjuhët që ndër vete janë të lar-

gëta gjeografikisht dhe përnga bijëria. Shqipja ka zanore hundore, siç kanë pak gjuhë në Europë (frëngjishtja, portugjishtja e polonishtja),¹¹⁸ ka zanore y, ka bashkëtingëllore ndërthembore, ka tjetër lloj theksi nga rumanishtja, etj. Po të vepronim mbi baza të tilla, edhe shqipen edhe rumanishten do t'i gjenim të afrueshme me ndonjë farë substrati me shumë gjuhë në botë. Veç kësaj, për gjendjen e sotme të studimeve, është pak e deplasuar të flitet për dofare tendencash që na paskan ruajtur gjuhët nga ndonjë substrat si ndonjë shpirt feniksi. Fakti se është një numër fjalësh në rumanishten, që i ka edhe shqipja, nuk tregon shumëçka për atë substrat. Është më e mundshme që një pjesë prej atyre elementeve të jenë nga adstrati. Më në fund, në shqipen ato përbëjnë një pjesë të leksikut indoeuropian të shqipes për një kohë të gjatë shumë produktiv, ndërsa në rumanishten megjithatë ai është leksik joqendror. Ka mundësi gjithashtu që një pjesë e fjalëve të tilla të ketë qarkulluar nga një gjuhë a dialekt në tjetrën qysh në lashtësi, nëse janë të lashta, kështu që është e vështirë të saktësojmë se prej nga vijnë. Fjalët që kanë transparencë strukturore fjalëndërtuese brenda shqipes, pas gjasësh, duan parë si me burim prej saj. Prej gjithë kësaj del se nuk mund të ketë gjë as nga pohimi vijues i Brâncuș-it: ndryshimet fonetike që u shënuan për të dy gjuhët nuk duhet të shpjegohen vetëm përmes një veprimi të vonë të substratit, po nga fakti se rumanishtja dhe shqipja, të ndryshme përnga prejardhja, të afra përnga substrati e të zhvilluara në mjedis të përbashkët, kanë arritur

“të ngjajnë shumë si strukturë fonetike dhe, për pasojë, të zhvillojnë, në mënyrë të pavarur, shumë tendenca identike dhe të reagojnë në të njëjtën mënyrë ndaj ndikimeve të jashtme”(Brâncuș 1977: 292),¹¹⁹

prej të cilave s'ka gjë. Prej atëherë kjo bindje ka ardhur duke m'u forcuar.

¹¹⁸ Transformimi dhe bjerrja e hundorsisë së zanoreve brenda shqipes së arealit jugor ka lënë pasoja dhe në diferencimet dialektore.

¹¹⁹ “... să asemene foarte mult ca structură fonetcă și, ca urmare, să dezvolte, independent, o mulțime de tendințe identice și să reacționeze în același fel la influențe externe”.

Poghirc-u për substratet

Cicerone Poghirc-u, gjithnjë në dijëni me ç'kishte pohuar Brâncuș-i në studimet e tij, lidhur me këto çështje ishte shprehur disa herë. Le të shohim ç' thoshte ai më 1977 në revistën bullgare *Linguistique balkanique* (Poghirc 1977: 83-87).

Sipas Poghirc-ut, tiparet e përbashkëta të gjuhëve ballkanike janë shpjeguar në mënyra të ndryshme: si të trashëguara nga substrati, apo me prejardhje nga adstrati, superstrati; si zhvillime të brendshme, sipas ligjësive të përgjithshme, etj. Por, sipas tij, asnjëherë një fakt gjuhësor nuk ka një shpjegim të vetëm. Shpesh për ballkanizmat kërkohet një shpjegim i vetëm. Sandfeld-i avanconte idenë e ndikimit grek. Të tjerë, për balancim, kanë vënë në pah ndikimin e romanitetit ballkanik (Rosetti), të shqipërisë (Çabej, Domi, *Studia albanica I* 1975: 81-89), të sllavishteve jugore (Georgiev, Seidel, etj), e madje edhe të turqishtes. Mendonte gjithashtu se është harruar sot elementi që sipas themeluesve Miklosich, Hasdeu, Weigand, përbënte shkaku themelor: ndikimi i substratit. Në pjesën e parë të sh. XX linguistët, të mbështetur në studimet për faktet gjuhësore të Ballkanit të lashtë që ishin në fillim, nuk shiheshin të kënaqshme shpjegimet përmes substratit, sepse nuk shpjegohej dot *ignotum per ignotus*. Por, sipas tij, edhe shpjegimet *per notum* që nuk u përgjigjen realiteteve nuk janë shkencore, po ashtu (Poghirc 1977: 83). Lashtësia na ka transmetuar nga gjuhët e Ballkanit verior një numër të mjaftueshëm të dhënash për të mos pohuar më se substrati trako-ilir është krejtësisht i panjohur: mbi 100 glosa, rreth 1500 toponime e mbi 2500 antroponime trako-ilire; në gjuhët moderne rreth 1000 fjalë autoktone në shqipëri, së paku 200 fjalë të substratit në rumanishten dhe disa duzina në bullgarishten, e këtyre u shtohen toponimet e trashëguar nga antikiteti. Rritja e trakologjisë në deceniet e fundit na lejon ta rimarrim çështjen e ndikimeve të substratit në krijimin e tipareve të përbashkëta të gjuhëve ballkanike. Sipas Poghirc-ut, duhet të qëndrojmë larg idesë që të gjithë ballkanizmat apo shumica e tyre të shpjegohen përmes substratit, apo se ndonjë tipar ka burim të vetëm substratin. Nuk është fjala për një substrat të përbash-

kët, po për më shumë të tillë dhe të ndryshëm: trashëgimi autoktone (ilire me elemente dako-meze?) në shqipen, substrat dako-mez (pa i përjashtuar elementet ilire e trakase) në rumanishten, trakase e meze në bullgarishten, pellazgjike në greqishten, etj. (Poghirc 1977: 84). Të ndryshme, gjuhët e Ballkanit të lashtë kishin tipare të përbashkëta, sidomos në leksik, por edhe në bazën e nyjetimit dhe në sintaksë. Mund të flitet për një union gjuhësor ballkanik në lashtësi, kur në Ballkan kishim gjuhë IE shumë më të afra midis tyre se gjuhët e Ballkanit sot. Do vënë re shkalla e ndryshme e ndikimit të këtyre substrateve: për shqipen, ajo që është ‘substrat’ për të tjerat këtu përbën vetë thelbin e gjuhës; në rumanishten ndikimi i substratit ka ndodhur midis sh. II e VII, ndërsa në bullgarishten ka zgjatur jo më shumë se dy shekuj; në greqishte, po të lëmë anash substratin ‘pellazgjik’ (që ka aq shumë tipare të përbashkëta me trakishten), kemi të bëjmë më parë me një adstrat ballkanik të vjetër në rajonet e Veriut. Mund të ketë ndodhur po ashtu që në fakt substrati i një gjuhe ballkanike moderne të ketë depërtuar në të tjerat në një kohë shumë të shkuar, sa që të mos mund të veçohet më nga tiparet e trashëguara (Poghirc 1977: 84). Sipas tij, nëse një fakt gjuhësor ballkanik vjen nga substrati dhe jo nga gjuhët moderne mund të përcaktohet në kushtet vijuese:

- nëse është dëshmuar në një prej gjuhëve të lashtësisë ballkanike, pos greqishtes;
- nëse ndeshet në gjuhët IE në mënyrë më të veçantë të lidhura me trakishten e ilirishten (frigishte, armenishte, baltishte, etj.);
- nëse fakti është i vjetër dhe prejardhjen e ka qartësisht në shqipen, në rumanishten apo në bullgarishten, pa pasur mundësi ta shpjegojmë përmes latinishtes e sllavishtes, apo si huazim të vonë nga një prej këtyre gjuhëve. Prova e parë është më e sigurta, por jo gjithnjë e mundshme; ekzistenca e dy argumenteve të fundit është po ashtu bindëse.

Ndër elemente që përmbushin kriteret e shqiptuar mund të numërohen:

- ka një numër fjalësh që me siguri janë të substratit, apo përkatësia e tyre në substrat është e besueshme. Fjalët panballkanike (së paku në tri gjuhë

jo të afra midis tyre) që ndeshen në lashtësi në rajonet trakase a ilire nuk janë të pakta dhe përbëjnë një provë me rëndësi për demonstrimin e një shtrese të substratit në leksikon ballkanik;¹²⁰

- elementet autokotne të shqipes aktualisht janë mjaft të përkufizuara; atje ku gjuhët e tjera ballkanike pajtohen me shqipen, pa pasur arsye të veçantë për huazim, mund të merret me mend një element substrati;¹²¹

- me shumë gjasë mund t'i atribuohen substratit në fonetikë disa fenomene;

- shumë studiues ka kohë që janë dakord të konsiderojnë që rum. *ă*, shq. *ë* e bullg. *ѣ* vijnë nga substrati; kushtet fonetike – varësia nga theksi, ndikimi i bashkëtingëlloreve fqinje, ashtu si lashtësia e fonemës në të gjitha këto gjuhë tregojnë se kemi të bëjmë me një fenomen të përbashkët, nga një burim i lashtë dhe jo nga ndikimi i një gjuhe në tjetrën, apo nga zhvillime spontane të pavarura; mendonte të kishte dëshmuar se oshilimi *a/e* në grafi në një sërë emrash të përveçëm trakas (dhe ilirë), në të njëjtat rrethana si në gjuhët ballkanike moderne, dëshmon për një tingull të këtij tipi në gjuhët e substratit (referonte: Poghirc 1961: 33-37); prejardhja trako-ilire e fenomenit dëshmohet dhe me faktin që, përveç rumanishtes, shqipes e bullgarishtes, ky tingull ndeshet pikërisht në Greqinë e Veriut,

¹²⁰ Kuptohet që të gjitha rastet e këtilla gjejnë dhe shpjegime autorësh të ndryshëm në raport me shqipen si të parme. *argea – ragal* (!), mak. e lashtë *ἀργελα*; *baltă – baltë*, dalm. *balta*, gr *βάλτη*, -a: trak. *Di-baltum* (bg. *balta* < sl. kom.); *buză – buzë*, bg. *buza*: trak. *Byzas*, ilir. *Buzos*, *Buzetius*; *Carpați – karpë*, bg. dial. *karpă*: dako-miz. *Καρπάτης ὄρος*; *mal – mal* e toponimet hungareze me -*mal*: dako-miz.: *Malvensis*, ill. *Malontum*, *Dimallum*; *strungă – shtrungë*, bg. *straga*, *srungă*, serbkr. *stru(n)ga(c)*, gr. *στρογγα*, top. mez. *Στρόγγες* (Poghirc 1977: 85)

¹²¹ *baç*, rum. *baci*, bullg. skr. *bač(o)*; *bajgëlë – balebă*, skr. *balega*, *balaga*; *bardhë – barz(ă)*, bg. *bardziv*; *kësulë – căciulă*, gr. *κατσῦλι*; *kopil – copil*, bg. *kopele*, gr. e re *κοπέλι*; *flojere, fyell*, rum. *fluiet(ă)*, ngr *φλονέρα*, skr. *frula*; *mushk – mușcoi*, v blg. *muška*; *shut(ë) – cuit(ă)*, *șut(ă)*, blg. skr. *šut*; *thark, cark – țarc*, gr. e re *τσάρκος*. *Nbaç*, rum. *baci*, bullg. skr. *bač(o)*; *bajgëlë – balebă*, skr. *balega*, *balaga*; *bardhë – barz(ă)*, bg. *bardziv*; *kësulë – căciulă*, gr. *κατσῦλι*; *kopil – copil*, bg. *kopele*, gr. e re *κοπέλι*; *flojere, fyell*, rum. *fluiet(ă)*, ngr *φλονέρα*, skr. *frula*; *mushk – mușcoi*, v blg. *muška*; *shut(ë) – cuit(ă)*, *șut(ă)*, blg. skr. *šut*; *thark, cark – țarc*, gr. e re *τσάρκος*. Në mjaft prej rasteve të këtilla ndeshim vështirësi apo shumësi interpretimi etimologjik dhe për mungesë të dhënash për kontekstet.

në rajonin që në lashtësi ishte ndikuar nga trakasit e ilirët;¹²²

- reduktimi i *e, o* në *i, u* në rrokje atone në rum., bullg. (në lindje) dhe në dialektet greke veriore mund t'i atribuohet po ashtu rolit të rëndësishëm të theksit të trashëguar nga epoka e lashtë, por me më pak siguri, sepse karakteri ,normal' i fenomenit si dhe mungesa e tij në shqipen dhe në lashtësi na bën të mendojmë se kemi të bëjmë më parë me një tendencë vetëm të gjuhëve të përmendura (në shqipen këto lidhen me ndryshimin e theksit: fiksimin e vendit të tij në rrokjen e fundit të temës, që Jokl e shihte afërsisht të kohës së fillimit të Epokës së Re);

- këmbimi / > r në rum., në shq., në greq. e rrallë në bullg. nga Miklosich-i i atribuohet ndikimit të substratit; shënimi nga C. Dumitrașcu (*Thraco-Dacica*, București 1976, 329-330) i një oshilimi të tillë në trako-dakishten e bën të besueshme hipotezën e Miklosich-it që një numër i mirë gjuhëtarësh e ka pranuar para provës së ekzistencës në trakishten (Poghirc 1977: 85).

Ndër ballkanizmat morfologjikë, sipas Poghirc-ut, substratit mund t'i atribuohen tiparet vijuese:

- konfuzioni gjinore-dhanore në shq., bullg. e rum., si për format sintetike ashtu dhe për analitiket;¹²³ as greqishtja nuk mund të veçohet; lashtësia e fenomenit në të gjitha këto gjuhë, ashtu si dhe ekzistenca e tij në frigjishten dhe në të afërt të tjerë të trakishtes (armenishte e iraniste) dëshmojnë se fjala është për substrat (Poghirc 1977: 85-86);

- disa herë e kemi vërejtur ekzistencën e pjesëzës deiktike *-ne* për akuzativin e përemrave ballkanikë (rum. *mine, tine, sine, cine*; shq. *mua* < **me-ne*, (referonte SCL XIII, 4, 1962: 491-495; Dacoromania I, 1973: 208), gr. e re (έ)μείνα e gr. e vj. έώωνη, τύνη, bullg. *мене*; indikativ është dhe fakti se të gjitha këto gjuhë kanë krijuar sistemin e kundërvënies së formave me *-ne* dhe pa të: rum. *mine/ mă*, shq. *ma/ me* (! *më*), gr. (έ)μείνα/

¹²² Ka shumë argumente që flasin qartë për proceset e brendshme të zhvillimit të shqipes me kronologji relative, pa pasur asfarë nevojë të postulohet asfarë substrati. Madje, lashtësia kaq e madhe duket vështirë e dokumentueshme.

¹²³ Më hollësisht për këto çështje shih Demiraj 1994: *Gjuhësi ballkanike*, ku mund të merren dhe shpjegime të tjera. Gjithsesi shpjegimi përmes zhvillimeve të brendshme duket më i motivuar.

με, bullg. *на мене/ ме*; lashtësinë e dëshmoka ekzistenca në gr. e lashtë, ashtu si prania e *-ne, -n* pas përemrit në mbishkrimet trakase (mbishkrimi i Ezerovos – *as-ne*; Kjolmen *as-n*) (Poghirc 1977: 86).¹²⁴

- prapavendosja e njëjës në shqj.; rum. e bullg. i atribuohet substratit; demonstrimi kategorik vështirë se mund të bëhet, sepse ky fenomen, që del nga pozita e përcaktorëve, mund të jetë prodhim i zhvillimit paralel, por të pavarur; siç ka treguar Georgiev-i (*Actes I Congr Balk, VI, f. 15-19*), kjo nuk ka mundur të ndodhte pa një shok nistor nga substrati, mendonte Poghiric-u;

- sa u përket ndërtimeve të shumta të ngurosura në gjuhët ballkanike (referonte Papahagi-n, Domin), në mungesë tekstesh të lashta në gjuhët e veriut të Ballkanit, është e vështirë t'i atribuohet diçka substratit;

- është e mundshme që konkordancat në përdorimin e parafjalëve kryesore në gjuhët e Ballkanit, sidomos midis gr., shq. e rum., të jenë nga substrati (referonte Asenova-n).

Këto janë faktet që me më shumë siguri mund t'u atribuohen ndikimeve të substratit ballkanik, mendonte Poghiric-u. Fjala është për një numër fjalësh, tingujsh e morfemash konkrete, por edhe për struktura mentale dhe tendenca zhvillimi që kanë mbrejtur markën e tyre përfundimtare në strukturat e gjuhëve ballkanike. Këto fakte autoktone karakterizojnë së pari shqipen e rumanishten; bullgarishtja hyn aty shpesh, por ajo ruan tipare specifike që mungojnë në gjuhët e tjera ballkanike; greqishtja ka gjithnjë një pozitë të veçantë, duke qenë e prekur sidomos në dialektet veriore.

Ndryshe nga ballkanizmat e tjerë, faktet e numëruar kanë depërtuar thellë në strukturën e gjuhëve ballkanike moderne, duke qenë elemente themelore të këtyre gjuhëve (Poghirc 1977: 86).

E qartë, shumë prej këtyre çështjeve janë diskutuar në raste dhe nga autorë të ndryshëm, ndërsa këmbëngulja te shpjegimi mbi bazë të një

¹²⁴ Për shqipen *mua/mue* nuk ka si të supozohet një paraformë **mene*, po kemi të bëjmë me **mōn*: pra, në pozitë të theksuar kemi zhvillimin **mōn > *mō > muo, mua, mue*, ndërsa në të patheksuarën **mōn > mθ*.

substrati gjithsesi të paspecifikuar vazhdon, për mendimin tim, të mbetet e pakonkretizuar dhe më shumë një koncept kallauz, se një shpjegim real. Mbi bazën e një konceptimi të atillë të substratit, ai përpqej të shpjegonte dhe raportet midis shqipes e rumanishtes, çka nuk i qëndron kritikës së përmendur të Çabejtë. Më konkretisht për këto mund të shihet edhe pjesa për raportet e shqipes me gjuhët e Ballkanit e këtij libri.

Tek *Istoria limbii române II*, 1969, Poghirc-u nxirrte përfundimin se elementet e substratit në rumanishten shtrihen edhe përtej të përbashkëtave me shqipen dhe nuk janë huazime prej saj, sepse, siç ka thënë më herët K. Treimer (në *Zeitschrift für romanische Philologie XXXVIII*, 1914, f. 387 e vijim), huazime me një peshë të atillë do të nënkuptonin epërsi qytetërimi. Kjo ndërkaq nuk ka ndodhur sepse të dy popujt kanë qenë barinj dhe bujqër. Prandaj kemi të bëjmë me prejardhje të përbashkët indo-europiane dhe lashtoballkanike

“... dhe jo përmes identitetit të substratit të gjuhës rumune me proto-shqipen” (Poghirc 1969: 365).¹²⁵

Brâncuș-i si ndikime të substratit trak gjithsesi dhe vetëm të tij shih-te ekzistencën e bashkëtingëllores *h-* në fillim të fjalës, kryesisht në bazë të fjalës së përbashkët me shqipen *hameș*.¹²⁶ Rotacizmin Brâncuș-i e shihte dëshmi të ndikimit të substratit trako-dak:

“...rotacizmi është reliket nga gjuha e ‘dakasve të lirë’, që mbijetuan deri në shekullin VI jashtë Dakisë, në veri dhe në jug të provincës së romanizuar. Duhet të mendohet që paraardhësit e toskëve (shqiptarëve të jugut), më vonë dhe të istrorumunëve, shtegtuan drejt jugut përkatësisht perëndimit nga hapësira e ‘dakasve të lirë’ e nga zonat përreth”.¹²⁷

¹²⁵ “... și nu prin identitatea substratului limbii române cu protoalbaneza”.

¹²⁶ *hamës*; këtë rast konkret ne na duket se duhet ta kundërshtojmë si ndërtim më parë kulturor, pra më të vonë, sepse, në të vërtetë, në shqipen popullore nga folja *ha* kemi ndërtimin [*hās*], jo *hamës*.

¹²⁷ “Der Verfasser vertritt die Ansicht, daß der Rhotazismus als Ergebnis des thrako-dakischen Substrateinflusses erklärt werden muß. Seiner Meinung nach ist der Rhotazismus ein Relikt aus der Sprache der ‚freien Daker‘, die außerhalb Dakiens, im Norden und im Westen der romanisierten Provinz, bis in das 6. Jahrhundert überlebten. Es ist

Tani, fenomeni i rotacizmit në toskërishten është i lidhur ngushtë me nazalizmin që vazhdon në gegnishten, pra me strukturën e rrokjes, por dhe në mënyrë pak më sporadike në rumanishten, konkretisht në istrorumanishten dhe në të folme të tjera dakorumune. Në këtë gjuhë kemi rotacizmin e *-l-* ndërzanore në *-r-*, që në asnjë rrethanë nuk ka si të ndër lidhet me zhvillimet e rotacizmit të shqipës. Shumë studiues rotacizimin e *n-së* së dobët në pozitë ndërzanore e kanë parë si fenomen substrati (Miklosich, op. cit.: 7; Hasdeu 1877: 88; Barić 1921: 117; Jokl, *ZRPh XLIV*, f. 50, Weigand *BA III*, f. 218-220, etj.). *ILR II* jepte këtë shpjegim: kemi të bëjmë me një realizim të veçantë të *n-së* së thjeshtë, çka shpjegohet brenda sistemit roman; edhe në shqipen ka pasur një zhvillim të ngjashëm (Coteanu, Bolocan, Caragiu-Marioțeanu, Drimba, Fischer, Iliescu, Isbășescu, Macarie, Mihăescu, Poghirc, Popescu, Sala, Stati (red.) 1969: 322).

Sa i përket rotacizmit, qysh në vitet '70 kishim sugjeruar një shpjegim, që supozonte zhvillime të mundshme brenda raporteve të caktuara sintagmatike, të mundshme në zhvillimet edhe brenda gjuhëve romane të hundores *n* në pozitë ndërzanore, pra, që mund të paraqitet si vijon (shih Ismajli 1971-2, rimarrë te Ismajli 1987: 184-192):

VnV > VrV : *bă*: [*bă:n*] – *bërë*; *ră:n(ë)* – *rërë* < *arēna*; *anmīk* – *armik* < *inimicus*;
nn > *n*: *gunna* > *gunë*, **han̄a* > *hanë*, **puṇa* > *punë*, **thanV* > *thanë*;
 në gjuhët romane:

1. *n* > *r*; *nn* > *n*;
2. *n* > *0*; *nn* > *n*;
3. *n* = *n* *nn* > *η*.

Për të shikuar edhe më qartë se kjo çështje nuk ka të bëjë me 'substrat', le të shohim pasqyrën e zhvillimit të bashkëtingëlloreve hundore (autorët flasin për të gjitha sonantet) në pozitë ndërzanore në gjuhët romane pas Fernando Sanchez Miret: *Manual de linguistica romanica*, f. 242:

anzunehmen, daß die Vorfahren der Tosker (Südalaner), später auch der Istroromanen, aus dem Gebiet der ‚freien Daker‘ und aus den benachbarten Bereichen nach Süden bzw. nach Westen abwanderten“. Brâncuș (1995), f. 116. Supozimin lidhur me ‚dakasit e lirë‘ dhe eventualisht lidhjen e tyre të prejardhjes së shqiptarëve të mëvonë nga ta e shohim krejtësisht të mjegulluar.

	NN	N	LL	L	RR	R
it.	nn	n	ll	l	rr	r
sard.	n	n	ɫɫ	l	rr	r
rum.	n	n, r	l	r	r	r
port.	n	∅	l	∅	r>R	r
cast.	ɲ	n	ʎ	l	r	r
cat.	ɲ	n	ʎ	ʎ	r	r
occ.	n	n	l	ʎ, w	r	r
fr.	n	n, ∅	l	l	r>R	r>R

Në portugalishten, kastilianishten, katalonishten ka dallim të plotë në reflekset e geminates në raport me të thjeshtën: nëse *-nn-* jep *-n-*, *-n-* jep \emptyset në portugishten, nëse *-nn-* jep *-ɲ-*, *-n-* ruhet në kastilianishten dhe katalonishten; në oksitanishten dhe në sardishten kemi rrafshim në *-n-*, ndërsa në frëngjishten dhe rumanishten kemi refleks të dyfishtë tek *-n-*: rum. *n, r*, fr. *n, ∅*. Vetëm në italishten është ruajtur gjendja e parme. Janë arsyet funksionale dhe strukturore ato që kanë ndikuar në mënyrë vendimtare në zhvillimet.

Manfred Trummer, nga ana e tij, tërë çështjen e shihte ndryshe (Trummer 1976: 17-19). Shqyrtimi sinkronik tipologjik nuk lejon që fonema /ǣ/ të shihet dhe kufizohet si specifike ballkanike, sepse shfaqet edhe në gjuhët fqinje, si turqishtja e serbishtja (grupi Prizren-Timok). Aty është edhe lidhja me fonemën /i/ në rumanishten dhe në lidhjet e saj historike me /ǣ/, e kështu pastaj do parë dhe raporti me sllavishten lindore /y/. Po u përfshinë turqishtja dhe sllavishtja lindore, duhet të largohemi në një masë nga hapësira ballkanike.

Për këtë ndryshim ka pasur dhe shpjegime të tjera, por asnjëherë nuk është abstraguar konteksti nazal dhe denazalizimi. Është pranuar përgjithësisht se në shqipen ky ndryshim do të ketë përfunduar rreth sh. VIII. Kronologjia në rumanishten mund të jetë e ndryshme.

Më tej në këtë libër Brâncuș-i vijonte me diskutimet që kishte zhvilluar dhe më herët për numërorët 11-19 në shqipen e rumanishten, tipar i përbashkët me sllavishten dhe me gjurmë në baltishtet, pra i rrafshit IE, për çka qysh nga Jokl-i është numëruar si pa ndonjë

lidhje ndikimi nga sllavishtja,¹²⁸ ashtu si momente të tjera lidhur me përdorimin e numërorëve. Nuk kemi shpjegim, ndërkaq, pse rumanishtja huazoi leksemën sllave (*sutǎ*) për numrin 100, ndërsa shqipja e ka marrë leksemën latine (*qind*, po edhe *mijë*).¹²⁹

Si elemente të padyshimta të ndikimit të substratit Brâncuș-i numëronte prapavendosjen e njëjës shquese në të dy gjuhët dhe disa çështje të renditjes së përcaktorëve, ashtu si mungesën e njëjës tek emrat që parashkohen nga një parafjalë (*trece pe drum - kalon në rrugë*), përveç në rastin e parafjalëve rumune *cu*, shq. *nga* e *te*, që kërkojnë njëjë, çka do të bëhet më vonë objekt diskutimesh të veçanta te Joseph Brian pikërisht lidhur me substratin. Në përgjithësi duket se në përkimet në fushën sintaksore Brâncuș-i gjente një rrugë shpjegimi përmes thënies vijuese:

“Rumanishtja dhe shqipja tregojnë një prirje të posaçme për prapavendosjen e pjesëzave të patheksuara (trajtat e shkurta të përemrave dhe të foljeve ndihmëse), të cilat i shtohen fjalës paraprijëse” (Brâncuș 1995: 118.),¹³⁰

çështje që mund të gjenden të komentuar nga Sh. Demiraj në veprat *Histori e shqipes dhe Gjuhësi ballkanike*.

Brian Joseph në *Romanian and the Balkans: some Comparative Perspectives*, merrej me veçoritë sintaksore të parafjalëve në rumanishten në raport me substratin e mundshëm. Në fakt ai diskutonte përdorimin e parafjalës rum. *din* (nga) në shembuj si *din cladire* ‘nga një ndërtesë/ ndërtesa’, normalisht vetëm me frazë nominale të pashquar si objekt, ndërsa parafjala *cu* (me) kërkon njëjës shquese për një objekt nominal të pamodifikuar dhe lejon njëjës shquese për objektin e modifikuar: *cu prietenul*, jo *cu priten*. Meqë nuk gjen arsye sinkronike për një sjellje të tillë, kërkon krahasime me shqipen, ku parafjala *me* jozakonshëm kërkon

¹²⁸ një-mbë-dhjetë/ jedan-na-deset/ un-spre-zece.

¹²⁹ S. Paliga shkante edhe më larg dhe numërorin *sutǎ* nuk e binte të huazuar nga sllavishtja *сто*, po të kundërtën.

¹³⁰ “Das Rumänische und das Albanische zeigen eine besondere Neigung für die Nachstellung von unbetonten Partikeln (Kurzformen der Pronomina und der Hilfsverben), die an das vorausgehende Wort angefügt werden”.

një objekt të shquar. Kërkonte kontrastimin e *pa* dhe *me*: *pa sheqer, pa mjetet (!)*; *me shqiptarët*, por e dyshon **me shqiptarë (!)*, ndërsa, si në rumanishten, shqipja lejon objekte të pashquara me *me* kur emri është i modifikuar: *një lëvizje me karakter politik*. Avancoje idenë se pajtimi midis rumanishtes e shqipes lidhur me një anomali sinkronike që involvon parafjalët dhe shquarësinë që është e nevojshme të shpjegohet diakronikisht. Një paralele si kjo duket tepër e saktë për të qenë e rastit, prandaj duket huazim apo kalk nga një gjuhë në tjetrën, po shumica e paraleleve strukturore midis dy gjuhëve janë të natyrës ballkanike, pra të konvergjencës, apo janë latine. Por këtu ai shihte diçka nga substrati, pikërisht duke u nisur nga ideja që substrati shfaqet më shumë në çështje fonetike dhe të sintaksës. Këtu sillte në mendje idenë e Hamp-it (1989: 47), se “*historically Romanian is Latin spoken with an Albanian stress system*” (“historikisht rumanishtja është latinisht e folur me një sistem theksor shqip”), duke konsideruar që latinishtja e vonë danubiane e Dakisë do të jetë filtruar nëpër gramatikën e një grupi të folësve të proto-albanoidishtes. Këtë ai e shihte në shtrëngesat e vendosjes së theksit dhe të ndryshimit të theksit, me ç’rast të dy gjuhët kanë theks në rrokjen fundore të temës së leksemës, kështu kur shtohet një prapashtesë theksi zhvendoset në të djathtë, si me rastin e *-tor* agentive në shqipen dhe *-tor* adjektivale në rumanishten, por jo në rastin e shtesës së dativit shumë *-eve*, përkatësisht dativit njëjës *-lui* apo femërores njëjës *-e* në rum.: *katúnd/ katúndeve, púnë/ punëtór – punëtóreve; cîine/ cîinelui – a folosí/ folositór*. Këto mund të konsiderohen ndikim i substratit në rumanishten në kohën kur folësit e proto-albanishtes kalonin në latinishten e folur në Daki. Fakti se kemi një paralele sintaksore dhe një paralele theksore është shumë sugjektiv për substratin dhe këtë e bën krejt plauzibël fakti se janë përfshirë vetëm dy gjuhë.

Në përgjithësi, brezi i përmendur i studiuesve rumunë ngul këmbë te mohimi i mundësisë së ndonjë ndikimi të shqipes në rumanishten sa u përket elementeve të përbashkëta të dy gjuhëve. Kjo do të diskutohet konkretisht lidhur me kundërshtimin e këtij qëndrimi nga S. Schumacher-i më poshtë.

Në studimet shqiptare me raportet midis shqipes e rumanishtes janë marrë E. Çabej, M. Domi, S. Floqi, E. Lafe, Sh. Demiraj, B. Bokshi, B. Demiraj, autori i këtyre radhëve, I. Arapi, etj. Çabej kishte theksuar:

“Shqipja dhe rumanishtja kanë lidhje të ngushta në fushën e fonetikës, të morfologjisë, të leksikut, të formimit të tingujve, të sintaksës dhe frazeologjisë, të mënyrave të të thënit dhe të lokucioneve proverbiale, saqë – pa i harruar veçantitë – krijohet përshtypja se fjala është për një frymë të vetme të gjuhës të manifestuar në dy forma... Besoj se këto raporte mund të vlerësohen drejt vetëm kur të vështrohen në kuadër më të gjerë të relacioneve kulturore midis këtyre dy popujve”. (Çabej 1959: 531).

Reminishencat kopitariane e më vonë të sh. XIX me ‘frymën e vetme’, por me dy forma të gjuhës në këtë rast nuk duan koment.

Duke kundërshtuar në mënyrë të vendosur implikimet e teorive të përmendura të gjuhëtarëve rumunë për vendin e hershëm të shqipes, duke saktësuar se sa i përket shqipes nuk mund të bëhet fjalë për substrat, sepse këtu nuk kemi të bëjmë me ndryshim gjuhe, duke theksuar se mungesa e dëshmimeve të gjuhëve të lashta të Ballkanit nxjerr vështirësi për atribuimin e fjalëve të mëvona për cilëndo prej tyre, duke vënë në pah se ndër elementet e përbashkëta midis këtyre dy gjuhëve do bërë një shtresëzim kohor, Çabej avanconte idenë vijuese:

“degët e skajit më verilindor të etnosit shqiptar... në mesjetën e hershme, pas gjase një kohë ende para dyndjes sllave, kanë qenë në një fqinjësi të pandërmjetme, fqinjësi kontakti, me degët e skajit më jugperëndimor të etnosit rumun, dhe kjo lidhje u ushqye më tej edhe me anën e transhumancës të barinjve shtegtarë”.

Kontakti i atillë ka qenë mjaft intim dhe madje diku-diku ka shkuar deri në simbiozë. Dhe ideja e simbiozës (jo vetëm me romanë, po edhe me sllavë) ka qenë e pranishme edhe tek autorë të tjerë qysh nga shekulli XIX e sidomos në gjysmën e parë të sh. XX, për shembull te Šufflay.

Ne më 1983 (Ismajli 1983, rimarrë në Ismajli 1987, ff. 57-71), në vijën e Çabejtë, lidhur me ato studime kishim bërë disa vërejtje, ndër to dhe: emërtimi i substratit të supozuar është herë ‘*dakishte*’, herë ‘*trako-dakishte*’, herë ‘*trako-dako-getishte*’, herë ‘*trako-dako-geto-mezishte*’, çka

krijon paqartësi; nuk dihet se cilës prej gjuhëve paleoballkanike i takonin fjalët që merren si të substratit; romanizimi në Ballkan kishte përfshirë të gjithë, nuk bënte seleksion etnik; nëse në rumanishten u ruajtën vetëm elemente të caktuara nga substrati, ndërsa në rastin e shqipes kemi vazhdimin e njasaj gjuhe që u bë substrat, si mund të ngremë pretendimin që vendi i formimit të shqipes ishte pikërisht vendi ku mbisundoi një gjuhë romane?; sa u përket raporteve leksikore, me rëndësi është fakti nëse ato hyjnë në vorbull etimologjik, të fjalëformimit e të prodhimtarisë kuptimore; disa prej atyre fjalëve mund të jenë të huazuara nga shqipja, disa nga rumanishtja, disa nga ndonjë gjuhë tjetër, pra do bërë diferencim kronologjik, diferencim për sa i përket burimit, etj.; ka dhe huazime krejt të vona nga shqipja, ose nga rumanishtja, apo me rrugë të tretë, etj.

Sa u përket elementeve të strukturës, ishte bërë vërejtja se shpesh ato i visheshin substratit pa argumentim, sepse nuk kishte shpjegim tjetër; lidhur me sistemin fonetik ishin vënë në pah dallimet jo të vogla të të dy sistemeve: shqipja ka zanore [y], ka vetëm një [ë], ka gjatësi zanoresh në veri, më herët ka pasur edhe në jug, ka hundorësi zanoresh në veri; rumanishtja nuk ka gjatësi zanoresh, nuk ka [y], ka dy zanore qendrore [ă, î] (të ngritjes së mesme dhe të ngritjes së lartë), nuk ka hundorësi, por ka diftongje të mesme [ea, oa], ka palatalizim; shqipja ka ndërdhëmbore, ka *h*, bën dallimin funksional *l/L, r/rr*; ishte bërë shpjegimi për rotacizmin si fenomen i ruajtjes së dallimit midis dy majoreve hundore me funksion fonematik, që ngjet edhe gjetiu në botën romane, por me rezultate të ndryshme, etj. Të gjitha këto flasin ndryshe nga ç'sugjeron ideja për *'frymën e njëjtë'*. Ishte vënë në dyshim shpjegimi përmes substratit, sakohë që kemi shpjegime të arsyeshme gjuhësore brenda zhvillimeve normale. Njësoj ishin vënë në dyshim *'tendencat'* e trashëguara nga substrati, të vëna madje në kontekste fare të pamundshme me dialekte sllave jo të afërta, pra duke përdorur të dhëna të pasakta. Sa i përket prapavendosjes së nyjës ishte parapëlqyer shpjegimi i Bokshit në kuadër të zhvillimeve të sintagmës nominale e të grupit nominal në raport me renditjen në një kohë kur lëvizja ishte e mundshme në shqipen, e kur në romanitetin ballkanik që po bëhej rumanishte kishte lëvizje (Ismajli 1987: 74-85).

Desnickaja në fillim të viteve '90 (Desnickaja 1991, 5-12) shprehte mendimin se rrjedhat dhe veçoritë e pasojave të kontaktit të rumanishtes e shqipes duan shikuar nga prizmi i afrisë gjuhësore të karakterit dytësor që del si rezultat i proceseve të caktuara etno-historike të mijëvjeçarit të parë. Një ide të ngjashme ajo e kishte zbatuar dhe për shqipen në jug më vonë lidhur me diferencimin midis labërishtes e toskërishtes në bazë të një 'substrati sllav' të supozuar në të dytën, ndërsa këtu ngulte këmbë te kompleksiteti i situatës: baza ilire e shqipes gjen raporte në elementet e substratit (dako-mezisht, dako-trakisht) të gjuhëve romanolindore, ndërkohë që komponenti roman i leksikut të shqipes ndërlihet për tipare të rëndësishme me bazën latine të idiomave romanolindore. Ajo kishte shprehur dhe mendimin sipas të cilit elementi latin i shqipes në njëfarë dore kishte edhe aspektin e substratit (Desnickaja 2001: 181-192).

Të përmbledhim mëtesat themelore për raportet e këtilla në fushën e strukturës

Për të bërë një paraqitje më sistematike dhe të plotë të mëtesave të diskutuara lidhur me elementet e përbashkëta midis shqipes e rumanishtes le të marrim si pikënisje veprën *Istoria limbii române*, București 1978, të hartuar nga grupi i Ministrisë së Edukimit dhe Mësimdhënies, nga universitetet e Bukureshtit e të Kluzhit: Florica Dimitrescu, Viorica Pamfil, Elena Barborică, Maria Cvasnii, Mirela Theodorescu, Cristina Călărașu, Mihai Marta, Elena Toma, Liliana Roxândoiu, me koordinator Florica Dimitrescu, më tej do t'i referohemi si Dimitrescu & Alii. Problematika që na intereson këtu përmbledhej atje në disa pjesë. Tek kapitulli *Elementi autokton* i rumanishtes së përbashkët fillimisht vlerësohej se njëri ndër problemet më të diskutuara është raporti i substratit, roli i elementit autokton në etnogjenezën e gjuhës dhe të popullit rumun, kështu që del me rëndësi të identifikohen elementet e tilla në strukturën e gjuhës rumune. (Dimitrescu & Alii 1978: 65). Si dije që duhet t'u jepet studentëve të gjuhës rumune grupi i autorëve të dy universiteteve të mëdha rumune që në të kaluarën

kanë pasur dhe ide divergjente, propozonte qysh në fillim t'u jepej kjo që veçoritë specifike të rumanishtes t'i atribuoheshin gjuhës së popullatës autoktone të pushtuar dhe të asimiluar nga romanët, siç kishte menduar B. Kopitar, ide që ndeshen dhe ndër studiues të tjerë të huaj (W. Tomaschek, P. Kretschmer, F. Miklosich, G. Meyer, H. Schuchardt, D. Dechev, V. Georgiev, G. Reichenkron, etj; referonin për listën më të gjerë tek I.I. Russu, *Elemente autoktone* dhe A. Vraciu: *Studii de lingvistică generală*, București 1972, 91-115). Ndhimesa të rëndësishme lidhur me trashëgiminë autoktone të gjuhës rumune kanë dhënë specialistët e shquar rumunë (B. P. Hasdeu, G. Tocilescu, A. Philippide, O. Densusianu, V. Pîrvan, T. Capidan, S. Pușcariu, G. Giuglea, A. Rosetti, I. I. Russu, G. Brâncuș, A. Vraciu, G. Ivănescu, etj.), çka është e kuptueshme, ndërsa ndarja e studiuesve 'të huaj' nga 'tanët' në shkencë, e zakonshme në vendet ish-komuniste, sikur shkon bashkë edhe me mospërmendjen kështu në radhë të parë lidhur me çështje si këto të ideve të dijetarëve shqiptarë apo të tjerë që mund të mos u kishin pëlqyer lidhur me vendin e formimit të hershëm të rumanishtes apo për ndonjë arsye tjetër (Çabej, Domi, Jokl, Mihănescu, Tamás, Tagliavini, Desnickaja, etj.).

Hulumtuesit e viteve të fundit, thonë autorët më tej,

"kanë vërtetuar dhe plotësuar tezën për ekzistencën e elementeve autoktone (pararomane) në strukturën e gjuhës rumune, mbi të gjitha në fushën e leksikut, por edhe në pjesët e tjera të gjuhës" (Dimitrescu & Alii 1978: 65).¹³¹

Dhe me kënaqësi raportonin se rezultatet më të reja në 'deshifrimin e trashëgimisë së stërlashtë trakase' janë komunikuar në Kongresin e parë ndërkombëtar të trakologjisë, Sofia 1972, ndërsa si më të vlershmet i cilësonte ndihmesat e I. I. Russu (*Limba traco-dacilor*, 1967) dhe kapitujt *Elemente autohtone* dhe *Influența autohtonă* të

¹³¹ "au verificat și completat teza existenței elementelor autohtone (preromane) în structura limbii române, mai ales în domeniul lexicului, dar și în celelalte compartimente ale limbii" dhe këtu referojmë: Russu 1967; Russu 1970; Poghiric në *Istoria limbii române II* 1969: 314-366.

Istoria limbii române II 1978 (pjesa përkatëse e hartuar nga Poghirç). Kuptohet që ngulej këmbë tek dëshmimi se rumanishtja është gjuhë romane dhe se dallimet në zhvillim që ajo ka sjellë në raport me gjuhët e tjera romane i detyrohen pikërisht substratit tjetër të saj nga ai i gjuhëve të tjera romane.

Cili është materiali gjuhësor dak, sipas tyre? Materiali gjuhësor që na ka mbetur nga popullata autoktone është i varfër: disa glosa, emra të përveçëm dhe mbishkrime.

1. Ndër glosa numëroheshin 57 emra bimësh mjekësore të përmendura në dy traktate të botanikës mjekësore (të mjekut grek Dioskorides sh. I i Erës sonë dhe tek traktati anonim i fundit të sh. III i cituar si Pseudo-Apuleius). Shpjegonin se glosat dakase (geto-dakase, apo trakase, a ka gjë ngatërruese në këtë rrëmujë emërtime?) në tekstin e Dioskoridi-t do të jenë shtuar mbase në fund të sh. III, ndërsa tek Pseudo-Apuleu në sh. IV. Arsyet e përdorimit të tyre në tekste latine/ greke qëndrojnë, sipas tyre, në interferencën gjuhësore të kësaj periudhe. Vlera gjuhësore e këtyre fjalëve është e reduktuar, sepse shumë pak prej tyre janë zbërthyer etimologjikisht, të tjera paraqesin forma të korruptuara, tek disa është e pamundur të rindërtohet forma autentike, etj. (Dimitrescu&Alii 1978: 66-67).
2. Emrat e njerëzve, të fiseve, të perëndive, të vendeve, të ujërave e të maleve të ruajtura tek autorët e lashtë apo në mbishkrime greke a latine e në monedha përbëjnë korpusin e kësaj trashëgimie: rreth 2050, prej të cilave 1150 janë antroponime, ndërsa 900 toponime.
3. Rreth 30 mbishkrime dakase me shkronja greke vetëm me bashkëtingëllore, mjerisht ende të padeshifruara. I pazbërthyer ka mbetur edhe mbishkrimi në unazën e artë të zbuluar në Ezerovo (Bullgari) më 1912 me 61 shkronja në 8 radhë *scriptio continua* (Shih dhe Ismajli 1987).

Ndër të paktat mbishkrime dakase përmendet ky: *Decebalus per Scorilo* në një vazë të qeramikës të zbuluar në ruinat e Sarmizegetusa-s, që është interpretuar si *Decebali i biri i Skorilit* (per i përgjigjet lat. *puer*), si kalk i lat. *Traianus filius Nervae* (Aty, f. 67). Do të shtojmë

ne këtu se kjo formulë është krahasuar nga të tjerë dhe me shqipen *Gegë Pergega (Gegë per Gega), Pal Perpali*, etj, por më vonë është menduar më shumë për diçka të afërt me latinishten.

Janë diskutuar dhe çështje që lidhen me emërtimet/ realitetet trakishte/ dakishte, pra me dallimet eventuale midis tyre të pasqyruara në materialin e disponueshëm. Georgiev, Poghirc, Vraciu, etj. mendojnë se dallimet që vërehen në fushën e vokalizmit e të konsonantizmit në emra dhe në mbishkrime na thonë se kemi të bëjmë me reflekse të dy gjuhëve të ndryshme, por të afërta midis tyre – dakishte apo dako-mezishte dhe trakishte, ndërsa shumica e gjuhëtarëve rumunë (Rosetti, Graur, Russu, Macrea, etj.) dallimet e tilla i shohin vetëm si dallime dialektore brenda tërësisë së madhe trako-dake, apo trako-dako-mezo-gete. Edhe pse mendonin që ishte e vështirë të vendosej kjo çështje, autorët sikur avanconin idenë e Russu-it e të tjerëve për substratin trako-dak (Dumiterescu & Alii 1978: 66), duke konsideruar se fjala është për

“dallim të thjeshtë dialektor midis geto-dakëve në veri dhe trakëve në jug të Haemusit” (Russu 1967: 34. Po ashtu Russu 1969: 41).¹³²

Russu-i madje, pohimin e Georgiev-it se

*“dako-mezishtja dhe trakishtja janë dy gjuhë të ndryshme indoeuropiane”*¹³³
nuk ngurronte ta quante

“një nga fiksionet e numërta që qarkullojnë në decenien e fundit”.¹³⁴

Ndër kriteret me të cilat vendosen elementet e substratit autorët numëronin ato që gjenden tek ILR II: 319-320. Për to u bë fjalë më sipër.

Analizat e elementeve autoktone të rumanishtes kanë treguar se duan parë jo vetëm elementet leksikore, po edhe të tjerët. Kur një pullatë e ndërron gjuhën, ruan një radhë mënyrash shqiptimi (baza e artikulimit) dhe modelesh gramatikore. Në strukturën gramatikore dhe në sistemin fonologjik të gjuhës rumune ka qenë e vështirë të identifikohet

¹³² “O simplă diferențiere între geto-daci din nord și tracia de la sud de Haemus”.

¹³³ Referonnte Georgiev, in *St. Clas.*, III 1961, pp. 24: “daco-misiana și tracia sint două limbi indo-europene diferite”.

¹³⁴ “Una din numeroasele ficțiuni care circulă în ultimul deceniu”, Russu 1967: 34, Russu 1969: 41.

shin efektet e substratit, sepse gjuha e trako-dakasve nuk njihet. Këtu, thonë autorët, ka pasur teprime (Dumiteresci & Alii 1978: 69). Ne nuk mund të mos pyesnim që si u bë që në një hapësirë kaq të gjerë, ku do të jenë folur me siguri varietete të ndryshme, të kemi një refleks kështu një-sor të një substrati konkret, sado që me emra të shumtë?

Ky prezantim pedagogjik i problematikës së substratit i bërë nga specialistët e dy universiteteve, paraqet dhe tiparet themelore strukturore në fushën e fonetikës dhe të morfologjisë që mendohet se janë të substratit. Në fonetikë supozohen mundësi ndikimi të drejtpërdrejtë, përmes aportit të ndonjë foneme të re, apo të ndërmjetme, përmes transmetimit të disa shprehive të të folurit, të cilat mund ta përcaktojnë orientimin diakronik të sistemit të ri. Dhe ata mendojnë se dakishtja është e pranishme në fonologjinë e rumanishtes në të dy aspektet. Në vokalizëm si ndikim i substratit shihej zanorja *ǎ*, e përbashkët me shqipen e bullgarishten. Në konsonantizëm efekti i substratit ka qenë qoftë në shfaqjen e tingujve të rinj, qoftë në modifikimin e tingujve apo të grupeve të tingujve në kuadër të sistemit latin. Përmes substratit është shpjeguar prejardhja e *h* të rumanishtes, ashtu si zhvillimi i grupeve latine *ct*, *cs* > dakorum. *pt*, *ps*, shqip *ft*, *fs*. Disa madje mendojnë se zhvillimi i *s* ndër-dhëmbore(!) në *ș* (lat. *sīc* > rum. *și*, *septem* > *șapte*) mund të ketë proveniencë trako-dake (emrat e vjetër dakë të lumenjve e kanë: *Argeș*, *Criș*, *Mureș*, *Someș*, *Timiș*, edhe pse në fjalët shqipe para sh. XI nuk ekzistonte *s*, po vetëm *sh*!) (Dumiterescu & Alii 1978: 69). Para se të shohim komentet, të themi po ashtu se autorët e kësaj paraqitjeje me mëtesë sinteze pedagogjike të detyrueshme për studentët diçka nga substrati shihnin, gjithnjë sipas dijetarëve, në fushën e gramatikës, gjithsesi të krahasueshme me shqipen dhe gjuhët ballkanike: prapavendosja e njëjës shquese, sinkretizmi gjenitiv-dativ, persistenca e asnjansit, sistemi i numërimit nga 11 te 19 me *spre/ mbë* dhe numërimi me dhjeta, pjesëza përemërore *-ne* (*cine*, *mine*, *sine*, formimi i së ardhmes me ndihmësen *do*, *dysia* lidhore-paskajore, etj. Ata shtonin se fenomene të shumta në fushën e morfologjisë dhe të sintaksës janë shpjeguar përmes substratit, por pa pasur mundësi për dëshmim. Për këtë sërish referojnë ILR II, ff. 324-327.

Le të sjellim dhe vrojtimin themelor të këtyre autorëve lidhur

me leksikon e përbashkët midis shqipes e rumanishtes. Ata niseshin nga supozimi kategorik për gjuhën shqipe si vazhduese direkte të gjuhës trakase (sic), gjithë duke shtuar se ka që mendojnë që shqipja vjen prej ilirishtes, ndër ta edhe Çabej (duke shtuar porse që ilirishtja bënte pjesë në të njëjtin grup si trakishtja, çka nuk është e vërtetë për mendimin e tyre), pra si gjuhë që është folur në lashtësi në pjesët verilindore të Siujdhesës, pa treguar më saktësisht kohën as vendin në tërë atë hapësirë. Shpejtonin të gjykonin se sot më nuk miratohet nga shumica e gjuhëtarëve teza sipas së cilës elementet e përbashkëta midis shqipes e rumanishtes shpjegohen përmes një ‘simbioze al-bano-rumune’ diku në zonat qendrore të Siujdhesës (këtu fusnin G. Weigand, H. Barić, N. Jokl, A. Philippide, T. Capidan, E Çabej, etj., dijetarë mendimet e të cilëve për këtë çështje nuk janë krejt të njëjta, shpesh madje të kundërta: Barić, po edhe Weigand, kontaktin e tillë e vendosnin në pjesët lindore jo qendrore të Ballkanit, ndërsa Çabej shkante me pjesën e skajshme të hapësirës së shqipes së hershme jo më shumë se deri në Dardani, ku i shihte ato kontakte. Më duket se do vërejtur që raportimi i ideve të G. Meyer-it ka mundur të jetë pak më i plotë, sepse, shqipen ai e shihte gjithsesi pasardhëse të ilirishtes, por, më duket se në konceptimet e tij periudha karpaticane e shqipes do lidhur me raportet e hershme kur ai supozonte afri të shqipes me gjuhët veri-lindore (balte e sllave). Por ideja e tyre themelore, e shprehur dhe nga Brâncuș, Russu e të tjerë, është se fjalët e përbashkëta të këtyre gjuhëve duan shpjeguar patjetër si të komunitetit të substratit etnik-social dhe jo si huazime nga një gjuhë në tjetrën pas epokës romanike të gjuhës romane. (Dimitrescu & Alii 1978: 71). Ata e mbyllnin këtë pjesë me fjalët e S. Pușcariu-t:

“Ngjashmëritë e gjuhës rumune të Dakisë dhe të shqipes nuk vijnë nga një kontakt direkt dhe nuk janë huazime direkte, po shpjegohen si forma arkaike të konservuara në zonat laterale në kohë të stërlashta” (Pușcariu, *Limba româna II*: 325, sipas Dimitrescu & Alii: 71).¹³⁵

¹³⁵ “Asemănările dintre limba română din Dacia și cea albaneză nu vin dintr-un contact direct și nu sînt împrumuturi directe, ci se explică ca forme arhaice conser-

Theksoheshin më tej elementet që mungojnë në dialektet jugdanubiane të rumanishtes dhe fakti se disa syresh me kohë mund të jenë zhdukur apo zëvendësuar me fjalë të shqipes, greqishtes, etj. Dhe këtu vendosnin edhe një element që sillet vazhdimisht, por që nuk është kontekstualizuar si duhet: fjala është për *ceafă*, që tek arumunët qenka zëvendësuar nga shqipja *zvercă*. Fjala *ceafă* me fonetikën e saj nuk të kujton toskërishten apo shqipen e lashtë *qafë*, po më parë gegnishten e vonë veriore *çafë*, me afrikate dhe jo palatale të mirëfilltë, çka mund të flasë dhe për vendin prej nga mund të ketë hyrë në rumanishten. Kjo mund të lidhet dhe me *ceapă* < lat. *cēpa*, shq. *qepë*.

Autorët e kësaj vepre vijnë me paraqitjen e fjalëve rumune autoktone që nuk dalin në shqipen, pra nuk mund të shihen si huazime nga shqipja. Pastaj jepeshin vrojtimet për emrat e përveçëm autoktonë të ruajtur në gjuhën rumune (Argeş, Cerna, Dunăre, Jiu, Lotru, Olt, Mureş, Prut, Siret, Someş, Timiş, Tisa). Këtu vendosnin emrin *Karpate*, që e lidhnin me fjalën *karpë*. Pas raportimit për elementet e derivacionit (sufiksi *-esc*, pastaj *-ac*, *-andru*, *-ăni*, *-eşte*, *-man*, *-oane*, etj), Dimitrescu&Alii 1978: 71-74.

Zanorja ă e rumanishtes

Sipas Brâncuş-it (1973: 291-296) studiuesit, me pak përjashtime, konsiderojnë se zhvillimi i këtij tingulli (pjesërisht dhe në bullgarishten) i detyrohet veprimit të substratit të përbashkët ballkanik,

*“disa tendencave të veçanta (lëvizja e mbylljes së zanoreve të pathek-suara, trajtimi specifik i disa zanoreve në pozitë hundore) që kanë provokuar shfaqjen e ă-së”, f. 293.*¹³⁶

Nuk mund të provohet ekzistenca e këtij timbri vokalik në trakishten a ilirishten, çka nuk do të thotë se s’ka ekzistuar.¹³⁷ Por oshilimi i shkri-

vate în arii laterale în timpuri străvechi”.

¹³⁶ “Unor tendințe particulare (mișcarea de închidere a vocalelor neaccentuate, tratamentul specific al unor vocale în poziție nazală) care au provocat apariția lui ă”.

¹³⁷ Referonete Philippide: *Originea românilor II*, f. 56: “... nu este cu neputință ca limba tracă, principală limbă autohtonă care a fost înlocuită prin cea românească, să fi fost

mit *a/e* në disa monumente antike ballkanike në disa fjalë do të ishte dëshmi se trakishtja kishte një tingull të tipit *ǎ*, të cilin grekët e romakët, duke mos e pasur, e jepnin me tinguj të ngjashëm, siç kishte argumentuar Poghirc.¹³⁸ Meqë nuk ka dëshmi të sigurt, më prudenste është që substratit t'i atribuojmë vetëm tendenca që e kanë përcaktuar shfaqjen e zanores *ǎ* në rum. e në shq., kufizohej Brâncuș-i.

Për shqipen vërente, sipas Dodit, se kemi të bëjmë me nyjetim të *ë* që ndryshon nga rajoni në rajon. Zanorja *ë* toske nyjtohet përmes një tërheqjeje dhe shtrëngimi të muskulit gjuhësor, pra, përmes ngushtimit të hapësirës faringale. Në toskërishten lindore kemi një *ë* më të përparme, me maje të gjuhës shumë të afruar me alveolat e poshtme me hapje më të vogël. Në Elbasan dhe në Labëri *ë*-ja është pak e labializuar (Brancuș 1973: 292). Krahasimi me rëntgenogramet e Rosetti-t për rum. tregonte se kishim të bënim me tinguj të ngjashëm, jo identikë. Referonte Rosetti-n. Ky i fundit në një artikull të veçantë¹³⁹ e kishte parë të nevojshme të debatonte me E. Petrovici-n 1964 (199-206), i cili kishte shprehur mendimin se zanorja *ǎ* nuk përbënte një tipar të përbashkët ballkanik për rumanishten e për shqipen dhe se ka të bëjë me një zhvillim spontan. Argumenti i Petrovici-it është se *î* është e rumanishtes komune, në trajtimet e lat. *a+n* (*a+m*): *î* do të ketë kaluar në *i* pas një elementi qiellzor, *i* te *ghindǎ*, *fin* < *glandem*, *filianus*, sepse po të kishte kaluar *a* e theksuar latine në *ǎ*, duhej të kishim *en*: *veghe*m < *vigilamus*. Për Rosetti-n teoria e Petrovici-t është e kundërta e zhvillimit të natyrshëm. Trajtimi *î* vjen pas trajtimit *ǎ* në pajtim me tendencën drejt mbylljes së timbrave zanorë karakteristikë e lat. lindore: lat. *a* > rum. *ǎ* > *î*, lat. *o* > rum. *u*, lat. *e* > rum. *i*. Më tej ai diskutonte pohimin e Petrovici-t se *î* shfaqet në tërë rum., çka është e saktë, por timbri mund të jetë i vonë, siç dëshmon arum. e disa të folme të sotme dakorum., ku del vetëm *ǎ*. Pran-

plină de sunete ǎ, î". ("Nuk është e pamundur që gjuha trakase, gjuha kryesore auto-ktone që është zëvendësuar nga rumanishtja, të ketë qenë plot me tinguj ǎ, î".

¹³⁸ Referonte Poghirc 1960: 657 e v.

¹³⁹ Rosetti, A.: *Balkanica. Sur roum. ǎ*, in *Linguistique balkanique*, XI, 1, pp. 69-70.

daj duhet të nisemi nga trajtimi i lat. *an (am)* > rum. *ă*, që kaloi në *en*: *familia* : *fămeaie, femeie; oricla* > *ureche* dhe më vonë *en* > *in*: *ghindă, fin*. Te *păcat* nga *peccatum* Petrovici nuk shihte ngjashmëri me shqipen *mëkat*. As këtu Rosetti nuk i jepte të drejtë. Prandaj Rosetti përfundonte që zanorja me timbër *ă* është më e vjetër në rumanishten, ndërsa vjetërsinë e saj e konfirmon edhe prania në shqipen e në bullgarishten, pra është tipar ballkanik.

Është vërejtur se zanorja *ă* u zhvillua në dy rrugë në të dy gjuhët:

a. Spontanisht nga *a* e theksuar. Lat. *familia* > *fămeie, femeie, fëmijë; cepa* > *cepă, qepë; camisia* > *cămașă, këmishë*; kjo vërehet dhe tek elementet e substratit: *baltă, mazăre, măgură, vatra, baltë, modhullë, magulë, vatrë*, (Brâncuș 1973: 292). Në huazimet e mëvona realizohet subastituimi mekanik i *a*-së fundore me *-ă*, të motivuar me vlerë morfologjike të *-ă* fundore primare. (Është e besueshme që shqipja e përbashkët nuk karakterizohej me *a* në vetën I njëjës të të pakryerës dëftore: *lanja*, dikur *lanjë, lanje*) dhe në vetën I njëjës të aoristit (*lava*, por *lashë*), Brâncuș 1973: 292. Në huazimet e vjetra sllave ndodh delabializimi i *o*-së fundore: *sito* > *sita, sitë*, edhe me mungesë morfeme nominale me *-o*, po edhe me faktin se *ă*, e afërt me *o*, u bë fonemë e pavarur në fillim të ndikimit sllav;

b. *ă* shfaqet e kondicionuar dhe nga *a* në pozitë nazale: lat. *sanctus* > *sînt, shënt; canis* > *cîne, qën, qen; campus* > *cîmp; gamba* > *këmbë*, f. 292. *N* u grupua me zanoren paraprijëse. Kjo shkaktoi mbylljen e zanores dhe nazalizimin; por hundorësia nuk përdorej në kundërvënien fonologjike. Edhe për shqipen. Mendohet se në rum. komune *î* ishte variant fonologjik i *ă*. Fonologjizimi u bë më vonë. Ndryshimet e tjera janë më të vona se rum. komune. Te rastet si *lucrăm, dă, stă, lă*, te perfekti i thjeshtë *lucră* dhe te femërorja në shumës *ce-tăți, măi*. Kjo zanore ka dalë dhe nga zanore të tjera: *consilium*: *këshillë, desiderare* > *dëshiroj, testimoniare* > *dëshmoj, filiaster* > *fjesh-tër, virtutem* > *vërtyt, circare* > *kërkoj, ordinare* > *urdhëroj, voluntatem* > *vullnet, vitulea* > *ftujë*, Brâncuș 1973: 292-3.

Sa i përket përndarjes: në të dy gjuhët kjo zanore nuk shfaqet në fillim. Përfundimisht: *ăsta, ăla, ăra*, të vona. Shqip te 6 fjalë me *ă* ni-store: *ëmë, ëmbël, ëndës, ëndër, ëndje, ënj*, pason nazalja. Kanë dhe variante me *a*. Në Fjalor ka gjetur dhe: *ëngjëll, ënjë, ëngjërdhi, ëmtë, ërgjënt*. Fonologjikisht sekuenca *ë+hundore*, pas tij, do interpretuar si një fonemë e vetme, me ç'rast nuk mund të komutojnë as *ë-* as *hundorja* me një tjetër fonemë apo me zero. Në lidhje me shqipen ai vërente se në pozitë të patheksuar segmenti *ën-, ëm-, ër-, ël-* nuk paraqet dy fonema, po nazale apo likuide me karkater silabik, apo para-shkuarje nga një timbër zanor pa vlerë dalluese. Brenda rrokjes kjo zanore del brenda saj apo në pozitë fundore, jo në fillim, si në rumanishten. Për shqipen shënonte se te tipet të *hajë, gjëmoj, qëlloj, një* kemi tendencë akomodimi palatal, si *e* apo *i*: të *haje, gjemoj, gjimoj, qelloj, qilloj, një*. Fonologjikisht është e lejueshme, sepse në këtë pozitë nuk ka kundërvënie me *e* apo *i*.¹⁴⁰ *ă, ë* nuk del në rrokje të patheksuar, pos në pozitë nazale. Si të vlefshme edhe për shqipen e sjell rregullën e E. Vasiliu-t për rumanishten komune:

“[a] dhe [ə] ishin dy zanore në përndarje komplementare në raport me theksin: [a] del në pozitë të patheksuar (ku nuk del kurrë [ə], ndërsa [ə] del në pozitë të patheksuar (ku nuk del kurrë [a])” (Vasiliu 1968: *Fonologia istorică a dialectelor dacoromâne*, București, f. 58; M. Sala 1969: *Fonologia në Istoria limbii române*, Vol. II, f. 193).

Por në gjendjen e sotme të shqipes, e besoj edhe në të kaluarën, kemi shumë raste të shfaqjes së *a* në pozitë të patheksuar, sado që në fillim të fjalës ajo shpesh ka rënë.

Grupet *cs, ct* të latinishtes

Sipas Ajetit 1965: 1-3 refleksi fillestar i grupit latin *ct* ka qenë *qt*, siç del në monumentet e hershme, por edhe *i drejtë, ndrejtë, i dreqtë, ndret, dret*. Pas tij, *dreqtë* e ka përmbysur mendimin që i vetmi refleksi i grupit *ct*

¹⁴⁰ Në të vërtetë, kemi të bëjmë më parë me të folme gege, ku *ë-ja* e supozuar ose bie (*t'*), ose realizohet si *e* e shkurtë, në rrokje të patheksuar, ose si *i*. Variantet me *e* të cituara më sipër më duken më parë të rastit.

është *jt*, ndërsa *qt* është më e vjetër – Buzuku ka *dëreq*, por ai e raportonte edhe për Briskë e Shestan. Çabej e sillte nga toskërishtja dhe arbërishtja e Italisë, ndërsa në Arbënesh të Zarës kemi *ndret*. Raportonte për idenë e gjuhëtarëve që mendojnë refleksin dyfish: *ft* dhe *jt*: *lucta*: *luftë*, *trocta*: *troftë*, *t(r)aftar*: *tractarium*, *directus*: *drejtë*, *fructus*: *fruit*, *fryt*. Vërente se ky refleks përshtatet mirë me refleksin dalmat me *jt*: *lactem*: *laite*, *tractam*: *traite*, po edhe *x* – *js*: *Maximus*: *Maisan* (referonte Barić 1922/23: *Južnosl. filolog III*: 209; *O uzajamnim jezičkim odonosima balkanskih jezika*, § 21; *Albanisch, romanisch und rumänisch*, *Godišnjak balkanološkog instituta* 1957, Sarajevo: 10). Jokl (*Revue internationale des études balkaniques* I-II, I. 3-4: 64) dhe Çabej (*Hyrje në historinë e gjuhës*: 51) ngulnin këmbë që lat. *ct* në shq i përgjigjen tri reflekse: *ft* (*qt*), *jt*, *t*. Jokl e çonte refleksin *jt* në një fazë më të hershme *qt*: *paqtoj* – *paqë*, duke e krahasuar me të sotmen *shoqi-shojnë*. Ajeti mendonte se kjo është më e re dhe se nistore ka qenë *pajtoj* nga *pactare*. Ngjashëm Çabej.

Sipas A. Landi-t, grupi latin *-ct-* në shqipen ka dhënë: *-j/-yt-*: *dīrectu* > *i drejt/ dreq, dëreq*. Nga *jt* pas saj kemi afrikaten palatale *č* për shkak të palatalizimit të *t* (*t'*), që vërehet edhe në zonat e Italisë jugore. Shembuj: *factūra* > *fëtyrë* > *fytyrë*; *fructu* > *fryt* nga *frujt* (referonte Di Giovine 1982: 39-41); *tractu* > *trajt, trajtë*; *strictu* > *i shtrëjt*; *-nct-* > *-jt-*: *sanctu* > *shëjt/shenj*; *-nct-* > *-nd/-mt-*: *iunctūra* > *gjymtyrë*; *unctūra* > *yndyrë*; *-ct-* > *-ft-* (referonte di Giovine 1982: 39-41): *lucta* > *luftë*, *tructa* > *troftë*. Sipas di Giovine, raportonte ajo, refleksi i grupit lat. *-ct-* në shqipen nuk është i kushtëzuar nga konteksti, po ‘*u detyrohet zonave dhe ndikimeve të ndryshme*’; refleksi *-jt-* i grupit *-ct-* i detyrohet një faze të parë të hershme (fillimi i epokës së krishterë),

*‘kur gjuha shqipe i ishte shtruar ndikimit gjuhësor të latinishtes në bregun dalmat me shtrirje drejt brendisë, ku -jt- nga -ct- në latinishten vulgare të Dalmacisë... qe transformuar në *[çt]’,*¹⁴¹ Landi 1989: 122.

Në një fazë të dytë nga sh II i erës sonë e deri në sh. VI-VII shqipja e rindjeu ndikimin e ‘latinishtes danubiane’, çka e nxiti labializimin e *t* në *-ft-*

¹⁴¹ “Allorché la lingua albanese si e trovatra esposta all’influenza linguistica del latino sulla costa dalmata in espansione verso l’interno, ove *-jt-* da *-ct-* nel latino volgare della Dalmazia ... si era trasformato in **[çt]*”.

, Di Giovine 1982: 106-108. Refleksi *-ft-* i përket zhvillimit tipik të konsonantizmit grek vulgar a bizantin o neogrek (nga *-kt-*), por rumanishtja e jep me *-pt-*: *luptă* < *lŭcta*, por për *troftë* kemi vetëm sllav. *păstrāv*. Luftë paraqet një shembull të kalimit latino-roman. *Troftë* është më e vonë sipas rregullave neogreke.

“Përfundimi -ft- nga -ct- lat. në shqipen, megjithatë, del me relevancë nga një zhvillim konsonantik me prejardhje heteroglore”, Landi 1989: 123.¹⁴²

Edhe për *koftor* shihet një ndërmjetësim rumun, *cuptor* nga *coc-toriu*. Grupi *-ks-* > *sh* (*/-fsh-*): *axungia* > *asúj/ ushúnj, ushú*; *coxa* > *kofshë*, të bën të mendosh për ndërmjetësim të rum. *coapsă*; *exāmina* > *shëmë, shëmë, fraxīnu* > *frashën, frashër*; **mataxu* > *mëndash* (formën *mëndafsh* e lidh me neogr.). Grupi kons *-ks-* (x) u transformua herë në *ps* e *psh*, pra *fsh*: *coxa*: **copsa* > *kofshë*, rum. *coapsă*, herë me *s* të lat. vulgare, u bë *sh* – rum *s*: *fraxīnu*: *frashën, r. frasin*.

“Dy gjuhët, pra, kanë rimarrë një trashëgimi të përbashkët” (Landi 1989: 124).¹⁴³

Sipas Holzer-it, në pjesën dalmate romane kemi zhvillimet: qysh në lat. mbylltorja velare *k* para *t* e *s* kaloi në frikative (velare a palatale):

Lactūca: **laçtūka*: *laçtūka*: **laxtīkā*: *loćika*

**sanctulus*: **sançtulus*: **snaçtulu*: *sanxtulu*: *suta*

Maximus: *Maçsimus*: *Majsemu*: **Majsimu*: *Majsan*, (Holzer, G. 2011: 20.

Sipas Marius Sala 1976: 185, transformimi i lat. [*kt*], [*ks*] në rum. [*pt*], [*ps*], [*s*] mund të ndërlihet me zhvillimin e atyre grupeve në Romaninë Perëndimore:

“ashtu si në perëndim të Romanisë, mund të shpjegohet me kritere interne, pa invokuar ndikime të jashtme (substrat, ndikim grek)”.¹⁴⁴

Kemi të bëjmë me një proces fonologjik të reduktimit të dallimeve në pozitë mbërthyesë, kështu që [*k*] mbërthyesë është asimiluar. Në rastin e [*ks*], që paraqet dy reflekse, [*ps*] e [*s*], ka ndodhur një asimilim i

¹⁴² “L’esito *-ft-* in albanese da *-ct-* latino, pertanto, risulta di pertinenza di un’evoluzione consonantica di origine eteroglore”.

¹⁴³ “Le due lingue hanno ripreso, dunque, un’eredità comune”.

¹⁴⁴ “Tout comme à l’ouest de la Roumanie, elle peut être expliquée par des critères internes, sans invoquer les influences externes (substrat, influence grecque)”, f. 185.

plotë në rastet kur implozivja ndodhej në rrokje të patheksuar, ndërsa asimilim i pjesshëm [ks] > [ps] kur ndodhej në rrokje të theksuar.

“Dallimi i trajtimit midis [kt] e [ks] shpjegohet me faktin se në latinishten tashmë asimilimi ishte më i shpeshtë në grupin [ks] se sa në grupin [kt]”.¹⁴⁵

Zhvillimi i tingujve lat. *kt*, *ks* në rumanishten *pt*, *ps*, shqip *ft*, *fs* është parë po ashtu si çështje e substratit (Densusianu, HLR I, f. 26; Barić, *Istorija arban.*, 37-39, etj.; *ILR II* 1969: 322). Ishte vërejtur po ashtu se qysh në latinishten këto grupe konsonantike ishin dobësuar përmes asimilimit -*ss* (*coxim* > *cossim*), fenomen roman (lat. *maxilla* > rum. *măsea*). Vetëm në disa raste ka dhënë *ps* në rum. dhe *fs* në shqipen (*coxa* > *coapsă*, *kofshë*; *fraxinus* > *frapsin* dialekt., *toxico* > *toapsec*; *laxa* > *lafshë*), *ILR II* 1969: 322.

Sipas *ILR II* rasti i grupit *kt* është pak më i ndërliqshëm. Në shqipen ndodh si në gjuhët perëndimore kur *kt* ndiqej nga *a* dhe *e* (*directu* > *drejtë*, *tractare* > *trajtoj*),¹⁴⁶ ndërsa me rumanishten pajtohet kur grupi parashkohej nga zanore të tjera (*lucta* > *luptă*, *luftë*).

Shumica e studiuesve kanë propozuar zhvillimin vijues: *kt* > *xt* > *ft* > *pt* (Densusianu HLR I, 26-27, 117). Ka pasur dhe kundërshtime për këtë. Nuk përjashtohet ndikimi i substratit për këto arsye: *pt*, *ps* si zgjedhje në rum. kundër situatës së përgjithshme romane, ku *pt* ishte aq e dobët sa *kt*, *ks* (*ipse* > *isse*, *optimo*, *scriptum*, *septembre* > *otimo*, *scritum*, *setembre* në lat. e vonë). Në rum. grupi *pt* është rezistent (*septem* > *șeapte*), u dobësua vetëm me disimilim nën ndikim të labiales parashkuese (*baptizare* > *boteza*); duket se grupi *kt* do të ketë qenë evituar në mënyrë të veçantë nga autoktonët veri-ballkanikë (stërgjyshërit e rumunëve dhe të shqiptarëve) për shkak se në gjuhën e tyre grupi IE **kt* qe eliminuar (lat. *noc-tem*, lit. *naktis*: *natė* (referon Barić 31). Në fjalët dakomeziane të dëshmuara grupi *kt* nuk shfaqet, ndërsa grupi *ks* një herë (*Axios*, *Axiupa*), por shfaqet *pt* (*Eptacentus*, *Eptala*, *Eptidius*, *Heptapor*), f. 323. Për këtë flasin dhe shmebujt *Axyrtos*: *Apsyrtos*, *Crexi*: *Krepsa*, *kokkypis*: *kokkyxs*. Gjëra të

¹⁴⁵ “La différence de traitement entre [kt] et [ks] s’explique par le fait qu’en latin déjà l’assimilation a été plus fréquente dans le groupe [ks] que dans le groupe [kt]”, f. 185.

¹⁴⁶ Barić 1955: 38, *ct* > *it* del në fjalë shqipe të huazuara nga dalmatishtja.

ngjashme shfaqen edhe në jug të Italisë. Kjo na bën të pranojmë shpjegimin me substrat të zëvendësimit të *kt* me *pt*, e jo *tt* a *it* (çka duket e vjetër), thonë ata, *ILR II* 1969: 323.¹⁴⁷

Barić 1955: 63 mendonte se

“zâvëndësimi i togjeve ct, x, ft, fš në fjalët shqipe me prejardhje latine është mâ i lashtë, kurse zâvëndësimi it, is është mâ i ri. Kjo don me thënë se kanë ekzistue dy shtresa elementesh romane kronologjikisht dhe gjeografikisht të ndame në gjuhën shqipe, njëna me ft, fš n’atdheun e vjetër të Shqiptarëve në mbrendësin e Gadishullit Ballkanik, në lidhje me elementin roman, në të cilin është formue populli dhe gjuha rumune, dhe tjetra me it, is në kontaktin mâ të ri të Shqiptarëve me Romanët bregdetarë mbas ardhjes së Shqiptarëve në bregdet, gjâ që sot përgjithësisht konsiderohet si vënd jetese mâ i vonshëm i Shqiptarëve”.

Pra, ai shihte këtu dy lloje ‘substratesh’: substrat i iliro-shqipes në Bregdetin Adriatik dhe substrat i trako-shqipes në brendësi të Gadishullit. Ka pasur një fazë ndërmjetëse *h* midis *ct* e *it* në romanishten bregdetare, ndërkohë që zëvendësimi i labialeve para *t*, *s* me labiale shpjegohet me reagimin e gjuhës shqipo-trakishte, ku tashmë grupet IE *kt*, *ks* janë thjeshtuar qysh në periudhën paralatine (Barić 1955: 64). Të gjitha këto lidhen me pikëpamjet e tij për prejardhjen e shqipes si dialekt trak që u shtri pas-taj në hapësirë ilire, ku ndodhi një simbiozë.¹⁴⁸ Kjo nga ana tjetër ndër-lidhet me konceptin e tij për latinitetin ballkanik, ku janë zhvilluar dy gjuhë romane – në brendi rumanishtja dhe në bregdet dalmatishtja, sipas tij. Ai shtonte madje, që edhe në Shqipërinë e Veriut është folur romanisht (psh. në Drisht), Barić 1955: 61.

Më duket se duan rikujtuar këtu përfundimet e studimit të P. di Giovine 1982: 107. Pasi kishte tërhequr vërejtjen për dallimet midis grupeve *ct*, *cs*, *gn*, megjithë ngjashmëritë dhe të përbashkëtat – në rastin e

¹⁴⁷ Kalimi *kt*: *t*, te *natë*, është i një kohe shumë të hershme dhe nuk ka të bëjë me *ct* lat. për të cilën po bëjmë fjalë. Kronologjia e zhvillimeve në shq. siç theksonte Di Giovine flet për shtresa të ndryshme, pra jo për një substrat të përbashkët.

¹⁴⁸ “Mund të thuhet se Dardania dhe Peonia janë krahina në të cilat është bërë simbioza e parë shqiptaro-iliriane qysh në mbrendësin e Gadishullit Ballkanik”, Barić 1955: 50.

parë kemi një grup dy mbylltoresh, në të dytin një mbylltore e një fërki-more, në të tretin një mbylltore e një hundore, prandaj edhe reflekset e këtyre grupeve latine në shqipen apo në gjuhë të tjera për kaq do të jenë të ndryshme në raport me të tjerat. Në një kohë të parë, në fillim të epokës së krishterë, nëse jo më parë, shqipja do të ketë qenë e ekspozuar ndaj ndikimit dalmat, kështu që kanë hyrë elemente të ndryshme leksikore, por me to dhe veçori fonologjike. Me këtë fazë, pas tij, më të largët, lidhet refleksi *jt* i *ct*-së, që në lat. vulgare të Dalmacisë kaloi në *[çt] (di Giovine 1982: 107). Në një kohë të dytë, nga sh. II e deri në sh. VI-VII në shqipen ndodhi një ndikim tjetër latino-ballkanik, latinishtja danubiane.¹⁴⁹ Ndikimi i këtillë ka të bëjë me morfologjinë e sintaksën, po edhe me leksikun e fonologjinë.¹⁵⁰ Në të tillë kuadër ai e shihte të mundshme vendosjen e labializimit *çt* (zëvendësim ballkanik i *ct* latine) në *ft*. Prandaj trajtimi i dyfishtë i grupit latin *ct* nuk do lidhur me kontekstet e ndryshme fonetike, po me latinitetet e ndryshme nga aspekti kohor e areal (di Giovine 1982: 108).¹⁵¹

Studiuesi i rëndësishëm i latinizmave të shqipes Guillaume Bonnet (1999) merrej në mënyrë të veçantë me këto grupe bashkëtingëlloresh latine. Me formim latinist, ai i shihte ato në historinë brenda shqipes, por dhe në raport me kontekstin latino-roman. Grupi */kt/*, pas tij, dilte me dy përfaqësime: *ftua* < *cotōneus*; *luftë* < *lucta* (mundet dhe *lëftoj*); *troftë* < *tracta* dhe *drejtë* < *dīrēctus*; *frujt* < *frūctus*; *trajtoj* < *tractāre*, Bonnet 1999:255.

¹⁴⁹ Dhe këtu ai vendoste një shënim: pas sh. VI sllavët kaluan Danubin dhe për pasojë shkaktuan një ndërprerje të kontaktit gjuhësor midis shqipes dhe ballkano-romanishtes (rumanishtes); mbase në këtë periudhë shqiptarët u vendosën në hapësirat e sotme. “Invazioni sllav i Dalmacisë... krijoi një frakturë, qoftë edhe më pak të thellë, edhe midis shqipes dhe dalmatishtes”.

¹⁵⁰ Në raport me idenë e Barić-it për burimin të trakishtja si paraardhëse e shqipes, di Giovine mendon të kundërtën dhe është shprehur edhe herë të tjera për arsyet pse shqipja nuk mund të konsiderohet pasardhëse e trakishtes.

¹⁵¹ “Il duplice trattamento di *ct* latino in albanese non è dunque da attribuire a diversità di contesto fonologico, ma piuttosto a due contatti con la latinità diversi arealmente e cronologicamente”. “Trajtimi i dyfishtë i *ct* latine në shqipen nuk duhet pra t’i atribuohet diversitetit të kontekstit fonologjik, po më parë dy kontakteve me latinitetet e ndryshme në aspektin areal dhe kronologjik”.

Te *dëftoj*, mendonte ai, ka gjasë të kemi /ft/ nga /kt/, por janë propozuar deri tash: **indictāre*, **doctāre*, *dictāre*, *dētegere* dhe së fundi nga Çabej *digitāre*. Po kështu *pajtoj*: diskutimi ka shkuar drejt *pajtoj* e *paqoj* nga *paq* apo kryqëzim me **pactāre*. Çabej e çon te *paq* me ndërmjetësim të prapashtesës foljore -(ë)toj. Ka pasur shumë diskutime nëse ka kushtëzim në pozitë nistore e pas zanoreve të prapme për /ft/, ndërsa /yt/ pas zanoreve të përparme. Është diskutuar dhe në raport me rumanishten: *pectus* > *piept*, *lactūca* > *lăptuca*. Shpjegimi për ngjashmëri me rumanishten është kërkuar te substrati apo te ndikimi grek. Kështu mendohej që shqipja /jt/ do të jetë më e vonë se /ft/, që do të vinte nga substrati. Është përfshirë aty dhe dalmatishtja *gwapto* '8'. Edhe pse ka dallime midis shqipes e rumanishtes (në të parën ndryshimi ndodh vetëm në këto fjalë të huazuara, ndërsa në rum. ndryshimi është i përgjithshëm), zgjidhjen ai nuk e shihte ekskluzive, Bonnet 1999: 257.

Shqyrtimin e niste me supozimin se /ft/ ishte rezultati gjithandej, pos pas një zanoreje palatale. Por, nëse kuptohet për frujt (më herët **fryit*), te *trajtoj*, *pajtoj* e *dëftoj* ka probleme. Në të dy rastet kemi të bëjmë me humbje të nyjëtimimit mbylltor, në shqipen kemi të bëjmë me tendencë dobësimi të mbylltores, çka vërehet dhe në latinishten, ndërsa në rum. kemi /pt/: *lactem* > *lapte*, sp. *leche*, fr. *lait*, it *latte*, Bonnet 1999: 258.

Në shqipen zgjedhja e realizimit [f] apo [y] për mbylltoren duket e lidhur me cilësinë e zanores parashkuese.

*“Përndarja fonetike drejtë, *fryit, por troftë, luftoj, shpjegohet përmes inventarit fonologjik të veçantë të gjuhës pranuese: spirantja buzore (apo tashmë buzoredhëmbore) është më e afërta me zanoret mediane të prapme, edhe pse yod afrohet natyrshëm me qiellzoret”, Bonnet 1999: 258.¹⁵²*

Ndryshe e shihte rastin e *ftua* < *cotōneum*, ku kemi zgjedhjen e [f] të përcaktuar nga kujdesi për të ruajtur elementin nistor (një formë **ftua* nuk duket e mundshme). Në vijim ndarja u zhduk: /ft/ e /yt/ u shumëfi-

¹⁵² “La repartition phonétique drejtë, **fryit*, mais *troftë*, *luftë*, *luftoj*, s’explique par l’inventaire phonologique propre à la langue d’accueil: la spirante labiale (ou déjà labiodentale?) est la plus proche des voyelles médianes d’arrière, cependant que yod est appelé naturellement par les palatales”.

shuan në gjuhë për pasojë zhvillimesh të pastajme: *kujtoj* < *cōg(i)tare*; po edhe *f* para dhëmbore: *aftë* < *aptus*. Format e mëvona *pajtoj* e *trajtoj* favorizojnë zgjedhjen [yt]. Për *fryt* ai mendonte se mund të çohet te *frujt*, ndërsa për *fëtyrë* < *factūra* shihte zgjedhjen me [ft]: **fëftyrë*. Te mundësia [k'] dyshonte fort. Njihet forma dialektore *dreq* në jug, Buzuku *dëreq*, *i dreqtë*, por Buzuku vetë ka *drejtë*. E shihte formim retrograd nga *drejtë*. Çabej sjell në jug *miq* – *mijtë*, kështu, pra *dreq* nga *drejtë* si te *shpesh* – *shpeshtë*, Bonnet 1999: 258-260.

Këtu duan rikujtuar format që sjell Ajeti 1965 për të folmen e Krajës dhe të Arbëneshit të Zarës. Ne këtu do të sjellim një detaj tjetër. Me palatale kemi në veri *ndreq* [ndreć], [îreć] nga **n-dreq*, deri edhe në të folmet veriore të Karadakut e të Preshevës.¹⁵³ Po nga këto zona do të sjellim shembullin [likṭyr], [lifṭyr] me alternim të rastit, çka mund të fliste për një proces më të vonë.

Ndryshe dalin realizimet te grupi /nkt/, Bonnet 1999: 261-3, me çka nuk po merremi këtu. Por të shohim si qëndron puna te shqyrtimi i grupit /ks/. Sipas Bonnet-së shqipja këtu ka më zakonisht /š/, por edhe /fš/: *bush* < *buxus*; *frashër* < *fraxinus*; *kofshë* < *coxa*; *lafshë* < *laxa*; *lëshoj* < *laxāre*; *shembë* < *exāmen*; *ushunjë* < *axungia* dhe *mëndash*, *mëndafsh* < *metaxa*, Bonnet 1999: 263-4. Rumanishtja ka ngjashmëri: /ps/ dhe /s/: *frixīt* > *fripse*, *maxilla* > *mășeava*.

“A mund të supozohej një e ndërmyetme rumune midis latinishtes dhe përfundimit /fsh/ të shqipes?”, pyeste ai.¹⁵⁴

E mundshme për *kofshë*, edhe për *mëndash*, por *lafshë* s’ka përkatës rumun. Supozonte se mund të merret me mend paralelizmi i *kofshë* me *luftë*, si proces fonetik. Raportonte mandej proceset brenda romanishtes te -ct- > tt. Sikur ka pasur reduktim të parmë të /ks/ në /ss/. Për *mëndafsh*, *mëndash* mund të kishte dhe arsye të tjera. Do të kujtojmë këtu formën e shpeshtë në veri: *mnash*. Po ashtu do të rikujtojmë zhvillimin e brendshëm: *kafshatë*: *kapshatë*: *kashatë*,

¹⁵³ Aty kemi: [zōg]: sh. [zōj]; [kaLamōtj]: mbiemër [i, e kaLamōjt], të zakonshme në shqipen e Veriut.

¹⁵⁴ “Pourrait-on supposer un intermédiaire roumain entre le latin et l’aboutissement /fsh/ albanais?”.

kafshoj: *kashoj*, *kashore*, *kafshore*, etj.

Bonnet-ja mendonte përfundimisht se është e mundshme që trajtimet shqipe të /kt/ e /ks/ të shihen si një zhvillim i vetëm, Bonnet 1999: 266.

Sido që të jetë, dallimet me zhvillimet në rumanishten janë të hetueshme, ashtu si dhe në raport me dalmatishten.

Fernado Sanchez Miret në *Manual de linguistica romanica*, f. 248 për palatalizimet dhe trajtimet e tjera të grupeve bashkëtingëllore në gjuhët romane jepte këtë pasqyrë:

	-CT-	-PS-	-CS-	-GN-
sard.	tt	ss	ss	nn
rum.	pt	s	s, ps	mn
it.	tt	ss	ʃʃ	ɲɲ, jɲ
fr.	jt	s	js	jɲ
occ.	jt, tʃ	js	js	ɲ
cat.	jt	jʃ	jʃ	ɲ
cast.	jt > tʃ	s, x	jʃ	ɲ
port.	jt	s, js	jʃ > x	ɲ

Sa i përket grupit *-ct-* rumanishtja reflekton përshtatje të veçantë *-pt-*, ndërkaq portugishtja, katalonishtja dhe frëngjishtja *-jt-* (e pra nuk ka supozime të kenë pasur substrat të njëjtë); oksitanishtja dhe kastilianishtja reflektojnë fillimisht *jt*, e pastaj *tʃ*, ndërsa italishtja e sardishtja *-tt-*. Po kështu ngjet edhe me grupet e tjera.

Për mendimin tim këto zhvillime në shqipen e në rumanishten s'kanë të bëjnë fare me asfarë substrati.

Përmbledhja e Kaluzhskaja-s

Të gjitha shpjegimet për elementin e përbashkët midis rumanishtes dhe shqipes kanë qenë të ndërlidhura në një mënyrë a një tjetër me çështjen e prejardhjes së popullit rumun, në një anë, dhe të popullit shqiptar, në tjetrën. Për të pasur një pasqyrë lidhur me rumanishten, le të përmbledhim diçka sipas atyre që janë paraqitur tek autorët si Firedwagner 1934, Gamillscheg 1964, Ivănescu 1980: 47-77, Russu 1981, Schramm 1985-1987, Kaluzhskaja 2001, etj., e që këtu po i referojmë kryesisht si bi-

bliografi dhe pa nuancimet jo të pakta. Në frymën e sintetizimit të Kaluzhskaja-s, tri janë vijat kryesore të të menduarit:

1. rumanishtja dhe populli rumun u formuan në veri të Danubit si rezultat i pushtimit romak të Dakisë; pas tërheqjes së ushtrive bashkë me një pjesë të popullatës më 271 në pjesën jugore të Danubit, në Daki u ruajt një shtresë e popullatës së romanizuar; kjo popullatë e romanizuar u bë bërthama etnike e rumunëve të mëvonë. Pikëpamje të tilla kanë mbështetur autorë të rëndësishëm si Hasdeu, Iorga, Părvan, Capidan, Rosetti, Russu, etj. (për Hasdeu, Capidan, Rosetti e Russu shih më sipër);

2. qendër themelore e romanizimit dhe e formimit të etnosit rumun kanë qenë hapësirat në jug të Danubit (Mezia e Epër dhe Mezia e Poshtme, Skitia e Vogël, Dardania dhe Prevalitana), prej nga në Mesjetë pati mërgim tjetër përtej Danubit (Philippide, Papahagi, Petrovici, Pușcariu, etj., shih më sipër);

3. formimi i rumunëve në jug të Danubit dhe shpërngulja në Daki, ku pas tërheqjes së romakëve, dyndjes së popujve, praktikisht popullatë romane s'kishte; këtu dalin dy versione: a. Mërgimi ka ndodhur para ardhjes së magjarëve në Transilvani, sh. VI—IX (Miklosich, Jireček, Densusianu), b. Pas arritjes së magjarëve, sh. X—XIII (Sulzer, Rösler, Tomaschek, Weigand, Tamás, Alföldy, Galdi, Du Nay) (shih dhe Kaluzhskaja 2001: 8 e në vijim).

Lidhur me teoritë dhe hipotezat për prejardhjen e gjuhës shqipe do të bëhet fjalë në pjesë të tjera të këtij libri, ndërsa këtu po lejohe mi të përmbledhim shkurt ato që theksonte Kaluzhskaja. Sipas saj, në përfundime duhet të theksohet sa vijon:

- Sasia e elementeve të përbashkëta rumuno-shqiptare të cilat mund të lidhen me trashëgiminë paleoballkanike me ndonjë siguri, është krejt e kufizuar (крајне ограничено);

- Përbërja e korpusit të këtyre fjalëve nuk është e njëllajtë, përfshin elemente me prejardhje të ndryshme: relikte paleoballkanike; huazime nga mesjeta e hershme nga shqipja në rumanish-

ten (nga shqipja e lashtë, sipas Desnickaja-s, në protorumanishten apo rumanishten e përbashkët), para shfaqjes së sllavizmave; albanizma të vonë të shpënë në dialektin e Transilvanisë; latinizma të hyrë në rumanishten përmes shqipes së lashtë të hershme; elemente protorumune në shqipen; elemente të përgjithshme romane; huazime të përgjithshme sllave e turke, 145;

- Analizat etimologjike të elementeve potencialisht të substratit me prognoza më të mira dalin ato të glosave, ku mund të vepohet me anën formale po edhe me përmbajtjen e fakteve bashkëkohëse;¹⁵⁵ duken më të besueshme afrimet me materialin onomastik paleoballkanik, atje ku mund të rindërtohet pak a shumë kuptimi përmes rindërtimeve të brendshme dhe burimeve të tërthorta;¹⁵⁶ në radhën e fundit sa i përket besueshmërisë janë përafrimet me njësitë onomastike që gjinden vetëm në rrafsh supozimi;¹⁵⁷

- Analiza e detajuar etimologjike tregon po ashtu se mund të pranohen jo të gjitha përafrimet rumuno-shqiptare me materialet paleoballkanike (rum. *abure* – alb. *avull* – ilir. *Atābulos*; rum. *balta* – alb. *Baltë* – trak. *Δεβελτός*, *Dibaltim*; rum. *bāl*, *bālan* – alb. *balash*, *balosh* – ilir. *Βαλίος*, *Βαλιός*; rum. *basčă* – alb. *bashkë* – trak. *Βασσάραι*; rum. *Brusture* – alb. *brushtullë* – dak. *Riborasta*; rum. *druete* – alb. *dru* – dak. *Δρουβητίς*, *Drubeta*, *Drobeta*), f. 146;

- Paralelet rumuno-shqiptare shfaqin përkime të veçanta me ilirishten (*Menzana*, *Codrione*), si me trako-dakishten (*μίζηλα*, *Στρόγγες*); ka raste kur ana paleoballkanike përfaqësohet edhe me ilirishten edhe me trakishten (trak. *Βύζας*, *Βυζάντιον* – ilir. *Beuzas*, *Beusas*, *Busio*; trak. *Malua*, *Maluensis* – ilir. *Malontum*); pakësia dhe fragmentariteti i materialeve të gjuhëve paleoballkanike, vësh-

¹⁵⁵ Rum. *argea* – dr. maked. *argella* – trak. *argilos*; rum. *başçă* – shq. *bashkë* – dr. mak. *βάσκιαι*, *βασκευται*; rum. *mazăre* – shq. *modhullë* – dak. *μίζηλα*.

¹⁵⁶ Rum. *bălaur* – shq. *bullar* – paragreq. *Βέλλαρος* – trak. *Βολλυρος*; rum. *buză* – shq. *buzë* – trak. *Βύζας*, *Βυζάντιον*; rum. *mal* – shq. *mal* – trak. *Malva*, *Malvensis*, ilir. *Malontum*; rum. *mînz* – shq. *mëz* – ilir. *Juppiter menzanas*.

¹⁵⁷ R. *codru* – shq. *kodër* – ilir. *Codrione*; r. *strungă* – shq. *shtrungë* – trak. *Στρόγγες*), f. 145.

tirësia për t'i atribuar njëanshëm njërës gjuhë materialet e caktuara e bën të vështirë përdorimin e përcaktorëve etnikë modernë, ndaj ato materiale cilësohen shpesh si paleoballkanikë, autoktonë;

- Në rum. ka elemente paleoballkanike që nuk dalin në shqipen (*argea, ragal* sipas saj është formë lokale sllave) f. 146;

- Paraqitja e pak njësive të veçanta paleoballkanike të substratit në gjuhët sllave jugore (*blavor, buza, *stronga*) dëshmon për kontaktet e kufizuara gjuhësore, sepse në kohën e ardhjes së sllavëve në Ballkan gjuhët vendore ishin ende në shkallë të ndryshme kontakti me latinishten e provincave ballkanike të Perandorisë romake, f. 146.

Në tërësi çështja shfaqet shumë e thërmuar dhe mozaike, kështu që është vështirë të nxirren përfundime që sugjerojnë zgjidhje drejtvizore për elementet paleoballkanike në gjuhët e sotme ballkanike; jemi të detryruar të marrim parasysh se marrëdhëniet ndërgjuhësore këtu gjithnjë kanë qenë të ndërliqshme. Referonte L. A. Gindin:

“është vështirë të gjesh në Europë një tjetër rajon gjeografik, ku problemet e substratit do të ishin po kaq aktualë dhe po kaq të ndërliqshëm, sa në historinë gjuhësore dhe etnike të Siujdhesës Ballkanike” (Gindin 1976: 147).

Duke u nisur nga diskutimi i *“kontraverzës iliro-trakase”* për preardhjen e gjuhës shqipe ajo përpiquej të paraqiste pikëpamjet e të dy ‘anëve’ (f. 8-13). Ajo theksonte se një numër i madh i albanistëve dhe i studiuesve të gjuhësisë së krahasuar indoeuropiane mbështeste pikëpamjen që shqipen e sheh në një mënyrë a një tjetër vazhdim të ilirishtes. Ajo theksonte posaçërisht idetë e A. V. Desnickaja-s. Natyrisht, në këtë vazhdë mbase mund të referoheshin më shumë përmbledhjet e vona të Sh. Demirajit.

Diskutime për nyjat

Duke u pajtuar plotësisht me mendimin e Stefan Schumacher-it se literatura për çështjen e nyjave në gjuhët e Ballkanit tashmë është bërë vështirë e përsundueshme, në këtë shqyrtim do të marrim pa-

rasysh çështje të veçanta të shtruara nga pak autorë të rëndësishëm, por mbase jo mjaft të konsultuar.

Në radhën e shqyrtimeve për ngjashmëritë e afritë midis shqipes dhe rumanishtes, Schumacher (2009: 37-60) kishte zgjedhur të fliste dhe për çështjen e prapavendosjes së nyjave me konstatimin se ky tipar paraqet veçori qenësore strukturore të përbashkët midis shqipes e rumanishtes dhe se kjo veçori e rumanishtes paraqet imitim të prapavendosjes në gjuhën shqipe (Schumacher 2009: 56).¹⁵⁸ Në vlerësimin e tij, ka një argument thelbësor kronologjik, që e vlen të thuhet:

*“Në shqipen prapangjitja e emrit me nyjën e shquar vijuese është shumë e vjetër – kjo shihet sidomos nga fakti se kallëzorja e emrave mashkullorë dhe femërorë me nyjë shquese në shqipen e vjetër kishte formën /-në/, se kjo /-në/ del nga *-om+*-tom përkatësisht nga *ām+*tām” (Schumacher 2009: 56).¹⁵⁹*

Dy autorë shumë rë rëndësishëm lidhur me trajtimin e prapavendosjes së nyjave në shqipen dhe gjuhët e Ballkanit, Selman Riza dhe Besim Bokshi, nuk e kanë lënë pa folur për prapangjitjen (aglutininin) e nyjës shquese në shqipen dhe në rumanishten, madje edhe në kontekstin e mundësisë së ndikimit të shqipes në të dytën. Në këto diskutime dhe në polemikat e Rizës me Çabejnë nuk ka mbetur pa u prekur as konstatimi i hershëm i Pedersen-it për formën /-n/ të akuzativit të nyjës, ai i diskutimit të La Piana-s. Bokshi, madje, ka një teori specifike në këtë drejtim. Por më parë le ta vijojmë paraqitjen e shqyrtimit nga Schumacher-i, i cili nuk i ka pasur këto diskutime.

Në fund të faqes prej nga u mor citati, Schumacher-i ka referuar

¹⁵⁸ “Eine wesentliche strukturelle Gemeinsamkeit des Albanischen und des Balkanromanischen steht nämlich darin, dass beide den bestimmten Artikel postponieren. Ich halte es für das wahrscheinlichste, dass die Postposition des Artikels im Balkanromanischen die Postposition des Artikels im Albanischen nachahmt”.

¹⁵⁹ “Im Albanischen hat die Univerbierung von Substantiv und nachfolgendem bestimmtem Artikel ein hohes Alter – dies zeigt sich insbesondere davon, dass der Akkusativ den maskulinen und femininen Substantive mit bestimmtem Artikel im Altalbanischen die Form /-në/ hat, denn dieses /-n/ geht auf *-om+*-tom bzw. auf *ām+*tām zurück”.

shqyrtimin e Sh. Demirajt dhe shkallët nëpër të cilat supozohet të ketë kaluar zhvillimi i shqipes deri te /-në/: *-om+*tom, *-ām+*tām > *-antan > *-annə > *altalb. /-në/*, pastaj asimilimin e -nt- ndërzanore e shihte të ngjashëm me atë të vetës 3 sh. dëftore joveprore *-antai > *altalb. /-enë/*. Në vijim ai thoshte:

“... përngjitja e emrit me një shqese është dashur të ndodhte para se të birreshin bashkëtingëlloret hundore fundore në fjalët brenda rrokjes në shqipen” (Schumacher 2009: 56).¹⁶⁰

Kusht të domosdoshëm për aglutinim e shihte kohën para rënies së zanores hundore fundore në fjalë shumërokëshe, jo çështjen e rotacizimit. Mirëpo, në gjuhën shqipe nuk ka dëshmi të drejtpërdrejta që do të flisnin për këtë rënie të bashkëtingëllores hundore në pozitë fundore në fjalë shumërokëshe, prandaj ai kërkonte dëshmi të ndërmjetme në latinishten dhe në greqishten. Në latinishten -m fundore në fjalët shumërokëshe nuk shqiptohej më qysh në sh. III para Krishtit, po më parë dilte e njëjtuar si zanore më e gjatë hundore (për këtë referonte: F. Sommer/ R. Pfister 1977: 219-221). Në fund të faqes ai kishte shënuar se gramatikat flasin për -m të reduktuar, çka do të thotë se zanorja ishte e nazalizuar, pra se mbyllja e buzëve për -m nuk realizohej. Fakti se, në poezinë klasike të sh. I para Krishtit rrokjet fundore -am, -em, -im, -um në fjalët shumërokëshe elidoheshin, flet, pas tij, qartë se bashkëtingëlloret hundore në këtë kohë kishte rënë.

Sa i përket greqishtes Schumacher-i mendonte se qysh në *Papyri* të kohës së Ptolomeut bëhej e qartë që /-n/ fundore në fjalët shumërokëshe birrej tashmë në sh. II para Krishtit (Referonte: Mayser 1970: 169-171). Kështu ai nxirrte përfundimin:

“Nëse protoshqipja është sjellë ngjashëm fonetikisht lidhur me bashkëtingëlloret hundore në fjalët shumërokëshe si latinishtja dhe greqishtja e kohës, atëherë çdo gjë flet për këtë që bashkëtingëlloret përkatëse hundore

¹⁶⁰ “... die Univerbierung zwischen dem Substantiv und dem bestimmten Artikel muss eingetreten sein, bevor im Albanischen die auslautenden Nasalkonsonanten bei innersilbigen Wörtern verloren gingen”.

fundore të protoshqipes do të jenë bjerrë tërësisht në shekullin I para Krishtit" (Schumacher 2009: 57).¹⁶¹

Cila do të ishte arsyeja fonetike ose tjetër për zhdukjen e *n*-së fundore në protoshqipen? A ka pasur edhe një nazalizim në protoshqipen, si më vonë në shqipen e hershme?

Schumacher-i pas këtyre supozimeve vijonte:

"Por, meqë përngjitja midis emrit dhe nyjës shquese do të ketë ndodhur tashmë qysh para rënies së bashkëtingëllores hundore nistore (shih më sipër), nga kjo që u tha rrjedh se protoshqipja qysh para shekullit I para Krishtit kishte një shquese të përngjitur me emrin para-shkues" (Schumacher 2009: 57).¹⁶²

Pra: shqipja kishte një të aglutinuar qysh para sh. I para Krishtit, mendonte ai. Si të vendoset kjo në radhën e aglutinimeve të tjera? Si del puna e temave në bazë të huazimeve nga latinishtja e greqishtja e vjetër? Si të vendosen zhvillimet brenda shqipes pas këtij konstatimi?

Duke e marrë të dëshmuar këtë, Schumacher-i vijonte me argumentimin se për latinishten e sh. I para Krishtit nuk mund të flitet për një shquese, prandaj mund vetëm të vështrohet e tërë çështja në dritën e asaj që mund të shihet nga zhvillimet në fushën e nyajve shquese në gjuhët romane. As në tekstet e vona latine të sh. 6/7 pas Krishtit gramatikalizimi i dëftorëve *ille* dhe *ipse* si nyja shquese ende nuk ka përfunduar (referonte: Nocentini 1996: 3-44, konkretisht 23),

¹⁶¹ "Wenn sich das Protoalbanische in Bezug auf auslautende Nasalkonsonanten in mehrsilbigen Wörtern phonetisch ähnlich verhalten hat wie das zeitgenössische Leteinische und Griechische, dann spricht alles dafür, dass die entsprechenden auslautenden Nasalkonsonanten des protoalbanischen spätestens im 1. Jahrhundert v. Chr. bereits völlig geschwunden waren".

¹⁶² "Da aber die Univerbierung zwischen Substantiv und bestimmtem Artikel schon vor dem Schwund des anlautenden Nasalkonsonanten eingetreten sein muss (siehe oben), folgt aus dem eben Gesagten, dass das Protoalbanische schon vor dem 1. Jahrhundert v. Chr. einen mit dem vorausgehenden Substantiv univerbirerten bestimmten Artikel hatte".

ndërsa një nyjë plotësisht të ndërtuar shquese e ndeshim për herë të parë në gjuhët romane.

E tërë kjo ka të bëjë me faktin se gjeneza e nyjës shquese në shqipen nuk mund të lidhet me ndikimin e latinishtes. Në shënimin 84 Schumacher-i shtronte idenë se duket më e besueshme që krijimi i nyjës shquese në shqipen të jetë i lidhur me ndikimin e greqishtes, por këtu nuk hynte në detaje. Megjithatë, theksonte se nga mesjeta e hershme në Europë ndeshet një nyjë shquese jo vetëm në gjuhët romane e gjermanike, po edhe në keltishten ishullore, në baskishten, në greqishten e në shqipen (në bullgarishten në këtë kohë nyja shquese ishte *in statu nascendi*). Nyja shquese jo te të gjitha gjuhët doli në të njëjtën kohë: në greqishten nyja shquese është shumë e vjetër, ndërsa në shqipen gjeneza e nyjës shkon “me gjasë qysh para ndërrimit të epokave”; por edhe në keltishten ishullore krijimi i nyjës shquese nuk mund të vendoset më vonë se ndërrimi i epokave, ndërsa në gjuhët romane dhe gjermanike kjo ka ngjarë qindra vjet më vonë. Avancoje konstatimin se çështja e nyjës shquese në Europë është çështje areale, prandaj shqyrtimi i saj në shqipen, në gjuhët romane dhe në gjuhët gjermanike nuk mund të jetë i plotë nëse nuk kihet parasysh se te nyja shquese kemi të bëjmë me një fenomen areal, ndërsa kontakti ka luajtur një rol. Por, thoshte në vijim të tekstit,

“... prapavendosja dhe përngjitja vijuese e nyjës shquese në gjuhët romane ballkanike mund të jetë ndikuar nga protoshqipja” (Schumacher 2009: 58).¹⁶³

Tani shtrohen çështjet: kur u krijua nyja shquese në shqipen? Cili është raporti midis nyjës së përparme dhe nyjës së prapme? Cilat janë rrethanat sintaktiko-strukture në të cilat ndikimi i protoshqipes do të ketë qenë i mundur?

Pse duhet të merret që *-në* te kallëzorja është nga **-ōm+tōm*? Dhe si të shpjegohen lidhjet e **tōm* me format e tjera të nyjës – *së, të, e, i* jashtë kallëzores?

¹⁶³ “... die Postposition und die nachfolgende Univerbierung des bestimmten Artikels in den balkanromanischen Sprachen durchaus vom protoalbanischen beeinflusst sein kann”.

Për të gjitha aspektet e nyjës në gjuhën shqipe tani vonë kemi një monografi të Kolec Topallit. Në të referohen idetë e studiuësve paraprakë në këtë fushë, natyrisht me parapëlqimet e tij për ato që ai gjykonte.

“Një drejtim të ri hapi në studimin e nyjave të shqipes Eqrem Çabej me botimin e artikullit ‘Rreth çështjeve të historisë së gjuhës shqipe’. Duke analizuar shfaqjet e dy nyjave në tekste të vjetra dhe në gjuhën popullore, ai arriti në përfundimin se nga dy nyjat e shqipes nyja e prapme është më e vjetër, kurse e përparmja është më e re dhe ka dalë nga përsëritja e nyjës së prapme në ngërthim të fjalisë”, (Topalli 2009: 42).

Këtë tezë Topalli e gjykonte të argumentuar. Topalli në veprën e tij më tej i ka raportuar të gjitha idetë e shprehura lidhur me krijimin e nyjave në shqipen. Lidhur me tezën për krijimin e nyjave në periudhën parahistorike ai raportonte si argument

“faktin se nyja shqese e rasës kallëzore -në, ku është bashkuar mbaresa e trashëguar e kësaj rase -om me përemrat dëftor[ë] tom (m.) ~ tām (f.), ka ndodhur në periudhën parahistorike, meqenëse huazimet latine, që i përkasin periudhës historike, nuk e kthejnë grupin /nt/ a /nd/ në /n/” (Topalli 2009: 265).

Topalli në vijim e theksonte faktin se

“formimi i nyjës së prapme shqese të rasës kallëzore është njëri nga argumentet e pakundërshtueshme”,

por, sipas tij, teza për formimin e kësaj nyjeje në periudhën parahistorike do rishikuar, sepse nuk i merr parasysh kushtet sintaksore në të cilat është formuar dhe pozicionin në lidhje me theksin sintagmatik. Se /t/, /nd/ në periudhën parahistorike janë shndërruar në /n/, sipas tij, dëshmojnë dhe foljet *janë, kanë*. Vështirësinë që krijon fakti se në huazimet latine ky grup nuk është zhvilluar në /n/ Topalli mëtonte ta zgjidhte përmes kushteve fonetike-sintaksore të sandh’it:

“grupi -nt-, i formuar nga bashkimi i mbaresës së vjetër të rasës kallëzore me përemrin dëftor (khs. sipas Pedersenit snusan-tām), është ndodhur jo pranë theksit të fjalës, por një rrokje pas tij, domethënë në një rrokje të patheksuar” (Topalli 2009: 266).

Sipas tij, meqenëse nuk mendon se nyja e prapme do të jetë krijuar në fazë parahistorike,

“mund të pranohet evolucioni i grupit bashkëtingëllor /nt/ > /n/ edhe në periudhën historike, në qoftë se ai ka qenë në një rrokje të pathek-suar”, Topalli 2009: 268.

Kjo do të thotë se zhvillimi në trajtën -në mund të ketë ndodhur në periudhën historike (por *snúsām tām* deri në periudhën historike do të ketë pasur dhe zhvillime të tjera fonetike, që nuk janë shpjeguar).

Pas të gjitha diskutimeve, Topalli arrinte këtë përfundim:

“... moshë e nyjave të shqipes mund të vendoset në periudhën e marrëdhënies të hershme ose intensive të shqipes me latinishten, jo më herët se shekulli IV, por jo më vonë se shekulli VI”, Topalli 2009: 272.

Me diskutimet lidhur me çështjet e përmendura nuk mund të merremi këtu gjerësisht. Mendoj se aspektet sintagmatike, që theksonte Topalli, duan parë si vërtet të rëndësishme dhe ato janë parë tashmë në një studim të rëndësishëm siç është ai i B. Bokshit. Ato mund të tregojnë qartë se si u krijua nyja nga dëftori, si ndodhi që të lëvizte vendi i saj në sintagmë, etj. Më duket se jo vetëm arsyet sintagmatike, po edhe përgjithësisht teza për krijimin e një elementi gramatikor si nyja (e përparme) përmes përsëritjes në ngërthim të fjalisë nuk i qëndron kritikës.

Në diskutimet për nyjën ka interes të sille të vëmendje një aspekt i veçantë lidhur me tejkalimin e vështirësive të përmendura fonetike dhe me konceptimin e përgjithshëm për zhvillimet e mbaresave pas krijimit të theksit dinamik, i shqyrtuar edhe te B. Bokshi. Fjala është për burimin e formës nyjore -n(ë) të rasës kallëzore njëjës të emrave mashkullorë e femërorë, që zakonisht është lidhur me format e lashta *-om-tom-. Për Bokshin, këtu kemi të bëjmë me një parafjalë-nyjë *ëntë*, pra konglutininim të parafjalës *ën* me formën nyjore të kallëzores -të. Në ndërtimet **ëntë pus* elementi *ëntë* ruante vlerën parafjalore, po edhe vlerën e nyjës shquese të paravendosur. Në ndërtime më të plota si **ën të thellë ëntë pus*, **ëntë* dilte me vlerë nyjore, ndërsa pastaj ajo shfaqej dhe në ndërtime me parafjalë të ngjashme si

**me të thellë ëntë pus. Suma sumarum*, kemi të bëjmë me ndërtim tjetër, jo me formën e lashtë IE **-om-tom-* (Bokshi 1980: 364-366; Bokshi 1984). Këtë diskutim, ashtu si dhe argumentimin e tij për krijimin e nyjës shquese si të parme dhe për procesin e pastajmë të prapavendosjes dhe aglutinimit Schumacher-i nuk e kishte parë.

Por le ta rikujtojmë më parë diskutimin gjithsesi specifik për këto çështje midis Çabejtë e Rizës, diskutim i cili për një pjesë, konkretisht dhe për atë që lidhet me konceptimin e raporteve shqipe-rumanishte, është bërë i njohur vetëm më vonë.

Çabej - Riza

Një nga mospajtimet e rëndësishme midis Çabejtë e Rizës lidhet me çështjen e nyjave: derisa Çabej mendonte se nyja është krijuar fillimisht si e prapavendosur dhe vetëm më vonë u krijua nyja e përparme, Riza thoshte ndryshe: e ardhur nga dëftori, nyja e prapme dikur ka qenë e paravendosur dhe u prapavendos më vonë. Këtë ide e kishte që në krye të herës. Në çështjen e krijimit të nyjës nga dëftori ai shihte përkime me greqishten e lashtë. Më 1966 ai nisej nga supozimi i Camarda-s 1864 për paralelizmin midis greqishtes së vjetër *ho, hē, to* dhe të shqipes *i, e, të*, si bashkëpërkim i posaçëm midis vetëm këtyre dy gjuhëve vetëm në pozitën parandejtuese në epokën e lashtë të shqipes. Referonte qëndrimin e kundërt të Çabejtë, për të cilin thoshte se nisej nga vështrimi i afrisë së shqipes me rumanishten, duke parë në nyjën gjenitivele e posesive *al, a* si pandanin strukturor të shqipes *i, e, të*; prandaj, sipas Rizës, Çabej nyjës gjenitivele të shqipes në çdo kohë i ka mohuar funksionin shques, madje karakterin nyjor, pra edhe përkimin me *ho, hē, to* të greqishtes.

Pohimi themelor i Çabejtë, prej nga nisej Riza, ishte ky:

“Shqipja dhe rumanishtja paraqesin midis tyre lidhje aq të ngushta në sistemin fonetik e morfologjik, në leksik e në fjalëformim, në sintaksë e në frazeologji, në mënyra të thëni, proverb e shprehje proverbiale, sa – pa lë-

në pas dore ndryshimet që kanë – shpesh-herë kemi përshtypjen se kemi të bëjmë me një të vetme frymë gjuhësore që shfaqet me dy trajta të ndryshme” (Çabej 1963: 74).

Në fundfaqe Riza bënte komente lidhur me këtë vlerësim të Çabejtë: meqenëse rumanishtja është gjuhë rio-latine, e formuar në sh. VII, përpara kontaktit tonë më aktiv me sllavët, ndërsa shqipja vazhduese e një gjuhe të lashtë indoeuropiane dhe të lashtë ballkanike, këto lidhje me rumanishten Çabej i ka stërmadhuar, sipas tij. Duke kallëzuar rrezikun për të rrëshqitur te vlerësimi i G. Meyer-it për ndikimin e latinishtes në shqipen, vlerësimin e Çabejtë:

“... lidhjet që ekzistojnë ndërmjet këtyre dy gjuhëve mund të zëvendësojnë me një farë mënyre për të dyja ato periodën e tyre paraletrae” (Çabej, aty. f. 73),

e cilësonte iluzion, ndërsa vetë përkimet me rumanishten i shihte si vijon:

“pikëpuqjet e shqipes me rumanishten mësëforti u përkasin vetëm elementet me prejardhje të përbashkët nga latinishtja ballkanike e nga sllavishtja jugore, sidhe huazimet reciprokë në lëmin kryesisht të leksikut dhe frazeologjisë. Anasjelltas afiniteti i shqipes me greqishten, gjuhë barabar lashtë-indoeuropiane dhe lashtoballkanike – në radhë të parë ka të bëjë pikërisht me fondin e pahuazuar të leksikut dhe strukturën origjinale të gramatikës të gjuhës sonë” (Riza 2004: 539).

Riza në kërkimet e tij i kthehej La Piana-s:

“... tiparet e përbashkët midis greqishtes dhe shqipes janë aq të shumtë e të tejpashëm në çdo fushë, në leksik, në morfologji, në sintaksë e deri në mënyrën e të menduarit, sa është absurd të duash t’i shpjegosh veçmas me ndikime të mundshëm të njërës gjuhë mbi tjetrën... Për ne këta tipare të përbashkët, që nuk përjashtojnë karakteristikat individuale në njërën dhe tjetrën gjuhë, janë për t’u vështruar para së gjithash në tërësinë e tyre, dhe tregojnë një evolucion të natyrshëm elementesh dhe lëvizjesh origjinarisht të përbashkëta...” (La Piana 1939: 139-40).

Riza sillte argumentet e Çabejtë për konceptin e tij të afrisë midis shqipes e rumanishtes, në një anë, dhe për dallimet midis shqipes e greqishtes, në anën tjetër. Ai njëherësh konstatonte se edhe nga të tjerët kjo

çështje është shqyrtuar në mënyra të ndryshme. Kishte vërejtje dhe për konceptimet e nyjave tek autorë të ndryshëm vendës e të tjerë.

Riza nisej nga vlerësimi se teorikisht vështrimet që thonë se në gjuhët si anglishtja, ku kemi një trajtë të vetme të nyjës shquese të pandryshueshme, ajo shërben për të shquar emrat dhe për të substantivuar jo-emrat, ashtu si ato që thonë se në gjuhë si shqipja e greqishtja, ku tri trajtat e një nyjeje shquese të ndryshueshme sipas gjinisë, numrit dhe rasës, përveç për të shquar emrat e substantivuar nga jo-emrat, shërbejnë për të treguar gjininë, numrin, rasën, në fakt këto vështrime mbështeten në një të vetëm: në gjuhët me një nyjë shquese, funksionit shques të saj i bashkërriten 1-4 funksione joshques (Riza 2004: 541-2). Kjo i dukej joshkencore.

Teza e Çabejtë, sipas tij, se në gjuhën shqipe nyja e paravenduar e shqimit të plotë gjithmonë, pra prej fillimi, ka qenë e zhveshur nga funksioni shques, është refleks i tezës së mësipër, prandaj e konsideronte të nevojshme ta zhvërtetonte të parën fillimisht. Ndërkaq, teoria e tillë sundon në traditat shqipe, greke, italiane, frënge, gjermane e rumune.

Riza mbronte kundërtezën se nyja shquese ka karakter të funksionit ekskluzivisht shques:

1. Përkimi i nyjës shquese (që rrjedh nga dëftori anaforik me funksion adjektival) me emrin është rast i veçantë i përkimit të emrit me mbiemrat;

2. Gjinia gramatikore e emrit është inherente në formën e tij bazale; gjinia natyrore shprehet me afiksa tek emrat mocionalë e me elemente të tjera, por jo me gjininë gramatikore të nyjës përkuese me emrin përkatës;

3. Dallimi në frëngjishte i rasteve homofone si *la porte – les portes* është i mundshëm vetëm atëherë kur lejohet përdorimi i nyjës shquese si mjet shqimi;

4. Në shqipen e gjermanishten pamundësia e përdorimit të emrit në gjinore–dhanore është çështje sintaksore; pra, trajtat e nyjës shquese nuk kryejnë funksion lakor për llogari të emrit, po ai i ka mbaresat e veta

lakore: *TischES, TischE; tryezE, tryezE.*; subjektivimin gramatikor e kanë dhe gjuhë pa nyjë si latinishtja;

6. Përkimi gjinor, numëror e rasor i nyjës shquese me emrin nuk hyn në specifikën e saj kategoriale: shih pandryshueshmërinë e nyjës në arabishte, ndërsa zhdukja e trajtave gjinore, numërore e rasore të nyjës në anglishten nuk ka penguar që ajo të mbetet nyjë;

7. Ndjekësit e teorisë së përmendur nuk kanë gjetur raste përdorimi të nyjës në pavarësi nga shqimi, Riza 2004: 544-5.

Më tej Riza merrej me shkaqet kryesore pse teoria për funksionet jo-shquese të nyjës shquese u shfaq në traditat e ndryshme.

Riza te gjinorja *i, e, të, së* shihte elementin e përsëritur për emrin parashkues, ndërsa gjinorja *e lisavet* në fund ishte shfaqur e fiksuar qysh te Buzuku. Në rastin e *të te po punoj jo me librin tim por me të Pjetrit - të është 'dëftor'*.

Lidhur me moshën e hershme të nyjës proklitike S. Riza ishte *shprehur* në studimin e vitit 1966, që kishte mbetur pa botuar deri më 2004.¹⁶⁴ Edhe pse nuk ishte botuar, lidhur me këtë kumtesë të Selman Rizës Eqrem Çabej, megjithatë, e kishte shprehur qëndrimin e vet më 1979, në një kohë kur Riza nuk kishte të drejtë botimi. Në studimin *Mbi disa dukuri të historisë së gjuhës shqipe të para në lidhje me gjuhët e tjera ballkanike*, në

¹⁶⁴ Në të vërtetë, kumtesa e përgatitur dhe e shtypur me kokën **Ier Congrès International des Études Balkaniques et Sud-Est Européennes, Communications de la Délégation de la R. P. d'Albanie, "imprimé sous forme de manuscrit"**, Tirana, 1966 nuk ishte dërguar në Sofje as autori ishte lejuar të shkonte atje, sepse komisioni (ku bënë pjesë edhe A. Kostallari e E. Çabej) nuk ishte pajtuar, megjithë përgjigjet e Rizës për vërejtjet. Autorit nuk i ishte lejuar më vonë që këtë kumtesë ta dërgonte për botim në Prishtinë (1976). Ndër vërejtjet që i bënte Komisioni ndonjë kishte të bënte dhe me qëndrimet e Rizës ndaj ideve të Çabejtë, për të cilat ai kishte dhënë shpjegime me kohë. Pas gjithë procedurës së diskutimeve, kumtesa ishte shtypur si material që do të dërgohej në Kongres, por kjo nuk kishte ndodhur. Nuk i dimë arsyet për këtë. Ne vendosëm ta botonim atë kur na ra në dorë, së pari frëngjisht te *Studime* 10/ 2003, Prishtinë, ff. 37-55 dhe shqip te S. Riza: *Vepra* 4, Prishtinë 2004, ff. 91-114. Materialet dokumentuese për diskutimet me atë rast janë botuar te R. Ismajli: *Pasionet dhe pësimet e Selman Rizës*, Prishtinë 2009, ff. 332-347.

Studime filologjike 4, 1979, f. 80-81, ai ishte shprehur si vijon:

“Edhe ndonjë përpjekje më e re për të vërtetuar për një proklitike një moshë të lashtë edhe aty në funksion shquarësie të ekzistuar qëmoti, dhe për ta postuluar atë një me një funksion të tillë bile edhe për emrin në një kohë të moçme, me qëllim për të vërtetuar me çdo kusht një konkordancë gramatikore, një “concordance quasi-totale et presque parfaite” midis greqishtes së vjetër dhe shqipes, (referonte: S. Riza, Sur une concordance grammaticale spécifique de l’albanais avec le grec, 1966, 29 vv, pa vend botimi) edhe kjo nuk mund të quhet se ia ka arritur qëllimit. Ndërtimit të mëdhenj thonj e jo të vegjëlë kinse dikur ‘les grands ongles et les petits’; në të vërtetë ‘(des) grands ongles et (des) petits’, i sajuar për këtë qëllim e që nuk i përgjigjet ndërtimit dhe topikës reale të fjalëve në fjalinë e shqipes, larg nga ajo që të vërtetojë një konkordancë të veçantë greko-shqiptare, rezulton të jetë në të vërtetë një lloj i veçantë i topikës sintaktike të gjuhëve gjermanike në lidhje këpujore, kopulative, topikë që në sintaksën gjermane quhet Spaltung ‘çarje’”.

Selman Riza e kishte kritikuar Eqrem Çabejnë se po i theksonte më shumë se ç’duhej raportet e afërsisë të shqipes me rumanishten, ndërsa ato, përkundrazi, sipas Rizës, duheshin trajtuar si të mesjetës. Për lashtësinë, sipas tij, duheshin marrë në konsideratë më parë raportet me gjuhët indoeuropiane, konkretisht me greqishten (Riza 2004:93). Çabej kishte qenë kundër mendimit të Dh. Kamardës, i cili kishte parë ngjashmëri midis shqipes e greqishtes sa u përket nyjave dhe shumë më tepër (shih Camarda 1864: 188-189). Çabej kishte parë një paralelizëm të përsosur midis sistemit nyjor të shqipes e të rumanishtes. Nevojën për t’i vështruar më parë raportet e shqipes me gjuhët lashtoballkanike e IE, duke parë aty diçka që ka të bëjë

“me fondin e pahuazuar të leksikut dhe strukturën origjinale të gramatikës sonë”,

Riza e kishte konkretizuar me shpjegimet për ngjashmëritë për krijimin e një shquese të shqipes e të greqishtes mjaft më herët:

“sistemet nyjorë të gjuhës shqipe dhe greqishtes duhet të jenë vërsnikë të një vërsnikie nga më të hershmet. Në këto dy gjuhë vetëm kështu mund të shpjegohen kënaqshëm në një anë idiomatizmi unikal i nyjzimit

të përgjithësuar të emrave të përveçëm, e n'anë tjetër mundësia gjithashtu unikale e primjes së emrave të nyjësuar nga dëftorët përkatës" (Riza 2004: 113).

Në këtë punë ai nuk ishte mjaftuar me kritikën e vet, po i ishte drejtuar tashmë një tradite albanistike për ato lidhje me greqishten, të shembëlluar më vonë me Marco La Piana-n:

"... tiparet e përbashkët midis greqishtes e shqipes janë aq të shumtë e të tejpushëm në çdo fushë, në leksik, në morfologji, në sintaksë e deri në mënyrën e të menduarit e të të shprehurit të mendimit, sa është absurde të duash t'i shpjegosh veçmas me ndikime të mundshëm të njëres gjuhë mbi tjetrën"... (La Piana 1939: 139-140, përkthimi i S. Rizës).

Aglutinimi i nyjës në shqipen dhe mundësia e ndikimit në rumanishten sipas Bokshit

Besim Bokshi në librin e tij *Prapavendosja e nyjave në gjuhët e Ballkanit*, duke u nisur nga studimi shterrues i zhvillimeve brenda shqipes, ishte marrë edhe me proceset e prapavendosjes së nyjave në gjuhët rumune e bullgare dhe kishte arritur në përfundimin se ka mundësi që shqipja të kishte ndikuar në romanitetin ballkanik të periudhës së sh. VII-VIII, kur po formohej rumanishtja, e kur kontaktet ishin ende të pandërprera nga sllavishtet. Sipas Bokshit lëvizjen e renditjes së elementit nyjë nga prapavendosja në prapavendosje në rumanishten do ta kishte kryer përemri në fazën anaforike dhe jo nyja, pra në kohën e latinishtes danubiane, në të cilën nuk u përgjithësuan strukturat e tipit *ille bonus homo, ille homo*, po pikërisht nën ndikimin e shqipes së atëhershme, pra të strukturave të saj të tipit *i pus, bujar i djalë*, ku anaforiku përdorej vetëm në kontakt me emrin, prandaj dhe renditja e detyrueshme u bë *bonu/ illu homo* dhe prej këndeje anaforiku kaloi në nyjë. Kur mungonte emri, pas tij, grupi emëror dilte *bonu əlu Ø*, ndërkohë që kur mungonte mbiemri ajo dilte *Ø əlu omu*. Meqenëse kjo në rumanishten ka ndodhur afërsisht nga sh. VII deri në sh. X, ka pasur mundësi që ajo të ketë ndikuar dhe në sllavishten (Bokshi 1984: 212). Pas aglutinimit u përftua struktura e re: nga *bonu/ əlu omu* në *bonu + əlu / omu*. Prandaj emri nuk mund të dilte me nyjë të paravendo-

sur. Në këtë mënyrë u përftua *bonul om* dhe *omul bun*. Kjo do të thotë se, sipas Bokshit, renditja për rumanishten e tipit mbiemër – emër anaforik + emër (*bonus ille homo*) kishte ndodhur në latinishten danubiane; renditja me kalim të anaforikut në një, pra mbiemër – një + emër (*bonu (il) lu omu*), kishte ndodhur në rumanishten e përbashkët, ndërsa aglutinimi i njëjës me mbiemrin: mbiemër – një + emër (*bonul om* dhe krijimi i renditjes së zakonshme emër + një – mbiemër (*omul bun*), edhe kjo do të ketë ndodhur në rumanishten e përbashkët.

Për ta parë gjithë këtë ngrehinë zhvillimesh në rrjedhën e saj më të plotë, do pasqyruar zhvillimi të cilin Bokshi e kishte parë brenda shqipes. Kuptohet që pikënisja e tij është se nyja ka dalë nga dëftori që qëndronte në pozitë të përparme. Nga periudha e kontakteve me latinishten deri nga përfundimi i sh. V, pas tij, u krijua nyja shqese, e paravendosur në raport me emrin [i pus]; në raport me mbiemrin dhe grupin e plotë emëror [i | thellë | pus] (= i thelli pus, pusi i thellë) (Bokshi 2010: 54). Transformimi nga përemri anaforik në një përfundoi pas një procesi relativisht të gjatë të funksionimit të përemrit si artikuloide.

“Për gjuhën shqipe, si për gjuhët neolatine më vonë, krijimi i njëjës është i lidhur me krijimin e strukturës analitike” (Bokshi 2010: 54).

E tërë kjo lidhet me fiksimin e vendit të theksit dhe me procesin e rënies së mbaresave. Në kuadër të argumentimeve, të tilla ka pasur edhe te Riza, Bokshi në këtë vepër vinte me shpjegimet për emrat e ditëve të javës në shqipen,

“kur nyja në gjuhën shqipe nuk përdorej ende me emrat e përveçëm”
dhe kjo është


“dëshmi e gjendjes pa mbaresa rasore: [e | Hënë | ditë] (=dita e Hënës), [e | Mart | ditë] (=dita e Martit), [e | Mërkur | ditë] (=dita e Mërkurit), etj.” (Bokshi 2010: 55).

Këtu e është një shqese e emrit të përgjithshëm *ditë*, ndërsa emrat e përveçëm *Hënë*, *Mart* nuk kanë njëjës. Kjo do të thotë se emrat *e martë*, *e mërkurë*, *e shtunë* janë huazuar nga latinishtja para përhapjes së krishtërit te latinët, prandaj

“nyja shquese në protoshqipen është e kohës së huazimeve të para nga latinishtja, pra e kohës para se të krijoheshin emrat septimana, sabati e dominica, që i sollli krishtërimi” (Bokshi 2010: 55).

Në fazën e parë të krijimit dhe të pozitës së nyjës në shqipen krijohet sistemi i nyjzimit, kategoria gramatikore e shquarësisë me të tre elementët: një shquese, një joshquese dhe një zero. Përemri dëftor dhe nyja shquese që dilte nga ai dallonin vetëm në çështje theksimi: përemri ishte i theksuar, nyja shquese e patheksuar.

Nyja e përparme të mbiemrat dhe të gjinorja u krijua në vijim në kuadër të proceseve sintagmatike brenda shqipes, ndërsa po në kuadër të atyre proceseve pati lëvizje në renditjen e fjalëve brenda gjymtyrës nominale. Pas krijimit të nyjës së përparme të mbiemrit ([i thellë i pus, i mirë i punëtor, bujar i djalë, i thellë i ø], nyja shquese u aglutinua me mbiemrin: [i thelli pus, i miri punëtor, bujari djalë, i thelli] (Bokshi 2010: 107). Kjo shkaktoi ndryshime të vendit të elementit funksiv nga F - Art E në F - M Art:



Nyja shquese në këtë situatë e lidhur me segmentin e parë e mbante të katalizueshëm emrin (*i thelli ø*) si segment të dytë të GN-së, F ishte segment konstant i GN-së, E funksionalisht variabël.

“Nyja u aglutinua pasi ishin reduktuar në -ë zanoret e nyjave në shumës: [*ta > të, *to > të, *tyn > të, *tan > të]” (Bokshi 2010: 108). “Përngjitja e

*nyjës është bërë pas shkrirjes së mbarësës së shumësit *-i d.m.th. pas përfutimit të formave metafonike e të palatalizuara në shumë, meqë nyja -i nuk e shkaktoi metafoninë e palatalizimin, por rotacizmin. Aglutinimi i nyjës u bë edhe pas rënies së -n-së nga tema me përfundim në -on të theksuar: [kro-i, përro-i, fto-i] dhe para rënies të emrat e tipit [pen-i, fren-i, mullin-i] si dhe të pjesorja e tipit (ka) lan edhe brenda mbiemrit të nyjshëm: [i lan-i, i pren-i, i thyen-i]. Këto tregojnë se përngjitja e nyjës është bërë pas përfutimit të huazimeve latine e para përfutimit të rotacizmit, që mendojmë të jetë i shek.. VIII. Kështu si kohë relative për përngjitjen e nyjës del shek. VII” (Bokshi 2010: 109).*

Në këtë rrjedhë procesesh sintagmatike dhe në këtë rrjedhë kohore del i kuptueshëm edhe supozimi i Bokshit i bërë në veprën për *Nyjat*, sipas të cilit ndikimi eventual i shqipes në romanishten/ rumanishten mund të ketë qenë i mundshëm në kohën kur në shqipen ende nuk ishte bërë aglutinimi, pra diku në sh. VI-VII, çka, për ne, duket plauzibile edhe për kohën kur mund të kenë hyrë në romanishten/ rumanishten edhe elemente të tjera nga shqipja (sidomos fjalë).

Të gjitha këto, përveç studimeve të Çabejtë dhe fare pak të Domit, nuk janë parë të konsultuara ndonjëherë në rumanistikë, mbase edhe për pasojë të njëfarë heshtjeje të tyre brenda albanistikës.

Frâncu dhe Paliga për prejardhjen e substratin

Më 1999 Constantin Frâncu botoi librin me interes *Geneza limbii romane și etnogeneza românilor*, që paraqiste një sprovë përmbledhëse, por njëherësh vlerësuese dhe për diçka edhe distancuese nga të mëparmet. Në pjesën për substratin e rumanishtes ai përmblihte afërsisht ato që janë thënë në dekadat e fundit para tij: fjala është për një popull trako-dak, apo geto-dak, indoeuropian, me gjuhë satəm, që banonte në verilindje të siujdhesës dhe në Daki, në rajonet e Deti të Zi, të Danubit e deri te Karpitet e stepat sarmate (referonte Russu 1967; ILR II 1969; Ivănescu 1980; Vraciu 1981; Reichenkron 1966, etj). Por veçonte gjithashtu se Steinke-Vraciu (1999: 139-140) në *Hyrjen* e tyre në *ballkanistikë* trakishten e dakishten i shihnin gju-

hë të veçanta. Ndër fiset trakase, ku hynin dakasit, getët, karpët, roksolanët, bastarnët, kostobokët, mezët (Mezi e Epër dhe e Poshtme), tribalët (Bullgari), krobizët (malet Ballkan), ai numëronte, si dhe të tjerë autorë rumunë, edhe dardanët në hapësirat Nais-Scupi. Gjuha e trakasve dhe e dakasve ka lënë gjurmë në rumanishten, çka shihet në glosa, emra vendesh, njerëzish, fisesh, hyjnish, etj. Zëvendësimi i gjuhës trako-dakase me latinishten ka qenë gradual, më parë në qytete. Në veri të Danubit fenomeni ishte më i shpejtë në vendbanimet urbane, por dukshëm më i ngadalshëm në zonat rurale të kostobokëve, të karpëve, të dakëve të lirë. Popullata trako-dake që kishte përvetësuar latinishten vazhdonte të jetonte në një formë të jetës sociale rustikale, pastorale, modeste, por vazhdonte t'i ruante lidhjet me romanitetin jugdanubian, duke mos qenë Danubi kufi i pakapërcyeshëm. Kështu ajo popullatë kishte ruajtur nga fondi gjuhësor pararoman një numër elementesh leksikore dhe një numër veçorish shqiptimore e morfosintaksore. Ato fjalë kanë pësuar përshtatje latine ashtu si latinizmat që pësuan përshtatje trako-dakase. Kjo, sipas tij, vlente vetëm për brezin e parë, ndërsa për brezin në vijim largimet drejtshqiptimore evitoheshin, siç dëshmon struktura fonetike e fjalëve rumune me prejardhje latine në pajtim të plotë me Romaninë tjetër. Në Daki u përshtat norma gjuhësore latine popullore. Duke pasur parasysh se sundimi roman në Daki zgjati afërsisht 5 breza (168 vjet) dhe se procesi i romanizimit kishte filluar me faktorë të tregtisë para pushtimit dhe kishte vazhduar dhe pastaj, përmes krishtenizmit, mendonte ai, mund të arrijmë përfundimin se në strukturën fonetike dhe morfo-sintaksore të gjuhës rumune nuk kanë mundur të ruheshin shumë fenomene trako-dakase.

Në kushtet që jemi, mendonte Frâncu, prania e tyre është vëshirë të përdëshmohet, por mund të presupozohet. Si të tilla janë përmendur shkrija e dativit me gjenitivin (e vërejtur në shqipen, armenishten, greqishten e re), prapavendosja e njëjës shquese (shqip, rum., bullg., armen. e gjuhët skandinave), ruajtja e asnjansit (vetëm shqip e rumanisht), formimi i numërorëve 11-19, numri *sută*, pjesëza *-ne*,

dyfishimi i përemrit vetor, zëvendësimi i paskajores me lidhore (gr. e re, shqip, bullg., pjesërisht serbisht dhe në disa dialekte të Italisë së Jugut). Disa syresh janë shpjeguar si fenomene latine, disa sllave apo të pavarura në rum. e në gjuhët e tjera (Frâncu 1999: 7-9).

Duket përgjithësisht i kuptueshëm skenari që supozohet për përshtatjen e latinishtes popullore. Por na duket se është e nevojshme të themi që skenarë të ngjashëm kanë ndodhur dhe në hapësira të tjera të Ballkanit dhe në kohë edhe më të hershme. Gjithashtu do thënë se adoptimi i tillë i latinishtes popullore vlente dhe për popullata me gjuhë tjetër pos trako-dakishtes, ndërsa kur romanizoheshin ata nuk dihehin më ç'kishin qenë më parë, sepse flisnin tani gjuhë të njëjtë. Kështu lindin vështirësi të reja për shpjegimin e prejardhjes së ndonjërit prej elementeve të supozuara si të substratit. Kjo vlen në radhë të parë për fjalët, të cilat kanë mundur të qarkullonin në hapësira të ndryshme, po edhe për çështjet më të vështira si ato të strukturës. Për shembull, këmbëngulja e tij për të dëshmuar se fonema /h/ në rumanishten prejardhjen e ka nga trako-dakishtja në bazë të fjalës *hameş* (shqip *hamës*), ndërkohë që rumanishtja ka huazuar numër jo të vogël fjalësh sllave me *h* në të gjitha pozitat, duket edhe më vështirë e dëshmueshme, sepse te *hameş* është evidente që, po të jetë nga shqipja, kemi të bëjmë me një huazim të vonë (këtë e tregon formimi: *ham-ës*, si te *pi-mës*, me prapashtesën *-ës* për emra veprimi). Vlen të theksohet posaçërisht fakti se Frâncu bënte vërejtje me interes lidhur me supozimet e tilla sa i përket përshtatjes së elementeve të supozuara të substratit: ngrinte nevojën e shpjegimit pse nuk ka ndodhur rotacizimi i *-l-* ndërzanore te fjalët e tipit *mal* (: **malu*), *căciulă*, apo pse nuk kanë rënë bashkëtingëlloret mbylltore të zëshme të tipit *măgură*, *mugure*, *măgar*, por shpjegimi që kërkonte duket konstruksion:

“këto fjalë kanë hyrë në gjuhën e popullatës së romanizuar nga gjuha e dakasve të lirë pasi kishte rënë -g- ndërzanore, domethënë më vonë, në sh. IV, V. Këtë situatë e kanë fjalët me -l- ndërzanore, të parotacizuar (căciulă, malu e të tjera, të cilat duan marrë si elemente të

adstratit" (Frâncu 1999: 12).¹⁶⁵

Në fakt, ne na duket se ky fond leksikor i përbashkët midis rumanishtes e shqipes do parë si shumë më i diferencuar sa i përket kohës, po dhe burimit, prandaj në të dalin kaq shumë mosrrafshime apo vështirësi shpjegimi. Fjalët me mosrotacizim të -/- ndërzanore kanë hyrë më vonë dhe ndonjëherë mund të kenë burim tjetër, si ato që nuk e kanë pësuar rënien e mbylltoreve të zëshme ndërzanore.

Sorin Paliga 2006 në kohët e vona me një sërë botimesh i ka rimmarrë raportet e shqipes me rumanishten duke i parë jo vetëm në kontekst të koncepteve për substratin trakas, po edhe më gjerë në një synim për të vendosur trakishten në tërë botën e lashtë IE. Në bazë të analizave komparative-etimologjike e toponimeve parasllave të Siujdhesës ballkanike dhe të ujdhesave adriatike ai nxirrte vlerësime të përgjithshme: e tërë hidronimia e lumenjve të mëdhenj është jo vetëm parasllave, po edhe pararomane, trake dhe/ apo ilire; disa prej këtyre emrave shpjegohen përmes vokabularit komun IE, të tjerat lejojnë shpjegime përmes të ashtuquajturit fond 'mesdhetar', para-indoeuropian; emrat e ujdhesave janë parasllavë, ilirë ose romanë, ose të origjinës italiane (veneciane); janë parasllave dhe pararomane (trake dhe/ ose ilire) disa hidronime që u referohen rrjedhave ujore për t'u bashkuar me rrjedhat kryesore; të tilla janë dhe disa toponime dhe oronime; në arealin kontinental emrat e origjinës latine janë më të rrallë, më të shpeshtë janë në bregdet dhe ujdhesa; në arealin kontinental, në Bullgari dhe Serbi, më të shpeshtë janë toponimet me prejardhje rumune, ndërsa në Adriatik - dalmatine dhe italiane. Pastaj Paliga diskutonte toponime parasllave e latine popullore të periudhës deri në sh. V-VII, para ardhjes sllave. Pjesa II e sh. VI, sipas tij, është faza më e vjetër e kalimit nga latinishtja e vonë në dalmatishten dhe rumanish-

¹⁶⁵ "... aceste cuvînte au întrat în limbba populației romanizate din limba dacilor liberi după ce -g- intervocalic căzuse, adică mai târziu, în secolele al IV-lea, al V-lea. Aceiași situație o au civintele cu -l- intervocalic, nerotacizat (căciulă, malu și altele), care trebuie privite ca elemente de adstrat".

ten, çka nuk pajtohet me shumë historianë të rumanishtes. Në intervalin midis sh. VI-X ka ndodhur procesi i etnogjenezës së popujve të Europës Juglindore dhe në përgjithësi të Europës; bënte dallim midis trakasve dhe ilirëve të romanizuar dhe rumanishtes e dalmatishtes, por fliste për element trako-ilir në zonat kalimtare – Maqedoni e Bosnje, Baseni i Drinës, ndërsa kelte në Slloveni.

Në ff. 37-42 fliste për etnogjenezën e shqiptarëve. Pranonte se në territorin shqiptar ka pasur vazhdimësi banimi, por ai shihte aty dhe probleme. Në fakt ai nisej nga idetë e I. I. Russu-it, të shprehura në konferencë në Akademinë Rumune më 1982 dhe të botuara vetëm më 1995, pas vdekjes (shih këtu më sipër). Reperët e teorisë së tij ‘të re’, sipas Paliga-s, janë: në territorin shqiptar nuk mund të flitet për diskontinuitet habitat; është dëshmuar qartë romanizimi i ilirëve, nëpër një proces të shpejtë dhe të thellë, sa që ilirët nuk përmenden më si grup etnik i veçantë nga sh. II pas Krishtit. Është pak e besueshme që një popull në fqinjësi me grekët të mos përmendej nga autorët antikë. Këtë e shpjegon vetëm romanizimi i tyre i plotë dhe i thellë. Meqenëse shqipja është idiomë me strukturë të veçantë të tipit neoilir apo neotrakas, duhet ta identifikojmë arealin ku do të jetë ruajtur në shekujt e parë të erës sonë si një grup etnik trakas apo ilir jo shumë i prekur nga romanizimi. Përmes eliminimit Russu ka përfunduar se në jug të Danubit i vetmi popull i paromanizuar kanë qenë grekët, kështu që duket pak e besueshme që këtu të ketë mbijetuar një ishull i paromanizuar. Po të kishte mbijetuar, do të përmendej në dokumente.¹⁶⁶ Më tej ai thoshte se edhe në Veri të Danubit romanizimi ka qenë i fuqishëm dhe i thellë. Por ka ekzistuar hapësira e Moldovës dhe Maramureshit ku arkeologët kanë treguar se dakasit e lirë kanë vazhduar për një kohë mënyrën tradicionale të jetesës. Vetëm grupe relativisht kompakte të dakasve të lirë, sidomos të karpëve e kostobokëve, nën tryshninë e shtrirjes sllave, u shpërngulën drejt jugut deri në jug të Danubit. Në përzierje me popullsinë lokale ilire të romanizuar bënë të lindte një popull i ri: shqiptarët. Gjuha shqipe ka disa komponente: auto-

¹⁶⁶ Vetë Paliga mendonte se ky pohim është tepër i guximshëm.

ktone ilire, latine popullore (rezultat i romanizimit), trake-veriore (karpike, sepse grupi karp ishte grupi më tenac trak i paromanizuar deri vonë, i përmendur në dokumente deri në sh. V, mendonte ai) dhe protorumune.

“Vetëm një stratifikim i këtillë etnolingvistik mund të shpjegojë, nga njëra anë, ngjashmëritë midis rumanishtes dhe shqipes (edhe për çka ka të bëjë me lashtësinë autoktone, ashtu si për elementet romane), por edhe veçantitë” (Paliga 2006: 40).¹⁶⁷

Në horizontet e sh. IV-VI e më vonë, kanë ekzistuar dy areale ku mund të ruheshin grupe kompakte trakase: areali karpik-kostobok (Moldavia e sotme) dhe një areal në jug të Bullgarisë moderne, thoshte ai.

Pas Paliga-s, hipoteza e Russu-it dhe e shkollës bullgare kërkojnë të pajtojnë teori të papajtueshme, sepse, në një anë, i konsiderojnë shqiptarët ekskluzivisht ilirë të romanizuar (shkolla shqiptare), por, nga ana tjetër, me origjinë trakase. Ka argumente historike e arkeologjike që e mbështesin njërën prej hipotezave: shqipja reflekton pa dyshim një ndikim trakas, qoftë verior (të tipit karpik), qoftë trakas në kuptimin e mirëfilltë (trakas jugor) (Paliga, 40). Pas tij ka ekzistuar një grup etnik i paromanizuar apo vetëm pjesërisht i romanizuar që do të ketë luajtur rol me rëndësi në etnogjenezën e shqiptarëve. Ky ka qenë vetëm trakas. Pyetja shtrohet vetëm sa është e mundshme që një grup karpik të ketë pasur mundësi të tillë më shumë se një grup jugor, më afër shqiptarëve. Paliga nuk merrte qëndrim. Nuk e përjashtonte që në etnogjenezën e shqiptarëve të kenë marrë pjesë dhe grupe të tjera veri-trakase (karpike) dhe jug-trakase.

“Dallimet dialektore midis gegërishtes dhe toskërishtes mund ta reflektonin pikërisht këtë gjë.¹⁶⁸ Thelbësor na duket fakti se shqipja nuk mund të konsiderohet një idiomë neoilire, po një përzierje elementesh ilire, romane (apo ilire të romanizuara) me të cilat bashkohen më vonë elemente trakase dhe elemente protorumune, në shkallën që romanizimi avanconte”

¹⁶⁷ “Numai o asemenea stratificare etno-lingvistică poate explica, pe de o parte, asemănările dintre română și albaneză (atât în aceea ce privește moștenirea autohtonă, cât și elementele romanice), dar și deosebirile”.

¹⁶⁸ Shih diskutimet më sipër.

(Paliga 2006).¹⁶⁹

Si te Hasdeu edhe këtu operohet gjerësisht me supozime vage për karpët dhe lëvizjet e tyre eventuale në jug dhe përgjithësisht për realitetet eventuale të asaj kohe. Mungesa e çdo dëshmie apo baze serioze për këto supozime dhe marrja e tyre si kështu evidente flet vetiu edhe për të tjerat pjesë që kanë të bëjnë me gjuhët e Ballkanit të lashtë tek autorë si këta.

Përveç elementit të dallimeve dialektore të shqipes, ashiqare të ndërlidhura me supozimin e shprehur nga Brâncuș-i e të tjerët, që, siç u pa më sipër, nuk mund të ketë ndonjë mbështetje në të dhënat e zhvillimeve dialektore të shqipes, këtu operohet me terma të përzierjes së gjuhëve, pa shfaqur as më të voglën ide se si do të ketë ndodhur ajo përzierje, cila do të ketë qenë baza sociolinguistike që do ta ketë favorizuar, cilat janë komponentet brenda kësaj përzierjeje dhe, më në fund, si u bëkan kështu përzierjet? Shtresëzimi i elementeve romane në shqipen është diçka që është vënë në pah gjithnjë, ashtu siç është diskutuar dhe sasia e këtij elementi, por asnjëherë nuk ka rezultuar se në raport me elementin roman shqipja mund të cilësohet si gjysmëromane, siç e pati cilësuar G. Meyer-i dhe demantuar shumë shpejt pas tij H. Pedersen-i. Nuk ka dyshim se në procesin e gjatë të sundimit romak në Iliri ka pasur shtresa jo të pakta ilire të romanizuara, madje me siguri shumë fise të tëra këtë fat e kanë pasur. Megjithatë, shkenca nuk ka në dispozicion dokumentacion mbi bazë të të cilit do të mund të gjykonte për këto procese dhe shkallë romanizimi. I vetmi dokumentacion, dhe shumë i begatshëm, është shtresa e huazimeve latine të fazave të ndryshme në shqipen, dokumentacioni i deritashëm i të cilit na ka dhënë mundësi për të diskutuar dhe lidhur me dallimin e këtyre huazimeve nga të mirëfilltat romane – ita-

¹⁶⁹ “Deosebirele dialectale dintre ghegă și toscă ar putea reflecta tocmai acest lucru. Esențial ni se pare faptul că albaneza nu poate fi considerată exclusiv un idiom neoilir, ci un amestec de elemente ilire, romanice (sau ilire romanizate) la care se adaugă ulterior elemente trace precum și elementele protoromânești, pe măsură ce procesul de romanizare avansa”.

liane, veneciane, madje dalmate, rumune, etj. Vërtet, Desnickaja (Desnickaja 2001, A. V.: *Mbi prejardhjen e gjuhës shqipe*, në *Studime* 5, 6, 7, ff. 181-192) kishte ngritur një hipotezë për shkrirjen e elementit ilir të romanizuar me ata më pak të romanizuarit në periudhën e sulmeve barbare nga fundi i Antikitetit – fillimi i Mesjetës, dhe për këtë shkak atë latinishte të të romanizuarve që u rikthye për t’u shkrirë në masën e më pak të romanizuarve që ende flisnin idiomën e tyre ajo e quante substrat, por edhe kjo nuk është më shumë se një supozim interesant, por, sa i përket mbështetjes faktike, gati gratuit.

Argumente linguistike për këso formulimesh Paliga kërkonte te Landi (1986), pas së cilës fjala *mbret* në shqipen nuk rrjedh nga *imperatorum*, sepse kjo do të kishte dhënë **mbërdur*, **mbërtuor*, **mbërtuer*, po nga e ndërmjetmja romane *impārat*). Por, në të vërtetë, në shqipen pas rënies së *i-* nistore forma për huazim do të ketë qenë **mpirat* (> *mbrat* > *mbret*), pasi kishte rënë dhe prapashtesa *-or*. Pavarësisht nga kjo, Paliga kërkonte dhe përjashtime të tjera: *kryq(ë)*, *kjel*, *kreshmë*, *rërë*, *mik*, *pëlqenj*, *qytet*, *qind*, *fruer*, *fshat*, *këndo*j (referonte dhe Vătăşescu 1997). Dhe nuk duhet shumë që këtu të shohim një shtresim tjetër kohor.

Aporti i fondit ilir: si argument për këtë Paliga referonte faktin se hidronimia dhe toponimia antike është ruajtur në shqipen sipas zhvillimit fonetik specifik: *Scupi – Shkup*, *Naissus – Nish*, *Scodra – Shkodër*, *Lissus – Lesh*, *Ulcinium – Ulqin*, *Dyrrachium – Durrës*, *Aulona – Vlorë*. Shkonte dhe më larg dhe citonte Brâncuş-in me idenë se shqipja paska elemente të tipit *satəm* dhe *centum*, për të nxjerrë përfundimin e tij vërtet specifik:

“Shkurt, mund të pohohet se shqipja është gjuhë sintezë multilingvistike, stratifikim etno-kulturor, në aparençë derutant, por që – në analizën e kujdesshme – e ka logjikën e vet të brendshme” (Paliga 2006: 41),¹⁷⁰

¹⁷⁰ “Pe scurt, se poate afirma că limba albaneză este o sinteză multilingvistică, o stratificare etnoculturală, aparent derutantă, dar având - la o analiză atentă în logica sa interioară. De altfel, tot spre hipoteza unui idiom multistratificat se pronunță și Huld (1984: 1-14)”.

duke pohuar në rrugën e thjeshtësimeve se kështu qenka prononcuar dhe Huld 1984, 1-14, çka, natyrisht, është pak si ndryshe e më komplekse.

Por ç'thoshte në të vërtetë Huld-i?

Vepra *Basic Albanian Etymologies* e Martin Huld-i është studim i 250 njësive themelore leksikore të shqipes me synimin që t'u jepet indoeuropianistëve dhe linguistëve historikë mbi bazë të rezultateve të të cilit mund të dedukohen tiparet historike të shqipes. Qysh në parathënie Huld-i nxirrte dy përfundime të rëndësishme, sipas vlerësimit të tij:

“se shqipja shfaq zhvillime të tri dorsaleve indoeuropiane që janë tepër komplekse për t'u interpretuar përmes dikotomisë krude dhe false satəm – centum dhe se, çfarëdo designimi që të marrë elementi i trashëguar indo-europian në shqipen, ajo nuk mund të karakterizohet si hibrid trako-ilir. Edhe pse zhvillimet e fonemave indoeuropiane të kësaj shtrese janë krejt komplekse, sidoqë të jetë, ne vërejmë zhvillimin e një entiteti të vetëm” (Huld 1984: VII-VIII).¹⁷¹

Këtu nuk bëhet fjalë për *'idiomë të shumështresuar'* në kuptimin e mësipër. Pjesa në vijim, faqet 1-14, merret me prapavijën historike dhe etnografike. Pas tij shqipja është gjuhë indoeuropiane indigjene në Europën juglindore. Fillimisht fliste për hapësirën ku flitet shqipja, pastaj për fillimet e shkrimit, për ndarjen dhe dallimet dialektore. Për detajet gjuhësore, historike e etnografike referonte Çabejnë, Hamp-in, Stadtmüller-in dhe, kuptohet që asnjëri syresh nuk do të pajtohej me konstatimin e cituar të Paliga-s. Pjesa tjetër është thjesht paraqitje e ideve që janë shfaqur nga arkeologët, nga gjuhëtarët dhe nga etnologët për vendin e shqipes, pastaj për rrjedhat e hulumtime-

¹⁷¹ “... that Albanian shows developments of the three Indo-European dorsals that are much too complex to be interpreted by the crude and false *satəm-centum* dichotomy and that, whatever designation the inherited Indo-European element in Albanian may receive, it cannot be characterized as a Thraco-Ilyrian hybrid. Although the developments of the Indo-European phonemes in this stratum are quite complex, we are, nevertheless, observing the evolution of a single entity”.

ve. Madje as në pjesën përfundimtare për vendin e shqipës në kuadër të gjuhëve indoeuropiane askund Huld-i nuk le të kuptohet diçka e atillë.

Në librin për etimologjitë trakase në rumanishten, S. Paliga (2006a) përpiquej t'i vendoste këto realitete duke hamendësuar formulime që mund të kërkonin argumentime plotësuese, madje të forta. Pas tij, romanizimi në bregun e Adriatikut që i shpejtë, ndërsa ilirishtja dhe folësit e saj u zhdukën nga dokumentet duke filluar nga sh. II pas Krishtit, pastaj Iliria, përsëriste pohimin tashmë të stërpërsëritur, kishte vetëm kuptim thjesht gjeografik. Përkundrazi, theksonte ai, trakishtja vijoi të ekzistonte me shekuj, megjithë trysninë e fuqishme të romanizimit. Shkolla bullgare e studimeve trakase mbron me këmbëngulje mbijetesën e trakishtes deri tek arritja e sllavëve në sh. VI, ndërsa arkeologët rumunë argumentojnë se folës të shpërndarë trakas kishin qëndruar në hapësirat e paromanizuara të Moldavisë (Karpët) dhe të Transilvanisë. Sipas Paliga-s trakishtja është folur deri në sh. VI-VII pas Krishtit, mbase edhe më vonë në hapësira të izoluara:

“Nëse pranojmë idenë se shqipja në themel është idiomë neotrakase dhe jo neoilire, siç ishte menduar më herët, mund të vendosim hipotezën se trakishtja ende jeton - në mënyrë të çuditshme - me emërtimin shqipe. Nëse një vizion i tillë nuk konsiderohet tepër audicioz, formula mund të ishte: trakishtja është ende idiomë e gjallë me emrin shqipe dhe përmes elementeve të numërta indigjene të rumanishtes, disa prej të cilëve janë ruajtur apo huazuar nga gjuhët fqinje (bullgarisht, serbisht, ukrainisht, hungarisht)” (Paliga 2006a: 236-237).¹⁷²

Në fusnotë ai shtonte:

¹⁷² “If we accept the idea that Albanian is basically a neo-Thracian, not a neo-Illyrian, idiom as formerly considered, then we may hypothesise, with fair correctness, that Thracian still survives – in a peculiar way – under the label Albanian. If such a view is not considered to audacious, then the best formula would be: Thracian still is a vivid idiom under the name Albanian, and through the numerous indigenous elements of Romanian, some of them preserved or borrowed in the neighbouring languages (Bulgarian, Serbian, Ukrainian, Hungarian mainly”.

“Sido që të jetë, karakteri i sugjeruar neo-ilir i shqipes nuk mund të invokohet më me argumente shkencore” (Paliga 2006a: 237).¹⁷³

Megjithatë, Paliga e ndjente të nevojshme të shtonte gjithashtu se, sipas Russu-it, trakishtja dhe ilirishtja

“duhet të kenë qenë gjuhë ngushtësisht të afra midis tyre, mbase reciprokisht të kuptueshme, së paku përgjatë kufirit të tyre gjuhësor”(!) (Paliga: 239).¹⁷⁴

Supozim pas supozimi, në një përzierje të këtyre, të gjitha këto përfundojnë të marra si të vërteta:

“meqë inventari i ilirishtes është ende më pak i numërt se i trakishtes, do të përqendrohemi në rindërtimin e arsyeshëm të fonetikës së trakishtes. Meqë ilirishtja ishte gjuhë e shuar në sh. II pas Krishtit, i kemi të gjitha arsyet të pranojmë që elementet e mundshme ilire, kryesisht në shqipen, disa në kroatishen dhe slovenishten, duhet të jenë ruajtur përmes proto-dalmatishtes, më pak përmes proto-romanishtes perëndimore” (Paliga 2006a: 239).¹⁷⁵

Për shembull, në fushën e vokalizmit Paliga theksonte se Reichenkron-i (1966), Russu-i, shkolla bullgare (Georgiev-i, Duridanov-i) dhe Poghirc-u kanë ndjekur rrugë të papajtueshme të rindërtimit fonetik. Megjithatë, Poghirc-u e Brâncuş-i i kanë përshtatur përfundimet e studiuësve bullgarë. Të rindërtosh vokalizmin e trakishtes, sipas tij, do të thotë të bësh analizë të emrave trakas të ruajtur nga shkrimtarët grekë e latinë; të bësh analizë të formave të mundshme moderne të ruajtura në rumanishten, shqipen dhe bullgarishten. Kështu është shumë e besueshme që

¹⁷³ “Anyway, the suggested Neo-Illyrian character of Albanian cannot be invoked any more with scientific arguments”.

¹⁷⁴ “Thracian and Illyrian must have been closely related languages, presumably mutually intelligible, at least along their linguistic border”.

¹⁷⁵ “As the Illyrian inventory is still less numerous than Thracian inventory, we shall concentrate on a reasonable reconstruction of Thracian phonetics. As Illyrian was an extinct language in the 2nd century A.D., we have all the reasons to admit that the possible Illyrian elements, mainly in Albanian, some in Croatian and Slovene, must have been preserved via Proto-Dalmatian, to a less extent via West Proto-Romanian”..

trakishtja të ketë pasur një zanore neutër, siç provohet nga rumanishtja *ă*, shqipja *ë*, bullgarishtja *ъ*, siç kishte sugjeruar Poghirc-u.

Konstatime të këtilla nuk më duken të qëndrueshme.

Indoeuropeisti dhe ballkanologu Eric P. Hamp, duke u nisur nga shqyrtimi i raporteve të shqipes me rumanishten, kishte avancuar hipotezën e tij për ekzistencën në lashtësi të një fashe dialektesh IE që ai i quante *proto-albanoide*, e që shtrihej nga vija Jireček e deri në Karpate, ndërsa shqipja ishte vetëm një mbetje e atij grupi dialektesh, ashtu si dhe elementet e përbashkëta të rumanishtes e mbase edhe elemente të tjera leksikore karpato-ballkanike. Në vështrimin e tij "*historikisht rumanishtja është latinishte e folur me një sistem theksor shqip*", çka do të thotë se në latinishten e vonë danubiane të Dakisë kishte pasur një ndikim të gramatikës së një grupi të proto-shqipes, apo, si thoshte ai, të proto-albanoidishtes. Këtë ai kishte provuar ta përtregonte përmes zhvillimeve fonetike në fushën e lateraleve në sllavishtet jugore në raport me shqipen, me implikime për zhvillimet *-l->-r-* në rumanishten (shih Hamp 2007). Fjalët e rumanishtes të njohura si të substratit, Hamp-i i kishte parë si *Restwörter* (fjalë mbetje) dhe jo si *Lehnwörter* (fjalë të huazuara), duke veçuar midis tyre:

- a) një shtresë më të hershme karpato-ballkanike të fushës baritore,
- b) një shtresë nga kontaktet e mëvona midis shqipes e rumanishtes dhe
- c) një shtresë tjetër më të re.

Sa i përket shtresës së parë, të ekzemplifikuar përmes fjalëve *vatër*, *shtrungë*, *hurdhë*, Hamp-i mendonte se reflektonin një tufë të tillë gjuhësh/ dialektesh proto-albanoide që shtrihej nga vija Jireček e deri në Karpate dhe Ukrainë. Këtë vijë të menduari ai e ndiqte edhe me analizën e emërvendit *Drobeta* si *dru+htë*, duke parë aty sintagmën më të vjetër shqipe (sh. I para K.), çka na ishte dukur e paqëndrueshme për arsye të zhvillimit të nyjave (Ismajli, 2003). Përgjithësisht Hamp-i po ashtu kishte vërejtur se toskërishtja në një kohë do të ketë kaluar nga veriu (zonat Leskovac-Nish) anash Sharrit drejt jugut,

çka po ashtu nuk duket plauzibile për shkak të dispozicionit shumë të hershëm të ndarjes dialektore të shqipes ashtu si është sot. As Hamp-i as Brâncuș-i e të tjerë që mund të kenë menduar se dallimi gegnishte/ toskërishte mund të kishte prejardhje të mëhershme të ndryshme gjeografike, pra edhe gjuhësore, dmth. shtrirje dy shtresash gjuhësore, nuk kanë sjellë argument tjetër, pos afrisë së supozuar më të madhe të toskërishtes me rumanishten, çka mendoj se mund të shpjegohet me arsye të tjera të zhvillimit gjuhësor. Për më tepër, edhe teoria për shtyrjen e arumanishtes në jug nga veriu diku pas sh. X gjithnjë e më pak po ka mbështetje.

Brian Joseph-i (1999, 2001), duke u mbështetur në idetë e Hamp-it për teorinë e substratit përmes proto-albanoidishtes, ka provuar të gjente elemente të tjera mbështetëse në fushën e strukturës gjuhësore. Infinitivi, për të cilin ai është specialist, për arsye kronologjike nuk i dilte i pranueshëm sa i përket substratit, koncept të cilin ai e pranonte dhe i bënte jehonë sërish. Por ai gjente elemente të tjera strukturore, në fushën e fonetikës me vendin e theksit në raport me mbaresat, ndryshe nga prapashtesat, me lateralet, apo të sintaksës me parafjalët *cu – me* në sintagma emërore. Idetë e tij janë ende në zhvillim dhe duhet të presim argumentet që do të sjellë.

Sërish Schumacher-i

S. Schumacher-i (2009) i është kthyer me shumë mprehtësi studimit të huazimeve protoshqipe në latinishten/ romanishten, duke synuar kështu ridiskutimin e njërit nga elementet thelbësorë të argumentimeve substratiste. Duke e cilësuar si

“një paragjykim etnocentrik me formulim polemik” (*ein polemisch formuliertes ethnozentrisches Vorurteil*),

pa të dhëna empirike pyetjen e A. Graur-it

“në cilën epokë mund të besohet se shqiptarët kanë qenë aq superiorë ndaj rumunëve, në mënyrë që këta të fundit të kenë huazuar nga të parët

*terma qytetërimi si 'vatra', 'mosha', etj?'*¹⁷⁶

ai, në mbështetje të krahasimeve me raportet e aborigjenëve australianë me anglishtfolësit, ku ka huazime nga ato gjuhë, e cilësonte absurd pohimin e tillë dhe shpjegonte se huazime nga proto-shqipja në latinishten mund të ketë pasur qoftë në rastet kur latinishtfolësit të kenë huazuar ndonjë fjalë prej shqipfolësve, qoftë dhe në rastet kur shqipfolësit e romanizuar të kenë përdorur ndonjë fjalë të proto-shqipes në latinishten e tyre, duke krijuar kështu huazime.

Schumacher-i bënte edhe vlerësimin e studimeve rumune të raporteve të shqipes me rumanishten përmes dy personazheve: G. Brâncuș dhe I. I. Russu. Të parin e cilësonte të interesuar për t'iu afruar së vërtetës, ndërsa punën e të dytit e shihte si njëformëshe dhe me metodë të vjetruar, çka, sipas tij, shpjegohej me detyrimin që kanë këto botime ndaj ideologjisë shtetërore rumune për të treguar se

"rumaniteti është zhvilluar në truall të Dakisë - dhe vetëm aty".

Schumacher-i i analizonte gjerësisht huazimet në rumanishten ballkanike nga proto-shqipja: *harc, țarcu – thark*, që në një studim të detajuar etimologjik e bie të lidhur me shqipen *thur; vatră – vatrë, votrë*, në proto-shqipen **ātrā*, prej nga u bë *votrë* > *vatrë* brenda shqipes, ndërsa forma më e hershme u huazua në rumanishten ballkanike. Kështu evitohej dhe nevoja për supozimin se fjala do të ketë hyrë nga toskërishtja. Më tej ai merrte në shqyrtim *pîrîu: përrua, viezure – vjedullë*, dhe *curpen – kurbën*. Merrte qëndrimet ndaj ideve të Russu-it, Brâncuș-it, Çabejtë. Të parin e kritikonte për arsye metode e për ngurtësi ideologjike, të dytin e lavdëronte për përpjekjet për t'iu afruar së vërtetës, edhe pse më vonë, mbase nën trysni të rrethanave, ishte kthyer prapa. Për Çabejnë theksonte ndryshimet ndaj Russu-it e Brâncuș-it sa i përket vendit të formimit të shqipes. Shprehte keqardhjen që në disa raste Çabej, sipas tij, nuk ishte i saktë në çështje të historisë fonologjike.

¹⁷⁶ "À quelle époque peut-on croire que les Albanais ont été tellement supérieurs aux Roumains, pour que les derniers aient emprunté aux premiers des termes de civilisation tels que 'foyer', 'vieillard', etc". Citonte dhe Russu 1969: 216; Graur 1936: 63, Schumacher 2009: 40.

Në fushë të përkimeve strukturore ai merrej sidomos me çështjen e nyjës, ku shqyrtonte sërish çështjen e aglutinimit të emrit me nyjën, që mendonte se do të ketë ndodhur para se të binin në proto-shqipen bashkëtingëlloret hundore fundore në fjalët shumërokëshe, çka, në krahasim me zhvillimet e tilla në latinishten e në greqishten, i dukej të vendosej para sh. I para Kishtit.

*“... ka porse një argument thelbësor kronologjik, që në diskutimin për nyjën e prapavendosur deri tash nuk është marrë parasysh: në shqipen përngjitja e emrit dhe nyjës shquese vijuese ka një lashtësi të madhe – kjo shihet sidomos nga fakti se kallëzorja e emrave mashkullorë e femërorë me nyjën shquese në shqipen e lashtë kishte formën /-në/, se kjo /-në/ lidhet me *-om+*-tom, përkatësisht *-ām+*-tām”. “... përngjitja midis emrit dhe nyjës shquese duhet të ketë ndodhur para se të jetë bjerrë në shqipen bashkëtingëllorja hundore fundore në fjalët shumërokëshe” (Schumacher 2009: 56).¹⁷⁷*

Sipas tij, nuk ka të dhëna direkte kur u borën bashkëtingëlloret hundore, por ka mundësi krahasimi me latinishten, ku mund të çohet deri në shekullin III para K., e me greqishten, ku do të jetë zhdukur në shekullin II para Krishtit. Prandaj, nëse proto-shqipja lidhur me këtë çështje fonetikut do të jetë sjellë afërsisht si latinishtja e greqishtja e asaj kohe, bashkëtingëlloret përkatëse hundore të proto-shqipes do të jenë zhdukur tërësisht më së voni në sh. I para K. Meqenëse përngjitja e emrit me nyjën shquese duhet të ketë ndodhur para rënies së bashkëtingëllores hundore, kjo do të thotë se protoshqipja qysh para sh. I para K. kishte një shquese të përngjitur (Schumacher: 57). Është e besueshme që krijimi i nyjës shquese në gjuhën shqipe të ke-

¹⁷⁷ “... es gibt aber ein essentielles chronologisches Argument, das in der Diskussion über den postponierten Artikel bisher kaum beachtet worden ist: Im Albanischen hat die Univerbierung von Substantiv und nachfolgendem bestimmten Artikel ein hohes Alter – dies zeigt sich insbesondere daran, dass der Akkusativ der maskulinen und femininen Substantive mit bestimmten Artikel im Altalbanischen die Form /-në/ hat, denn dies /-në/ geht auf *-om+*-tom bzw. auf *-ām+*-tām zurück“... “die Univerbierung zwischen dem Substantiv und dem bestimmten Artikel muss eingetreten sein, bevor im Albanischen die auslautenden Nasalkonsonanten bei mehrsilbigen Wörtern verloren gingen“.

të ndodhur nën ndikimin e greqishtes. Krijimi i nyjës mund të konsiderohet fenomen areal. Por, meqë nyja shquese e gjuhëve romane është krijuar vetëm pasi të jenë mëvetësuar ato, kjo do të thotë se në rastin e krijimit të nyjës në shqipen nuk kemi të bëjmë me ndonjë ndikim nga latinishtja, po përkundrazi, shqipja e lashtë mund të kishte ndikuar në çështjen e prapavendosjes së nyjës shquese në rumanishten, që është e vetmja gjuhë romane me nyjë të prapavendosur e që në fqinjësi kishte shqipen, e cila do ta ketë prapavendosur nyjën shekuj më herët. Në romanistikë një ide e tillë është kundërshtuar.

Schumacher-i nuk i kishte shënuar si të njohura idetë e S. Rizës për krijimin mbi dy mijë vjet më herët të nyjës shquese (të paravendosur, e që u prapavendos më vonë) në shqipen, as për ngjashmërinë me greqishten e vjetër lidhur me krijimin e nyjës shquese,¹⁷⁸ as idetë e Bokshit për mundësitë e ndikimit të shqipes në rumanishten sa i përket prapavendosjes së nyjës dhe për diskutimin lidhur me prejardhjen e *-n* të kallëzores.¹⁷⁹ Kështu Riza qysh herët kishte shprehur mendim të kundërt me të Pedersen-it lidhur me prejardhjen e *-n* të kallëzores në shqipen (Pedersen, Kontribut 1973: 243), që thotë se *-në* e kallëzores së shquar njëjës del nga aglutinimi i nyjës në kallëzore me mbaresën e vjetër të kallëzores *-om-tom*, *-am-tam*, përmes procesit *-mt > -nt > -nd > -n*, ndërsa të tjerë kishin paraparë edhe një fazë *-nn < nd* (La Piana: *Studi I* 1939: 129-30). Prandaj zhvillimi *-mt > -nt* ishte konsideruar si i kohës paralatine, sepse *-nt* e lat. nuk dha *n*, po *nd*: *mentem > mend*, *apparamentum > parmendë*, *cantare > këndoj*. Në sytë e la Piana-s kjo do të thotë se aglutinimi i nyjës shquese me emrin paraprijës ndodhi para huazimeve latine. Sipas Bokshit kjo nuk qëndron, sepse aglutinimi nuk mund të kishte ndodhur para kontakteve me latinishten; aglutinimi, siç u pa, sipas tij, do të ketë ndodhur para përfundimit të rotacizmit, para sh. VIII. Mendimin e Pedersen-it për formën e kallëzores e kishte kundërshtuar dhe S. Riza më 1958 (*Nyjat*: 14), sipas të cilit në kohën e aglutinimit të nyjës (pas tij në sh. VIII-IX) mbaresa e kallëzores

¹⁷⁸ Riza (1958), Riza (1966).

¹⁷⁹ Bokshi (1980), Bokshi (1984).

njëjës nuk ishte *-om*, *-am*, po *-n*; nyja u aglutinua jo si *-tom* e *-tam*, po si *-të* (shih dhe Bokshi 2010: 220-221).

Sipas Bokshit në këtë rast kemi të bëjmë gjithsesi me një proces më të vonë se ai që supozohet nga Pedersen-i, La Piana, tani Schumacher-i, po edhe të ndryshëm sa i përket prejardhjes së këtij segmenti. Në një kohë që shqipja i kishte bjerrë mbaresat për pasojë të veprimit të ngulitjes së theksit, segmentet e reja ishin krijuar nga elementë të tjerë: këtu konkretisht, thoshte ai, kemi të bëjmë me krijimin e një parafjale+nyjë shqese: brenda grupit nominal pa mbiemër nyja shqese prepozitive e emrit në rasën kallëzore ra në kontakt me *-ën* dhe u aglutinua: *ën të pus* -> *ëntë pus*, ndërsa sintagma parafjalore mund të sillte me emrin: 1. Një kuptim konkret të njohur [ëntë pus], ose të panjohur [ën një pus], ose 2. Një kuptim abstrakt [ën pus], pra u bë dallimi midis *ën* dhe *ëntë*. Parafjala-nyjë qëndroi para emrit edhe kur mbiemri dilte para tij dhe

“u bë formë e nyjës së rasës kallëzore: ën të thellë ëntë pus etj., duke e nxjerrë nga përdorimi formën origjinale të nyjës në kallëzore njëjës të emrave të gjinisë mashkullore e femërore...” (Bokshi 2010: 71; Bokshi 1980).

Përfundimi i Schumacher-it më duket me interes në një aspekt: në Ballkan latinishtja e folur, përkatësisht romanishtja/ rumanishtja, ka qenë në kontakt me proto-shqipen, prej së cilës ka pësuar ndikime leksikore dhe strukturore. Ku do të jetë zhvilluar ky kontakt, sipas tij, nuk dihet, por mund të thuhet se një pjesë e proto-albanëve u romanizua dhe ajo pjesë solli pastaj tipare leksikore e strukturore të gjuhës së saj në latinishten. Sa i përket konceptit të substratit ai mendonte se kemi të bëjmë me një mistifikim. Ky koncept përdoret kryesisht nga ata që duan të mohojnë se proto-shqipja mund të ketë ndikuar në latinishten e folur/ romanishten në Ballkan. Substrati i paemër ballkanik, sipas tij, ka një prapavijë politike:

“shërben para së gjithash për të mbështetur tezën e autoktonisë që në Rumani praktikisht është ngritur në rrafsh doktrine shtetërore”

(Schumacher 2009, f. 59).¹⁸⁰

Në krahasimet midis rumanishtes dhe shqipes na dalin elemente të ndryshme: të vjetra, strukturore, sintaksore, leksikore të shtresave të ndryshme. Në konceptimet e Sprachbundit ballkanik ato që janë vetëm të shqipes dhe të rumanishtes sikur dalin periferike, dhe aty hyjnë më të vjetrat, gjithsesi përbashkësitë vetëm të këtyre gjuhëve para periudhës sllave. Pastaj vijnë përbashkësitë nga fondi latin dhe më tej ato me burim sllav, për të mos u ngjitur më tej në kohë kur kontaktet midis dy gjuhëve duket të kenë qenë jo të drejtpërdrejta dhe intensive. Prandaj, për të folur në mënyrë më të saktë për vendin e shqipes në lashtësi del e nevojshme të shohim raportet e këtyre gjuhëve në fushën e latinitetit. Haralambie Mihăescu dhe të tjerët kishin konstatuar se shqipja, duke u folur në fqinjësi dhe në hapësira ku dominonte latinishtja, ka një shtresë të gjerë fjalësh latine në të gjitha fushat, rreth 600 fjalë bazë. Latinizmat e shqipes për një pjesë janë më të hershëm se të rumanishtes, kanë karakter edhe urban, më pak rural se të rumanishtes, për një pjesë afrohen më shumë me dalmatishten e romanitetin perëndimor; është vërejtur një shtresë që veçon latinizmat e shqipes dhe të greqishtes nga latinizmat e tjerë ballkanikë (Mihăescu 1966; Mihăescu 1981. Shih shtojcën). Qysh Meyer-Lübke kishte parë se latinizmat e shqipes ishin më të vjetra, se janë kryesisht nga forma të thjeshta, ndërsa të gjuhëve romane derivate, më popullore.

Kjo do të thotë se në raport me rumanishten shqipja ishte folur më në perëndim të Gadishullit Ballkanik. Fakti se në shqipen kemi huazime të vjetra greke, shumë më tepër se në rumanishten, flet po ashtu në të mirë të këtij konstatimi.

Diskutime të vona për romanizimin ndër shqiptarë

Sh. Demiraj tani vonë¹⁸¹ diskutonte lidhur me romanizimin në Ball-

¹⁸⁰ "Es dient vor allem dazu, die in Rumänien praktisch zur Staatsdoktrin erhobene Autochthoniethese zu stützen".

¹⁸¹ Demiraj, Sh. 2000: *À propos de la romanisation des anciens peuples de la Péninsule Balkanique*, in **Studia Albanica**, XXXIIIe année, Tirana, ff. 1-6.

kan duke paraqitur në radhë të parë aspektet problematike, zgjidhja përfundimtare e të cilave është larg. Kryesore, pas tij, është çështja vijuese:

“A u romanizuan të gjithë popujt e lashtë ballkanikë të nënshtruar nga Perandoria Romake, pos grekëve?” (Demiraj 2000: 1-7).¹⁸²

Rastet si rumanishtja apo dalmatishtja e vjetër tregojnë se romanizimi kishte transformuar rajone të gjera të pjesëve lindore e perëndimore të Siujdhesës. Kjo me siguri do të ketë ndodhur para imigrimit të tribuve sllave në Siujdhesë. Ka të dhëna që na bëjnë të pohojmë se sllavët, kur erdhën në Ballkan, përveç grekëve, gjetën një popullatë të romanizuar, po edhe etni të tjera që flisnin gjuhë të ndryshme, pohonte ai. Të dhënat lidhur me Mesjetën e hershme e bëjnë të vështirë përshkrimin e situatës etnike në Ballkan në kohën e arritjes së sllavëve. Mund të pohohet se në atë kohë fise të tjera ballkanike i kishin mbijetuar romanizimit. Provë për këtë është ekzistenca e popullit shqiptar. Me rëndësi i dukej fakti se shqiptarët, qofshin pasardhës të trakasve, të dakomezëve apo të ilirëve, kanë qenë në Perandorinë Romake.

Prania e paraardhësve të shqiptarëve në brigjet e Adriatikut konfirmohet edhe nga huazimet latine në shqipen, që janë më të shumta se greket dhe kanë hyrë në periudha të ndryshme. Shtresa më e vjetër ngjitet në shekujt e fundit të epokës së vjetër. Për këtë referonte pohimin shumë të njohur të W. Meyer-Lübke-s (1914, 32):

“Elementi latin i shqipes paraqet një gjendje më të vjetër se secila prej gjuhëve romane”, Demiraj 2000: 3.¹⁸³

Ndër huazimet më të vjetra të shqipes nga latinishtja duan konsideruar ato ku velarja *c-*, *g-* [*k-*, *g-*] para zanores së përparme ruante shqiptimin gutural në lat., jo më vonë se shekujt e parë të erës sonë. Bashkëtingëlloret e tilla velare janë palatalizuar nëpër shekuj në shqipen jo vetëm në huazimet latine e greke, po edhe në fjalët e trashëguara: *piscis*:

¹⁸² Est-ce que tous les anciens peuples balkaniques soumis par l'Empire Romain, à l'exception des Grecs, ont été romanisés?

¹⁸³ “L'élément latin de l'albanais présente une situation plus ancienne que chacune des langues romanes”.

peshk, cicer: qiqër, civitas: qytet, sagitta: shëgjetë. Si të vjetra citonte edhe zhvillimet si /ō/: /e/ te *pemë: pōmum, herë: hōra, tërmet: terrae mōtus*, etj. Referonte G. B. Pellegrini (1995, 227):

“Fakte të shënueshme konservimi të një leksiku arkaik dhe kuazi unik në kuptimin e gjuhëve neolatine përtregon një depërtim roman shumë më të shkuar dhe qartë më të hershëm se latinishtja e Dakisë, që shfaqet në fillim të shekullit II pas K.”, f. 3.¹⁸⁴

I dukej e natyrshme të përshtaste mendimin vijues të R. Katičić-it 1976, 184:

“Prandaj është e natyrshme të përfytyrohet që shqipja qysh nga kohët e lashta është folur pak a shumë në të njëjtën hapësirë ku flitet tash”, Demiraj 2000: 3.¹⁸⁵

Nga kjo del pa dyshim se shqiptarët ishin në Ballkan në kohën e dominimit romak. Por shtrohet pyetja: si ia dolën t’i rezistonin romanizimit duke ruajtur idiomën e tyre, sidomos nëse kemi parasysh se bregu perëndimor i Siujdhesës u okupua shekuj para Dakisë, popullata e së cilës u romanizua për një kohë më të shkurtë? (Demiraj 2000: 4).

Sipas Demirajt, një pjesë e mirë e pararadhësve të shqiptarëve, sidomos në pjesët e qyteteve bregdetare, ishte romanizuar, por banorët e brendisë, shpesh malore, ia dolën ta ruanin identitetin dhe idiomën. Referonte G. B. Pellegrini (1995: 198), sipas të cilit, përveç greqishtes e latinishtes, së paku në disa zona, qe ruajtur mjaft vitale gjuha autoktone.

“... ndryshe nuk do ta kishim gjuhën shqipe” (Demiraj 2000: 4).¹⁸⁶

Në këtë aspekt të ruajtjes ai theksonte veçoritë që i konsideronte tipare konservative të etnisë shqiptare, ndër to karakteri malor i rajonit, ku shqiptarët ishin strehuar. Por pas sh. IV

¹⁸⁴ “I notevole fatti di conservazione di un lessico sovente arcaico e quasi unico in seno alle lingue neolatine, denuncia una penetrazione romana molto remota e ovviamente più antica del latino della Dacia, che risale ai primi del II sec. D. C.”

¹⁸⁵ “It is therefore natural to assume that Albanian was since ancient times spoken in more or less the same area in which it is now”, Katičić 1976: 184..

¹⁸⁶ “... altrimenti non avremmo la lingua Albanese”. Pellegrini 1995:198.

“një pjesë e mirë e fshatarëve shqiptarë u kthye në qytete, ku me kohë ata asimiluan gradualisht popullatën tashmë të romanizuar”, (Demiraj 2000: 4-5).¹⁸⁷

Krahaso këtë me idetë e Desnickaja-s për substratin latin në shqipen, të referuar dhe më sipër. Pajtohej dhe me një ide tjetër të shprehur nga Mansaku 1995: 169 - Roma që e detyruar të përqendronte forcat e mbrojtjes nga barbarët në periferi, si në Daki, prandaj trysnia në pjesët e tjera do të ketë qenë më e vogël, ashtu siç kishte shprehur një mendim të ngjashëm edhe Mihăescu për greqishten.¹⁸⁸

Mansaku për implikimet romane

Me interes për këto çështje më duken diskutimet e Seit Mansakut.¹⁸⁹ Ndryshe nga bindjet e sh. XIX, sot pranohet se latinishtja ballkanike nuk ka qenë homogjene, theksonte ai në fillim. Kjo i dukej e arsyeshme për shkak të kohës së zgjatjes së ndikimit latin dhe të diversitetit etnik e gjuhësor të rajonit. Rikujtonte se në vitet ‘30 të sh. XX Petar Skok-u veçonte dy lloje romaniteti në jug-lindje të Europës – një kontinental dhe një bregdetar. Ai besonte se elementet romane të shqipes dhe rumanishtja bënin pjesë në romanitetin kontinental (P. Skok: *Osnove romanske lingvistike I*, 1940, not. 4, 42v.), Mansaku 2000: 40.

Ideja e zhvillimit konvergjent të latinitetit ballkanik mbështetej në ngjashmëritë e leksikut të rumanishtes e të elementeve latine të shqipes. Më vonë u mbitheksua kjo ngjashmëri, edhe për shkak të nevojës për të mbështetur tezën për prejardhjen trakase të shqipes dhe të simbiozës së supozuar të paraardhësve të shqiptarëve e rumunëve në trekëndëshin Nish-Sofje-Shkup. Mansaku vërente se shumë studiues që mbështesin tezën për prejardhjen trakase të shqipes i kanë mbivlerësuar ngjashmëritë e

¹⁸⁷ “Une bonne partie des paysans albanais sont rentrés dans les villes, où avec le temps ils ont assimilé graduellement la population déjà romanisée”.

¹⁸⁸ Mansaku, Seit 1995: *Çështja e autoktonisë së shqiptarëve në dritën e marrëdhënieve të shqipes me latinishten*, in *Seminari XVII*, 169.

¹⁸⁹ Mansaku, Seit (2000): *La position des éléments latins de la langue albanaise dans la romanité balkanique*, in *Studia albanica*, XXXIIIe année, Tirana, ff. 39-55.

leksikut latin të gjuhëve shqipe e rumune dhe zhvillimet e tyre paralele. Dallimet në zhvillimet e ndryshme fonetike i kanë shpjeguar mandej me ndryshim vendbanimi të shqiptarëve, të cilët duhej të kishin qenë afër rumunëve në lindje (cf. grupin *ct*, shqip *ft*, rum. *pt*), pas tyre, i detyrohet faktit se atdheu i lashtë i shqiptarëve do të ketë qenë afër rumunëve, ndërsa refleksi *jt* faktit se ka ndodhur në atdheun e ri në afërsi me dalmatët. Kështu janë motivuar edhe reflekset e dyfishtë të zanores *a* në *a* dhe *e* (*peccatum*: *mëkat*, r. *păcat*, *galbinus* : *i gjelbër*, *e*, *galben*; *ū* në *u* e *y*: *nūmerus*: *numër*, r. *număr*, *mūcus*: *myk*; *au* në *a* apo *av af*: *aurum*: *ar*, r. *aur*, *laudem*: *lavd*, r. *lăuda*, *laurus*: *lar*, r. *laur*. etj., Mansaku 2000: 41). Por ka pasur dhe linguistë që midis elementit latin të shqipes e rumanishtes shihnin jo vetëm ngjashmëri, po edhe ndryshime të konsiderueshme. W. Meyer-Lübke ka qenë i pari që kishte vërejtur se paralelizmat fonetikë të shqipes e rumanishtes janë më të paktë se ç'ishte menduar dhe se dallimet janë të konsiderueshme, Mansaku 2000: 42.

Mansaku me të drejtë ritheksonie idenë që ishte shprehur dhe më parë se në shqipen ka elemente latine të periudhës klasike, ndërsa rumanishtja dilte nga lat. vulgare: *shelboj*: *salvare*, r. *scăpa*: *excăpare*; *turp*: *turpis*, r. *ruşine*: *roseur*; *shëroj*: *sanare*, ar. *asinedz*. Po ashtu, në vijën e Çabejtë (Çabej: *Studime gjuhësore II*, 303; Jokl, LKU, 209) ai elaboronte që në shq. ka fjalë të bimësisë e faunës mediterane që mungojnë në rum., si *ulli*: *olive*, *vaj*: *oleum*, *voshtër*: *oleaster*, për të shtuar dhe *mendull*: *amygdala*, *shermend*: *sarmentum*, etj. (Mansaku 2000: 42). Mendoj se ky argument ka vlerë për hetimin e këtyre raporteve.

Më tej Mansaku rikujtonte se ka ndryshime në terminologjinë e krishterë të dy gjuhëve. Shqipja ka pasur raporte të vazhdueshme me latinitetin oksidental, ndërsa rumunët ishin kthyer nga Bizanti e sllavët, prej nga i mori kjo gjuhë termat. Për shembull, shqip *kishë*: *ecclesia*, rum. *biserică* nga *basilica*, *Christi natale*: *kërshëndella*, rum. *crăciun*, *meshë*: *missa*, rum. *slujbă*, *murg* – *monachus*, rum. *călugar*, nga *καλόγερος*, *kelk*, *qelq*, *calicem*, rum. *potir*; *mallkoj* – *maledicere*, rum. *blagoslovi*; *ferr* – *infernum*, rum. *iad*; *fe*: *fides*, rum. *credință*, (Mansaku 2000: 42).

Në fonetikë përmendte dy fenomene: 1. Cilësinë e guturales *k* para *e*, *i*, që pajtohet me dalmatishten e sardishten, me shqiptimin velar *ke ki*, ndryshe nga it. e rum. me afrikate: *qepë: cepa*, rum. *ceapă*, it. *cipolla*; *qiell: caelum*, rm. *cer*, it. *cielo*. 2. disa fjalë latine në shqipen reflektojnë fazën e letrares, ku ruhej dallimi *zanore e gjatë/ zanore e shkurtë*; *ō* lat. në disa raste dha *e*, ndërsa *ū* dha *y*: *pōmum: pemë*, *hōra: herë*, *plōpus: plep*, *scūtum: shqyt*, *padūlem: pyll*, rum. *pădure*; *iunctūra: gjymtyrë*. Duke iu referuar Mihăescu-t, pranonte se dallimi i kunatitetit persistonte në mënyrë sporadike në latinishten deri në sh. III, pra fjalët e tilla paraqesin një stad më të vjetër. Edhe sipas tij, për ta përcaktuar vendin e latinizmave të shqipes duan marrë parasysh edhe raportet me dalmatishten, retoromanishten dhe elementet latine në gjuhët ballkanike. Jokl-i kishte treguar se paraardhësit e shqiptarëve kishin huazuar nga dalmatishtja fjalë si *prift – prievt*, *kambanë*, etj. (*Slavia* 13 (1934-1935), f. 286-292), Mansaku 2000: 43.

Nga të gjitha këto del se elementi latin i shqipes përbën një zonë të veçantë në latinitetin ballkanik, qoftë për sasinë apo për lashtësinë e fonetizmin, me lidhje me rumanishten, më pak me dalmatishten (Mansaku 2000: 43); shih për këto Banfi 1983, raportuar dhe këtu me sipër). Në lek-sikun latin të shqipes e të rumanishtes ka më shumë dallime sesa ngjashmëri, sepse ndikimi i latinishtes në shqipen është më i vjetër dhe ky ndikim ka vazhduar edhe gjatë Perandorisë së Lindjes dhe pas ardhjes së sllavëve në Ballkan. Këto ndikime janë vendosur mbi baza etnike të ndryshme. Si përfundim citonte Jokl-in, *Slavia* 13 1934-35: 286-92:

“Shqiptarët banonin një territor më të gjerë se ai që banojnë sot; ai territor shtrihej në Lindje deri në Dardanië Antike, ku prekte periferinë e zonës së stërgjyshërve të rumunëve, ndërsa në Perëndim deri në Detin Adriatik ku stërgjyshërit e shqiptarëve ishin fqinj me popullatën romane të Dalmacisë”, (Mansaku 2000: 44).¹⁹⁰

¹⁹⁰ “Les Albanais habitaient un territoire plus vaste que celui qu’ils habitent aujourd’hui; ce territoire s’étendait à l’Est jusque dans l’antique Dardanie, où il touchait à la périphérie de la zone des ancêtres des Roumains, et à l’Ouest jusqu’à la mer Adriatique où les ancêtres des Albanais étaient voisins avec la population romaine de Dalmatie”. Mbase nuk mund të mos vërehet ngjashmëria e idesë së Çabejtë me të mësuesit të tij.

Në një rast tjetër Mansaku fliste për çështje të tipologjisë romane në strukturën gjuhësore të shqipes, natyrisht, të para dhe në kontekst ballkanik.¹⁹¹

Në evolucionin e vazhdueshëm nga indoeuropianishtja, nëpër ilirishte e arbërishte për të arritur në gjendjen e shqipes së sotme, janë paraqitur larmi trajtash e modelesh si në këndvështrimin tipologjik ashtu edhe në atë gjenealogjik, në strukturën gramatikore të saj bashkëjetojnë dhe funksionojnë trajta e ndërtime me tipologji të ndryshme, me gjenealogji të ndryshme dhe me kronologji të ndryshme. Me tipologji romane a ballkanike ai kupton tipare strukturore që mbizotërojnë, që përbëjnë karakteristika themelore të një grupi të caktuar gjuhësh e që nuk gjenden, ose më saktë, nuk janë relevante për një grup tjetër gjuhësh. Niset nga dallimi midis rastit kur dy a më shumë gjuhë kanë tipare të përbashkëta a të ngjashme në mes tyre për shkak të origjinës së përbashkët, dhe tjetrit kur ato bëhen të ngjashme për shkak të kontakteve historike. Rasti i parë lidhet me gjuhët romane midis tyre, rasti i dytë me gjuhët ballkanike. Kjo nuk duhej të pengonte dhe eventualitete substratesh e raportesh të tjera. Tipologjitë romane kanë prejardhje nga gjuhët romane, nga latinishtja vulgare, ndërsa tiparet e përbashkëta të gjuhëve të Ballkanit mund të jenë me prejardhje krejt të ndryshme. Kjo nuk e përjashton mundësinë që edhe tiparet e përbashkëta të gjuhëve të Ballkanit të burojnë nga latinishtja vulgare ballkanike, mendonte Mansaku.

Në fushën morfosintaksore një nga tiparet që i ndan gjuhët romane perëndimore nga gjuhët ballkanike, përfshirë rumanishten, është prania e paskajores dhe e lidhores në të parat, pra bashkëjetoja e tyre dhe mungesa ose humbja e paskajores në të dytat. Në këtë

Po e them këtë, sepse disa studiues në emër të ndonjë objektiviteti të kalkulluar i bien në qafë albanologut tonë pikërisht në emër të ndonjë antinacionalizmi, çka nuk ka kuptim për rastin e Jokl-it.

¹⁹¹ Mansaku (2012), Seit: Tipologji romane dhe ballkanike në strukturën gramatikore të shqipes, in Ismajli (red.): *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit/ Albanian and Balkan languages*, ASHAK, Prishtinë, pp. 71-89.

ndarje shqipja zë një pozitë të ndërmjetme. Një vend të ndërmjetëm zë shqipja edhe për tipat e trajtës së kohës së ardhme. Zhdukja e paskajores në gjuhën rumune është treguesi më i qartë i formimit të një tipi ballkanik të gjuhëve të këtij rajoni. Origjina latine e rumanishtes nuk ka mundur të pengonte zhdukjen e paskajores në këtë gjuhë romane ballkanike. Me sa duket prirja që përfshiu gjuhët e Ballkanit për ta zëvendësuar trajtën e paskajores me trajtën e lidhores ka qenë më e fuqishme sesa tradita gjuhësore romane ku bashkëjetojnë paskajorja me lidhoren. Në këtë pikë një gjuhë romane në arealin gjuhësor ballkanik ka ndjekur zhvillimet gjuhësore të rajonit jo lidhjet historike gjenetike të traditës, mendonte ai, duke vënë në pah dhe dallimet midis saj e shqipes (Mansaku 2012: 74).

Areali gjuhësor i shqipes, vazhdonte ai, është i ndarë në dy pjesë: në arealin gjuhësor gegë ku bashkëjetojnë paskajorja dhe lidhorja, ashtu si në gjuhët romane dhe në arealin gjuhësor toskë ku përdoret lidhorja dhe një trajtë paskajorje e re ashtu si në gjuhët e tjera ballkanike. Kjo do të thotë se gegnishtja afrohet më shumë me tipin roman, ndërsa toskërishtja me tipin ballkanik,

“madje gegërishtja është më afër tipit gjuhësor roman edhe se vetë rumanishtja që është gjuhë romane”, (Mansaku 2012: 75).

Pas analizave, ai konstatonte se shqipja nuk merr pjesë në tiparin ballkanik të humbjes së paskajores dhe të zëvendësimit të saj me lidhoren.

“Në tërësinë e saj me këtë tipar ajo është më afër tipologjisë së gjuhëve romane që përdorin edhe paskajoren edhe lidhoren, sesa me gjuhët ballkanike ku paskajorja është zëvendësuar me lidhoren”, (Mansaku 2012: 75-76).

Ai vjen të mbështesë idenë që një nga faktorët që ka ndikuar në krijimin e përhapjen e ballkanizmave ka qenë romaniteti ballkanik. Kështu ato ngjashmëri paraqiten si tipologji romane dhe ballkanike njëkohësisht. Nga pikëpamja e origjinës janë romane, nga ana tipologjike janë romane dhe ballkanike. Kështu p. sh. trajta e së kryerës së gjuhës shqipe, e formuar nga folja ndihmëse *kam* dhe pjesorja e foljes kryesore: *kam shkruar*,

kam kënduar etj., duket se është krijuar sipas modelit latin *habeo scriptum, habeo cantatum* etj. Në vijim ai merrej me trajtat e së ardhmes në shqipe në krahasim me gjuhët romane dhe gjuhët ballkanike. Lidhur me trajtat e së ardhmes shqipja zë vend të ndërmjetëm, sepse në strukturën gramatikore ka trajtën e së ardhmes me *do* + lidhore, trajtat me foljen ndihmëse *kam* + paskajore gege me *me*, ose paskajoren e mbarë shqipes me *për të*, të cilat i përkasin modelit roman dhe trajtën me foljen ndihmëse *kam* + lidhore që përbën një model të përzier.

Tipi i së ardhmes *kam* + paskajore, sipas Mansakut, mund të konsiderohet roman, i krahasueshëm me trajtat e gjuhëve romane sipas latinishtes vulgare infinitiv + folje ndihmëse *habeo: cantare habeo*. Meqë ky model roman është i përhapur edhe në gjuhë të tjera europiane, kjo nuk do të thotë domosdo se e ardhmja e tipit *kam* + paskajore në shqipe është krijuar nën ndikimin e drejtpërdrejtë të latinishtes vulgare ose të latinishtes ballkanike. Ndryshe nga Kristian Sandfeld¹⁹² që e shihte të tillë, mendonte se Shaban Demiraj nuk pajtohej.¹⁹³ Mansaku shkante më tej dhe argumentonte se në latinishten vulgare dhe në latinishten kishtare krahas *cantare habeo* ka ekzistuar *habeo cantare, habeo dicere* dhe *habeo ad cantare*,

“nga mund të burojnë togjet sintaksore e pastaj trajtat e shqipes kam me këndue dhe kam për të kënduar” (Manskau 2012: 82).

Dhe theksonte se

“tipi i së ardhmes me kam + paskajore në gjuhët romane perëndimore është formuar mbi bazën e togut latin cantare habeo, ndërsa ai i shqipes dhe i rumanishtes së vjetër mbi bazën e togut latin me rend të përkundërt habeo cantare. Mbi bazën e këtij lokucioni është krijuar futuri i vjetër rumun am a cânta, që u zëvendësua më vonë me trajtën e së ardhmes am sâ cînt” (Mansaku 2012: 83).¹⁹⁴

Këtu ai rendiste edhe të dhënën se trajta e së ardhmes në ru-

¹⁹² Sandfeld, Kristian: 1930, f. 183.

¹⁹³ Demiraj 1986, Shaban: f. 848.

¹⁹⁴ Referonte Densusianu, *Histoire de la langue roumaine I*, f. 181.

manishten dhe në shqipen është një formë perifrastike, ndryshe nga gjuhët romane perëndimore. Natyrisht, Mansaku të gjitha këto i shih-te komplekse në ndërlidhjet ballkanike e romano-ballkanike.

Sa i përket lindjes së nyjave ai, pas një trijazhi të materialit e ideve, niset nga përfundimi se përjashtohet prejardhja greke. Kjo do të thotë se për këtë duhet t'i drejtohem latinishtes ballkanike ose ndonjë substrati. Kuptohet që prapavendosja nuk mund të kërkohet nga latinishtja. Për shkak se në rumanishten çështja e prapavendosjes – me prejardhje latine apo të substratit trak – mund të ndiqet më lehtë, për shqipen, mendonte ai, çështjen duhet ta shohim në raportet me rumanishten, bullgarishten e maqedonishten.

“... Përderisa të gjithë studiuesit e gjejnë burimin e nyjeve të dëftorët anaforikë, atëherë prapavendosja e nyjes shqese duhet kërkuar në ato gjuhë që kanë njohur prapavendosjen e këtyre dëftorëve”, (Mansaku 2012: 88).

Kjo do të thotë se ndikimin eventual mund ta kërkonim te përhapja e modelit që i prapavendos dëftorët anaforikë. Ai e merrte të mirëqenë faktin se zhvillimi nga dëftorthi te nyja shqese është proces i brendshëm i secilës gjuhë. Me fjalë të tjera, ai këtu shihte ndonjë lloj kalku nga latinishtja ballkanike apo nga ndonjë substrat. Kuptohet, e tërë kjo, edhe pse sa i përket konceptimit mund të të kujtojë reflekset e Rizës, mund të mos pajtohet me zberthimet sintagmatike të Bokshit, për çka do të flitet më vonë.

Për elemente ballkanike që dalin dhe në gjuhë të tjera, pos rumanishtes e shqipes, Mansaku kërkonte shpjegime ballkanike. Te numërorët nga 11 deri në 19 ai sugjeronte që, përveç afrisë me gjuhët e Ballkanit, të shihet dhe ruajtja *“e ndonjë elemeti të sistemit vigezimal (njëzet, dyzet)”*, ku, siç është vënë re shumë dekada më herët, gjuha shqipe ka përkime me frëngjishten (qatre vint), dikush e ka çuar më tej te mundësia e përkimit më të hershëm me baskishten, etj. Kështu ai vinte në përfundimin se

“shqipja,... merr pjesë në lidhjen gjuhësore ballkanike me disa tipare kryesore të sistemit të saj gramatikor dhe në disa prirje zhvillimi, por

në disa tipare ajo afrohet edhe me struktura të gjuhëve romane, duke zënë kështu një vend të ndërmjetëm midis gjuhëve ballkanike dhe gjuhëve romane”, (Mansaku 2012: 88).

Pa e mohuar mundësinë e ndikimit të ndonjë substrati, ai kërkonte që shpjegimet të bëhen më parë brenda zhvillimeve konkrete ballkanike.

Në ballkanistikë ka pasur shumë diskutime lidhur me çështjen e ‘zhdukjes së paskajores’. Këto diskutime nuk kanë qenë të pakta as lidhur me gjuhën shqipe. Në vijim të këtyre diskutimeve, sidomos të Mansakut e Demirajt, Ina Arapi ndërmori një studim të gjerë për përdorimin e paskajores dhe të lidhores në shqipen e vjetër në përjasje dhe me rumanishten. Studimi i Arapit është i gjerë dhe merret me përdorimet e paskajores më vete dhe në lidhje me folje të veçanta modale. Krahasimi me rumanishten e shkrimeve të hershme jep mundësinë të nxirren dhe përfundime të tjera lidhur me procesin që, Sh. Demiraj në studimin e tij të vitit 2012 e kishte cilësuar kështu:

“... çështja e zhdukjes së paskajores në gjuhët e Ballkanit mbetet e hapur” (Demiraj 2012: 133).

Shqyrtimi i mëtejshëm i analizave të gjera dhe përfundimeve konkrete të studimit të Arapit do të na çonte larg në çështje të veçanta, që nuk kanë qenë objekt i këtij studimi. Ajo që duhet të theksohet me këtë rast është fakti se studimi i Arapit tregon qartë proceset komplekse të zhvillimit sintaksor të përdorimeve të formave të ndryshme të paskajores që nga autorët e vjetër e deri në gjendjen e sotme, ashtu siç tregon se ka zhvillime të tilla edhe në rumanishten – është vështirë që t’i çojmë te substrati. Më duket se studime të këtij lloji do të ndihmonin shumë për sqarimin e shkallës së afrive midis dy gjuhëve dhe eventualisht lidhjet që mund të supozohen me substratin apo tendencat që janë përmendur si trashëgimi prej andej.

Kristophson-i

Me interes kanë qenë pikërisht në këtë drejtim vrojtimit e Jürgen Kristophson-it (1988: 51-93) për romanizmat e shqipes. Sipas tij,

kontaktet e shqipes me latinishten/ gjuhë romane kanë qenë dinamike, në kohë dhe në hapësirë. Në parim, duke lënë anash latinishten e periudhës klasike standarde, gjuhë e shkruar, ai veçonte më tej latinishten e periudhës pasklasike, gjuhë e shkruar, gjuhën popullore latine, të periudhës klasike, gjuhën popullore latine të periudhës pasklasike, variantet rajonale në kohë të ndryshme, gjuhët joromane në pika të ndryshme kohore, duke vendosur kështu kontakte dinamike dhe jo njëdrejtimëshe midis idiomës vendore jolatine dhe idiomave romane (latinishte popullore) në kohë të ndryshme. Ndër periudhat që vërehen nga skica e tij në f. 53, del se kontakte mund të parashikohen midis latinishtes në kuptimin e gjuhës popullore të periudhës klasike, por edhe të latinishtes klasike standarde, pastaj midis latinishtes popullore të periudhës pasklasike, ku relacionet midis lat. klasike dhe romanishtes së periudhës së kohës së tashme e romanishtes së kohës klasike janë të tipit të kontinuitetit, por janë të mundshme aty ndikime lat. klasike pasklasike në të dhe në shqipen përkatëse njëherësh; derisa në periudhat e mëparme kemi ndikime në shqipen nga latinishtja dhe romanishtja apo latinishtja popullore e kohës klasike e pasklasike, në një periudhë kohore të caktuar kemi ndikime nga romanishtja në variacionet rajonale të tipit rumanishte, të tipit rajonal dalmatishte dhe të tipit rajonal italishte, të gjitha në një periudhë të shqipes së hershme (Früh-albanisch). Në këtë lak kohor mendohet të ketë pasur një fazë bilinguizmi midis shqipes përkatëse dhe para-rumanishtes; në periudhën kohore vijuese, ndërkaq, shënohen më tej kontakte dhe ndikime midis romanishtes së tipit dalmat e italian, por jo më rumun në shqipen. Në kohën t3, pra, kemi një kontakt të tipit të bilinguizmit të përhapur midis parashkallës së rumanishtes së sotme, para-rumanishtes dhe rumanishtes së hershme dhe para-shqipes apo shqipes së hershme (Vor-albanisch, Früh-albanisch): këtu mendohet të ketë pasur ndikime nga drejtimi i romanishtes së tipit para-rumun apo rumanishte e hershme në para-shqipen apo shqipen e hershme, por edhe e kundërta: kjo merret si një situatë e bilinguizmit të përhapur, apo edhe si e rrethanave të substratit të disa

grupeve të folësve të shqipes së asaj shkalle, por jo të gjithëve për përkatësen romane. Këtë hipotezë e mbështeste, pas tij, më tej fakti se elementi autokton i rumanishtes shfaq paralele të pjesshme me shqipen, sakohë që me gjuhë të tjera nuk dalin korrespondenca bindëse (Kristophson 1988: 53-54).

Pavarësisht se ka raste shpjegimesh kronologjike-etimologjike të errëta, vetë vështrimi dinamik kohor, ashtu si diskutimi i Kristophson-it në bazë të kriterëve nga fusha e zhvillimeve fonetike e semantike ka vlerë. Prej këtyre analizave të risimeve del se disa prej elementeve romane të shqipes lidhen me rumanishten, konkretisht me para-rumanishten apo rumanishten e hershme. Si ilustrim jepete rastin: lat. *scala*, rom. *scala*, formë e veçantë gjuhësore *scatǎ* (forcim i / ndërzanore, dobësim i fundjes), rom. e re: it. *scala*, rum. *scară* (*t : r*), fr. *échelle*, sp. *escala*. Hua-zimi në shqipen e hershme shkallë (*t = ll*, në fund ka *ë*, në fillim *sh*). Shqipja dhe rumanishtja këtu ndahen nga gjuhët e tjera romane me ndryshimin e *-l-*. Pak më i vështirë shihej rasti i emrave popullore të muajve. Një pasqyrë jepej te Kristophson 1988: 56-7:

lat. letr.	romane rajonale	rajonale romane	rumune/ shqipe
	(forma teorik. realizime të mundshme të rind. fonet.)		
ianuarius	kalendarius	kalendariu	çärindar/ kallënduar
februarius	feuarium		färuar/ fruar
martius	marču		març/ mars
aprilis	pritu		prier/ prill
iunius	ceresiarius	k'erešariu	cirešar/ qershör
iulius	...		
augustus	agustu		agust/ gushtë
septembris	?	
octobris	?	
novembris	brumarius	brumariu	brumar/ brymor
decembris	Sanctus Andreas	san andrea	ëndrea/ shëndënda

shën e shqipes duhet t'i përgjigjet formës së vjetër rumune *sîn*, si te it. *san*. Forma e plotë, apo e gjatë, në rumanishten është sllave – *sfînt*, apo greke – arum. *ajiu*, ndërsa në shqipen kemi *shenjt*, *i*, *e*, prandaj duhet të jetë nga një tjetër idiomë romane, ku *-nct* u bë *-nj*. Në rastet si *gusht*, mund të kemi të bëjmë me fazë më të hershme, sepse rënia e zanores në fillim përputhet me të tjerat: *Ndue*, *Ndre*, *mik*, *rrgjan*, etj.; te *qershör*, *bry-*

mor mund të kemi të bëjmë me huazim të parmë *qersh*, *brymë* dhe pas-taj ndërtime brenda rrjedhave të shqipes; te *shën*, *shenjtë*, kemi të bëjmë me kronologji tjetër të huazimit të terminologjisë së krishterë, prandaj edhe shtresë tjetër gjuhësore, nuk e di sa e afërt me dalmatishten.

Midis latinishtes, rumanishtes e shqipes ai vendoste ndërpergjegjësi tingullore si vijon:

latinisht	rumanisht	shqip
a në pozitë të theksuar	ă, î	ë
i në pozitë të theksuar	ă, î	ë
ce-/ci-	ce-/ci-	q-
ge-/gi-	ge-/gi	gj-
s	s	sh
ti-, ci-	para zanores ci-, ț	s
l ndërzanore	r	ll
cl-, gl-	kl'-, gl', e vjetër; zhvillimi i mëtejshëm i ndryshëm;	
-ct-	pt ft.	Por shqip jt, t, qt.

Korrespondenca të tilla tingullore flasin për kohë më të vjetër, aq më tepër që ato mund të vërehen edhe tek elementi autokton i rumanishtes: *viezure/ vjedhull*. Edhe kjo flet për kontakte të lashta midis romanëve rajonalë dhe joromanëve vendorë, (Kristophson 1988: 57).

Kur në fjalët shqipe me prejardhje romane kemi reflekse të tjera, kjo do të thotë se duhet të shohim lidhjet me ndonjë gjuhë tjetër romane, si gjuhë e dytë e kontaktit – këtu dalmatishtja; nëse as kjo nuk jep shpjegim duhet të shohim një gjuhë të panjohur romane, latinishte ende e panyjëtuar, apo të shohim një zhvillim brenda shqipes (Kristophson 1988: 58. Për bazë ka Mihăescu 1966, Haarmann 1972, Çabej 1976, Pușcariu 1905, Meyer-Lübke).

Proceset e derivimit, sipas tij, nxjerrin vështirësi. Për shembull: *tjegull* - *tegula*, *tjegullar* – *tegularius*; *asper* - *ashpër*, *ashpërim*, rum. *asprime*; *scurt* - *shkurt*, *shkurtim*, rum. *scurtime*.

Por, derisa te *shkurtim*, nga *shkurtoj* kemi derivim të rregullt brenda shqipes, tek *ashpërim* kemi të bëjmë me formim libresk.

Kristophson-i me këtë rast shënonte dhe paqartësitë eventuale lidhur me fenomenin e *multiple etymologies* – të rasteve kur një fjalë shqipe mund të dalë nga burime të ndryshme romane: *kungë* me *kungoj*, apo me *congā* (Kristophson 1988: 59).

Përfundimet e C. Vătăşescu-t

Studimet e elementit latin të shqipes në raport me atë që quhet latinitet ballkanik kanë tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve prej kohësh. Një raport me interes për këto aspekte mund të gjendet te R. Solta (1980). Diskutime të mëtejme ka dhe te Pellegrini (1997), ndërsa tek ne më të thelluara kanë qenë shqyrtimet e Çabejtë (1962: 166-180), i cili tërhiqte vërejtjen se në raportet midis latinizmave të shqipes, dalmatishtes e rumanishtes mund të dalin raporte me interes, porse jo çdo herë është e mundur të hetohen çështjet deri në fund për shkak se për dalmatishten nuk ka të dhëna të mjaftueshme. Sido që të jetë, ai mendonte se elementi latin i shqipes vendoset diku midis dalmatishtes dhe rumanishtes. Për disa veçori, si duket, dalmatishtja del më e afërt me latinizmat e shqipes sesa me rumanishten. Këtë e kishte theksuar dhe Pellegrini (1997), ndërsa Mihăescu (1966 : 349) mendonte se dalmatishtja dhe shqipja largoheshin nga rumanishtja duke qenë më afër me romanizmat perëndimorë. Ai shënonte elemente të përbashkëta midis shqipes, dalmatishtes e rumanishtes, por edhe vetëm midis shqipes e dalmatishtes. Vătăşescu me të drejtë theksonte se çështja e raporteve midis latinizmave të shqipes, të dalmatishtes dhe të rumanishtes ende nuk është studiuar në mënyrë shterruese (Vătăşescu 1999: 8).

Kështu koncepti i latinitetit ballkanik vihet në dyshim. Në fakt, qysh Skok-u (1940) kishte veçuar një latinitet ballkanik bregdetar dhe një tjetër kontinental. Diçka tillë kishin diskutuar dhe Barić-i e të tjerë me raste të ndryshme. Sipas konceptimit tradicional latiniteti ballkanik karakterizohet me një leksik homogjen, i cili del si në dalmatishten e rumanishten, ashtu dhe në gjuhët e ndikuara më pak a më shumë

nga latinishtja – në shqipen, në greqishten dhe në sllavishtet e jugut (Solta 1980: 124 e tutje). Sipas Solta-s ky koncept në përgjithësi ishte i pranueshëm, por ai bënte dhe disa vërejtje. G. B. Pellegrini tërë këtë e quante latinitet ballkano-danubian dhe aty përfshinte elementet latine të gjuhëve ballkanike, por nuk shihte nevojë që këtë ta kundërvinte me romanitetin tjetër. Sido që të jetë shqyrtime të Çabej dhe të Rosetti nuk merren shumë me diskutimin e nocionit, po e miratojnë atë në përgjithësi. Pak më kontestues në raport me latinitetin ballkanik ka qenë studiuesi i shquar i elementit latin të shqipes H. Mihăescu (1970: 10 e në vijim). Ai dallonte disa zona të ndryshme të elementeve latine në Ballkan edhe në raport me kohën dhe hapësirat: elementet latine të shqipes, dalmatishtja, istrorumanishtja dhe panonishtja e humbur, rumanishtja, elementet latine në gjuhët sllave të jugut dhe elementet latine në greqishten. Na duket se duhet të pajtohemi me C. Vătăşescu-n që konceptimet e Mihăescu-t ishin më të nuancuarat dhe më të afërtat me realitetet. Por edhe studiues të tjerë këtu shihnin diferencime, si p. sh. Banfi, për tri zonat e të cilit fjalë diçka më herët. Ai e kishte theksuar po ashtu raportin e veçantë të latinizimeve të shqipes me italishten e jugut. Në rumanistikë lidhur me këto çështje ka pasur dhe vazhdon të ketë diskutime të shumta. Kështu, p.sh., te G. Brâncuş-i (1983 : 187-188) mund të vërehen që brenda latinitetit karpato-ballkanik do të jenë zhvilluar së paku dy zona dialektore dhe këtë ai përpikëj ta vinte disi në raport me elementet latine të rumanishtes dhe të shqipes. Më herët A. Philippide (1928: 63-691), siç raportohet dhe te Vătăşescu (1999: 9), ndër elementet latine të shqipes dallonte disa kategori:

- fjalë latine të përbashkëta vetëm për shqipen dhe rumanishten;¹⁹⁵

- fjalë që në shqipen e në rumanishten kanë etimologji të afra, njëra ndjek fjalën bazë, tjetra derivatin, apo të dyja ndjekin derivate

¹⁹⁵ Këtu vetë Vătăşescu numëronte: *canticum, capitina, cerebrum, creatio, cunctari, debitare, fossatum, horae, horrere, hospitium, imperator, iudicata, iudicium, manicare, maregella, mastichinus, noverca, ordinare, paenitare, pallium, pervigilare, rosalia, spodium*, f. 511.

të ndryshme të një baze;

- fjalë latine që dalin në shqipen e arumanishten, por nuk shfaqen në dakorumanishten;

- fjalë panromane që janë huazuar nga shqipja, por mungojnë në rumanishten;¹⁹⁶

- fjalë të përbashkëta për shqipen dhe për dakorumanishten, por që mungojnë në gjuhët e tjera romane (shih dhe Vătăşescu 1999: 9-10). Sipas tij, fakti se në shqipen ka mjaft elemente latine që mungojnë në rumanishten tregon se nuk kishte pasur ndonjë lidhje të ngushtë midis rumanishtes e shqipes.

Në studimin e saj të gjerë, të nuancuar dhe të thelluar për leksikon me prejardhje latine të shqipes në krahasim me rumanishten, Cătălina Vătăşescu (1997) kishte ndërmarrë shqyrtimin e konvergjençave dhe divergjençave midis shqipes e rumanishtes dhe e kishte konsideruar të domosdoshme të vinte ballë për ballë termat latinë të shqipes dhe të rumanishtes, të grupuar sipas fushave leksikore në një mënyrë unitare. Sipas përfundimeve të saj, studimet e thelluara të latinizmave të shqipes, sidomos të Mihăescu 1993 dhe të Kristophson 1988, ngjet që të ketë absolutizime herë të divergjençave, herë të konvergjençave midis shqipes e rumanishtes.

“nga njëra anë, për H. Mihăescu-n, ngjashmëritë midis këtyre dy gjuhëve nuk kanë domethënie të veçantë dhe përjashtojnë mundësinë e një zhvillimi të përbashkët” (Vătăşescu 1997: 493),¹⁹⁷

ndërsa për Kristophson-in ndër raportet midis elementit latin të shqipes dhe rumanishtes të vetmet që kanë rëndësi janë paralelizmat. Në bindjen e Kristophson-it, burimi i huazimeve latine të shqipes është variant i latinishtes prej së cilës u zhvillua rumanishtja.

¹⁹⁶ Ndër to Vătăşescu shënonte: *aetas, arca, centum, temina, fides, gaudium, honor, infernus, laborare, lima, molinum, monachus, opera, ordinis, par, paucus, radio, rapum, rapa, rete, ruga, salvare, spatula, spina, tine, valere*, etj.

¹⁹⁷ “Pe de o parte, pentru H. Mihăescu, similitudinile dintre cele două limbi nu au o semnificație specială și exclud posibilitatea unor evoluții comune”.

Studimi i Vătăşescu-t këtë hipotezë e pohon vetëm në pak raste, ndërsa më të shpeshtën ky supozim kundërshtohet me evidencën se rumnaishtja ka terma të tjerë me prejardhje latine të cilat i ka marrë ndryshe nga shqipja. Studimin e saj ajo e ka nyjtuar sipas 22 grupeve të fjalëve, që japin një pasqyrë të tërësishme dhe komplekse e të nuancuar për pozitën e elementit latin të shqipes (Vătăşescu 1997: 493). Kategoritë e veçuara i japin asaj përfundimin se midis inventarit të elementeve latine të huazuara nga shqipja dhe elementeve të trashëguara në rumanishten ka bashkëpërkime të rëndësishme strukturore, të përndarjes dhe të zhvillimit kuptimor. Në të njëjtën kohë, paralelet që kanë shqipja e rumanishtja, secila në mënyrë të vet, me dalmatishten, italishten, sardishten e retoromanishten, ashtu si me gjuhët romane perëndimore,

“e mohojnë tezën për ekzistencën e një njësie të formuar midis shqipes dhe rumanishtes, në kundërvënje me gjuhët e tjera romane” (f. 517).¹⁹⁸

Studiuesja Vătăşescu nuk arrin në përfundimin e studiuesve të ndryshëm të raporteve midis shqipes e rumanishtes, sipas të cilit njësia midis këtyre dy shtresave i detyrohej ndikimit ekskluziv në shqipen të variantit të latinishtes që do të bëhej gjuhë rumune. Sipas saj, elementet latine të ruajtura në rumanishten dhe në shqipen nuk përkufizojnë një hapësirë që do t’i kundërvihej në mënyrë sistematike dhe të përhershme bllokut të gjuhëve romane perëndimore. Studimi i saj i thelluar dhe me vështrimin gjithëroman, thotë se ka një vazhdimësi të idiomave romane nga perëndimi deri në juglindje të Europës, kështu që shqipja ka pasur mundësi të huazonte ga burime të ndryshme të siujdhesës Apenine, të Europës juglindore, apo nga një variant i latinishtes së humbur para se të zhvilloheshin gjuhët e veçanta romane lindore – dalmatishtja dhe rumanishtja. Pra, përbri zhvillimeve të përbashkëta midis rumanishtes e shqipes, ka pasur dhe zhvillime divergjente (Vătăşescu 1997: 517).¹⁹⁹

¹⁹⁸ “... infirmă teza existenței unei unități formate de albaneză și română, opusă celorlalte limbi romanice”.

¹⁹⁹ Ajo shënonte, ndër të tjera, grupin e fjalëve që shqipja i ka marrë direkt nga latinishtja, ndërsa rumanishtje me ndërmjetësim sllav: *oleum, flasca, rosalia, campana*, etj.

NË FUND

Studimet e mëparme theksojnë lidhjen e fortë të këtyre elementeve romane të shqipes me rumanishten (Weigand 1927, Skok 1940) ose marrin dy rryma kryesore huazimesh – nga rumanishtja dhe nga dalmatishtja (Barić 1956 I, Çabej 1962) me kufizime, shohin një pozitë të ndërmjeme midis dalmatishtes e rumanishtes, ose lidhjet me rumanishten i interpretojnë veçan (Mihăescu 1966).

Nga ana tjetër, sllavizmat e shqipes dhe të rumanishtes shfaqin po ashtu ngjashmëri dhe dallime. Dallimi i parë qëndron në sasi: rumanishtja ka shumë më tepër sllavizma se shqipja. Madje edhe fjalë kështu të zakonshme si *iubi, drag, prieten, obraz, slujbă* (meshë) në rumanishten janë nga sllavishtja. Më i rëndësishëm është fakti se nga sllavishtja në rumanishten kanë hyrë kryesisht bullgarizma, ndërsa në shqipen edhe serbizma. Duket se vala e hershme sllave drejt jugut të Ballkanit nëpër Bullgari e në luginën Morava-Vardar ka shkuar më parë drejt Greqisë deri në Peleponez, ku ka lënë gjurmë sllavizmash para metatezës së likuideve sllave, që ka përfunduar në sh. IX. Duket se disa gjurmë sllavizmash të hershëm ruhen në shqipen e jugut pikërisht nga ato kohë, ndërsa aspekti bullgar i ndikimit sllav andej u theksua pas shekullit X (Rosetti 1968; Mihăilă 1960; Pătruț 1974, 1974a; Ylli 1996; Svane 1992, etj).

Edhe ky dispozicion i sllavizmave të shqipes e të rumanishtes flet për ndodhjen e këtyre gjuhëve kryesisht në dy anë të Gadishullit - lindje/perëndim. Kur kësaj i shtojmë edhe vlerësimet në rrafshin IE për shqipen si më perëndimore në raport me trakishten, frigjishten, armenishten (Heinal 2003), apo edhe analizat leksikostatistike që thonë po këtë gjë (Holm, 2009), nuk mund të mos flasim për vendosjen e proto-shqipes në hapësirat më perëndimore të Ballkanit. Kështu mund të ndihmojmë dhe për vendosjen më të saktë të kontinuumit gradual dhe me ndryshime të romanitetit ballkanik nga perëndimi në lindje, po edhe nga shek. II para K. e më vonë.

Diskutimet e paraqitura kështu përmbledhtazi sikur na udhëzojnë të provojmë të nxjerrim përfundimet vijuese.

Shqipja dhe rumanishtja kanë ngjashmëri midis tyre në rrafshet e ndryshme. Në rrafshin strukturor ngjashmëritë nuk shkojnë më herët se sh. VII-VIII, kur u formua rumanishtja, sepse në latinishten popullore nuk dokumentohen. Tiparet si burimi dhe prapavendosja e njëjës shquese në shqipen janë të lashta, ndërsa në rumanishten mbase pas sh. VIII. Prapavendosja dhe përngjitja e njëjës shquese duket të ketë marrë fund në sh. VI-VII, prandaj bëhet e mundshme hipoteza për ndikimin eventual të shqipes mbi rumanishten. Rotacizmi do të jetë zhvillim i pavarur.

Ngjashmëritë midis dakorumanishtes dhe toskërishtes, që theksoheshin ndonjëherë pa të drejtë në raport me ndonjë shpërngulje të supozuar të folësve të toskërishtes nga hapësirat veriore, duan parë më tepër të kohëve të zhvillimeve ballkanike, pra pas vendosjes së sllavëve.

Në leksik ka shtresa të ndryshme;

Leksiku latin i të dy gjuhëve, edhe kur mendohet nga një latinisht ballkanike (sa njëjësore?), në rastin e shqipes shfaq veçori më përndimore, më urbane, më të hershme se në rumanishten;

Zhvillimet fonetike në fushën e latinizmave të dy gjuhëve shfaqin ngjashmëri, por edhe ndryshime.

Sa i përket leksikut të përbashkët paralatin, për një pjesë kemi të bëjmë gjithsesi me elemente të lashta, por as në ato raste nuk mund ta dimë se nga cila gjuhë na vijnë; shtegtimi i leksikut është i njohur; për një pjesë kemi të bëjmë me zhvillime më të vona, sepse këtë e thonë proceset fjalëformuese të identifikueshme brenda shqipes. Lidhur me këtë çështje po sjell përfundimet që kisha arritur në vitin 1983.

Ekzistenca e një substrati në rumanishten s'ka si të vihet në dyshim, por kjo nuk do të thotë se çdogjë e përcaktuar në mënyrën e sipërpërmendur i takon substratit. Vetë emërtimi i substratit - dako-getishte, dako-mezishte, trako-dako-geto-mezishte, duket problematik. Nga ana tjetër, midis njatij substrati dhe gjuhëve të tjera paleoballkanike kishte kontakte intensive shumëshekullore, kështuqë huazimet midis tyre ishin jo vetëm të mundshme, por të domosdoshme. Në errësirën që jemi lidhur

me këto gjuhë nuk mund të dihet se cili element leksikor i takonte cilës prej këtyre gjuhëve.

Romanizmi përfshiu të gjithë Ballkanin, ku më shumë e ku më pak, dhe që të gjithë i përfshiu në të njëjtën mënyrë: nuk bëhej zgjedhje midis popujve që do të romanizoheshin: zgjedhja, si gjithmonë, kishte karakter klasor, të pasurit u romanizuan më shpejt; kur bëheshin romanë të gjithë ishin njësoj, nuk dihej më kush ishte “dakoroman”, kush “getoroman”, kush “mezoroman” kush “ilioroman”, etj. Rezultati unifikues (megjithë ndryshimet që dalin nga pikënisjet e ndryshme të romanizimit) fsheh, të mos themi fshin, gjurmët e rendit të mëparshëm.

Nëse ky substrat është ruajtur në rumanishten vetëm në elemente të veçuara, ndërsa në shqipen është ruajtur megjithatë si një gjuhë e tërë, si mund ta ngrejmë mbi këtë bazë tezën pas së cilës vendi i formimit të shqipes ishte Veriu i Ballkanit, ku u krijua një gjuhë romane? Pse u desh shqipja të mbetet e gjallë në një zonë që do të duhej të ishte romanizuar më herët? A nuk duket e sforcuar teza pas së cilës vendi ku është folur një gjuhë nuk është ai ku flitet edhe sot dhe ku ka gjurmët qysh në Antikë, po një zonë ku na qenkan ruajtur vetëm elemente të veçuara të kësaj gjuhe në një gjuhë tjetër?

Nëse këto elemente të veçuara do të duhej të tregonin se shqipja në Antikë është folur në zonat ku do të jetë formuar rumanishtja e sotme, ajo duhet të ketë ruajtur në vete elemente të kontakteve me gjuhët që janë folur në atë kohë në ato vise; cilat janë ato elemente dhe me cilat gjuhë e afrojnë shqipen? Të tilla, me sa duket, nuk ka.

Në shqipen element paleoballkanik është vetë shqipja, ndërsa në rumanishten “substrati”. Ky dallim cilësor shumë i madh, i theksuar disa herë nga Çabej, nuk ka si të mos përfillet, pavarësisht nga mundësitë që ka shkenca në gjendjen e sotme për shpjegimin e elementeve të substratit të rumanishtes.

Lidhur me raportet leksikore dua të vij te përfundimet që mund t’i kem pasur dhe më herët, pra diskutimet ndërkohë, sidomos të Schumacher-it e të tjerëve, vetëm sa m’i kanë ripohuar.

Në numrin e fjalëve të përbashkëta midis dy gjuhëve përfshihen dhe fjalë për të cilat kjo lidhje duket shumë e dyshimtë, ndonjëherë madje edhe e pamundur (*pururea – përherë, droaie – droe*, etj.). Fakti se këto fjalë ndeshen në shqipen dhe në rumanishten nuk mjafton për të dëshmuar se këto fjalë janë nga gjuha prej së cilës doli shqipja, e cila në këtë rast do të ishte gjuha që u zëvendësua nga rumanishtja në Rumani. Në shumë raste etimologjite më të matura kanë treguar madje se kemi të bëjmë me huazime në të dy gjuhët nga ndonjë gjuhë fqinje, ose edhe me ndonjë latinizëm. Prandaj për vendosjen e listës përfundimtare të fjalëve të përbashkëta të shqipes dhe të rumanishtes është nevojshme një shoshitje e re etimologjike me kriterë pak më të sigurt, me ç’rast do të merreshin parasysht në mënyrë më të qartë ndryshimet fonetike midis këtyre fjalëve në shqipen dhe në rumanishten, si dhe ndryshimet kuptimore. Për ne është e qartë një gjë: nëse një fjalë shqipe e pahuazuar hyn në një vorbull etimologjik, me ndryshimet dëshmon lidhje të zgjeruara fjalëformuese dhe kuptimore, ndërsa në rumanishten del e izoluar, kjo do të thotë se kjo fjalë në këtë gjuhë është huazim nga shqipja. Ky përfundim mund të vështrohet edhe nga aspekti i zhvillimit fonetik, me ç’rast edhe mund të verifikohet teza (fjalët që në rumanishten kanë -l- ndërzanore (*balaur, mal(u)*), apo me zhvillime të tjera në vokalizëm, siç kishte vërejtur dhe Frâncu ndërkohë). Është e qartë edhe kjo: jo të gjitha fjalët që shënohen si të përbashkëta në shqipen dhe në rumanishten janë të të njëjtit burim. Disa prej tyre mund të jenë të trashëgimisë së vjetër shqipe, disa huazime nga ndonjë gjuhë e afërt gjeografikisht në ndonjë kohë, ndërsa disa huazime nga rumanishtja në shqipen.

Le të marrim ndonjë shembull. Fjala shqipe *këlbazë* zërthehet në *kalb+azë* dhe në këtë mënyrë hyn në lidhjet e tjera kuptimore dhe fjalëformuese (Çabej). Si e tillë ajo nuk mund të jetë shumë e vjetër, sepse në atë rast gjurmët fjalëformuese do të ishin zbehur ose zhdukur fare. Nëse fjala në shqipen nuk mund të jetë huazim për shkak të lidhjeve të saj evidente fjalëformuese dhe kuptimore brenda shqipes, dhe nëse nuk është e

vjetër, ajo nuk mund të jetë as fjalë e ndonjë gjuhe që do të ishte substrat i rumanishtes. Pra, një fjalë e tillë nuk ka mundur të hyjë në rumanishten në kohën e latinishtes danubiane. Shpjegime të ngjashme na dalin përpara edhe për fjalë si *shtrungë* (*shtroj+ungj*, si te *shtjell+ ungë= shtëllungë*), *gërresë* (*gërryëj+esë*, *shtresë=shtroj+esë*), *shkul* (*shk+kul*, *n+kul=ngul*, *për+kul*), etj. Në të gjitha rastet e tilla bie në sy se në rumanishten nuk janë ruajtur fjalët e parme.

Rosetti dhe disa dijetarë të mëvonë rumunë mendojnë se korresponduesit e ndryshëm tingullorë të fjalëve të caktuara të shqipes në rumanishten dëshmojnë faktin se këto fjalë nuk mund të jenë huazime nga shqipja, po nga një burim i vjetër i përbashkët. Prandaj del nevoja e rindërtimit të shqipes së përbashkët, me të cilën duan krahasuar format rumune. P.sh. kemi shqip *bredh*, rum. *brad*, shqip *bardh*, rum. *barzâ*, shq. *modhullë* – rum. *mazâre*, shq. *vjedull* (*vjedhull*) – rum. *viezure*, shq. *gjysëm*, *gjymës* – rum. *jumâtate*, por shqip. *gjysh* rum. *ghiuj*, etj. Në të njëjtën pozitë të njëjtit tingull i përgjigjet herë një tingull herë një tjetër (*bredh* më herët në shqipen do të ketë qenë **bradh*; *gjymës* krahasohet mirë me *jumâtate*, ndërsa fakti se rum *ghiuj* ka kuptim pezhorativ, e vendos atë në huazime margjinale më vonë; forma *vjedhull(ë)* në shqipen duket dialektore e arealit ku shpesh *d* bëhet *dh* nën ndikimin e greqishtes, sepse gegnishtja ka vetëm *vjetull*, *vjedull*). Kjo bashkë me elementet fjalëformuese, na duket, dhe me trajtat gramatikore tregon se kemi të bëjmë me huazime nga shqipja, por në kohë të ndryshme.

Duket se Weigand-i megjithatë kishte të drejtë kur fjalët e shënuara në Transilvani si këto: *dandar* ('i huaj' nga *dhëndër*), *îmă* (ëmë), etj. i shihte huazime mesjetare nga shqiptarët e shpërngulur andej. Në favor të tezës për huazime nga shqipja flet edhe fakti se një numër fjalësh me etimologji fare të qarta në shqipen, madje me reflekse të qarta të rrugëve të zhvillimit fonetik të saj, dalin në rumanishten pikërisht me rrjedhë tingullore shumë të afërt, e të tilla janë fjalët: *buzë* – *buză*, *mâz*, *mës* – *minz*, *bredh* (nga **bradh* – *brad*, *dash* – *daş*), etj. Te *qafë* – *ceafă* në rumanishten kemi të bëjmë me një formë fonetike gege, çka po ashtu indikon një kohë të vonë huazimi.

Ndër fjalët e përbashkëta bie në sy një element fjalëformues. Fjala është për sufiksin *-ull(ë)* – rumanisht *-ure* pas rotacizimit *L:r*: *avull* – *abure*, *brushtullë* – *brusture*, *magullë* – *măgurâ*, *modhullë* – *mazăre*, *mugull* – *mugur*, *thumbull* – *sîmbure*, *vjedull(ë)* – *viezure*. Këto fjalë, për aq sa do të delnin të sakta etimologjitë, mund të jenë më të vjetra.

Disa nga këto fjalë të përbashkëta janë ballkanizma, e ndonjëherë edhe me burim të paqartë. Të tilla janë fjalët: *baltë* – *baltă*, *bajgë* (**balgë*) – *baligă*, *katund* – *cătun*, *kopil*, - *copil*, *murg*, etj. Ndërkaq fjalët si *bunget* nga (*bung+et*), *druete* (*dru*) *hames* (*ha-m-ës*), etj., ku shihet qartë se forma rumune paraqet ndonjë formë shqipe të re, nuk ka si të supozohen të kohës së latinishtes në Daki.

Më në fund është një numër fjalësh të përbashkëta të cilat janë huazime të rumanishtes në gjuhën shqipe: *mistrec*, *magull*, etj. Sigurisht se nga rumanishtja në shqipen do të ketë edhe fjalë të tjera, por si të latinizuara ose latine ato vështirë identifikohen.

Leksiku i përbashkët i shqipes dhe i rumanishtes nuk do parë në bllok: as vetëm si huazim nga njëra gjuhë në tjetrën, as vetëm si trashëgimi nga shtresat para romanizimit. Nuk duket i pranueshëm mendimi pas të cilit të gjitha këto fjalë janë të “*substratit trako-dak*”, për shkak se disa prej tyre thjesht as nuk mund të jenë aq të vjetra. Nga ana tjetër, në rumanishten ekziston edhe një numër fjalësh etimologjia e të cilave nuk dihet fare, e të cilat nuk ekzistojnë në shqipen e as që manifestojnë fare afri me fjalët e kësaj gjuhe. Trajtimi i këtyre dy grupeve të fjalëve si të të njëjtit substrat do të nxirrte në shesh pak më shumë afri sistemore midis dy gjuhëve për shkak se kështu së bashku bëjnë një numër jo të vogël fjalësh. Dy grupe kështu të mëdha të ndryshme fjalësh nga i njëjti substrat nuk mund të shpjegohen.

Numri i fjalëve të përbashkëta të shqipes e të rumanishtes megjithatë nuk është gjithaq i madh, për shkak se disa prej tyre mund të shpjegohen me lidhje të tjera: latine, sllave, turke. Një numër i madh prej tyre janë huazime nga shqipja diku në kohën e ardhjes së sllavëve, ndërsa një numër tjetër më i vogël mund të jenë shumë më të

vjetra, si p.sh. *mal, buzë*, e ndonjë tjetër. Fjalët e tilla në fakt nuk dimë cilës gjuhë i takonin në Antikë, madje nuk dimë nëse mund t'u takonin gjuhëve të ndryshme, por të afërta.

Numri i më pak se 50 fjalëve të përbashkëta të shqipes dhe të rumanishtes në tërësi mund të trajtohet si element i kontakteve më të ndryshme në Ballkan dhe, shpesh, adstrat ose substrat.

Shqipja dhe rumanishtja kanë midis tyre edhe një varg elementesh të përbashkëta në fushë të strukturës gjuhësore në rrafshet e ndryshme: në fonetikë, në morfologji, në sintaksë, etj. sadoqë në raste të ndryshme kemi të bëjmë me çështje të ndryshme, një varg dijetarësh, sidomos ata që përkrahin teorinë e substratit, nuk kanë qenë akceptivë ndaj kësaj ndryshueshmie, kështuqë çdo element të përbashkët e kanë shpjeguar me origjinë të përbashkët.

Në sistemin e zanoreve shqipja ka të përbashkët me rumanishten faktin se ka sistem me tri shkallë të ngritjes dhe tri radhë. Në kuadër të zanoreve të radhës së mesme këto dy gjuhë kanë të përbashkët vetëm faktin e radhës: shqipja ka *ë* të radhës së përzier, të ngritjes së mesme, ndërsa rumanishtja ka *ă* dhe *â* që kundërvihen ndër ve-te përnga shkalla e ngritjes. Ky fakt u ka mjaftuar dijetarëve si Miklosich, Schuchardt, Hasdeu, Philippide, Papahagiu, Rosetti, Brâncuș, Georgiev e Poghiric të nxjerrin përfundimin se këtë zanore këto gjuhë e kanë krijuar nën ndikimin e substratit.

Gjuha shqipe ka vetëm një zanore të radhës së përzier – <ë>, me status të ndryshëm fonologjik dhe me burime të ndryshme. Në gjendjen e sotme toskërishtja ka zanore (fonemë) *ë* në pozitë të theksuar dhe në pozitë të patheksuar, ndërsa gegërishtja, nëse nuk merret parasysh një shtresë leksikore e huazuar vonë dhe ndonjë e folme e veçantë, ka vetëm zanore *ë* të patheksuar. Në gegërishten *ë*-ja ka status të ndryshëm fonologjik: diku lidhet me gjatësinë e rrokjes parashkuese, dhe mund të interpretohet si tingull latent në relacion të drejtpërdrejtë me gjatësinë, në një anë, ndërsa si variant i sonanteve rrokjeformuese në rastet e tjera; në disa të folme në gjendjen e

sotme ajo është thjesht variant i e-së së patheksuar. Historikisht ë-ja e theksuar e toskërishtes është krijuar me denazalizimin e zanoreve hundore: *âsht/ është, bâ(në)/ bërë* dhe është e lidhur kronologjikisht me rotacizmin, pra është e kohës para kontakteve me sllavishten, më mirë të themi e kontakteve të para me të, pra e Mesjetës së hershme dhe jo e kohës së “substratit”. Kjo është mbase edhe koha e fonologjizimit të ë-së në toskërishten. ë-ja e patheksuar në shqipen duhet të jetë pak më e vjetër dhe lidhet drejtpërsëdrejti me fiksimin e theksit, me kapërcimin nga theksi muzikor në theksin dinamik, gjë që bëri që rrokjet e patheksuara të mos shqiptoheshin me qartësi maksimale. Kjo ë doli në radhë të parë në rrokje të patheksuar fundore nga zanorja *a*, po edhe nga zanore të tjera në pozitë të patheksuar paratheksore në mënyrë më pak të rregullt.

Rumanishtja ka dy zanore të kësaj radhe: <î> të ngritjes së lartë, dhe *â* të ngritjes së mesme. Proceset e formimit të këtyre dy zanoreve të rumanishtes janë të shpjgueshme përmes sistemit të latinishtes vulgare përmes procesit të zhdukjes së gjatësisë dhe të shkallës së hapjes, dhe përmes varianteve të veçanta para hundoreve. Ky proces nuk mund të veçohet nga procesi i përgjithshëm i krijimit të sistemit shtatëzanorësh pa gjatësi dhe pa dallime të shkallës së hapjes midis zanoreve të së njëjtës shkallë të ngritjes. Prandaj këto zanore nuk kanë lidhje gjenetike me ato të shqipes, e ndryshojnë edhe funksionalisht. Është e qartë se ë-ja e bullgarishtes ka dallim nga të dyja.

Shumë autorë të ndryshëm, përmendin ekzistencën e bashkëtingëllores *h* në të dy gjuhët. Në shqipen kjo bashkëtingëllore farin-gale është shumë e vjetër dhe del nga grupi *sk* ose nga *s*-ja në pozita të caktuara. Në rumanishten ajo del kryesisht në fjalë me origjinë sllave (*har, hranâ*, etj.), po edhe në fjalët e pakta, *hames, lehaj hututui*, që janë afruar me fjalët shqipe *hamës, leh, hutoj*. Del edhe në disa fjalë të tjera, origjina e të cilave është e dyshimtë. Kjo gjendje nga disa dijetarë u interpretua si e trashëguar nga substrati i përbashkët me shqipen, edhe pse mund të shihet qartë se *hames*, po të lidhet me *hamës* është e vonë dhe patjetër huazim nga shqipja, ndërsa

afrimi i *hututui* me *hutoj* është më i largët. Duket megjithatë se *h*-ja e shqipes nuk ka farë lidhje me *h*-në e rumanishtes, sidomos po të mbahet parasysh fakti se *h*-ja e rumanishtes del më së shumti në fjalë me origjinë sllave, pra është mjaft e vonë në këtë gjuhë. Këtë e thotë edhe fakti se në rumanishten *h*-ja është “pa përdorim në morfologji”.

Në toskërishten në pozitë midis dy zanoreve ndodhi ndryshimi i mëtutjeshëm i dy *n*-ve (*n* dhe *nn*), me ç’rast *n*-ja e thjeshtë (e dobët) kaloi në *r*, u bë denanzalizimi, i cili u bë edhe te zanoret, ndërsa *n*-ja e fortë me origjinë nga *nn*, ose *nt* kaloi në *n* të thjeshtë. Ky fenomen u quajt rotacizëm. Në gegërishten ndërkaq, kjo nuk ndodhi, për shkak se u forcua dhe u fonologjizua hundorësia e zanoreve. Strukturalisht këtu kemi të bëjmë me një presion paradigmatic në sistemin e shqipes: meqë nuk kishte gjatësi bashkëtingëlloresh, e meqë ishin krijuar fjalë të ndryshme qoftë përmes reduktimit të grupit *nt*, qoftë përmes huazimit nga latinishtja, dallimi funksional u ruajt me ndryshimin tingullor, me shtimin e dendurisë së dridhëses *r*. Pra kemi $nn > n$, $n > r$. Tipologjikisht ndryshime të ngjashme kanë ndodhur në të folme të ndryshme romane ku nuk është ruajtur *nn*-ja e gjatë, porse në shumicën e këtyre të folmeve kalon ose në qiellzore, ose në velare, ose zhduket krejt. Fenomeni është i përhapur. Kronologjikisht ndryshimi në shqipen i ka përfshirë të gjitha fjalët vendëse, huazimet greke, huazimet latine, pa i prekur huazimet më të vona sllave, mbase shumë pak, në mos aspak, as të hershmet. Pra në shqipen ky ndryshim ka përfunduar më së voni në shekujt VII-VIII.

Me substrat shpjegohet edhe një numër ndryshimesh jo të njëjta po të ngjashme të fjalëve latine në këto dy gjuhë. Vetë fakti se kemi të bëjmë me të njëjtin burim të fjalëve me dy zhvillime të ndryshme tregon se ato nuk u zhvilluan në të njëjtin truall.

Një kohë të gjatë mendohej se shkrirja e gjenitivit me dativin i detyrohej substratit, por më vonë u pa se një gjë e tillë ndodh edhe me armenishten, me greqishten e re, me iranishten e gjuhë të tjera. Kjo, natyrisht nuk shkon në favor të teorisë së substratit. Autorët e

Istoria limbii române II 1969 (f.324), hetuan se “*tendenca për t’i përzier këto rasë del qysh në latinishten popullore*”.

Më me interes në këtë mes duket çështja e nyjës së prapavendosur: shqip *njeriu-u, mal-i, vajzë–vajza, rum. omul, cal-ul, fată–fata*, etj. Bashkë me këtë shkon edhe çështja e vendosjes së mbiemrit prapa emrit dhe e krijimit të nyjave të mbiemrit. Pra, kemi të bëjmë me nyjën dhe raportin brenda grupit nominal dhe sintagmës nominale në tërësi, domethënë me tipin sintaksor. Interpretimi B. Bokshit më duket se përmban elemente të mjaftueshme për shpjegim. Për shqipen Bokshi e përcakton kohën e aglutinimit të nyjës së prapme rreth shekullit VIII. Kjo do të thotë në Mesjetën e hershme, jo në Antikë, kur shtyhet substrati.

Paralelizmat gramatikorë midis shqipes dhe rumanishtes, edhe ata, nuk janë të gjithë të një burimi dhe të një shkalle. Disa janë njëherësh paralelizma ballkanikë me origjinë mesjetare, disa të tjerë janë paralelizma të krijuar thjesht nga tendenca e dy gjuhëve drejt analitizmit, ashtu siç mund të gjenden paralelizma të tillë edhe midis shqipes e frëngjishtes apo anglishtes e ndonjë gjuhe tjetër, prandaj teoria e substratit mbahet e gjallë ose për shkak të mungesës së shpjegimit gjuhësor si kallauz i përgjithshëm që nuk shpjegon asgjë, ose si shprehje e paragjytimeve të ndryshme.²⁰⁰

²⁰⁰ Përfundimet e sjella këtu ishin shprehur dhe në artikullin e botuar te *Rilindja*, Prishtinë, e shtunë 15. I. 1983 dhe e shtunë 29. I. 1983, rimarrë te *Artikuj për gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1987.

Shtojcë I: Fjalë të përbashkëta të shqipes e të rumanishtes

G. Brâncuș: Vocabularul autohton alimbii române, București, 1983.

Abure avull
 Argea Rragäll e Madhe, ragäll
 Baçi baç, bac, baçicë
 Bajcã bashkë
 baltur bollë
 balegã bagël bajgë
 balta baltë
 barz(ã) bardh
 bîlc pellg
 bîr berr
 brad bredh
 brîu brez
 brusture brushtull
 buc byk
 bucura bukur
 bunget bung
 buza buzë
 căciulã kësulë
 călbeazã këlbazë
 căpujã këpushë
 cãtun katund
 ceafã qafë
 cioarã sorrë
 cioc çok
 ciucã çukë
 ciuf xhufkë
 ciump thumb
 cipi çupis
 ciut shut
 coacãzã kokëzë
 copac kopaç
 copil kopil
 curpen kulpër
 cursã kurthë
 droaie drojë, droe
 druete drutë
 fãrimã thërimë
 fluier floiere
 gard gardh
 gata gati
 ghimpe gjemb
 ghionoaie gjon
 ghiuj gjysh
 grapã grep
 gresie gërrësë
 groapã gropë
 gurmaz gurmaz
 gruno krunde
 gujã gushë
 hamej hamës
 jumãtate gjymësë
 letë letë
 leurda hudër

sipas A. du Nay, The Early History of Rumanian, Chicago, 1977

abes dial besë
 abure avull
 argea ragall
 as as
 baçi baç
 bãl, bãlaș balosh
 balã, balaur bollë
 balegã bagël, bajgë
 balta baltë
 barã bërrakë
 barzã bardhë
 bașcã bashkë
 bîlc bellg
 bîr berr
 boreasã bareshë
 brad bredh
 brîu brez
 brustur(e) brushtull
 buc byk
 bucura bukur, zbukuroj
 bunget bung
 burtã urdhë
 buza buzë
 căciulã kësulë
 căpușã këpushë
 cãtun katund
 ceafã qafë
 cioarã sorrë
 cioc çok
 ciuca çukë
 ciuf, ciof cufkë, xhufkë
 ciump thumb
 ciupi cupis
 ciut, șut shut
 coacãzã koqe
 codru kodër
 colibã kolibe
 copac kopac
 copil kopil
 curpen, curpãn kulpër, kërpnjë
 cursã kurthë
 daș dash
 droaie droje
 druete Oltenia dru
 drum dhrom, drum
 fãrimã thërrimë
 fluier flojere
 gãlbeazã gëlbazë, këlbazë
 gard gardh
 gata gati
 ghimp gjemb, glemb
 ghionoaie gjon
 ghiuj peior gjysh

Istoria limbii române, volumul II, București 1969, C. Poghiric

abeș besë
 abur(e) avull
 amurg murg
 argea ragal
 aș(i) 'ba nu' as
 baci baç, bac
 balaur, balã bollë
 balegã bajgë
 baltã baltë
 barã bërrakë
 bardzu bardh
 bascã bashkë
 bãl, bãlan, bãlaș balash
 bîlc pellk, pellgu
 bîr interj berr
 boreasã bareshë
 brad bredh
 brîu cingãtoare' brez
 brusture brushtull
 buc 'pleavã' byk
 bucura bukuronj
 bunget bung
 burduf burdhë
 buzã buzë
 căciulã kësuljë
 călbeazã, gãlbeazã këlbazë
 căpușã këpushë
 cãtun katund
 ceafã 'cerbice' qafë
 cioarã sorrë
 cioc 'ciocan' çok
 ciucã çukë
 ciuf cufkë xhufkë
 ciump, ciomp thump,
 ciupi çupis
 ciut, șut shut
 coacãzã koqë, koqëzë
 codru 'pãdure' kodër
 colibã kolubë (!) kolibë
 copac kopaç
 copil 'bastard' kopil
 cerpen, curpãn kulpër
 cursã kurthë
 daș dash
 droaie droe, droje
 druete 'lemn' dru
 fãrimã thërrimë
 fluier flojere
 gãlbeazã gëlbazë
 gard, gardinã gardh
 gata gat gatuj
 ghimpe gjëmp
 ghionoaie, ghion gjon

măgar	magar	gogă	gogë	ghiu	gjysh
magură	magulë	grapă	grep	gogă	gogë
mal	mal	gresie	gërresë	grapă	grep
mărar	mërajë	groapă	gropë	gresie	gërresë
mare	madh	grunz	krunde	groapă	gropë
mazăre	modhull	gurmaz	gurmas	grumaz	gurmas
mînz	mâz	guşă	gushë	grunz	grundë, krundë
moş	moshë	hamës	hamës	guşă	gushë
mugure	mugull	hututui	hutoj	hamës	hamës
murg	murg	late	lesh	hututui	hutoj
muşcoi	mushk	lehăi	leh	jumătat	gjymësë
năpîrca	nepërkë	letë	lehtë	lehăi	leh
noian	ujanë	leurdă	hudër	letë	leh(ë)të
pîrîu	përrua	măgar	magar	leurdă	hudhërë, hurdhë
pupăză	pupëzë	măgură	magulë	mal	mal
rata	rosë	mal	mal	mare	madh
rînză	rrëndës	mărar	mërajë	mazăre	modhullë
sărbad	tharbët	mazăre	modhullë	măgar	magar
scapară	shkrep	mînz	maz	măgură	magulë
scrum	shkrum	mire	mirë	mărar	maraj, mërajë
sîmbure	sumbull	moş	moshë	mire	mirë
şopîrla	zhapi	mugur(e)	mugull	mînz	mës, mëzi
spînz	shpendër	murg	murg	moş	moshë
ştira	shtjerra, shqerra	muşcoi	mushk	mugur	mugull
ştrepede	shtërpi	năpîrcă	nepërkë	muşcoi	mushk
strugure	shtrydh, shtrij?	noian	ujanë, ujë	năpîrcă	nepërkë
strunga	shtrungë	pîrîu	përrua	noian	ujanë
ţap	cap	pupăză	pupë	pîrîu	përrua
ţarc	thark	rata	rosë	pupăză	pupë, pupëzë
ţeapa	thep	rîndză	rranxa, rrandsa	rata	rosë
urdă	urdhë	sărbad	tharbët	rîndză	rrënd, rrâ
vatra	vatër, votër	scăpăra	shkrep	sărbad, sarbed	tharbët
viezure	vjedull, vjedhull	scrum	shkrum	scăpăra	shkrep
zară	dhallë	sîmbure	sumbull	scrum	shkrum
zgardă	shkardhë	sopîrlă	zhapi, jo shapi	sîmbur(e)	sumbull, thumbull
		spînz	shpendër	spînz, pînt	shpendër
		spîrc	spërk	spîrc 'spîn	spërk
		spuză	shpuzë	spuză	shpuzë
		ştiră	shtjerrë	strepede	shtrep
		ştrepede	shtrep	strungă	shtrungë
		strungă	shtrungë	şopîrlă	shapi
		ţap	cap	ştiră	shtjerrë
		ţarc	cark, thark	şut	shut
		ţeapa	thep	ţap	cap
		urdă	urdhë	ţarc	thark
		vatra	vatër/ votër	ţ(e)apă thep	gëthap
		viezure	vjedullë	urdă	urdhë
		zară	dhallë	vatra	vatër
		zgardă	shkardë	(v)iezure	vjedhullë
				zară	dhallë
				zgardă	shkardhë

Leksiku i shqyrtuar nga		Cârcel	kërcell	Gîdila, a	gudulis
Kaluzhskaja:		Ceafă	qafë	Gogă Olteni	gogë
Abeş	besë	Ceară	shalë	Gogă 'Şarik'	gogë
Abur	avull	Chelbe	qelb	Grapă	grep
Acum	akoma	Cheţ	kec	Gresie	gërresë
Aghiută	agoja	Chiţi, a	shqis	Griu	grurë
Ajumitul	gjumë	Cioară	sorrë	Groapă	gropë
Alak	lakër	Cioc	çok	Grumaz	gurmaz
Alior	rrjell	Ciopată	copë	Grunz, grundă	krunde
Andilandi	dallëndyshe	Ciucă	çukë	Guşă	gushë
Argea	ragal	Ciuf	çufkë	Hamës	hámës
Archită	ajkë, alkë	Ciump	thumb	Hărean	hirrë
Aşi	as	Ciung	cung	Hudiţă	udhë
Baçi	bac	Ciupi, a	çupis	Hurduca, a	hurdhë
Balaur	bollë, bullar	Ciurui, a	çurrel	Hutuuiu	hutoj
Balegă	bajgë	Cîrlig	kërluk	Îmă	ëmë
Balta	baltë	Cîrtăi, a	kërcas	Iţi, a	eci
Bară	bërrakë	Coacăză	koqe koqëz	Încăla, a	ngjall
Barzăşă	bashkë	cocobarză, dial	Kokëbardhë	Îngăima, a	gënjej
A băia		baj	kodër	Jumătate	gjymësë
Băl, bălan	bal, balosh	Copac	kopaç	Jupui, a	hup
Bărăta	bërtas	Copil	kopil	Lai	lajë, llahë
Bîrsă	bërthamë	Copleşi, a	kapllis	lehăi, a	leh
Berc, bearcă	berkth	Corcoduşă	kokërrduçe	Lete	lehtë, i, e
Beskid	bjeshkë	Corcoli, a	kurkulos	Leurdă	hudhër
Bituşă	bishtëzë	Crăciun	kërcu	Mal	mal
Bîlc	pellg	Creţ	krec	Mare	madh, i, e
Bîr	berr	Crişca, a	kris	Mazăre	modhullë
Bîrsă	verzë	Cruţa, a	kursej	Măgar	magar
Bleg	legë	Curma, a	kurm	Măgădău	madh, i, e
A bocăni	zbekth	Curpen, curpăn	kulpër,	măgură	gamule, magulë
Bordeiu	buroj	Cursă	kurthë	mărar	maraj, maraq
Boreasă	bareshë bajoreshë	Cuteza, a	kuxoj	mărat	mjerë, i
Borţ	mbarsë	Dalta	daltë	mărăcine	mërqinjë
Borză	bollë	Dandăr	dhandër	matura	netull
Brad	breth	Daş	dash	mendre	mëndyrë
Brişcă	brisk	Dărima, a	dërmoj	mic	mej
Brîncă	brengë	Dîrstă	dërstilë	mieriu	mëllenjë
Brînză	brenza	Droaie	droje	mire	mirë, i, e
Briu	brez	Druete	dru	mistreţ	mistrec
Brusture	brushtull	Drum	dhrom, drum	mînz	mëz
Buc	byk	Fara	farë	moş	moshë
Bua, abua	buj	Fărimă	thërime	mugur	mugull
Buçşi, a	mbush	Ferie	therkë	mură	mullë
Bucura, a	bukur, i, e	Fluier	flojere	murg	murg
Bulz	bulëz	Fluture	flutur	murză	mullëzë
Bumb	bumbrek	Fusta	fustë	muşcoi	mushk
Bunget	bung	Foşoi	fushë	năpîrcă	nepërkë
Burduf	burduhan	Gard	gardh	negură	mjegull, niegull
Buş	mbush	Gardină	gardhën	noian	ujanë
Butuc	butuk	Gata	gati	oacăra	vakër
Buza	buzë	Gaură	gavrë	(h)orghidan	herdhe
Carîmb	kërrabë	Găoace	guaskë	Pala	palë
Căciulă	kësulë	Găsi, a	gjej	Paltin	palnjë
Călbează	këlbazë	Ghimpe	gjemb	Păstaie	bishtajë
Căpuşă	këpushë	Ghioagă	qokë	Penchi	beng
Căpută	këpucë	Ghionoaie	gjon	petec, petica	petk
Cătun	katund	Ghiuj	gjysh	pic, a pica	pikë

pielm, piemn	pjalm, pjelm	zburda, a	shpurdh
pitpalac	porpollok	zdup	zhdëp
pînzâ	pëndëz	zgardâ	shkardhë
pîrû	përrua	zgäu	zgjyjë
pojgËitË	lëvozhgë	zgîrea, a	shqerr,
pupâzâ	pupëzë	zhgërryej	
pururea	përherë		
rata	rosë		
razâm	rëzë, rrëzë		
râbda, a	rreptë, i		
ricâi, a	rrekem		
rîmf	rrufe		
rînzâ	rrëndës		
sarbâd, sarbed	tharbët, i,e		
saricâ, sarcâ	shark, zhark		
scai	halë		
scâpâra, a	shkrep		
scorburâ	korbull		
scrum	shkrumb		
scula, a	shkul		
scurma,a	kurmoj		
sîmbure	thumbullë		
sîmcea	thimth		
speie	shpenje		
spînz	shpendër		
spîrc	spërk		
spuzâ	shpuzë		
stapin	shtëpâ		
sterp	shterp		
stina	shtazë		
stîng	shtang		
strepede	shtrep		
strugure	shtrud		
strungâ	shtrungë		
susai	shushalë		
şale	shalë		
şole	shollë		
şopîrlâ	zhapi, shapi		
şteazâ	shtezë		
ştirâ	shtëjrra, shqerra		
şut, ciut	shut, shyt		
tartacot	tartakut		
traistâ	trastë		
ţap	cap, cjap		
ţarc	thark		
ţeapâ	thep		
ţiclâu	qikëlë		
tira	cërre		
ţuranâ	curr		
ţurţure	xurxull		
urdâ	udhos		
uture ut,	hut		
vatra	vatër,		
vâtui	ftujë, vëtulë		
viezure	vjedhull		
viscol	vishkëlloj		
volburâ	vorbullë		
zarâ	dhallë		

Paralelet leksikore rumuno-shqiptare me ato paleobalkanike

Abur	- avull,	mesap Atabulus
Argea	- ragal,	maked. ἄργελλα gr. ἄργιλλα, trk. ἄργιλλο
balaur, bälaur	- bullar, srb. blavor,	paragr. Βέλλερος, trak. Βόλουρος
baltä	- baltë,	ilir. *balta – trak. Di-baltum, Δε-βελτός
bascä	- bashkë,	trak. βασσάρα, maked. βάσκοιοι, βασκευαί
bäl, bälän	- balash, balosh	- trak. βάλας – ilir. Βάλιος, βαλιός
brustur	- brushtull	- dak. riborasta
buzä	- buzë	- bg. buza – skr. buza – trak. Βύζας, Βυζάντιον – ilir. Beuzas, Beusas, Busio
codru	- kodër	- ilir. Codrione
druete	- dru	- dak. Δρουβητίς, Drubeta, Drobeta
mal	- mal	- dsk. Malva, Malvensis – ilir. Malontum
mazäre	- modhullë	- dak. μίζηλα
mînz	- mëz	- ilir. Menzanas, trak. mezENAI
strungä	- shtrungë	- trak. Στρόγγες

Qysh W. Meyer-Lübke e kishte theksuar karakterin më arkaik të latinizmave të shqipes në raport me të rumanishtes. Mund të pajtohem po ashtu me këtë vijë diskutimesh, të theksuar sidomos më vonë nga H. Mihăescu, se paralelizmat fonetikë midis latinizmave të shqipes dhe të rumanishtes janë më të vogla seç besohej. Është vërejtur po ashtu se në gjuhën shqipe elementet latine më shpesh vijnë nga format e thjeshta, ndërsa në rumanishten, po edhe në gjuhët romane, nga derivatet. Kjo është lidhur edhe me faktin se rumanishtja shpesh paraqet dhe aspekte më tepër rurale. Duke u nisur nga sistematizimet e H. Mihăescu-t le të japim këtu një pasqyrë të vogël krahasimesh të tilla:

lat. cēpa:	shq. qepë,	r. ceapă,	gjuhët romane nga *cepulla: it. cipolla;
lat. os:	shq. vesh;	lat. auriculla:	fr. oreille, r. ureche;
lat. par:	shq. par;	lat. pauricula:	rum. päreche;
lat. ramus:	shq. rrem;	lat. ramulus, ramuli:	rum. Ramuri
lat. rete:	shq. rjet;	lat. retella:	rum. rețea;
lat. spina:	shq. shpinë;	lat. spinalis:	rum. spinare
lat. truncus:	shq. trunq;		
lat. *trunculus:		rum. trunchi;	
lat. vetus, veteris:	shq. i vjetër;		
lat. veteranus:		rum. bătrîn	
Fjalë që konsiderohen më të hershme:			
colare:	kulloj,	rum strecura:	extracolare;
quietu:	i qetë,	rum. încet	
ruinare:	rrënoj,	rum. strica:	extricare;
sanare:	shëroj,	rum. sănătos, însănătoși	
fides:	fe,	rum. credință	
liber:	lirë,	rum. iertat	
veritate:	vërtetë,	rum adevăr, ad de verum;	
voluntatem:	vullnet,	rum. voință	
Shqip – terma paganë,		rum. terma popullorë të krishterë – bizantinë:	
këllanë:	calandae –	sll. colindă;	
javë:	hebdomas –	r. septimană	
perëndi:	imperante –	dumnezeu: domine Zeus;	
rshaje:	rosaliae –	r. sll. rusalii	
e shtunë:	saturni dies –	r. sîmbăta: Sabbat;	
kishë (klishë):	ecclesia –	r. biserică: basilica	

kërshëndella:	Christi natalia –r. crăciun;
shëndërtat:	sanctam trinitatem – r. sfinta troiță
bekoj:	benedicere – r. blagoslavi;
qelq:	calicem – r. potir
ipeshkv:	episcopus – r. vladică;
ungjill:	evangelium – r. evanghelie
ferr:	infernum – r. iad;
mallkoj:	maledicere – r. cleveti
meshë:	missa – r. slujbă;
mung:	monachus – r. călugăr
parriz (parajs):	paradisus – r. rai;
shëkroj:	sacrare – r. sfinti
shekull:	saeculum – r. veak;
shpërej:	sperare – r. nădăjdui, etj.

Në vijën e shembujve të sistemuar nga Mihăescu veçohen katër kategori që dalin më shpesh në shqipen e jo në rumanishte:

elemente me origjinë kulte

terma flore e faune mesdhetare në shqipen, jo në rumanishten

terma kishtarë katolikë

terma të tregtisë detare dhe të terminologjisë detare

shqip	latinizma	rum. huazim sllav	tjetër:
mik:	amicus		priten
mendull -	amygdala,		
anmik:	inimicus		dușman
ngjalë -	anguilla,		
i aftë:	aptus		potrivit
bush -	buxus		
këlqere:	calcaria		var
mlysh -	lucius		
kafshë:	causa		pricină
myll -	mūlus		
qind:	centum		sută
voshtër -	oleaster		
qimkë:	cimica		plașniță
voj -	oleum		
kullos:	colere		hrăni
ulli -	oliva		
këshill:	consilium		sfat
pjeshkë -	pessica		
dragua:	draconem		zmeu
shermend -	sarmentum		
fëjej:	fallere		greși
lirë:	liber		slobod

Rumanisht mungojnë edhe: kënatë, gunë, limë, lluqerë, kastile, por janë: këngë – cîntec – canticum, kaptinë – căpătină – capitina, mbret – împărat – imperator.

RRETH SLLAVIZMAVE TË SHQIPES

Kontaktet midis shqipes dhe gjuhëve sllave të jugut nuk kanë qenë të njëtrajtshme as në hapësirë as në kohë, i karakterizon dinamizmi dhe në këtë dinamizëm ato kanë qenë vazhdimisht të lidhura me zhvillimet brenda shqipes ashtu si brenda dialekteve dhe gjuhëve sllave të jugut, në aspektin kohor, ashtu si në aspektin hapësinor. Në periudha të gjata kohore shqipja dhe gjuhët sllave të jugut kanë bashkëjetuar në situata dhe raporte të ndryshme. Kjo ndërliqësi raportesh në kontaktet me intensitet të ndryshëm në kohë të ndryshme kërkon që rezultatet e këtyre kontakteve qoftë brenda shqipes, qoftë brenda sllavishteve, të shihen në mënyrë të diferencuar, jo vetëm si masë e tërë e sllavizmave të shqipes/ të albanizmave të gjuhëve sllave.

Historiku i studimit të këtyre raporteve është i gjatë.¹ Xh. Ylli, që ka merita për përmbledhjen dhe botimin e sllavizmave të shqipes në

¹ Raportet e shqipes me sllavishtet e jugut deri sot janë shqyrtuar nga shumë autorë. Ndër më të rëndësishmit mbahen, sa i përket ndikimit sllav në shqipen, F. Miklosich (1870), A. M. Seliščev (1931), N. Jokl (1935), më vonë H. Barić (1955), P. Skok (1925, 1934, 1948), S. Riza (1952), E. P. Hamp (1970), I. Popović (1960), A. Desnickaja (1963), E. Çabej (1976, 1976a), J. Gjinari (1972), dhe më vonë I. Duridanov (1977), G. Svane (1992), V. Stanišić (1995) dhe Xh. Ylli (2000), etj; ndërkaq, sa i përket ndikimit të shqipes në gjuhët sllave të jugut, veçohen sidomos I. Popović (1953, 1957), I. Ajeti (1963, 1965, 1966, 1967a) dhe tani vonë M. Blaku (1989), Q. Murati (1990), V. Stanišić (1995), A. Omari (1989), A. Omari (2012), etj. Shih Ylli (1997).

Në kohën kur po hartohet ky studim ne nuk i kishim në dispozicion studimet e A. Omarit: *Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe*, Botimet albanologjike, Tiranë 2012; të H. Shabanit: *Dygyhësia te shqiptarët në Malin e Zi*, dorëshkrim i paraqitur për disertacion të doktoratës në UP, Prishtinë 2014; të M. C. Curtis: *Slavic-Albanian Language Contact. Convergence, and Coexistence*, Dissertation, Graduate Program in Slavic Linguistics, The Ohio State University, 2012, dorëshkrim i pabotuar, prandaj idetë e shprehura atje nuk kanë mundur të jenë të pasqyruara në vijim.

leksik e toponimi të paraqitur dhe me harta të veçanta për territorin e Republikës së Shqipërisë, në Konferencën ballkanistike që u mbajt në Prishtinë më 2011 shtroi për diskutim nevojën për një vlerësim objektiv të huazimeve sllave në gjuhën shqipe, duke theksuar posaçërisht arsyet për dallimin sa i përket inventarit të sllavizmave në atë që ai e quante “inventar i përgjithshëm” dhe “inventar relativ” (Ylli 2012: 533-544). Duket me vend këmbëngulja që këto huazime të shihen në mënyrë të veçantë nëpër zonat përkatëse, ashtu siç duket e nevojshme të shihet dhe përdorimi real i këtyre elementeve leksikore në funksionimet e shqipes së sotme.

Kontekstet

Në një pjesë të studimeve ballkano-sllavistike është shprehur mendimi se sllavizmat e shqipes janë të ngjashëm ose të njëjtë me sllavizmat e rumanishtes. Mbi bazë të një supozimi të tillë madje G. Svane (1992) e ka bërë klasifikimin e këtyre huazimeve sipas fushave semantike ashtu si janë bërë për rumanishten. I. Popović (1960), historian i shquar i serbishtes e ballkanolog, mendonte se shumë shpjegime në historinë e serbokroatishtes dhe të dialektologjisë sllave të jugut i detyroheshin miksoglotisë. Dhe përzierja e sllavëve të jugut me popujt dhe gjuhët përreth, sipas tij, nuk ishte vetëm kulturore, po edhe biologjike. Në këtë përzierje biologjike edhe gjuhët fqinje pësuan zhvillime largvajtëse me huazime të shumta, po edhe me gjurmë të dukshme në zhvillimet strukturore. Ndikimin më të madh e ka pësuar rumanishtja, në shkallën që Popović e cilësonte si vijon:

“Sa i përket leksikut rumanishtja nuk është një gjuhë romane, po një gjuhë sllave”, (Popović 1960: 199).²

Struktura e gjuhës rumune është romane, por ka ndikime sllave në fonetikë e në sintaksë, dhe për diskutimet lidhur me palatalizimin,

² “In Bezug auf den Wortschatz ist das Rumänische keine romanische, sondern eine slawische Sprache”.

prejotizimin, fonemën /h/, etj. në rumanishten referonte Emil Petrovici, sipas të cilit rumanishtja qenka një “*gjuhë romane në gojë sllave*” (Popović 1960: 206-207).³ Meqenëse rumunët dikur do të kenë pasur një simbiozë të ngushtë me shqiptarët, sipas tij, pritet që ndikimi sllav në shqipen të jetë i ngjashëm me atë në rumanishten. Huazimet e supozuara si *daltë*, *daltă* nga **dlato* e padëshmuar, rum. *poruncă* shqip *porosis*⁴ me o prej maqedonishtes *o*, nga sllav. *poročiti* dhe huazimet zakonisht të njëjta sllave të rumanishtes e të shqipes, sipas tij, flasin në të mirë të këtyre hipotezave.

“Megjithatë, duhet të qartësohet se ndikimi sllav në shqipen në përgjithësi ka qenë më pak i fuqishëm se në rumanishten – gjë që teorisht nuk shpjegohet lehtë, meqenëse edhe shqiptarët jetonin brenda shteteve feudale serbe e bullgare. Në rastin e shqiptarëve mbase kemi të bëjmë me një përzierje thjesht biologjikisht më të dobët se në rastin e rumunëve. Derisa lidhur me rumanishten mund të flitet për një ndikim kaq të madh të sllavishtes, saqë gati-gati e ka rrënuar karakterin roman të rumanishtes (khs. §69), në rastin e shqipes nuk mund të flitet për një lloj të atillë sllavizimi: në shqipen kemi të bëjmë me një ndikim shumë të fuqishëm dhe kulturalisht të rëndësishëm të sllavishtes së jugut, megjithatë ky ndikim nuk shkonte përtej kornizave të një ndikimi ‘normal’ të huaj gjuhësor: për shqipen nuk mund të themi se është një gjuhë gjysmë e sllavizuar; karakteri i saj i lashtë trakas mbeti i paprekur nga ndikimi sllav” (Popović 1960: 210).⁵

³ “Romanische Sprache im slawischen Mund”.

⁴ Shqipja *porosis* do të jetë huazuar fillimisht si *porësi*, pra me ë për sll. *o*, siç na del edhe te Budi, dhe jo *porosis*. Te Budi del si emër *porësi*.

⁵ „Trotzdem muß festgestellt werden, daß der sl. Einfluß auf das Albanische im Allgemeinen weniger stark war als auf das Rumänische – eine Tatsache, die theoretisch nicht leicht erklärbar ist, da auch die Albaner innerhalb der serbischen und bulgarischen Feudalstaaten lebten. Vielleicht handelt es sich im Fall der Albaner um eine rein biologisch schwächere Mischung als im Fall der Rumänen. Wenn man in bezug auf das Rumänische von einem so großen sl. Einfluß sprechen kann, daß er beinahe den romanischen Charakter des Rumänischen zerstört hat (vgl. §69), so kann von einer solchen Art der Slavisierung im Falle des Albanischen nicht gesprochen werden: im Alb. handelt es sich zwar um einen sehr starken und kulturell bedeutenden Einfluß des Südsl., doch dieser Einfluß

Më tej, ai mendonte se në shqipen sllavizmat flasin për

“përzierje biologjike në albanizmin e sllavëve të Shqipërisë” (aty: 210),⁶

sidomos, sipas tij, për faktin se Shqipëria e sotme më parë paskësh qenë sllave dhe më vonë, pas pushtimit të fiseve shqiptare, qenka albanizuar përfundimisht dhe desllavizuar (cf. kap. II, §26; kap. III, §53; kap. IV §64 të librit të tij).

Ide të ngjashme ishin shfaqur qysh te Seliščev-i (1931). Tek ai e ka burimin dhe ideja tjetër, që thotë se sllavët erdhën e u vendosën në hapësirat ku kontaktuan me shqiptarët në lugina dhe rrafshe, ndërsa arbërit e vllëhtë ikën në male dhe vetëm atje, u specializuan për blegtori, ndërsa bujqësia mbeti për sllavët.

Për tezën e parë të Seliščev-it, të rimarrë nga Popović-i, për supozimin se sllavët paskan qenë para shqiptarëve në hapësirat ku jetojnë ata sot, nuk më duket e nevojshme të diskutojmë këtu, mjafton t’u drejtohem ideve të Jokl-it (Jokl 1935; Jokl 1984) e të tjerëve më vonë, sidomos Çabejtë (Çabej 1963, Çabej 1970, etj.).

Lidhur me tezën e dytë, që sllavët qenkan vendosur vetëm në lugina, ndërsa arbërit dhe vllëhtë vetëm në male, do thënë se megjithë shpeshhtësinë e dëshmimeve për ndarje etnike të veprimtarive të caaktuara shoqërore, një konceptim i tillë në aspektin social kërkon diskutime, sepse asnjë shoqëri nuk mund të jetë ashtu e njëtrajtshme, vetëm blegtorale, apo vetëm bujqësore. Një ide e tillë ishte bërë e vetja edhe nga gjuhëtarë të tjerë, dhe përsëritet në mënyrë ekstensive, siç mund të shihet qartë nga raportimi i V. Stanišić-it:

“Shqiptarizimi i shkallëshkallshëm i sllavëve brenda Shqipërisë paraqet paralele me asimilimin e sllavëve në Rumani. Në të dy rastet u imponua elementi malësor-baritor, që gjithnjë ka qenë më i fuqishëm se popull-

gelangte nicht über den Rahmen eines ‚normalen‘ fremden Spracheinfluss hinaus: für das Albanische kann man nicht sagen, dass es eine halbslavisierte Sprache sei; sein urthrakischer Charakter blieb vom sl. Einfluß unberührt”.

⁶ “Biologische Mischung auf die Albanisierung der Slaven Albanien’s”.

sia bujqësore... Para së gjithash, në njetë natyrë të lëvizshme baritore të arbërve qëndron arsyeja e migrimit të tyre përtej hapësirës së tyre amë-sore malore dhe e pushtimit të tyre të hapësirave joshqiptare përreth. Nga fundi i mesjetës, duke përfituar nga dobësia e Bizantit dhe pushtimet e Dušan-it, ata zbresin thellë në Greqi drejt Epirit, Tesalisë e Peleponezit. Në veri depërtojnë më ngadalë, por deri nga fundi i mesjetës arritën edhe aty në kufijt e rrafshinave të Zetës e të Kosovë-Metohisë (P. Ivić 1991; B. Gjuzelev 1991, 86). Aty do të vendosen në masë në periudhën turke, duke anashkaluar vetëm zonën po ashtu njësoj malësore malore të Kuçit-Vasojeviqëve” (Stanišić 1995: 38).⁷

Shqiptarët baritorë paskan qenë të vrazhdë, por të qëndrueshëm, e, duke qenë agresivë, qenkan imponuar. Natyrisht, referimi i hapësirave të Malit të Zi, apo i faktit se fillimisht serbët ishin vendosur kryesisht në Raška e Zeta (aspak jo-malore), se gjurmë sllave në Shqipërinë e sotme janë ruajtur në zonat malore (Golloborda, Gora), flasin ndryshe. Do të themi vetëm se hapësirat e Malit të Zi gjerësisht malor njihen si zona të asimilimeve të gjera të popullatës shqiptare, për arsye më parë të karakterit të raporteve sociale, të fesë etj. dhe jo për shkak të vetë natyrës së tyre, as më të butë as më të egër, në raport me fqinjët. Ndërkaq, mërgimet e arbërve drejt jugut shpjegohen me arsye të tjera: të trysnisë dhe të shkatërrimeve që vinin nga veriu, por edhe për shkak se hapësira në jug kishte mbetur e zbrazët.

Do të shënojmë me këtë rast refleksin e Mato Pižurica-s lidhur me statusin e kontakteve midis shqipes e sllavishteve të Malit të Zi të shprehura në diskutimin e tij të natyrës parimore. Sipas tij, në Malin e

7 “Postepena albanizacija Slovena unutar Albanije paralela je asimilaciji Slovena u Rumuniji. U oba slučaja se nametnuo gorštački stočarski element, koji je uvek bivao jači od ratarskog stanovništva... Pre svega u toj pokretljivoj stočarskoj prirodi Arbanasa sadržan je razlog njihove migracije izvan svog matičnog planinskog kraja i njihovog zaposedanja okolnih nealbanskih oblasti. Krajem srednjeg veka, koristeći slabost Vizantije i Dušanova osvajanja, oni se spuštaju duboko u Grčku ka Epiru, Tesaliji i Peleponezu. Na severu napreduju sporije, ali su do kraja srednjeg veka i tu dospeli na granice zetske i kosovsko-metohijske ravnice [P. Ivić 1991; B. Gjuzelev 1991, 86]. U njih će se masovno useliti u tursko doba, zaobilazeći jedino isto tako gorštačku kučko-vasojevičku planinsku oblast”, f. 38.

Zi ka pasur kontakte të sllavëve vetëm me shqipen dhe rumanishten. Prania e romanishtes ndeshet në tërë hapësirën e Malit të Zi, por ka karakter heterogjen: derisa në qytetet bregdetare ndeshen kultura urbane dhe dalmatishtja romane (jugore), në brendi ndesheshin elementet vllahe. Por në këtë vend ndeshen edhe elemente të tjera romane, elementi Venecian dhe italishtja letrare e dialekti toskan, por këto kanë karakter tjetër – karakter superstrati. Sipas tij, nuk ka të dhëna të besueshme nëse në mesjetën e hershme në Malin e Zi, pra në Zetë, ka pasur shqiptarë, sepse burimet bizantine i përmendin në sh. XI. Studiues si Barić e të tjerë kanë sjellë si argument për ardhjen e tyre në këto hapësira para sllavëve emrin e lumit *Buna*, sl. *Bojana* të supozuar të ardhur nga *Barbanna*, që shpjegohet vetëm me mjete të shqipes. Kufirin etnik dhe gjuhësor në sh. XIII-XIV ai e supozonte duke u nisur nga dokumentet e njohura si *Vranjinske povelje* dhe nga *Krisobulat e Deçanit*, apo nga analizat e defterëve osmanë të bëra nga M. Pešikan (*Onomatološki prilozii III*, SANU, Beograd 1982, ff. 1-118). Madje, sipas atyre analizave, edhe Mrković (Mrkojević, Mërkotajt) në prapavijën e Tivarit e Ulqinit kanë antroponimi sllave me elemente shqiptare, kurse

“Kraja (midis Čermnicës, Rumisë dhe Bunës) paraqet zonë të përzier, ndërsa karakter të tillë ka edhe treva rreth Cemit (nga Kelmendi në Shqipëri, përmes Kuçit, e deri te rrafshina e Zetës – Podluzhja historike)”, f. 84.⁸

Megjithatë, ai shënonte se te *Vranjinske povelje* përmendeshin arbanasët e Krajës dhe

“një numër emrash të njerëzve shqiptarë dhe/ apo të shqiptarizuar ose të sllavizuar (Đeno Voglić, Bardonja, Bakso, Bogza, Maršen, Daminko Salkut, Šotevići, Plačko, idr.)”, fusnota 3, f. 84.⁹

⁸ “... Krajina (između Crmnice, Rumije i Bojane) predstavlja miješanu zonu, a takav karakter ima i područje oko Cijevne (od Klimenata u Albaniji, preko Kuča, pa do Zetske ravnice – istorijskog Podlužja)”.

⁹ “...krajinski Arbanasi i jedan broj albanskih i/ili albanizovanih ili sloveniziranih ličnih imena (Đeno Voglić, Bardonja, Bakso, Bogza, Maršen, Daminko Salkut, Šote-

Më tej ai nxirrte përfundime edhe më largvajtëse tipologjike duke u mbështetur në vrojtimin:

“Pešikan-i në Malin e Zi të Vjetër në perëndim të liqenit dhe të Moraçës, çka vlen edhe për Piperët, Vasojeviqët dhe krahinën e Plavës-Gusisë, nuk gjen elemente shqipe në onomastikon”, f. 85, prandaj “ndikimi gjuhësor shqiptar ka karakter adstrati”.¹⁰

Në këtë vazhdë ai shtonte se asimilimi gjuhësor dhe etnik i vllëve ka qenë i shpejtë, i plotë dhe spontan,

“nuk ka askund shënime për detyrim gjuhësor; individualitetin etnografik-social e kanë ruajtur shumë më gjatë”.¹¹

Ndërkaq, sipas tij, bashkegzistenca gjuhësore me shqiptarët ka mundur të jetë vetëm pjesërisht analoge me atë me vllëhtë.

“Së pari, sepse është në aspektin hapësinor më e kufizuar, e dyta – ka karakter adstrati sepse realizohet kryesisht në hapësirat e kontakteve etnike dhe gjuhësore dhe e treta – asimilimi i ndërsjellë ka qenë i përmasave të kufizuara (herë në dobi të njëres, herë në dobi të tjetrës palë). Por bilingvizmi në zonat e kontaktit deri në ditët tona, krushqitë e ndërsjella, madje edhe rrëfimet për paraardhës të përbashkët për fise të veçanta shqiptare dhe malaziasë – flasin se gjerësinë dhe intensitetin e kontakteve shqiptaro-sllave, të rëndësishme edhe në rrafshin e gjuhës, nuk duhet as ta nënçmojmë”, f. 85.¹²

vići, Plačko, idr.)”. Meqë jemi këtu, në sllavistikë shpesh përmendet koncepti i albanizimit, çka mund të ketë ndodhur në mjedise të përziera. Por që të ndodhte albanizimi a nuk presupozon kjo që atje ku mund të ketë ndodhur ky proces popullata shumicë ose mbisunduese të ketë qenë shqiptare?

¹⁰ “Pešikan u Staroj Crnoj Gori i zapadno od jezera i Morače što važi i za Pipere, Vasojeviće i plavsko-gusinski kraj ne nalazi albanskih jezičkih elemenata u onomastikonu”. “Albanski jezički uticaj ima karakter adstrata”.

¹¹ “Etnička i jezička asimilacija Vlaha bila je brza, potpuna i spontana (nema nigdje zapisa o jezičkoj prinudi); etnografsko-socijalnu individualnost očuvali su znatno duže”.

¹² “Prvo, zato što je prostorno ograničenija, drugo – ima karakter adstrata jer se uglavnom ostvaruje u prostoru etničkih i jezičkih dodira i treće – uzajamna asimilacija je bila ograničenog domašaja (čast u korist jedne čast u korist druge strane). Medjutim bilingvizam u dodirnim zonama do naših dana, medjusobno orođava-

Këtu referonte rrëfimet për lidhjet e përbashkëta të hershme fisnore me Dukagjinët – pesë vëllezërit Ozro, Pipo, Vaso, Kraso e Hot, për Palin e Bardhë dhe Gashin si bij të L. Dukagjinit, për lidhjet e Kelmendësve me Ceklijanët, Hotët e Cemjanët e Piperët (referonte Erdeljanović, Šobajić). Më tej shprehte mendimin se ndikimi i turqishtes në malazezishten është i madh, por ka karakter superstrati. Sido që jetë, pranonte se njohjet gjuhësore janë ende të pamjaftueshme, sepse disa janë të vdekura – romanet, ndërsa shqipja është dokumentuar vonë. Sikur ta ndjente se diçka nuk shkonte në këtë rrëfim të natyrës së përgjithshme, në pjesën e dytë të studimit niste me diçka që nuk e përjashtonte statusin e substratit për shqipen:

“substrati roman e eventualisht edhe shqiptari, kanë mundur të ndikonin në mënyrë vendimtare në manifestimin e hershëm të diferencimit dialektor të të folmeve popullore malaziasë”, f. 87.¹³

Dhe në këtë proces, mendonte ai, është përfshirë më tepër pjesa juglindore e Zetës së vjetër, prandaj edhe M. Pešikan thoshte se

“ka marrë pjesë në procese fillestare të formimit të një lidhjeje specifike gjuhësore ballkanike”.¹⁴

Dhe në këtë kuadër ai niste regjistrin e tipareve dalluese strukturalisht të rëndësishme: bjerrja e reksionit të foljeve (mosdallim i rasës së qëllimit nga rasa e vendit, si: *idem u planinu, bio sam u planinu* (si në pjesët e tjera të kontaktit me shqipen); karakteri specifik i recessionit theksor malazias (*zèmlja, trâva*); fenomene marginale si dyfishimi i përemrave vetorë (*mene mi daj*); shënimi i madhësisë, përkatësisht masave: *pobolji, ponajbolji, primanji, pristari, poprinajcrnji, popristari, popribrži, omanji, okrupaşan, popričekati, popristanuti, po-*

nje, pa čak i predanje o zajedničkim precima za pojedina albanska i crnogorska plemena – govore da širinu i intenzitet albansko-slovenskih kontakata, značajnih i u domenu jezika, ne treba ni potcjenjivati”.

¹³ “Romanski substrat a eventualno i albanski, mogli [su] odlučujuće uticati na rano ispoljavanje dijalekatske diferencijacije crnogorskih narodnih govora”.

¹⁴ Këtu referonte M. Pešikan: *Jedan opšti pogled na crnogorske govore*, in *Zbornik za filologiju i lingvistiku XXII/1*, Novi Sad 1979, f. 166.

napuniti, poprituriti; mendonte se këtu kemi të bëjmë me mjete sllave për ‘*zgjerrimin e potencialit operacional*’ (konceptim i M. Ivić), por me nxitjen e analizimit sa i përket krahasimit nga substrati ballkanik.¹⁵ Në përmbledhjen e tij shumë të dobishme dhe shpesh sugjestive, M. Pižurica ndalonte posaçërisht te prozodia, ku

“*ndikimet e jashtme më parë kanë pasur karakter të impulsit të jashtëm sesa të ‘kopjimit’ të drejtpërdrejtë të sistemit*”, f. 88.

Këtu kishte parasysh të ashtuquajturin ‘*recesion theksor malazias’* (*rëbro, tráva, Pêro*) dhe pyeste nëse ky fenomen është rezultat impulsesh nga substrati roman, sidomos në hapësirat në kontakt me këtë gjuhë në skajet e të folmeve të tipit zetsko-sjenički, ku, si duket, fjala e ruan theksin roman, në shumicën e rasteve në rrokjen e dytë nga fundi, por që, sipas të tjerëve, ky është vetë tipi theksor zetsko-sjenički. Më duket se pikërisht këtu mund të shihen gjurmë që ndër lidhen me mundësinë e ndikimit të shqipes dhe vendin e saj të theksit. Dhe kjo më tej mund të ndërlidhet me fenomenin që theksonte Pižurica tek e folmja e mërkotajve të bjerrjes së gjatësive të pathek-suara dhe të zhdukjes së intonacionit midis theksave *kratkosilazni* e *kratkouzlazni*, që studiuesi i këtij dialekti L. Vujović e ka cilësuar si

“*shfaqje të fillimeve të formimit të një theksi, dhe pikërisht të ekspiratorit*”.

Më duket krejtësisht e drejtë vërejtja e M. Pižurica-s –

“*e ilustron mirë shkallshkallshmërinë e proceseve të frymëzuar nga struktura, në rastin konkret, e gjuhës shqipe*”, f. 88.

¹⁵ Ku do ta ketë pasur burimin analizimi ballkanik? Është e qartë se diçka të atillë shumë më tepër gjasë ka të gjejmë te substrati shqip sesa te ndonjë substrat vag roman. Në historinë e gjuhës shqipe është e njohur qysh nga Jokl-i e këndeje që kjo gjuhë diku në fillim të mijëvjeçarit, apo edhe në kapërcyell nga i vjetri, për pasojë të fiksimit të theksit në elementin temëformues kishte pësuar një proces të gjerë rrëgjimi të mbaresave dhe elementëve të tjerë bartës të sintezimit sidomos në fleksionin nominal. Kjo ka bërë që në këtë gjuhë të kemi lëvizje të hetueshme në drejtim të analizimit, përfshirë dhe ato që kanë ndodhur në tipin e krahasimit me *po-* në të folmet malaziase, po edhe në serbishten e jugut në përgjithësi, ashtu si në maqedonishten.

Kuptohet vetiu që në këtë lloj paraqitjeje nuk ka kriter për të gjykuar në këtë formë të prerë. Mjafton të shikosh onomastikonin me burim shqip që ndeshet ngado në Malin e Zi e deri në Hercegovinë (Zotovići, Burmaz(ovići), Zogovići, etj.), apo përkthimet e tipit Bjelopavlići – Palabardhaj, etj., apo gjurmët e tjera të vëna në pah edhe nga studiues malazias, për të nxjerrë pikërisht përfundimin e kundërt, se elementet shqipe në të folmet sllave të Malit të Zi kanë pikërisht karakter substrati.

Në vijim Pižurica numëronte elementet që mund të shihen si ndikime nga shqipja, çka mund të shihet, sidomos sa i përket leksikut edhe te Stanišić-i, që u përmend më sipër.

Në interpretimet e tij, ndryshe nga Miklošič-i (1870), i cili jo rrallë e kishte theksuar karakterin serb të huazimeve sllave të shqipes, Seliščev-i në veprën e tij për sllavët në Shqipëri ngulte këmbë më shumë te karakteri bullgar i tyre, gjë që ishte diskutuar edhe nga Jokl-i e më vonë nga I. Popović-i. Jokl-i kishte diskutuar argumente të ndryshme të natyrës gjuhësore në favor të kronologjizimit dhe të vendosjes së huazimeve sllave në zhvillimet e shqipes (Jokl 1935). Di-sa prej atyre ideve vazhdojnë të jenë objekt diskutimesh në albanistikë. Duke u nisur nga numri i huazimeve dhe nga përshtatja e tyre, ai kishte avancuar përfundimin se sllavët, kur erdhën në Ballkan në viset shqiptare, aty gjetën vetëm romanë, se shqiptarët aty erdhën më vonë. Kjo ide vinte si paralele dhe plotësuese me interpretimet në vijën e G. Weigand-it, të zhvillimeve të emrave të vendit për mungesën e toponimeve me vijimësi shqipe brenda hapësirës shqiptare, e pra për supozimin e ardhjes së shqiptarëve në këto hapësira më vonë. Këtu mund të themi vetëm se, nëse sllavizmat e shqipes merren në shqyrtim në relacione të këtilla, kjo do të fliste vetëm për vendosjen e saj aty ku është që prej kohësh dhe assesi gjetiu. Idetë dhe teoritë e tilla janë diskutuar gjerësisht. Mjafton të theksojmë se historiku i hyrjes dhe i përshtatjes së sllavizmave në gjuhën shqipe ishte vënë në kontekst të interpretimit të vendit ku flitej shqipja para ardhjes së

sllavëve në Ballkan, ndërsa e tërë kjo çështje po ndërlidhej me vendin e formimit të gjuhës rumune, e prandaj me nevojën për të treguar se shqipja ishte patjetër pasardhëse e trakishtes apo e një gjuhe tjetër, më në lindje se vendi ku flitet shqipja e sotme, çka implicite do ta bënte më të lehtë shpjegimin e ekzistencës së elementeve të përbashkëta midis shqipes e rumanishtes, pra edhe të ngjashmërisë së sllavizmave.

Sa i përket numrit, inventarit, po edhe gjuhëve prej të cilave burojnë sllavizmat, ka dallime midis shqipes e rumanishtes. Në rumanishten leksiku i huazuar sllav përbën një shtresë shumë të rëndësishme të leksikut të përgjithshëm. Fjalë të zakonshme si *drag*, *iubi*, *prieten*, *neprieten*, *maică*, *mašteħă*, *slujbă*, etj. nuk kanë hyrë në shqipen. Terminologjia e krishterë rumune është kryesisht bizantine-sllave, ndërsa në shqipen latine - e përbashkëta, bizantine-greke - e mëvona ortodokse. Mbi të gjitha, në rumanishten janë vënë re ndikime të rëndësishme fonetike sllave, si palatalizimi e elemente që çojnë më në lindje. Në shqipen ndikime të tilla nuk janë vënë re, madje ato e ubikojnë atë vetëm në perëndim.

V. Polák ka pohuar, e të tjerë e kanë përsëritur, se në shqipen ka ndikim në sistemin tonal të gegnishtes në fushën e kuantitetit të zanoreve nga sistemi politonik i serbokroatishtes (Polák 1957, 1960: 665).

“Nocionet kuantitative - si duket – nuk luajnë rol vendimtar, kuantiteti është fenomen dytësor, meqenëse kundërvëniet në fjalë kanë karakter tjetër nga rastet e shënuara. Në fakt, fjala është për kundërvënie kualitative dhe gegnishtja duket të bëjë pjesë në një domen të mbyllur polifonik, ku përfshihen po ashtu shumica e të folmeve serbokroate dhe sllovene... Këto përafrime sllavo-shqiptare nuk janë befasuese, meqë zhvillimi historik i dialekteve të shqipes ka qenë determinuar për një pjesë nga ndikimet sllave” (Polák 1960: 665; referon Polák 1957: 85 e vijim).¹⁶

¹⁶ “Les notions quantitatives ne jouent pas – semble-t-il – rôle décisif, la quantité est le phénomène secondaire, étant donné que les oppositions en question ont autre caractère pour les cas signalés. En effet, il s’agit d’oppositions qualitatives et le guègue semble faire part d’un domaine polytonique fermé, comprenant aussi la majorité des

Tashmë është gjerësisht e njohur se theksi i shqipes është eks-pirator, ndërsa në një fazë të caktuar të zhvillimit të saj në pozitë të theksuar zanoret mund të jenë funksionalisht të gjata dhe të shkurta, me neutralizim në të mesme në pozita të rrokjes së mbyllur. Zanoret e gjata në gegnishten paraqesin një kompleks – kuantitet, timbër intensitet, me ç’rast edhe vetëm njëri prej tipareve të përmendura mund të mjaftojë për ta shprehur kuantitetin. Sido që të jetë, tanimë nuk dyshohet që dallimet e kuantitetit në gegnishten kanë vlerë kundërvënëse. Gjatësia e zanoreve i ka karakterizuar të dy dialektet e shqipes, çka mund të shihet dhe tek autorët e vjetër: Buzuku e Matrënga zanoret e gjata i shënonin të dyfishuara. (cf. Ismajli 1972; Ismajli 1987: 200; Ismajli 1977).¹⁷ Zhvillimet e mëvona kanë njohur drejtime të ndryshme: në gegnishten gjatësia është shoqëuar dhe me dallime në timbër, ndërsa në toskërishten kanë ndodhur rrafshime të thjeshta, duke e ruajtur kështu vlerën e zanores ë të patheksuar me funksione të veçanta. Edhe në të folme toske deri vonë janë hetuar gjurmë të atyre gjatësive.

Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e dialekteve serbe me të cilat gegnishtja ka pasur kontakte deri sot, pra ekavishtja e tipit kosovsko-resavski e torllakishtja, sot nuk ka sistem të 4 theksave të serbokroatishtes, ajo dallon vetëm dy theksa, pra kryesisht mbi bazën e gjatësisë. Në këto rrethana mund të shtrohej vetëm e kundërta: ashtu si për sistemin rasor, për elementet e tjera ballkanike të serbishtes së jugut dhe përgjithësisht të *torlački dijalekat*, mund të kërkohej ndoshta ndikime aloglote.

parlers serbo-croates et slovènes... Ces rapprochements slavo-albanais ne sont pas surprenants, étant donné que le développement historique des dialectes albanais a été déterminé en partie par les influences slaves”.

¹⁷ Pohimi i Gjinarit: “... diferencimi në gjatësinë e zanoreve nuk është absolut e për pasojë as relevant, sepse zanore të gjata gjenden edhe sot dhe në të folme të labërishtes, të çamërishtes dhe të kolonive të arbëresheve të Italisë...” nuk qëndron në të gjitha pjesët. Dallimet në gjatësinë e zanoreve janë relevante (shih *dī* ‘veta II’: *dī* ‘veta I’, etj.). Tjetër gjë është mënyra e realizimit të kompleksit të kuantitetit nëpër dialekte dhe të folme të ndryshme.

Shpjegimi i I. Popović-it për ekzistencën e një numri larg më të vogël të sllavizmave në gjuhën shqipe në raport me rumanishten, në formën

“mbase kemi të bëjmë në rastin e shqiptarëve me një përzierje më të dobët biologjike sesa në rastin e rumunëve” (Popović 1960: 210),¹⁸

por që sllavizmat e shqipes, megjithatë, flitkan për

“përzierje biologjike në albanizmin e sllavëve të Shqipërisë”.¹⁹

duket i diskutueshëm. Ndikimet gjuhësore mund të ndodhin në rrethana të kontaktit midis bashkësive të të folurit, por me raporte hierarkie sociale, ekonomike e politike, ku nuk përjashtohen as ‘përzierjet biologjike’, si albanizmi i sllavëve, po as sllavizmi i shqiptarëve në hapësira të tjera. Sido-mos huazimet që shtrihen në tërë hapësirën e shqipes nuk mund të lidhen vetëm me shpjegime të atij lloji, po më parë me raportet e sundimit.

Rumanishtja është gjuhë romane dhe e përhapur në hapësira të gjera ndaj ka pasur mundësi të kishte pozitë tjetër në raportet bilinguale me sllavishtet në Ballkan. Feja e njëjtë dhe shërbimi në sllavishten kishtarë ka krijuar kontekste të favorshme për asimilime të tilla. Në pjesët ku mund të kishte shërbim fetar të njëjtë me sllavishten si gjuhë shërbimi, kanë ndodhur asimilime në sllavë, siç do të ketë ndodhur në Kosovë, e tash fare vonë në fshatrat e Mavrovës në Maqedoni.

Për shqipen rrethanat kanë qenë të tjera. Ka edhe më dallime: në rumanishten kemi ndikim kryesisht bullgar, vetëm më vonë serb. Në shqipen ky ndikim është i përndarë edhe sipas zonave dialektore: bullgar në jug e lindje, mundet dhe më gjerë në fillim serb në veri. Në rumanishten ka pasur ndikime sllave të tipit ukrainian, polak e rus, në shqipen jo. Në rumanishten ka ndikime sllave kulturore: shkrimet fetare një kohë ishin sllavisht. Në shqipen jo. Por hapësira shqiptare ka qenë nën sundimin bullgar në jug në sh. IX-X, ndërsa në veri në sh.

¹⁸ “Vielleicht handelt es sich in dem Fall der Albaner um eine biologisch Schwächere Mischung als im Fall der Rumänen“.

¹⁹ “Biologische Mischung auf die Albanisierung der Slaven Albaniens“.

XII-XIV. Të gjitha këto e krijojnë kuadrin.

Diskutimet për sllavizmat në rumanishten kanë një histori tjetër: ato kanë shkuar në drejtime të kundërta – nga O. Densușianu (1901/ 1975: 230-273) e më vonë është një rrymë që kundërshtonte animet e mëhershme për minimizimin e ndikimit sllav, duke theksuar se ato ndikime kanë nisur qysh në sh. V-VI e VII-VIII, duke shtuar madje se është pikërisht ndikimi sllav ai që përcaktoi rrugën e zhvillimit të mëvonë të rumanishtes në raport me gjuhët e tjera romane dhe i dha aspektin e saj të veçantë. I. Bărbulescu e të tjerë më vonë e kritikuan duke theksuar se në fakt ndikimet sllave në rumanishten janë shumë më të vona, madje pas sh. X e më vonë. Sllavistët rumunë, ndër ta A. Rosetti, E. Petrovici, G. Mihăilă, I. Pătruț, kanë shprehur mendime më të moderuara në këtë drejtim. Megjithatë, as ata nuk e kanë çuar kohën e këtyre ndikimeve përtej sh. IX. (shih për këto Dumitrescu et. Al. 1980).

*“E vetmja fjalë me prejardhje sllave e ruajtur në latinishten e vonë (sh. VI-VII), e trashëguar në rumanishten është emri i sllavëve jugorë të lindjes slověne > lat. sclavini, sclavi, rum. șchei, njëjës șchiau”.*²⁰

Nga të tjerat, disa më parë kanë prejardhje autoktone apo nuk kanë etimologji të sigurt sllave.

*“Përballë numrit të madh të fjalëve sllave të vjetra të ruajtura në gjuhën rumune me tipare fonetike të datueshme, në linja të përgjithshme, në shekujt IX–XI (pjesërisht dhe XII), këto janë tepër pak që të mund të jenë të ndara në një kategori të veçantë, më të vjetër”, Mihăilă, f. 23.*²¹

Aty ai referonte këtë mendim të V. Kiparsky-t:

“Lista e elementeve sllave të rumanishtes nuk përmban asnjë huazim do-

²⁰ “În concluzie, singurul cuvînt de origine slavă pătruns în latina tîrzie (atestat începînd cu sec. VI-VII), și moștenit de limba română este însuși numele slavilor sudici răsăriteni slověne > lat. sclavini, slavi, rom. șchei, sg. șchiau”, Mihăilă 1973: 22.

²¹ “Față de numărul mare al cuvîntelor vechi slave pătrunse în limbă română cu trăsături fonetice databile, în linii mare, în secolele al IX-lea - al XI-lea (parțial și al XII-lea), această sint prea puține pentru a putea fi separate într-o categorie aparte, mai veche”.

mosdo të mëhershëm se shekulli IX" (V. Kiparsky, në *Neuphilologische Mitteilungen*, XLV, Helsinki, 1944).²²

Në fund Mihăilă vinte me një përfundim si ky:

"Mbetet pra të konsiderojmë se shtresa më e vjetër e huazimeve sllave të jugut në gjuhën rumune paraqet tipare fonetike që i përkasin epokës së sllavishtes së vjetër (bullgarishtes së vjetër), respektivisht, për disa fjalë, fillimit të mediobullgarishtes, domethënë epokës në të cilën, për pasojë të bilinguizmit sllavo-roman, sllavët qenë asimiluar në territorin në veri të Danubit" (Mihăilă, aty: 23).²³

Argumentet themelore gjuhësore në raste të diskutimit për mundësinë e ndikimit të sllavishtes në latinishten popullore para formimit të rumanishtes mbështeten kryesisht në interpretimin e huazimeve si: *sută, ŝchei, gard, baltă, daltă*, pastaj në transformimin e *a* para *n* në *î* (romane *bătrîn, mînă; sllave jupîn, smîntînă, stăpîn, stîină, stîncă, stanъ, stopanъ, županъ*), ndryshe nga më të vonat, ku është ruajtur *a*: *hrană, rană*. Rumanistë e sllavistë rumunë si Mihăilă, Pătruț e sidomos tash vonë S. Paliga (2012) kanë vënë dyshime për këto zhvillime, i fundit edhe për vetë fjalën *sută*.

Për t'i sqaruar përmasat e huazimeve sllave në shqipen autorë të ndryshëm kishin krijuar një përfytyrim për situatën në të cilën do të kenë ndodhur ato huazime. Në vijën e Seliščev-it (1931), pastaj të Petar Skok-ut (1934, 1948), e më vonë të Ivan Popović-it (1960), në një formë tjetër të Vaclav Polák-ut (1963) e pjesërisht të Agnja Desnickaja-s (1976) më në fund, ishte kredituar ideja sipas së cilës në hapësirën ku është folur shqipja do të ketë jetuar një popullatë e rëndësishme sllave, e cila, për shkak të masës dhe fuqisë më të madhe të popullatës baritore-malësore (shqiptare) ishte asimiluar dhe kështu

²² "La liste des éléments slaves du roumain ne contient aucun emprunt nécessairement antérieur au IXe siècle".

²³ "Rămîne deci să considerăm că cel mai vechi strat de împrumuturi sud-slave în limbă română prezintă trăsături fonetice aparținînd epocii slave vechi (bulgare vechi), respectiv, pentru unele cuvînte, începutului celei medio-bulgare, adică epocii în care, în urmă bilinguismului slavo-român, slavii au fost asimilați pe teritoriul de la nordul Dunării".

në shqipen kishte sjellë një numër të madh sllavizmash. Nuk harrohej as fakti se në hapësirat shqiptare ka pasur sundim shtetëror sllav (kjo ishte theksuar posaçërisht nga Riza 1952 dhe nga Barić-i 1955), por kjo nuk u mjaftonte autorëve në fjalë për shpjegim. Në këtë pikë ka dallime midis autorëve të përmendur: derisa Polák-u (1963) mendonte se krejt diferencimi dialektor i shqipes në gegnishte/ toskërishte i detyrohej pikërisht ndikimit të adstratit sllav, për çka kishte marrë vërejtjet serioze kritike të dialektologut J. Gjinari (1968), pjesërisht dhe distancat e Desnickaja-s (1976: 187), e cila hidhte poshtë supozimin e tillë, sepse tipari themelor (sipas saj) dallues midis dy dialekteve – tipari i rotacizmit nuk i përfshinte huazimet sllave (aty: 186), por, nga ana e saj, supozonte, edhe me mbështetje të Seliščev-it e Skok-ut, se në hapësirat e toskërishtes veriore do të ketë pasur një popullatë më të gjerë sllave që ishte vendosur atje dhe që me kohë ishte asimiluar (para sh. XIV-XV), duke lënë pasojë në mënyrën e shqiptimit të zanoreve dhe të tingujve të shqipes në përgjithësi, çka, nga ana tjetër, krijoi dallime dialektore në raport me toskërishten tjetër labe, e cila, sipas saj, manifeston tipare arkaike e inovuese të përbashkëta me gegnishten e të ndryshme nga toskërishtja tjetër.

Sipas Desnickaja-s (Desnickaja 1976: 186-197), dallimet midis krye-dialekteve të shqipes sa vijnë e rriten në 2-3 shekujt e fundit. Me rëndësi ajo i shihte raportet konservim/ inovim në relacionin toskërishte/ gegnishte; toskërishten e shihte si të ndarë në toskërishte veriore dhe labërishte e çamërishte; labërishtja nuk ka kontakte me gegnishten, gjithashtu malsore; tipar karakteristik i trashëguar nga gjendja lashtoshqipe e labërishtes, sipas saj, del gjatësia e zanoreve të theksuara: *dēt, urīth, dȳ*, ndryshe nga toskërishtja veriore (Desnickaja 1976: 188). Veçori tjetër është tendenca e tërheqjes prapa të nyjetimit të zanores së theksuar të gjatë në geg. *ā* - tosk. *ǣ* - labializim në gegnishten. Në toskërishten kemi *ǣ: u bǣ* për gegnishten *u bā, u bo*. Kemi pra labializim e tërheqje prapa në gegnishten e labërishten (aty: 189). Tipar tjetër me rëndësi për të është raporti *dh/ll*, përkatësisht shkrirja, neutralizimi i tyre: në gegnishten – labërishten kemi: *ullë, mall, elle*, për *udhë, madh, edhe*, por *gjellë* në Veri; në Gjirokastrë

kemi: *holla, modha*, për *hodha e molla* (f. 189). Inovim në gegnishten pas saj paraqet asimilimi $mb > \bar{m} > m$; $nd > \bar{n} > n$, e kjo lidhur me velarizimin, ashtu siç kemi në Labëri: *m̄leth: mbleth, n̄ih: ndih; veñ: vend*.

Më tej ajo theksonte se kontaktet e shqiptarëve me sllavë vazhdojnë nga sh. VI-VII; Seliščev-i kishte skicuar rrugët e depërtimit: luginat e Shkumbinit, Devollit, Osumit drejt Adriatikut, lugina e Vjosës dhe Bisticës drejt Detit Jon, në jug, e përmes Malit të Zi te Shkodra, në veri (Desnickaja 1976: 191). Pas Desnickaja-s, Seliščev-i e kishte dëshmuar asimilimin e sllavëve atje; *Historia e Shqipërisë* e vitit 1959 sillte argumente sociale, kontakte fshatare, etj., mendonte ajo:

*“Në Shqipërinë e Jugut, ku masa bazë e sllavëve maqedonas në fillim ishte vendosur në lugina, gradualisht u përhap edhe në rajone malore”, f. 191.*²⁴

Në jetën shoqërore të shqiptarëve të jugut vijoi procesi i kalimit nga blegtoria malore te puna bujqësore në lugina. Mund të supozojmë se në Shqipërinë e Jugut popullata sllave dhe shqiptarët u përfshinë njësoj në procesin e sistemit fisnor, gradualisht të transformuar në lidhje territoriale. Kësaj i shtohen përzierjet, martesat. Si thotë *Historia e Shqipërisë*, *“simbioza shqiptaro-sllave vazhdoi me shekuj”* (Desnickaja 1976: 191).

Për rrjedhojë pati bilinguizëm. Depërtimi sllav arriti shkallën më të lartë në periudhën e sh. IX-XI, kur Shqipëria Qendrore dhe Jugore u përfshi në Mbretërinë Bullgare (aty: 192). Pas periudhës së bilinguizmit, që Seliščev e çonte deri në sh. XIV-XV, sllavët e zëvendësuan gjuhën e tyre me shqipen. Procesin qe gradual: rajoni i Oparit, ta zëmë, e ruajti gjuhën sllave deri në sh. XVI, thoshte Desnickaja. Kjo gjendje la gjurmë leksikore e fjalëformuese të tipit maqedono-sllav, në toponimi, oronimi, hidronimi, etj. Kjo dëshmon për rolin e sllavëve në etnogjenezën e popullatës së Shqipërisë së jugut. Sipas Seliščev-it më shumë toponime sllave ka në toskërishten juglindore (*Osum, Vjosë, Devoll, Shkumbin*), po edhe te Shko-

²⁴ “V Južnoj Albanii, gde osnovnaja massa makedonskih slavjan pervonačalno byla rasselena v dolinax, proishodilo postepennoe prodviženie poslednih takže v gornye rajony”.

dra (por për këtë zonën e fundit nuk fliste për asimilim). Sipas Desnickaja-s në Labëri s'ka ndikime sllave:

“Malësorët labë, si malësorët gegë, vijuan të jetonin në bashkësitë e tyre fisnore dhe nuk u përziën me sllavët në atë masë, siç ishte karakteristike për popullatën e Toskërisë veriore e juglindore”, f. 193.²⁵

Kjo gjendje e veçantë shihet edhe tek emri: *Labëri e Arbëri* (*arb-/ *alb-, lab nga alb me metatezën sllave); *Arbëri* si variant i *Labëri*: Vlorë-Sarandë-Tepelenë. Prandaj, sipas saj, *Labëri/ Albëri* shihej si zonë e Labëve, pra thjesht arbërve. Si fakte, pra, evidentonte: a) emri i vjetër shfaqet në zona malore; b) huazimet sllave aty janë më të pakta, sepse zonat fqinje ishin të përziëra; prandaj barinjtë e Kurveleshit e ruajtën organizimin e tyre fisnor, ishin Labë *“sobstvenno albancami”*, ndërsa vendi quhej *Labëri – Arbëri*. Labërishtja e gegnishtja kanë tipare të përbashkëta që nuk i ka toskërishtja tjetër, f. 194. Konservatizmi i dialekteve toske veriore del te bilinguizmi fillestar, pra te baza nyjëtimore e të folurit sllav, f. 196.

Në këtë gamë çështjesh që numëronte albanologia e njohur mund të ketë vend për diskutime nga më të ndryshmet. Do të merremi vetëm me disa për ne parimore. Pretendimi se labërishtja paska konservatizma, e madje edhe inovacione që e lidhkan atë në mënyrë specifike me gegnishten ndryshe nga toskërishtja tjetër, mbetet për t'u dëshmuar.

Kam frikë se fenomenet që përmend Desnickaja kërkojnë dhe kanë shpjegime të tjera brenda strukturës gjuhësore e për pasojë argumentet që sjell ajo nuk qëndrojnë ose nuk janë specifike.

Gjatësia e zanoreve ka qenë e përbashkët për tërë shqipen, siç shihet edhe te Matrënga²⁶ e në arbërishte të tjera me prejardhje jo vetëm labe, po gjithtoske. Procesi i zhdukjes së karakterit dallues të saj ka qenë i

25 “Ljaberijskie gorcy, podobno gorcam Gegerii, prodolžali žit’ svoimi rodovymi obščinami i ne smešivali’s’ so slavanami v toi mere, kak eto bylo harakterno dlja naselenija severnoj i jugo-vostočnoj Toskerii”.

26 Kështu Matrënga (1592): *Tæ miræ tæ chræxtée búra e gráa* /tə ‘mirə tə krəsh’tə ‘bura e grā/; *E bæen pær bijr tæ tij e pær vælúa* /e bæn pæn pær bīr tə tī e pær və ‘Lā/.

ndryshëm në të folme të ndryshme e kohë të ndryshme. Edhe sot mund të ndeshim procese të tilla në gegnishten, por me kompensim labializues për *ā*-në e gjatë, ta zëmë.

Njësoj ngjet dhe me supozimin se labërishtja, konkretisht e folmja e Gjirokastrës, e bën neutralizimin e dallimit *dh/ll* midis zanoresh si gegnishtja veriore, në literaturë e njohur më shumë për shkodranishten. Është e vërtetë se një neutralizim i tillë ndodh shpesh, por kjo ngjet për arsye të natyrës strukurore: *dh* e *ll* në shqipen i karakterizon tipari i përbashkët kontinuant, tipar jorelevant ose së paku me rendiment krejt të ulët dallues, ndërsa *ll* velare në pozitë ndërzanore anon më shumë drejt gjysmë-vokalizimit po ashtu kontinuant dhe nën ndikimin e gjuhëve të tjera që nuk e bëjnë këtë dallim (as kanë *dh*, as e kanë *ll*-në ashtu velare në atë kontekst), ka ndodhur neutralizimi sidomos në qytete: këtë e vërejmë në Pejë në qytet, madje në veri fare në Preshevë po ashtu në qytet, ku ndikimi i turqishtes ka bërë që shpesh të dëgjohet: *e malle* për *e madhe*, *elle*, por dhe *ere* për *edhe*, etj. Në të folme të tjera, madje në fqinjësi me këto qytete, ku ndikimi i gjuhëve të tjera mund të jetë më i vogël, kjo nuk ngjet. Pra nuk kemi të bëjmë me tipar specifik labo-gegë, po me diçka që shpjegohet me zhvillimet e përgjithshme të strukturës së shqipes në rrethana të caktuara kontaktesh.

Krejt ngjashëm shpjegohet neutralizimi i tiparit të buzorësisë të zanoret e përparme *y/i*, në toskërishten jugore, po edhe në gegnishten e mesme (Mirditë, Krujë, Dibër), ne do të shtonim edhe në veri të skajshëm (e folmja e Bujanovcit). Kemi të bëjmë me një dallim aspak rendimental ndër zanoret e përparme të shqipes: vetëm për disa fjalë me *y* mbahet dallimi i vetëm i buzorësisë në tërë sistemin e zanoreve të përparme, ndërkohë që tipari i buzorësisë i karakterizon zanoret e prapme të ngritjes jo të ulët.²⁷

²⁷ Në sistemin e zanoreve të shqipes, sipas gjatësisë kemi:

ī ŷ	ū	ī ŷ	ū
ě ə ǎ		ē (ə) ō	
ǎ		ā	

Fare ngjashëm shpjegohet ndryshimi *nj: j*, dhe të gjitha tiparet e tjera të supozuara si të veçanta labe në raport me ato që qenkan bërë të përziera për shkak të ndikimit. Kjo do të thotë se për zhvillime të tilla nuk është i domosdoshëm asimilimi etnik, në plot raste mjafton një kontakt i zakonshëm gjuhësor si nxitës për lëvizjet që në potencë i ka vetë sistemi.

Nuk ka dyshim se gjithandej në Ballkan ka pasur asimilime popullatash dhe prandaj edhe ndikime më intensive. Jo të gjitha ndikimet mund të shpjegohen njësoj. P.sh. ndryshe shtrohet çështja në Malin e Zi, ku ka pasur asimilime shqiptarësh në fise të ndryshme, ndryshe në hapësirat e *torlački dijalekat*, apo në Boboshticë e Opar, apo në Kosovë, ku gjatë mesjetës kisha ortodokse ishte vetëm slla-

Pra kemi zanore buzore ndër zanoret e radhës së përparme të ngritjes së lartë / \bar{y} , \check{y} / dhe ndër zanoret e radhës së prapme të ngritjes së lartë / \bar{u} , \check{u} / dhe zanore të ngritjes së mesme / \bar{o} , \check{o} /. Meqë tek zanoret e radhës së përparme buzore është vetëm zanorja / \bar{y} , \check{y} /, ndërsa te të prapmet të tilla janë / \bar{u} , \check{u} , \bar{o} , \check{o} / të ngritjes së lartë dhe të ngritjes së mesme, në shumë të folme, sidomos në jug, tipari i buzorësisë tek të përparmet nuk realizohet dhe kemi një sistem pa / \bar{y} , \check{y} /. Kjo vlen edhe për ato të folme që kanë zanore hundore. Kështu me kohë dallimi midis të gjatave dhe të shkurtave ndër zanoret e ngritjes së ulët, që në shumë të folme të veriut realizohej e shkurta si më e përparme / \check{a} /, ndërsa e gjata si më e prapme / \bar{a} /, me kohë kjo e fundit, sidomos hundorja, anonte drejt labializimit, prandaj shpesh shënohet edhe si [a^o]. Kështu, në jug, ku të gjatat dhe të shkurtat nuk dalloheshin përnga shkalla e hapjes, kemi specializim të tiparit të buzorësisë vetëm për zanoret e prapme, pra rrafshim të dallimit i/ y; kjo ka ndodhur dhe në një numër të folmesh gege. Me siguri se ka ndikuar fakti se ky tipar karakterizon vetëm një zanore të përparme të ngritjes së lartë përbri një tjetre të po kësaj ngritjeje, po ashtu të përparme por jobuzore, ndërsa zanoret e prapme të të dy ngritjeve janë vetëm buzore. Në të folme të veriut, ku ka zanore hundore, te të cilat zanorja e ngritjes së ulët realizohet më e prapme, shpesh e një ngritjeje lehtësisht më të lartë, automatikisht më pak a më shumë e buzorëzuar, kjo ka ndikuar që tipari i buzorësisë të përgjithësohej te të gjitha të prapmet. Meqenëse shumë shpesh në këto të folme nuk ka [\check{o}] hundore, zanorja hundore e prapme e gjatë e ngritjes së ulët [\check{a}] bëhet e buzorëzuar dhe e një ngritjeje më të lartë se përkatësja gojore jo e gjatë, ka tendencë që në këto të folme kjo zanore të kalojë në zanore të ngritjes së mesme dhe si e buzorëzuar të identifikohet me zanoren [o], prandaj edhe ta humbasë hundorësinë.

visht, ndërsa emrat e personave brenda familjeve me prejardhje të qartë shqipe apo sllave, flasin për shkallë të caktuar asimilimi. Por të gjitha këto duan parë veç e veç, pa pasur nevojë t'i referohemi një simbioze të supozuar sllavo-shqiptare që do të ngërthente asimilimin në masë të sllavëve në Shqipëri, në shkallën që të ketë qenë shkak-tare e diferencimeve dialektore brenda shqipes. Më shumë se kaq, mendoj se në hapësirat për të cilat po bëjmë fjalë e më në lindje kemi kontakte të gjata sllavo-vllaho-greko-shqipe, çka mund të ketë ndikuar në krijimin apo përhapjen e një numri ballkanizmesh, të cilat zënë hapësira të ndryshme brenda zhvillimeve të gjuhëve përkatëse.

Mendoj se për këtë çështje mund të kemi për një pjesë shpjegime me interes edhe përmes situatave të mëvona. E kemi krejtësisht të re situatën e ndikimeve eksese sllave në shqipen e veriut, konkretisht në Maqedoni në rastin e asimilimit gjuhësor të shqiptarëve ortodoksë të Rekës te Mavrova në gjysmën e dytë të sh. XX, apo të shqiptarëve katolikë në Shkup, ndërsa në Luginën e Preshevës kemi një situatë që ndryshon sërish nga e Kosovës sot: vendosja e sundimit sllav në këto hapësira pas vitit 1912 solli me vete zëvendësimin masiv të leksikut oriental të vendosur për pasojë të sundimit shekullor osman, sidomos në administratë e në jetën publike, ku shqipja ishte përjashtuar. Edhe kur mori një status që i lejonte përdorimin në hapësira të tilla, shqipja nuk ishte burimi i kreativitetit leksikor në ato hapësira, kështu që ata që nuk i kishin bërë të vetat njësitë përkatëse i drejtoheshin burimit zyrtar sllavisht. Kjo binte në sy sidomos në fushat e drejtimit, të ushtrisë, të policisë, të dokumentacionit, që në qendrat e vendosjes nuk lejohej shqip, etj. Kështu tash kemi situatë kontrasti: në Kosovë sllavizmat e shumtë në fusha të ndryshme tani po tërhiqen, ndërsa në hapësirat e tjera ende po vazhdojnë. Në asnjërën prej këtyre hapësirave nuk ka pasur në këtë kohë të vonë procese asimilimi etnik në masë në kuptimin e përmendur (për pasojë përzierjesh), po vetëm kontakt me staturë të ndryshme të dy gjuhëve: njëra gjuhë e shtetit, e sunduesit, tjetra gjuhë e sunduar. Kësaj i shtohet dhe fakti se folësit e të dy gjuhëve kanë vazhduar të jetonin në vendbanime të përziera pranë njëri

tjetrit, por pa procese simbioze, çka kishte theksuar edhe Hamp-i më herët. Krejt tjetër shfaqet situata e kontaktit shqiptaro-malazias te Mërko-tajt/ Mrkojević-ët te Tivari, ku kemi ndërthurjen e elementit të pushtetit të kombinuar me proceset e bashkëjetesës. Mendoj se të këtilla janë arsyet themelore të mjaftueshme për të shpjeguar këtë shkallë ndikimesh sllave në shqipen e këtyre hapësirave në këto kohë, por se duan bërë diferencime situatash.

Koha e huazimeve

Seliščev-i, Jokl-i kishin shtruar mendimet e tyre edhe për kohën e huazimeve sllave në shqipen. Seliščev-i mendonte se ishin gjithsesi të vjetra, madje, sipas tij e I. Popović-it, kur sllavët erdhën në hapësirat shqiptare nuk gjetën aty shqiptarë (arbënë), po vetëm romanë. Popović-i supozonte se arbërit do të kenë ardhur prej diku (askush s'e di prej ku) vetëm pas sh. XI, madje në sh. XIII, pa thënë se a patën ata kontakte me sllavët para kësaj kohe dhe ku.

Por si të shpjegohet që, po sipas këtyre autorëve, po edhe zakonisht, sllavët morën emrin *Arbënë* në variantin e tyre të metatetizuar *Rabъnъ*, që nuk mund të hynte pas sh. IX? Për më tepër, *Arbënë* dhe *Rabъnъ* i referoheshin shtetit/ vendit me ubikim të qartë atje ku dihet gjithmonë, pra nga Adriatiku e në lindje? Dhe më tej, si të shpjegohet emri *Lab*?

Le të sjellim këtu fillimisht shqyrtimin e Petar Skok-ut në *Povijest slavenstva u Epiru* për çështjen e dytë. Ai shtronte pyetjen: pse *Lap*, *Labi*, *lebër*, *Labër*, *Labeshë*, *Labëri*? Pas G. Meyer-it emri vjen nga *Albănus*, pas metatezës së likuideve sllave jugore, si te *mlad* < *moldu*, *kralj* < *Carolus*, *Labin* < *Albona*; *Albănus*: prej andej *arbër*, *arbëresh*, nga geg. kemi në sll. *Arbànas(in)*. Për G. Meyer-in nga *Albănus* kemi *Lap*, ff. 79. Sipas Skok-ut më tej *Lap*-ët janë myslimanë, pak të krishterë.

“E tërë krahina e Lebërve (Ljaba) është përplot me emërtime sllave për

vendbanimet, lumenjtë, kodrinat dhe viset, shenjë e qartë se sllavët këtu kanë përbërë popullatën e lashtë vendëse bujqësore, që u zhduk midis shqiptarëve".²⁸

Në një kohë të hershme, mendonte ai, këtu ka pasur simbiozë sllavo-shqiptare:

"e dimë që Car Dushani këndej kishte dërguar qefalitë dhe qesarët e tij dhe se nga kjo krahinë rrjedh edhe familja e heroit kombëtar shqiptar Skënderbeut, gjyshi i të cilit ka qenë qefali në Kaninë te Vlora".²⁹

Sllavët u zhdukën këtu midis shqiptarëve në sh. XVI e XVII. Në anën e djathtë të Vjosës, 4 orë nga Përmeti, kemi *Shqëri*, nga *shqa*, *shqe* < *sclavus*; *Shqeri* nga *Sclavinia*; sot në zonën e Shqerisë ka vetëm toskë të krishterë. Në Shqeri nuk ka vllah ballkanikë, por ka pak në fshatin Bodár, më shumë në Kosinë. Në Dangëlli banojnë toskë pjesërisht myslimanë, në Shqeri vetëm ortodoksë, f. 84.

"Në të dy krahinat kanë banuar dikur sllavët edhe këtu si gjetiu në Arbëni, dhe si popullsi e lashtë vendëse bujqësore. Përveç kësaj popullate fshatare kanë jetuar Arbanasët si popullsi nomade në male".³⁰

Këtu ai sillte supozimet për dallimet ekonomike midis serbëve e arbërve në Serbinë mesjetare, ku Serbi ishte bujk i ngulitur, në pronë ma-nastiri e katund pronjari, ndërsa Arbni, Vllahu e Bullgari në katune malore

²⁸ "Čitav kraj Ljaba prepun je slavenskih naziva za naselja, rijeke, uzvisine i krajeve, očiti znak da su Slaveni ovdje sačinjavali poljoprivredno starosijedelačko stanovništvo, koje je nestalo među Arbanasima", f. 80.

²⁹ "Znamo da je Car Dušan ovamo slao svoje čefalije i kesare i da iz ovoga kraja potječe i porodica narodnog heroja arbanaškoga Skanderbega, čiji je djed bio čefalija u Kanini kod Valone", f. 82. Më herët fliste për bujqër, kurse tani për qefalij, që nuk është njësoj. Ndërkaq për historinë e familjes Kastrioti ka studime dhe nga studiues të tjerë, Skok-u nuk paraqet ndonjë burim me rëndësi.

³⁰ "U oba kraja stanovali su nekada Slaveni i ovdje kao i drugdje u Arbaniji, i to kao poljoprivredno stalnosjedilačko stanovništvo. Pored ovoga seoskog stanovništva živjeli su Arbanasi kao nomadsko stanovništvo u planinama", f. 84. Është e qartë se nuk është fjala për grupe të njëjta popullatash: ato te Vlora, pra që paskan ardhur si qefalinj, domethënë pjesë e aparatit sundues, ndërsa këta të tjerët duket të jenë të lidhur me mbetjet e popullatës së zakonshme të kohës së sundimit të bullgarëve. Po të kenë qenë serbë qefalinjtë te Vlora, nuk duhej të kishin lidhje me bullgarët në anën tjetër. Kjo flet mjaftueshëm për asimilimet pansllaviste.

si barinj nomadë, që lëvizin me bagëtinë. Kanuni i Dušan-it e theksonte dallimin, sepse i ndalonte martesat midis tyre.

*“Me ardhjen e turqve në këtë krahinë raporti midis sllavëve dhe arbana-sëve ndryshoi në dëm të sllavëve. Arbanasët zbresin nga malet dhe bëhen banorë të përhershëm dhe si të gjithë malorët absorbojnë popullsinë e ngulitur, por e ruajnë terminologjinë gjeografike sllave, duke e përshtatur në një vëllim të parëndësishëm me shqiptimin e tyre”.*³¹

Por Skok-u sikur harronte se sllavizmat e hapësirave për të cilat flis-te ai janë të tipit bullgar/ maqedonas, jo serb, “harronte” se kjo mund të shpjegohet me fazën e tij të ideologjisë jugosllaviste, që as nuk e fshihte te libri *Dolazak Slovena na Mediteran* (1934).

Por cili është raporti *Lab – Arbër, Arbën*? Sipas Thallóczy-Jireček-Sufflay, *Acta et diplomata...*, 563, 569, *Albos* shfaqet më 1304. Tek *arbër, arbënë*, pas Skok, kemi sufiksin *-āno* të lat. *Albānus*, por jo te *Lap*, sepse *Lap* u krijua te popullsia sllave; sllavët fundjen *-ën, -ër* e panë si veçori të shumësit shqip të ruajtur tek *Lebër, Labër*; duke e hedhur atë krijuan emrin *Lap*, f. 84.

Duhet të themi se *Arbënë* është emër vendi, pra s’kemi mbaresë shumësi;³² me *Lap* mbulohet, ndoshta *Albos*. Por nëse *Lap* u bë nga *Alb-* e *Albānus*, kjo do të thotë se kemi huazim sllav në shqipen. Më tej Skok-u ritheksonte se sllavët e Epirit, që u zhdukën në sh. 16-17, fqinjët e tyre *arbanasë*, me të cilët jetonin në komunikim të përditshëm, i quanin *Ljab*, ndërsa këtë e morën prej tyre disa arbanasë të Epirit, f. 85.

Komenti lidhur me *Рабънъ* mund të jetë pak më i gjerë po ashtu. Forma gr. *Ἀρβανον*, që shënonte vendin, jo vetëm Krujë, siç thuhet te Loma e Stanišić, në sllavishten do të jepte **Ravon/ *Rabon*, ndërsa lat. *Arbānum* mund të jepte diçka tjetër nga *Рабънъ* (mbase **Rabanъ* ose **Rabonъ*), po ashtu. Shih *Albona/ Labin, Scardona/ Skradin*; pra, ka gjasë

³¹ “Dolaskom Turaka u ovaj kraj odnos izmedju Slavena i Arbanasa izmjenio se na štetu Slavena. Arbanasi silaze sa planina i postaju stalnosjedioci i kao svi gorštaci absorbiraju stalnosjedilačko stanovništvo, ali zadržavaju geografsku slavensku terminologiju, prilagodivši je u neznatnom opsegu svojem izgovoru”, f. 84.

³² Vetëm më vonë shfaqet emri me sufiks *-i* - *Arbanii* te Buzuku.

që sllavët ta kenë ndeshur emrin popullor të vendit të arbërve dhe jo formën latine apo greke, që ishte 'Arbënë, siç del deri vonë tek autorët e sh. XVII; te Buzuku vetëm një herë kemi nd'Arbaniit, që, për shkak të gjatësisë së zanores -ī, mund të thotë se theksi binte mbi të dhe se tashmë kishte nisur përdorimi i emërimit të ri me sufiksin e abstrakteve me -ī; 'Arbënë me zanoret qendrore, që në sh. VIII mund të ishin dhe më të përparme dhe të ngritjes së ulët, në atë rast do ta kishte ruajtur zanoren a të theksuar në rrokjen e metatetizuar, ndërsa ajo që cilësohet si zanore qendrore mund të ishte përshtatur në sll. si ъ. Skok-u, më parë Meyer-i, kishte shfaqur mendimin se etniku *Lab*, emri i krahinës *Labëri*, nuk janë gjë tjetër pos formës metatetike sllave të **Arb*, **Alb*, **Albëri*; këtë mendim e kanë adoptuar shumë studiues të mëvonë. Çabej vinte një dyshim. Së pari, nuk është dëshmuar ekzistenca e formës **Arb*-, **Alb*-, që të metatetizohej pastaj në **Rab*, **Lab*; në fakt, askund nuk del forma **Rab*, që do të pritej më parë, po të mbështetemi te *Rabънъ*; nuk është regjistruar as *Albëri* që do të jepte *Labëri*. Kjo formë është më e vonë, edhe për faktin se ka një sufiks -ī; supozimi i përmendur ka përballë kritikën, prandaj mund të jetë që etimologjia e *Lab*, *Labëri* do kërkuar gjetiu. A lidhet kjo disi me emërtimin e lumit *Lab*, *Llap* në veri apo ka pasur edhe diçka tjetër? Nuk duket serioz supozimi i Loma-s për burimin tek *Alba* nga veriu i Europës (*Elba*) që mund ta paskan sjellë me vete sllavët.

Kronologjitë e ndryshimeve fonetike³³

Për çështjen e kronologjisë së ndryshimeve fonetike të përfshira në huazimet sllave kanë diskutuar studiuesit qysh nga Seliščev-i, Jokl-i e deri te Barić-i, Popović-i, Loma, Svane-ja, Duridanov-i dhe së fundi me një pasqyrë të përmbledhur vinte dhe Ylli. Do të nisem këtu nga diskutimet e Duridanov-it.³⁴ Duke iu referuar Desnickaja-s, ai krijonte kuadrin e përgjithshëm për hulumtimin e kronologjisë së ndryshimeve fonetike, si kriterin kryesor për shtresëzimin e sllavizmave të shqipes, të cilat lidhen me

³³ Duridanov 1977: 688-696.

³⁴ Duridanov 1991: 3-19.

“... procesin afatgjatë të shqiptarizimit të popullsisë sllave në Shqipëri”.³⁵

Si sllavizma të vjetër të një kohe shumë të hershme – nga periudha e sllavishtes së lashtë, pra e sllavishtes së përbashkët para diferencimit në sllavishte të ndryshme të jugut, ai veçonte rastet me veçoritë që do të paraqiten në vijim.

Sllavishte e lashtë ã e shkurtë – shqipe a

Mendohet se sistemi fonematik i sllavishtes së lashtë deri në sh. VI-VIII kishte një ã të shkurtë, në kundërvënie me ā, ashtu siç del në huazimet sllave dhe emrat e vendeve. Në shqipen këtu Duridanov-i gjente fjalët: *kapicë* (sllavishtja e lashtë **kǎpicā*, bullg. *kopica* nga *kopá*, skr. *kōpa*, rus. *kopá*); karrutë (nga sllavishte e lashtë **kǎrytǎ*, serb-sll. kisht. *koryto*, bullg. *korito*, skr. *kōrito*, rus. *koryto*; gr. e re *καρούτα*, prej nga emrat *καρούτια*, *καρούτεζ*), në shqipen ka edhe *koritë*; *maçál* (nga sllavishte e lashtë **mǎčalb*, apo me -ǎ; në Greqi emrat: *μότσιαλι*, *μουτσάλα*; më vonë në shq. *moçál*), *magulë* (sll. e lashtë **mǎgylā*, serb. - sll. kisht. *mogyla*, bullg. *mogíla*, serb. *gòmila*, *mògila*; në gr. *μαγούλα*, emër vendi *μαγούλα*). E vjetër në rum *mǎgurǎ*). Në shq. edhe *mogilë* nga *gomilë*; *matukë*, sll. *motyka*, por nga më e vjetra **matyka* (bullg. e vj. *motyka*, bullg. *motíka*, serb *mòtika*); *patkua*, më e re *potkua* (nga sllav. *podъkova*, bullg. *podkóva*), f. 689;³⁶ *vanishtë* (sll. e lashtë **vǎnište*, sll. e lashtë **vǎn'ā*, bullg. e vj. *von'a*, bullg. *von'á*, skr. *vōnj*, *vōnja*), f. 690.

Por ai theksonte po ashtu se sllavishtja e lashtë ã e shkurtë në shqipen mund të japë edhe ë në huazimet sllave: *lëmishtë*, pas Jokl-it nga *lomište* (*lomiti*; më drejt nga **lǎmište*, nga sll. **lǎmъ*, *lomъ*; sot njohim bullg. *lomište*, em. lumi *Lomište*, *lomošta*). Në huazimet më të vona sllave në shqipen për sllavishten e lashtë ã del o: *boricë*, *borigë*; *kotél* – bullg. *kotél*, *zakon*, emra vendi *Vodica*, *Golik*, *Dobresh*, *Lomnica*, f. 690.

³⁵ “...was mit dem langdauernden Albanisierungsprozeß der slavischen Bevölkerung in Albanien zusammenhängt” referon Desnickaja, 20, f. 688.

³⁶ Por shtrohet pyetja: po të ishte kaq e vjetër, si të shpjegohet shurdhimi në këtë kontekst *дъk* në shqipen?

Këtu më duket se shpjegimet e cituara nuk janë të padyshimta lidhur me tiparin e cekur të sllavishtes së përbashkët. Tek ndryshimi *o: a* në rastet *maçal: moçal, patkue: potkue, kopicë: kopicë* kemi të bëjmë më parë me zhvillime brenda shqipes. Ndërsa në rastet *karrutë, magulë, matukë* të ndeshura në jug kemi të bëjmë me depërtime nga hapësira greke, pra mund të jetë nga popullata sllave që depërtoi andej në atë kohë, por jo me huazime të periudhës së sundimit bullgar në Shqipërinë e jugut.³⁷

Sllavishte e lashtë *y* – shqipe *u*

Është e njohur që në huazimet më të vjetra sllave në rum., gr., e shq., sllav. *y* ka dhënë *u*: *karrutë, magulë, matukë*; shtohen edhe *purrrë* nga *pyr-, Bushtrica – Pushterica, Bustricë* nga sllavishtja e lashtë **Bystrica*, mbiemër, në bullg. e vj. *bystrъ*. Huazimet e mëvona sllave në shq. shfaqin *i* për *y*: *koritë, vidër*, bullg. *vidra*, skr. *vǐdra* < sllavishte e lashtë **vydrā*, *Koritnik, Mogila, Bistrica*, (Duridnaov 977: 690-1).

Mendoj se këtu kemi të bëjmë me depërtimin e përmendur nga Greqia, pra nga skajet lindore të hapësirës ku flitej shqipja. Kështu *koritë* është e tërë hapësirës, ndërsa *vidër* nuk më duket e dëshmuar gjithandej.

Sllavishte e lashtë *ъ, ь* – shqipe *u, i*

Për sllav. *ъ* që në shqipen do të jepte *u*, sipas tij, kemi këto elemente: *dryhna, - drъv(a), druvar* nga *drъvarъ*, bullg. *drъvár*, skr. *drǔvar*, f. 691; *grusht*: slav. *grъstъ*, shënuar në bullg. e vj.;

Rasti *shullë* nga sll. *сълъ*, khs. sllov. *po-sel*, më duket me dyshime, për *l:ll* dhe mungesë në bullg. e serb.

Fjala *dryhna* nuk duket të jetë huazim. Ndrësa *druvar*, që del me shtrirje mjaft të lokalizuar, nuk duket më shumë se një ndikim krejt i vonë.

³⁷ H. W. Schaller tani vonë në *Reflexe sprachlicher Varietäten in den Balkansprachen* në A. N. Sobolev & A. Ju. Rusakov (Red.): *Aktualnye voprosy ballkanskogo jazykoznanija*, Sankt-Peterburg 2003, pp. 158-163, është marrë me disa prej çështjeve të shtruara te Duridanov, edhe pse nuk e ka konsultuar studimin e tij.

dryhna, druvar më duken të rastit, nëse jo krejt të dyshimta, ndërsa shembulli *grusht* mund të marrë dhe shpjegime të tjera. M. Camaj (1966: 35) mendimit të G. Meyer-it për *grusht* nga sll. e vj. kisht. *grъstъ* i shtonte vërejtjen se në atë rast do të prisnim të kishim **gërsht* apo **grësht*, si në rum. *gîrșt*. Kjo lidhet me huazimin nga sllav e lashtë të *r* silabike -*ъr* (*vërtít*: *vrъt-ěti*) ose -*rb* (*gërbë*: *grъrbъ*). Prandaj në shqipen në këtë rast duhej të kishim vetëm **gërsht*. Fjalën shqipe *grusht* ai e mbante për lashtësisht të afërt me baltosll. **gurti*, let. *gürste* 'Flachsknocke', sllav. e lashtë *grъrstъ*, sll. e vjetër kisht. *grъctъ*, ndërsa tek segmenti -*ru* i shqipes shihte refleksin e vjetër të IE *r*. Pra, s'do të kishim të bënim me huazim sllav.

Edhe sipas Duridanov-it, shembuj të sigurt për huazime nga ajo periudhë e hershme (para ndarjes së gjuhëve sllave) ka vetëm për grupin e parë të fjalëve, e që është: *baltë* nga sllavishtja e lashtë **baltǎ*, bullg. e vj. *blato*, bullg. *bláto*, skr. *blāto*, në rum. e gr. si në shqipen *baltǎ*, *βάλτα*, *βάλτος*, f. 691; *daltë* ru. *daltǎ* nga sllavishtja e lashtë **daltǎ*, bullg. *dlató*, *dleto*.

Nga serb. *dleto*, *dlijeto*, maq. *dleto*, nuk mund të shpjegohet forma *daltë*. Çabej e Hamp nuk e pranonin këtë si huazim, një formë e sll. së vj. **daltъ* nuk është dëshmuar gjëkund. *gardh*, rum. *gard*, nga sll. *gradъ*, sllavishte e lashtë **gardъ*; janë shënuar emra vendi në Greqi: *Γαρδίκι*, *Γαρδίτσα*; Jokl-i ka sjellë argumente që nuk flasin në favor të huazimit sllav, pra është e pasigurt. Huazimet e mëvona shfaqin metatezën: *vlak*, *prak*, *glava*, *krava*, f. 692. Pra, s'kemi gjurmë të sigurta as të gjera për huazime nga fazat para metatezës, që është fundi i sh. VIII - fillimi i sh. IX.

Sipas Holzer-it (2011) në sllav. e jugut kemi *dlijeto*: sllav. e lashtë **delta* > *delta* > **dlēta* > **dlēto*. Pra nuk ka askund **dal*. M. Snoj (2003) shpjegonte sa vijon: *dlēto*, -a, (sh. XVI), *dlētce*, kroat. *Dlijéto*, serb. *dlēto*. Sllav. e lashtë. **deltò*, **doltò* nga **del(b)tí* 'dolbsti', f. 114. Ndërsa për *bláto*, -a, (16. st.), *bláten*, *blâtnik*, *blátiti*, oblátiti, kroat., serb *blàto*, rus. *bolóto*, çek. *bláto*, sllav e lashtë **bólto* nga IE **bhōl-to-*, e afërt me shqipen *bal-të*. *grâd*, -a, *gradû* (16. st.), *grájski*, *graščák*, *graščína*, *gradník*, *gradišče*. Sll. e vj. *gradъ*, kr., serb. *grâd* 'mesto'. Sllav. e lashtë **gôrdъ* *'ograda'. Prej andej janë zhvilluar kuptimet 'që është e rrethuar, e rrethuar me mur; e

murosur'. IE *ghordho-, nga rrënja *gherdh- 'me rrethue, me mbërthye, me kufizue, me thurë gardh', lit. *gardās* 'rrethim për shpezë', alb. *gardh*, got. *gards* 'kasolle', nord. e vj. *garðr* 'rrethim, *gardh*, oborr', gjerm. e vj. e lartë *gart* 'rreth', frig. -*gordum* 'vend', tek emrat *Manegordum*, e afërt me gjerm. e vj. të lartë *Garten*, ind. e vj. *grhá-* 'kasolle, bujtinë', tok. B. *karcīye* 'pallat', het. *gurta-* 'kështjellë'. Shih *gradīti*, *vinograd*, *žrd*, f. 186. Pas tij, pra, duket qartë se kemi të bëjmë me paralele dhe jo mundësi huazimi.

Vladimir Orel-i (1998: 15-16), fjalën *gardh* e sillte nga protoshqipja **garda*, të lidhur me got. *gards*, lit. *gaĩdas*, sll. **gordъ*. Rum. *gard* e shihte huazim të hershëm nga shqipja e hershme.

André Martinet-ja lejonte mundësinë që fjala sllave për 'qytet' të jetë huazim nga gotishtja e vjetër: **gardas*, që mori formën **garadǔ*, para *gradǔ* të sllavishtes së vjetër e *gorodǔ* të rusishtes së vjetër (Martinet 1994: 78-79).

B. Demiraj (1997) jepte këtë vështrim: *balt/ë, -a; balt(ë)/ra, -na; bal-tak baltik baltanik, baltinë, baltovinë, baltos, përbalt; top. balta, baltëza, baltak*. Janë parë lidhje me lit. *báltas*, sll. e vj. kisht. *blato*, ose është kundruar si huazim i hershëm sllav, apo si izoglosë albano-balto-sllave 'weiß' (Pisani) apo si fjalë e substratit ilir, emër vendi ilir *Balta* (> lat. *baltea* 'Kotklümpfchen' Bruch), përbri rum. *baltă*, gr. e re *βάλτος*, e përhapur në sllavitë e jugut (Trombetti). Çabej ndalonte tek izoglosa albano-balto-sllave: **bhol-tā*; pas Solta-s, nuk është i pamundur ndikimi i drejtpërdrejtë nga sllav. para metatezës së likuideve, por i duket pak e besueshme. Të shihet brenda arealit gjuhësor ballkanik rum. *baltă*, bull. *blato*, skr. *blāto*.

"Në lidhje me këtë mundësia e një ndikimi sll. (jugor) si burim (i lashtë) i përbashkët nuk është për t'u përfshuar; gr. *βαλτέτσι* < sl. **bolъce*, (s. Bräuer, SS I 82, ff. 88)",³⁸ përfundonte ai.

Ndërkaq, V. Orel-i 1998: 15-16, *baltë*, nga protoshqipja **baltā*, e shihte të lidhur ngushtë me sllav. **bolto*, sipas Meyer-it nga IE **bholatom* lidhur me paradigmen e mbiemrit **bholato-* 'i bardhë', lit. *báltas*, rum. *bal-*

³⁸ "In diesem Zusammenhang ist die Möglichkeit eines (süd)sl. Einflusses als gemeinsame (Ur)quelle wohl nicht auszuschließen; gr. *βαλτέτσι* < sl. **bolъce*, Bräuer, SS I 82, ff. 88".

tǎ, gr. βάλτος si duket e huazuar nga shqipja. Fjalën *daltë* ai e shihte të huazuar nga sllavishtja **dolbto*, bullg. *dlato*, f. 54-55.

Më duket se del qartë që nuk ofrohen argumente vendimtare për të parë te këto fjalë në shqipen huazim sllav. Në rastin e *gardh/ grad* bie në sy dallimi kuptimor: fjala shqipe në asnjë kontekst nuk lidhet me ndërtimin me mjete të tjera, pos me rrema të drurit, ndërsa në sllavishtet kjo është e përgjithshme, pos në raste të veçanta. Në rastin e *daltë* me rëndësi lidhur me diskutimin tonë më duket fakti se në shqipen kuptimisht fjala i referohet një mjeti të metaltë, ndërsa kjo mund ta ndërlidhte me kohën e huazimeve sllave. Sido që të jetë, argumenti që sillte Hamp, lidhur me dëshmimin e fjalës edhe në prusishten flet për fjalë të një areali më të gjerë, pra jo për huazime.

Sllavishtja s – shqipja sh

Sipas Jokl-it (*Slaven und Albaner* 292) ky është tipar për huazimet e vjetra, para vitit 1000. *Shullë, grusht, Bushtrica, Pushterica*; pas Seliščev-it edhe *lesh* nga sl. *lěsa*, bullg. *lesá*; *kosherë*, sll. kisht. *kosorъ*, më parë nga sll. jug. *kosěrъ*, skr. *kòsijer*; pas sh. VIII, sepse sllavishtja e lashtë ã kishte kaluar në *o* dhe para 1000, kur ndodhi ndryshimi *s: sh*, f. 692-3.

Sllavishtja kl, gl – shqipja q, gj, k̑, g̑

Në huazimet më të vjetra sllave *kl, gl* kanë dhënë *q, gj, k̑, g̑, k, g*: (Seliščev 307; Jokl, *Slaven und Albaner* 641): në të vërtetë, këto grupe janë zhvilluar si grupet *kl, gl* edhe në fjalë të tjera: *gluhë* (Buzuku, por edhe në çamërishte), *klumështë*; *gjuhë, qumësht* (tosk. *tjetër, geg. qendrore e jugore*); *g̑ũ:h, k̑ũmsht* (geg. *veriperëndimore*); *gũ:h, kumsht*; sll. *kyç* – sll. *kl'učь*; *gjobë* – sllav. *globa, gjobar*; skr. *glòbar*; *Gjomboçari, Gjumboçari* – sll. *Glòbočani, glòbokъ*; *Gjanica* nga slav. **Glavъnica*; më vonë: *kllopashkë, kleçkë, glinë, Glava*, f. 693. Më duket se kronologjia shqipe në raport me fjalët e tjera (shih: *gjuhë, qumësht*; raporti ç: s; raporti q: om, em, um), flasin për një fazë të mëvonë të huazimeve të tilla.

Zanoret hundore sllave

Me rëndësi sipas Duridanov-it janë ato që kanë ruajtur gjurmë të nazalizimit: *on, om, un, um: prondit* < **prōditi*, skr *prūditi*, Desnickaja f. 16 jepte këto raporte: *trondit, trondis* sllavishte e lashtë **trōtiti* (?!); *sundoj* < *sōditi; zhumbinë – zōbъ; Gjumboçari, Gjumboçari*, shih Duridanov f. 693. *Trondit, zhumbinë, Gjëmboçari* janë shembuj që shfaqen vetëm në të folmet toske, apo edhe gege jugore. *Sundoj* nuk duhet të jetë nga *sōditi*, po nga *sund*, prej nga doli pastaj brenda shqipes folja *sundoj* dhe edhe kuptimisht lidhet me periudhën e sundimit serb.

an, am, dalin vetëm në toponimi: *Langajca* nga bullg. e vj. *лѡгъ*. *Rambec, Rëmbec* duket më e vonë, pas sh. X bullg. *ъ>e*, f. 694; *ën, ëm: orëndi* (sic) nga bullg. e vj. *orōdije*, bullg. *orēdie*; *rrëmbenj* nga sll. *rōbiti*; *pëndar* sll. *pōdarъ*, bullg. *pōdar*; *Lënga* nga bullg. e vj. *лѡгъ*, *Dëmbra* nga *dōbrъ*, Duridanov f. 694.³⁹

Për *ç* del *en, ën: rend – rēdb, porend*, bullg. e re *poreda, lëndinë*, edhe *lëndinë*, pranë më të vonës *ledinë* nga sllavishtja e lashtë **lēdina*, bullg. *ledina*, skr. *lēdina*; në Greqi *Sfentogeria* nga sll. **Svētogorije* (Seliščev: 291), Duridanov: 694.

Në huazimet e vona *ç* jepet me *o, a, b, u*, ndërsa *ç* ka dhënë *e*; në Boboshticë deri vonë është ruajtur grupi tingullor vokal (*a, e*) + nazal për *ç, ç: damp* < sllavishte e lashtë **dōbъ*, *zent* < sllavishte e lashtë **zētb*.

Kjo qendër (Boboshtica) mund të ketë shërbyer edhe si bërthamë rrezatimi, sipas Duridanov-it. Së pari shtrohet pyetja pse të ketë shërbyer Boboshtica si qendër rrezatimi? Nga ana tjetër, madje, po të kishim të bënim me ndikim nga një qendër si Boboshtica, do të bëhej fjalë për huazim krejt të vonë, pra as këtu nuk mund të flasim për faza krejt të hershme, pra për sh. VI-VIII, por nuk përjashtohet faza e sh. IX-X.⁴⁰ Edhe Duri-

³⁹ Edhe këto dalin vetëm në jug. Kështu kronologjia do lidhur me të folmet maqedonase.

⁴⁰ Pohimi: "Die älteste Schicht der slavischen Entlehnungen im Albanischen, die sich auf Grund der obigen Lautmerkmale ermitteln läßt, zeugt von einer frühen (6.-7. Und 8.-10. Jh) Besiedlung der albanischen Gebiete durch slavische Bevölkerung", f. 695

danov-i vërente se fenomene të këtilla lidhen me varietete jugore e lindore. Por kërkimi i shpjegimit tek e folmja e Boboshticës si pikë rrezatimi më duket se nuk motivohet.

Duridanov-i i ka diskutuar këto çështje dhe lidhur me rumanishten (Duridanov 1991: 3-19). Diskutues të shumtë kanë theksuar mendimin tjetër se huazimet sllave në rumanishten janë të kohës pas sh. VIII, ose madje IX-X. Rosetti 1954 në rumanishten shihte 3 shtresa huazimesh sllave:

të lashta, midis sh. VI-XII;
të sh. XIII – themelimi i shtetit rumun në veri;
pas sh. XIII nga serbokr., bullg., ukr., rus.

Për *or, ol (ar, al)* Rosetti mendonte se në rum. e shqipen kanë hyrë me metatezë: *gradinë, plaz, prag*, por kemi *baltă, daltă, gard*, për të cilat mendonte se janë nga sllavishtja.

Duridanov-i, pas diskutimeve për *Sclavus, jupîn, stăpîn, stîină, smîntînă, magură, mătură, baltă* (sidomos në f. 14-15) shprehte besimin se në rumanishten më herët, nga fillimi i sh. VI, do të kenë hyrë: *baltă, daltă, gard, măgură, mătură, smîntînă, stăpîn, sută, stîină, şchiau, şchei*, duke u pajtuar kështu me Petrovici-n.⁴¹ Përtruç-i, Mihăilă-a e sidomos Paligă-a e

[Shtresa më e lashtë e huazimeve sllave në shqipen, që bëhet e mundur të përcaktohet në bazë të veçorive fonetike të përmendura më sipër, flet për një okupim të hershëm të viseve shqiptare nga popullatat sllave (sh. 6-7 dhe 8-10)], nuk duket i mbështetur në 'dëshmi' si të mësipërmet, që nuk i qëndrojnë shqyrtimit kritik.

⁴¹ Sipas tij, "Das slavische Adsrtrat, das für das Rumänische in Betracht kommt, war das Altbulgarische und das Mittelbulgarische. Das Altbulgarische besass die zwei mittleren Vokale, das jerъ (ъ) und das jery (ь), welche den rumänischen mittleren Vokalen *ă* und *î* entsprechen. Im Mittelbulgarischen sind *y* (ь) und *i* (у) zusammengefallen, einige ostbulgarische Mundarten haben jedoch Spuren des jery bis zum heutigen Tage bewahrt" f. 12. [Adstrati sllav, që vjen në konsiderim për rumanishten, ishte bullgarishtja e vjetër dhe bullgarishtja e mesme. Bullgarishtja e vjetër kishte dy zanore të mesme, jerin ъ dhe jerin ь, që u përgjigjen zanoreve të mesme të rumanishtes. Në bullgarishten e mesme *y* (ь) dhe *i* (у) u shkrinë, megjithatë disa të folme bullgare lindore kanë ruajtur gjithsesi gjurmë të jerit deri në ditët e sotme.]

kontestojnë këtë. Pos tjerash, diskutohet edhe çështja e kronologjisë në raport me rumanishten/ romanishten.

Më 1952 Selman Riza, në bazë të ideve të Milan Šufflay-it të shprehura te *"Srbi i Arbanasi"*, vlerësonte se ka pasur një

"bashkëjetesë të Shqiptarëvet me Serbët gjatë Mesjetës së vonshme, prej së cilës kohë edhe datojnë të sodshëmet sllavizma në fjalorin e shqipes".

Duket qartë se sllavizmat e shqipes nuk mund të jenë më të hershëm se rotacizmi, të cilin fjalët sllave në shqipen nuk e kanë pësuar, e i cili do të ketë përfunduar para sh. VIII. Edhe kjo është një shenjë kufiri kohor.⁴²

Edhe Henrik Barić-i (1955) mendonte se marrëdhëniet më intensive dhe intime shqiptaro-sllave nuk janë të shekujve të parë të ardhjes së sllavëve në Ballkan, po sidomos pas sh. XIV, kur kemi simbiozë dhe bilinguizëm:

"marrëdhënjet intime dhe intenzive sllavo-shqiptare nuk kanë ndodhë me siguri në shekujt e parë të nguljes së Sllavëve të jugut në tokën shqiptare, por kryesisht prej shekullit XIV-të kur, për rrethana politike e shoqërore, është bërë simbioza dhe bilinguizeti sllavo-shqiptar" (Barić 1955: 75).

Sipas tij, kriter për përcaktimin e vjetërsisë së elementeve sllave në shqipen është ruajtja e gjurmëve të sll. *ǎ* dhe *ǔ*, çka shihet në rastet si: *Dibra* prej *dǐbrǐ*, *druhna* < sll. *drǔva*, *shullë* < *sǔlǔ*, *sule* < *čǔlnǔ*,⁴³ u për sll. *y* e

Pa ndikimin sllav rumanishtja do të kishte zhvilluar një zanore të radhës së mesme, me nyjetim të papërcaktuar gjuhësi si fr. *e* muet apo portugjishtja e katalanishtja e patheksuar *a* ose si dialekt. it. *e*, apo edhe tinguj të hundorëzuar për shkak të nazaleve, por kjo me siguri nuk do të krijonte trekëndëshin e sotëm zanor të rumanishtes. 12-13.

⁴² Ndër gjurmët e hershme, por jo para metatezës, në Kosovë, nëse lëmë anash ato që u përmendën dhe nëse harrojmë që një fjalë e tillë është tepër e gjatë për kohë të hershme, ne mund të shohim te *Landovicë*, me gjurmë të nazales.

⁴³ Të gjitha të lidhura me hapësirat juglindore. Siç u pa, e dyshimtë si huazim duket *druhna*, ndërsa nga *čǔlnǔ* mund të pritej më parë **sul*, jo *sule*.

gjente tek arb. e Greqisë: *matukë* < sll. *motyka*, *karrutë* < sll. *koryto*, *purrë* < sll. *pyr*, që në shqipen kanë hyrë në sh. XIII, kur në gjuhët sllave të jugut y kalon në i, f. 75. Këtu hyjnë fjalët pa ndryshimin metatetik *tolt-tlat* – *daltë* < **dalto*, ndryshe nga e vona *dlato* dhe geg. e jugut *harabel*, tosk. *arravelë* me refleks shqip të vokalit sllav krejt të shkurtë midis okluzivit e likuides (*tolot*), si në gr. e re *saloma* = *soloma* / *slama*. Të shtresës së vjetër të huazimeve sllave janë ato ku kemi *sh* për *s*: *lesh* < sl. *lěsa*, *shuk* < **sŭkŭ* (rus. *Suka*), *koshere* < *kosorŭ*; meqë s ital. mbetet e pandryshuar, ndërsa italianizmat fillojnë rreth v. 1000, del se *sh* për sl. *s* del e sh. XI më së largu. Të vjetra sll. kemi edhe nga fakti se *rav(i)nŭ* dha *raun* dhe *Baau-anna* (nga *Barbanna*) del njësoj: *rrue* dhe *Buenë*, f. 46.

Mendoj se mund të pajtohem me mendimin që shumica e sllavizmave në shqipen lidhet me periudhat e sundimit sllav, e që mund të specifikohet me sundimin bullgar në jug në sh. IX-XI, me sundimin serb në sh. XII-XIV, por edhe me raporte mbisundimi bullgar në veri në sh. IX-X, kohë në të cilën serbët ishin ende në Raška e Zeta, me simbiozën që përshkruante Šufflay-i në Mesjetë, e pastaj me sundimin sllav (serb/ malazias e maqedonas) në sh. XX në kuadër të Jugosllavisë dhe me mbisundimin rus në suaza të ideologjisë komuniste në pjesën e dytë të sh. XX. Por ky kuadër i përgjithshëm paraqet shumë raste të veçanta në zona konkrete hapësinore.

Numri i sllavizmave

Numri i sllavizmave në gjuhën shqipe është llogaritur në tërësi, pa diferencime sipas dialekteve, të folmeve, shtresave, etj. Në atë tërësi Svane ka hetuar 1.181 huazime të tilla, ndërsa tek Ylli ky numër nuk shkon mbi 800, te Desnickaja janë regjistruar 161 sllavizma, ndërsa në të folmen e Preshevës, pa vjelje në terren, po sipas kujtesës, kishim regjistruar 325 sllavizma të zakonshëm dhe 72 të tjerë që mund të konsiderohen të lidhur me administrimin aktual. Në të vërtetë, siç dëshmon paraqitja hartografike e Yllit, jo në të gjitha hapësirat ku flitet shqipja kemi

numër të tillë sllavizmash. Prandaj disa syresh janë lokalë, disa të tjerë me përhapje më të gjerë krahinore, të tjerë me përhapje edhe më të gjerë. Kjo ndërlihet edhe me kohën kur janë bërë huazimet. Për shqipen e gjallë sot kjo shtresë leksikore do vështruar dhe nga aspekti i përdorimit në situatat konkrete. Për ta vështruar këtë më përafër, në mungesë llogaritjesh dhe evidentimesh sistematike, kemi bërë një vjelje të përafërt: 1. Fjalori i dendurisë prej 5.000 fjalësh në shqipen e sotme i hartuar nga A. Caka; 2. Kanuni; 3. Poezia lirike e Gj. Fishtës, 4. Poezia e L. Poradecit dhe të Leksikut të Drenicës nga Boretzky. Në të gjitha këto burime numri i sllavizmave të përdorur sillet rreth 100-200. Në të gjitha rastet kemi sllavizma të ndryshëm dhe përdorimi varet nga konteksti, nga tematika, por edhe nga krahina. Fishta ka më shumë afri me gjuhën e Kanunit, ndërsa Lasgushi ka më shumë sllavizma të zonës së Pogradecit-Korçës. Fjalori i Gjuhës Shqipe i viti 1980, ndërkaq, për mendimin tim, përfshinte dhe sllavizma që për një pjesë të folësve ndjehen si barbarizma, ose të paktën si qartësisht dialektorë.

Këto llogaritje janë krejtësisht relative, kështu që numri i përgjithshëm gjithsesi do të duket ndryshe. Megjithatë, ato e tregojnë peshën relative që ka kjo shtresë leksikore brenda leksikut të shqipes në përdorimin aktual kulturor.

Këtu po japim pasqyrën e përdorimeve të përmendura në format që dalin atje.

Kanuni -formula	Kanuni	Fishta: lirika	Lasgushi: lirika	Fj. 5000 fjalësh
bashtinë	babunë	báca bácen	blatishtë	begati
beditë, me	bashtinë	barot	brazdë	begatoj
bludë	beditë	bashtinet	breg	begatshëm (i)
çetinë	binak	bisedoj	bregore	binjak
giobë	bludë	blegtori	breng	bisedë
grabitë, me	brac	boshtin	brengohe	bisedim
grazhd	carâ	breg	buças	bisedoj
grusht	çarranik	briskut	buçim ,	bosht
kasnec	çetinë	bujarí	bujar	breg,,bregdet,b
koçanë	daltë	bujare bujari	bujë	regor
konop	dobi,	bulritë (tue)	ças	brengë
koritë, me	dobishme e	çast	çetë	brengosur (i)
kotec	giobë,	çelik	çudë, çudi	brisk
leçitë, me	giobtar	cernagore	çuditim	bujar, bujari
ledinë	giobitë	çetë	çukit	çast
mërzitë, me	giobitun, të	çorodite	dobare	çekan
nagaç	govixh	çuda	dobi	çekiç
oborr	grabitë	dobije	dremite	çudi
pansire	grabitme, e	dobishme, t'	duf	çudit, çuditshëm
perzivoj	grabitçarë	flad	fal	(i), çuditur (i)
pojatë	grazhd	fladitë	fingjill	daltë
poronik	grazhdue	fladshme, e	gati	dobi, dobishëm
porotë	grusht	goditen, me	gatohet,	(i)
rend	habitë	gozhda	gatoj	godinë
rednitë, me	kapar	grabitun	godas	godit
ridë	kaparueme, e	habitun	greminë	goditje
rob	kasnec:	kapicen	gremis	gogol
rod	kërçik	kerdi	grifshë	gozhdë
rubë	kërtollë	kob	gropë	gozhdoj
sânë	koçan	kobshem	iskër	grabit grabitqar
sund	koc	koca	kalitem	grabitur
stel	kofë	koritë, me	kanisk	grabitje
stenë	konop	kore	kapitem	grusht
strafulec	koritë:	kori, korís	kasnec	habi
sheste	koritun	kosë	kobë-zi	habit
ujem	korín	krahina	krabë	jug juglindor
um	kosë: kosa	krajl	krahinë	jugor
vadë	kosh:	kreshnik	krastë	jugosllav
vaditë, me	koshar	megje	krillë	kockë
valanicë	koshiq	neveritun i	kryevenitur	kos
vjedër	kositë	nevojë	kunëz	kosë
zabel	kostar	oborr	lele	kovaç
zheg.	kotec	orrl	lëndinë	krahinë
	krahinë	orvatë, me u	llom	krap
	kurvë	pajandrra	lopatë	kreshnik

leçitë	palc	maçok	kroat
leçitun, i	pod	mahnitur	kroatisht
leçi	pol	mërshë	kroatishte
ledinë	pushka	mërzitje	kyç
mërzitë	qerpiku	neverit	lëndinë
merzitun, i	ravë	nosit	mace
nagaç	ravisë	obor	maçok
nevojë	rendin	opingë	memec
oborr	rob	parpalitem	mërzi
ogiç	robënis, t'	poleskë	mërzit
ograjë	robneshtë	potershëm	mërzitje
opangë	robnimit	pulit	mërzitshëm (i)
paditë	rod	pulitje	mërzitur (i)
pancir	rudina	qipallë	neveri
pashtrak	rvatet	qipallëzë	neverit
përtëkë	sokola,	robëri	neveritshëm (i)
perzivoj	stana	robëroj	nevojë
plaçkitë	stervina	ronitem	nevojitem
pleh	streha	shtërg	nevojshëm (i)
pojatë	sundo,	sodit	nevojtoje
poronik	sunduest	strehë	oborr
porositë	topitun, t'	trup	pleh
porotë	trup	ugar	plug
prozhëm	turitë (i a)	ujem	porosi
pushkë	uzdaja	vazhdë	porosit
rend, rendtar	vedrime	vënit	porositje
ridë	veriga	vërsë	prag
rob	vobekut	vërtik	qepallë
robí	zabele	vërtikshmë	rend
rod	zakoni	vërtitem	rendit
parode	zallotë	vlak	renditje
sanë	zhari	zakon	renditur (i)
shestë	zharitse	zbrazët	rob
shpraz	zharrisë, t'	zhurit	robëri
stel	zharritne, t'		rrepë
strafulec	zhegu		sanë
strajcë	zhiguese		serb
sund	zhyemi		serbisht
sundimit	zidit		serbishte
sundohen			sllav
trup			slloven
tym			sllovenisht
ujem			strehë
vadë			strehim
vadëtar			strehoj
vaditë			strofë

	valanicë vjedër vojvodë vozgë zabel zatetë			strofull sundim sundoj sundues trondit tronditje trup vazhdim vazhdimësi vazhdimisht vazhdoj vazhdueshëm i vishnjë vorbë vranët (i) zakon zakonisht zakonshëm (i) zbavit zbavitës zbraz zbrazët (i)
--	---	--	--	--

Listë e sllavizmave në të folmen e Preshevës

a'pët	çe'rëp, -i	grüşht, 'grushti
apera'cī, apera'cija	çët, 'çeta	grāzhd, 'grazhdi
a'vīt, me	çūd, 'çuda	gra'bīt, me
avto'pūt, avto'puti	çu'dīt, me:	gra'nīc, gra'nica
ba'bīn, ba'bina	çu'dīt, me u	gre'būle, gre'bulja
bag'rēm, bag'remi	çukār, çu'kari	gre'dël, gre'deli
be'lëg, be'legi	çu'tūr, çu'tura	gru'hāt, me
bër'llōg, bër'llogi	çutu'rīc, çutu'rica	gu'gūtk, gu'gutka
bija'skōp, bija'skopi	çu'vār, çu'vari	gu'llūb, gu'llubi
bīk, 'biki	damaz'llëk,	ha'bīt, me
bi'nāk, bi'naki	damaz'llëk i	haj'dūk, haj'duki
bi'rōv, bi'rovi (zyrë, administrate; e sh. 20)	damaz'nīk,	halla'kāt, me
blūd, 'bluda	damaz'niki	hu'kāt, me
bollo'vānj/e, bollo'vanja	da'rītë, me	't̄zbe, 'izbja
bōsht, 'boshti	darda'lëc, darda'leci	iz'jāv, iz'java
bo'zhūr, bo'zhuri	dër'zhāv, dër'zhava	iz'vōr, iz'vori
brëg, 'bregi	dese'tār, dese'tari	ja'vīt, me
'brēme, 'bremja	dete'līn, dete'lina	jāz, -i, 'jazi
brān, 'brana	di'hāt, me	jaz'bēc, jaz'bēci
brāv, 'brava	doma'qīc, doma'qica	kala'nīc, kala'nica
brāzd, 'brazda	doma'qīn, doma'qini	ka'māt, ka'mata
bra'nīt, me, bra'nīt	drūm, 'drumi	kastra'vēc, kastra'veci
bri'gū, me, bri'gō	ërr'gjāv, me	kaz'mīt, me
būb, 'buba	ërrgj, 'ërrgja	kërç'ma
bullīc, bu'llica	fi'ngīll, fi'ngilli	kër'pīt, me
bull'nīc, bull'nica	fillād, 'filladi	kërsh, 'kërshi
bu'nār, bu'nari	filla'dīt, me	kër'stīn, kër'stina
'būre, 'burja	filla'nīk, flla'niki	kër'stīt, me
by'rīt, m'u	gër'bāç, gër'baçi	klēçk, 'kleçka
cīc/, 'cica	gërbān, gër'bani	klla'pī, klla'pija
'calla	gër'bāv, me u	kni'zhīc, kni'zhica
ca'rīn, ca'rina	'gërbë, 'gërba	kōb, 'kobi
ce'dīll, ce'dilla	gër'çār, gër'çari	ko'çī, ku'çī; ko'çija,
ce'nīt, me (e vonë, adm.)	gër'dītë, me u	ku'çija
cērg, 'cerga	gër'hātë, me	ko'çāk, ko'çaki,
çāfk, 'çaftka	glla'vīnë, glla'vina	ku'çāk, ku'çaki
çāgi, 'çagji	gllō'bār, gllō'bari	ko'çān, ko'çani,
çakall'nīc, çakall'nica	gōb, 'goba	ku'çān, kuçani
ças'tīt, me	go'bīt, me	koç'nīc, koç'nica,
çe'kīç, -i	go'dīt, me (me akaparue)	kuç'nīc, kuç'nica
	gōll, 'golla	ko'llār, ko'llari,
	gove'dār, gove'dari	ku'llār, ku'llari
	gozh'dū, me	kom'pīr, kom'piri,
		kum'pīr, kum'piri

ko'nǎp, ko'nopi
 'kōre, 'korja
 ko'rīt, ko'rita, ku'rīt,
 ku'rita
 ko'rīt, me
 ko'sāçi, ko'saçi,
 ku'sāç, ku'saçi,
 ko'sūç sh.
 kōs, 'kosi
 ko'sīt, me; ku'sīt, me
 kōsh, 'koshi
 ko'tāre, ko'tarja
 ko'vāç, -i, ku'vaç-i
 ko'zār, ko'zari
 ko'zhǔf, ko'zhufi,
 ku'zhǔf, ku'zhufi
 'krōshnje, 'kroshnja
 krāl, kr'ali
 kra'līc, kra'lica
 kra'sīt, me
 kre'nīk, kre'niki
 kre'vēt, kre'veti
 kūçk, kuçka
 ku'fēr, ku'feri
 ku'lāç, ku'laçi
 ku'līc, ku'ica
 ku'pīn, ku'pin
 ku'rūb, ku'ruba
 ku'rīst, ku'risti
 kūrv, 'kurva
 kur'vār, kur'vari
 ku'vāçk, ku'vaçka
 lak'mū, me
 le'çīt, me
 le'dīn, le'dina
 lēh, 'leha
 le'pīt, me
 lē'se, 'lesja
 liçna'kārt, liçna'karta
 llǎç, 'lloçi
 llǎm, 'llomi
 llōz, 'lloza
 llo'mīt, me
 llopo'vīn, llopo'vina
 llubu'nīc, llubu'nica
 lubi'çīc, lubi'çica

māc, 'maca
 ma'çǎrr, ma'çorri
 ma'līn, ma'lina
 mash'trāp, mash'trapi
 mati'çār, mati'çari
 mātk, 'matka
 mēçk, 'meçka
 'mēgie. 'megja
 mōlc, 'molca
 mōllb, 'mollba
 mǎmk, 'momki
 me'qāv, me'qava
 mērsh, 'mērsha
 mēr'zī, mēr'zija
 mēr'zīt, me u
 mesha'līc, mesha'lica
 me'tīl, mi'tīl, mi'tili
 mrāz, 'mrazi
 mrēzh, 'mrezha
 nēm, 'nemi
 nēmç, 'nemci
 na'çēt, me
 na'rǎd, na'rodi
 nu'hāt, me
 o'bǎrr, 'borri
 of'çār, of'çari
 ofi'çir, ofi'çiri
 o'kōlla
 o'kōllēm o'kōll
 oko'lī, oko'lija
 o'pōng, o'ponga
 op'çīn, op'çina
 op'shtīn, op'shtina
 o'rāshk, o'rashka
 ōrrl, 'orrli
 ōs, 'osi
 o'tāv, o'tava
 ot'kūp, ot'kupi
 ot'kǎs, otk'kosi
 ot'kāz, ot'kazi
 ot'pūst, ot'pusti
 pīçk, 'piçka
 pǎd, 'podì
 pōll, 'polla
 pūshk, 'pushka
 pajs'tǎrk, pajs'torki-i

pa'rīt, me
 pa'sūl, pa'suli
 pas'pāl, pas'pali
 pastor'kī, pastor'kija
 pata'rīc, pata'rica
 pat'kū, pat'kuni
 pe'lēn, pe'lena
 pe'nēz, pe'nezi
 pēr'zhēgre,
 pēr'zhegra
 pēr'zhīt, me
 pet'rōvk, pet'rovka
 pi'çūrç, pi'çurca
 pi'jān, pi'jani
 pija'vīc, pija'vica
 pi'rājç, pi'rajka
 piro'vīn, piro'vina
 pizhi'mūzh,
 pizhi'muzhi
 plāçk, 'plaçka
 plaçkīt, me
 plēh, 'plehi
 plēme, 'plemja
 plēsh, 'pleshti
 pllāt, 'plata
 pllōç, 'ploça
 pllūg, 'plugi
 pobra'tīm, pobra'timi
 pu'çīng, pu'çinga
 po'drūm, pu'drumi
 po'gāç, pu'gāç,
 po'gaça
 po'lāk, po'laki
 pollo'mīd, pollo'mida
 po'rēz, po'ezi
 porez'nīk, porez'niki
 poro'sī, poro'sija
 poro'sīt, me
 po'rōzh, po'rozha
 posh'tār, posh'tari
 pōsh, 'poshta
 pos'llōm, pos'llomi
 pos'tāv, pas'tava
 po'tēr, po'tera
 pōtk, 'potka
 potvērç, pot'vërda

pozif, po'zifi	smoll'nīc, smoll'nica	to'pīt, me; tu'pīt, me
praĝ, 'pragi	so'kōl, so'koli	to'rīsh̄t, -a, tu'rīsh̄t, -a
pra'shīt, me	sōn, 'sona	trāĝ, 'tragi
pre'glēd, preg'ledi	spīc, 'spica	trāp, 'trapi
preki'daç, preki'daçi	stōĝ, 'stogi	trōh, 'troha
pre'sēk, pre'seki	stāp, 'stapi	tro'shīt, me; tru'shīt
preva'rīt, me	stān, 'stani	trūp, 'trupī
pri'jāv, pri'java	sta'tīv, sta'tiva	tu'çill, tu'çilla
prītk, 'pritka	stēl, 'stela	tu'çīt, me
pros'jāk, pros'jaki	stēn, 'stena	tūĝ, 'tuga
proto'gjēr, proto'gjeri	ste'nīc, ste'nica	tu'pān, tu'pani
prun'dīt, me	stēr'vīn, stēr'vina	tūz̄hb, 'tuz̄hba
pu'dīt, me	strājc, 'strajca	tu'zhīt, me
pu'pūlk, pu'pulka	strēh, 'streha	u'ĝār, u'gari
pu'tār, pu'tari	strēm, 'stremi	ugo'vōr, ugo'vori
rūd, 'ruda	stre'dīt, me u	u'jēm, u'jemi
rōk, 'roki	'strōkēll, 'stroklla	u'līc, u'lica
rēk, 'reka	struja'xhī, struja'xhija	u'llōĝ, u'llogi
rēnd, 'rendi	sūd, 'sudi	u'pūt, up'uti
rēp, 'repa	su'dī, su'dija	ur'ōf, uro'fi
ra'būsh, ra'bushi	su'dīt, me	utak'mīc, utak'mica
ra'kīt, ra'kita	su'ĝjēnje, su'ĝjenja	uve'rēnje, -uve'renja
ra'sād, ra'sadi	sun'dū, me	uve'rīt, me
rasa'dīt, me	shāpk, 'shapka	uz'dāj, uz'daja
rasad'nīk, -i	sha'rōv, sha'rovi	vād, 'vada
ra'sōj, ra'oji	sha'tīt, me	vāĝ, 'vaga
ren'dīt, me	sha'vōr, sha'vari	va'dīt, me
re'shēnje, re'shenja	she'bōj, she'boja	vam'pīr, vam'piri
re'shīt, me	'shībēl, 'shibla	'varīt, me
rezh'nīka, -t	'shkrāpēl, 'shkrapla	'vāzhd, 'vazhda
rōb, 'robi	shpo'rēt, shpo'reti	velig'dān. velig'dani
ro'bī, ro'bija	shta'vīt, me	vēz̄hb, 'vezhba
rūb, 'ruba	shtrāf, 'shtrafi	vezhbāt, me
rrēz'bīt, me	shu'mār, shu'mari	vērshalīc, vērsha'lica
sāj, 'saji	ta'bān, ta'bani	vērs'nīk, vērs'niki
sa'kīc, sa'kica	ta'bōrr, ta'borri	vikāt, me
se'līsht, se'lishta	te'mēl, te'meli	virōn, vi'roni
sēr'nīsht, sēr'nishta	tem'līk, tem'liki	vīshnje, vish'nja
sfe'dōk, sfe'doki	tēt, 'teta	vllāç, 'vllaça
sīt, 'sita	tēr'kūz, tēr'kuza	vlla'çīt, me
skllōt, 'skllota	'tērla	vllāĝ, 'vllaga
sledo'vānje,	tēr'pī, tēr'pija	vodni'çār, vodni'çari
sledo'vanja	tērr'nāk, tērr'naki	vodo'vōd, vodo'vodi
sli'kāt, me	tērrna'kōp,	vojni ot'sēk,
sllūpc, 'sllupci	tērrna'kopi	vojniot'seki
sllu'zhīt, me	tes'līc, tes'lica	vojni 'sūd, vojni'sudi

'vōjni, 'vojni
 za'bël, za'beli
 za'brân, za'brani
 zabu'shīt, me
 zaglla'vīt, me
 za'kōn, za'koni
 zapa'rīn, zapa'rina
 zapis'nīk, zapis'niki
 za'tēt, me
 za'vōj, za'voji
 ze'zāt, me
 zija'bīt, me
 zu'vīt, me
 zuz'bīc, zuz'bica
 zhāb, 'zhaba
 zhāllb, 'zhallba
 zha'rāv, zha'rava
 zhara'vīn, zhara'vina
 zhëg, 'zhe'gi
 'zhëgër, 'zhegra
 zhīg, 'zhigi
 zhīv, 'zhiva
 zhūg, 'zhuga

**Sllavizma në Drenicë,
 sipas Boretzky: Der
 Wortschatz der
 Drenica, në shtyp te
 Studime 22.**

apōng-a/opong-a pl.
 astall m.
 avit v. [afr-on] ,, avit-
 et/avyt-et pass.; i
 avytke ngat
 bërllōg/barllag/barllōg
 m. ' ; e bani bërllōg
 bised-on v.
 brázd f. [hulli]
 breg-u m., brigje pl.
 breme f.
 bríg f. [hall tk.]
 búb f., -a pl.
 bukíc f.
 celín f.

cíc f.
 çorod-e adj.f. khs.
 çorodit)
 çudi f. ardh çudi
 çudit-et v.pass.
 dobi f. ; pa dobi
 fal v., fal-i 1.sg.; fal ni
 evlad; fal xhumán
 (xhumón); fal-et ; ju
 fal nerës,
 faleminerës/faliminé
 rs; t fali zoti ?; fal
 xhumón; fal dreken; t
 falni-t
 gati/gadi adv. ; bâ gati
 gërbav v. ; gërbav-et ,
 gërbav-u!
 gërbī-ni m./gërbín
 f.det.
 gërçak m.
 gergere f. [gërgërë]
 gërnaq m.
 gerrdit: u gerrdit v.aor.
 gllasít f.,
 gobit v. [gjobit] ,
 godit v.
 gorjan m.
 gost: përr gost
 gostí f.
 gozhd-a pl.
 grabit v.; grabit përpara
 grabúj, -a pl
 grazhd m. ,Raufe, Stall'
 grusht m. ,Faust'
 halit-et pass.
 jadac
 jaz m.
 jazbak-u m.
 jazbin-a f. ,
 kastravec m.
 kavaç s. kovaç
 kërhas 1.sg., kërhat,
 kërhet v.
 kërstín f.
 kërsh m.
 kërhat s. kërhat

kërri f.
 koçit v.
 kompir/kumpir m.,
 konop/kanop m. ,
 kopáč f. [kofshë] ,
 koráv f. [anije] ,
 kore f.)
 korí f.
 korit v
 korít f,
 kosaç m.
 kosit v.
 kostar m.
 kovaç/kavaç
 kral-i m.
 krajlí/kralí f.
 krashnik
 krojshe/krójsh/kroshqë
 /kroshne f.
 kulaç m., kuleç pl.
 ledín
 llam
 llováč f.
 lludnic f.
 maçorr m.
 mégj f.
 merzit-et v.,
 mërzi: m vjen mërzi
 mishnic f.
 moler m.
 naçet v., naçes 1.sg.
 navilq-it pl./novilk ,
 ném (i) adj.
 nemec
 nevój f
 nevojshëm (i) adj. '
 nevojtore f.
 novilk s. navilq-it
 obrorr/aborr m.
 obrok m.
 okolla/akolla adv.präp.
 opet s. apet
 opqín f. ,
 orl-i [shqipe] m.
 otáv f.
 pacerrk-a f.

pasterk/pastork m. –u	robnësh f.	trág f./trag-u m., tragje pl.
penez m.	robní f. ‚Hausvolk‘	trám f. (dramë)
perájk s.	robnim m.	trósh f., -a pl; vgl. trohë
perrzhít v.	rod m.	trup m.
plaçkit v)	rovín f.	trup-on v.
plaçkaxhi m.	sakicë f. sapát	ulíc f.
pleh m.	smet m., -e pl.	uzdáj f.
pleme f.	smonic-a det.	vadit v.
pllug m.)	stan m.	vërvit v.
pobratim	stén f. , për stene	vlláč f.
pocërrk f.	stenic-a f.det.	vllaçit v.
podváll f.	stërnishte f.	vodeniçar/vodniçár m.
pogaçe f.	sterf m. -a pl.,	vojvód, -a det.
polar m.	stog m.	vranc/vronc/vrôç m.
políc f.	stom s. stam	vrancín/vransín f.
porájk s.	strájç f.	vremç-a pl.
porosit/parasit v.trans.	stréh f.	zabel m.
postáv f. [astar] ,	strínc f.	zabun m.
postérk f	strug-on v.	zakon m.
potér/patér f.	stupc m.	zallóg f.
prag m.	sud m.; súd m., -a det.	zamarit v
prashit v.	sun-on v., súnue; sún	zar interr.
presek m.	m.	zarar m.
presoll m.	shlem m., -a pl.	zates (ně) v.,
prezore (-ě) (prozore,	shpraz v.	zid m.
perzore) f.	shprazët/shprázt (i)	zid-on v.
pudar m. [polak]	tarrakop/tarnakop m.	zháb f.
púshk f. ; púshk me dy	teslíc f.	zharáv
gryka	tihát v.	zhég f.
rakít f.	toçíll f.	zhig m.
rasoj m.	torísht f.	zhig-on v.
rob pl.; rob t shpís		

Bibliografi e përbashkët për dy pjesët e fundit

- Agani (1969), Hilmi: Cila është treva gjuhësore e Fjalorit të Kujunxhiçit, Gjurmime albanologjike, Prishtinë, 1969, 1.
- Agani (1981), Hilmi: Fjalori i Lubomir Kujunxhiçit në dritën e shqipes së Rahovecit e të Gjakovës, Rilindja, Prishtinë.
- Ajeti 1961, I.: Istroijski razvitak gegijskog govora Arbanasa kod Zadra, Sarajevo.
- Ajeti (1963), I.: O nekim uzajamnim šiptarsko-srpskim jezičkim odnosima, Buletin i Fakultetit Filozofik I, Prishtinë, 1963, 149-167.
- Ajeti (1965), I.: Prilog proučavanju medjusobnih šiptarsko-srpskih jezičkih odnosa, Gjurmime albanologjike 2, 1965.
- Ajeti (1965), Idriz: Sur la substitutin ct en albanais, in Zeitschrift für Balkanologie 3, pp. 1-5.
- Ajeti (1966), I.: Neki zajednički izrazi šiptarske i srpskohrvatske leksike, Buletin i Fakultetit Filozofik III, Prishtrinë, 1965-1966.
- Ajeti (1967a), I.: Über einige alb.-serbokroatische Gemeinsamkeiten in der Lexik, Zeitschrift für Balkanologie V, 1967, 138-145.
- Ajeti (1981), Idriz: Quelques problèmes de l'histoire de l'albanais à la lumière des études balkaniques, in Zeitschrift für Balkanologie 17, pp. 121-128.
- Ajeti (1982), I.: Albanizmat në Fjalorin e të folmeve serbe të Kosovë-Metohisë të Glisha Elezoviçit, në Studime gjuhësore në fushë të shqipes, "Rilindja", Prishtinë, 1982, 54-77
- Ajeti (1982a), I.: Studime gjuhësore në fushë të shqipes (edhe serbokroatisht: Studije iz istorije albanskog jezika, ANUK, Posebna izdanja, Knj. 4, Priština, 1982.
- Ajeti (1983), I.: Zhvillime paralele fonetike dhe ndikime të ndërsjella të dialekteve shqiptare dhe serbe të Kosovës te Seminari Ndërkombëtar për gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, Prishtinë, 1983, nr. 8, 13-18.
- Ajeti 1961, I.: Istroijski razvitak gegijskog govora Arbanasa kod Zadra, Sarajevo,
- Ajeti 1986, Idriz: Rapports de l'Albanais avec les langues Balkaniques, në Zeitschrift für Balkanologie, B. XXII/2, 1986, ff. 147-157.
- Ajeti, Idriz: Vepra I-V, ASHAK, Prishtinë.
- Akten des Internationalen albanologischen Kolloquiums, Innsbruck 1972, zum Gedächtnis an Norbert Jokl, herausgegeben von Hermann Ölberg, Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft, Sonderheft 41, Innsbruck 1977.
- Albanci. Lažni Iliri (2007), Referati okruglog stola "Metodološki problem istraživanja porekla Albanaca, SANU 21. juna 2007, Pešić i sinovi, Beograd.
- Alföldy (1940), A.: Daci e Romani in Transilvania, Budapest.

- Anamali, S. (1984): The problem of the Formation of the Albanian People in the Light of Archaeological Data, në Problems of the Formation of the Albanian People, their Language and Culture, Tirana, 65-94.
- Anamali, S. & Biçoku, K. & Duka F. & Islami, S. & Korkuti, M. & Naçi, S. & Prendi, F. & Pulaha, S. & Xhufi, P. (2002): Historia e popullit shqiptar, Vëllimi i parë, Toena, Tiranë, 2002, 39-195.
- Antila, Raimo (1988): An Introduction to Historical and Comparative Linguistics, New York.
- Arap 2010, Ina: Der gebrauch von Infinitiv und Konjunktiv im Altalbanischen mit Ausblick auf da Rumänische, Verlag Dr. Kovač, Hamburg.
- Aronson, Howard, I.: The Balkan Linguistic League, "Orientalism", and Linguistic Typology, Ann Arbor, New York, 2007.
- Arvinte (1968), V.: Die Westgrenze des Entstehungsgebietes der rumänischen Sprache, in Zeitschrift für Balkanologie VI, pp. 97-113.
- Arvinte (1980), V.: Die Rumänen. Ursprung, Volks- und Landesnamen, Narr, Tübingen.
- Asenova, Petja 2002: Balkansko ezikoznanie. Osnovni problemi na balkanskija ezikov съюз, Faber, Sofia.
- Avram, Andrei 1985: Sur les nasales iniciales préconsonantiques en roumain et en albanais, in Mélanges linguistique dédiés à la mémoire de Petar Skok, Zagreb, pp. 33-42.
- Bader, Françoise (1997): Les langues indo-européennes, Paris, Balkan-Archiv II, 1928, f. 227 e vijim.
- Balotă 1927, A.: L'ouverture des syllabes et l'origine de la nasalisation en Albanais, București.
- Banfi 1972, Emanuele: Aree latinizzate nei Balcani e una terza area latino-balcanica (area della Via Egnazia), në Istituto Lombardo - Academia di Scienze e lettere, Estratto dai rendiconti. Classe di lettere, v ol. 106, 1972, Milano, ff. 185-233.
- Banfi (1977), E.: Problemi di fonetica delle aree latino-balcaniche, in Akten des Internationalen albanologischen Kolloquiums, Innsbruck 1972, zum Gedächtnis an Norbert Jokl, herausgegeben von Hermann Ölberg, Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft, Sondereheft 41, Innsbruck, pp. 269-285.
- Banfi (1985), Emanuele: Linguistica balcanica, Bologna.
- Banfi (1987), Emanuele: Cristianizzazione nei Balcani e formazione della lega linguistica balcanica, Zeitschrift für Balkanologie, 23, 4-18.
- Banfi (1991), E.: Storia linguistica del Sud-Est Europeo, Milano, 1991.
- Barić (1919), H.: Albanorumänische Studien I, Sarajevo;
- Barić (1924), H.: Rec. për Jokl, Albaner, në Arhiv II, Beograd 1924,
- Barić 1954, H.: Lingvističke studije, Sarajevo.
- Barić, H. (1954a): Poreklo Arbanasa u svetlu vezika, në Lingvističke studije, Sarajevo, 1954, 7-48.
- Barić (1954b), H.: Etimološki gramatički prilozi; Lingvističke studije I-III, Sarajevo, 1954.
- Barić (1955), H.: Hÿmje në historin e gjuhës shqipe, përkt. H. Kaleshi&H. Thaçi, Prishtinë.
- Barić (1957), H.: Albanisch, Romanisch und Rumänisch, in Godišnjak Naučnog društva N. R. Bosne i Hercegovine, Sarajevo 1957, pp. 1-16.I
- Barić (1959), H.: Istorija arbanaskog jezika, Sarajevo, 1959.

- Barić (1961), H.: La perte de l'infinifitif dans les langues balkaniques, in Godišnjak, Sarajevo, f. 1-11.
- Barjaktarević (1977), D.: Dijalektološka istraživanja, Jedinstvo, Priština, 1977, 434;
- Barjaktarević (1986), D.: Istorijski razvoj kosovsko-metohijskih govora, ANUK, Posebna izdanja, knj. 7, Priština, 1986, 139.
- Bartl (2000), P.: Zum Geschichtsmythos der Albaner, in D. Dahlmann et al. (Hgg.): Mythen, Symbole und Rituale. Die Geschichtsmächtigkeit der Zeichen in Südosteuropa im 19. und 20. Jahrhundert, Frankfurt am Main u.a.: Lang, 119-139.
- Bartoli, M.: (1899) Über eine Studienreise zur Erforschung des altromanischen Dalmatiens, në Anzeiger der phil.-hist. Cl. der Akad. XXV, Wien.
- Bartoli (1906), M. G.: Das Dalmatische I, II, Wien.
- Beci (2002), B.: Probleme të lidhjeve të shqipes me gjuhët e tjera ballkanike, Dukagjini, Pejë.
- Beci: Lashtësia e dialekteve të shqipes, Studime filologjike 3; rimarrë te Beci 2002: Probleme të lidhjeve të shqipes me gjuhët e tjera ballkanike, Pejë 2002: 157 e vijim.
- Bednarczuk, L. (1986): On the development of the Indo-Europena Syllabic Sonants in Balto-Slavic and Albanian, Acta Balto-Slavica, 17, 77-83;
- Benveniste, Emile (1969): Le vocabulaire des institutions indo-européennes I-II, Paris, 1969.
- Birnbaum (1985), Henrik: New approaches to Balkan linguistics, Zbornik u čast Petru Skoku, JAZU, Zagreb, 79-87.
- Blaku (1987), M.: Elemente të shqipes në prozën popullore serbe të Kosovës, Çështje të studimeve albanologjike I, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1987, 78-96. (edhe te Recherches albanologiques nr. 5, viti 1988).
- Blaku (1989), M.: Ndikimi i shqipes mbi të folmet serbe të Kosovës, dorëshkrim i doktoratës, Prishtinë, 1989.
- Bokshi 1980, B.: Rruga e formimit të fleksionit nominal të sotëm të shqipes, ASHAK, Prishtinë.
- Bokshi (1984), B.: Prapavendosja e nyjave në gjuhët e Ballkanit, Rilindja, Prishtinë.
- Bokshi 2010, B.: Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes, ASHAK, Prishtinë.
- Bokshi 2014, Besim: Varia, ASHAK, Prishtinë.
- Bonfante (1973), G.: Studii romeni, Roma.
- Bonnet (1999), Guillaume: Les mots latins de l'albanais, l'Harmatan, Paris.
- Bopp (1855), F.: Über das Albanesische in seinen nverwandtschaftlichen Beziehungen. Abhandl. Der Kön. Akad. D. Wiss., Berlin, s. 459.
- Boretzky, Norbert: Der türkische Einfluss auf das Albanische, I, II, Wiesbaden 1975, 1976;
- Boretzky (2015), N.: Wortshcaatz der Drenica, në shtyp në Studime 22/ 2015.
- Brâncuș (1961), G.: Originea consoanei h din limba română, in SCL XII, 4.
- Brâncuș (1971), G.: Albano-romanica I: Metoda comparației româno-albaneze, in SCL XII (1971), 4, ff. 411-216.
- Brâncuș (1972), G.: Albano-romanica II. Cuvinte autohtone probabile, in SCL XXIII.
- Brâncuș 1973, G.: Albano-romanica. III Vocala ă în română și albaneză, in Studii și cercetări lingvistice, nr. 3, anul XXIV, pp. 291-296.

- Brâncuș 1977: Schimbări fonetice tîrzii în română și albaneză, in Studii și cercetări lingvistice 3/1977, ff. 289-293.
- Brâncuș (1978), Grigore: Balkan Studies, Rosetti, A. & Golopenția Eretescu (eds.): Current Trends in Romanian Linguistics, Revue roumaine de linguistique, Tome XXIII, nr 1-4, Cahiers de linguistique théorique et appliquée, tome XV, nr 1-2, Editura Academiei Republicii Socialiste România, pp. 367-379.
- Brâncuș (1983), G.: Vocabularul autokton al limbii române, București, 1983, 197.
- Brâncuș 1999, Grigore: Das Rumänische, në Hinrichs, Uve (Hg.): Handbuch der Suedosteuropa-Linguistik, Wiesbaden, 261-276.
- Brâncuș, G. 1995: Cercetări asupra fondului traco-dac al limbii române, Institutul roman de tracologie, Bibliotheca thracologica VIII, București, ff. 118.
- Breidaks, A. Concerning the parallels between Baltic and ancient Balkan languages, Linguistique balkanique, 33 (1-2), 43-53;
- Brixhe, C. & Panayotou, A. (1997): Le thrace, in F. Bader (Hg.): Langues indoeuropéennes, Paris, CNRS, pp. 181-205.
- Buchholz, Oda: Zur Verdoppelung der Objekte im Albanischen, Berlin, 1977.
- Buda (1986): Ilirët e jugut si problem i historiografisë, Shkrime historike 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, ff. 13-41.
- Buda, A. (2006): Studime historike, Tekste të zgjedhura. Redaksia: H. Islami, F. Rexhepi, T. Haxhimihali. Parathënia R, Ismajli, ASHAK, Prishtinë, ff. 604.
- Buda (2006), A.: Etnogjeneza e popullit shqiptar në dritën e historisë, në Buda (2006).
- Buda (2006), A.: Vështrim mbi historinë e shqiptarëve dhe të kulturës së tyre, 11-18; Vendi i shqiptarëve në historinë europiane të shekujve VIII-XVIII, 78-101, J. F. Falmerajer dhe historia mesjetare e shqiptarëve, 102-118 në Buda, A. (2006).
- Budimir 1965, Milan: Mesto arbanaskog u krugu indoevropskih vezika, Gjurmime albanologjike – Albanologjia istraživanja, Fakulteti Filozofik i Prishtinës, Katedra Albanologjike – Filozofski fakultet u Prištini, Katedra za albanologiju, 2/ 1965, ff. 5-13, me rezyme latinisht: De linguae albanae conditione argumentum.
- Budziszewska (1986), W.: Slavische Lehnwoerter in den nordalbanischen Dialekten Jugoslaviens, Jezykowe studia balkanistyczne, I, Prace slawistyczne 46, Wroclaw 1986, 173-186.
- Camarda, D. (1864): Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese, Livorno, borim i ri Palermo, 1989;
- Campbell, Lyle: Areal Linguistics, a closer Scrutiny, në http://www.hum.utah.edu.Linguistics/Faculty/oldFacultyPage/campbel/Areal_linguistics_short.do
- Candrea (1930-1931), I. A.: Limba albaneză în raporturile cu limba română, București.
- Capidan (1922), T.: Raporturile albanoromâne, in Dacoromania 2 (1921-22), pp 444-454.
- Capidan (1932), T.: Aromânii. Dialectul aromân, București,
- Cimochowski (1958), Waclav: Prejardhja e gjuhës shqipe, në Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Shkencat Shoqërore II, Tiranë, 37-53.
- Cimochowski (1960), Waclav: Des recherches sur la toponomastique de l'Albanie, në Lingua Posnaniensis, t. VIII, 133-145;

- Cimochowski (1968), Waclav: recension për Idriz Ajeti, Istorijski razvitak gegijskog govora Arbanasa kod Zadra, Sarajevo, 1961, në *Lingua Posnaniensis*, t. XII/ XIII, 176-184;
- Cimochowski 1973, W.: Pozicioni gjuhësor i ilirishtes ballkanike në rrethin e gjuhëve indoeuropiane, in *Studime filologjike* 2.
- Cimochowski (1974), Waclav: *Albanologia w Polsce* (Dotychezasowy dorobek badań nad językiem i literaturze albańska), në *Balkanistyka polska*, Wrocław;
- Cimochowski (2004), Waclaw: Për gjuhën shqipe, Parathënia R. Ismajli, red. I Ajeti, B. Bokshi, R. Ismajli, ASHAK, Prishtinë, ff. 470.
- Cimochowski, Waclaw: *Studime për shqipen*, Prishtinë, 204;
- Civjan, Tatjana: *Lingvističeskie osnovy balkanskoj modeli mira*, Moskva, 1990.
- Clewing, K. (2005): An den Grenzen der Geschichtswissenschaft: Thraker und Illyrier, in *Genesis*, M. und Matzinger, J. (Hrsgs.) *Albanologische und balkanologische Studien. Festschrift für Wilfried Fiedler*, Hamburg, 2005, 215-225.
- Condurachi, Emil & Daicovicu, C. (1972): Rumänen, München/ Genf/ Paris.
- Ion Coteanu (1961), Ion: *Elemente de dialectologie a limbii române*, București.
- Coteanu, I. 1981: *Originile limbii române*, Buucuresti.
- Coteanu, I., Bolocan, Gh., Caragiu-Marioțeanu, M., Drimba, V., Fischer, I., Iliescu, M., Isbășescu, M., Macarie, L., Mihăescu, H., Poghirc, C., Popescu, S., Sala, M., Stati, S. (red.) 1969: *Istoria limbii române*, volumul II, Bucuresti 1969, f. 322.
- Çabej 1958, E.: Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emravit të vendeve, *Bul. i Univ. Të Tiranës* 1958, nr. 2, f. 2;
- Çabej (1959), E.: Unele probleme ale istoriei limbii albaneze, në *Studii și cercetări lingvistice*, 4, X, București, 1959, f. 531 e tutje.
- Çabej (1962), Eqrem 1962 : Zur Charakteristik der lateinischen Lehnwoerter im Albanischen, *Revue de linguistique* 7, 161-199. shqip: Çabej (1975), E.: Karakteristikat e huazimeve latine të shqipes, në *Studime filologjike* 1, 1975;
- Çabej (1963), E.: Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe, në *Buletin i USHT, SSSH*, 3/ 1963, f. 74.
- Çabej (1964), E.: Disa probleme themelore të historisë së vjetër të gjuhës shqipe, *Bul i Univ të tiranës, SSSH*, 4.
- Çabej (1964), E.: Einige Grundprobleme der älteren albanischen Sprachgeschichte, in *Studia albanica* 1964, 1.
- Çabej (1965), E.: Albanisch-rumänische Sprachbeziehungen, *Revue roumaine de linguistique* X, 1965, nr. 1-3, ff. 101-115.
- Çabej (1967), Eqrem: Das Albanische und seine Nachbarsprachen, in *Die Sprache*, XIII (1967), 39-51; (Shqipja dhe gjuhët fqinje, *Studime filologjike*, Tiranë, 1973, IV, 95-105; *Studime gjuhësore*, Rilindja, Prishtinë, 1977, IV, 323-332);
- Çabej (1970), E.: Hyrje në historinë e gjuhës me fonetikë historike, Prishtinë, 1970.
- Çabej, E. (1970a): L'Illyrien et l'Albanais. Questions de principe, in *Studia albanica*, 1, 157-170.
- Çabej (1971-73), Eqrem: Albanische Beiträge zur Kenntniss des lateinischen Wortschatzes, *Bolletino dell'Atlante linguistico mediterraneo* 13-15, 365-377.

- Çabej, E. (1972): Le problème du territoire de la formation de la langue albanaise, Bulletin de l'Association Internationale d'Études du Sud-Est-Européen X, 2, Bucarest, 71-99;
- Çabej (1975a), Eqrem: Disa mendime mbi marrëdhëniet gjuhësore rumune-shqiptare, Studime filologjike 1, 1975.
- Çabej (1976), E.: Histori fjalësh të sllavishtes dhe të shqipes, Studime filologjike, XXX, 1, 1976, 123-135;
- Çabej (1976a), E.: Mbi disa izoglosa të shqipes me sllavishten, Studime filologjike, 2, 1976, 63-76.
- Çabej (1976b), Eqrem: Rumänisch-albanische Wortparallelen, në Revue roumaine de linguistique, t. XXI, 1976, ff. 55-57.
- Çabej (1977)), Kontributi i shqipes në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike, Studime gjuhësore, Rilindja, Prishtinë, 1977, IV, 335-346, më parë te Actes du premier Congrès International d'études Balkaniques et Sud-Est Européennes VI, 265-275, Sofia, 1968 dhe te Studime filologjike, Tiranë, 1970, 4, 3-15
- Çabej, E. (1976-): Studime gjuhësore I-VI, Rilindja, Prishtinë.
- Çabej, E.: Karakteristika e huazimeve latine në gjuhën shqipe, Studime filologjike 2, 1974, Tiranë.
- Çabej, E.: Studime etimologjike në fushë të shqipes I, Tiranë 1982, v. II 1976. III 1987, IV 1986.
- Čović 1986, Borivoj: Die Ethnogenese der Illyrier aus der Sicht der Vor- und Frühgeschichte, në Bernhard, Kandler-Pálsson (Hrsgb.): Ethnogenese europäischer Völker, Fischer verlag, Stuttgart. New York, 1986.
- Ćirković (1988), S.: Albanci u ogledalu južnoslovenskih izvora, in Garašanin (red.) 1988, M.: Iliri i Albanci, Srpska akademija nauka i umetnosti, Beograd, pp. 323-340, frëngjisht pp 341-360.
- Ćorović, V. (1928): Spisi sv. Save, ed. V., Beograd-Sr. Karlovci, 1928, 151-152.
- Dançetoviq (1960), V.: Sufiksi deminutiv i emnave të gjuhës shqipe, Prishtinë, 1960.
- Dechev (1952), D.: Karakterisitka na trakijskija ezik, Sofija 1952.
- Demiraj (1988), Bardhyl: Prof. E. Çabej për marrëdhëniet gjuhësore të shqipes me rumanishten, në Studime filologjike 3/ 1988, ff. 119-123.
- Demiraj, B. 1990: Die Bildung der Zahlwörter 11 bis 19 im Albanischen, në Studia albanica 2/ 1990: 185-189.
- Demiraj (1997), Bardhyl: Albanische Etymologie, Amsterdam-Atlanta GA.
- Demiraj (2010), Bardhyl: Kur etnikët tregojnë: shqa-u ndër shqiptarë, in Studime 16-17, ASHAK, Prishtinë, pp. 231-248.
- Demiraj (2012), Bardhyl: Umsiedler oder Alteingesessene? Fragen zur Urheimat der Albaner im Frühmittelalter, in Südost-Forschungen, Band 71, pp. 379-389.
- Demiraj (1986), Shaban: Besim Bokshi, Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes, Prishtinë, 1980, ff. 395, në Studime filologjike 1, 1986, ff. 172-182.
- Demiraj (1989), Sh.: Gjuha shqipe dhe historia e saj, Prishtinë.
- Demiraj (1994), Shaban: Gjuhësi ballkanike, Shkup.
- Demiraj (1997), Sh.: Fonologjia historike e gjuhës shqipe, Tiranë.

- Demiraj 1999, Sh.: Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmive të gjuhës shqipe, Tiranë.
- Demiraj, Sh. 2000: À propos de la romanisation des anciens peuples de la Péninsule Balkanique, in **Studia Albanica**, XXXIIIe année, Tirana, ff. 1-6.
- Demiraj 2006, Sh.: The Origin of the Albanians (linguistically investigated), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tirana.
- Demiraj 2008, Sh.: Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët, Akadmeia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.
- Densusianu (1901), Ovid: Histoire de la langue roumaine, Paris, 1901.
- Densusianu 1915, O.: Graiul din Țara Hațegului, București, 1915.
- Densusianu (1975), Ovid: Opere, Ediție îngrijită de B. Cazacu, V. Rusu și I. Șerb, II Lingvistica, Histoire de la langue roumaine. I. Les origines, II. Le sixième siècle. Ediție critică și note de V. Russu. Prefață de B. Cazacu, Editura Minerva, București 1975. Më tej : Densusianu 1975.
- Đerić (1927), V.: Arbanaške reči u srpskom jeziku, Prilozi za književnost, jezik, istoriju i folklor, Beograd, VIII, 1927,
- Đerić (1930), V.: Još nešto o arbanaškim rečima u srpskom jeziku, Prilozi za književnost, jezik, istoriju i folklor, Beograd, X, 1930.
- Desnickaja (1963), A. V.: Slavjanske zaimstvovanija v albanskom jazyke, V Meždunarodnyj sovez slavistov, Sofija, 1963, Moskva, 1963, rimarrë në Albanskaja literatura i albanskij jazyk, Leningrad, 1987, 252-269.
- Desnickaja (1968a), A. V.: Albanski jazik i ego dialekty, Leningrad, 1968, përkth. shqip, Prishtinë, 1972.
- Desnickaja (1976), A. V.: Evolucija dialektnoj sistemy v uslovijah etničeskogo smešanija, in Voprosy etnogjeneza i etničeskoj istorii slavjan i vostočnih romance, Nauka, Moskva, pp. 186-197.
- Desnickaja, A. V. (1984): Drevnie balkano-baltijskie sootvetsvija i albanskij jazyk, Sravnitelnoe jazykoznanije i istorija jazykov, Moskva, 192-210.
- Desnickaja, A. V. (1987): K probleme obrazovanija albanskogo jazyka i albanski narodnosti. O latinskih elementah albanskoi leksiki, në Albanskaja literatura i albanskij jazyk, Leningrad.
- Desnickaja (2001), A. V.: Mbi prejardhjen e gjuhës shqipe, Studime 5, 6, 7/ 2000, ff. 181-192.
- Detschew (1957), D.: Die thrakischen Sprachreste, Wien.
- di Giovine 1979, Paolo: Tracio, dacio ed Albanese nella prospettiva genealogica, në Rendiconti della Classe di scienze morali, storiche e filologiche dell'Accademia nazionale dei Lincei, serie VIII, vol. XXXIV, fasc. 7-12, Luglio-dicembre, ff. 397-412.
- Di Giovine, P.: Il grupo ct latino in albanese, Roma 1892 (sic! 1992).
- Đokaj (1984), Đerđ: Neke karakteristike govora Albanaca u Crnoj Gori i uzajamni uticaji crnogorskih i albanskih govora, in Crnogorski gojori, Titogra, pp. 179-187.
- Domi (1968), Mahir: Concordances et analogies syntaxiques albano-roumaines, në Actes du premier Congrès international des études balkaniques et sud-est européennes, VI, Sofia, 1968, ff. 681-695.

- Domi (1974), M.: Prapashtesa ilire dhe shqipe, përkime dhe paralelizma, in Studime filologjike 4, Tiranë.
- Domi (1975), Mahir: Considérations sur les traits communs ou paraleles de l'albanais avec les autres langues balkaniques et sur leur étude, në Studia albanica, 1, 1975, ff. 81-91.
- Domi (1982): De quelques parallelismes syntaxiques albano-roumains, në Beiträge zur allgemeinen, indogermanischen und romanischen Sprachwissenschaft, Festschrift für Johannes Hubschmid zum 65. Geburtstag, Herausgegeben von Otto Winkelmann und Maria Braisch, Franke Verlag Bern und München, 1982, ff. 345-358.
- Domi (1982a): Probleme të historisë së formimit të gjuhës shqipe, arritje dhe detyra, in Studime filologjike, 3-4, Tiranë,
- Domi, M.(1984): Problems of the History of the Formation of the Albanian Language, achievements and tasks, The Academy of Sciences of the People's Republic of Albania: Problems of the Formation of the Albanian People, their Language and Culture, 8 Nëntori, Tirana, 1984, 35-64;
- Domosileckaja (1988), Maria Valentinova: Leksičeskie svjazi albanskogo s vostonoromanskimi jazykami (na materiale terminov skotovodčeskogo hozjaistva), Avto-referat disertacii kandidata filologičeskikh nauk, Leningrad, 1988, ff. 3-22.
- Dragomir (1958), S.: Vlahii din serbia nordul peninsulei balcanice, Editura academiei, București.
- du Nay (1977), André: The early History of the Rumanian Language, Lake, Bluff, Illinois.
- Dumitrescu, F, Pamfil, V. Barborică, E., Cvasnii, M., Theodorescu, M., Călărașu, C., Marta, M., Toma, E., Roxândoiu, L. (1978): Istoria limbii române, București, 1978.
- Duridanov 1976, I.: Ezikat na trakite, Sofija.
- Duridanov (1977), Ivan: Zur bestimmung der ältesten slavischen entlehnungen im albanischen, në Akten des internationalen albanologischen Kolloquiums Innsbruck 1972, zum Gedächtnis an Norbert Jokl, Herausgegeben von Hermann M. Ölberg, Innsbruck 1977, ff. 688-696.
- Duridanov (1991), Ivan: Die ältesten slavischen Entlehnungen im Rumänischen, Linguistique balkanique XXXIV (1991), 1-2, pp. 3-19.
- Duridanov (1999), Ivan: Thrakisch, Dakisch, Illyrisch, në Handbuch der Suedoosteuro-palinguistik, hsg. U. Hinrichs, Wiesbaden 1999.
- Eichner, H. (2004): Illyrisch -Die unbekannte Sprache, in Die Illyrer. Archäologische Funde des I. vorchristlichen Jahrtausends aus Albanien, Katalog der Ausstellung Asparn a.d. Zaya 2004, o.A. 92-117.
- Elezović (1932, 1935): Rečnik kosovsko-metohijskog dijalekta, I, Beograd, 1932; II Beograd, 1935.
- Ernaut-Meillet: Dictionnaire étymologique de la langue latine, Paris 1967;
- Eutorpius, Breviarium IX, 15, 1.
- Ferjančić (1988), B.: Albanci u vizantijskim izvorima, in Garašanin (red.) 1988, M.: Iliri i Albanci, Srpska akademija nauka i umetnosti, Beograd, pp. 285-302, frëngjisht pp. 303-322.
- Ferjančić (1996), B.: Dolazak orvata i Srba na Balkansko Poluostrvo, në Zbornik gradova Vizantološkog instituta, XXXV, Beograd, ff. 117-154.

- Feuillet, Jack: La linguistique balkanique, Cahiers balkaniques 10, Paris, 1986.
- Fiedler (1996), Wilfried: Schramm Gottfried: Anfänge des albanischen Christentums. Die frühe Bekehrung der Bessen und ihre langen Folgen, Freiburg 1994, in Südost-Forschungen, Band 55, 1996, pp. 495-501.
- Fiedler (2006), Wilfried: Einführung in die Albanologie, internet.
- Fiedler, Wilfried: Einführung in die Balkanphilologie, në Rehder, P. (Hg.): Einführung in die slavischen Sprachen, Darmstadt, f. 347-364.
- Floqi (1966), S.: Constructions tautologiques en albanais contemporain (et concordances albano-roumaines), in Studia albanica 2, Tirana, pp. 129-144.
- Fortson IV 2004, B. W.: Indo-European Language and Culture. An Introduction, Blackwell.
- Frâncu (1999), Constatin: Geneza limbii române și etnogeneza românilor, Demiurg, Iași.
- Friedman (1983), Victor: Grammatical categories and a comparative Balkan grammar, in N. Reiter (ed.): Ziele und Wege der Balkanlinguistik, Berlin, pp. 81-98.
- Friedman V. 2003: Evidentiality in the Balkans. In Studies in Evidentiality, Benjamins, Amsterdam, pp. 189-218.
- Friedman, V. A.: 2004: Studies on Albanian and other Balkan Languages, Dukagjini, Pejë.
- Friedman, V. A. 2006: Balkans as a Linguistic Area, Elsevier Ltd. 657-672.
- Friedman, Victor & Joseph, Brian (2006): The Balkan Languages, Cambridge.
- Friedman, Victor A.: Admirativity: Between Modality and Evidentiality, in Sprachtypologie und Universalienforschung 58: 26-37.
- Friedman, Victor: Balkan Slavic Dialectology and Balkan Linguistics: Periphery as Center,
- Friedwagner 1934: Über die Sprache und Heimat der Rumänen in der Frühzeit, në Zeitschrift für romanische Philologie 54/ 1934, ff. 641-715.
- Garašanin (1988), M.: Nastanak i poreklo ilira, in Garašanin (red.) 1988, M.: Iliri i Albanci, Srpska akademija nauka i umetnosti, Beograd, pp. 9-80, frëngjisht pp. 81-144.
- Garašanin (1988a), M.: Zaključna razmatranja, in Garašanin (red.) 1988, M.: Iliri i Albanci, Srpska akademija nauka i umetnosti, Beograd, pp. 361-387, frëngjisht: 369-375.
- Garašanin (red.) (1988b), M.: Iliri i Albanci, Srpska akademija nauka i umetnosti, Beograd.
- Garde, P. (2004): Les discours balkaniques. Des mots et des hommes, Paris, Fayard.
- Georgiev, Vi. (1957): Trakijskijat ezik, Bŭlgarska Akademija na Naukite, Sofija, 1957.
- Georgiev (1960), V.: Albanisch, Dakisch-Mysisch und Rumänisch, in Linguistique balkanique II, ff. 10-19.
- Georgiev, V. (1961): La toponymie ancienne de la péninsule balkanique et la thèse méditerranéenne, in Linguistique balkanique III/ 1, 1961.
- Georgiev (1963), V.: Thrace et illyrien, Balkansko ezikoznanie, 6, 1963, Sofija.
- Georgiev (1964), V.: Vokalnata sistema na slavjanskite ezici, Sofija.
- Georgiev (1968), V.: Le probleme de l'Union linguistique balkanique, Actes du premier Congrès international des Etudes Balkaniques et sud-est europeennes, IV, Linguistique, Sofia.
- Georgiev 1976, Vi.: Les Illyriens et leurs voisins, in Iliria 5.
- Georgiev, V. (1981): Introduction to the History of the Indo-European Languages, Sofia, Bulgarian Academy of Sciences.

- Gimbutas (1986), Marija: Remarks on the Ethnogenesis of the Indo-Europeans in Europe, in Bernhard, Kandler-Pálsson (Hrsg.): *Ethnogenese europäischer Völker*, Fischer verlag, Stuttgart.NewYork, ff. 5-
- Gindin, L. A., Kaluškaia, I. A. , Orel, V. E. 1982: A propos de la composition du fonds de substrat des langues de l'aire balkanique, in *Zeitschrift für Balkanologie*, XVIII, 1982, ff. 127-133.
- Gjinari (1968): Për historinë e dialekteve të gjuhës shqipe, *Studime filologjike*, Tiranë, 1968, 4, 127-144 ("Jehona", Shkup, 1971, nr. 6, f. 35-61).
- Gjinari (1972), J.: Mbi disa elemente sllave në të folmet veriore të shqipes jugore, *Studime filologjike* 4, 1972, 267-278.
- Gjuzelev (1991), B.: Die bulgarisch-albanische ethnische Grenze während des Mittelalters, *Balkansko Ezikoznaie* 3, 1991, 78-91.
- Graur (1936), Al.: Coup d'oeil sur la linguistique balkanique, *Bulletin linguistique*, publ. par A. Rosetti, București-Paris (I- 1933- XV/XVI 1948), IV, 31-45.
- Haarmann, H.: *Der lateinische Lehnwortschatz im Albanischen*, Hamburg 1972;
- Haas 1962, Oto: *Messapische Studien*, Heidelberg.
- Hajnal (2003), Ivo: *Methodische Vorbemerkungen zu einer Paleolinguistik des Balkanraums*, në *Bammesberger, A. & Vennemann, Th.: Languages in prehistoric Europe*, 2003, ff. 117-145.
- Halimi (1954), K.: *Arbanaške reči u našim tajnim jezicima*, *Glasnik etnografskog muzeja u Beogradu*, XXII, 1954, 75-89.
- Hamp (1957), E. P.: *Albanian and Messapic*, në *Pulgram, E. (Ed.): Studies Presented to Joshua Watmaugh on his sixties birthday*, 'S-Grevenhage, 1957, 73-89, shqip te *Studime krahasuese për shqipen*, përgatiti R. Ismajli, Prishtinë, 2007, 147-170;
- Hamp (1960), Eric P.: *Palatal before resonant in Albanian*, *KZ* 76, 257-280;
- Hamp (1961), Eric P.: *Albanian be, besë*, *KZ* 77, 252-253;
- Hamp (1961a), E. P.: *Indo-European bhendh in Albanian*, *KZ* 77, 253-254;
- Hamp (1963), Eric P.: *Einige slavische Toponyme in Griechenland aus dem 17. Jahrhundert*, in *Zeitschrift für slavische Philologie*, Band XXXI, Heft 1, pp. 143-145.
- Hamp (1965), E. P.: *Evidence in Albanian*, në *Evidence for Laryngeals*, The Hague, 123-141;
- Hamp (1966), Eric P.: *The position of Albanian*, *Ancient Indo-European Dialects*, Berkeley, 97-122, shqip te *Studime për shqipen ASHAK*, Prishtinë 2007;
- Hamp (1968), Eric P.: *La langue albanaise et ses voisins*, in *Actes du premier Congrès international des études balkaniques et sud-est-européennes VI*, Sofia, pp. 663-668.
- Hamp (1970), E., *Early Slavic influence on Albanian*, *Balkansko ezikoznanie-Linguistique balkanique*, Sofia, 2, 1970, 11-17
- Hamp (1972), Eric P.: *Albanian*, në *Current trends in linguistics*, Hague, 1626-1692;
- Hamp, E. P. (1973): *On Baltic, Luwian and Albanian participles in *-m*, *Baltistica* IX (1), 45-50.
- Hamp (1976), E. P.: *On the distribution and origin of Vatra*, në *Opuscula slavica et linguistica*, Klagenfurt, 1976, 201-210;
- Hamp (1978), Eric P.: *Strunga*, *Balkansko ezikoznanie* 20, 1978, 115-119;
- Hamp (1980), E. P.: *Thracian, Dacian and Albanian-Romanian correspondences*, *Actes du IIe congrès international de thracologie*, 1980, f. 575-60;

- Hamp (1981), E. P.: On the distribution and Origin of (h)urda, *Linguistique balkanique* XXIV, 3, 1981, 47-50.
- Hamp (1981a), E.P.: Autochthonous vatra, *Revue roumaine de linguistique* 24, 1981, 315.
- Hamp (1982): The oldest Albanian Syntagma, in *Linguistique balkanique/ Balkansko ezikoznanie* XXV, ff. 77-79.
- Hamp 1982-3, E. P.: Indo-European *leugh- in the Ponto-Baltic Region, in *Ponto-baltica* 2-3, *Accademia Toscana di Scienze e Lettere "La Colombaria"*, ff. 7-8.
- Hamp, E. P. (1988): Northwest Indo-European 'spoon', në *Studies in Anatolian, Italic and the Indo-European Languages*, ed. By Yoël L. Arbeitman, Louvain-la-Neuve, 501-504, të gjitha të rimarra shqip në Hamp (2007).
- Hamp (1989), E. P.: Yugoslavia – sa crossroads of Sprachbünde, in *Zeitschrift für Balkanologie*, 25, 1989.
- Hamp (1990), E. P.: The Pre-Indoeuropean Language of Northern (central) Europe, in Markey et Greppin (dir.): *When Worlds collide. Indo-Europeans and Pre-Indo-Europeans*, Karoma Publisher, 1990.
- Hamp (1998), Eric, P.: Whose were Tocharians? Linguistic Subgrouping and Diachronic Idiosynchrasy, në V. H. Mair (Ed.): *The Bronze Age and Early Iron Age Peoples of Eastern Central Asia*, Institute for the Study of Man and University of Pennsylvania, 1998, ff. 307-346.
- Hamp (2007), Eric P.: Studime krahasuese për shqipen, Zgjedhja e Parath. R. Ismajli, përkth. B. Rugova, Rr. Paçarizi, Sh. Munishi, G. Bërlajolli, B. Pllana, R. Ismajli, ASHAK, Prishtinë, ff. 440.
- Hamp, E.: Basis, në *Actes du XIe Congrès international des Sciences Onomastiques*, t. 1, Sofia, 367-369;
- Hamp, E.P.: On Serbo-Croatian's Historic Laterals, in *Of All the Slavs My Favoritess: Studies in Honor of Howard I. Aronson on the Occasion of his 66th Birthday*, ed. V. A. Friedman and D. Deyer, Bloomington, IN, pp. 243-250.
- Hasdeu (1901), Petriceicu, Bogdan: Cine sunt albanesii?, *Analele Academiei Române*, tom XXIII, *Memoriile, Sect. Literare*, ff. 103-113.
- Hasdeu (1877), B. P.: *Columna Traiana 1877*;
- Haxhimihali, T. (2005): *Aleks Buda, kujtime*, Tiranë.
- Hinrichs, U. (ed.) 1999: *Handbuch der Südosteuropa Linguistik*, Harrasowitz, Wiesbaden.
- Hirt 1898, H.: Die Sprachliche Stellung des Illyrischen, në *Beiträge zur alten Geschichte und Geographie*, në *Festschrift für H. Kiepert*, Berlin, f. 181 e vijim;
- Hirt 1905, H.: Die Ingogermanen, *Strassburg*, I, f. 140 e vijim, me shënime f. 600 e vijim.
- Hirt (1940), H.: *Indogermanica. Forschungen über Sprache und Geschichte Alteuropas*, Halle.
- Holm (2009), H. J.: Albanische Basiswortlisten und die Stellung des Albanischen in den Indogermanischen Sprachen, in *Zeitschrift fuer Balkanologie* 45, 2009, f. 171-205.
- Holm (2009), H. J.: Albanische Basiswortlisten und die Stellung des Albanischen in den Indogermanischen Sprachen, in *Zeitschrift fuer Balkanologie* 45, 2009, f. 171-205.
- Holzer (2011), G.: *Glasovni razvoj hrvatskoga jezika*, Institut za hrvatski jezik i jezikodlovlje, Zagreb.

- Hoxha (2001), Sh.: Elemente leksikore të shqipes në gjuhët sllave ballkanike, Camaj-Pipa, Shkodër.
- Hoxha, Enver: Vepra, vëll. 23, f. 547, referuar sipas autorit, ne nuk e kemi parë.
- Huld (1984), Martin: Basic Albanian Etymologies, Ohio, 1984.
- Ier Congrès International des Études Balkaniques et Sud-Est Européennes, Communications de la Délégation de la R. P. d'Albanie, "imprimé sous forme de manuscrit", Tirana, 1966
- Ilievski, Petar: Balkanološki lingvistički studii, Institut za makedonski jazik, Skopje, 1988.
- Isaković (1988), A.: Uvodna reč, in Garašanin (red.) 1988, M.: Iliri i Albanci, Srpska akademija nauka i umetnosti, Beograd, pp. 5-6, frëngjisht: 7-8.
- Ismajli (1971), R.: Disa fjalë shqipe në maqedonishte, Gjurmime albanologjike, 1, 1971, (197), 159-165.
- Ismajli (1971-2), Rexhep: Edhe diçka rreth rotacizmit në gjuhën shqipe, në Dituria 2/3, 1971-72, Prishtinë.
- Ismajli (1972), R.: A propos de la quantité vocalique de l'albanais, in Akten des Internationalen Albanologischen Colloquiums 1972, zum Gedächtniss an Norbert Jokl, Hrsg. von Hermann M. Ölberg, Innsbruck 1977, pp. 367-373; shqip Rreth kuantitetit të zanoreve të theksuara të shqipes, in Gjurmime albanologjike Seria shkencat filologjike III 1973, pp. 57-62, rimarrë në Artikuj për gjuhën shqipe, Rilindja, Prishtinë, 1987, pp. 193-200.
- Ismajli (1977), R.: Grafia e Buzukut dhe disa çështje të sistemit fonetik të shqipes, in Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave filologjike, VII 1977, Prishtinë 1978, pp. 227-254.
- Ismajli (1983), R.: Marrëdhëniet e shqipes me rumanishten, Rilindja, Prishtinë, 15. 1. dhe 29. 1. 1983,
- Ismajli (1987), R.: Artikuj për gjuhën shqipe, Prishtinë, 1987, ff. 57-71.
- Ismajli (1987a), R.: Ndryshime fonetike të vona të shqipes dhe rumanishtes, Artikuj për gjuhën shqipe, Prishtinë, 1987, f. 83.
- Ismajli 1987, R.: Prejardhja e gjuhës shqipe, in Artikuj për gjuhën shqipe, Prishtinë,
- Ismajli 1987b, R.: Origine de la langue albanaise, in Recherches albanologiques, 4, 7-22;
- Ismajli (1994), R. : Kanuni si palimpsest, në Etni e modernitet, Pejë, 1994, f. 76.
- Ismajli (1996), R.: Ballkanistika dhe prejardhja e shqipes, Studime 3, 1996, Prishtinë, 1997, 255-274.
- Ismajli (2009), R.: Pasionet dhe pësimet e Selman Rizës, Prishtinë.
- Ismajli 1983: Marrëdhëniet e shqipes me rumanishten, Rilindja, Prishtinë, 15. I. 1983 dhe 29.I 1983.
- Istoria limbii române, volumul II, Ed. Academiei Republicii socialiste România, București 1969, në pjesën e punuar nga C. Poghir, f. 335-55.
- Ivănescu (1980), G; Istoria limbii române, Junimea, Iași.
- Ivić (1994), P.: Srpskohrvatski dialekti. Njihova struktura i razvoj, Celokupna dela III, Sremski Karlovci - Novi Sad.
- Ivšić, S. (1970): Slavenska poredbena gramatika, botuar pas vdekjes te Školska knjiga, Zagreb, 1970.

- Jašar-Nasteva (1953), O.: Albanski zborovi vo makedonskite tajni jazici, Makedonski Jazik, III, IV, V, VI, 1953
- Jašar-Nasteva (1957), O.: Vlijaniето na makedonskiот jazik vrz albanskite i turskite govori vo Makedonija, Makedonski jazik VIII/2, 1957.
- Jireček (1901), K.: Die Romanen in den Städten Dalmatiens während des Mittelalters I, Wien.
- Jireček (1916), C.: Albanien in der Vergangenheit, in Illyrsch-albanische Forschungen, München-Leipzig 1916, f. 69.
- Jokl, N. (1917a): Albanisch, in W. Streitberg (Hg.) Die Erforschung der indogermanischen Sprachen, Bd. 3 (Slavisch Litauisch, Albanisch), Strassburg, 1917, 109-154.
- Jokl (1923), Linguistisch - kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen, Berlin, Leipzig, 1923.
- Jokl, (1924), N.: Albaner, in Reallexicon der Vorgeschichte I, Hrsg. von Ebert.
- Jokl, N. (1926): Griechisch-albanische Studien, in Festschrift für Paul Kretschmer, Wien-Leipzig-New York, 78-95.
- Jokl, N. (1927): Altmakedonisch-Griechisch-Albanisch, Indogermanische Forschungen 44, 13-70.
- Jokl (1928), Norbert 1928: Balkanlateinische Studien, Balkan-Archiv, 4, 195-217.
- Jokl, N. (1929): Zur Vorgeschichte des Albanischen und Albaner, in Wörter und Sachen 12, Heidelberg, 63-91.
- Jokl (1932), N.: Zur Geschichte des albanesischen Diphthongs ue-, ua-, in Indogermanische Forschungen, bd. 50, f. 33-34;
- Jokl (1933), N.: Südslavische Wortgeographie und albanische Lehnwortkunde, Sbornik v cest na prof. Miletić, Sofija, 1933, 118-146.
- Jokl (1934), Norbert: Slaven und Albaner, në Slavia 13, f. 281-325 dhe 609-645.
- Jokl (1936), Norbert 1936: Zu den lateinischen Elementen des albanischen Wortschatzes, Glotta 25, 1211-134.
- Jokl (1963), N.: Die Verwandtschaftsverhältnisse des Albanischen zu den übrigen indogermanischen Sprachen, Die Sprache 9, 1963, 113-156.
- Jokl (1984), N.: Sprachliche Beiträge zur Paläo-Ethnologie der Balkanhalbinsel, Aus dem Nachlass herausgegeben von O. Pfeiffer, Österreichische Akademie der Wissenschaften, Philologisch-Historische Klasse, Linguistische Abteilung XXIX, Wien 1984;
- Jokl (2011), Norbert: Studime për etimologjinë dhe fjalëformimin shqip/ Studien zur albanesischen Etymologie und Wortbildung, Parathënia R. Ismajli, përktimi E. Çabej, përgatitur nga R. Ismajli, ASHAK, Prishtinë, ff. 434.
- José Enrique Gargallo Gil, Maria Reina Bastardas (coords) 2007: Manual de lingüística romanica, Ariel, Barcelona 2007.
- Joseph (1999), Brian: Romanian and the Balkans: Some Comparative Perspectives, në Embleton, S. & Joseph, J. & Niedereh H.J. (eds., 1999): The Emergence of Modern Language Sciences. Studies on the Transition from Historical-Comparative to Structural Linguistics in Honour of E. F. K. Koerner, v. 2, Amsterdam, ff. 218-235.
- Joseph (2001), Brian D.: Is Balkan comparative Syntax Possible, në Rivero, M. L. and Rally, A. (eds.): Comparative Syntax of Balkan Languages, Oxford, 2001, 17-43.

- Joseph, Brian 1983: *The Synchrony and Diachrony of the Balkan Infinitive: a study in areal, gjenereal, and historical linguistics*, Cambridge University press.
- Joseph, Brian 1987: A fresh look at the Balkan Sprachbund: some observations on H. W. Schaller's *Die Balkansprachen*, in *mediterranean Language Review* 3, pp. 105-114.
- Joseph, Brian : A note on Slavic Loans in Romanian: (I) revisited, *Limba română, limbă romanică*, București, ff. 231-234.
- Katičić, R. (1974): Die Balkanprovinzen, in *Die Sprachen im römischen Reich der Kaiserzeit*, Kolloquium vom 8. bis 10. April 1974, Beihefte der Bonner Jahrbücher Band 40, pp. 103-119.
- Katičić (1976), Radoslav: *Ancient Languages of the Balkans I, II*, Hague, 1976.
- Katičić 1985, R.: Sur la langue illyrienne, in *Recherches albanologiques*, 1, Prishtinë, 23-34.
- Klemenčič (2007), Simona: K metodologiji dialektologije jezikovnih družin: sklepanje o obstoju narečenega areala, in *Slovenski jezik/ Slovene linguistic studies*, 6, 2007, pp. 133-150.
- Klepikova (1973): *Iz Karpato-Balkanskoj terminologiji vysokogornogo skotovodstva*. 2. Vatra, *Balkanskoe jazykoznanie*, Moskva, 149-169.
- Klewing, Konrad: An den Grenzen der Geschichtswissenschaft: Albaner, Thraker und Illyrier, në *Genesis*, M./ Matzinger, J. (Hg.): *Albanologische und balkanologische Studien*. Festschrift fuer Wilfried Fiedler, Hamburg, 2005, f. 215-225;
- Klingenschmitt, G. (1994): Das albanische als Glied der indogermanischen Sprachfamilie, in *Rasmunsen, J. E. (Hrsgb.) In honorem Holger Pedersen*, Wiesbaden, 221-233;
- Klingenschmitt, G. (1994a): Die verwandschaftsverhältnisse der indogermanischen Sprachen, in *Rasmunsen (Hg): In honorem Holger Pedersen*, Wiesbaden, 235-251,
- Klingenschmitt, G.: Albanisch und Urindogermanisch, in *MSS* 40, 93-131;
- Kopitar 1929: *Albanische, Walachische u. bulgarische Sprache, botimi Bartholomaei Kopitarii Scriptorum. Pars secunda. Tomus II MDCCCXXV-MDCCCXXXIV, Operi adorando parfuit dr. R. Nahtigal, Labaci, MCXLV*, ff. 227-273.
- Kopitar, Jernej: Albanische, walachische und bulgarische Sprache, in *Jahrbücher der Literatur* 46: 59-106.
- Kortland, F. (1986): Albanian and Armenian, në *Leroi, Maurice-Mawet, Francine (Hgg.)*, *La place de l'arménien dans les langues indoeuropéennes*, Louvain, 1986, 38-47.
- Kovačec 1971, A.: *Descrierea istroromânei actuale*, București.
- Krahe (1925), Hans: *Die alten balkanillyrischen geographischen Namen*, Heidelberg,
- Krahe (1929), Hans: *Lexicon altillyrischer Personennamen*, Heidelberg,
- Krahe 1940, H.: Beiträge zur illyrischen Wort- und Namenforschung, in *Indogermanische Forschungen* 57, 116;
- Krahe (1950), Hans në *Sonderbericht der Heidelberger Akademie der Wissenschaften, philologische-historische Klasse*, 3.
- Krahe 1955, H.: *Die Sprache der Illyrier I. Die Quellen*. Wiesbaden.
- Kristophson, Jürgen 1988: Romanische Elemente im Albanischen, in *Zeitschrift für Balkanologie* 24, 51-93.
- Kronasser 1962, H.: *Zum Stand der Illyristik*, *Balkansko ezikoznanie IV*, Sofia.
- Kuçi (1913), S.: *Studimet mbi strukturën e shqipës në BRSS*, Prishtinë, 2013, ff. 266.

- Kulišić (1980), Š.: O etnogenezi Crnogoraca, Tirograd.
- La Piana (1939), Marco: Studi linguistici albanesi, vol. I, Prolegomeni allo studio della linguistic Albanese, Palermo, 1939, f. 139-40.
- Lafe (2000), Genc: Grigore Brâncuș, Cercetări asupra fondului traco-dac al limbii române, București, 1995, in *Studia albanica* 2000, ff. 255-364.
- Landi, Addolorata 1989: Gli elementi latini nella lingua albanese, Napoli.
- Lindsted, Juoko: Linguistic Balkanization Contact-induced change by Mutual Reinforcement, në D. Gilberts, J. Nerbonne and J. Shaeken: *Languages in Contact*, Amsterdam, 2000, 231-246.
- Liukkonen, K.: Albano-balto-slavjanskije etimologii, in *Scando-slavica*, 35, 197-202;
- Loma, A. (1991): Sloveni i Albanci do XII veka u svetlu toponomastike, në Stanovništvo slovenskog porekla u Albaniji. Zbornik radova sa medjunarodnog naučnog skupa održanog u Cetinju 21, 22 i 23. juna 1990, Titograd, 1991, 279-327.
- Malcolm, N. (1998): *Kosovo. A Short History*, Macmillan, bot. Papermac, London-Oxford.
- Mallory, J.P. (1989): *In the Search of the Indo-Europeans. Language, Archaeology and Myth*, Thames & Hudson Ltd. London, 1989, repr. 2001.
- Mansaku 1982, Seit: Autoktonia e shqiptarëve në dritën e të dhënave të toponimisë së lashtë, in *Studime filologjike* 3, Tiranë.
- Mansaku, S. (1995-1999): Problèmes de l'histoire de l'albanais à la lumière de ses relations avec le grec, *Studia albanica*, 111-124;
- Mansaku (1995), Seit: Çështja e autoktonisë së shqiptarëve në dritën e marrëdhënive të shqipes me latinishten, in *Seminari XVII*, ff. 167-176.
- Mansaku, S. (1997): Quelques caractéristiques des éléments du grec ancien en albanais, *Zeitschrift für Balkanologie* 33, 182-186.
- Mansaku, Seit (2000): La position des éléments latins de la langue albanaise dans la romanité balkanique, in *Studia albanica*, XXXIIIe année, Tirana, ff. 39-55.
- Mansaku (2012), Seit: Tipologji romane dhe ballkanike në strukturën gramatikore të shqipes, in Ismajli (red.): *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit/ Albanian and Balkan languages*, ASHAK, Prishtinë, pp. 71-89.
- Marius Sala, *Contribuți la fonetica istorică a limbii române*, București, 1970.
- Martinet, André: *Des steppes aux océans. L'indo-européen et les "Indo-Européens"*, Paris, Payot, 1986.
- Matasović (2008), R.: *Poredbeno-povijesna gramatika hrvatskoga jezika*, Matica hrvatska, Zagreb.
- Matzinger (2005), Joachim: Messapisch und Albanisch, in *International Journal of Diachronic Linguistics and Linguistic Reconstruction* 2, 2005, pp. 29-54:.
- Matzinger, J. (2006): *Der Altalbanische Text [e] Mbsuame e krështerë (Dottrina cristiana des Lekë Matrënga von 1592. Eine Einführung in die albanische Sprachwissenschaft*, Dettelbach, 47-92.
- Matzinger 2009, Joachim: *Illyrisch und Albanisch – Erkenntnisse und Desiderata*, in *Die Sprache* 48, *h2nr. Festschrift für Heiner Eichner, Wiener Sprachgesellschaft/Harrasowitz Verlag, Wiesbaden, pp. 98-106.

- Matzinger 2012, Joachim: Zur Herkunft des Albanischen: Argumente gegen die thrakische Hypothese, në Bardh Rugova (red.): Studime për nder të Rexhep Ismajlit, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë dhe Koha, Prishtinë, ff. 463-477.
- Mayer (1957, 1959), Antun: Die Sprache der Alten Illyrier I-II, Wien.
- Mayer (1982), Harvey: Dacian, Thracian as Southern Baltoidic, in *Lituanus* 38, n. 2
- Mayer (1991b), H.: Reflexes of Indo-European Syllabic Resonants in Baltic, Slavic and Albanian, in *Lituanus* 37, 4.
- Mayer (1991a), H.: Tokharian and Baltic versus Slavic and Albanian, in *Lituanus* 37, 1.
- Mayer, H. (1991): Reflexes of Indo-European Syllabic Resonants in Baltic, Slavic and Albanian, *Lituanus* 37, no. 4;
- Mayer, H. (1991c): Reflexes of Indo-European Syllabic Resonants in Baltic, Slavic and Albanian, *Lituanus* 37, no. 4;
- Mayer, H. (1993): Slavic, a Balticized Albanian?, *Lituanus* 39, 2;
- Mayer (1997), Harvey: Balts and Carpathians, in *Lituanus* 43, no. 2
- Mayer, H. (2003): Shifts in early albanian-slavic syllable boundaries, *Lituanus* 49, no. 3;
- Mayser (1970), Edwin: Grammatik der griechischen Papyri aus der Ptolomäerzeit. Bd. 1.1. Berlin 1970, 169-171.
- Meid 2007, Wolfgang: Die Kelten, Reclam, Stuttgart.
- Meillet, A. (1908): Les dialectes indoeuropéens, Paris.
- Meyer (1883), G.: Essays und Studien zur Sprachgeschichte und Volkskunde I, Berlin, 53.
- Meyer, G. (1884): Die Stellung des Albanesischen im Kreise der indogermanischen Sprachen, BB, Göttingen, 1884, 185-189.
- Meyer (1888), G.: Alb. Studien III, te Grundriss der romanischen Philologie, Strassburg.
- Meyer (1888a), G.: Die lateinische Elemente in Albanesischen, Gröbers Grundriss I Auflage.
- Meyer (1891), Gustav: Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache, Strassburg, 1891.
- Meyer, G. (1891a): Albanesische Studien III, Jena.
- Meyer-Lübke, Wilhelm 1914: Rumänisch, Romanisch, Albanesisch, in *Mitteilungen des Rumänischen Instituts an der Universität Wien* 1, Heidelberg, 1-42.
- Meyer-Lübke, Wilhelm 1904: Die lateinischen Elemente im Albanesischen, Gustav Gröber, Grundriss der romanischen Philologie 1, Bd. Strassbourg, 1038-1057.
- Mihăescu (1966), Haralambie: Les éléments latin de la langue albanaise, *Revue des études sud-est européennes* 1-2-3-4, Bucuresti;
- Mihăescu (1981), Haralambie: Locul elementelor lexicale latine din albaneză în cadrul romanității sud-est europene, në Coteanu, I. & Wald, L. (1981): *Semantică și semiotică*, București, 1981, ff. 216-235.
- Mihăescu (1993), Haralambie: La romanité dans le sud-est de l'Europe, București, 1993, botim i plotësuar nga 1978.
- Mihăilă (1960), G.: Împrumuturi vechi sud-slave în limba română, București.
- Mihăilă (1973), G.: Studii de lexicologie și istorie a lingvisticii românești, Ed. didactică și pedagogică, București, pp. 9-53.

- Miklosich, F. (1858): *Monumenta Serbica spectantia historiam Serbiae Bosnae Ragusii, Vindbonae*, 4.
- Miklosich (1870), F.: *Albanische Forschunge*, I, *Die Slavischen Elemente im Albanischen*, Wien, 1870 (Denkschrift der Wiener Akademie der Wissenschaften, XIX).
- Miklosich (1879), Franz: *Über die Einwanderung der Rumänen in den Dalmatischen Alpen von den Karpaten*, Wien.
- Miklošič (2006), Franc: *Gjurmime shqiptare/ Albanesische Forschungen*, Parathënie R. Ismajli e M. Snoj, përgatitur nga R. Ismajli & M. Snoj, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës & Slovenska akademija znanosti in umetnosti, Prishtinë-Lubjanë, ff. 504.
- Mirčev, K. (1958): *Istoričeska gramatika na bŭlgarskija ezik*, Sofija;
- Mirdita 2003, Zef: *Vlasi u historiografiji*, Zagreb, Hrvatski institut za povijest.
- Mirdita, 2009, Zef: *Vlasi*, Zagreb, Hrvatski institut za povijest.
- Mišeska-Tomić, Olga: *Balkan Sprachbund Morpho-syntactic Features*, *Studies in Natural Language & Linguistic Theory*, Springer 2006, pp. 749.
- Mladenov 1925, St.: *Bemerkungen über die Albaner und das Albanische in Nordmakedonien und Altserbien*, në *Balkan-Archiv*, I, 1925.
- Mladenov (1927), S.: *Prinos kŭm izučavanje na bŭlgarsko-albanskite otnošenija*, *Godišnik na Sofijskija universitet*, ist. fil. XXII, 8, Sofija, 1927.
- Mladenov 1938, S.: *Albanisch und Thrako-Illyrisch*, në *Balkan-Archiv* 4, f. 181;
- Murati (1990), Q.: *Elementet e gjuhës shqipe në gjuhët sllave jugore*, Prishtinë, 1990.
- Murati (2004), Q.: *Fjalor i fjalëve shqipe në maqedonishten dhe idiomatikë shqiptaro-maqedonase*, Logos-A, Shkup-Prishtinë-Tiranë.
- Nesimi (1986), R.: *Disa elemente shqipe në të folmet e maqedonishtes perëndimore*, *Gjurmime albanologjike*, 2, 1986, 21-31.
- Nesimi (1987), R.: *Elemente të përbashkëta të shqipes, maqedonishtes, Çështje të studimeve albanologjike I*, *Instituti Albanologjik i Prishtinës*, 1987;
- Nocentini (1996), Alberto: *Tipologia e genesi dell'articolo nelle lingue europee*, *Archivio glottologico italiano* 81, 1996, 3-44.
- Ölberg, H. M.: *Einige Überlegungen zur laryngaltheorie (An Hand des Albanischen)*, in *Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung* 86: 121-136.
- Ölberg (1972), H.: *Griechisch-albanische Sprachbeziehungen*, R. Muth (Hrsg.): *Serta philologica Aeniponana II*, Innsbruck, f. 33-64;
- Omari (1989), A.: *Ndikime të gjuhës shqipe në të folmet jugore të serbishtes*, *Studime filologjike* 1, 1989, 43-59.
- Omari (1994), A.: *Ndihmesë për inventarin e huazimeve sllave në gjuhën shqipe*, in *Studime filologjike*, 1-4, 1994.
- Omari 2012, Anila: *Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe*, *Botimet albanologjike*, Tiranë.
- Orel (1993), V.: *Albanian and Indo-European*, in *In honorem Holger Pedersen*, 1993, Wiesbaden;
- Orel (1998), V.: *Albanian Etymological Dictionary*, Leiden, Boston, Koeln, Brill, 1998;
- Orel (2000), V.: *A concise historical grammar of the albanian language: Reconstruction of Proto-Albanian*, Brill

- Paliga (1999), S.: Thracian and pre-Thracian studies, București, Lucretius.
- Paliga (2006), Sorin : Influențe romane și preromane în limbile slave de sud, Fundația Evenimentul, București, 2006.
- Paliga (2006a), Sorin: Etymological Lexicon of the Indigenous (Thracian) Elements in Romanian, București.
- Paliga (2012), S.: Introducere în studiul comparativ al limbilor slave, Editura Universității București.
- Panaiteescu: Latinità e Cristianesimo nella evoluzione storica del popolo romeno, në Studi sulla Romania, Roma, 1925.
- Papazoglu (1988), Fanula: Ilirska i dardanska kraljevina, in Garašanin (red.) 1988, M.: Iliri i Albanci, Srpska akademija nauka i umetnosti, Beograd, pp. 145-172; frëngjisht po aty pp. 173-200.
- Papazoglu (2007), Fanula: Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba, Equilibriu, Beograd. Botimi i parë Sarajevo 1969.
- Pătruț 1958, Ion: Contribuții slave și maghiare la formarea subdialectelor dacoromâne, CL III, 1958, f. 67, 70.
- Pătruț (1974), I.: Locul elementului slav în structura limbii române, në Studii de limba română și slavistică, Editura Dacia, Cluj, 1974, ff. 91-100.
- Pătruț (1974a), I.: Studii de limba română și slavistică, Editura Dacia, Cluj.
- Pătruț (1974b), I.: Vechimea relațiilor lingvistice slavo-române, në Studii de limba română și slavistică, Editura Dacia, Cluj, 1974, ff. 101-123.
- Pedersen 1900, Holger: Albanesisch und Armenisch, in KZ 36, Neue Folge 16, ff. 340-41. Shih përkthimin shqip nga A. Dhrimo, në Pedersen 2003, H.: Studime për gjuhën shqipe, ASHAK, Prishtinë, ff. 115-116.
- Pedersen, Holger (1931): The Discovery of Language. Linguistic Science in the 19th Century, Indiana University Press, Bloomington & London, fifth printing 1972, f. 71
- Pedersen (2003), Holger: Studime për gjuhën shqipe, parathënie R. Ismajli, red. I. Ajeti, B. Bokshi, R. Ismajli, ASHAK, Prishtinë, ff. 495.
- Pellegrini (1998), G. B.: Avviamento alla linguistica albanese, Università degli studi della Calabria, Rende.
- Pešikan (1979), M.: Jedan opšti pogled na crnogorske govore, in Zbornik za filologiju i lingvistiku XXII/1, Novi Sad 1979, f. 166)
- Petriceicu-Hasdeu (1976), B.: Etymologicum magnum Romania. Dictionarul limbilor istorice și populare a românilor, ediție îngrijită și studiu introductiv de Grigore Brâncuș, 3, Editura Minerva, București 1976, ff. 7-30,
- Petrovici (1950), Emil: Corelația de timbre a consoanelor dure și moi în limba română, Studii și cercetări lingvistice I 1950.
- Petrovici (1957), Emil: Kann das Phonemsystem einer Sprache durch fremden Einfluss umgestaltet werden? In Zum slavischen Einfluss auf das Rumänische Lautsystem, Mouton and Co, 'S-Gravenhage, 1957, *Janua linguarum. Studia memoriae Nicolai van Wijk* dedicata, nr. III, pp. 44.

- Petrovici 1964, E.: Traits balkaniques communs dans les systemes phonétiques du roumain et de l'albanais (la voyelle du type *ă*), in *Die Kultur Südosteuropas. Ihre Geschichte und ihre Ausdrucksformen*, Wiesbaden, pp. 199-206.
- Petrovici 1966), E.: Problema limitei sud-vestice a teritorului de formare a limbii românești, in *Limba română IX*, pp. 79-83.
- Philippide (1927), Alexandru: Originea românilor II. Ce spun limbile română și albaneză, Iași, 1927.
- Pisani 1933, Vittore: Preistoria delle lingue indeuropee, in *Atti del Reale Accademia dei Lincei. Memorie. Ser. VI, vol. IV, fasc. VI*, 545.
- Pisani (1941), V.: Il Problema illirico, Appendice 2: Su Georg Stadtmüller, *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte*, in *Linguistica generale e indeuropea, Saggi e discorsi*, I. Torino, 1959, pp. 100-101, sê pari në *Archivio Glottologico*, XXXIV, 1942, p. 128 e vijim.
- Pisani (1950), Vittorio: L'albanais et les autres langues indoeuropéennes në *Annuaire de l'Institut de Philologie et d'histoire orientales et slaves*, t. X, *Mélanges Grégoire II*, Bruxelles.
- Pisani 1959, V.: Lexicalische Beziehungen des Albanesischen zu den anderen indogermanischen Sprachen, *Saggi di linguistica storica*, Torino, f. 134. Pisani (1964), Vittorio: Les origines de la langue albanaise. Question de principes et de méthode. *Studia albanica 1*, ff. 61-68.
- Pižurica (1984), Mato: Tragovi međujezičkih dodira u govornima Crne Gore, in *Crnogorski govori*. Titograd, pp. 83-95.
- Plomé (), E. C.: Balkan languages (Illyrian, Thracian, and Daco-moesian, in *The Cambridge ancient History*, vol. III, part. I: The Prehistory of the Balkans; and the Middle East and the Aegean world, tenth to eighth centuries B.C., eds. Boardman, J., Edwards, I. E. S, Hammond, N. G. L., Sollberger, E.
- Poghirc (1960): Vocalele rom. *ă*, alb. *ë*, bulg. *ъ* și oscilația a/e in grafia cuvîntelor trace, in *SCL XI*, 1960, 3, f. 657 e v.
- Poghirc (1961), La valeur phonétique de l'oscillation graphique a/e a la lumière des données des langues balkaniques modernes, *Studii și cercetări lingvistice III*, 1961, f. 33-37.
- Poghirc 1963, C.: L'alternance m/mb/b en thrace et en albanais, në *Balkansko ezikoznanie 6*.
- Poghirc 1967: 30) Considérations sur les éléments autochtones du roumain, në *Revue roumaine de linguistique*, XII, nr. 1.
- Poghirc (1968a), C.: Reflexions sur les problèmes du daco-moesien, L'Ethnogenèse des peuples balkaniques, *Symposium International sur l'Ethnogenèse des peuples balkaniques*, Plovdiv 1969, Sofia 1971.
- Poghirc (1968), Cicerone: B. P. Hasdeu linguist și filolog, București, Editura Minerva.
- Poghirc (1969), C.: në *Istoria limbii române II 1969*: 314-366.
- Poghirc (1977), Cicerone: L'apport des substrats antiques à l'union linguistique balkanique, *Balkansko ezikoznanie/ Linguistique balkanique XX*, 1-2, Sofija, 1977, ff. 83-87.
- Poghirc (1983), Cicerone: *Philologica et linguistica, Ausgewählte Aufsätze (1953-1983)*, Bochum, 1983.

- Poghirc, Cicerone: Le roumain dans le contexte de la linguistique indo-européenne/ Limba română în limina lingvisticii indeuropene, București.
- Poghirc, Cicerone: Substrats prélatins dans la Romania orientale et occidentale, Dritter internationaler thrakologischer Kongress, Staatlicher Verlag SWJAT.
- Polák (1957), V.: Slované a Albánci, in *Časopis pro moderni filologii* 39, pp. 85 et suiv.
- Polák, Václav 1958: Quelques idées concernant les rapports lexicaux albano-roumains, in: *Omăgiu lui Iorgu Iordan cu prilejul împlinirii a 70 de ani*, Academia Republicii populare Romîne, 1958, ff. 603-699.
- Polák, V. (1960): Stèmes vocaliques en albanais, in *Studii și cercetări lingvistice*, Omăgiu lui Al. Graur cu prilejul împlinirii a 60 de ani, 3, anul XI, pp. 661-668.
- Polák, V. (1963): Les origines de la différenciation dialectale en Albanie, *Orbis*, t. XII, nr. 2.
- Popović (1953), Ivan: Disa fjalë mbi marrëdhënjet reciproke linguistike sllavo-shqiptare, in *Jeta e re*, Prishtinë, 1953, V, 269-276;
- Popović (1954), Ivan: Neki gentilni i njima srodni termini kod Crnogoraca i Arbanasa, *Radovi naučnog društva II*, odj. ist. - fil. II, Sarajevo, 1954, 49-84;
- Popović (1955), Ivan: Istorija srpskohrvatskog jezika, Novi Sad, 1955, 128-144
- Popović (1957), Ivan: Elemente të gjuhës shqipe në gjuhët tjera, *Përparimi*, 1-2, 21-33;
- Popović (1958), Ivan: Studi etimologici montenegrini, ricerche Linguistiche, *Bolletino dell' Instituto di Glottologia dell' Università di roma*, roma, 1958, IV, 139-149;
- Popović, I. (1958a): Slaven und Albaner in Albanien und Montenegro, in *Zeitschrift für slavische Philologie*, XXVI, Heidelberg, pp. 301-324.
- Popović, I. (1960a): Bemerkungen über die vorslavischen Ortsnamen in Serbien, in *Zeitschrift für slavische Philologie*, XXVIII, Heidelberg, pp. 101-114.
- Popović (1960), Ivan: Geschichte der Serbokroatischen Sprache, Otto Harrasowitz, Wiesbaden.
- Popović (1988), V.: Albanija u kasnoj antici, in *Garašanin (red.) 1988, M.: Iliri i Albanci*, Srpska akademija nauka i umetnosti, Beograd, pp. 201-250, frëngjisht pp. 251-284.
- Porzig 1974, W.: Die Gliederung des indogermanischen Sprachgebietes, Heidelberg.
- Prendi, F. & Zheku, K. (1984): The Illyrian-Arbër Ethno-cultural Continuity in the City of Lissus, në *Problems of the Formation of the Albanian People, their Language and Culture*, Tirana, 109-116.
- Puşcariu (), S.: Limba româna II: 325, sipas Dimitrescu et alii: 71.
- Puşcariu (1974), S.: Cercetări și studii, București, 1974, f. 90.
- Rădulescu 1984, Mircea-Mihai: Illyrian, Thracian, Daco-Mysian, the substratum of Romanian and Albanian, in *JIES* 12, 1-2, p. 77-131;
- Rădulescu 1987, Mircea-Mihai: The Indo-European Position of Illyrian, Daco-Mysian and Thracian: a historico-methodological approach, in *JIES* 15, 33-4, p. 239-271;
- Rădulescu, M. M.: The Indo-European Position of Messapic, në *Journal of Indo-European Studies*, 22, 1994, 329-344;
- Ramovš, F.: *Kratka zgodovina slovenskega vezika I*, 1936, Znanstvenoraziskovalni center SAZU, Ljubljana 1995;
- Reichenkron 1966, G.: *Das Dakische*, 180.

- Reichenkron, G. 1958: Der lokativische Zaehltypus fuer die Reihe 11 bis 19: "eins auf zehn", në Südost-Forschungen, Bd. XVII, 1, Halbband, München, 1958: 152-174.
- Reiter, Norbert: Grundzuege der balkanologie, Berlin, 1994, 1-95, 691-898.
- Renfrew, C. (1990): Archeology and Language, The Puzzle of Indo-European Origins, 1987, përkthimi frëngjisht: C. Renfrew: L'énigme indo-européenne. Archéologie et Langage, trad. Michèle Miech-Chatenay, Flammarion, Paris, 1990.
- Rexhepagiq (1971), J.: Disa elemente të gjuhës shqipe në të folmen e popullsisë së Plavës, Gjurmime albanologjike, 1, 1971, 151-156.
- Ribezzo 1940, F.: Premesse storico-linguistiche sull'autoctonia illirica degli Albanesi, Rivista d' Albania 1, f. 114 e vijim.
- Riska, A. 2005: Arumunët, Sejko, Tiranë.
- Riska, A. 2011: Trajtesa gjuhësore, Pegi, Tiranë.
- Riska, A. 2012: Shqipja dhe krishterimi, Dituria, Tiranë.
- Riza (1952), S.: Fillimet e gjuhësisë shqiptare, Prishtinë, 1952.
- Riza (1966), Selman: Sur une concordance grammaticale spécifique de l'albanais avec le grec, Comité National Albanais des Études Balkaniques, Tirana 1966, ff. 1-54
- Riza, S. (2004): Mbi një bashkëpërkim gramatikor të posaçëm të gjuhës shqipe me greqishten, Vepra 4, ASHAK, Prishtinë, 2004, 91-114;
- Riza: Vepra 4, Prishtinë 2004, ff. 91-114.
- Riza (2009), Selman: Mbi një bashkëpërkim gramatikor të posaçëm të gjuhës shqipe me greqishten, nga dorëshkrimi i vitit 1966 te Studime 10, 2004.
- Rösler (1871), R.: Romanische Studien. Untersuchungen zur älteren Geschichte Rumäniens, Leipzig.
- Rosetti: Istoria limbii române II, București 1938, ff. 34-36.
- Rosetti (1950) Alexandru: Contribuție la o istorie științifică a limbii romîne, Influența limbilor slave meridionale, Bucuresti 1950.
- Rosetti (1954), Alexandru: Influența limbilor slave meridionale asupra limbii romîne (sec. VI-XII), 1954.
- Rosetti (1967), Alexandru: Sur la reconstruction du dace, në Revue roumaine de linguistique, t. XII, no. 2, 1967, ff. 163-164.
- Rosetti (1968), Alexandru: Istoria limbii române de la origjine pînă în secolul al XVII-lea, București, 1968, ka një botim të ri 1986.
- Rosetti (1970), A.: Sur les frontieres du latin balkanique, in Revue roumaine de linguistique, XV, nr. 5, pp. 505-506.
- Rosetti (1972), Alexandru: Le Vocabulaire du sud-est européens de quelques institutions, në Proceedings of the Eleventh International Congress of Linguists, Bologna-Florence, 1972, ed. by Luigi Heilmann II, il Mulino, ff. 759-763.
- Rosetti (1972b), Alexandru: État actuel des études de linguistique balkanique en Roumanie, në Actes du Ile Congrès Internationmal des études du sud-est européens, Tome I, Athènes, 1972, ff. 450-455.
- Rosetti (1977), Alexandru: Thrace, daco-mésien, illyrien, roumain et albanais. Quelques précisions, në Linguistique balkanique XX, 1-2, Sofia, 1977, ff. 79-82.

- Rosetti (1977b), Alexandru: Slavo-romanica. Considérations sur les rapports linguistique slavo-roumains à l'époque la plus ancienne, në Analele Universității București, Limbi și literaturi străine II, anul XXVI, 1977, ff. 27-30.
- Rosetti (1978), Alexandru: Sur la parenté du roumain et de l'albanais, në Revue roumaine de linguistique, tome XXIII, 1978, Supplément, București, ff. 79-80.
- Rosetti, A.: Balcanica. Sur roum. ă, in Linguistique balkanique, XI, 1, pp. 69-70.
- Russu 1959, I. I.: Limba traco-dacilor, București 1959, E. Academiei 1967;
- Russu 1966, G.: Probleme de fonetică și fonologie dialectală, në CL XI, 1966, nr. 2, f. 352.
- Russu (1969). I. I. : Sprache der Thrako-Daker, București 1969, f. 216.
- Russu (1969a), I. I.: Illirii. Istoria, limba și onomastica, romanizarea, București.
- Russu 1970: Elemente autohtone în limba română. Substratul comun româno-albanez, Ed. Academiei, București, 1970;
- Russu 1981: Etnogeneza românilor. Fondul autohton traco-dacic și componenta latino-romanică, București, Ed. Academiei, 1981, ff. 466;
- Russu 1995: Obârșia tracică a românilor și albanezilor. Clarificări comparativ-istorice și etnologice, Vluj-Napoca, ed. Dacia, 1995)
- Sala (1967), Marius : Cintribuții la fonetica istorică a limbii române, București.
- Sala (1999), Marius: Du latin au roumain, traduction de Claude Dignoire, L'Harmattan Paris – Univers encyclopedic Bucarest, ff. 187.
- Sandfeld (1930), Kristian: Linguistique balkanique - Problèmes et résultats - Paris, 1930.
- Sawicka, Irena 1997: The Balkan Sprachbund in light of phonetic features, Energiea, Toruń.
- Schaller, Helmuth: Die Balkansprachen. Eine Einführung, Heidelberg, 1975.
- Schmitt, J. O. (2003): Genosse Aleks und seine Partei oder: Zu Politik und Geschichtswissenschaft im kommunistischen Albanien (1945-1991), në Hoepken, W. & Sundhausen, H. (Hrsg.): Studien zur Geschichte, kultur und Gesellschaft Südosteuropas, B. 4, 143-166.
- Schmitt, O. J. & Frantz, E. A. (2009) (Herausg.): Albanische Geschichte. Stand und Perspektiven der Forschung, Oldenburg Verlag, München, 13-36.
- Schramm, G. (1981): Eroberer und Eingesessene. Geographische Lehnnamen als Zeugen der Geschichte Südosteuropas im ersten Jahrtausend nach Chr., Stuttgart, 1981.
- Schramm (1994), G.: Anfänge des Albanischen Christentums. Die frühe Bekehrung der Bessen und ihre langen Folgen, Freiburg/ Brisgau, 1994.
- Schramm, G. (2006): Fillet e krishtërimt shqiptar, përkthimi shqip nga S. Gashi, Albanisches Institut, St. Gallen, 2006, ff. 316;
- Schuchard (1866-1868), Hugo: Der Vokalismus des Vulgärlateins, Vol. I-III, Leipzig.
- Schumacher, Stefan und Matzinger, Joachim (2013): Die Verben des Altalbanischen, Harrassowitz, Wiesbaden.
- Schumacher, Stefan: Lehnbeziehungen zwischen Protoalbanisch und balkanischem Latein zv. Romanisch, në O. Scmitt & E Frantz (Hrsg.): Albanische Geschichte. Stand und Perspektiven der Forschung, München, 2009, ff. 37-60.
- Schütz (1995), I.: Shënime mbi monografinë e prof. dr. Gottfried Schramm-it "Anfänge des Albanischen Christentums", në Seminari Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Tiranë, ff. 161-166.

- Seliščev (1931), A. M.: Slavjanskoe naselenie v Albanii, Sofija, 1931.
- Sergent (1995), Bernard: Les Indo-européens: histoire, langues, mythes, Paris, Payot-Rivages, 1995.
- Shytç (1989), Istvan: Përkimet gjuhësore shqiptaro-rumune dhe vazhdimësia etnike në Kosovë, in Studime filologjike 3, ff. 85-90.
- Skok (1925), Petar: Slave et Albanais, in Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju II 1924, Beograd 1925, pp. 107-168.
- Skok (1931), Petar: Byzance comme centre d'irradiation pour les mots latins des langues balkaniques, Byzantion VI, 371.
- Skok (1934a), P.: Zum Balkanlatein IV, Zeitschrift für romanische Philologie, LIV, 175-215
- Skok (1934), Petar: Dolazak Slovena na Mediteran, Split.
- Skok (1948), P.: Leksikologijske studije, Rad JAZU knj. 272, pp. 5-90, Zagreb 1948.
- Skok (1950), P.: Slavenstvo i romanstvo na jadranskim otocima, I, II, Zagreb, 1950;
- Skok (1974), Petar: Etimologijski rječnik hrvatskog ili srpskoga jezika, I-IV, Zagreb, 1971-1974;
- Snoj (2003), M.: Etimološki slovar slovenskega jezika, Ljubljana.
- Solovjev, A.(1926): Odabrani spomenici srpskog prava (od XII do kraja XV veka), Beograd, 12.
- Solta, R. (1960): Die Stellung des Armenischen im Kreise der indogermanischen Sprachen, Wien.
- Solta, G. 1980: Einführung in die Balkanlinguistik mit besonderer Berücksichtigung des Substrats und des Balkanlateinischen, Darmstadt.
- Sommer, F./ Pfister, R. (1977): Handbuch der lateinischen laut- und Formenlehre, Heidelberg, 1977, ff. 219-221.
- Sowa 2005, Wojciech: Anmerkungen zum Balkanindogermanischen, in Indogermanica, Festschrift Gert Klingenschmitt, herausgegeben von Günter Schweiger, Tübingen, Schweiger VWT-Verlag, ff. 611-628.
- Spitzer (1914), L.: Zu den linguistischen Beziehungen der Albanesen und Rumänen, in Mitteilungen des Rumänischen Instituts an der Universität Wien 1, Heidelberg, pp. 192-297.
- Stadtmüller, G. (1950): Geschichte Südosteuropas, München, 10-11.
- Stadtmüller, G. (1966): Forschungen zur albanischen Frühgeschichte, Harrassowitz, Wiesbaden.
- Stanišić (1995), Vanja: Srpsko-albanski jezički odnosi, SANU, Beograd, 1995.
- Steinke, K.: Der Ursprung des Albanischen im Spiegel der deutschen Forschung, pp. 145-151.
- Steinke, K. & Vraciu, A. (1999): Intoducere în lingvistica balcanică, Ed. Universității "Al. I. Cuza", Iași.
- Stevanović (1933-34), M.: Istočnocrnogorski dijalekat, Južnoslovenski filolog, XIII, pp. 1-128.
- Stevanović (1950), M.:Djakovački govor, Srpski dijalektološki zbornik XI.
- Stojanović, Lj. (1934): Stare srpske povelje i pisma II, Beograd-Sr. Karlovci 1934;
- Sufflay (1925), M.: Srbi i Arbanasi, Beograd, 1925.
- Sulzer, Geschichte des transalpinischen Daziens, Wien, 1871,
- Svane (1992), G.: Slavische Lehnwörter im albanischen, Acta Jutlandica LXVIII, Humanistische Reihe 67, Aarhus University Press.

- Szemerényi (1907), Oswald: Introduction to Indo-European Linguistics, Oxford U. Press, 1996. Originali gjermanisht: Einführung in die Indogermanische Sprachwissenschaft, doli më 1970.
- Tagliavini (1941): Gli elementi latini nell'albanese, Cultura neolatina I, II, ff. 90-94.
- Tagliavini 1942, Carlo: Le parlate albanesi di tipo ghego orientale, Roma, 1942.
- Tagliavini, Carlo 1968: La stratificazione dell lessico albanese, Bologna.
- Tagliavini: Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes lindore / Dardania e Maqedonia Veriperëndimore /, Studime gjuhësore, I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, 108-109 (botuar te Le terre albanesi redenti, I, Roma, 1942);
- Tamás (1936), A.: Romains, Romans et Roumains dans l'histoire de Dacie Trajane, in Archivum Europae Centro-Orientalis 2, pp. 46-83, 245-54, Budapest.
- Tasmowski, De Ryck L.: La réduplication clitique en roumain, in Akten der Theodor Gartner-Tagung, ed. G. A. Plagg and M. Iliescu, Innsbruck, pp. 282-343.
- Thallóczy, L. & Jireček, C. & Šufflay, E. (1918): Acta et diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia II, Vindobonae, reg. nr. 375. 328.
- Thomai, J.-Lloshi, Xh. (1966): Parallèles phraséologiques entre l'albanais et les autres langues balkaniques, in Studia albanica 2, Tirana, pp. 161-174.
- Thumb: 1909, A.: Allgriechische Elemente des Albanischen, in Indogermanische Forschungen 26, f. 16.
- Thunmann (1774), J.: Untersuchungen über die Geschichte der östlichen europäischen Völker, Leipzig.
- Tomaschek, Zur Kunde der haemus-Halbinsel, Wien, 1881 në Dardani,
- Topalli 2001, Kolec: Sonantet e gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë.
- Topalli 2006, Kolec: Fonetika historike e gjuhës shqipe, Tiranë.
- Topalli 2009, Kolec: Nyjat e shqipes, Botimet Toena, Tiranë.
- Topalli 2011, K.: Bazat e gramatikës historike të gjuhës shqipe, SHBLU, Tiranë.
- Toporov, V. N. Balto-albanica, Acta Balto-slavica 17, 275-293, etj.
- Treimer (1914), C.: në ZRPh XXXVIII, 1914, p. 387 și urm.
- Trummer (1976), Manfred: Die Entwicklung der mittleren Nasalvokale oder Nasaldiphthonge – zur Formulierung eines phonetischen Balkanismus, Balkansko ezikoznanie/ Linguistique balkanique XIX, 1, Sofija, pp. 17-19.
- Untermann 1964, J.: Die messapischen Personennamen;
- Uspenskij, F. (1902): Izvestija ruskogo arheologičeskogo inatituta v Konstantinopol' 7, 11, sl. 5.
- Vasilii (1968), Emanuel: Fonologia istorică a dialectelor daco-române, Editura Academiei, București.
- Vasmer (1921), M.: Studien zur albanesichen Wortforschung, Dorpat, 1921, 1-70.
- Vasmer (1937), M.: Ein albanische Lehnwort im Serbokroatischen, Zeitschrift für slavische Philologie, XIV (1937), 59-60.
- Vasmer (1970), M.: Die Slaven in Griechenland, Leipzig.
- Vătășescu, Cătălina: Vocabularul de origine latină din limba albaneză în comparație cu româna, București, 1997, ff. 543.

- Velkova (1986), Z.: The Thracian Glosses, Amsterdam, 1986.
- Vermeer (1996), W.: Linguistics and Politics: the origin of the Albanian Language, në > Dijings, D. Janjić, Sh. Maliqi (1996): Confrontation or Coexistence, Peace Research Centre, University of Nijmegen, Political Cultural Centre O42, pp. 123-132.
- Vindekens van: Le pélasgique, Louvain, 1954,
- Vraču (1965), A.: Rassuzdenija o dak-mizijskom substrate rumynskogo jazyka, in Balkansko ezikoznanie/ Linguistique balkanique IV.
- Vraciu (1980), A.: Limba daco-geților, editura Facla, Timișoara, 1980, ff. 218.
- Vraciu, Arton: Quelques remarques sur la position linguistique du thraco-dace, in Dritter internationaler thrakologischer Kongress, Staatlicher verlag SWJAT
- Vujović, Luka: Mrkovički dijalekat, Srpski dijalektološki zbornik XVIII.
- Weigand (1898), G.: Der Banater Dialekt, në WJb III, Leipzig, 1898.
- Weigand (1924), G.: Ethnographie von Makedonien, Leipzig.
- Weigand (1925), G.: Vorwort, zugleich Programm des Balkanarchivs, Balkan-Archiv I, Leipzig 1925;
- Weigand, G. (1927): Sind die Albaner die Nachkommen der Illyrier oder der Thraker?, Balkan-Archiv 3, 1927, 227-251, përthimi shqip nga A. Xhuvani te Dituria, 8, 291 dhe 9-11, 333-334, 1928, Tiranë.
- Witczak (1994), K. T.: Proto-Albanian and the Problem of the Ethnogenesis of the Albanian Nation, Biuletin polskiego towarzystwa jezykoznawczego L, 1994, ff. 21-26;
- Witczak 1995, K. T.: Were the Bessans Ancestors of the Albanians? A new opinion on the ethnogenesis of the Albanian nation. In Thraco-Dacica XVI (1-2), ff. 309-312.
- Ylli (1970, Xh.: Die slavische Lehngut im Albanischen, I, München, 1997.
- Ylli (1987), Xh.: Rreth trajtimit të derisotëm të huazimeve sllave të shqipes, Studime filologjike 1, 1987, 117-134.
- Ylli (1988), Xh.: Mbi disa huazime leksikore sllave në të folmet juglindore të shqipes, Studime filologjike, 2, 1988, 145-152.
- Ylli (1991), Xh.: Ndhimesë për inventarin e huazimeve leksikore sllave në gjuhën shqipe, Studime filologjike, 1, 1991, 75-82.
- Ylli (2000), Xh.: Die slavische Lehngut im Albanischen, II, München 2. Teil, Ortsnamen.
- Ylli (2012), Xh.: Rreth vlerësimit të huazimeve sllave në gjuhën shqipe, in Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit, ASHAK, Prishtinë, 533-544.
- Дуриданов 1976, Иван: Езикът на Траките, София.
- Георгиев 1957, В.: Тракийският език, София;
- Георгиев 1960, В.: Българска етимология и ономастика, София.
- Георгиев 1977, В.: Траките и техният език, София.
- Десницкая (1974), А. В.: О категории числа в албанском языке, in Проблемы Сравнительной филологии, Москва-Ленинград 1974, 172;
- Десницкая (1984), А. В.: Сравнительное языкознание и история языков, Ленинград.
- Десницкая (1984а), Агня Василевная: Древние германо-албанские языковые связи в свете проблем индоевропейской ареальной лингвистики, në Сравнительное языкознание и история языков, Ленинград, Наука, 1984, pp. 210-239.

- Джаукян, Г. Б. (1967): Очерки по истории дописменного периода армянского языка, Ереван 1967;
- Джаукян, Г. Б. (1982), Сравнительная грамматика армянского языка, Ереван 1982;
- Джаукян, Г. Б., Л. А. Сараджева, Ц. Р. Арутюнян (1983): Очерки по сравнительной лексикологии армянского языка, Ереван 1983.
- Нерознак 1978, В. П.: Палеобалканские языки, Москва.
- Широков (1986). О. С.: Балто-албано-славянские глоттогенетические связи по этимологическим данным, in Acta Baltico-Slavica XVII.

INDEKSI I EMRAVE

- Adams, 82
 Agani, 513
 Ahrens, 30
 Ajeti, 20, 27, 34, 35, 391, 392, 398, 469, 513, 517, 530
 Alföldy, 57, 116, 400, 513
 Altimari, 175
 Anamali, 207, 421, 514
 Antila, 514
 Appiani, 218
 Арутюнян, 165, 538
 Arapi, 27, 380, 444, 514
 Aronson, 514
 Arvinte, 355, 514
 Asenova, 17, 374, 514
 August, 220
 Avram, 514
 Bader, 116, 514, 516
 Bakija, 88
 Balotă, 76, 514
 Banfi, 17, 145, 182, 183, 184, 185, 252, 254, 255, 257, 274, 345, 439, 449, 514, 525
 Barborică, 382, 520
 Barić, 28, 33, 34, 35, 43, 45, 46, 88, 89, 90, 91, 92, 93, 95, 97, 120, 132, 136, 149, 166, 178, 228, 229, 247, 257, 287, 288, 315, 321, 336, 354, 355, 376, 387, 392, 394, 395, 396, 452, 469, 474, 484, 493, 501, 514, 515
 Barjaktarević, 515
 Bartl, 104, 205, 515
 Bartoli, 164, 280, 309, 515
 Basha, 10
 Beci, 20, 316, 317, 318, 429, 515
 Bednarczuk, 69, 131, 161, 226, 515
 Belluscio, 175
 Benveniste, 109, 169, 515
 Berkeley, 522
 Bërlajolli, 27, 523
 Biçoku, 207, 514
 Birnbaum, 171, 172, 173, 193, 515
 Biso, 13, 38, 175, 198, 322, 522, 523
 Blaku, 469, 515
 Bokshi, 10, 15, 20, 27, 54, 106, 159, 168, 288, 335, 380, 381, 403, 408, 414, 415, 416, 417, 432, 433, 443, 461, 515, 517, 518, 530
 Bolocan, 376, 517
 Bonfante, 115, 120, 221, 343, 515
 Bonnet, 396, 398, 399, 515
 Bopp, 29, 42, 137, 138, 224, 515
 Boretzky, 13, 515
 Borgeaud, 115
 Brâncuș, 285, 288, 306, 307, 308, 310, 320, 321, 322, 323, 324, 325, 326, 327, 332, 333, 335, 336, 353, 357, 358, 359, 360, 361, 362, 363, 365, 366, 367, 369, 370, 375, 376, 377, 378, 383, 387, 388, 389, 423, 424, 427, 429, 430, 458, 462, 515, 516, 527, 530

- Breidaks, 131, 161, 516
- Brixhe, 12, 102, 105, 156, 516
- Brugmann, 42, 90
- Buchholz, 516
- Buda, 5, 143, 205, 206, 207, 224, 225, 228, 229, 230, 231, 232, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 241, 243, 256, 261, 262, 263, 267, 268, 516, 523
- Budimir, 208, 219, 220, 222, 228, 516
- Budziszewska, 516
- Bugge, 42
- Buzuku, 144, 168, 281, 392, 398, 412, 480, 492, 493
- Bynon, 173
- Çabej, 12, 13, 20, 27, 28, 33, 34, 35, 38, 43, 44, 49, 50, 51, 61, 62, 63, 64, 69, 83, 99, 106, 108, 111, 119, 130, 140, 141, 143, 144, 154, 156, 163, 165, 166, 167, 168, 176, 178, 182, 183, 199, 205, 207, 208, 226, 227, 228, 230, 233, 251, 257, 261, 262, 268, 271, 272, 273, 278, 279, 280, 281, 282, 283, 284, 285, 286, 288, 317, 321, 323, 325, 326, 332, 335, 336, 339, 340, 342, 344, 347, 354, 358, 360, 370, 375, 380, 383, 387, 392, 397, 398, 403, 407, 409, 410, 411, 412, 413, 417, 425, 430, 438, 439, 447, 448, 449, 452, 454, 455, 469, 472, 493, 496, 497, 517, 518, 525
- Călărașu, 382, 520
- Camaj, 312, 496
- Camarda, 29, 30, 228, 409, 413, 516
- Campbell, 16, 516
- Candrea, 335
- Capidan, 288, 308, 310, 321, 335, 336, 383, 387, 400, 516
- Caragiu-Marioțeanu, 376, 517
- Caton, 220
- Cazacu, 519
- Ceka, 207
- Cimochowski, 12, 27, 34, 35, 44, 59, 120, 140, 156, 163, 176, 178, 365, 516, 517
- Ćirković, 264, 518
- Civjan, 517
- Clewing, 517
- Condurachi, 517
- Ćorović, 264, 517, 518
- Coteanu, 183, 363, 376, 517, 528
- Čović, 215, 216, 217, 218, 219, 226, 518
- Curtis, 469
- Cvasnii, 382, 520
- Daicoviciu, 517
- Daņcetoviq, 518
- Davidescu, 191
- de Simone, 45, 64, 83, 219
- Deanović, 171
- Dečev, 12, 43, 93, 94, 96, 97, 98, 156, 222, 338, 358, 383, 518
- Delamarre, 120
- Demiraj, Bardhyl 20, 161, 325, 326, 327, 328, 331, 351, 382, 499, 520
- Demiraj, Shaban 17, 20, 27, 28, 33, 34, 35, 43, 54, 64, 69, 83, 84, 106, 108, 141, 154, 156, 159, 165, 167, 228, 257, 265, 281, 283, 284, 285, 286, 287, 288, 297, 323, 324, 325, 326, 329, 349, 373, 378, 380, 402, 404, 434, 435, 436, 437, 442, 444, 497, 518, 519
- Densusianu, 254, 291, 298, 299, 300, 301, 302, 303, 335, 337, 361, 383, 394, 400, 442, 482, 519
- Desnickaja, 34, 35, 36, 39, 40, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 106, 131, 140, 156, 158, 161, 163, 166, 180, 182, 199, 202, 226, 227, 230, 271, 319, 382, 383, 401, 402, 424, 437, 469, 483, 484, 485, 486, 493, 494, 499, 502, 515, 519, 537, shih Десницкая
- Detschew, 120, 358
- Devoto, 135
- Dhima, 421

- Dhrimo, 132, 530
- di Giovine, 92, 94, 95, 97, 98, 99, 109, 120, 166, 322, 392, 393, 395, 396, 519
- Dimitrescu, 332, 382, 383, 384, 387, 388, 532
- Diokletian, 355
- Dionis, 61
- Dioskorid, 128
- Djerić, 519
- Dodbiba, 154
- Dodi, 389
- Đokaj, 519
- Domi, 20, 21, 24, 27, 34, 35, 61, 205, 283, 288, 354, 370, 374, 380, 383, 421, 519, 520
- Domosileckaja, 520
- Dragomir, 520
- Drimba, 376, 517
- Drobeta, 14, 38, 191, 313, 401, 428, 466
- du Nay, 186, 287, 288, 303, 305, 400, 462, 536
- Duka, 207, 514
- Dumitrescu, 385, 482, 520
- Duridanov, 12, 58, 68, 74, 94, 98, 120, 127, 155, 156, 158, 161, 163, 191, 197, 304, 358, 427, 469, 493, 494, 495, 496, 499, 500, 520
- Dušan, 240, 473, 491, 492
- Džaukjan, 165
- Ebert, 33, 525
- Eichner, 104, 106, 111, 520, 528
- Elezović, 520
- Epirit, 115
- Erdeljanović, 318, 476
- Ernaut-Meillet, 520
- Eutorpius, 279, 520
- Ferjančić, 520
- Feuillet, 521
- Fiedler, 29, 30, 31, 112, 164, 167, 226, 410, 517, 521, 526
- Fischer, 376, 517, 518, 522
- Fishta, 503, 504
- Floqi, 20, 283, 288, 380, 521
- Fortson IV, 79, 521
- Frâncu, 274, 288, 329, 341, 358, 417, 418, 419, 420, 455, 521
- Frantz, 534
- Frashëri, 208, 209, 219, 224, 225, 493
- Friedman, 16, 18, 277, 329, 521, 523
- Friedwagner, 254, 279, 303, 309, 521
- Gabinschi, 288
- Galdi, 400
- Gamillscheg, 399
- Garašanin, 150, 151, 152, 207, 209, 518, 520, 521, 524, 530, 532
- Garde, 521
- Gashi, 27, 233, 529, 534
- Genesin, 517, 526
- Georgiev, 12, 34, 38, 43, 44, 46, 58, 93, 94, 95, 96, 97, 98, 99, 116, 117, 119, 120, 121, 125, 127, 147, 149, 155, 156, 161, 162, 163, 166, 169, 173, 178, 191, 197, 200, 222, 227, 228, 229, 250, 265, 266, 276, 288, 292, 313, 321, 327, 332, 338, 353, 354, 356, 358, 370, 374, 383, 385, 427, 458, 521, 537
- Gilberts, 527
- Gimbutas, 209, 211, 212, 213, 214, 215, 225, 226, 522
- Gindin, 329, 330, 402, 522
- Giuglea, 383
- Gjinari, 317, 319, 469, 480, 484, 522
- Gjokaj, 478
- Gjuzelev, 473, 522
- Golopenția Eretescu, 516
- Graur, 14, 173, 288, 334, 385, 429, 522, 532
- Grimm, 30
- Haarmann, 183, 344, 447, 522

- Haas, 45, 64, 82, 83, 116, 121
Hague, 522
Hahn, 30, 120, 257, 297, 316, 318, 338
Hajnal, 15, 101, 102, 110, 111, 522
Halimi, 522
Hammond, 83, 531
Hamp, 12, 13, 15, 18, 21, 27, 32, 35, 36, 37, 38, 44, 48, 59, 61, 63, 64, 68, 70, 83, 84, 87, 100, 103, 112, 113, 114, 117, 119, 120, 122, 139, 140, 156, 157, 158, 159, 161, 162, 164, 167, 169, 174, 175, 176, 178, 179, 180, 181, 182, 186, 187, 188, 189, 190, 191, 192, 193, 194, 196, 197, 198, 199, 200, 201, 202, 226, 227, 251, 271, 288, 295, 311, 312, 313, 314, 315, 320, 322, 328, 331, 379, 425, 428, 429, 469, 490, 496, 498, 522, 523
Hasdeu, 288, 290, 291, 292, 293, 294, 295, 297, 298, 301, 306, 332, 335, 336, 337, 342, 370, 376, 383, 400, 458, 523, 530, 531
Haxhimihali, 205, 516, 523
Heinal, 452
Hermann, 99, 136, 513, 514, 520, 524
Herodoti, 121
Hesiku, 61, 62
Hinrichs, 516, 520, 523
Hirt, 33, 42, 59, 88, 92, 93, 100, 120, 136, 222, 229, 336, 523
Hitler, 150
Hock, 106
Holm, 452, 523
Holzer, 393, 496, 523
Hoxha, 236, 524
Huld, 33, 82, 85, 119, 159, 226, 424, 425, 426, 524
Ibanes, 159
Iliescu, 376, 517
Ilievski, 524
Iordan, 135, 532
Isaković, 149, 524
Isbășescu, 376, 517
Islami, 207, 514, 516
Ismajli, 27, 31, 33, 35, 36, 42, 43, 45, 84, 92, 93, 94, 100, 109, 135, 153, 158, 179, 197, 215, 227, 276, 283, 314, 322, 344, 360, 362, 376, 380, 381, 384, 412, 428, 440, 480, 516, 517, 522, 523, 524, 525, 527, 528, 529, 530
Issatschenko, 187
Ivănescu, 327, 383, 399, 417, 524
Ivić, 473, 477, 524
Ivšić, 267, 525
Jašar-Nasteva, 525
Jireček, 148, 162, 172, 180, 181, 182, 195, 234, 245, 252, 254, 255, 265, 311, 312, 314, 315, 400, 428, 492, 525, 536
Jokl, 13, 27, 30, 31, 33, 42, 43, 44, 45, 48, 49, 50, 53, 59, 63, 77, 88, 90, 93, 95, 96, 97, 98, 99, 100, 111, 119, 120, 140, 142, 143, 144, 149, 155, 163, 164, 176, 178, 180, 182, 187, 190, 197, 199, 200, 201, 226, 230, 237, 239, 247, 248, 255, 256, 258, 271, 283, 284, 305, 310, 317, 321, 332, 333, 336, 342, 350, 354, 373, 376, 377, 383, 387, 392, 438, 439, 440, 469, 472, 477, 478, 490, 493, 494, 496, 498, 513, 514, 520, 524, 525
Joseph, 23, 378, 429, 521, 525, 526
Kaleshi, 28, 514
Kalleris, 12
Kalužskaia, 329, 348, 399, 400, 464, 522
Karpate, 75, 76
Kastriota, 150
Katičić, 12, 35, 44, 45, 57, 62, 102, 106, 116, 117, 118, 120, 124, 125, 128, 129, 130, 131, 137, 146, 156, 163, 219, 228, 251, 256, 267, 322, 436, 526
Kiepert, 92, 523
Klagenfurt, 522
Klemenčić, 123, 526

- Klepikova, 186, 190, 194, 526
 Klewing, 526
 Klingenschmit, 526
 Klingenschmitt, 76, 84, 85, 109, 110, 112, 229, 526, 535, 538
 Ködderitzsch, 58, 120, 421, 422
 Komata, 421
 Kopitar, 16, 288, 289, 302, 338, 383, 526
 Korkuti, 207, 208, 514
 Kortlandt, 120, 121, 526
 Kostallari, 104
 Kovačec, 361, 526
 Krae, 55
 Krahe, 32, 44, 51, 55, 56, 59, 61, 81, 97, 115, 116, 119, 146, 156, 163, 169, 200, 209, 211, 526
 Kretschmer, 42, 53, 116, 120, 121, 383, 525
 Krishti, 14, 38, 39, 106, 112, 132, 150, 160, 166, 198, 211, 217, 259, 293, 296, 314, 404, 405, 421, 426, 427, 431
 Kristophson, 183, 444, 446, 447, 448, 450, 526
 Kronasser, 44, 57, 115, 120, 527
 Kuçi, 39, 527
 La Piana, 403, 410, 414, 432, 433, 527
 Lafe, 324, 326, 333, 380, 527
 Landi, 392, 424, 527
 Lasgushi, 503, 504
 Lazzeroni, 64
 Leibnitz, 105
 Lejeune, 116, 117, 118, 119, 120, 200
 Lindstedt, 18, 527
 Liukkonen, 35, 131, 161, 527
 Liukkonen, 35
 Lloshi, 283, 536
 Loma, 165, 257, 262, 266, 492, 493, 527
 Lombardo, 64, 252, 345, 514
 Macarie, 376, 517
 Macrea, 280, 385
 Mair, 199, 523
 Majer, 219
 Majer-Lipke, 220
 Malcolm, 258, 259, 260, 261, 527
 Mallory, 81, 82, 527
 Malte-Brun, 30
 Mann, 119, 160
 Mansaku, 27, 35, 106, 142, 228, 319, 437, 438, 439, 440, 441, 442, 443, 444, 527
 Marta, 520
 Martinet, 215, 225, 497, 527
 Matasović, 527
 Matrënga, 85, 480, 486, 527
 Matzinger, 12, 64, 65, 66, 67, 85, 100, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 108, 110, 117, 227, 229, 233, 257, 517, 526, 527, 528
 Mayani, 236
 Mayer, 32, 35, 59, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 78, 97, 116, 156, 158, 203, 226, 528
 Mayser, 404, 528
 Meid, 115, 133, 528
 Meier-Brügger, 110
 Meillet, 31, 32, 33, 528
 Meksi, 421
 Meyer, 30, 31, 33, 35, 40, 42, 45, 49, 50, 51, 62, 63, 90, 105, 119, 120, 138, 140, 141, 146, 163, 225, 226, 230, 254, 256, 271, 282, 288, 290, 301, 303, 312, 316, 327, 336, 339, 383, 387, 410, 423, 434, 435, 438, 447, 466, 490, 493, 496, 497, 528
 Meyer-Lübke, 254, 434, 435, 447, 466, 528, shih Majer-Lipke, Majer-Lybke,
 Mihăescu, 13, 106, 145, 183, 275, 276, 291, 344, 345, 346, 354, 376, 383, 434, 437, 439, 447, 448, 452, 466, 467, 517, 528
 Mihai, 118, 382
 Mihăilă, 452, 482, 483, 500, 528, 529

- Miklošič, 16, 27, 264, 284, 288, 302, 370, 373, 376, 383, 400, 458, 469, 478, 529, shih Miklosich,
- Mirčev, 265, 529
- Mirdita, 279, 280, 529
- Miret, 376, 399
- Mišeska-Tomić, 22, 23, 24, 529
- Mladenov, 93, 120, 361, 362, 364, 529
- Muljačić, 448
- Munishi, 27, 523
- Murati, 469, 529
- Naçi, 207, 514
- Nay, 520
- Nemanja, 264, 265
- Neroznak, 12, 35, 44, 45, 57, 58, 60, 62, 66, 156, 169, 322, shih Нерознак
- Nesimi, 529
- Neumann, 102
- Njeroznak, 35
- Nocentini, 405, 529
- Ölberg, 13, 87, 513, 514, 520, 524, 529
- Omari, 469, 529
- Orel, 57, 62, 76, 131, 159, 161, 329, 349, 497, 522, 529
- Paçarizi, 27, 84, 523
- Paliga, 167, 288, 306, 378, 417, 420, 421, 422, 423, 424, 425, 426, 427, 483, 530
- Pallotino, 64
- Pamfil, 382, 520
- Panaitescu, 253, 530
- Panayotou, 102, 105, 156, 516
- Papahagi, 335
- Papazoglu, 147, 148, 149, 207, 215, 250, 530
- Parlangeli, 64, 83, 116
- Pärvan, 144, 342, 400
- Pătruț, 363, 452, 482, 483, 530
- Pauli, 53, 88, 120, 229
- Pedersen, 14, 27, 29, 32, 42, 45, 63, 77, 85, 88, 91, 92, 99, 105, 106, 111, 131, 132, 140, 141, 147, 163, 164, 176, 227, 228, 229, 230, 255, 271, 301, 334, 336, 337, 342, 403, 423, 432, 433, 526, 529, 530
- Pellegrini, 33, 35, 43, 69, 83, 140, 141, 226, 436, 448, 530
- Pešikan, 474, 475, 476, 530
- Petrovici, 355, 389, 390, 400, 471, 482, 500, 530, 531
- Pfister, 404, 535
- Philippide, 144, 182, 248, 252, 295, 296, 303, 305, 306, 307, 327, 335, 336, 338, 343, 383, 387, 388, 400, 458, 531
- Pîrvan, 383
- Pisani, 32, 44, 46, 89, 90, 115, 119, 135, 136, 137, 140, 169, 241, 243, 244, 246, 497, 531
- Pižurica, 473, 477, 531
- Pllana, 27, 523
- Poghirc, 12, 13, 94, 98, 156, 276, 288, 290, 291, 292, 357, 360, 370, 372, 373, 374, 375, 376, 384, 385, 389, 427, 428, 458, 462, 517, 524, 531, 532
- Pokorny, 49, 50, 59, 115, 220, 221
- Polák, 316, 319, 479, 483, 532
- Polomé, 120, 121, 161, 197
- Popescu, 376, 517
- Popović, 147, 150, 152, 153, 238, 262, 263, 304, 319, 469, 470, 471, 472, 478, 481, 483, 490, 493, 532
- Porzig, 32, 77, 78, 112, 116, 119, 201, 531, 532
- Prendi, 207, 209, 225, 514, 532
- Prosdocoimi, 64
- Ptolomeu, 62, 80, 120, 121, 167, 296
- Pulaha, 207, 514
- Pulgram, 522
- Puşcariu, 120, 288, 308, 309, 335, 337, 383, 387, 400, 447, 532
- Rădulescu, 12, 38, 64, 114, 116, 118, 119, 120, 121, 227, 532

- Ramovš, 266, 267, 532
- Rask, 29
- Rasmunsen, 85, 526
- Reichenkron, 97, 120, 178, 329, 338, 383, 417, 427, 533
- Reiter, 171, 533
- Renfrew, 31, 533
- Rexhepagiq, 533
- Ribezzo, 93, 120, 533
- Riska, 533
- Ritter, 111
- Riza, 15, 106, 111, 205, 228, 288, 335, 403, 409, 410, 411, 412, 413, 414, 415, 432, 443, 469, 484, 501, 533
- Rosetti, 120, 173, 252, 255, 273, 274, 276, 277, 278, 280, 288, 291, 310, 315, 321, 325, 334, 338, 353, 354, 355, 356, 357, 363, 370, 383, 385, 389, 390, 400, 452, 456, 458, 482, 500, 516, 522, 526, 531, 533, 534
- Rösler, 254, 303, 400, 533
- Rossi-Landi, 183
- Roxândoiu, 382, 520
- Rugova, 10, 27, 100, 523, 528
- Russu, 13, 59, 94, 95, 96, 97, 173, 190, 275, 288, 290, 298, 306, 322, 327, 336, 337, 338, 339, 340, 342, 343, 344, 345, 346, 357, 358, 363, 383, 385, 387, 399, 400, 417, 421, 422, 427, 430, 519, 534
- Sala, 212, 368, 376, 391, 393, 517, 527, 534
- Sandfeld, 16, 282, 288, 370, 442, 534
- Santoro, 64, 83, 116
- Sawicka, 21
- Schaller, 17, 534
- Schleicher, 16, 28, 29, 30, 41, 138, 227
- Schmidt, 28, 30, 31, 227
- Schmitt, 205, 206, 534
- Schramm, 34, 101, 108, 159, 165, 229, 233, 251, 257, 258, 259, 260, 399, 521, 534
- Schuchardt, 120, 183, 254, 288, 302, 383, 458
- Schumacher, 14, 101, 106, 107, 352, 379, 402, 403, 404, 405, 406, 409, 429, 430, 431, 432, 433, 534
- Schütz, 288, 534, shih Shytc, 535
- Schweiger, 109, 535
- Schwyzler, 115
- Segent, 58
- Seliščev, 153, 178, 238, 262, 315, 319, 469, 472, 478, 483, 485, 490, 493, 498, 499, 535
- Šerb, 519
- Serdicae, 197
- Sergent, 35, 114, 115, 116, 117, 118, 119, 120, 121, 122, 159, 197, 535
- Shtip, 202
- Sims, 23
- Skenderbeg, 150, 491
- Skok, 90, 182, 183, 252, 254, 267, 304, 309, 319, 437, 452, 469, 483, 490, 492, 493, 535
- Skoku, 171, 492, 515
- Snoj, 27, 496, 529, 535
- Šobajjić, 476
- Solovjev, 264, 535
- Solta, 17, 85, 171, 448, 449, 497, 535
- Sommer, 404, 535
- Sowa, 109, 110, 111, 535
- Spitzer, 288, 535
- Stadtmüller, 120, 130, 165, 233, 234, 235, 236, 237, 239, 240, 241, 243, 244, 245, 246, 247, 248, 249, 251, 253, 254, 255, 256, 257, 280, 303, 338, 425, 531, 535, shih Shtadtmyler, 235, 237, 239
- Stanišić, 469, 472, 473, 492, 535
- Stati, 376, 517
- Steinke, 417, 535
- Stevanović, 535

- Stojanović, 535
- Straboni, 62, 78, 121, 198, 218, 316
- Šufflay, 265, 380, 501, 502, 535, 536
- Sulzer, 254, 400, 535
- Svane, 13, 452, 469, 470, 493, 502, 536
- Szemerényi, 536
- Tagliavini, 247, 248, 249, 252, 255, 316, 317, 338, 361, 383, 536
- Tamás, 288, 303, 383, 400, 536
- Tasmowski, 536
- Thaçi, 28, 514
- Thallóczy, 265, 492, 536
- Theodorescu, 382, 520
- Thomaj, 283, 536
- Thumb, 13, 77, 96, 111, 142, 536
- Thunmann, 16, 30, 42, 105, 137, 141, 257, 288, 289, 302, 536
- Tocilescu, 383
- Toma, 382, 520
- Tomaschek, 121, 254, 292, 383, 400, 536
- Tomor, 202
- Topalli, 54, 69, 70, 141, 160, 407, 408
- Torogov, 132, 161, 536
- Топииа, 265
- Treimer, 288, 336, 375, 536
- Trombetti, 287, 497
- Trubeckoi, 16, 173
- Trummer, 536
- Untermann, 45, 536
- Uspenskij, 536
- Vasiliiu, 391
- Vasmer, 120, 315, 536
- Vătăşescu, 183, 275, 288, 424, 448, 449, 450, 451, 537
- Velkova, 102, 537
- Vindekens, 12, 228, 537
- Vopiscus, 279
- Vraciu, 12, 13, 121, 156, 358, 383, 385, 417, 535, 537
- Vraču, 537
- Vrana, 267
- Vujović, 477, 537
- Wald, 183, 528
- Weigand, 16, 18, 33, 34, 42, 43, 93, 100, 108, 120, 149, 153, 155, 166, 191, 229, 247, 257, 262, 281, 288, 332, 336, 339, 359, 361, 370, 376, 387, 400, 452, 456, 478, 537
- Whatmough, 36, 44, 115, 120, 174, 200, 522
- Witzak, 34, 132, 160, 229, 233, 537
- Xhufi, 207, 514
- Xhuvani, 20, 288, 380, 537
- Xylander, 41
- Ylli, 13, 452, 469, 493, 502, 537
- Zenkevičius, 165
- Zeuss, 30
- Zheku, 207, 532
- Дуриданов, 68, 537
- Георгиев, 34, 537
- Десницкая, 34, 41, 42, 43, 44, 47, 515, 537, 538
- Джаукян, 165, 538
- Нерознак, 35, 58, 59, 60, 61, 62, 112, 156, 327, 538
- Сараджева, 165, 538

Rexhep Ismajli
STUDIME PËR HISTORINË E SHQIPES NË KONTEKST BALLKANIK
2015

Botues
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Redaktor teknik:
ASHAK

Realizimi kompjuterik:
ASHAK

Madhësia: 34.25 tabakë shtypi
Tirazhi: 500 copë
Formati: 16x24 cm

Shtypi:
Focus Print
Shkup

Katalogimi në publikim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

811.18-26
811.135/.18(497)

Ismajli, Rexhep

Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik / Rexhep Ismajli. - Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2015. – 547 f.: 24 cm. - (ASHAK: Botime të Veçanta; CLII: Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë; Libri 55)

Titulli paralel në gjuhën shqipe dhe angleze. – Parathënie: f.[7]-11 – Bibliografi e përbashkët: f. 513-538. – Indeksi i emrave f. 539-546

ISBN 978-9951-615-54-9